Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXV nr. 81 / 2006

Edukata Islame
Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXV nr. 81 - 2006

Botues:
Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës
Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84
Tel & fax: 038 / 224-024
e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:
Mr. Qemajl Morina
qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:
Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr.Pajazit Nushi,
Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahimi,
Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë: ***Hajrullah Hoxha***

Lektor: Bislim Berisha
Korrektor: Skender Rashiti

Realizimi: **Shtëpia Botuese**
Operator kompjuterik: Nuhi Simnica

Shtyp: *Koha* - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXV nr. 81 / 2006

Prishtinë
2006

EDITORIALI

Mr. Qemajl Morina

"GJASHTË SHEKUJ TË ISLAMIT NDËR SHQIPTARËT"*

Të nderuar pjesëmarrës, mysafirë, miq e dashamirë!

Kam nderin dhe kënaqësinë që, në emër të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë dhe në emrin tim personal, t'ju përshëndes dhe t'ju shpreh mirëseardhjen në simpoziumin **"Gjashtë shekuj të Islamit ndër shqiptarët".** Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë komisionin organizues, si dhe të gjithë ata që kanë kontribuar me relacionet e tyre, që do t'i japin këtij simpoziumi nivelin e duhur shkencor.

Trojet shqiptare, toka ku Lindja hedh hapin drejt Perëndimit dhe Perëndimi drejt Lindjes, Islami takohet me Krishterimin dhe Krishterimi me Islamin, toka, ku kulturat përpiqen dhe takohen, ku historia takohet me dritëhijet e saj dhe endet me fijet shumëllojshe të kohëve që herë - herë marrin forma të pakuptueshme. Po, është e vështirë, por është edhe sfidë urgjente të përballosh nevojën dhe kërkesën për të reflektuar mbi rrënjët dhe trungun e këtij populli, sa të lashtë aq edhe të ri, sa të njohur aq edhe të panjohur, sa të vuajtur e të përvuajtur aq

* Fjala hyrëse e mbajtur në Simpoziumin "Gjashtë shekuj të Islamit ndër shqiptarë", mbajtur më 15-16 shtator 2006, organizuar nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë.

edhe me të drejtën për të gëzuar e afirmuar identitetin e vet, që fshihet në velin e viteve dhe të shekujve.

Kurrë më shumë se sot nuk ka qenë magjepsës angazhimi për të hedhur një shikim retrospektiv mbi kthesat e së kaluarës. Rrjedha e moteve ka nevojë për prehjet e veta, ka nevojë ta ndalojë hapin për të bërë llogaritë me vetveten, ka nevojë të freskohet me ujin e gurrës së vet, që të gëzojë lehtësinë e shtegtarit të palodhshëm. Ka nevojë për një jubile. Kështu rizgjohet kujtesa e bashkë me të edhe nostalgjia për të shkuarën dhe ëndja për të ardhmen.

Islam. Troje shqiptare. Histori. Ç'kanë për t'i thënë sot këtij kombi këto terma? Ky komb çfarë ka për t'i thënë botës sot me të shkuarën dhe me të tashmen e tij? Këtu përsiatja bëhet e vështirë, por e pashmangshme.

Për këto, dhe shumë çështje të tjera do të bëhet fjalë në simpoziumin "Gjashtë shekuj të Islamit ndër shqiptarët" - tema bosht e të cilit është madhore. Ajo është sa tradicionale aq edhe aktuale, sa teologjike aq edhe historike, sa filozofike aq edhe pedagogjike, sa universale aq edhe kombëtare. Islami është taban i rëndësishëm i qytetërimit botëror, por njëkohësisht edhe i qytetërimit shqiptar. Këtij besimi i përkasin mbi një miliard njerëz nga të gjitha meridianët e rruzullit tokësor, por edhe shumica dërrmuese e shqiptarëve i takojnë këtij besimi. Kultura dhe besimi islam është i ngulitur thellë në qenien e tyre. Islami ka ndikuar në ndërgjegjen e besimtarëve shqiptarë, madje jo vetëm në ndërgjegjen e tyre, por në ndërgjegjen e çdo shqiptari.

Tradita islame, për shkaqe politike dhe ideologjike, për shkaqe të mendimit sekularist dhe ateist, u trajtua në mënyra fragmentare, tendencioze, të njëanshme dhe gjithnjë në kontekstin negativ dhe denigrues, si anakronizëm dhe obskurantizëm i së kaluarës së dështuar. Thënë shkurt ne na mësonin ta urrejmë historinë tonë pesëqindvjeçare dhe - duke urryer atë pjesë të historisë sonë ta urrejmë vetveten. Fatkeqësisht në disa raste kështu veprohet edhe sot.

Ka ardhur koha të hedhim poshtë mite e legjenda, të pavërteta e gjysmë të vërteta e të përqendrohemi në studime serioze e me karakter të mirëfilltë shkencor të shkaqeve dhe të rrjedhimeve të veprimeve të

së kaluarës, në qoftë se duam të kuptojmë të tashmen e të përgatisim të ardhmen e atdheut shqiptar e të shoqërisë shqiptare.

Dëshiroj të theksoj se përpjekja jonë të kuptojmë historinë është, siç thuhet shpesh herë, burimi i urtësisë, i pjekurisë sonë. Le të mos harrojmë se edhe interpretimet tona të historisë janë, në një masë të madhe, të përcaktuara nga vetë historia jonë; prandaj hapësira për interpretime është e pakufishme. Pikërisht këtu gjen terrenin e përshtatshëm fryma e kërkimeve, e debatit, e përfundimisht e debatit të lirë. "Historia mund të keqkuptohet, shkruan prof. J.M. Roberts, nga Universiteti i Oxfordit, - ose të keqinterpretohet, me rezultate shkatërrimtare. Historia e shtrembëruar është mësues i rrezikshëm. Por, sot më shumë se kurrë, kemi nevojë për një histori të saktë".

Na mban shpresa se puna dhe rezultatet e këtij simpoziumi shkencor, të këtij kuvendi të intelektualëve dhe të shkencëtarëve eminentë vendas dhe të ndërkombëtarë, do të shënojnë një hap serioz e cilësor, në ndriçimin e aspekteve të ndryshme të Islamit ndër shqiptarët, nga fillimi i përhapjes së tij në këto troje e deri në ditët tona. Kjo do të ndikojë edhe në rivlerësimin dhe ridimensionimin shkencor të Islamit te ne, si dhe religjioneve të tjera ndër shqiptarët në përgjithësi.

Ndriçimi i Islamit si teori dhe praktikë, me vlera universale, në kushte të veçanta historike të popullit shqiptar, është një punë fisnike, është dhe do të jetë obligim i vazhdueshëm i yni dhe i shkencës sonë ndaj kësaj tradite të çmuar shumëshekullore të njerëzimit. Pa ndriçimin shkencor, me kompetencë e dashamirësi të Islamit, por edhe të religjioneve të tjera ndër shqiptarët, historiografia jonë do të vazhdojë të jetë e mangët, jo e plotë.

Ne shqiptarët me bagazhin tonë të vjetër kulturo-historiko – islam, në një anë , si dhe me përkatësinë tanë evropiane në anën tjetër, kemi privilegjin të jemi urë afrimi dhe mirëkuptimi midis Lindjes dhe Perëndimit, botës islame dhe asaj të krishterë, në mënyrë të veçantë, në kohën në të cilën po jetojmë.

Dhe në fund, shpresoj se ju, pjesëmarrës të respektuar të këtij simpoziumi, do të gjeni forcë mendore e guximin e duhur intelektual të trajtoni subjektin "Gjashtë shekuj të Islamit ndër shqiptarët", me me-

ndje të hapur dhe ndërgjegje të plotë, pavarësisht nga paevitueshmëria e nxjerrjes në shesh të ngjarjeve jo të këndshme të së kaluarës sonë të rëndë. Asnjëri nga ne nuk është përgjegjës për gabimet e së kaluarës, por të gjithë ne jemi përgjegjës në qoftë se lejojmë përsëritjen e gabimeve të së kaluarës.

Kam besim të plotë se ndershmëria në shkencë triumfon me të vërtetën.

Duke ju falënderuar edhe një herë, ju uroj punë të mbarë!

Qemajl Morina

"SIX CENTURIES OF ISLAM AMONG THE ALBANIANS"

(Summary)

Dear participants, guests and friends!

I have the honor and pleasure to greet you and to welcome you to this symposium on behalf of the Faculty of Islamic Studies in Prishtina. I would like to express my special thanks to the organizing committee as well as to all those who will participate in this symposium, giving it an adequate scientific level.

The territories inhabited by Albanians are the meeting point between the East and the West, Islam and Christianity, the place in which different cultures interact. The need to reflect over the history of this nation, which has the right to enjoy and affirm its identity, hidden under the veil of many years and centuries, is a difficult and a challenging task.

كمال مورينا

"ستة قرون على الاسلام بين الالبان"

(الكلمة الافتتاحية للمؤتمر)

(خلاصة البحث)

المشاركون و الضيوف و الاصدقاء الاعزاء

انتهز هذه الفرصة لاحييكم باسم كلية الدراسات الاسلامية في برشتينا و باسمى الشخصى و أرحب بمشاركتكم في المؤتمر العلمى "ستة قرون على الاسلام بين الالبان". و أحب ان أشكر بصفة خاصة اللجنة المنظمة للمؤتمر و كذلك كل الذين ساهموا ليتكلل هذا المؤتمر بنجاح.

ان الوطن الالبانى حيث يلتقى الشرق مع الغرب، حيث يلتقى الاسلام مع المسيحية و المسيحية مع الاسلام، المكان الذي تلتقى فيه الحضارات و الثقافات و يكتب فيه التاريخ الذي قد يبدو بعض الاحيان متناقضا بعض الشئ. عليه ليس من السهل كتابة تاريخ هذا الشعب العريق في جذوره و الحيوى في حاضره و المشهور و المجهول في الوقت نفسه و الذي عانى الكثير خلال تاريخه الطويل لاجل أن يحافظ على هويته و شخصيته عبر السنين و القرون.

KUMTESË

Akademik Jashar Rexhepagiq

DISA PËRPARËSI TË ARSIMIT NË KOSOVËN E RE, EVROPIANE DHE MODERNE

Me siguri se duke shpresuar se së shpejti Kosova do të jetë një realitet i ri, përparimtar dhe gjithnjë më i përsosur, mund të dallojmë së paku dhjetë veçori thelbësore të arsimit në të. Ato janë:

1. *Arsimi do të jetë më i avancuar në të gjitha trevat e Kosovës*, pasi sidomos organet shtetërore dhe arsimore më shumë do të kujdesen për institucionet arsimore dhe për edukimin e gjithë popullatës. Edhe në dokumente të shumta evropiane dhe ndërkombëtare, posaçërisht të UNESKO-s si dhe në Strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017, u theksua nevoja e realizimit të idesë themelore: *Arsimi për të gjithë.*
2. *Arsimi në të gjitha nivelet do të jetë më i unisuar, më tepër demokratik dhe më kreativ*, pasi tërë shoqëria në frymën e proceseve integrale do të inkuadrohet në ngritjen permanente të fëmijëve, të rinisë dhe të qytetarëve.
3. *Arsimi fillor, i mesëm dhe i mesëm i lartë dhe shëndetësia, shpresojmë, do të jenë pa pagesë.*
4. *Baza materiale e shkollave, e kuadrit mësimor dhe e arismit në tërësi do të përmirësohet*, sepse pos kuptimit e rëndësisë dhe ndikimit të arsimit, edhe ekonomia në Kosovën e ardhshme do të ecë me nxitim. Me siguri se me investime më të mëdha në arsim, paralelisht do të ndikojnë tri forca të pakufizuara, ose shkurtazi: tri "E" (ekonomia, energjia dhe edukata).

5. *Analfabetizmi,* përqindja e të cilit sot e kaq vjet është brengosës, *do të eliminohet me përpjesëtime sa më të gjëra,*me qëllim që të reduktohet në Kosovë deri në 5%. Në shkollën tonë sot dhe nesër më shumë duhet afirmuar vlerat arsimore dhe trashëgiminë kulturore e etnive që jetojnë në Kosovë, ballkanase dhe botërore.
6. *Rrjeta e institucioneve parashkollore* e cila sot është një çështje shqetësuese, dhe përpos disa lëvizjeve të viteve të fundit, me dekada e lërë pas dore, si tërësi e edukimit dhe arsimit themelor, *do të zhvillohet dhe të përfshihet në çdo komunë dhe çdo pjesë të Kosovës.* Përfshirja e fëmijëve në edukimin parashkollor do të jetë së paku 70%.
7. *Ndryshime të mëdha - për jetë,* para së gjithash *ato progresive, veçanërisht modernizimi i mësimit* (përsosja e metodave mësimore, e programeve të reja mësimore, sigurimi i teksteve funksionale dhe moderne mësimore etj.) *dhe aftësimi praktik i të rinjve do bëhen në çdo nivel të arsimit.* Këtë duhet konsideruar si *obligim i përhershëm i institucioneve dhe i organeve të arsimit dhe të të gjithë pjesëmarrësve në punën edukativo-arsimore* (nxënësve, arsimtarëve, studentëve, asistentëve, profesorëve, metodicientëve, shkencëtarëve etj.). Në shkollën bashkëkohkore janë evidente disa rezultate të arritura, por as shkolla e sotme nuk është e liruar nga shumë dobësi, siç janë: ende në shkollat tona dominon të mësuarit në bazë të një a dy burimeve; metoda laboratorike-eksperimentale në shkencat natyrore rrallëkund përdoret; në shumë shkolla (posaçërisht nëpër fshatra) mungojnë edhe mjete klasike në mësim; në mësimin universitar provimet organizohen pothuaj tërësisht me teste; në shkollat fillore ende është numri i madh i mësimdhënësve të pakualifikuar dhe mësimi aty-këtu edhe tash zhvillohet në disa ndërrime; që nga klasë të para në shkollat tona mbizotëron teorizimi, i ashtuquajtur materializmi didaktik, përzierje e pozitivizmit dhe i

historicizimit; interesimi i zvogëluar i arsimtarve për përsosjen e tyre profesionale e pedagogjike për shkak të anës materiale etj. Evitimi ose së paku zvogëlimi i vështirësive e problemeve të shumta në arsim, do të përparon dhe ndryshon fizionominë dhe cilësinë e arsimit në Kosovë.

8. *Shpresojmë se* nga pedagogët dhe psikologët të dalluar, ekonomistët e arsimit, sociologët e arsimit e profesionistëve të tjerë *edhe në Kosovë do të jetësohet nisma për themelimin e institutit kërkimor-shkencor pedagogjik i cili në shembullin e instituteve më të njohur evropiane dhe jashtë Evrope, si dhe duke u mbështetur në metodologjinë bashkëkohore shkencore, ekskluzivisht do të merret me studimin e çështjeve të arsimit* me qëllim që ky të jetë:
   - më efikas,
   - më fleksibil,
   - më bashkëkohor,
   - më jetësor ose më saktësisht – gjatë gjithë jetës, dhe pa dyshim:
   - gjithëpërfshirës, multikulturor, integrativ, multietnik, kombëtar, racional dhe i barabartë.
9. Duke u bazuar në Pedagogjinë futurologjike ose në Futurologjinë pedagogjike (sinonime) si dhe në parimet e Pedagogjisë ndërkombëtare, edhe *në planifikimin e vendeve më pak të zhvilluara, siç është Kosova, nuk do të lehet pas dore arsimi*, i cili në vendet e zhvilluara është një ndër faktorët primar në zhvillimin arsimor, kulturor por edhe ekonomik dhe teknologjik i tyre.
10. *Bashkëpunimi ndërkombëtar me ndihmën e arsimit* solid dhe i organizuar në nivel të lartë po ashtu *do të jetë më i ngritur dhe i unisuar*.

Nuk duhet harruar as çështje të tjera aktuale, siç janë: çështja e rikualifikimit të arsimtarëve, arsimimi i femrës, aftësimi i mësimdhënësve për punë me kompjuterë (sipas Strategjisë deri në vitin 2012), tekste të reja dhe literatura tjetër shkollore, teknologjika e arsimit, objektet e reja moderne shkollore, pajisja e shkollave me mjete mësimore, raporti midis shkollave private dhe atyre shtetërore, çështja e

punësimit të studentëve të diplomuar dhe e nxënësve me shkolla profesionale të kryer, përsosmëria e kuadrit mësimor (pedagogjike, psikologjike dhe profesionale), etika e arsimtarit dhe shumë tema të tjera që janë gjithaq të rëndësishme dhe dëshmojnë rolin kryesor të fenomenit të arsimit në Kosovën e ardhshme. Me një fjalë arsimi është dhe do të jetë *një ndër themelet e demokracisë dhe i tërë civilizimit, si dhe pjesë përbërëse e statusit të ardhshëm të Kosovës.* Duhet shtuar edhe një shpresë dhe besim të plotë që edhe reforma e arsimit (ajo rrënjësore dhe e gjithmbarshme) së shpejti të fillojë në Kosovën e integruar e cila do të jep, me siguri, më shumë rëndësi çështjeve ekonomike dhe sociale ndër to edhe reformimit të sistemit arsimor.

Jashar Rexhepagiq

CERTAIN ADVANTAGES OF EDUCATION IN PRESENT DAY KOSOVA (EUROPEAN AND MODERN)

(Summary)

The main characteristics of education in Kosova (in its near future) will be:

1. Education will be more advanced. State organs will pay greater attention to the education of the population. The need for the implementation of the fundamental idea to provide education for all has been stressed in international documents as well as the Strategy for the Development of Higher Education in Kosova (2007-2017).
2. The whole society will be involved in the education of children, the youth and citizens.
3. Primary and secondary school education as well as health care services will be provided free of charge.

ياشار رجب آغيش

بعض من أولويات التعليم في كوسوفا الجديدة الاوربية و المعاصرة

(خلاصة البحث)

بما أننا نرجو أن كوسوفا في القريب العادل سوف تتحول إلى واقع جديد و متقدم بامكاننا ان نفرق عشرة خصائص اساسية تتعلق بالتعليم و هي:

1- أولوية التعليم في جميع انحاء كوسوفا و ذلك لان الدوائر الحكومية و التعلمية سوف تعطى الاولوبة للمؤسسات التعليمية لتعليم الشعب الكوسوفي بجميع طوائفة. و ذلك لان في كل الوثائق الاوربية و الدولية و بصفة خاصة فيما يتلعق بمنظمة يونسكو و الوثيقة الخاصة باستراتجية تطوير التعليم ما قبل المرحلة الجامعية في كوسوفا عن الفترة من 2017/2007 تم التركيز عن الفكرة الاساسية: "التعليم للجميع"

2- التعليم على كل المستويات سوف يكون أكثر انسجاما و أكثر ديموقراطية و انفتاحا، بما أن المجتمع بكامله على ضوء التطورات الجديدة سوف يقوم برفع مستوى الاطفال و الشباب و المواطنين.

3- نرجو ان التعليم الابتدائى و المتوسط و الجامعى و كذلك العنابة الصحية أن تكون مجانا.

AKAID

Orhan Bislimaj

NOCIONET "*ISLAM*" DHE "*IMAN*", ENTITETE TË NDARA DHE TË BASHKUARA (Shpjegim aka-ideologjik i thënies së Imami A'dham Ebu Hanife r.a.)

قوله: وَالْإِسْلَامُ هُوَ التَّسْلِيمُ وَ الْإِنْقِيَادُ لِأَوَامِرِ اللهِ تَعَالَى، فَفِي طَرِيقِ اللُّغَةِ فَرْقٌ بَيْنَ الْإِيمَانِ وَ الْإِسْلَامِ، وَ لَكِنْ لَا يَكُونُ إِيمَانٌ بِلَا إِسْلَامٍ، وَ لَا يُوجَدُ إِسْلَامٌ بِلَا إِيمَانٍ فَهُمَا كَالظَّهْرِ مَعَ الْبَطْنِ، وَالدِّينُ اسْمٌ وَاقِعٌ عَلَى الْإِيمَانِ وَ الْإِسْلَامِ وَ الشَّرَائِعِ كُلِّهَا.

Thënia e Ebu Hanifes: **"Islami është dorëzim (në aspektin interier) dhe pranim i urdhrave të Allahut xh.sh (në aspektin eksterier). Nga aspekti gjuhësor ekziston dallimi mes imanit dhe Islamit. Mirëpo, imani pa islam nuk mund të ekzistojë dhe as islami pa iman. Lidhshmëria mes tyre është sikurse shpina në raport me barkun. Ndërsa Feja (ed-dinu) është emër që e përfshin imanin, islamin dhe dispozitat në tërësi."**[1]

Jo rrallëherë prezantimi i nocionit 'islam' dhe 'iman' shkakton një përzierje te dëgjuesi, apo tek ai, i cili për herë të parë fillon të mendo-

[1] El-Mul-la Alij bin Sulltan Muhammed El-Kari, "*Sherhu'l fikhi'l ekber li ebi hanifete en-nu'man",* tahkik Mervan Muhamed Esh-Sha'ar, 'daru'n-nefais, botimi i parë – 1417/1997, Bejrut-Libon, fq. 19.

jë më veçan për njohjen parimore të tyre. Më se dhe nxitin kureshtjen se ç'domethënie ka njëri e ç'domethënie ka tjetri. A janë një dhe a e kanë një synim të përbashkët. Dhe nëse jo, cili është dallimi mes tyre dhe parashtrime të tjera.

Dijetarët kanë mendime të ndryshme nëse 'islami' është 'iman' apo është tjetër, dhe nëse është tjetër, atëherë a është ai i ndarë nga ai si i pavarur prej tij, apo është i lidhur me të që nuk ndahet. Ndaj dhe është thënë:

Ata dy janë një gjë e vetme, si në përmbajtje si në dispozitë dhe njëri tjetrin e mbulojnë.

Janë dy gjëra që nuk lidhen dhe janë të pavarura në esencë.

Janë dy gjëra, mirëpo njëri me tjetrin lidhen [2].

Ndërsa Imam Ebu Hanife r.a. në këtë formulim të tij, pikëpamjet e karakterizimit të *'islamit'* dhe *'imanit'* ndër të tjera i fokuson nga dy aspekte bazë: nga aspekti gjuhësor, ku thotë se në këtë aspekt *"ekziston dallimi mes 'imanit' dhe 'islamit'";* dhe nga aspekti terminologjik, ku thotë: *"'Imani' pa 'islam' nuk mund të ekzistojë dhe as 'islami' pa 'iman'".*

Nocioni islam dhe iman dallojnë nga aspekti gjuhësor

Thënia e Ebu Hanifes[3]: "Nga aspekti gjuhësor ekziston dallimi mes islamit dhe imanit".

"Islam" nga aspekti gjuhësor, është emër i gjuhës arabe. Ai rrjedh prej llojit të IV të foljeve, nga grupi i foljeve të prejardhura 'el-mezidatu- eth-thulathijju el-mezidu fihi' dhe bën 'esleme'-për kohën e shkuar; 'juslimu'- për kohën e tashme dhe të ardhshme, dhe 'islam'- bën infinitivi, i cili e ka domethënien e "nënshtrimit dhe dorëzimit në kuptim të pranimit të dispozitave dhe përuljes"[4].

[2] Musa Muhamed Alij, *"Kavaidu'l akaidi"* li huxh-xhetil Islami'l imami'l Gazalijj, boton alemu'l kutub, botimi i dytë, 1405 h /1985 m, f.235.

[3] I referohet tekstit të Ebu Hanifës r.a. që është i shtruar për shpjegim.

[4] Xhemalud-din Ahmed bin Muhamed, El-Gaznevijj El-Hanefijj, "*Kitabu usulid-dini*", tahkik ed-duktur Omer Vefik Da'uk, boton: darul beshairi'l islamijjeh, botimi i parë, 1998/1419.f. 261.

Mbiemri foljor aktiv (apo vepror) bën 'MUSLIM' - (te ne përdoret 'mysliman') që do të thotë: Ai i cili beson në shpalljen e Muhamedit a.s. duke e shprehur nënshtrimin dhe pranimin ndaj saj.[5]

Sakaq, nocioni 'islam' ka domethënie të gjerë dhe përdoret në kontekste të ndryshme.

Imam Maturidiju r.h., në veprën e tij 'Kitabu't-Tevhid' citon disa mendime të dijetarëve rreth domethënies së 'islamit' në aspektin gjuhësor…:

El-Islam në gjuhë është el-ihlas - sinqeritet. Në këtë domethënie asocon fjala e Allahut xh.sh.:

إِذْ قَالَ لَهُ رَبُّهُ أَسْلِمْ قَالَ أَسْلَمْتُ لِرَبِّ الْعَالَمِينَ

"Kur Zoti i vet atij i tha: "Dorëzohu"! Ai tha: "Iu kam dorëzuar Zotit të gjithësisë" *(Kur'ani, El-Bekare: 131)*[6]*;* dhe (gjithashtu) Fjala e Allahut:

"Ju *(besimtarë)* ***thuani: "Ne i besuam Allahut, … dhe ne vetëm Atij i jemi bindur"*** *(Kur'ani, El-Bekare: 136),* është në kuptim të sinqeritetit (ihlas) qeniesor të robit ndaj Allahut të Madhëruar dhe në atë sinqeritet askënd nuk e shoqëron…[7] Pra, *'islami'* vjen në kuptim të sinqeritetit të pastër (el-ihlas) ndaj Allahut xh.sh., sikurse që i Lartmadhërishmi thotë: ***"Kush ka fe më të mirë se ai që sinqerisht i është bindur Allahut?…"*** *(Kur'ani, En-Nisa: 125)*[8]

'Islam' është dorëzim dhe nënshtrim ndaj Allahut xh.sh. Sipas kësaj edhe u urdhëruan beduinët që të thonë: ***" … ne jemi dorëzuar"***

[5] Ibrahim Mustafa, Ahmed Hasen Ez-Zejjat, Hamid Abdul Kadir, Muhamed Alijun-Nexhar, "*El-Muxhemu'l Vesit*", pjesa e parë dhe e dytë, Daru'd-da'veti, 1989/1410, Stamboll, Turqi, shkronja 's' fq.446.

[6] Përkthimi i ajeteve me disa adaptime, është marrë nga: *KUR'ANI, përkthimi me komentim në gjuhën shqipe*, përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, 1413h/1992m, Prishtinë, botim i Medinës.

[7] Ebi Mensur Muhamed bin Muhamed bin Mahmud El-Maturidijj Es-Semerkandij, "*Kitabut-Tevhid*", tahkik dhe ta'lik prof.dr. Bekir Topaloglu dhe dr. Muhamed Aruçi, boton ISAM-i (Turkiye Diyanet Vakfi) me nr.318, botimi i parë, 1423/2003, Ankara, f. 633.

[8] Afif Abdul Fet-tah, Tab-bareh, "*Ruhud-din el-islamijj*" boton 'daru'l ilmi li'l melajin, botimi i njëzetë e shtatë, 1984, Bejrut Liban. f. 14

(Kur'ani, El-Huxhurat: 14)[9]*;* dhe citati tjetër: ***"Dhe kthehuni te Zoti juaj dhe përulnju Atij para se t'u vijë dënimi…"*** *(Kur'ani, Ez-Zumer: 54).*

Pos këtyre dy kuptimeve nocioni 'islam' në përdorimin e tij gjuhësor në Kur'anin e madhëruar vjen edhe në kuptime të tjera, ndër to dhe:

- Vjen në kuptim të kundërvënies ndaj idhujtarisë (mukabeletush-shirki) [10]. Allahu xh. thotë: ***"…Thuaj: Unë jam i urdhëruar të jem i pari që bindem dhe*** *(urdhërohem):* ***të mos bëhem kurrsesi nga idhujtarët"*** *(Kur'ani, El-En'am: 14).*

- Vjen në kuptim të kundërvënies ndaj pabesimit (el-kufr). Në Kur'an citohet: ***"…Vallë a ju urdhëroi ai juve mosbesimin pasi që ju jeni myslimanë?"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 80).*

Nga njëherë Kur'ani famëlartë fjalën *'esleme'* (nga e cila rrjedh fjala Islam), në kuptim të nënshtrimit dhe dorëzimit (absolut), e përgjithëson edhe për besimtarët edhe për pabesimtarët bashkërisht. Për faktin se të gjithë ata (edhe besimtarët edhe pabesimtarët) janë të nënshtruar ndaj Allahut për nga aspekti i ligjit të krijimit të tyre. u pëlqeu atyre apo s'u pëlqeu, ligjet e gjithësisë ndaj tyre vazhdojnë[11]. I Lartëmadhërishmi thotë:

وَلَهُ أَسْلَمَ مَن فِي السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا وَإِلَيْهِ يُرْجَعُونَ

"…E Atij i është dorëzuar gjithçka në qiej e në tokë, me dashje e pa dashje dhe tek Ai kthehen" *(Kur'ani, Ali Imran: 83).*

Pra, parimisht dhe në bazë të këtyre kuptimeve dhe të tjera gjuhësore të nocionit islam, mund të rezultojë se ai kryesisht vjen si 'simbol' i tre relacioneve bazë:

[9] El-Maturidijj, "*Kitabu't-tevhid*", op. cit. f. 633. Mirëpo ai dorëzim ishte për shkak të frikës ndaj besimtarëve e jo ndaj Allahut, ashtu siç thotë Allahu: "Ju (besimtarët) në zemrat e tyre (të munafikëve) jeni frikë më e fortë se Allahu (frika nga Allahu)" (El Kur'an, El Hashr: 13); dhe ajeti tjetër ku i përshkruan ata: "… e çdo zë e mendojnë se është kundër tyre. Ata janë armiq pra, ruaju prej tyre" (El-Kur'an, El-Munafikun: 4). Shih po aty: El-Maturidijj, "*Kitabu't-tevhid*", op. cit. f. 633.

[10] Tab-bareh, "*Ruhu'd-din…*" op.cit. f.14.

[11] Tab-bareh, "*Ruhu'd-din…*" op.cit. f.14.

1. Ai është emër që identifikon besimtarët e sinqertë ndaj Allahut xh.sh;
2. Është emër që simbolizon kundërvënien ndaj ateizmit dhe politeizmit dhe
3. Ai është emër që e konsiston dhe e miraton dorëzimin ndaj Allahut për të gjithë krijesat instinktivisht. Edhe për besimtarët që janë në rrugë të Tij, edhe për pabesimtarët që e refuzojnë udhëzimin e Tij. Të gjithë ata në parim janë të dorëzuar ndaj Allahut, dhe një trajtim të tillë potencialisht e kanë të gjitha krijesat, pa marrë parasysh nëse e kuptojnë këtë apo jo. Atyre u mbetet vetëm ta zbulojnë atë.

* * *

Imam Gazaliu në veprën e tij madhore 'Ihjau ulumid-din' sqaron dallimin gjuhësor mes *'imanit'* dhe *'islamit'* në një kapitull të cilin e quan 'bahthun fil imani vel islami ve ma bejnehuma minel it-tisali vel infisali' ku thotë: 'E vërteta është se *'iman'* gjuhësisht është shprehje e besimit të plotë [12], ndërsa 'islami' është shprehje e nënshtrimit dhe e deklarimit (të hyrjes në Islam) me bindje të thellë dhe të përkushtuar duke e braktisur kundërshtimin, lajthitjen dhe kundërvënien. Për besimin vend i posaçëm është zemra, ndërsa gjuha është artikuluese e tij. Kurse sa i përket dorëzimit (islamit) ai me të vërtetë është i përgjithshëm. Ai është në zemër, gjuhë dhe ekstremitete (gjymtyrë). Atëherë, sipas të vërtetës gjuhësore (bi muvxhebi'l-lugati) islami është më përfshirës se *imani*, ndërkohë që *imani* është shprehje e pjesës më të kualifikuar (eshrefu) të *Islamit*[13]. Në këtë kontekst është hadithi në vijim:

[12] Allahu xh.sh.citon thënien e vëllezërve të Jusufit ndaj babait të tyre: 'Ti nuk do të na besosh neve, edhe po të jemi të vërtetë!" (Kur'ani, Jusuf: 17.).

[13] Ez-Zebejdi, "*Sherhu Ihjai Ulumid-Din*", të Imam Gazalijjut, 1/102 dhe 2/365, cituar sipas: Abdul Kerim Tetan,; Muhamed Edib El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi lish-sherhi xhevheret'it-tevhidi*" fi akideti Ehli Sunneti ve'l xhemaati, boton Darul Beshair, botimi i dytë, 1999/1419, pa vend botimi, pjesa e parë, fq. 253.

حَدَّثَنَا عَبْدُ الرَّزَّاقِ قَالَ حَدَّثَنَا مَعْمَرٌ عَنْ أَيُّوبَ عَنْ أَبِي قِلَابَةَ عَنْ عَمْرِو بْنِ عَبَسَةَ قَالَ قَالَ رَجُلٌ يَا رَسُولَ اللَّهِ مَا الْإِسْلَامُ قَالَ أَنْ يُسْلِمَ قَلْبُكَ لِلَّهِ عَزَّ وَجَلَّ وَأَنْ يَسْلَمَ الْمُسْلِمُونَ مِنْ لِسَانِكَ وَيَدِكَ قَالَ فَأَيُّ الْإِسْلَامِ أَفْضَلُ قَالَ الْإِيمَانُ

Transmetohet se Një njeri i ka thënë Resulullahit s.a.w.s. çka është Islami? (Pejgamberi a.s.) i ka thënë: Që zemra jote t'i dorëzohet (plotësisht) Allahut të madhëruar dhe që myslimanët të jenë të qetë nga gjuha dhe dora (vepra) jote. Ai tha: Cili Islam është më i vlefshëm? (Pejgamberi a.s.) tha: Imani…"[14]

Ndërsa Mulla Alij bin Sulltan El-Kari El-Hanefij, kur e shpjegon thënien e Ebu Hanifes se 'nga aspekti gjuhësor ekziston dallimi mes islamit dhe imanit', ai thotë: "Imani është 'tasdik-besim i plotë i prerë, sikurse thotë Allahu xh.sh.: ***Ti nuk do të na besosh neve…"*** *(Kur'ani, Jusuf: 17),* do të thotë, nuk po beson në këtë rrëfim. Ndërsa Islami është dorëzim-pranim absolut, siç argumenton për këtë fjala e Allahut xh.sh.: **وَلَهُ أَسْلَمَ** - ***"Atij i është dorëzuar"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 83),* d.m.th. i është nënshtruar "**مَن فِي السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضِ طَوْعًا وَكَرْهًا** - ***gjithë ç'ka në qiej dhe në tokë me dashje"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 83)* siç janë engjëjt dhe myslimanët ***"e pa dashje"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 83)* siç janë pabesimtarët. Andaj, *Imani* është specifik për dorëzim ezoterik (batinij), ndërsa Islami është specifik për dorëzim ekzoterik (dhahirij), sikurse dëfton fjala e Allahut xh.sh.[15]:

قَالَتِ الأَعْرَابُ آمَنَّا قُل لَّمْ تُؤْمِنُوا
وَلَكِن قُولُوا أَسْلَمْنَا وَلَمَّا يَدْخُلِ الإِيمَانُ فِي قُلُوبِكُمْ

"Beduinët thanë "Ne kemi besuar! Thuaj: "Ju nuk keni besuar *(ende),* ***por thoni: ne jemi dorëzuar, e ende nuk po u hyn besimi në zemrat tuaja"*** *(Kur'ani, El-Huxhurat: 14).* Qëllimi me pjesën e ajetit: "Thuani: "ne jemi dorëzuar" do të thotë jemi dorëzuar nga aspekti i jashtëm (sipërfaqësor) i yni, e të tillët në të vërtetë ishin munafikët.

[14] Musnedi i Ahmedit, Kitabu musnedish-shamijjin, Babu: hadithu Amr bin Abesete, nr. 16413.

[15] Alij El-Kari, "*Sherhu'l fikhi'l …"*op.cit., f. 149.

Kjo është ndër thëniet e komentatorëve në këtë ajet [16], ndërkohë që dijetarët dhe komentatorët nuk janë të një mendimi se ky ajet ka të bëjë ekskluzivisht me munafikët apo me ndonjë shtresë tjetër të shoqërisë.

Krahas kësaj, ekziston mendimi se ky ajet i aludon besimtarët me besim jo të konsoliduar.

I këtij mendimi është edhe komentuesi *'akaidit'* të imam Tahaviut, Ibnu Ebi'l Izz El-Hanefij ku thotë: Unë për këtë ajet përgjigjem me një thënie tjetër e cila është edhe më parësore: "E vërteta është se ata (të apostrofuarit në ajet) nuk ishin besimtarë me iman të kompletuar, sikur që mohohet (nufije) besimi për vrasësin (me padrejtësi), prostitutën, vjedhësin, të pabesueshmin[17], dhe jo se ata ishin munafikët. Këtë domethënie e mbështet struktura e ajetit, sepse kaptina[18] që nga fillimi i saj e deri te ky ajet është në fokusim të ndalesës nga mëkatet dhe të dispozitave të disa mëkatarëve dhe të ngjashme dhe në të nuk ka potencim të munafikëve. Në këtë kontekst Allahu xh.sh. në vazhdim të ajetit të lartcekur (El-Huxhurat: 14) thotë: ***"E nëse e respektoni Allahun dhe të dërguarin e Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja…"*** *(Kur'ani, El-Huxhurat: 14)*. Sikur ata të ishin munafikë, atyre nuk do t'u bënin dobi fare veprat e mira. Pastaj Ai

[16] El-Al-lametu Ibnu Ebil Izz El-Hanefijj, "*Sherhul akidetit-tahavije*", vërtetimin shkencor dhe recenzimin e kanë bërë grup dijetarësh, nxjerrjen e hadithеve e ka bërë Muhammed Nasirud-din El-Elbanijj, botimi i nëntë 1408h\1988m, El-mektebetu'l Islamijj, Bejrut, f. 349.

[17] Me këto thënie aludohet në disa hadithe të pejgamberit në të cilat potencohet ndalimi i besimit për disa bartës të mëkatit (të madh) si p.sh. për prostitutin, vjedhësin, alkoolistin etj, ndërkohë që në të vërtetë (de facto dhe de jure) nuk i mohohet besimi, apo se konsiderohen të tillët pabesimtarë pas atyre mëkateve, për derisa ata nuk besojnë në lejueshmërinë e tyre, por ata e kanë humbur atë realitetin (hakikatu) e besimit që në fakt është frika (el-havfu) dhe devotshmëria (el-veru'), andaj edhe domethënia e hadithеve konsiston në lëndimin dhe paplotshmërinë e besimit të tyre. Të kësaj natyre ekzistojnë hadithe të shumta dhe të verteta, si: "*Prostituti nuk është besimtar në kohën kur bën prostitucion, vjedhësi nuk është besimtar në kohën kur bën vjedhje…"(* Shih: "*Fet'hul Bari bi sherhi Sahihil Buhari*", Kitabul Medhalimi, kapitulli i 30, hadithi nr.2475.) Shih: El-Gazalij "*Kavaidu'l akaidi*…" op.cit. f. 259-260, ndërsa se kuptimi i hadithеve është alegorik për këtë shih: Jusuf Kardavi, "*Rizgjimi Islam*", ndërmjet kundërshtimit dhe ekstremizmit, boton Logos, Prishtinë 2002, fq.77-79.

[18] Për qëllim është kaptina El-Huxhurat, nga e cila është ajeti i lartëcekur.

thotë: ***"Besimtarët janë vetëm ata që i besuan Allahut, të Dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan…"*** *(Kur'ani, El-Huxhurat: 15)* Ky ajet i konsiston besimtarët me besim të plotësuar (el-mu'mininel kamilil imani), ndonëse Allahu e di më së miri,[19] thotë Ibni Ebi'l Izz El-Hanefij r.a.

Në këtë kontekst edhe Imam Maturidiu citon se Allahu xh.sh. i lejoi beduinët (el-a'rabu) që të thirren me Islam, për aspektin e jashtëm, por nuk i lejoi ata që të thirren me iman për faktin se ende nuk e kishin atë (imanin) në mënyrë të vërtetë (hakikaten) në zemër[20].

Imani dhe Islami kanë dallim kur ata vijnë të bashkuar

Sipas ajetit: Ne kemi besuar! Thuaj: ***"Ju nuk keni besuar ende, por thuani: ne jemi dorëzuar, e ende nuk ka hyrë besimi në zemrat tuaja"*** *(Kur'ani,El-Huxhurat: 14),* bëhet i qartë dallimi në mes tyre sipas ndryshimit të përmbajtjes gjuhësore në të kuptuar. Ndërkohë që Islami i perceptuar në kuptimin terminologjik, nuk mund të ekzistojë pa ekzistimin e imanit. Ndërsa ai (islami) në këtë ajet vjen në kuptim të dorëzimit të jashtëm (el-inkijadudh-dhahiru), pa ekzistuar fare dorëzimi i brendshëm (min gajri inkijadil batini) siç është pozita e atij i cili e shqipton me fjalë shehadetin (premisën e hyrjes në Islam – fjalën *nuk ka zot tjetër pos Allahut*), pa pasur fare besim adekuat në realitetin e Imanit[21].

Kur Islami vjen bashkërisht me imanin, atëherë Islami është identitet për veprat e karakterit të jashtëm siç janë shqiptimi me gjuhë dhe veprimi me gjymtyrë, kurse Imani është identitet për veprat e karakterit të brendshëm nga aspekti i besimit dhe veprimeve të zemrës. Për

[19] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti*…"op.cit. f. 349.

[20] El-Maturidijj, "*Kitabu't-tevhid*", op. cit. f. 632.

[21] El-Mulla Alij bin Sulltan El-Kari El-Hanefijj, "*Sherhu Kitabi'l fikhi'l ekber*", me tahkik të Alijj Muhamed Dendel, boton 'darul kutubi'l ilmijjeh', botimi i parë, Bejrut-Liban,1995/1416, f. 236.

këtë dallim argumenton Fjala e Allahut xh.sh.[22] që u cek më lartë El-Huxhurat: 14, dhe ajeti tjetër rreth tregimit të Lutit a.s. ku Allahu xh.sh. thotë:

فَأَخْرَجْنَا مَن كَانَ فِيهَا مِنَ الْمُؤْمِنِينَ فَمَا وَجَدْنَا فِيهَا غَيْرَ بَيْتٍ مِّنَ الْمُسْلِمِينَ

***"Dhe kush ishte aty nga besimtarët, ne i nxorëm** (i larguam). **Po nuk gjetëm aty pos një shtëpie mysliman"** (Kur'ani, Edh-Dharijat: 35-36).*

Në këtë ajet Allahu i madhëruar ka bërë dallim mes besimtarëve dhe myslimanëve, (kupto: mes imanit dhe islamit) sepse shtëpia e cila ishte në atë fshat, ishte shtëpi myslimane në aspektin sipërfaqësor (artificialisht), për faktin se aty ishte gruaja e Lutit a.s., e cila e kishte tradhtuar atë (Lutin) me mosbesim dhe ajo ishte pabesimtare. Ndaj, ata që u larguan prej tij (fshatit) dhe shpëtuan, të tillët ishin besimtarë të vërtetë, në zemrat e të cilëve ka hyrë besimi[23].

Dallimin mes *'islamit'* dhe *'imanit'* me rastin e bashkimit të tyre (kur vijnë njëri pas tjetrit), e argumenton edhe hadithi i Omer bin El Hat-tabit r.a. në të cilin Xhibrili a.s. e pyeti Muhamedin a.s. për *'islamin'* dhe *'imanin'?* Pejgamberi a.s. iu përgjigj atij[24]: *"Islam është që të dëshmosh se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh ramazanin dhe të vizitosh Qaben*[25]*,* me se edhe e vërteton ndryshimin e *'islamit'* nga *'imani'* i komentuar, ku Resulullahi s.a.w.s. (për imanin) thotë: *"Iman është: të besosh në Allahun, melaqet e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, ditën e fundit, dhe të besosh në caktimin se edhe e mira edhe e keqja janë nga Allahu"*[26]*,* duke e harmonizuar aplikimin (dallimin) gjuhësor, pa e lajthitur pajtimin terminologjik të tyre në ku-

[22] Muhamed bin Salih, El-Uthejmin, "*Mexhmuu fetava-fetavel akaidti - xhemun ve tertibun"* Fehd bin Nasir bin Ibrahim Es-Sulejman, boton 'Daruth-thurija lin-neshri', botimi i dytë 1414/1994, vëllimi i parë fq. 48.

[23] El-Uthejmin, "*Mexhmu'u fetava* …"op.cit. 1/48-49.

[24] El-Uthejmin, "*Mexhmu'u fetava* …"op.cit.1/49.

[25] "*Sahihu'l Muslim Bisherhin-Neveij*", pjesa e parë, botimi i parë 1347 h\1929 m., boton "El-matbeatu'l Misrijjeh" Kajro, kaptina "Kitabul Imani" hadithi në fillim, fq.155-160.

[26] *"Sahihu'l Muslim"* botimi i Kajros, op.cit. 1/155-160.

ptim të synimit të përbashkët se 'imani' është besim i plotë me zemër duke e përfshirë sferën e dorëzimit të brendshëm, kurse *'islami'* është shfaqje e atij dorëzimi të brendshëm përmes shqiptimit me gjuhë dhe nënshtrimit ndaj dispozitave islame…[27].

Pra, në këtë hadith ekziston argumenti i dallimit mes 'islamit' dhe 'imanit'[28], sepse Xhibrili a.s. për 'imanin' tha:

قَالَ فَإِذَا فَعَلْتُ ذَلِكَ فَأَنَا مُؤْمِنٌ

"Nëse unë i veproj këto (konditat e imanit), atëherë unë, jam mu'min (besimtar)?, ndërsa për 'islamin' tha:

قَالَ فَإِذَا فَعَلْتُ ذَلِكَ فَأَنَا مُسْلِمٌ

"Nëse unë i veproj këto (konditat e islamit), atëherë, unë jam myslim (mysliman)?".

(Pejgamberi a.s.) Tha: **قَالَ نَعَمْ** *"PO".*

(Xhibrili a.s.) Tha: **قَالَ صَـــدَقْتَ** *"e the të vërtetën"*[29]. Ndaj (dijetarët) thanë: Mes dy nocioneve ka bërë dallim Kur'ani, pastaj Sunneti, pastaj vërtetimi (tasdik) i Xhibrilit a.s., pastaj dëshmia e potencimit të emrit (ku Xhibrili a.s. tha: Unë a jam mu'min?; unë a jam myslim?).[30]

Siç shihet në hadithin e Xhibrilit a.s. Pejgamberi a.s. *islamin* e komentoi me veprat e gjymtyrëve, pra të aspektit të jashtëm prej fjalëve dhe veprave. E para e tyre: Dëshmia se *'nuk ka zot tjetër pos Allahut'* dhe se *'Muhamedi a.s. është i Dërguari i tij',* është veprim i gjuhës, ndërsa falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i ramazanit dhe vizita (haxhi) e Qabesë kush ka mundësi udhëtimi tek ajo, ndahen: në veprime trupore: siç është namazi dhe agjërimi; në veprime pasurie, siç

[27] Alij El-Karij "*Sherhu kitabi'l fikhi'l ekber*", f. 236.

[28] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti*…"op.cit. f.346.

[29] Musnedi i Ahmedit, Kitab: Musnedu'l muketh-thirine…, babu: bakijel musned… nr. 5592.

[30] El-Maturidijj, "*Kitabu't-tevhid*", op. cit. f. 631.

është dhënia e zekatit dhe në aso që përbëhen prej të dyjave e ai është haxhi…[31]

Ndërsa nga ana tjetër, Pejgamberi a.s. në këtë hadith imanin e komentoi me elemente besimore të brendshme. Ai tha: *"Që të besosh në Allahun, në melaqët e Tij…*[32] dhe kushtet tjera me radhë. Pra, Pejgamberi a.s.bëri dallim mes tyre, kur ata i bashkoi njërin pranë tjetrit. Dhe kështu, qëllimi me *iman* është sfera e besimit të zemrës, ndërsa me Islam është sfera e veprimit të veprës [33].

Në këtë kontekst është hadithi i cituar në 'Musnedin" e Imam Hanbelit nga Enesi r.a. nga Pejgamberi a.s. i cili ka thënë: *"Islami është haptazi (me veprime të jashtme), ndërsa 'imani' është (i brendshëm) në zemër*[34]. Do të thotë, veprat duken haptazi e besimi në zemër nuk duket [35]. Pastaj Pejgamberi a.s. thotë: *"O Zoti im Ty t'u kam dorëzuar (eslemtu) dhe në Ty kam besuar (amentu)"*[36]

Pikëpamjet terminologjike të 'islamit' dhe 'imanit'

Thënia e Ebu Hanifes: ***"Mirëpo, 'imani' pa 'islam' nuk mund të ekzistojë dhe as 'islami' pa iman".***

Në të vërtetë, sipas aspektit terminologjik, përdorimi (aplikimi) i *'islamit'* dhe *'imanit'* vjen:

1. Nga aspekti i sinonimitetit dhe përkimit;
2. Nga aspekti i ndryshueshmërisë; dhe
3. Nga aspekti i shtrirjes së njërit në tjetrin.[37]

[31] El Imam Ibni Rexheb El-hanbelijj, *"Xhamiul ulumi vel hikemi, fi sherhi hamsine hadithen min xhevamil kelim*", tahkik Fuad bin Alijj Hafidh, boton xhemijjetu ihjait-turathi'l islamij, botimi i parë 1419/1998, Kuvajt, fq.35-36.

[32] Ibnu Rexheb "*Xhamiu'l ulumi…*"op.cit. f.38.

[33] Ibnu Rexheb "*Xhamiu'l ulumi…*"op.cit. f..41.

[34] Hadithi është 'daif" (i dobët). Transmeton Ahmedi nr.11933. Në senedin e tij është Alij bin Mus'adete El-Bahilij i cili është i dobët në mbamendje. Cituar sipas: Ibnu Rexheb "*Xhamiu'l ulumi…*"op.cit. f. 41.

[35] Ibnu Rexheb "*Xhamiu'l ulumi…*"op.cit. f. 41.

[36] Muttefikun alejhi, nga hadithi i Ibni Abasit r.a. Ky hadith është sekuencë (pjesë) nga lutja e Pejgamberit a.s. gjatë fillimit të namazit të natës. Shih: 'sifetus-sala…', cituar sipas: Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti*…"op.cit. f. 348.

[37] El-Gazalij "*Kavaidu'l akaidi*…" op.cit. f. 237.

E para: *Nga aspekti i sinonimitetit (et-teradufu) dhe përkimit (et-tevarudu),* ku *'islami'* konsiderohet shprehje e dorëzimit të brendshëm (me zemër) dhe të jashtëm bashkërisht, dhe kjo e tëra është pranim. I tillë është edhe 'imani', pas përgjithësimit të tij duke e futur edhe aspektin e jashtëm (të veprimeve) në domethënien e tij. Kjo gjuhësisht është e lejueshme, sepse dorëzimi i jashtëm me anë të fjalëve dhe veprave konsiderohen frute dhe rezultate të besimit të brendshëm me zemër. Argument për këtë aplikim është thënia e të Lartmadhërishmit: ***"Dhe kush ishte aty nga besimtarët, ne i nxorëm*** *(i larguam).* ***Po nuk gjetëm aty pos një shtëpie myslimane"*** *(Kur'ani, Edh-Dharijat: 35-36).* Me konsensus nuk kishte shtëpi tjetër përpos një shtëpie të vetme[38] Gjithashtu Allahu i Madhëruar thotë:

وَقَالَ مُوسَى يَا قَوْمِ إِن كُنتُمْ آمَنتُم بِاللّهِ فَعَلَيْهِ تَوَكَّلُواْ إِن كُنتُم مُّسْلِمِينَ

"Musai tha: O populli im, nëse i keni besuar Allahut, vetëm Atij mbështetuni, nëse jeni të dorëzuar *(vendimit të Tij)" (Kur'ani, Junus: 84).* Në këtë ajet 'imani' dhe 'islami' vijnë në qëllim dhe synim të njëjtë. Sepse si njëri ashtu edhe tjetri kanë ardhur në cilësi të kushtëzimit dhe me të njëjtën mënyrë të shprehjes: ***"in kuntum amentum…*** *nëse i keni besuar Allahut; dhe* ***'in kuntum muslimin*** *- nëse jeni të dorëzuar (vendimit të Tij)'.*

E dyta: *Ata karakterizohen nga aspekti i ndryshueshmërisë (el-ihtilafu),* ku *'imani'* është shprehje vetëm për besimin me zemër, ndërsa 'islami' është shprehje për dorëzim nga aspekti i jashtëm. Argument për këtë aplikim të dytë është Fjala e të Lartmadhërishmit[39]:

قَالَتِ الأَعْرَابُ آمَنَّا قُل لَّمْ تُؤْمِنُوا
وَلَكِن قُولُوا أَسْلَمْنَا وَلَمَّا يَدْخُلِ الإِيمَانُ فِي قُلُوبِكُمْ

"Beduinët thanë: "Ne kemi besuar! Thuaj: "Ju nuk keni besuar ende, por thuani: ne jemi dorëzuar, e ende nuk u ka hyrë besimi në zemrat tuaja" *(Kur'ani, El-Huxhurat: 14).* Domethënia e të cilit

[38] Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi*…", op.cit. 1/253.

[39] Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi*…", op.cit. 1/254.

është: jemi dorëzuar në aspektin e jashtëm. Dhe në këtë rast me" imanin është konsistuar vetëm besimi me zemër, ndërsa me 'islamin' dorëzimi në aspektin e jashtëm me anë të deklaratës së gjuhës dhe veprimeve të gjymtyrëve[40]

E treta: *Nga aspekti i shtrirjes së njërit në tjetrin (et-tedahhulu),* ku *'islami'* konsiderohet shprehje e dorëzimit me zemër, me gjuhë dhe me vepër bashkërisht. Ndërsa *'imani'* konsiderohet shprehje për disa (elemente) që hyjnë në *'islam',* pra konkretisht për besimin me zemër dhe ky është ai të cilin e kemi nënkuptuar me *'shtrirje të njërit në tjetrin (et-tedahulu)'.* Argument për këtë aplikim është transmetimi ku Resulullahi s.a.w.s. është pyetur se: *Cila prej veprave është më me vlerë?* Resulullahi s.a.w.s. tha: *Imani…*" Ky është argument për ndryshimin dhe ndërfutjen dhe është prej aplikimeve më të favorizuara në gjuhë, sepse *'imani'* është një prej veprave dhe është më e vlefshmja e tyre, kurse *'islami'* është dorëzim si me zemër si me gjuhë dhe si me vepër, ndërsa më e vlefshmja prej të gjithave është: *"dorëzimi që është me zemër",* e ai është të besuarit (et-tasdik), i cili emërtohet me emrin *'iman'.*[41]

Pika e tretë faktikisht pasqyrohet nën semantikën e emrit të fesë së pranuar tek Allahu xh.sh., e cila është Islami. Pra në këtë kuptim emri *'islam'* si emërtim i fesë së pranuar, patjetër se e përfshin imanin në gjirin e tij.

* * *

Këto ishin disa prej pikëpamjeve të përbashkëta dhe të ndara të *'islamit'* dhe *'imanit'* të kundruara nga aspekti terminologjik. Sakaq *'islam'* në aspektin terminologjik do të thotë: *"Të shprehurit e ndjeshmërisë së Allahut xh.sh., duke iu dorëzuar dhe nënshtruar me ndërgjegje të sinqertë Atij, si dhe të besuarit në fundamentet fetare, të cilat kanë ardhur nga Allahu xh.sh."*[42]. Qëllimi me dorëzim është pohimi

[40] Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi…*", op.cit. 1/254.
[41] Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi…*", op.cit. 1/254.
[42] Tab-bareh, "*Ruhu'd-din…*" op.cit. f.14.

me anë të gjuhës e të gjithë asaj me të cilën ka ardhur Muhamedi s.a.w.s. dhe e cila përmban vërtetimin e Njëshmërisë së Allahut dhe vërtetimin e elementeve të tjera prej dispozitave që dihen si të pashmangshme të fesë.[43] Pra, *'islam'* në aspektin terminologjik do të thotë: Fe, e cila ngrihet mbi pesë shtyllat: dëshmia se nuk ka zot tjetër pos Allahut, falja e namazit[44] dhe pikat tjera me radhë të potencuara në hadithin e Xhibrilit a.s., pastaj në hadithin e Ibni Omer El-Hattab: *"Islami ngrihet mbi pesë (shtylla)…"*[45], dhe në shumë hadithe të tjera.

Nga hadithi (i Xhibrilit) nuk duhet kuptuar se gjërat të cilat i përmend hadithi në fjalë janë i gjithë *'islami'.* Islami është shumë më i gjerë se sa është përfshirë në këtë hadith. Të theksuarit e pesë kushteve në hadith do të thotë se këto janë çështjet më kryesore të fesë, mbi të cilat është ngritur feja. Ekzistojnë edhe shumë gjëra të tjera…[46]. Ashtu siç këtë e dëfton transmetimi i hadithit të lartcekur nga ana e Ibni Hibanit ku ai hadithit të lartcekur ia bashkon edhe bërjen e *'umres'* (vizitën e Qabës duke kryer disa rite të caktuara), 'guslin' (pastrimin total të trupit) nga papastërtia dhe plotësimin e abdestit, me se edhe sinjalizon se të gjitha obligimet e sferës së jashtme bëjnë pjesë në emërtimin 'islam', sikurse që në atë emërtim hyjnë edhe braktisja e të ndaluarave[47] e kështu me radhë.

Ndërsa *'imani'* (në parim) nga aspekti terminologjik është besim i plotë në atë me të cilën ka ardhur Pejgamberi a.s. nga Allahu xh.sh. Do të thotë, të besuarit plotësisht me zemër, në mënyrë të përgjithshme në Pejgamberin a.s. në të gjitha ato që dihen si parime të domosdoshme të ardhjes së tij prej Allahut xh.sh.[48]. Pra, besimi në mënyrë të

[43] El-Al-lametu Ibrahim El-Baxhuri, "S*herhu xhevheretit-tevhid*", nes-seka ve harr-rrexhe ehadithehu Muhamed Edib El-Kilanij dhe Abdul Kerim Tetan, pa vend dhe vit botimi, fq.74.
[44] Dr. Mustafa El-Buga, Mujidin Mistu, "*Komenti i dyzet hadittheve të imam Neveviut,* SHB "Furkan ISM",-Shkup, 1424/2003, fq.19.
[45] *"Sahihu'l Buhari"* op.cit. në Kapitullin 'El-Imanu' nr.8, dhe *"Sahihu'l Muslim"* op.cit. në 'kapitulli: bejanu erkanil islami ve deaimihi'l idham).
[46] Mustafa El-Buga dhe Mujidin Mistu, "*Komenti…*"op.cit. f.27.
[47] Ibnu Rexheb "*Xhamiu'l ulumi…*"op.cit. f. 36-37.
[48] El-Gaznevijj "*Kitabu usuli…*" op.cit. f. 251

përgjithshme (ixhmalen)[49] është obligim në ato që dihen se janë të përgjithshme, dhe besimi në mënyrë të detajizuar është obligim në ato që dihen se janë të detajizuar[50].

Sakaq, *'iman'* në kuptim të përmbajtjes së veprimeve themelore të fesë është ai, konditat parësore, të të cilit i ka perceptuar Kur'ani famëlartë në shumë ajete, dhe hadithi i Pejgamberit a.s. në rastin konkret hadithi i lartcekur i Xhibrilit, ku Resulullahi s.a.w.s. tha: *"Imani është të besosh në Allahun, melaqet e Tij…,* dhe kushtet tjera me radhë.

Nga ajo që u theksua më lart shihet qartë se *Islami* dhe *imani* janë dy të vërteta të ndryshme në aspektin etimologjik dhe atë terminologjik [51]

Mirëpo, ato janë të tilla kryesisht vetëm në dy raste:

1. Kur ata vështrohen dhe përkufizohen nën parametrat e veprimeve të caktuara dhe specifike, siç këtë e argumenton hadithi i Xhibrilit a.s. duke e definuar Islamin me veprime të caktuara (kujto: pesë kushtet) dhe *Imanin* gjithashtu me veprime tjera të caktuar (kujto: gjashtë kushtet), dhe
2. Kur ata potencohen veç e veç njëri pranë(pas) tjetrit, me se edhe për secilin ekziston përkufizimi adekuat dhe me kahe të përcaktuar, sepse në këtë rast të bashkimit të tyre nuk mund të jepet i njëjti përkufizim për të dytë, dhe as në këtë pozitë njëri nuk mund ta zëvendëson tjetrin përmes eliminimit të qëllimshëm të njërit prej tyre pa marrë parasysh, dhe lënies së tjetrit për zëvendësim të dyanshëm.

[49] Me formulimin "*besimi në mënyrë të përgjithshme*", konsistohet në atë që është paraqitur në mënyrë të atillë, siç është besimi në melaiket, librat, të dërguarit (etj.). Dhe kushtëzohët besimi në ato që janë të detajizuar, siç është Xhibrili, Mikaili (prej melaikeve); Musa, Isa,… (prej pejgamberëve); Tevrati, Inxhili,… (prej librave të shpallura), e kështu me radhë. Kjo është te esh'arijtë dhe maturidijtë. El-Gazalij "*Kavaidu'l akaidi…*" op.cit. f.244, fusnota (1).

[50] Sa'dud-Dinë Mes'ud bin 'Umer, Et-Taftazanij, "*Sherhu'l akaidi'n-nesefijjeti*", tahkik Muhamed Adnan Dervish, boton 'mektebetu daril bejruni, pa vend dhe vit botimi, f.197.

[51] Mustafa El-Buga dhe Mujidin Mistu, "*Komenti…*"op.cit. f. 20.

Nga ana tjetër, as nocioni *'islam'* dhe as ai *'iman',* siç thamë edhe më lart, nuk limitohen në mënyrë të prerë vetëm me ato veprime. Ato janë prioritetet e fesë, nën kuptimin e kushteve të të cilëve koncentrohet bazamenti i domosdoshëm i realitetit të fesë. Njohja e këtij dallimi (fakti) është shumë me rëndësi në të kuptuarit e dy nocioneve. Mirëpo, si sfera e *'imanit'* si ajo e *'islamit'* janë shumë të gjëra. Ato janë të gjëra sa edhe vetë Feja Islame. Andaj edhe përmbajtja e hadithit të Xhibrilit a.s.mbi të gjitha është fokusimi dhe definimi i sferës karakterizuese të nocioneve duke e konsideruar njërin për përfaqësim të gjendjes së brendshme të njeriut e ky është imani, e tjetrin për përfaqësim të gjendjes së jashtme të tij, e ky është Islami, dhe jo se vetëm konditat e potencuara në hadith, në mënyrë të prerë janë përmbyllëse të hapësirës së *'imanit'* dhe *'islamit'*. Kjo është e pamundur. Këtë e vërtetojnë varietetet e transmetimeve të hadithit të Xhibrilit a.s. ku shtohen edhe elemente të tjera pos kushteve themelore dhe bazë të tyre.

Prandaj, në parim, potencialisht ekziston dallimi mes *islamit* dhe *imanit* nga aspekti etimologjik. Mirëpo, soditja e tyre nga aspekti terminologjik në përmasat tej përkufizimit sasior të Xhibrilit a.s. rezulton në një konkludim të përbashkët, në një synim të përbashkët, në një identifikim të njëjtë, dhe në një adresë të vetme.

Pra, ata janë një gjë e vetme dhe janë sinonime e njërit ndaj tjetrit. Çdo *"mu'min"*[52] - besimtar është *"muslim"*[53] - mysliman, dhe çdo *"muslim"* është *"mu'min"*. Këtë e argumenton Fjala e të Lartmadhërishmit:

وَمَن يَبْتَغِ غَيْرَ الإِسْلاَمِ دِينًا فَلَن يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الآخِرَةِ مِنَ الْخَاسِرِينَ

"E kush kërkon fe tjetër, përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit" *(Kur'ani, Ali Imran: 85).* Dhe citati tjetër: إِنَّ الدِّينَ عِندَ اللّهِ الإِسْلاَمُ - ***"Feja e pra-***

[52] MU'MIN- është mbiemri foljor aktiv (vepror) i llojit të katërt të grupit të foljeve të prejardhura (të zgjeruara) nga i cili rrjedh nocioni iman..

[53] MUSLIM- është mbiemri foljor aktiv (vepror) i llojit të katërt të grupit të foljeve të prejardhura (të zgjeruara) të gjuhës arabe, nga i cili rrjedh nocioni Islam.

nueshme tek Allahu është Islami...” *(Kur’ani, Ali Imran: 19),* që do të thotë Feja nga Allahu është Islami [54].

Sikur imani të ishte tjetër nga islami atëherë ai do të konsiderohej i papranueshëm. Ndërkohë që imani gjithsesi është fe (besim) dhe nuk është tjetër nga Islami, sepse në të kundërtën nuk konsiderohet fe (besim) nga Allahu[55]

Patjetër se me ekzistimin e njërit prej tyre te ndonjë njeri, ai konsiderohet prej radhëve të imanit (besimtarëve). Dhe sipas kësaj ligjvënësi (esh-shariu-Pejgamberi a.s.) ‘imanin’ njëherë e definoi (e kaloi) në përmbajtje të ‘islamit’ e herën tjetër ‘islamin’ e kaloi në përmbajtje të ‘imanit’, sikurse është thënia e Pejgamberit a.s. ndaj një delegacioni[56]:

قَالَ أَتَدْرُونَ مَا الإِيمَانُ بِاللَّهِ وَحْدَهُ قَالُوا اللَّهُ وَرَسُولُهُ أَعْلَمُ قَالَ شَهَادَةُ أَنْ لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللَّهُ وَأَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ وَإِقَامُ الصَّلاَةِ وَإِيتَاءُ الزَّكَاةِ وَصِيَامُ رَمَضَانَ ...

”A e dini se çka është imani (besimi) në Zotin? Ata thanë: Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri. Tha alejhis-salatu ves-selam: (Iman është) Dëshmia se nuk ka zot tjetër, pos Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, d.t.th, rob i Tij dhe i dërguar i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit…”[57]

Islami dhe imani janë të pandashëm

Thënia e Ebu Hanifes: ***”Lidhshmëria mes tyre është sikurse shpina në raport me barkun.”***

Gjëja më e vogël e emërtimit të Islamit është dëshmia la ilahe illa’ Ll-llah ve en-ne Muhammeden resulull-Llah, kurse më e vogla e emërtimit të imanit është vërtetimi i palëkundur me zemër i këtyre dy dëshmive. Kështu islami dhe imani janë reciprocikisht të domosdo-

[54] El-Gazneviјj “*Kitabu usuli*…” op.cit. f. 261-263.
[55] El-Gazneviјj “*Kitabu usuli*…” op.cit. f. 263.
[56] Alij El-Karij “*Sherhu kitabi’l fikhi’l ekber*”, op.cit. f. 237. Ky delegacion citohet të jetë ai ‘Abdul Kajsit’.
[57] Sahihu’l Buhari, Kitabu’l Imani, babu: edai’l hamsi mine’l imani, nr. 51.

shëm dhe nuk mund të ekzistojë njëri pa ekzistimin e tjetrit. Shqiptimi i dy dëshmive nuk pranohet tek Allahu, pa vërtetimin e plotë me zemër, kurse vërtetimi me zemër pa shqiptimin me gjuhë, po ashtu nuk pranohet. Prandaj Ebu Hanife ka thënë: ***“ata dy janë sikurse shpina në raport me barkun.”***[58]

Shumica e maturidinjve janë të mendimit se *‘islami’* dhe *‘imani’* janë një, në bazë të asaj se çka e shpëton robin në botën tjetër. Ngase domethënia e ‘amentu-kam besuar në atë me të cilën ka ardhur Pejgamberi a.s. është *‘sad-daktu* - kam besuar. Dhe përmbajtja e fjalës *‘eslemtu lehu* - i jam dorëzuar, është *sel-lemtuhu* - jam dorëzuar’, dhe mes tyre nuk shfaqet shumë dallim për shkak të rikthimit të tyre në domethënie të deklarimit *(el-i’tirafu),* dorëzimit, nënshtrimit dhe pranimit[59]

Ndërsa imam Nurudin Es-Sabuni në librin e tij *‘El-kifajetu fil hidajeti’* thotë: *‘Imani’* është të besuarit në Allahun xh sh. në të gjitha ato që i ka shpallur prej urdhëresave dhe ndalesave të Tij. Ndërsa ‘islami’ është dorëzim dhe nënshtrim ndaj Njëshmërisë së Allahut, dhe kjo nuk mund të realizohet përpos me pranimin e urdhëresave dhe ndalesave. Prandaj *‘imani’* nga aspekti i dispozitës nuk ndahet nga *‘islami’*. Ata nuk ndryshojnë.[60]

Edhe imamul huda - El-Maturidiju është i mendimit se ‘islami’ dhe ‘imani’ janë një ku ai thotë: është vërtetuar se ata dy janë një në identifikim (tahkik) sipas asaj që pasojnë dispozitat e Kur’anit ndaj tyre. Allahu i madhëruar thotë: ***”Ju*** *(besimtarë)* ***thuani: Ne <u>i besuam</u> Allahut…”*** e deri te Fjala e Tij: ***”…dhe ne vetëm Atij i jemi bindur”***[61]**.** Atyre ua obligoi emrin e *‘islamit’* mbi bazën e asaj që kanë

[58] El-Kadi Ebu Bekr Muhamed bin Et-Taj-jib El-Bakil-lanij, “*Kitabu temhidi’l evaili ve telhisi’d-delaili*” me tahkik të shejh Imadud-din Ahmed Hajdar, boton Mues-sesetu’l kutubi’th-thekafijjeh, botimi i parë 1407 h / 1987 m, Bejrut Liban, fq.391.
[59] El-Gazneviјj “*Kitabu usuli*…” op.cit. f. 261
[60] Shih: librin ‘*El-Bidajetu minel hidajeti*”, tahkik Fet’hullah Halif, fq13, cituar sipas: Et-Taftazanij “*Sherhu’l akaidi*…” op.cit. f. 200.
[61] Kur’ani, El-Bekare: 136. Ajeti i plotë është si vijon: ”Ju (besimtarë) thuani: Ne i besuam Allahut atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Ja’kubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në pesëmbëdhjetë kabile) atë që i është dhënë Musait, Isait dhe që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm Atij i jemi bindur”

iman. Diç e ngjashme është edhe në kaptinën Junus: ***"Musai tha: O Populli im, nëse i keni besuar Allahut, vetëm Atij mbështetuni, nëse jeni të dorëzuar*** *(vendimit të Tij)" (Kur'ani, Junus: 84),* ku ata i ka bërë (konsideruar) myslimanë në bazë të asaj që kanë besuar. Pastaj ajeti tjetër: ***"Ata ta shprehin ty mirënjohjen*** *(ta përmendin)* ***që u bënë myslimanë. Thuaj: pranimin tuaj të Fesë islame mos ma njihni*** *(mos ma përmendni)* ***mua, por nëse jeni të sinqertë Allahu juve ju bëri mirë, kur ju udhëzoi për besim"****(Kur'ani, El-Huxhurat: 17),* ku ata i ka bërë prej 'islamit', me kusht që ata ta kenë shprehur sinqeritetin e tyre në iman - besim, dhe si të tillë ata janë besimtarë. Pastaj, engjëjt thanë: ***"Dhe kush ishte aty nga besimtarët, ne i nxorëm*** *(i larguam).* ***Po nuk gjetëm aty pos një shtëpie myslimane"*** *(Kur'ani, Edh-Dharijat: 35-36),* ku ata të cilët ishin myslimanë (muslimin) i ka bërë (llogaritur) besimtarë (mu'minin). Pastaj, gjithashtu lajmin e mirë (el bisharetu[62]) Allahu xh.sh. njëherë e ka përmendur krahas potencimit të *'imanit',* e herën tjetër krahas potencimit të *'islamit',* me se edhe vërtetohet se ata dy janë një në realitet[63].

Në këtë kontekst transmetohet nga Resulullahi s.a.w.s. se ka thënë:

لاَ يَدْخُلُ الْجَنَّةَ إِلاَّ نَفْسٌ مُؤْمِنَةٌ

"Nuk do të hyjë në xhennet, përpos një njeri që është besimtarë"[64]*,* dhe transmetohet se ka thënë:

[62] Siç është Fjala e Allahut xh.sh. kur besimtarëve u jep përgëzim: "…ve besh-shiril mu'minine - e besimtarëve jepu myzhde…" (Kur'ani, El-Bekare: 223); dhe citati tjetër kur muslimanëve u jep përgëzim: "…ve huden ve bushra lilmuslimine - dhe për të qenë udhërrëfyes e myzhde për muslimanët" (Kur'ani, En-Nahl: 102).

[63] El-Maturidijj, "*Kitabu't-tevhid*", op. cit. f. 637.

[64] Musnedi i Ahmedit, Kitabu: Musnedu'l ashereti'l mubesh-shirine…, babu: ve min musnedi Alijj…, nr. 560.

لاَ يَدْخُلُ الْجَنَّةَ إِلاَّ نَفْسٌ مُسْلِمَةٌ

"Nuk do të hyjë në xhennet, përpos një njeri që është mysliman"[65]*,* ku bartësin e 'imanit' dhe bartësin e 'islamit' i ka bërë një në dispozitë.

Edhe më tej Imam Maturidiju vazhdon duke thënë se "çështja (e islamit dhe imanit) është përcjellë pa kurrfarë polemizimi rreth emërtimit të çdo myslimani besimtar dhe të çdo besimtari mysliman. Mandej dijetarët e medh'hebëve (të njohura) në islam janë unikë se ajo që e nxjerr atë prej *'imanit'* e nxjerr edhe prej *'islamit'.* Dhe kështu ajo që e nxjerr prej *'islamit'* e nxjerr edhe prej *'imanit'.* Pastaj te të gjitha drejtimet (el-firek), është e papolemizueshme se në botën tjetër, shtëpia e cila është për bartësit e *'islamit'* është po ajo edhe për bartësit e *'imanit'.* Dhe se të gjitha shpërblimet që janë për njërin janë po ato edhe për tjetrin. Sepse Allahu xh.sh. ashtu si i ka ndarë krijesat në këtë botë, Ai i ka ndarë ato edhe në ahiret. Ai thotë: ***"Ai është që ju krijoi juve, e nga ju ka mohues dhe ka besimtarë…"*** *(Kur'ani, Et-Tegabun: 2)*[66].

Në kohën e Pejgamberit a.s. nuk janë potencuar veçanërisht diferencimet mes bartësve të *'islamit'* dhe të atyre të *'imanit'.* Me këtë nënkuptoj nuk kanë ekzistuar dy tabore me dy identitete të mëvetësishme: myslimanë-besimtarë me vijë ndarëse, dhe më pastaj me anë të këtyre dy identiteteve i gjithë ymeti Muhamed të përfaqësohej te të tjerët.

Në fakt, njerëzit në kohën e Resulullahit s.a.w.s. ishin të ndarë në tri grupe: në *besimtarë, hipokritë dhe pabesimtarë.* Grupi i katërt nuk ekzistonte fare[67]. Mirëpo, shtresa e hipokritëve (në besim) përfaqësohej me këtë emër vetëm te njerëzit, ndërsa ata tek Allahu xh.sh. llogari-

[65] Sahihu'l Muslim, Kitabu'l Imani, Babu: Kevnu hadhihi'l ummetu nisfu ehli'l xhenneti, nr. 326.

[66] El-Maturidijj, "*Kitabu't-tevhid*", op. cit. f. 638.

[67] Alij El-Karij "*Sherhu kitabi'l fikhi'l ekber*", op.cit. f. 236.

ten prej pabesimtarëve[68]. Atëherë mbi këtë bazë, njerëzit ndahen në dy grupe, *në besimtarë dhe pabesimtarë,* konform citatit të lartcekur.

Prandaj, edhe në aspektin e dispozitës, *imani* nuk ndahet nga *islami*. Ata nuk ndryshojnë. Kush e vërteton ndryshimin mes tyre, atij i thuhet: cila është dispozita ndaj atij i cili ka *besuar,* por nuk është *islamizuar,* ose është *islamizuar,* por nuk ka *besuar?* Nëse ai cakton dispozitë për njërin e të tillën nuk e cakton edhe për tjetrin, ai në fakt haptazi e ka zhvlerësuar thënien e tij [69], sepse nuk është valide që të gjykohet për ndonjërin se është *besimtar* e nuk është *mysliman*, apo është *mysliman* e nuk është besimtar…[70]

Konkluza e këtij elaborimi

Në bazë të këtij elaborimi dhe në shenjë të përmbylljes, edhe pse është mjaft temë e hapur, pikëpamjet e përbashkëta dhe të ndara ndërmjet *'islamit'* dhe *'imanit',* më së miri i kristalizon shembulli që paraqitet nga komentuesi i akaidit të imam Tahavisë r.a., Ibnu Ebi'l Izz El-Hanefij, Allahu e mëshiroftë ku ai rezonon: Imani dhe islami në të vërtetë janë sikurse shembulli i dy dëshmive[71] njëri ndaj tjetrit. Dëshmia e risales (e shpalljes te Pejgamberi a.s) është tjetër nga dëshmia e Njëshmërisë. Në fakt ato dy dëshmi janë dy gjera në esencë, mirëpo njëra me tjetrën si në përmbajtje si në dispozitë janë të lidhura si një gjë e vetme. Të tillë janë *'islami'* dhe *'imani'*. Nuk ka *'iman'* ai që nuk ka *'islam'* dhe as nuk ka *'islam'* ai që nuk ka *'iman'*. Pra, besimtari nuk është i paislam kur te ai është i vërtetuar besimi dhe as myslimani nuk është i paiman kur te ai është i pranishëm islami i tij…[72]

[68] Allahu për hipokritët thotë: 'Ka disa njerëz që thonë: "Ne i kemi besuar Allahut dhe jetës tjetër (ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë." (Kur'ani, El-Bekare: 8).

[69] Nurudin Es-Sabuni "*El-Bidajetu minel hidajeti"*, tahkik Fet'hullah Halif, fq.13, cituar sipas: Et- El-Al-lametu Mes'ud bin Umer bin Abdullah, i njohur me pseudonimin Sa'd-ud-din Taftazanij, "*Sherhu'l mekasid*", ta'lik Ibrahim Shemsud-din, botimi i parë, 2001/1422, boton 'darul kutubi'l ilmijjeh, Libon Bejrut, f. 200.

[70] Alij El-Karij "*Sherhu kitabi'l fikhi'l ekber*", op.cit. f. 235-236.

[71] Me dy dëshmitë nënkuptohet: dëshmia: '*se nuk ka zot tjetër pos Allahut'* dhe dëshmia: se '*Muhamedi është i dërguar i Tij'*.

[72] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti*…"op.cit. f. 348.

Kështu Pejgamberi a.s. ka thënë:

أُمِرْتُ أَنْ أُقَاتِلَ النَّاسَ حَتَّى يَشْهَدُوا أَنْ لاَ إِلَهَ إِلاَّ اللهُ ، وَ أَنَّ مُحَمَّدا رَسُولُ اللهِ .

"Jam urdhëruar që t'i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij."[73]. Sikur ta thoshin vetëm këtë e ta mohonin risalen (shpalljen), ata nuk do të ishin meritorë për mbrojtje (për hyrje në shoqërinë myslimane), porse pa tjetër është që ata ta thonë *'la ilahe il-lall-llah',* të paluhatshëm në vërtetësinë e saj. Ndërsa ata nuk mund të kenë bindje stabile dhe të paluhatshëm derisa nuk besojnë në shpalljen[74] e Muhamedi a.s. se ai është i dërguar i Allahut. Nuk mund të konsiderohet besimtar mysliman, ai i cili e beson Allahun, por e mohon pejgamberinë e Muhamedit a.s. dhe të gjithë atë me të cilën ka ardhur ai. Dhe as nuk konsiderohet besimtarë mysliman ai i cili e beson pejgamberinë e Muhamedit a.s. por e mohon ekzistimin e një Zoti të vetëm. Kështu është islami dhe imani kur ata vijnë të shoqëruar njëri pranë (pas) tjetrit, siç është citati:

إِنَّ الْمُسْلِمِينَ وَالْمُسْلِمَاتِ وَالْمُؤْمِنِينَ وَالْمُؤْمِنَاتِ

"Nuk ka dyshim se për myslimanët e myslimanet, besimtarët e besimtaret…" *(Kur'ani, El-Ahzab: 35),* dhe hadithi i Pejgamberit a.s. (që u potencua më parë):

اللَّهُمَّ لَكَ أَسْلَمْتُ وَبِكَ آمَنْتُ

"O Zoti im Ty t'u kam dorëzuar (eslemtu) dhe në Ty kam besuar (amentu)"[75].

Pra, qëllimi me njërin është tjetër fare nga ai me tjetrin. Ndërsa kur ata vijnë të ndarë (veç e veç), atëherë cilido prej tyre e përmban kuptimin dhe dispozitën e tjetrit…[76]

[73] Nga Abdilah bin Omer dhe të tjerë prej sahabëve, S.Muslim, Kitabul Imani, nr.22 .

[74] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti*…"op.cit. f. 349.

[75] Sahihu'l Muslim, Kitabudh-dhikri ved-duai vetë-tevbeti…, Babu: et-teavvedhu mine-sh-sher-rri…, nr. 4894

[76] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti*…"op.cit. f. 349-350.

Feja e përfshin bashkërisht edhe 'islamin' edhe 'imanin'

Thënia e Ebu Hanifes: ***"Ndërsa Feja** (ed-dinu) **është emër që e përfshin 'imanin', 'islamin' dhe dispozitat në tërësi"***

Nocioni **'din'** është nocion i gjuhës arabe, përkatësisht infinitiv i llojit të I-rë *(eth-thulathijju el-muxherr-rredu)* të foljeve të parregullta *'el-mu'tel-letu',* të nëngrupit *'el-exhvefu jaijj',* në të cilat bashkëtingëllorja e mesme rrënjësore është "ي - ja" e cila konsiderohet bashkëtingëllore e dobët. Koha e shkuar (el-madi) e emrit *'din',* bën *'dane';* koha e tashme apo e ardhme (el-mudari) bën *'jedinu',* ndërsa infinitivi bën: *'dinen'*[77] dhe *'dijaneten'*[78] i cili është *'emër që përfshin të gjitha ato me të cilat adhurohet Allahu i madhëruar'*[79]

Fjala 'din-fe' në aspektin etimologjik ka disa domethënie, prej tyre edhe: nënshtrim, adhurim[80], shpërblim (ndëshkim), llogari[81], dhe kuptime të tjera[82]ndërsa në aspektin terminologjik feja nënkupton: Atë që e ka bërë ligj[83] Allahu xh.sh. prej dispozitave, për mes gjuhës (komunikimit) të të dërguarit të Tij'. Ose 'Ajo (feja) është një sistemim

[77] Me këtë prejardhje morfologjike emri "*din*" potencohet edhe në Kur'anin famëlartë, përkatësisht në kaptinën 'Et-Tevbetu, citati 29, ku thotë: … وَلَا يَدِينُونَ دِينَ الْحَقِّ - dhe ata nuk e besojnë fenë e vërtetë…"

[78] 'Dijaneten' është infinitiv i llojit të IV-ër të foljeve të prejardhura (el-mezidatu) i foljes 'dane', dhe bënë'edane'-'judinu'-'dijaneten'.

[79] "*El-Muxhemul Vesit"*, pjesa e parë dhe e dytë, shkronja 'd', fq.307.

[80] Në domethënie të "*nënshtrimit*" dhe "*adhurimit*", vjen në ajetet: 11,12,14,15 të kaptinës Ez-Zumer të Kur'anit.

[81] Në domethënie të "*shpërblimit*" dhe "*llogarisë"* vjen në ajetin: "Dhe se shpërblimi (gjykimi për veprat) do të ndodhë patjetër" (Edh-Dharijat: 6), dhe ajete të tjera të shumta si: kaptina El-Infitar: 17-19, Es-Safat: 53.

[82] Për më gjerë shih: Ebul A'la El-Mevdudi, "*El-Mustalehatul Erbeatu Fil Kur'ani*: el-Ilah,er-Rrab-bu, el-Ibadetu, ed-Dinu" botimi i dytë 1986/1406, Darut-turathil arebijj, pa vend botimi, fq.107-122.

[83] Fjala "Din" në kuptim të ligjit, përfshir këtu dispozitat dhe ligjet (el-hududu vel-kavanin), vjen në shumë ajete, ndër to edhe në: En-Nur: 2; Et-Tevbete: 36.; El En'am: 137. Esh-Shura: 21; El Kafirune: 2, dhe ajete të tjera.

(ligj, produkt, krijim – vad'un) hyjnor që i drejton[84] mendjeshëndoshit, në bazë të zgjedhjes së tyre të ndershme, drejt asaj që është më e mirë për vetveten e tyre[85]

Në këtë definicion nuk bëjnë pjesë ato që njeriu i ka sajuar prej legjislaturës. As ato që i kanë shkruar prej dispozitave dhe normave (standardeve), sipas të cilave ata sillen në botën e politikës, tregtisë, industrisë dhe lidhjeve të tjera [86].

Është emërtuar 'din-fe', sepse ne shprehim besim dhe shprehim dorëzim[87]. Në këtë kuptim nocioni "din" vjen në Kur'anin e madhëruar ku Allahu xh.sh. për ata të cilët nuk besojnë thotë:

" … وَلَا يَدِينُونَ دِينَ الْحَقِّ - ***dhe ata nuk e besojnë Fenë e vërtetë…"***
(Kur'ani, Et-Tevbetu: 29)

* * *

Në hadithin e njohur të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi, ku meleku Xhibril a.s., vjen dhe e pyet Muhamedin a.s., për domethënien e *'islamit', 'imanit'* dhe të *'ihsanit',* Pejgamberi a.s. pasi ishte përgjigjur në pyetjet e tij dhe Xhibrili a.s. ishte larguar, në fund të bisedës, ai (Pejgamberi a.s.) tha: *"ky ishte Xhibrili i cili erdhi t'ua mësojë juve fenë tuaj"*. Që do të thotë se të tre *'islami', 'imani'* dhe *'ihsani'* janë bashkëformues të një uniteti, dhe ajo është feja. Ai (Pejgamberi a.s.) sqaroi se feja jonë përfshinë (bashkon) treshin të kategorizuar në tri shkallë: *muslim (mysliman), mu'min (besimtar) dhe muhsin (bamirës)*[88]

[84] Fjalia: 'ajo është një sistemim hyjnor që i drejton', do të thotë kur mukel-lefi (i ngarkuari me obligime) njoftohet se zbatimi e detyrimeve ka shpërblim ose kryerja e të ndaluarës ka ndëshkim, atëherë ai stimulohet në zbatimin e të parës dhe braktisjen e të dytës.(shih: Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi*…", op.cit. 1/93.

[85] Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi*…", op.cit. 1/93.

[86] Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi*…", op.cit. 1/93.

[87] Tetan dhe El-Kilanijj, "*Avnu'l muridi*…", op.cit. 1/94.

[88] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti*…" op.cit. f.346-347.

Allahu e pranon vetëm një Fe

Pra, kur feja shprehet në kuptim të përgjithshëm, ajo përfshin besimin (tasdik), pohimin me gjuhë të asaj që e beson zemra (ikrar) dhe pranimin e të gjitha dispozitave të pejgamberëve a.s., sikurse pohon ajeti kur'anor: ***"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk i pranohet"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 85),* dhe ajeti: ***"Feja e pranueshme tek Allahu është islami"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 19).*

Dy ajetet e lartcekura qartazi argumentojnë se *islami* është e vetmja fe e pranuar tek Allahu xh.sh. dhe i paalternativë tek Ai. Ndërsa është më se e ditur se feja nuk është nocion abstrakt - fiks e që s'mund të deshifrohet, porse feja është një pikë kulmore që në vete përmban rregullat ligjore të sjelljeve të njeriut si nga sfera e shpirtërores si nga sfera e konkretës bashkërisht. Ndaj edhe ajo patjetër e përfshin edhe *islamin* edhe *imanin* dhe të tjerat prej dispozitave.

Në këtë kontekst Imam Ebu Muhamed El-Husejn bin Mes'ud El-Begavij Esh-Shafiij r.a. rreth hadithit të pyetjeve të Xhibrilit s.a.w.s. për imanin dhe islamin dhe përgjigjja e Pejgamberit ndaj tij thotë: *"Pejgamberi s.a.w.s. e ka bërë Islamin emër për ato që shfaqen prej veprave, ndërsa Imanin e ka bërë emër për ato që janë të brendshme prej besimit. Dhe nuk është ajo (qëllimi i hadithit) se veprat (që i atribuohen islamit) nuk janë prej Imanit, dhe se besimi me zemër (që i atribuohët imanit) nuk është prej Islamit. Mirëpo qëllimi i hadithit është detajizimi i një tërësie e cila është një gjë e vetme, ndërsa përmbledhje e saj është FE-ja.* Prandaj edhe për këtë Pejgamberi s.a.w.s. tha: *ky ishte Xhibrili i cili erdhi t'ua mësojë juve fenë tuaj".* Besimi dhe vepra e rezultojnë emrin e *imanit* dhe të *islamit* në mënyrë të bashkuar. Këtë e argumenton Fjala e Allahut të Madhëruar: ***"Feja e pranueshme tek Allahu është Islami…"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 19),* dhe ***"Kush kërkon fe tjetër përveç Fesë Islame, atij kurrsesi nuk i pranohet…"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 85).* Andaj Allahu i Madhëruar ka informuar se feja me të cilën Ai është i kënaqur dhe të cilën e pranon prej robërve të Tij është Islami, dhe si e tillë ajo nuk mund të jetë në pozitë të kë-

naqësisë dhe pranimit (te Allahu) përpos se me përmbajtjen e besimit dhe veprës[89], përfundon Begaviju r.h.

Islam është emri me të cilin njihet feja me të cilën ka ardhur Muhamedi a.s., dhe ky emërtim nuk është i vendosur për mes ixhtihadit (përpjekjes) të Pejgamberit a.s., porse ai është vendosur nga Allahu i Madhëruar[90], ku Ai thotë: ***"…Dhe zgjodha për ju islamin fe…"*** *(Kur'ani, El-Maide: 3)*

Feja islame është ajo të cilën Allahu xh.sh. e ka bërë ligj për robërit e Tij, me anë të gjuhës së të dërguarve të tij[91] për gjatë gjithë historisë së njerëzimit, që nga njeriu i parë dhe njëkohësisht edhe pejgamber i parë, Ademi a.s. dhe deri te Muhamedi a.s. pejgamber i fundit, dhe përmes këtij te të gjithë krijesat deri në ditën e Kijametit. Resulullahi s.a.w.s. thotë:

وَالْأَنْبِيَاءُ إِخْوَةٌ لِعَلَّاتٍ أُمَّهَاتُهُمْ شَتَّى وَدِينُهُمْ وَاحِدٌ

"Pejgamberët janë vëllezër prej një babe (el-al-lat), nënat e tyre janë të ndryshme, kurse feja e tyre është një"[92]. Kurse Imam Tahaviju thotë:

"Feja e Allahut në tokë e qiell është një. Kjo është Feja Islame. Allahu thotë: ***"Feja e pranueshme tek Allahu është islami"*** *(Kur'ani, Ali Imran: 19)* … Ajo është fe e maturisë ndërmjet teprimit (el-guluvvu) dhe neglizhencës (et-taksir); ndërmjet shembëllimit dhe shkatërrimit; ndërmjet detyrimit dhe përcaktimit; ndërmjet sigurisë dhe dëshpërimit. Kjo është feja jonë dhe të besuarit tonë nga aspekti i jashtëm dhe i brendshëm[93].

---

[89] Shih: *"Sahihu'l Muslim"* botimi i Kajros, op.cit., pjesa e parë, fq.145.
[90] Tab-bareh, "*Ruhu'd-din…*" op.cit. f. 13.
[91] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti…*"op.cit. f.518
[92] Sahihu'l Buhari, Kitabu'l ehadithi'l enbijai, Babu: Kavlull-llahi: vedhkur fil kitabi…, nr. 3187
[93] Ibnu Ebi'l Izz "*Sherhu'l akideti…*"op.cit. f. 520.

Orhan Bislimaj

THE CONCEPT OF "ISLAM" AND "IMAN" – SEPARATE AND UNIFIED ENTITIES
Aka-ideological explanation of the statement of Imam Abu Hanifa

(Summary)

"Islam is surrender and submission to the commands of God Most High. There is a lexical distinction between iman and Islam, but there is no belief without Islam, and Islam cannot be conceived of without belief. They are like the inner and outer aspects of a thing (that is inseparable). Religion (din) is a name applied to both belief and Islam, and indeed to all divine codes".

أرحان بسلماي

المصطلحات "الاسلام" و "الايمان" مكونات منفصلة أو متحدة
(شرح عقائدى لمقالة الامام الاعظم أبى حنيفة ر.ع.)

(خلاصة البحث)

قوله: وَالْإِسْلَامُ هُوَ التَّسْلِيمُ وَ الْإِنْقِيَادُ لِأَوَامِرِ اللهِ تَعَالَى، فَفِي طَرِيقِ اللُّغَةِ فَرْقٌ بَيْنَ الْإِيمَانِ وَ الْإِسْلَامِ، وَ لَكِنْ لَا يَكُونُ إِيمَانٌ بِلَا اِسْلَامٍ، وَ لَايُوجَدُ إِسْلَامٌ بِلَا إِيمَانٍ فَهُمَا كَالظَّهْرِ مَعَ الْبَطْنِ، وَالدِّينُ اِسْمٌ وَاقِعٌ عَلَى الْإِيمَانِ وَ الْإِسْلَامِ وَ الشَّرَائِعِ كُلِّهَا.

إن المصطلحين "الاسلام" و "الايمان" قد يسببان أرباكا لدى القارئ أو المستمع أو عند الشخص الذي يحاول معرفة معنيهما.

و هذا الامر قد يزيد شغفا لمعرفة معنى الاول و معنى الثاني و هل معناهما واحد وهل مغزاهما واحد كذلك و اذا لم يكن كذلك ما الفرق بينهما الخ.

FILOZOFI

Ibn Rushd & (Averroes)
(1126-1198 e.s.)

Pajtimi ndërmjet sheriatit dhe filozofisë & Religjioni & Filozofia, 1190 e.s.

Hyrje

Ne pohojmë se detyra e filozofisë s'është gjë tjetër veçse të shohë krijimin dhe të mendojë mbi të, me qëllim që të drejtohet drejt Krijuesit – me fjalë të tjera, të shqyrtojë kuptimin e ekzistencës.[1] Mbasi, njohja e krijimit të çon drejt njohjes së Krijuesit, përmes njohjes së të krijuarës, sa më e përkryer bëhet njohja e krijimit, aq më e përkryer bëhet njohja e Krijuesit. Ligji na inkurajon dhe na nxit ta vrojtojmë krijimin. Kështu, është e qartë se kjo duhet marrë si një urdhër fetar, apo si diçka e aprovuar prej Ligjit. Por, Ligji na nxit për të vrojtuar krijimin nëpërmjet arsyes dhe si rrjedhim kërkon njohje përmes arsyes. Kjo është e qartë prej ajeteve të ndryshme kur'anore. Për shembull, në Kur'an thuhet: ***"Pra merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes"***

[1] Ky tekst në anglisht njihet me titullin: 'Mbi harmoninë e besimeve dhe filozofisë' (On the Harmony of religions and Philosophy), Në arabisht 'Kitab fasl al-makal', me shtojcën e vet (Damina). Gjithashtu, e bashkangjitura është një ekstrakt prej 'Kitab al-kashf an manahij al-adilla'. Burimi: Sipas: http://www.fordham.edu/halsall/source/1190averroes.html.

[Kur'an 59; 2]. Ky është një tregues i qartë i domosdoshmërisë së përdorimit të aftësisë arsyetuese, apo më mirë të arsyes dhe të fesë, në interpretimin e gjërave. Përveç kësaj, ai (Kur'ani) thotë:

"A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në tokë, dhe gjërat që Allahu i ka krijuar?" *[Kur'an 7; 185]*

Kjo është një thirrje e hapur për të inkurajuar përdorimin e vrojtimit të krijimit. Kujtojmë se njëri, të cilin Zoti e dalloi veçanërisht në këtë pikëpamje, ishte pejgamberi Ibrahim. Mbasi, Ai thotë: ***"Dhe kështu Ibrahimit ia mundësuam t'i shohë madhësitë e qiejve dhe të tokës…"*** *[Kur'an 6; 75]*

Gjithashtu, Ai thotë: ***"A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar? Edhe qiellin se si është ngritur lart!"*** *[Kur'an 88; 17-18]*

Apo, ende përsëri: ***"Dhe*** *(të cilët)* ***thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës*** *(duke thënë)*: ***Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot".*** *[Kur'an 3; 191]*

Ekzistojnë shumë ajete të tjera mbi këtë temë: në sasi tepër të mëdha për t'u numëruar.

Tani, duke qenë se Ligji e bën të detyrueshëm vëzhgimin dhe shqyrtimin e krijimit me anën e arsyes - dhe duke qenë se shqyrtimi s'duhet bërë veçse eksplicit (i shprehur qartë) dhe implicit (i nënkuptuar) – kjo mund të bëhet vetëm nëpërmjet arsyes. Kështu, ne duhet ta vështrojmë krijimin me arsye. Për më tepër, është e qartë se vëzhgimi, të cilin Ligji e miraton dhe inkurajon, duhet të jetë i formës më të përsosur, i kryer me llojin më të përsosur të të arsyetuarit. Mbasi Ligji thekson njohjen e Zotit dhe të krijimit të Tij me anën e konkluzionit, është detyrë e çdokujt, i cili dëshiron ta njohë Zotin dhe krijimin e Tij në tërësi me anën e konkluzionit, të mësojë llojet e konkluzioneve, kushtet e tyre dhe atë që e dallon filozofinë prej dialektikës dhe egzoterizmin prej silogjizmit. Kjo do të ishte e pamundur nëse askush nuk do të zotëronte, që më parë, njohjen e llojeve të ndryshme të të arsyetuarit dhe të mësonte për të dalluar midis të arsyetuarit dhe të asaj që nuk është arsyetim. Kjo nuk mund të bëhet përveçse prej atij, i cili i njeh pjesët e ndryshme të saj, pra që njeh llojet e ndryshme të premisave (kushteve paraprake).

Kështu, për një besimtar të Ligjit dhe një pasues të tij, është e domosdoshme që t'i dijë këto gjëra, përpara se ai të fillojë të vështrojë krijimin, mbasi ato janë njëlloj si instrumentet për vrojtim. Sepse, - pikërisht sikurse një student (i juridikut) mëson me anën e studimit të ligjit domosdoshmërinë e njohjes së të arsyetuarit ligjor, me të gjitha llojet dhe dallimet e tij, - një student (i teologjisë) do të zbulojë me anën e vrojtimit të krijimit, domosdoshmërinë e të arsyetuarit metafizik. Në të vërtetë, ai ka një pretendim më të madh lidhur me të, sesa një jurist. Mbasi, nëse një jurist e argumenton domosdoshmërinë e të arsyetuarit ligjor prej thënies së Zotit: ***"Pra merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes"*** *[Kur'an 59; 2],* një student i teologjisë ka më shumë të drejtë, për të bërë të njëjtën prej tij, në emër të të arsyetuarit metafizik.

Askush nuk mund të pohojë se ky lloj i të arsyetuarit është një novatorizëm në fe, për shkak se ai nuk ka ekzistuar në ditët e hershme të Islamit. Mbasi të arsyetuarit ligjor dhe llojet e tij, janë çështje të cilat u shpikën, gjithashtu, në shekujt e më vonshëm, dhe askush nuk mendon se ato janë novatorizma. I tillë duhet të jetë, gjithashtu, qëndrimi ynë kundrejt të arsyetuarit filozofik. Ekziston (edhe) një arsye tjetër përse kjo duhet të jetë kështu, por këtu nuk është vendi përkatës për ta përmendur atë. Një numër i madh i pasuesve të kësaj feje e pohojnë të arsyetuarit filozofik, me përjashtim të një pakice të vogël të pavlefshme, të cilët argumentojnë në bazë të urdhëresave fetare. Tani, meqë është thënë se Ligji e bën shqyrtimin e të arsyetuarit filozofik dhe të llojeve të tij, si të domosdoshëm sikurse të arsyetuarit ligjor, nëse askush prej paraardhësve tanë nuk ka bërë një përpjekje për ta shqyrtuar atë, ne duhet të fillojmë ta bëjmë atë, dhe kështu u ndihmojmë atyre, derisa njohja të kompletohet. Mbasi, nëse është e vështirë, apo më mirë e pamundur për një person për ta njohur i vetëm vetveten me të gjitha gjërat, gjë që është e domosdoshme për të njohur çështjet ligjore, kjo është akoma më e vështirë në rastin e të arsyetuarit filozofik. Dhe nëse përpara nesh, dikush e ka shqyrtuar atë, ne duhet të përftojmë ndihmë prej asaj se çfarë ai ka thënë. Është krejtësisht e parëndësishme nëse ky njeri është bashkëbesimtari ynë apo jo; mbasi instrumenti,

me anën e të cilit purifikimi përsoset, nuk bëhet i dyshimtë në dobishmërinë e vet prej të qenit të tij në duart e njërit prej vetë grupit tonë, apo të një të huaji, nëse ai zotëron atributet e së vërtetës. Me anën e këtyre të fundit, ne kemi parasysh ata Antikë, të cilët i gjurmuan këto çështje para ardhjes së Islamit.

Tani, rasti është i tillë. Gjithçka që kërkohet në shqyrtimin e të arsyetuarit filozofik ka qenë ekzaminuar tashmë më parë përsosmërisht prej Antikëve. E gjitha që kërkohet prej nesh është se, ne duhet t'u kthehemi përsëri librave të tyre dhe të shohim se çfarë kanë thënë ata lidhur me këtë. Nëse e gjithë ajo, që ata kanë thënë, është e vërtetë, ne duhet ta pranojmë atë, dhe nëse ekziston diçka e gabuar, ne duhet të paralajmërohemi me anën e saj. Kështu, kur ne të kemi përfunduar këtë lloj kërkimi, ne do të kemi përftuar instrumentet, me anën e të cilave ne mund të vëzhgojmë universin dhe duhet të marrim parasysh karakterin e përgjithshëm të tij. Për sa kohë që ndokush nuk është në dijeni të karakterit të përgjithshëm të këtij (kërkimi), ai nuk mund ta njohë të krijuarën, dhe për sa kohë ai nuk e njeh të krijuarën, ai nuk mund ta njohë natyrën e saj.

Të gjitha gjërat janë të bëra dhe të krijuara. Kjo është plotësisht e kuptueshme në vetvete, në rastin e kafshëve dhe bimëve, pasi Zoti ka thënë: ***"Vërtet, ata që po i adhuroni në vend të All-llahut, ata nuk mund ta krijojnë asnjë mizë, dhe nëse tubohen të gjithë për të…"*** *[Kur'an 22; 72].* Ne shohim një lëndë inorganike dhe më pas (vëmë re se) ekziston jeta në të. Kështu ne e dimë me siguri se ekziston një shpikës dhe dhurues i jetës dhe Ai është Zoti. Prej qiejve (trupave qiellorë), ne e dimë, me anën e lëvizjeve të tyre, të cilat asnjëherë nuk ngadalësohen, se ata punojnë për të mirën tonë, sipas përkujdesjes hyjnore dhe se ata janë të nënshtruar për mirëqenien tonë. Një objekt i tillë, i urdhëruar dhe i nënshtruar, gjithmonë është i krijuar për disa qëllime. Parimi i dytë është, se për çdo gjë të krijuar ekziston një krijues. Kështu është e drejtë të thuhet prej dy parimeve të lartpërmendura se për çdo gjë ekzistuese ekziston një shpikës. Ekzistojnë shumë argumente, në pajtim me numrin e gjërave të krijuara, të cilat mund të paraqiten për të vërtetuar këtë premisë. Në këtë mënyrë, është e do-

mosdoshme për secilin, i cili dëshiron të njohë Zotin, pasi Ai duhet të njihet, që ta informojë vetveten me esencën e gjërave, kështu që ai të mund të marrë informacion rreth krijimit të të gjitha gjërave. Mbasi kush nuk mund ta kuptojë thelbin dhe qëllimin real të një sendi, nuk mund të kuptojë domethënien më të vogël të krijimit të tij. Kjo është ajo, së cilës All-llahu i referohet në ajetin që vijon: ***"A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në tokë, dhe gjërat që Allahu i ka krijuar?"*** *[Kur'an 7; 185]*. Dhe kështu një njeri, i cili dëshiron të ndjekë qëllimin e filozofisë në shqyrtimin dhe ekzistencën e gjërave, pra që dëshiron të përpiqet për të njohur shkakun, i cili e çon drejt krijimit të tij, dhe qëllimin e tij, duhet ta njohë argumentin e mirësisë tepër përsosmërisht. Këto dy argumente janë ato të miratuara prej Ligjit.

Ajetet e Kur'anit, që të shpien drejt njohjes së ekzistencës së Zotit, varen vetëm nga dy argumentet e sipërpërmendura. Kjo do të jetë plotësisht e qartë për cilindo, i cili do të shqyrtojë me vëmendje ajetet, të cilat ndeshen në Librin Hyjnor, në lidhje me këtë. Kur të shqyrtohen, do të zbulohet se ato (ajetet) janë të tre llojeve, ato: ose janë ajete që tregojnë "argumentet e mirësisë", ose janë ajete që përmendin "argumentet e krijimit", ose janë ajete të cilat përfshijnë të dyja llojet e argumenteve. Ajetet që pasojnë mund të merren si ilustruese të argumentit të mirësisë. ***"A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme*** *(për jetë)*. ***Ndërsa kodrat shtylla? Dhe Ne u krijuam juve në çifte. Dhe gjumin tuaj ua bëmë për pushim. Dhe natën ua bëmë mbulesë. Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim. Dhe Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të fortë. Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron. Dhe prej reve të shtrydhura kemi lëshuar shi të madh. Që me të rrisim drithëra e bimë. Edhe kopshte të dendura palë mbi palë."*** *[Kur'an 79; 6-16]* dhe: ***"I madhërishëm është Ai që krijoi yje në qiell dhe vendosi në të dritë*** *(diell)* ***e hënë që ndriçon."*** *[Kur'an, 25; 61]* dhe përsëri: ***"Njeriu le ta shikojë ushqimin e vet."*** *[Kur'an, 80; 24]*

Ajetet, që pasojnë, i referohen argumentit të shpikjes: ***"Le ta shikojë njeriu se prej çfarë është krijuar. Ai është krijuar prej një uji që hidhet fuqishëm. E që del nga kurrizi i shpinës dhe dërrasa e gjok-***

sit. *[Kur'an, 86; 5-7]* dhe: ***"A nuk i shikojnë devetë si janë krijuar? Edhe qiellin si është ngritur lart. Edhe kodrat se si janë venduar! Edhe tokën se si është shtruar!"*** *[Kur'an 88; 17-20]* dhe përsëri: ***"O ju njerëz, ja një shembull, veni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuroni në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të…"*** *[Kur'an 22; 73]*. Mbas kësaj mund të tregojmë historinë e Ibrahimit, që përmendet në ajetin që vijon: ***"Unë me veten time i drejtohem Atij, që krijoi qiejt e tokën. Larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shokë!"*** *[Kur'an 6; 79]*.

Mund të citohen shumë ajete që i referohen këtij argumenti. Ajetet, që përfshijnë të dyja argumentet, janë gjithashtu shumë, për shembull: ***"O ju njerëz, adhuroni Zotin tuaj, i cili ju krijoi juve dhe ata që ishin para jush, ashtu që të jeni të devotshëm. Ai, i cili për ju e bëri tokën shtrat e qiellin kulm, e prej qiellit ju lëshoi shi, me të cilin siguroi lloje të frutave si ushqim për ju, pra mos i përshkruani Allahut shokë, duke qenë se ju e dini."*** *[Kur'an 2; 21-22]*

Fjalët e Tij: "I cili ju krijoi juve dhe ata që ishin para jush", na çojnë drejt argumentit të krijimit, ndërsa fjalët: "I cili për ju e bëri tokën shtrat" i referohen argumentit të përkujdesjes hyjnore për njeriun. Të këtij lloji janë gjithashtu ajetet që vijojnë: ***"Dhe për ata është argument toka e vdekur, të cilën Ne e ngjallim, nxjerrim prej saj drithin, nga i cili ata hanë."*** *[Kur'an 36; 33]* dhe: ***"Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt. Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim, kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës*** *(duke thënë)*: ***Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!"*** *[Kur'an 3; 190-191])*. Shumë ajete të këtij lloji përfshijnë të dyja llojet e argumenteve.

Kjo metodë është rruga e drejtë, me të cilën Zoti i ka ftuar njerëzit drejt njohjes së ekzistencës së Tij dhe t'i informojë ata për të, përmes inteligjencës, të cilën Ai e ka rrënjosur në natyrën e tyre. Ajeti, që vijon, i referohet kësaj natyre të përcaktuar dhe të lindur të njeriut:

"Kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit, pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre: "A nuk jam Unë Zoti juaj?" Ata thanë: "Po, dëshmuam!" Të mos thoni në Ditën e Kijametit: "Ne nga ky** (dëshmim) **ishim të panjohur."** [Kur'an 7; 172)*. Kështu është detyrë për çdokënd, që dëshiron t'i bindet Zotit dhe të pasojë urdhrin e Pejgamberit të Tij, që ai ta përvetësojë këtë metodë, duke e bërë kështu vetveten një prej atyre njerëzve të ditur, të cilët bartin dëshminë e Hyjnisë së Zotit, me dëshminë e vet Atij, dhe të engjëjve të Tij, sikurse Ai thotë: ***"Allahu vërtetoi se nuk ka Zot tjetër përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka Zot, përveç Tij, Fuqiplotit e të Urtit." *[Kur'an 3; 18]*. Midis argumenteve për të dyja llojet, është edhe lavdërimi, të cilit Zoti i referohet në ajetin që vijon: ***"Nuk ka asnjë send që nuk e madhëron, duke i shprehur falënderim Atij, por ju nuk e kuptoni atë madhërim të tyre."*** *[Kur'an 17; 44]*.

Është e qartë, prej argumenteve të mësipërme për ekzistimin e Zotit, se ato janë në varësi të dy kategorive të të arsyetuarit. Është, gjithashtu, e qartë se të dyja këto metoda kanë parasysh njerëz të veçantë; që janë të diturit. Tani për sa i përket metodës së masave (njerëzve të zakonshëm). Dallimi midis këtyre dy metodave qëndron vetëm në hollësi. Masat nuk mund t'i kuptojnë dy argumentet e sipërpërmendura, por (mund të kuptojnë) vetëm atë çfarë ata mund ta kapin prej shqisave të tyre; ndërsa njerëzit e shkolluar (të diturit) mund të shkojnë më tutje dhe të mësojnë, gjithashtu, edhe me anën e të arsyetuarit, përveç të të mësuarit me anën e shqisave. Ata kanë shkuar aq larg, sa që një njeri i ditur ka thënë se të mirat e njerëzve të ditur që përftohen prej njohjes së trupit njerëzor dhe shtazor, janë njëmijë e një. Nëse kjo është kështu, atëherë kjo është metoda, e cila mësohet edhe prej Ligjit, edhe prej Natyrës. Kjo është metoda, e cila është predikuar prej Pejgamberit dhe librave hyjnorë. Njeriu i ditur nuk ua përmend këto dy linja të të arsyetuarit masave, jo për shkak të numrit të tyre, por për shkak të një domosdoshmërie të thellë të të mësuarit nga ana e tyre, rreth njohjes vetëm të një gjëje të vetme. Shembulli i njeriut të zakonshëm, që vështron dhe mendon mbi universin, është si një

njeri që e shqyrton një gjë, manifakturën e të cilit ai nuk e njeh. Gjithçka, që një njeri i tillë mund të dijë rreth saj, është se ajo është e prodhuar dhe se duhet të ekzistojë prodhuesi i saj. Ndërkaq, nga ana tjetër i shkolluari (i dituri) e vështron universin, pikërisht si një njeri që e njeh artin e të bërit; (dhe ai) përpiqet që ta kuptojë qëllimin real të tij. Kështu është plotësisht e qartë se dija e tij rreth Krijuesit, si bërës i universit, do të jetë shumë më e mirë, sesa ajo e njeriut, i cili e njeh atë vetëm si të bërë. Ateistët, të cilët e mohojnë plotësisht Krijuesin, janë të njëjtë me njerëzit, të cilët mund t'i shohin dhe t'i ndiejnë gjërat, por nuk pranojnë ndonjë Krijues për to, por ia atribuojnë gjithçka vetëm rastësisë, dhe (pohojnë) se ato vijnë në ekzistencë prej vetvetes.

Atëherë, nëse tani, kjo është metoda e miratuar prej Ligjit, mund të pyetet: Cila është mënyra e të vërtetuarit të njësisë së Zotit nëpërmjet Ligjit; që është njohja e formulës religjioze se "Nuk ka zot tjetër, përveç Zotit"? Mohuesja, që përmbahet në të, është shtim i pohueses, të cilën përmban e formula, ndërkohë që pohuesja tashmë është vërtetuar. Cili është qëllimi i këtij mohimi? Ne duhet të themi se metoda e aprovuar prej Ligjit, e të mohuarit të hyjnisë së gjithçkaje përveç Zotit, është në pajtim me urdhëresën e Zotit në Kur'an…

Nëse ju do ta vështroni atë në mënyrë pak më të vëmendshme, do të bëhet e qartë për ju, se pavarësisht prej faktit se Ligji nuk ka dhënë ilustrim të këtyre gjërave për njerëzit e zakonshëm, përtej së cilës imagjinata e tyre nuk mund të shkojë, ai gjithashtu ka informuar njerëzit e ditur për domethëniet e nënfshehura të këtyre ilustrimeve. Kështu, është e domosdoshme për t'i pasur parasysh kufijtë, të cilat Ligji i ka vendosur rreth udhëzimit të çdo kategorie të njerëzve, dhe jo t'i përziejmë ata së bashku. Mbasi, në këtë mënyrë, qëllimi i Kur'anit shumëfishohet. Për këtë shkak, Pejgamberi ka thënë: "Ne pejgamberët jemi të urdhëruar që ta adaptojmë (përshtatim) vetveten me gjendjen (rangun) e njerëzve dhe t'iu drejtohemi atyre sipas inteligjencës së tyre". Ai, i cili përpiqet që t'i udhëzojë të gjithë njerëzit në çështjen e fesë, në një mënyrë të vetme dhe të njëjtë, është njëlloj si një njeri, i cili dëshiron që t'i bëjë ata të njëjtë në veprime gjithashtu, gjë që është plotësisht kundër ligjeve dhe arsyes së qartë.

Prej së lartpërmendurës, duhet të jetë bërë e qartë për ju se vizioni hyjnor ka një domethënie ezoterike, në të cilën nuk ka dyshim, nëse ne i marrim fjalët e Kur'anit, lidhur me Zotin sikurse ato janë, (pra i marrim) jashtë të vërtetuarit apo të përgënjeshtruarit të cilësisë antropomorfike të Zotit. Tani, përderisa pjesa e parë e Ligjit është bërë plotësisht e qartë, për sa i përket pastërtisë së Zotit, dhe sasisë së të mësuarit të përshtatshëm për njerëzit e zakonshëm; është koha për të filluar diskutimin rreth veprimtarisë së Zotit, pas së cilit qëndron qëllimi ynë në të shkruarit e këtij traktati.

Në këtë seksion ne do të ngremë pesë çështje, rreth të cilave rrotullohen të gjitha të tjerat. Në radhë të parë, faktin e krijimit të universit; së dyti, ardhjen e pejgamberëve; së treti, paracaktimin dhe caktimi; së katërti, drejtësinë dhe padrejtësinë Hyjnore; së pesti, Ditën e Gjykimit.

***

Problemi i Parë: Krijimi i Universit

Kur'ani na mëson se universi u shpik dhe u krijua prej Zotit, dhe se ai nuk erdhi në ekzistencë rastësisht, apo prej vetvetes. Metoda e miratuar prej Ligjit për të vërtetuar këtë, nuk është e vetmja mbi të cilën mbështeten Asharitët. Mbasi, ne tashmë kemi treguar se këto metoda nuk janë të përcaktuara posaçërisht për të shkolluarit, as mjaft të përgjithshme për të bindur të gjitha shtresat e njerëzve. Metodat, të cilat, në të vërtetë, janë të dobishme janë ato, të cilat kanë shumë pak premisa dhe përfundimet e të cilave shkojnë shumë pranë ideve të zakonshme të njohura. Por, në të udhëzuarit e njerëzve të zakonshëm, Ligji nuk përmban deklarata mbështetëse të të arsyetuarit të gjatë dhe të plotë, të mbështetur mbi probleme të ndryshme. Kështu, çdokush i cili, në mësimdhënien e tyre, përvetëson një drejtim të ndryshëm, dhe interpreton Ligjin sipas tij, e ka humbur shikimin e qëllimit të tij dhe ka shkuar në rrugë të gabuar prej rrugës së drejtë. Dhe për këtë arsye,

gjithashtu, Ligji në ilustrimet dhënëse për të arsyetuarit e tij, përdor vetëm ato, të cilat janë prezente para nesh.

Çdo gjë, që ka qenë vlerësuar e domosdoshme për t'u ditur prej njerëzve të thjeshtë, u ka qenë shpjeguar atyre me shembujt më të afërt të vlefshëm (në dispozicion), sikurse (është) rasti i Ditës së Gjykimit. Por, çdo gjë, që ka qenë e panevojshme për t'u ditur nga ana e tyre, atyre u është thënë se kjo është përtej njohjes së tyre, sikurse (janë) fjalët e Zotit rreth Shpirtit. [Kur'an, 22; 85]. Tani që neve e kemi vendosur këtë, është e nevojshme që metoda e miratuar prej Ligjit, për t'u dhënë njohuri njerëzve të thjeshtë mbi krijimin e universit, të jetë e tillë që të pranohet prej të gjithëve. Është gjithashtu e nevojshme, që përderisa nuk mund të gjendet diçka prezente për të ilustruar krijimin e universit, Ligji duhet të ketë përdorur shembuj të krijimit të gjërave në botën e dukshme.

Kështu, metoda e aprovuar prej Ligjit është se universi është krijuar prej Zotit. Nëse ne vështrojmë në mënyrë të vëmendshme ajetet që lidhen me këtë temë, ne do të shohim se metoda e pranuar është ajo e përkujdesjes hyjnore, të cilën ne e njohim të jetë një prej atyre, që provojnë ekzistencën e Zotit. Kur një njeri shikon një gjë të bërë në një formë, proporcion dhe model të caktuar, për një dobi të posaçme që përfitohet prej saj dhe për një qëllim i cili duhet të arrihet, bëhet e qartë për të, se (derisa) ajo është gjendur në këtë formë dhe proporcion, atëherë ky përfitim do të ketë qenë i dëshiruar në të, dhe ai arrin të dijë me siguri se ekziston bërësi i asaj gjëje, dhe se ai e ka bërë atë në atë formë dhe proporcion, për një qëllim të caktuar. Mbasi është e pamundshme që të gjitha cilësitë që i shërbejnë këtij qëllimi, të mblidhen në këtë gjë rastësisht. Për shembull, nëse një njeri shikon një gur në tokë në një formë të përshtatshme për t'u ulur, dhe gjen proporcionet e tij dhe modelin e të njëjtit lloj, atëherë ai do të arrijë të dijë se kjo është bërë prej një krijuesi dhe se ai e ka bërë atë, dhe e ka vendosur atë atje. Por, kur ai nuk shikon asgjë në të, e cila do të mund ta bënte atë të përshtatshme për t'u ulur, atëherë atij i bëhet e sigurt se ekzistenca e tij, në këtë vend, ishte vetëm rastësisht, pa të qenit të tij i modeluar prej ndonjë bërësi.

I tillë është gjithashtu edhe rasti me tërësinë e universit. Mbasi, kur një njeri shikon diellin, hënën dhe të gjithë yjet, të cilat janë shkaku i të katër stinëve; i ditëve dhe netëve, i shiut, i ujit dhe i erërave, i banimit të pjesëve të tokës, i ekzistencës së njeriut dhe i ekzistencës të të gjithë kafshëve dhe bimëve dhe i ekzistencës së tokës të përshtatshme për vendbanimin e njeriut dhe i gjallesave të tjera që jetojnë në të; dhe uji i përshtatshëm për gjallesat që jetojnë në të; dhe ajri i përshtatshëm për zogjtë, dhe nëse do të ekzistonte diçka e pavend në këtë krijim dhe ngrehinë, e tërë bota do të shkonte drejt çrregullimit dhe pështjellimit, atëherë ai do të arrinte të dinte me siguri se nuk është e mundur që kjo harmoni në të, për anëtarët e ndryshëm të universit – njeriun, kafshët dhe bimët – të gjendej vetëm rastësisht.

Ai do të dinte se ekziston dikush, i cili e përcaktoi atë, dhe i cili e bëri atë me qëllim dhe ky është Zoti, i lartësuar dhe i madhëruar qoftë Ai. Ai do ta dijë me siguri se universi është i krijuar, mbasi ai duhet, domosdoshmërisht, të mendojë se nuk është e mundur që në të, të mund të gjendet e gjithë ajo harmoni, nëse ai nuk është i bërë prej dikujt, dhe se ka ardhur në ekzistencë vetëm rastësisht. Ky lloj argumenti është plotësisht i përcaktuar dhe në të njëjtën kohë i qartë dhe atë paksa e kemi përmendur këtu. Ai bazohet mbi dy parime, të cilat janë të pranuara prej të gjithëve. Një prej tyre është se universi, me të gjithë pjesët e tij përbërëse, është krijuar i përshtatshëm për ekzistencën e njeriut dhe të gjërave; së dyti, ky që është krijuar i përshtatshëm në të gjitha pjesët e tij, për një synim të vetëm, duke u udhëhequr drejt një qëllimi të vetëm, është domosdoshmërisht një gjë e krijuar. Për këtë arsye, këto dy parime na çojnë ne, në mënyrë të natyrshme, që të pranojmë se universi është i krijuar, dhe se ekziston krijuesi i tij. Kështu "argumenti i analogjisë" na çon drejt dy gjërave, në të vetmen dhe të njëjtën kohë, dhe kjo është arsyeja se përse ky është argumenti më i mirë për të provuar ekzistimin e Zotit. Ky lloj i të arsyetuarit, gjithashtu, gjendet në Kur'an, në shumë ajete, në të cilat përmendet krijimi i universit.

Për shembull: ***"A nuk e bëmë Ne tokën të përshtatshme? Ndërsa kodrat shtylla? Dhe ne u krijuam juve në çifte. Dhe gjumin tuaj ua***

bëmë për pushim. Dhe natën ua bëmë mbulesë. Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim. Dhe Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të fortë. Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron. Dhe prej reve të shtrydhura kemi lëshuar shi të madh. Që me të të rrisim drithëra e bimë. Edhe kopshte të dendura palë mbi palë." *[Kur'an, 78; 6-16]*. Nëse ne mendojmë mbi këtë ajet, do të gjejmë se është tërhequr vëmendja jonë drejt përshtatshmërisë të pjesëve të ndryshme të universit për ekzistimin e njeriut. Në fillim fare, ne informohemi me faktin e mirënjohur prej të gjithëve - dhe ky (fakt) është se toka ka qenë krijuar në një mënyrë, e cila ka qenë e përshtatshme për ekzistencën tonë. Nëse ajo do të kish qenë e paqëndrueshme, apo në ndonjë formë tjetër, apo në ndonjë vend tjetër, apo jo në proporcionet e tashme, ajo nuk do të kishte pasur mundësi për të qenë këtu, apo mbi të nuk do të kishte pasur kurrfarë krijimi. E gjithë kjo përmblidhet në fjalët: "A nuk e kemi bërë Ne tokën shtrat për ju?" sepse në (fjalën) shtrat janë përmbledhur, së bashku, të gjitha cilësitë e formës, qetësisë dhe paqes, të cilave mund t'u shtohen edhe ato të lëmimit dhe butësisë.

Kështu sa e çuditshme është kjo vepër e mahnitshme dhe sa e shkëlqyeshme është kjo mirësi dhe sa i mrekullueshëm ky koleksion i të gjithë cilësive! Kjo është kështu për arsye se në fjalën "mihad" (shtrat) jepen së bashku të gjitha këto cilësi, të cilat gjenden në tokë, duke e bërë atë të përshtatshme për ekzistimin e njeriut. Kjo është një gjë, që bëhet e qartë për të diturin, pas shumë njohurish dhe pas një kohe të gjatë: ***"Mirëpo, Allahu me mëshirën e vet, veçon atë që dëshiron…".*** *[Kur'an 2; 105]*. Prandaj, për sa u përket fjalëve hyjnore: "Dhe malet shtylla" – ato na tregojnë ne, avantazhin e të qenit të tokës në qetësi, për shkak të maleve. Mbasi, nëse toka do të kish qenë krijuar më e vogël se tani, pra të kish qenë krijuar pa male, ajo do të ishte dridhur prej lëvizjes së elementeve të tjera, ujit dhe ajrit, dhe do të ishte tronditur dhe kështu do të ishte zhvendosur. Kjo, natyrisht do të kishte qenë shkak i shkatërrimit të botës shtazore. Prandaj, kur qetësia është në harmoni me ata që jetojnë në të, kjo nuk mund të ketë ardhur në ekzistencë vetëm rastësisht, por është bërë prej synimit dhe

përcaktimit të dikujt. Pa dyshim, ajo është bërë prej Atij, i Cili e paracaktoi dhe e determinoi atë, për hir të atyre që jetojnë në të.

Më pas, Ai tërheq vëmendjen tonë për përshtatshmërinë e ekzistencës së natës dhe të ditës për shtazët. Ai thotë: "Dhe natën ua bëmë mbulesë. Ndërsa ditën e bëmë për gjallërim." Ai ka si qëllim për të thënë se, Ai e ka bërë natën si mbulesë dhe mbështjellëse, për të gjitha gjërat, prej nxehtësisë së diellit. Mbasi, nëse nuk do të kish ekzistuar perëndimi i diellit natën, të gjitha gjërat, jeta e të cilave ka qenë e varur prej diellit, do të ishin shkatërruar – si kafshët, ashtu edhe bimët. Sikurse rroba, përveç të të qenit të saj një mbulesë, i mbron njerëzit prej nxehtësisë së diellit, ashtu Zoti e krahason natën me të. Kjo është një prej metaforave më të bukura. Gjithashtu, ekziston edhe një tjetër dobi e natës për shtazët; gjumi i tyre në të, pas perëndimit të diellit, është tepër i thellë, (por) i mban aftësitë në lëvizje, (pra kafsha) është vigjilente. Zoti thotë: ***"Dhe e caktoi gjumin tuaj për pushim"*** për shkak të errësirës së natës. Pastaj, Ai thotë: ***"Dhe Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të fortë. Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron."*** Këtu me fjalën 'ndërtim' Ai ka si qëllim krijimin e tyre, dhe harmoninë e tyre me gjërat e krijuara, dhe rregullimin dhe sistemimin e tyre. Me forcë, Ai nënkupton atë, se fuqia e rrotullimit dhe e lëvizjes kurrë nuk ngadalësohet dhe (atë fuqi) kurrë nuk e zë lodhja; dhe ata (qiejt) kurrë nuk rrëzohen si çatitë e tjera dhe ndërtesat e larta. Kësaj i referohen fjalët e Zotit: ***"Qiellin ua bëri kulm të sigurt."*** *[Kur'an 21; 32]*. Me anën e gjithë kësaj, Ai tregon përshtatshmërinë e tyre (të trupave qiellorë) në numër, gjendje, formë, dhe lëvizje, për ekzistencën e atyre që jetojnë në tokë, përreth saj. Nëse një prej trupave qiellorë, të mos flasim për të gjithë, të ndalonte për një moment, gjithçka do të ishte në kaos, mbi faqen e tokës. Disa njerëz besojnë se fryrja e borisë së fundit, që do të jetë shkaku i goditjes ushtuese, nuk do të jetë gjë tjetër, përveçse një ndalim në rrotullimin e trupave qiellorë.

Më pas, Ai na tregon ne, dobinë e diellit për ata që jetojnë në tokë dhe thotë: "Dhe kemi vënë ndriçuesin që flakëron." Ai e emëron atë si një llambë, për shkak se në të vërtetë ajo (toka) është e gjitha në errësirë, dhe drita mbulon errësirën e natës, dhe nëse nuk ekziston llamba,

njeriu nuk mund të ketë përfitim prej shqisës së tij të të parit gjatë natës; dhe në të njëjtën mënyrë, nëse nuk ekziston dielli, kafshët nuk mund të kenë dobi prej shqisës së tyre të të parit. Ai tërheq vëmendjen tonë ndaj këtij avantazhi të diellit, duke mos përfillur të tjerët, për shkak se ai është më madhështori prej të gjithë avantazheve dhe më i dukshmi nga të gjithë. Pastaj, Ai na tregon ne për mirësinë e Tij në dërgimin e shiut, për hir të bimëve dhe kafshëve. Zbritja e shiut, në një proporcion të caktuar dhe në një stinë të caktuar, për fushat e kultivuara, nuk mund të jetë vetëm rastësisht, por është rezultat i përkujdesjes hyjnore për të gjithë ne. Kështu, Ai thotë: ***"Dhe prej reve të shtrydhura kemi lëshuar shi të madh. Që me të të rrisim drithëra e bimë. Edhe kopshte të dendura palë mbi palë."***

Ekzistojnë shumë ajete në Kur'an mbi këtë temë. Për shembull, Ai thotë: ***"A nuk e keni parë se si Allahu krijoi shtatë palë qiej. Dhe në ta hënën e bëri dritë, diellin e bëri ndriçues. Dhe Allahu u shpiku juve prej tokës si bimë."*** *[Kur'an 71; 15-17]*.

Nëse do të duhej t'i numëronim të gjitha ajetet e tilla, dhe t'i komentonim ato, duke treguar mirësitë e Krijuesit për krijesat, kjo do të merrte shumë vëllime. Ne nuk kemi ndërmend të bëjmë këtë, në këtë libër. Nëse Zoti do të na japë jetë dhe kohë të lirë, ne do të shkruajmë një libër për të treguar mirësitë e Zotit, për të cilat ai ka tërhequr vëmendjen tonë.

Duhet të dihet se ky lloj argumenti është krejt i kundërt me atë, me anë të të cilit Asharitët mendojnë të udhëhiqen drejt njohjes së Zotit. Ata mendojnë se krijimi nuk na çon ne drejt njohjes së Zotit, nëpërmjet çfarëdo prej mirësive të Tij, por përmes mundësisë, që është, mundësia e cila gjendet në të gjitha gjërat, të cilat ne mund t'i kuptojmë të jenë të formës së vet apo të një forme plotësisht të kundërt. Por, nëse kjo mundësi gjendet njëlloj në të dyja rastet, atëherë nuk ekziston urtësi në krijimin e universit, dhe nuk gjendet harmoni midis njeriut dhe pjesëve të tij. Mbasi, sikurse mendojnë ata, nëse është e mundur që gjërat të kenë ndonjë formë tjetër, prej asaj të cilën ato kanë tani, atëherë në atë pikë nuk mund të ekzistojë harmoni midis njeriut dhe gjërave të tjera ekzistuese me anën e krijimit, për të cilin Zoti e ka

obliguar njeriun dhe e ka urdhëruar atë, të jetë mirënjohës ndaj Tij. Ky mendim, sipas të cilit krijimi i njeriut, si pjesë e universit, është thjesht si i mundshëm, për shembull, sikurse krijimi i tij në zbrazëtirë, është i njëjtë me mendimin e atyre, të cilët thonë se njeriu ekziston, por ai mund të ishte krijuar në një formë plotësisht tjetër dhe, megjithatë, të mund të kryente veprime të njëjta sikurse njeriu. Sipas tyre, është gjithashtu e mundshme që Ai të mund të kishte formuar pjesë të një universi tjetër, plotësisht të ndryshëm prej atij ekzistuesit. Në këtë rast, bekimi e universit nuk mund të ishte obligim për njeriun, pasi ata nuk janë të nevojshëm për qëllimin e tij. Kështu njeriu është plotësisht mospërfillës ndaj tyre dhe ata ndaj tij. Për këtë arsye ekzistenca e tyre nuk është mirësi ndaj tij. Kjo është plotësisht kundër natyrës së njeriut.

Në përgjithësi, një njeri i cili mohon ekzistencën e pasojave të përshtatura sipas shkaqeve në çështjen e arteve (mjeshtërive), apo zgjuarsia e të cilit nuk mund ta kuptojë atë, atëherë ai nuk ka njohuri të artit të Krijuesit të tij. Për këtë arsye, një njeri i cili, gjithashtu, mohon ekzistencën e rregullit të pasojave në pajtim me shkaqet në këtë univers, mohon ekzistencën e Krijuesit plotësisht. Thënia e tyre se Zoti ekziston sipër këtyre shkaqeve, dhe se ato nuk mund të kenë ndonjë lidhje mbi pasojat sipas urdhrit të Tij, është tepër larg prej natyrës së vërtetë të filozofisë, madje, kjo është shkatërrim i saj. Mbasi, nëse është e mundur që të ketë pasoja të njëjta me të tjera shkaqe, ndryshe nga shkaqet e parashkruara, pikërisht në shkallë të njëjtë sikurse prej tyre, atëherë ku është madhështia në shkaktimin e pasojave prej shkaqeve të njohura? Kjo është kështu sepse pasojat prej shkaqeve kanë një prej tre arsyeve të mëposhtme. Ose ekzistenca e shkaqeve do të jetë në vend të pasojave me detyrim, sikurse marrja nga ana e njeriut të ushqimit të tij; ose të qenit e tyre më perfekt, pra që, pasoja bëhet më e mirë dhe më e përsosur përmes tyre, sikurse të pasurit nga ana e njeriut të dy syve; ose ato mund të mos kenë as pasojë më të mirë, e as pasojë më shumë detyruese. Në këtë rast ekzistenca e pasojës dhe e shkakut do të jetë rastësisht, krejt pa ndonjë qëllim; dhe kështu, nuk do të ekzistonte madhështi në të.

Për shembull, nëse forma e dorës së njeriut, numri i gishtave, dhe gjatësia e tyre nuk është as e domosdoshme, as plotëson ndonjë përkryerje në punën e saj në të kapurit (shfrytëzuarit) e gjërave të llojeve të ndryshme, atëherë veprimet e dorës prej kësaj forme, dhe numri i pjesëve, duhet të jenë vetëm rastësisht. Nëse kjo është kështu, atëherë kjo nuk bën dallim nëse njeriut i është dhënë një dorë apo një thundër, apo diçka tjetër, ashtu si kafshët e ndryshme, për veprimet e tyre të veçanta. Në përgjithësi, nëse ne injorojmë shkaqet dhe pasojat e tyre, atëherë në këtë çështje nuk mbetet asgjë për të përgënjeshtruar argumentet e atyre, të cilët besojnë në krijimin e universit vetëm rastësisht, pra, të atyre të cilët thonë se nuk ekziston fare Krijues dhe ajo që ka ardhur në ekzistencë në këtë univers është pasojë e shkaqeve materiale. Sepse, duke marrë një prej dy alternativave, nuk është më tepër e mundshme që ajo të mund të ketë ndodhur rastësisht, sesa të jetë përfunduar prej një Aktori të pavarur. Kështu, kur Asharitët thonë se ekzistenca e një, apo më tepër mundësive tregon se ekziston një Bërës e veçantë i këtyre gjërave, ata mund të përgjigjen dhe thonë se ekzistenca e gjërave me anën e një prej këtyre mundësive ishte vetëm rastësisht, mbasi qëllimi punon sikurse një prej shkaqeve, dhe ajo e cila ndodh pa ndonjë mënyrë (mjet) apo shkak është rastësisht. Ne shohim se shumë gjëra vijnë në ekzistencë në këtë mënyrë. Për shembull, elementet kombinohen së bashku rastësisht, dhe atëherë, me anën e kësaj përzierje të paqëllimshme, paraqitet një gjë e re. Ato kombinohen përsëri dhe kjo paraqet një gjë plotësisht të re, në mënyrë plotësisht të paparamenduar. Në këtë mënyrë, çdo lloj i krijimit, mund të thuhet se ka ardhur në ekzistencë rastësisht. Ne themi se është e domosdoshme se, atje, gjendet një rregull dhe organizim, shumë më perfekt dhe më i përfunduar sesa ai, që ne mund ta imagjinojmë. Ky kombinim i elementeve së bashku është i kufizuar dhe i parapërgatitur dhe gjërat e shkaktuara prej tyre janë pa dyshim (të sigurta) që të ndodhin, dhe kurrfarë pështjellimi nuk ka ndodhur ndonjëherë në ta. Por, e gjithë kjo nuk mund të ndodhë vetëm rastësisht, mbasi ajo, e cila ndodh në këtë mënyrë, pra rastësisht, është e një vlere të një shkalle të ulët. Kjo është ajo, së cilës Zoti i referohet në Kur'an: ***"Mjeshtëri e Allahut që***

përsosi çdo send." *[Kur'an 27; 88]*. Unë do të dëshiroja të dija se çfarë përmbushje mund të gjendet në gjërat e bërë rastësisht, mbasi gjëra të tilla nuk janë kurrsesi më të mira sesa të kundërtat e tyre. Kësaj, Zoti, i referohet me fjalët që vijojnë: ***"Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj, drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?"*** *[Kur'an 67; 3]*. Por çfarë mungese (defekti) mund të jetë më e madhe sesa që, të gjitha gjërat mund të gjenden me çfarëdo cilësie tjetër, se sa (nga ato cilësi që) ato realisht zotërojnë. Mbasi një cilësi joekzistuese mund të jetë më e mirë sesa ajo që ekziston. Në këtë mënyrë, nëse ndokush mendon se duhej lëvizja lindore që të bëhej perëndimorja dhe anasjelltas, dhe nuk do të ekzistonte ndryshim në univers, atëherë ai e ka shkatërruar filozofinë plotësisht. Ai është si një njeri, i cili mendon se duhej ana e djathtë e kafshëve për t'u bërë e majta dhe anasjelltas, dhe nuk do të kishte ndryshim fare, mbasi një prej këtyre dy alternativave është atje. Sepse, sikurse është e mundshme për të thënë se kjo është bërë sipas një alternative, prej një Krijuesi të pavarur, kështu është e mundur të pohosh se ajo u bë e gjitha vetëm rastësisht. Mbasi, ne shohim aq shumë gjëra, që vijnë në ekzistencë prej vetvetes.

Është plotësisht e qartë për ju se, të gjithë njerëzit shohin se llojet më të ulëta të krijimit mundej të ishin bërë në një formë të ndryshme, prej asaj në të cilën ato realisht janë, dhe ndërsa ata shohin këtë shkallë më të ulët në shumë gjëra, ata mendojnë se ato duhet të jenë bërë rastësisht. Por, në krijimin më të lartë, ata e dinë se ai (krijimi) është i pamundur për të qenë i bërë në një formë më perfekte dhe më të përsosur sesa ajo (formë) që i është dhënë atij prej Krijuesit. Kështu, ky mendim, i cili është një prej mendimeve të Mutekelitëve është edhe kundër Ligjit dhe edhe kundër filozofisë. Ajo që ne mund të themi është se, mendimi i mundësisë në krijim është më afër një mohimi komplet të Zotit, sesa (një mendim) që na çon neve më afër Tij. Në të njëjtën kohë, kjo shtrembëron (falsifikon) filozofinë. Sepse nëse ne nuk kuptojmë se ekziston një mes midis fillimeve dhe fundeve të Krijimit, mbi të cilin bazohen fundet e gjërave, atëherë nuk mund të ekzistojë as ndonjë urdhër, e as ndonjë metodë në të. Dhe nëse ata janë

duke kërkuar (dëshiruar), atëherë nuk mund të ekzistojë argumenti i ekzistencës së një Krijuesi inteligjent dhe të ditur; mbasi duke i marrë ato së bashku me shkakun dhe pasojën, ne drejtohemi drejt faktit se ato duhet të kenë qenë krijuar prej urtësisë dhe diturisë.

Por, nga ana tjetër, ekzistenca e cilësdo prej dy mundësive tregon se ato mund të jenë kryer prej një Bërësi të paditur dhe vetëm rastësisht. Pikërisht sikurse një gur, që duke rënë në tokë mund të bjerë në ndonjë vend, në ndonjë anë, apo në ndonjë formë. Kjo do të tregojë mungesën e ekzistimit fare të një krijuesi, ose së paku të një Krijuesi të mençur dhe të ditur. Gjëja që i ka detyruar Mutekilitët me Asharitët për të pranuar këtë mendim është mohimi i veprimtarisë të këtyre forcave natyrore, të cilat Zoti i ka vendosur në të gjitha gjërat, pasi Ai i ka pajisur ato me jetë, fuqi e të tjera. Ata i shmangen mendimit se ekziston ndonjë krijues tjetër përveç Zotit, dhe Zoti nuk lejon që të ekzistojë ndonjë tjetër, pasi Ai është krijuesi i vetëm i shkaqeve dhe ata janë bërë efektivë vetëm prej komandës së Tij. Ne do të flasim për këtë me hollësi, kur të bisedojmë mbi Caktimin dhe Paracaktimin. Ata, gjithashtu, frikësohen se me anën e pranimit të shkaqeve natyrore, ata mund të akuzoheshin prej thënieve (nga ana e tyre) se universi erdhi në ekzistence vetëm rastësisht. Ata do ta kenë ditur se një mohim i saj, do të thotë mohim i një pjesë të madhe të argumenteve, të cilat mund të paraqiten për dëshminë e ekzistimin e Zotit. Çdokush që mohon një pjesë të krijimit të Zotit mohon punën (veprën) e Tij, e cila shkon shumë afër mohimit të një pjese të atributeve të Tij.

Në përgjithësi, pasi mendimi i tyre bazohet mbi konkluzione të shpejtuara, të cilat vijnë në mendjen e njeriut prej të gjykuarit të përciptë dhe pasi dukshmërisht duket se fjala "qëllim" mund të përdoret ndaj ndokujt, i cili ka fuqi për të bërë keq apo ndryshe, ata e kuptojnë se nëse nuk pranojnë që i gjithë krijimi është i mundshëm, ata nuk do të jenë në gjendje të thonë se ai erdhi në ekzistencë me anën e veprimit të një krijuesi të nënkuptuar. Kështu ata thonë se i gjithë krijimi është i mundshëm, që ata të mund të vërtetojnë kështu se krijuesi është një krijues inteligjent. Ata nuk e marrin parasysh kurrë rendin (urdhrin), i cili është i domosdoshëm në bërjen e gjërave, dhe me këtë

ardhjen e tyre prej një krijuesi inteligjent. Këta njerëz gjithashtu kanë injoruar fajin që ata do të duhej të mbanin, në këtë mënyrë, duke mohuar urtësinë e krijuesit, apo duke pohuar se rastësia gjendet duke drejtuar krijimin. Ata e dinë, sikurse ne e kemi thënë, se është e domosdoshme, për shkak të rregullit ekzistues në natyrë, që ajo duhet të jetë sjellë në ekzistencë me anën e një krijuesi disi të ditur, përndryshe rregulli i gjendur në të, do të ishte rastësisht. Kur ata detyrohen për të mohuar forcat natyrore, ata duhet të mohojnë me to një numër të madh të atyre forcave, të cilat Zoti i ka bërë të nënshtruara ndaj komandës së Tij, për krijimin dhe ruajtjen e gjërave. Mbasi, Zoti i ka krijuar disa gjëra prej shkaqeve, të cilat Ai i ka shkaktuar nga jashtë, ata janë trupat qiellorë; ekzistojnë gjëra të tjera, të cilat Ai i ka bërë prej shkaqeve të vendosura në vetë gjërat; që është shpirti dhe forcat e tjera natyrore, me anën e të cilave ai i mban këto gjëra. Prandaj, sa i pandershëm është njeriu, i cili e shkatërron filozofinë dhe: ***"Shpif gënjeshtra kundër Allahut."*** *[Kur'an 3; 94]*.

Kjo është vetëm një pjesë e ndryshimit që ka ndodhur në Ligj, në këtë dhe drejtime të tjera, të cilat ne tashmë i kemi përmendur dhe do t'i përmendim në të ardhmen. Prej gjithë kësaj, duhet të jetë bërë e qartë për ju se, metoda të cilën Zoti e ka miratuar për t'iu mësuar krijesave të Tij se universi është bërë dhe krijuar prej Tij, është metoda e mirësisë dhe urtësisë, kundrejt të gjitha krijesave të Tij, dhe veçanërisht kundrejt njeriut. Kjo është një metodë e cila bart të njëjtin relacion ndaj intelektit tonë, sikurse dielli bart ndaj shqisave tona. Metoda, të cilën ai ka adoptuar kundrejt njerëzve të thjeshtë rreth këtij problemi, është ajo e ilustrimit prej gjërave të vrojtuara. Por, ndërsa nuk ekziston asgjë, e cila do të mund të jepej si ilustrim dhe derisa njerëzit e zakonshëm nuk mund ta kuptojnë një gjë, ilustrimin e së cilës ata nuk mund ta shohin, Zoti na tregon se universi u krijua në një kohë të caktuar, prej një gjëje të caktuar, të cilën e bëri Ai. Ai na tregon gjendjen e Tij, përpara krijimit të universit: ***"E Arshi i Tij kishte qenë mbi ujë."*** *[Kur'an 11; 7]*. Ai, gjithashtu, thotë: ***"Vërtet Zoti juaj, Allahu është Ai që krijoi qiejt e tokën, brenda gjashtë ditësh."*** *[Kur'an 7; 54],* dhe: ***"Mandej e mësyu qiellin e ai ishte tym."*** *[Kur'an 41; 11]*.

Përveç këtyre, ekzistojnë ajete të tjera të Librit, që kanë lidhje me këtë temë. Prandaj është detyrë që asgjë prej tyre, nuk duhet t'u shpjegohet njerëzve të thjeshtë, dhe asgjë nuk duhet t'u paraqitet atyre në të shpjeguarit e tij, përveç këtij ilustrimi. Mbasi çdokush, që e ndryshon atë, e bën diturinë e Ligjit të pavlefshme. Nëse thuhet se Ligji na mëson se universi është i krijuar, dhe i bërë prej asgjëje dhe në kurrfarë kohe, atëherë kjo është një gjë, të cilën madje dhe i shkolluari nuk mund ta kuptojë, e të mos flasim për njerëzit e zakonshëm. Prandaj, ne nuk duhet të devijojmë në këtë çështje të Ligjit…

***

Problemi i Dytë: Shfaqja e Pejgamberëve

Nëse ne e pranojmë ekzistencën e misionit profetik, duke shprehur idenë e mundësisë, - e cila është në fakt injorancë, - në vend të sigurisë, dhe i bëjmë mrekullitë dëshmi të vërtetësisë së një njeriu, i cili pretendon të jetë profet, kjo e bën të domosdoshme që ato nuk duhet të sillen prej një personi, i cili thotë se ato mund të kryhen prej të tjerëve, sesa nga ana e profetëve, sikurse thonë Mutekelitët. Ata mendojnë se mrekullitë mund të kryhen prej magjistarëve dhe shenjtorëve. Kushti me të cilin ata i sulmojnë ato është se mrekullitë vërtetojnë se një njeri është profet, kur ai në të njëjtën kohë pretendon të jetë ashtu, pasi pejgamberi i vërtetë mund t'i kryejë ato si kundërvënie ndaj atyre fals. Ky është një argument pa ndonjë vërtetim, mbasi ky mund të kuptohet edhe me anën e gjykimit edhe me anën e arsyes. Thuhet se çdokush, pretendimet e të cilit për profeci janë të pasakta, nuk mund të kryejë mrekulli, por sikurse ne tashmë e kemi thënë, në kohën kur ato nuk mund të kryhen prej një gënjeshtari, atëherë ato mund të jenë bërë vetëm prej njerëzve të mirë, të cilët Zoti i ka pasur parasysh për këtë qëllim. Këta njerëz, nëse thonë një gënjeshtër, ata nuk janë të mirë, dhe kështu nuk mund të kryejnë mrekulli. Por, kjo nuk i kënaq njerëzit, të cilët mendojnë se mrekullitë janë të mundshme për t'u kryer prej magjistarëve, mbasi ata, pa dyshim, nuk janë njerëz të mirë. Këtu që-

ndron dobësia e argumentit. Kështu, disa njerëz, kanë menduar se gjëja më e mirë është të besosh se ato nuk mund të kryhen, veçse prej pejgamberëve.

Është e qartë për ju, nga jeta e profetit, paqja qoftë mbi të, se ai kurrë nuk i ka kërkuar ndonjë njeriu apo komuniteti, të besojë në profecinë e tij, dhe atë të cilën ai e ka sjellë me vete prej Zotit, me anën e kryerjes së çfarëdo mrekullie në mbështetje të pohimit të tij, të tillë si të ndryshuarit e ndonjë elementi në një tjetër. Sidoqoftë, mrekullitë e shfaqura prej tij, ishin të kryera vetëm në zhvillimin natyror të gjërave, pa ndonjë qëllim, nga anë e tij të pretendimit apo konkurrencës. Fjalët e mëposhtme të Kur'anit do të na i bëjnë këtë më të qartë: ***"Ata thanë: "Nuk të besojmë ty, derisa të na nxjerrësh prej tokës burime. Ose, të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh të rrjedhin vazhdimisht lumenj në mesin e tyre. Ose të bjerë mbi ne qielli copa-copa, ashtu si po mendon ti, apo të na sjellësh Allahun dhe engjëjt pranë nesh. Ose të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitesh lart në qiell, po ne nuk të besojmë për ngjitjen tënde, derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë?!" Thuaj: "Subhanallah – i Madhërishëm është Zoti im, a mos jam unë tjetër vetëm se njeri, pejgamber?"*** *[Kur'an 17; 90-93]*

Pastaj, përsëri: ***"Neve nuk na pengoi asgjë, që t'u sjellim argumente, pos asaj se ata, të parët, i përgënjeshtruan ato."*** *[Kur'an 17; 59]*

Gjëja me të cilën ne i ftojmë njerëzit të besojnë atë (pejgamberin), dhe me të cilën ai konkurroi me ta, është Kur'ani. Mbasi, Zoti thotë: ***"Thuaj: "Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund të bënin si ky, sado që do ta ndihmonin njëri-tjetrin."*** *[Kur'an 17; 88]*. Pastaj, më tutje, Ai thotë: ***"Apo, pse ata thonë: 'Ai** (Muhammedi) **e trilloi atë'. Thuaj: 'Formuloni pra, dhjetë kaptina si ai** (Kur'ani) **ashtu të trilluara'."*** *[Kur'an 11; 13]*. Rasti i mrekullisë së Pejgamberit, me të cilin ai konkurroi me njerëzit dhe të cilën ai e paraqiti si një argument për vërtetësinë e pohimit të tij të misionit profetik, ishte Kur'ani. Nëse thuhet se kjo është plotësisht e qartë, në ç'mënyrë u duk se Kur'ani është një

mrekulli (mirazh), dhe se ai provon profecinë e tij, ndërkohë që, pikërisht, tani ne kemi provuar dobësinë e vërtetësisë së profecisë nëpërmjet mrekullive, pa çfarëdo përjashtimesh, në rastin e çfarëdo pejgamberi. Përveç kësaj, njerëzit kanë mendime të ndryshme në të marrit apo jo të Kur'anit si mrekulli. Mbasi, sipas mendimit të tyre, një prej kushteve të mrekullisë është se ajo duhet të jetë plotësisht e ndryshme prej çfarëdo akti, i cili mund të jetë bërë i zakonshëm. Por, Kur'ani është i këtij lloji, sepse ai është vetëm fjalë, megjithëse ai ua kapërcen të gjitha fjalëve të krijuara. Për këtë arsye, ai u bë mrekulli vetëm me anën superioritetin e vet, që është, pamundësia e njerëzve për të sjellë diçka të ngjashme me të, për shkak të të qenit të tij me elokuencë të lartë. Ky rast, dallon prej të zakonshmit, jo në gjini, por vetëm në detaje, dhe ai i cili dallon në këtë aspekt është i llojit të njëjtë.

Disa njerëz thonë se ai është mrekulli vetvetiu dhe jo prej superioritetit së tij. Ata nuk e vendosin si kusht për mrekullitë, që ato duhet të jenë plotësisht të ndryshme prej të zakonshmes, por mendojnë se ajo duhet të jetë një veprim i tillë i zakonshëm, megjithëse njerëzit nuk mund të arrijnë ta përmbushin. Ne do t'i përgjigjemi se kjo është sikurse shprehen objektorët, por çështja rreth kësaj nuk është sikurse ata kanë menduar. Që Kur'ani është dëshmi e profecisë se tij, bazohet, - besojmë ne, - mbi dy parime, të cilat gjenden në vetë librin. E para është se ekzistenca e grupit të njerëzve të quajtur profetë dhe apostuj, është e mirënjohur. Ata janë njerëzit, të cilët vendosën ligje për njerëzit prej relevatës hyjnore dhe jo prej edukatës njerëzore. Ekzistenca e tyre mund të mohohet vetëm prej njerëzve, të cilët mohojnë veprimtarinë e vazhdueshme (e përsëritur), sikurse ekzistencën e të gjitha gjërave, të cilat ne nuk i kemi parë – jetët e mendimtarëve të famshëm dhe të tjera. Të gjithë filozofët dhe njerëzit e tjerë, me përjashtim të atyre të cilët nuk i kushtojnë vëmendje fjalëve të tyre, (dhe ata janë materialistët), janë të një mendjeje, se ekzistojnë njerëz, të cilëve u janë reveluar shumë urdhëresa për njerëzit, për të kryer vepra të caktuara të mira, me anën e të cilave sjelljet e tyre mund të përsoseshin; dhe

për t'i bërë ata, të hiqnin dorë prej besimeve të caktuara të gabuara dhe veprimeve të mbrapshta. Kjo është detyra e apostujve hyjnorë.

Parimi i dytë është, se çdokush që e bën këtë punë, pra që, dikton ligje prej revelimit, është pejgamber. Ky parim, gjithashtu, është plotësisht në përputhje me natyrën njerëzore. Sepse, sikurse dihet se, detyra e mjekësisë është të mjekojë një sëmundje, dhe ai i cili mund të kurojë është një mjek, ashtu, gjithashtu, dihet se detyra e profetëve është t'u japin ligje njerëzve, prej shpalljes hyjnore, dhe ai që vepron kështu është pejgamber. Libri e përmend parimin e parë, si vijon: ***"Ne të frymëzuam ty me shpallje, sikurse e patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismailin, Is-hakun, Jakubin, dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, e Davudit i patëm dhënë Zeburin. Dhe*** *(dërguam)* ***të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të dërguar të tjerë, për të cilët nuk të rrëfyem, e Musait i foli Allahu me fjalë."*** *[Kur'an 4; 163-164]*. Dhe përsëri: ***"Thuaj: 'Unë nuk jam risimtar prej të dërguarve'."*** *[Kur'an 46; 9]*

Parimi i dytë është se Muhamedi, paqja qoftë mbi të, ka kryer punën e pejgamberit, pra, u ka dhënë njerëzve Ligjin prej shpalljes hyjnore. Kjo, gjithashtu, mund të dihet prej Kur'anit, ku Zoti e përmend atë. Ai thotë: ***"O ju njerëz, juve ju erdhi nga Zoti juaj argument dhe Ne ju zbritëm dritë të qartë."*** *[Kur'an 4; 174]*. Me "dritë të qartë" nënkuptohet Kur'ani. Përsëri, Ai thotë: ***"O ju njerëz, juve u erdhi i dërguari me të vërtetën nga Zoti juaj, pra t'i besoni se është më e dobishme për ju."*** *[Kur'ani 4; 170],* dhe përsëri: ***"Por ata, prej tyre që kanë thesar të diturisë, dhe besimtarët, besojnë atë që t'u shpall ty dhe atë që u shpall para teje."*** *[Kur'an 4; 162];* dhe përsëri: ***"Por Allahu dëshmon për atë që t'u zbrit ty, atë ta zbriti sipas dijes së Vet, edhe engjëjt dëshmojnë, po mjaft është All-llahu dëshmues."*** *[Kur'an 4; 166]*.

***

Problemi i Tretë: Caktimi dhe Paracaktimi

Ky është njëri nga problemet më të ndërlikuara të fesë. Mbasi nëse ju shqyrtoni përmbledhjet tradicionale (Hadithin) rreth këtij problemi, ju do t'i gjeni ato kontradiktore; i tillë gjithashtu është rasti me argumentet e arsyes. Kontradikta në argumentet e llojit të parë gjendet në Kur'an dhe Hadith. Ekzistojnë shumë ajete të Kur'anit, të cilat me natyrën e tyre universale mësojnë se të gjitha gjërat janë të paracaktuara dhe se njeriu është i detyruar për të bërë veprimet e tij; ndërkohë ekzistojnë ajete të tjera të cilat thonë se njeriu është i lirë në veprimet e tij dhe nuk është i detyruar për t'i kryer ato. Ajetet e mëposhtme na tregojnë se, të gjitha gjërat janë me detyrim dhe janë të paracaktuara. ***"Ne çdo send e kemi krijuar me masë të caktuar"*** *[Kur'an 54; 49],* përsëri: ***"Tek Ai çdo send është me masë të caktuar."*** *[Kur'an 13; 8]*. Më tutje, Ai thotë: ***"Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime*** *(libër- Lehvi Mahfudh)* ***para se të ndodhë ajo, e kjo për Allahun është lehtë."*** *[Kur'an 57; 22]*. Mund të përmenden shumë ajete të tjera mbi këtë temë.

Tani, për sa u përket ajeteve, të cilat thonë se njeriu mund t'i marrë veprimet me vullnet të lirë, dhe se gjërat janë vetëm të mundshme dhe jo të domosdoshme (pashmangshme), mund të citohet ajeti i mëposhtëm: ***"Ose i përmbyt ata për shkak të asaj që vepruan, e për shumë të tjera Ai i fal."*** *[Kur'an 42; 34]*. Dhe përsëri: ***"Çfarëdo e keqe që mund t'iu godasë ajo është pasojë e veprave tuaja…"*** *[Kur'an 42; 30]*. Më tej, Ai thotë: ***"E, ata që bënë të këqija, dënimi i së keqes është sa është ajo…"*** *[Kur'an 10; 27]*. Përsëri, Ai thotë: ***"Atij*** *(njeriut)* ***i takon ajo që e fitoi dhe atij i bie ajo*** *(e keqe)* ***që e meritoi."*** *[Kur'an 2; 286]*. Dhe: ***"Sa i përket Themudit. Ne atyre u patëm treguar rrugën e drejtë, por ata megjithatë më shumë e deshën verbërinë…"*** *[Kur'an 41; 17]*.

Ndonjëherë, kontradikta shfaqet madje në një ajet të vetëm të Kur'anit. Për shembull, Ai thotë: ***"E kur juve u goditi një dështim*** *(në Uhud)* ***e që ju ia patët dhënë atë dyfish*** *(armikut në Bedër),* ***thatë:***

"Prej nga kjo?" Thuaj: "Ajo është nga vetë ju!" S'ka dyshim se Allahu është i plotfuqishëm për çdo send. *[Kur'an 3; 165]*. Në një ajet tjetër, Ai thotë: ***"Ajo që ju goditi juve ditën e ballafaqimit të dy grupeve, ishte me lejen e Allahut."*** *[Kur'an 3; 166]*. I këtij lloji është gjithashtu ajeti: ***"Çfarëdo e mire që të vijë, është nga Allahu, e çka të ndodh ndonjë e keqe është nga vetë ti."*** *[Kur'an 4; 79],* kurse ajeti i mësipërm thotë: ***"Të gjitha janë nga Allahu"*** *[Kur'an 4; 78]*.

I tillë është gjithashtu rasti edhe me hadithin. Profeti thotë: *"Çdo fëmijë lindet në fenë e vërtetë; prindërit e tij më pas e kthejnë atë në një çifut apo në një të krishterë". Në një rast tjetër, ai thotë: "Njerëzit që janë krijuar për në ferr bëjnë vepra të atyre, të cilat janë të përshtatshme për të. Ata që janë krijuar për në qiell, bëjnë vepra të përshtatshme për të."* Hadithi i parë thotë se shkaku i mosbesimit është mjedisi i vetë njeriut; kurse feja dhe besimi janë natyrore te njeriu. Hadithi tjetër thotë se pandershmëria dhe mosbesimi janë krijuar prej Zotit, dhe njeriu është i detyruar t'i pasojë ato.

Kjo gjendje e gjërave i ka çuar myslimanët drejt ndarjes në dy grupe. Njëri grup beson se pandershmëria apo virtyti është fitim i atij vetë, dhe se në pajtim me to, ai ose do të ndëshkohet ose do të shpërblehet. Këta janë Mutezilitët. Besimi (bindja) i grupit tjetër është plotësisht i kundërt me këtë. Ata thonë se njeriu është i detyruar për t'i bërë veprat e tij. Këta janë Xhabaritët. Asharitët janë orvatur për të adoptuar një mesatare midis këtyre dy pikëpamjeve ekstreme. Ata thonë se njeriu mund të veprojë, veçse veprimet e bëra dhe mundësia për t'i bërë ato, janë të dyja të krijuara nga Zoti. Por, kjo është plotësisht e pakuptimtë. Mbasi nëse vepra dhe mundësia e bërjes së saj, janë të dyja të krijuara prej Zotit, atëherë njeriu është i detyruar për ta bërë veprimin në mënyrë të domosdoshme. Kjo është një prej arsyeve të mosmarrëveshjes të mendimit, rreth këtij problemi.

Sikurse ne e kemi thënë ekziston një shkak tjetër i ndryshimit të mendimit rreth këtij problemi, sesa ai tradicional. Kjo përbëhet nga argumentet kontradiktore të paraqitura. Mbasi nëse ne themi se njeriu është krijues i vetë veprave të tij, do të duhet të jetë e domosdoshme të pranosh se ekzistojnë gjëra, të cilat nuk janë bërë në pajtim me vu-

llnetin e Zotit, apo autoritetit të Tij. Kështu do të ekzistojë një krijues tjetër, përveç Zotit, ndërsa myslimanët pajtohen në mendimin se nuk ekziston krijues përveç Atij. Nëse, nga njëra anë, ne duhet të supozojmë se njeriu nuk mund të veprojë lirisht, ne pranojmë kështu se ai është i detyruar për të bërë veprime të caktuara, mbasi nuk ekziston mesi midis detyrimit dhe lirisë. Nga ana tjetër, nëse njeriu është i detyruar për të bërë vepra të caktuara, atëherë mbi të është ngarkuar një detyrë, të cilën ai nuk mund ta mbartë; dhe kur ai është bërë për të mbartur një barrë, nuk ekziston ndonjë ndryshim midis punës së tij dhe punës së materieve inorganike. Mbasi (sikurse) lëndët inorganike nuk kanë mundësi, as njeriu nuk ka mundësi për atë, të cilën ai nuk mund ta mbartë. Kështu të gjithë njerëzit kanë aftësinë e një prej kushteve për imponimin e një detyre, të tillë si dituria. Ne gjejmë Abdul Maali, duke thënë në Nizamiyyah-in e tij, se njeriu është i lirë në veprimet e tij të veta, dhe ka aftësinë e bërjes së tyre. Ai e ka vendosur atë mbi pamundësinë e ngarkimit të një detyre, të cilën ai nuk mund ta mbartë, me qëllim që të shmangë parimin që më parë u hodh poshtë prej Mutezilitëve, për shkak të të qenit të tij i papërshtatshëm për arsyen. Pasuesit e Asharitëve i kanë kundërshtuar ata. Përveç kësaj, nëse njeriu nuk ka mundësi në bërjen e një vepre, atëherë do të jetë vetëm rastësi që ai të mund t'i largohet prej mëkatit, dhe kjo është e pakuptimtë. I tillë, gjithashtu, do të jetë edhe rasti me mirësinë e fituar. Në këtë mënyrë, të gjitha këto arte (mjeshtëri), të cilat na çojnë drejt lumturisë, si bujqësia etj., do të bëhen të pavlefshme. Kështu do të bëheshin, gjithashtu, të padobishme të gjitha ato mjeshtëri, qëllimi i të cilave është mbrojtja dhe shtytja e rrezikut, sikurse shkencat e luftës, lundrimit, mjekësisë etj. Një kusht i tillë është plotësisht i kundërt ndaj gjithçkaje që është e kapshme për njeriun.

Tani mund të pyetet se, nëse rasti është kështu, çfarë është kjo kontradiktë që gjendet edhe në hadith, edhe në arsye; për t'u pajtuar ne do të themi, se dukshmërisht, qëllimi i fesë në këtë problem, nuk është për ta ndarë atë në dy bindje të mëvetësishme, por për t'i pajtuar ato me anën e një kursi të mesëm, e cila është metoda e drejtë. Është e qartë se Zoti ka krijuar tek ne fuqinë me të cilën ne mund të kryejmë ve-

pra, të cilat janë kontradiktore në natyrën e tyre. Por, pasi kjo nuk mund të jetë e përfunduar përveçse me anën e shkakut, të cilin Zoti ka pajisur për ne, prej nga jashtë, dhe largimi i vështirësive prej tyre, veprat e bëra kryhen vetëm prej bashkimit të këtyre dy gjërave në të njëjtën kohë. Duke qenë kështu, veprat e ngarkuara për t'u bërë (përdorur), janë bërë sipas qëllimit tonë dhe sipas përshtatshmërisë së shkaqeve, të cilat emërohen Paracaktimi i Zotit, të cilat Ai i ka furnizuar për ne, prej jashtë. Ato, as i përfundojnë punët të cilat ne kemi ndërmend, as i pengojnë ato, por natyrisht bëhen shkak i të synuarit tonë të tyre – një prej dy gjërave. Mbasi qëllimi paraqitet te ne prej imagjinatës sonë, ose mbasi argumentimi e një çështjeje, e cila në vetvete nuk është në mundësinë tonë, por vjen në ekzistencë prej shkaqeve jashtë nesh. Për shembull, nëse ne e shohim një gjë të mirë, ne e pëlqejmë atë, pa qëllim, dhe lëvizim drejt saj për të përftuar atë. Kështu, gjithashtu, nëse ndodh të vijë një gjë, e cila është më mirë për t'iu shmangur, ne e lemë atë pa qëllim. Kështu, qëllimet tona lidhen dhe bashkohen kundrejt shkaqeve që ndodhen jashtë vetes sonë.

Kësaj i referohen fjalët e mëposhtme të Zotit: ***"Ai** (njeri) **ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhrin e Allahut e ruajnë atë."** [Kur'an 13; 11]*. Mbasi këto shkaqe marrin nga jashtë këtë drejtim sipas renditjes dhe rregullimit të mirë-përcaktuar dhe kurrë nuk shkojnë në rrugë të shtrembër prej rrugës, të cilin Krijuesi i tyre ka caktuar për ta, dhe vetë synimet tona as nuk mund të detyrohen, as gjithmonë të gjenden, në tërësi, përveçse prej përshtatshmërisë së tyre, kështu është e domosdoshme që veprimet për më tepër duhet të jenë gjithashtu brenda kufijve të mirë-përcaktuar, pra, ata të gjenden në një periudhë të dhënë kohe dhe në një sasi të dhënë. Kjo është e domosdoshme, sepse veprat tona janë pasoja të shkaqeve, që qëndrojnë jashtë nesh; dhe të gjitha pasojat, të cilat rezultojnë prej shkaqeve të kufizuara dhe të parapërgatitura, janë vetë të kufizuara, dhe gjenden vetëm në një sasi të dhënë. Ky relacion nuk ekziston vetëm midis veprimeve tona dhe shkaqeve të jashtme, por gjithashtu midis atyre dhe shkaqeve të cilat Zoti i ka krijuar në trupat tanë, dhe rregullit të mirë-përcaktuar që ekziston midis shkaqeve të brendshme dhe të jashtme.

Kjo është ajo çfarë nënkuptohet me Caktimin dhe Paracaktimin, i cili gjendet i përmendur në Kur'an dhe është detyrë mbi njeriun. Kjo është gjithashtu ***"Pllaka Ruajtëse"** [Kur'an 85; 22]*. Njohja nga ana e Zotit të këtyre shkaqeve, dhe e asaj që lidhet me to, është shkaku i ekzistencës së tyre. Prandaj, askush nuk mund të ketë një njohje të plotë të këtyre gjërave, përveç Zotit, dhe kështu, Ai është Njohësi i Vetëm i sekreteve, gjë që është plotësisht e vërtetë, pasi Zoti ka thënë: ***"Thuaj: 'Askush, veç Allahut, as në qiej, as në tokë, nuk e di të fshehtën'"** [Kur'an 27; 65]*.

Njohja e shkaqeve është njohja e gjërave sekrete, sepse sekreti është njohja e ekzistencës së një gjëje, përpara se ajo të vijë në ekzistencë, dhe derisa parapërgatitja dhe rendi i shkaqeve sjell apo jo një gjë në ekzistencë, në një kohë të caktuar, duhet të ekzistojë njohja e ekzistencës apo mosekzistimit të një gjëje, në një kohë të caktuar. Njohja e shkaqeve në tërësi është njohje e atyre gjërave, që gjenden apo nuk gjenden në një moment të caktuar të kohës. I lavdëruar qoftë Ai, i cili ka njohje të plotë të krijimit dhe të të gjithë shkaqeve të tij. Kjo është ajo çfarë nënkuptohet me "çelësat e sekretit", në fjalët e Zotit që pasojnë: ***"Çelësat e fshehtësisë janë vetëm te Ai, atë nuk e di kush pos Tij."** [Kur'an 6; 59]*.

Duke qenë se gjithçka që ne kemi thënë është e vërtetë, duhet të jetë bërë e qartë se në ç'mënyrë ne mund t'i përftojmë veprat tona dhe sa shumë ato drejtohen prej paracaktimit dhe caktimit. Pikërisht ky pajtim është qëllimi real i religjionit me anën e këtyre ajeteve dhe hadithit, të cilat në dukje janë kontradiktore. Kur natyra e tyre universale kufizohet në këtë mënyrë, këto kontradikta do të të shuhen prej vetvetes dhe të gjitha dyshimet, të cilat ishin ngritur përpara, rreth natyrës kontradiktore të arsyes, do të zhduken. Gjërat ekzistuese prej vullnetit tonë kryhen me anën e dy gjërave, qëllimit tonë dhe shkaqeve të tjera. Por, kur veprat i atribuohen vetëm njërit prej këtyre mjeteve, dyshimet do të ngrenë krye. Kjo ndoshta thuhet është një përgjigje e mirë, dhe këtu arsyeja është në pajtim të plotë me religjionin, por ajo bazohet mbi parimet se këto përputhen se ekzistojnë shkaqe krijuese që sjellin në ekzistencë gjëra të tjera; ndërkohë që myslimanët paj-

tohen se nuk ekziston Krijues, përveç Zotit. Ne themi se në çdo gjë që ata pajtohen është plotësisht e saktë, por kundërshtimi mund të zgjidhet në dy mënyra. Një prej tyre është se vetë ky kundërshtim mund të kuptohet në dy mënyra; një prej tyre është se nuk ekziston Krijues tjetër përveç Zotit, dhe të gjitha këto shkaqe të cilat Ai i ka krijuar, nuk mund të quhen krijuese, përveçse duke folur figurativisht.

Ekzistimi i tyre gjithashtu varet prej Tij. Vetëm Ai i ka bërë ato që të jenë shkaqe, dhe vetëm Ai ruan ekzistimin e tyre si faktorë krijues dhe mbron pasojat e tyre pas veprimeve të tyre. Ai, nga ana tjetër, paraqet esencat e tyre në momentin kur shkaqet bëhen së bashku. Vetëm Ai i ruan ato si një tërësi. Po të mos kishte qenë mbrojtja hyjnore, ato nuk do të mund të kishin ekzistuar as për, të paktën, një moment të kohës. Ebu Hamid (El-Ghazzali) ka thënë se një njeri, i cili e bën ndonjë prej shkaqeve të jetë bashkekzistuese me Zotin, është njëlloj si njeriu i cili e bën penën të jetë pjesëmarrëse në punën e shkrimtarit në të shkruar; pra si ai që thotë se pena është shkrimtare, dhe njeriu është shkrimtar gjithashtu. Ai nënkupton se të shkruarit është një fjalë e cila mund t'iu drejtohet të dyve, por në të vërtetë ata nuk kanë përngjasim në asgjë përveç fjalës, mbasi për ndryshe nuk ekziston dallim midis tyre. I tillë është gjithashtu rasti me fjalën Krijues, kur përdoret për Zotin dhe shkaqet. Ne themi se në këtë ilustrim ekzistojnë dyshime. Duhet të jetë treguar qartësisht, nëse shkrimtari ishte Krijuesi i esencës (Jawhar) së penës, ruajtës i saj, sa kohë që ajo mbetet një penë dhe përveç kësaj një ruajtës i shkrimit, pasi ai është shkruar, një Krijues i asaj pasi ajo ka ardhur në kontakt me penën, pikërisht sikurse ne e kemi shpjeguar se Zoti është Krijues i esencave (Jawahir) të çdo gjëje që vjen në kontakt me shkaqet e tij, të cilat janë quajtur kështu vetëm prej përdorimit (zakonit). Kjo është arsyeja përse nuk ekziston krijues tjetër përveç Zotit - një gjykim që pajtohet me ndjenjat tona, arsyen dhe fenë. Ndjenjat dhe arsyeja jonë sheh se ekzistojnë gjëra, të cilat shkaktojnë të tjerat.

Rregulli i gjendur në univers është i dy llojeve: ai të cilin Zoti e ka vendosur në natyrë dhe në dispozicion të gjërave; dhe ai që rrethon universin nga jashtë. Kjo është plotësisht e qartë në lëvizjen e trupave

qiellorë. Mbasi është evidente se dielli dhe hëna, dita dhe nata, dhe të gjithë yjet janë të nënshtruara për ne; dhe kjo është mbi atë organizim dhe rregull, të cilin Zoti e ka vendosur në lëvizjet e tyre, nga ku varet ekzistenca jonë dhe ajo e të gjitha gjërave të tjera. Kështu, madje nëse ne imagjinojmë konfuzionin më të vogël të mundshëm në ta, në çfarëdo pozicioni, madhësie dhe shpejtësie tjetër të lëvizjes, të cilën Zoti ka caktuar për ta, të gjitha gjërat ekzistuese mbi tokë do të shkatërroheshin. Kjo është kështu për shkak të natyrës, në të cilën Zoti i ka bërë ata, dhe natyrën e gjërave që ndikohen prej tyre. Kjo është tepër e qartë në efektet e diellit dhe hënës mbi gjërat e kësaj bote; i tillë është gjithashtu rasti me shirat, erërat, detet dhe gjërat e tjera të kapshme. Por, efekti më i madh shkaktohet mbi bimët, dhe mbi një numër të madh, apo plotësisht, mbi kafshët. Për më tepër, është e qartë se po të mos kishin qenë këto aftësi, të cilat Zoti i ka vendosur në trupat tanë, krahas me të rregulluarit e tyre, nuk mund të ekzistonim madje për një moment të vetëm pas lindjes. Por, ne thamë, se po të mos kishin qenë aftësitë, që gjenden në të gjitha trupat e kafshëve, bimëve dhe ato që gjenden në botë, sipas lëvizjes së trupave qiellorë, atëherë ato nuk do të kishin ekzistuar fare, madje as sa hap e mbyll sytë.

Prandaj i lartësuar qoftë: ***"I Urti, i Dituri",*** *[Kur'an 76; 30]*. Zoti ka tërhequr vëmendjen tonë ndaj këtij fakti, në librin e Tij: ***"Dhe për ju nënshtroi natën e ditën dhe diellin e hënën. Edhe yjet janë të nënshtruar me urdhrin e Tij."*** *[Kur'an 16; 12];* përsëri: ***"Thuaj ç'mendoni: 'Sikur Allahu ta bënte natën të përhershme deri në Ditën e Kijametit?"*** *[Kur'an 28; 71];* dhe përsëri: ***"Po nga mëshira e Tij, u bëri juve natën dhe ditën për të pushuar në të dhe për të përfituar nga begatitë e Tij, prandaj të jeni mirënjohës."*** *[Kur'an 28; 73];* dhe: ***"Dhe për ju nënshtroi gjithë çka në qiej dhe çka në tokë"*** *[Kur'an 45; 13]*. Më tej, Ai thotë: ***"Për ju nënshtroi diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë. Për ju përshtati edhe natën e ditën."*** *[Kur'an 14; 33]*. Mund të citohen edhe shumë ajete të tjera mbi këtë temë. Po të mos kishte pasur ndonjë urtësi në ekzistencën e tyre, me të cilat Zoti na ka favorizuar ne, nuk do të kishin qenë këto mirësi, për të cilat ne duhet të jemi mirënjohës ndaj Tij.

Përgjigjja e dytë ndaj vërejtjes është se ne kemi thënë se gjërat e shkaktuara prej tij janë dy llojesh: esencat dhe substancat; lëvizjet, qëndrueshmëria, ftohtësia dhe të gjitha rastësitë (aksidentet) e tjera. Esencat dhe substancat nuk janë të krijuara prej ndokujt, përveçse prej Zotit. Shkaqet e tyre kryejnë aksidentet e këtyre esencave dhe jo vetë esencat. Për shembull, burri dhe gruaja janë vetëm elementë, ndërsa Zoti është krijuesi i vërtetë i fëmijës dhe i jetës në të. I tillë është gjithashtu rasti me bujqësinë. Toka është përgatitur dhe bërë gati dhe fara shpërndahet në të. Por, është Zoti, Ai i cili bën që të mbijnë kallinjtë e drithit. Kështu nuk ekziston krijues përveç Zotit, ndërsa gjërat e krijuara janë veçse esenca. Kësaj i referohen fjalët e Zotit: ***"O ju njerëz, ja një shembull, veni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuroni në vend të Allahut, ata nuk mund të krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të, e po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi edhe i luturi."*** *[Kur'an 22; 73]*. Ky (ajet) është (në lidhje me rastin) kur një pabesimtar dëshiroi ta fuste në rrugë të gabuar Ibrahimin, dhe i tha: ***"Edhe unë jap jetë dhe vdekje"*** *[Kur'an 2; 258]*. Kur Ibrahimi e pa se ai nuk mund ta kuptonte atë, ai menjëherë iu drejtua argumentit përfundimtar dhe tha: "Zoti im e sjell diellin nga lindja, sille pra ti atë nga perëndimi."

Në përgjithësi, nëse çështja rreth krijuesit dhe bërësit kuptohet në këtë mënyrë, nuk do të ekzistojë kontradiktë, as në hadith, e as në arsye. Kështu ne themi se fjala "Krijues" nuk u drejtohet gjërave të krijuara me anën e çfarëdo metafore të afërt apo të largët, mbasi kuptimi i krijuesit është shpikësi i esencës. Prandaj Zoti ka thënë: ***"E Allahu ju krijoi juve dhe atë që e punoni."*** *[Kur'an 37; 96]*. Duhet të dihet se çdokush, i cili mohon efektin e shkaqeve mbi rezultatet e tyre, gjithashtu mohon filozofinë dhe të gjitha shkencat. Mbasi, shkenca është njohja e gjërave prej shkaqeve të tyre, ndërsa filozofia është njohja e shkaqeve të fshehta. T'i mohosh shkaqet plotësisht, është një gjë e cila është e pakapshme për arsyen njerëzore. Kjo është të mohosh Krijuesin, që nuk shihet prej nesh. Mbasi e padukshmja në këtë materie duhet gjithmonë të kuptohet prej një referimi ndaj të dukshmes.

Kështu, këta njerëz nuk mund të kenë njohje të Zotit, kur ata pohojnë se për çdo vepër ekziston një aktor. Duke qenë kështu, pajtimi i myslimanëve në faktin se nuk ekziston Krijues përveç Zotit, nuk mund të jetë perfekt, nëse ne kuptojmë prej saj mohimin e ekzistencës së një elementi në botën e dukshme. Mbasi prej ekzistencës së elementit në të, ne kemi sjellë një argument për Krijuesin në botën e padukshme. Por, kur ne kemi pranuar njëherë ekzistencën e Krijuesit në botën e padukshme, bëhet e qartë se nuk ekziston element Krijues përveç atij, prej komandës dhe vullnetit të Tij. Është gjithashtu evidente se ne mund t'i kryejmë vetë veprat tona dhe se ndokush, i cili merret vetëm me njërën anë të pyetjes është i gabuar, sikurse është rasti me Mutezilitët dhe Xhabaritët. Ata, të cilët për zbulimin e së vërtetës, adoptojnë rrugën e mesme, sikurse Asharitët, nuk mund ta gjejnë atë. Mbasi ata nuk bëjnë dallim te një njeri, midis dridhjes dhe lëvizjes së dorës së tij me qëllim. Nuk ekziston kuptim në pohimin e tyre se të dy lëvizjet nuk janë prej vetvetes. Sepse, nëse ato nuk janë prej vetvetes ne nuk kemi mundësi për t'i kontrolluar ato, kështu ne jemi të detyruar për t'i bërë ato. Që këtu, nuk ka dallim midis dridhjes së dorës dhe lëvizjes vullnetare, të cilën ata mund ta quajnë të përftuar… E gjithë kjo është e qartë vetvetiu.

***

Problemi i Katërt: Drejtësia dhe Padrejtësia Hyjnore

Asharitët kanë shprehur një mendim tepër të veçantë, lidhur me arsyen, dhe me fenë, rreth këtij problemi. Ata e kanë shpjeguar atë në një mënyrë, të cilën feja nuk e ka, por kanë përvetësuar një metodë plotësisht të kundërt. Ata thonë se në këtë problem, rasti i botës së padukshme është plotësisht i kundërt ndaj të dukshmes. Ata mendojnë se Zoti është i drejtë apo i padrejtë brenda kufijve të veprimeve fetare. Kështu, kur veprimi i një njeriu është i drejtë lidhur me fenë, Ai gjithashtu është drejtë; dhe (kur njeriu bën) çfarëdo që feja e quan të jetë e padrejtë, Ai është i padrejtë. Ata thonë se çdo gjë, që nuk është nga-

rkuar si një detyrë e urdhëruar hyjnisht mbi njeriun, nuk futet brenda katër mureve të fesë. Ai s'është as i drejtë, as i padrejtë, por të gjitha veprat e Tij, rreth gjërave të tilla, janë të drejta. Ata kanë vendosur se nuk ekziston asgjë në vete, të cilën mund ta quajmë të drejtë apo të padrejtë. Por, të thuash se nuk ekziston asgjë, të cilën në vetvete të mund ta quash të mirë apo të keqe, është tërësisht e patolerueshme. Drejtësia njihet si e mirë, dhe padrejtësia si e keqe. Kështu, sipas tyre, politeizmi s'është në vetvete as i padrejtë, as i dëmshëm, përveçse në lidhje me fenë, dhe po ta kishte urdhëruar feja atë, kjo do të kishte qenë e drejtë dhe e vërtetë. I tillë do të kishte qenë rasti me çdo lloj mëkati. Por, e gjithë kjo, është plotësisht në kundërshtim me hadithin dhe arsyen tonë.

Për sa i përket hadithit, Zoti e ka përshkruar Veten si të drejtë dhe ia mohon padrejtësinë Vetvetes. Ai thotë: ***"Allahu vërtetoi se nuk ka Zot tjetër përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët…"*** *[Kur'an 3; 18];* dhe ***"Zoti nuk është i padrejtë ndaj robërve të Tij"*** *[Kur'an 41; 46];* dhe përsëri: ***"Allahu nuk u bën asgjë të padrejtë njerëzve, por ata i bëjnë të padrejtë vetes së tyre."*** *[Kur'an 10; 44].* Mund të pyetet: Cili është mendimi juaj rreth njerëzve të futur në rrugë të gabuar, nëse kjo është e drejtë apo e padrejtë, mbasi Zoti e ka përmendur në shumë ajete të Kur'anit: ***"Ai e lë të humbur atë që do dhe e udhëzon tjetrin që do".*** *[Kur'an 16; 93].* Ai thotë: ***"E Allahu e lë të humbur atë që do, dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë që do."*** *[Kur'an 14; 4];* dhe: ***"Sikur të kishim dëshiruar Ne, secilit njeri do t'ia jepnim udhëzimin."*** *[Kur'an 32; 13].* Ne do të themi se këto ajete nuk mund të merren në mënyrë ezoterike, mbasi ekzistojnë shumë ajete, të cilat i kundërshtojnë dukshmërisht këto ajete në të cilat Zoti ia mohon padrejtësinë Vetvetes.

Për shembull, Ai thotë: ***"Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Vet."*** *[Kur'an 39; 7].* Kështu është e qartë se, pasi Ai nuk e pëlqen madje mosmirënjohjen prej tyre, Ai sigurisht nuk mund t'u shkaktojë atyre (dëshirën) për të gabuar. Për sa i përket deklaratës së Asharitëve, se Zoti ndonjëherë bën gjëra, të cilat Ai nuk i pëlqen dhe urdhëron të tjerët (për një gjë) të cilën Ai nuk e pëlqen, Zoti na ndalon

ne për të pasur një pikëpamjeje të tillë rreth Tij, pasi ky është pabesim e pastër. Që Zoti nuk i ka çorientuar dhe nuk ka qenë shkaktar që ata të gabojnë, do të bëhet e qartë për ju, prej ajeteve që vijojnë: ***"Përqendro vetveten tënde sinqerisht në fe, i larguar prej çdo të kote,*** *(e ajo fe),* ***feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit…"*** *[Kur'an 30; 30];* dhe ***"Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre…"*** *[Kur'an 7; 172].* Një hadith i Pejgamberit thotë: *"Çdo fëmijë lindet sipas kushtetutës hyjnore".*

Këto kontradikta që janë në këtë problem, do të përpiqemi që t'i pajtojmë, ashtu që ato të mund të përputhen me arsyen. Ajeti: ***"Në të vërtetë, Allahu e largon nga e vërteta atë që do, dhe Ai udhëzon atë që do."*** *[Kur'an 35; 8];* i referohet vullnetit hyjnor të parapërgatitur, me të cilin janë pajisur të gjitha gjërat. Ata janë krijuar për të gabuar, pra të përgatitur për të shkuar në rrugë të gabuar prej vetë natyrës së tyre dhe drejtohen drejt saj prej shkaqeve të brendshme apo të jashtme. Domethënia e ajetit: ***"Sikur të kishim dëshiruar Ne, secilit njeri do t'ia jepnim udhëzimin."*** *[Kur'an 32; 13],* është se Ai e mendoi të mos krijuarit e njerëzve të prirë për të gabuar, prej natyrës së tyre, apo prej shkaqeve të jashtme, apo prej të dyjave, megjithëse Ai mundej të kishte bërë kështu. Por, pasi prirjet e njerëzve janë të ndryshme, fjalët mund ta çonin në drejtim të gabuar dikë, dhe ta drejtonin një tjetër. Për këta, janë ajetet të cilat u flasin njerëzve të devijuar. Për shembull: ***"Ai me të humb shumë, e po me të udhëzon në rrugën e drejtë shumë, po me përjashtim të atyre që janë jashtë rrugës, Ai me të nuk humb tjetër."*** *[Kur'an 2; 26]* dhe ***"E atë pamjen tënde që të treguam*** *(natën e Miraxhit)". [Kur'an 17; 60],* dhe gjithashtu pema e mallkuar në Kur'an dhe ajetet rreth një numri engjëjsh të xhehenemit: ***"Ja ashtu, Allahu e lë të humbur atë që do, dhe e udhëzon atë që do."*** *[Kur'an 74; 31].* Kjo do të thotë se për natyrat mëkatare, këto ajete janë çorientuese, pasi për njerëzit e sëmurë madje ilaçet e mira janë të dëmshme….

***

Problemi i pestë: Dita e Gjykimit

Në Ditën e Gjykimit, disa besojnë se trupi (njeriu) do të jetë i ndryshëm prej trupit të tanishëm. Ky është vetëm i përkohshëm, që do të jetë i përjetshëm. Për këtë gjithashtu ekzistojnë argumente fetare. Duket se madje edhe Abdullah bin-Abbas e mbron këtë pikëpamje. Mbasi tregohet se ai ka thënë: "Nuk ekziston asgjë prej kësaj bote në të ardhmen (në botën tjetër), përveçse emrat". Duket se ky mendim u përshtatet më mirë njerëzve të ditur, sepse mundësia e saj mbështetet mbi parime, në të cilat nuk ekziston mosmarrëveshje sipas të gjithë njerëzve: e para është se shpirti është i pavdekshëm, dhe e dyta është se kthimi i shpirtrave në trupat e tjerë nuk shikohet aq i pamundshëm sa kthimi i trupave vetë. Kjo është kështu, sepse materiali i trupave këtu, gjendet duke pasuar dhe kaluar prej një trupi në një tjetër, pra e njëjta materie gjendet në shumë njerëz dhe në shumë kohëra të ndryshme. Shembulli i trupave nuk mund të gjendet, pasi materia është e njëjtë. Për shembull një njeri vdes dhe trupi i tij bëhet dekompozohet në tokë. Toka, fundja bëhet e shpërbërë në perime, të cilat hahen prej një njeriu krejtësisht të ndryshëm, prej të cilit vjen një tjetër njeri në ekzistencë. Nëse ne supozojmë se janë trupa të ndryshëm, atëherë pikëpamja jonë e lartpërmendur nuk mund të jetë e vërtetë. E vërteta rreth kësaj çështjeje është se njeriu duhet të ndjekë atë, të cilën ai vetë e ka shqyrtuar, por në çdo rast, kjo nuk duhet të jetë pikëpamje, e cila mund të mohojë plotësisht parimin themelor. Mbasi kjo do ta mohonte ekzistencën e tij. Një besim i tillë të çon drejt femohimit, për arsye të një njohje të qartë të këtij kushti, që i është dhënë njeriut, edhe prej fesë dhe prej arsyes njerëzore, e cila e gjitha bazohet mbi natyrën e përjetshme të shpirtit. Nëse thuhet se a ekziston ndonjë argument apo informacion në Ligj, rreth kësaj natyre të përjetshme të shpirtit, ne do të themi se kjo gjendet në vetë Kur'an, ku Zoti thotë: ***"Allahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre, e edhe atë që është në gjumë, e që nuk ka vdekur".*** *[Kur'an 39; 42]*. Në këtë ajet, gjumi dhe vdekja janë vendosur në nivel të njëjtë, për arsye të ndryshimit në ins-

trumentin e tij, dhe në gjumë për shkak të ndryshimit në vetvete. Mbasi nëse nuk do të kishte qenë kështu, ai nuk do të kishte ardhur drejt gjendjes së vet të mëparshme, pas të zgjuarit. Në këtë mënyrë, ne dimë se ky lëshim nuk përmbush esencën e vet, por vetëm i bashkëngjitet atij për shkak të ndryshimit në instrumentin e tij. Kështu, nuk rrjedh se me një ndërprerje të punës së instrumentit, shpirti gjithashtu ndal së ekzistuari. Vdekja është vetëm një ndërprerje e punës, prandaj është e qartë se gjendja e saj duhet jetë e njëjtë me atë të gjumit. Sikurse ka thënë dikush se, nëse një njeri i vjetër do të merrte sytë e një të riu, ai do të fillonte të shihte sikurse ai.

Kjo është e gjitha që gjykuam në një parashtrim të bindjeve të fesë sonë, Islamit. Ajo çfarë mbetet për ne është të shqyrtojmë çështjet e fesë në të cilat lejohet dhe nuk lejohet interpretimi. Dhe nëse lejohet, atëherë cilët njerëz duhet të përfitojnë prej tij? Me këtë çështje, ne do ta përfundojmë ligjërimin tonë.

Çështjet që gjenden në Ligj mund të ndahen në pesë lloje. Por në radhë të parë, ekzistojnë dy lloje çështjesh: të pazbërthyeshme dhe të zbërthyeshme. Të zbërthyeshmet ndahen në katër lloje. Lloji i parë, i cili përmendet në Kur'an është plotësisht i qartë në domethëniet e veta. I dyti është ai, në të cilin gjëja e përmendur nuk është gjëja e nënkuptuar, por është vetëm një shembull i saj. Kjo, nga ana tjetër, ndahet në katër lloje. E para, domethëniet të cilat ajo përmend janë vetëm ilustrime të tilla, që ato mund të njihen vetëm prej analogjive të përafruara dhe të përbëra, të cilat nuk mund të kuptohen, përveçse pas një kohe të gjatë dhe punë të shumtë. Askush nuk mund t'i kuptojë ato, përveç natyrave perfekte dhe të përsosura; dhe nuk mund të njihet se ilustrimi i dhënë nuk është gjë reale; përveçse me këtë mënyrë të përafruar. E dyta është pikërisht e kundërta e të parës: ato mund të kuptohen lehtësisht, dhe mund të njihet se shembulli është pikërisht ajo çfarë është përmendur këtu. Së treti, kjo mund të njihet lehtësisht se është thjesht një ilustrim, por çfarë shembulli është ky, është vështirë për t'u kuptuar. Lloji i katërt është pikërisht i kundërti i të mëparshmit. Gjëja e cila është marrë shembull, kuptohet lehtësisht; ndërsa është e vështirë për t'u ditur nëse ai është (apo jo) një shembull fare.

Interpretimi i llojit të parë është pa dyshim i gabuar. Lloji në të cilin të dyja gjërat janë të përafruara: interpretimi i tij veçanërisht qëndron në ata, të cilët janë të faktuar mirë në dituri; dhe shtjellimi i saj nuk është i përshtatshëm për çdokënd, përveçse të diturit. Interpretimi i të kundërtës së saj - ajo e cila mund të kuptohet në të dyja anët – është pikërisht ajo çfarë kërkohet, dhe një shtjellim i saj është e domosdoshëm. Rasti i llojit të tretë është i ngjashëm me rastin e sipërm. Mbasi, në të, ilustrimi nuk është përmendur për shkak të vështirësisë për njerëzit e zakonshëm për ta kuptuar atë: kjo vetëm i nxit njerëzit për të vepruar. I tillë është rasti me hadithin e Pejgamberit: "Guri i zi është veprim i Zotit në tokë," etj., etj. Ai, i cili mund të njihet lehtësisht se është një shembull, por vështirë për të ditur se shembulli i kujt është ai, nuk duhet të interpretohet, veçse për hir të personave të veçantë dhe njerëzve të ditur. Ata, të cilët e kuptojnë se kjo është vetëm një ilustrim, por nuk janë mjaft të ditur për të ditur gjënë të cilën ajo ilustron, duhet t'u thuhet se, ose ai është alegorik dhe mund të kuptohet prej njerëzve të shkolluar të mirëformuar; ose ilustrimi duhet t'u ndryshohet në një mënyrë, e cila mund të jetë afër të kuptuarit të tyre. Ky do të jetë plani më i mirë, për të larguar dyshimet prej mendjeve të tyre.

Ligji rreth kësaj duhet të jetë ai, i cili është vendosur prej Ebu Hamid (El Ghazzali) në librin e tij, Al Tafriga bainal Islam wal Zingida. Duhet të kuptohet se një gjë ka pesë ekzistenca, të cilat ai i emëronte me emrat: thelbësor (Zati); sensual (Hissi); racional (Agli); imagjinar (Khayali); dhe dyshues (Shilbhi). Prandaj në kohën e dyshimit duhet të merret parasysh se cila prej këtyre pesë llojeve do ta bindë më mirë njeriun, i cili ka dyshime. Nëse kjo është ajo, të cilën ai e ka emërtuar thelbësore, do t'i bindte më mirë mendjet e tyre, se sa një ilustrim. Në të, gjithashtu, përfshihet hadithi i Pejgamberit, që vijon: "Çdo gjë që pejgamberët e mëhershëm e kanë parë, unë e kam parë atë prej vendit tim këtu, madje qiellin dhe ferrin"; "Midis varrit dhe minberit tim gjendet një kopsht i parajsës" dhe "Toka do të shpërbëjë të tërë njeriun, me përjashtim të ekstremitetit të bishtit". Të gjitha këto, mund të njihen lehtësisht se s'janë veçse ilustrime, por çfarë është gjëja të cilën ato

ilustrojnë, kjo është e vështirë për t'u kuptuar. Kështu, në këtë rast është e nevojshme për t'u dhënë një shembull njerëzve, të cilin ata të mund ta kuptojnë lehtësisht. Ky lloj ilustrimi kur përdoret në një rast të tillë, është i lejueshëm; por kur përdoret në mënyrë irelevante është i gabuar. Ebu Hamidi nuk ka vendosur rreth rastit kur të dyja anët e çështjes -- ilustrimi dhe e ilustruara – janë të dyja të përafruara dhe të vështira për t'u kuptuar. Në këtë rast, në dukje do të ekzistojë një dyshim, por një dyshim pa ndonjë bazë. Ajo çfarë duhet të bëhet është të provohet se dyshimi nuk ka baza, veçse nuk duhet të bëhet interpretimi, sikurse ne e kemi treguar, në shumë vende në librin tonë të tanishëm, në kontrast me Mutekelistët, Asharitët dhe Mutezilitët.

Lloji i katërt i arsyes është plotësisht i kundërt me të mëparshmin. Në këtë, është tepër vështirë për t'u kuptuar se ai është një shembull, veçse menjëherë pasi e kupton (se është shembull), ju mund ta kuptoni lehtësisht gjënë e ilustruar. Në interpretimin e kësaj, gjithashtu, ekziston një konsideratë: rreth atyre njerëzve, të cilët e dinë se nëse ky është një shembull, kjo ilustron këtë gjë; përveçse nëse ata dyshojnë a është ky (apo jo) një ilustrim fare. Nëse ata nuk janë njerëz të shkolluar, gjëja më e mirë për të bërë me ta, është mosbërja e asnjë interpretimi, por vetëm të provohet gabimi e pikëpamjeve, të cilat ata mbajnë rreth të qenit (apo jo) të tij një ilustrim fare. Është gjithashtu e mundur që një interpretim mund t'i bëjë ata akoma më të largët prej së vërtetave, për shkak të natyrës së ilustrimit dhe të ilustruarës. Mbasi, nëse jepet një interpretim për këto dy lloj rastesh, ato shkaktojnë bindje të huaja, larg prej ligjit, i cili kur zbulohet, mohohet prej njerëzve të zakonshëm. I tillë ka qenë rasti me Sufitë dhe ata njerëz të ditur, që i kanë pasuar ata. Kur, kjo punë e interpretimit u bë prej njerëzve, të cilët nuk mund të dallonin midis këtyre rasteve, dhe nuk bënë dallim midis njerëzve të cilëve duhej t'u bëhej interpretimi, këto lindën mosmarrëveshje të mendimeve, së fundi duke formuar sekte, të cilat përfundonin në akuzimin e njëri-tjetrit për mosbesim. E gjithë kjo është mosdije e pastër e qëllimit të Ligjit.

Prej asaj se çfarë kemi thënë ne deri tash, vlera e dëmit të bërë me anën e interpretimit, duhet të jetë bërë e qartë për ju. Ne gjithmonë

përpiqemi për të siguruar qëllimin tonë me njohjen e asaj se çfarë duhet të interpretohet dhe çfarë jo; dhe kur të interpretohet, si duhet bërë ai; dhe nëse duhet të shpjegohen, apo jo, të gjitha pjesët e vështira të Ligjit dhe hadithit. Këto janë të gjitha të përfshira në katër llojet, të cilat ne tashmë i kemi numëruar.

Qëllimi i të shkruarit tonë të këtij libri tashmë është i përfunduar. Ne u morëm me të, sepse ne mendojmë se ajo ishte më e rëndësishmja e të gjithave qëllimeve – të lidhurit me Zotin dhe Ligjin.[2]

Përktheu nga anglishtja
Mimoza Sinani

[2] Burimi: Ibn Rushd: 'On the Harmony of Religions and Philosophy'. Në arabisht 'Kitab fasl al-makal', me shtojcën e vet (Damina). Gjithashtu e bashkangjitura është një ekstrakt, prej 'Kitab al-kashf an manahij al-adilla', publikuar dhe përkthyer, me titullin: 'Averroes, The philosophy and Theology of Averroes', përkthyer prej Mohammed Jamil-al-Rahman (Baroda: A.G. Widgery, 1921), f. 14-19, 122-131, 204-229, 260-283, 300-308. Botimi më i fundit është botuar prej George Hourani, (Leiden, E. J. Brill, 1959). http://www.fordham.edu/halsall/source/1190averroes.html

Ibn Rushd & (Averroes) - *(1126-1198 CE)*

SHARIA AND PHILOSOPHY
RELIGION AND PHILOSOPHY, 1190 CE

(Summary)

We maintain that the business of philosophy is nothing other than to look into creation and to ponder over it in order to be guided to the Creator -- in other words, to look into the meaning of existence. For the knowledge of creation leads to the cognizance of the Creator, through the knowledge of the created. The more perfect becomes the knowledge of creation, the more perfect becomes the knowledge of the Creator. The Law encourages and exhorts us to observe creation. Thus, it is clear that this is to be taken either as a religious injunction or as something approved by the Law. But the Law urges us to observe creation by means of reason and demands the knowledge thereof through reason. This is evident from different verses of the Qur'an. For example, the Qur'an says: "Wherefore take example from them, you who have eyes" [Qur'an 49.2]. That is a clear indication of the necessity of using the reasoning faculty, or rather both reason and religion, in the interpretation of things. Again it says: "Or do they not contemplate the kingdom of heaven and earth and the things which God has created" [Qur'an 7.184].

إبن رشد (1126-1198)

التوافق بين الشريعة و الفلسفة

و الدين و الفلسفة

(خلاصة البحث)

مقدمة

نحن نقول بان مهمة الفلسفة أن ترى الخلق و ان تفكر فيه لاجل ان تهتدى إلى الخالق بمعنى آخر أن تناقش معنى الخلق. بما أن معرفة الخلق تقودنا إلى معرفة الخالق و ذلك لان عن طريق معرفة الخلق نتعرف على خفايا الخالق. بناء عليه فان الشريعة تحثنا لنتأمل الخلق، عليه فان هذا يعتبر امرا دينيا أو أمرا مأخوذا من الشريعة. الا أن الشريعة تحثنا على ان نتأمل الخلق عن طريق العقل و بناء عليه فانها تطلب المعرفة عن طريق العقل. و يتضع ذلك من الآيات الكثيرة المذكورة في القرآن الكريم، مثل: "... فَاعْتَبِرُوا يَاأُولِي الأَبْصَارِ" (سورة الحشر: 2) هذا دليل واضح في حتمية استخدام خاصية العقل و الدين في تفسير الاشياء. و هناك آيات كثيرة تحثنا على ذلك مثل: أَوَلَمْ يَنظُرُوا فِي مَلَكُوتِ السَّمَاوَاتِ وَالأَرْضِ وَمَا خَلَقَ اللَّهُ مِنْ شَيْءٍ..." (سورة الاعراف: 185)

TOLERANCA ISLAME

Abdullah Nasih Ulvan

LIRIA E BESIMIT NË LIGJIN ISLAM

Para se të trajtojmë temën për lirinë e besimit në Ligjin Islam, duhet t'i përmendim shkurtimisht tri faktet themelore që lidhen me temën:

1. Vulosja e Shpalljes
2. Universaliteti i thirrjes në Islam
3. Dëshmitë e profecisë

Vulosja e Shpalljes

Çdo njeri i drejtë e pranon faktin që Muhamedi a.s. ishte Vula e Profetëve dhe e të Dërguarve, dhe shpallja me të cilën u dërgua dhe u urdhërua ta transmetojë është vula e shpalljeve, shpallja e fundit që do t'u transmetohet njerëzve. Këtë e konfirmon edhe Kur'ani i Shenjtë:

"Muhamedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve, e All-llahu është i dijshëm për çdo send". *(el-Ahzabë: 40)*

Syneti i Muhamedit a.s., gjithashtu e konfirmon këtë fakt. Muhamedi a.s. thotë: *"Ngjashmëria mes meje dhe profetëve të dërguar para meje i ngjason njeriut, i cili ka ndërtuar një shtëpi shumë të bukur e madhështore, por që i mungon një tullë në njërën nga këndet e saj.*

Njerëzit do të sillen përreth, duke e vlerësuar lart ndërtesën, por duke thënë: "Pse nuk është vënë tulla këtu?" Ai thotë a.s.: "Unë jam ajo tullë, dhe unë jam i dërguari i fundit".

Edhe Kur'ani konfirmon faktin që Muhamedi a.s. erdhi me shpalljen e fundit. Ai thotë:

"Ne edhe ty *(Muhamed)* ***ta zbritëm librin*** *(Kur'anin)* ***e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshëm dhe garantues i tyre…"*** *(el-Maide: 48)*

"Ai është që e dërgoi të dërguarin e vet me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fe, e mjafton All-llahu dëshmitar". *(el-Fet-h: 28)*

"E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit". *(Ali Imran: 85)*

Përveç ajeteve të lartpërmendura, edhe shumë ajete tjera konfirmojnë faktin që Ligji Islam ka shfuqizuar të gjitha ligjet e mëparshme fetare dhe se Shpallja e Muhamedit a.s. është shpallja e fundit. Ajo i shfuqizon të gjitha shpalljet e mëparshme dhe është shumë e besuar, ngase ajo përmban mësimet e të gjitha shpalljeve të mëparshme, që të jetë legjislacion i përhershëm dhe i kompletuar. Ky legjislacion, që është konfirmuar dhe provuar me analiza, hulumtime dhe pohime të armiqve, dallohet duke qenë hyjnore, universale, e përhershme dhe e përtërirë. Ajo gjithashtu cilësohet si gjithëpërfshirëse, e zgjatur dhe e përhershme derisa të përfundojë kjo botë. Kur'ani thotë:

"…Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe…". *(el-Maide: 3)*

Universaliteti i Thirrjes

Ligji Islam me rregullat, sistemet dhe parimet e tij ka nuancë universale e njerëzore, pasi që është dërguar si mëshirë, udhëzim dhe rrugë e qartë për njerëzimin.

Ai nuk është dërguar për një racë të veçantë apo për një territor të caktuar apo grup specifik të njerëzve. Më saktë, i është dërguar tërë

njerëzimit pavarësisht ngjyrës, racës, gjuhës apo kombësisë. Nuk ekziston racizëm në këtë thirrje, as fanatizëm në këtë legjislacion, dhe nuk ekziston shpirt kaste në Islam. Të gjithë njerëzit janë të barabartë në Islam. Nuk ka epërsi të një kombi ndaj kombit tjetër. Më i ndershmi nga njerëzit para All-llahut xh.sh. është ai që është më i devotshëm. All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur *(nga të këqijat)…". (el-Huxhuratë: 13)*

Ky universalitet është konfirmuar në shumë ajete të Kur'anit të shenjtë. All-llahu xh.sh. thotë:

"E Ne të dërguam ty *(Muhamed)* ***vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat".*** *(el-Enbija: 107)*

"Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit, myzhdedhënës dhe tërheqës i vërejtjes…". (Sebe'ë: 28)

"Thuaj *(Muhamed):* ***"O ju njerëz! Unë jam i dërguari i All-llahut te të gjithë ju. All-llahut që vetëm i Tij është sundimi i qiejve e i tokës…".*** *(el-A'rafë: 158)*

Buhariu dhe Muslimi transmetojnë se i Dërguari a.s. ka thënë: *"Më janë dhënë pesë gjëra, të cilat nuk i janë dhënë askujt para meje: All-llahu më ka bërë fitimtar përmes frikës (duke i frikësuar armiqtë e mi në një distancë sa një muaj udhëtim). Toka për mua dhe pasuesit e mi është bërë për faljen e namazit dhe gjë me të cilën pastrohemi (marrim tejemum), prandaj çdonjëri nga pasuesit e mi mund të falë namazin kudo sa herë që vjen koha e tij. Plaçka më është lejuar mua, por nuk i ishte lejuar askujt tjetër para meje. Më është dhënë e drejta për ndërmjetësim (në Ditën e Gjykimit). Çdo profet është dërguar vetëm te populli i tij, ndërsa unë jam dërguar për gjithë njerëzimin".*

Muhamedi a.s. i dërgoi shkresa mbretërve dhe sunduesve të asaj kohe duke i ftuar në Islam. Për shembull, i dërgoi shkresë mbretit të Abisinisë (Nexhashiut), Perandorit Persian, Perandorit Bizantin dhe sunduesit të Egjiptit. Ai iu drejtua duke u thënë: *"Përqafoni Islamin*

që të jeni të sigurt dhe që t'ju jepet shpërblim i dyfishtë. Nëse e refuzoni Islamin, do të bartni mëkatet e gjithë popullit tuaj".

Sikur thirrja e Muhamedit a.s. në Islam të mos ishte universale, ai nuk do t'i kishte dërguar shkresa mbretërve dhe sunduesve të huaj. Dëshminë që konfirmon këtë universalitet e gjejmë në faktin që Kur'ani i ngarkon myslimanët me përgjegjësinë e përhapjes së Islamit në çdo kohë e vend. Kjo përgjegjësi është deklaruar në shumë ajete kur'anore. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun…". *(Ali Imran: 110)*

"Dhe ashtu *(sikur u udhëzuam në fenë islame)* ***Ne ju bëmë juve një popull të drejtë*** *(një mes të zgjedhur)* ***për të qenë ju dëshmitarë*** *(në ditën e gjykimit)* ***ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush…".*** *(el-Bekare: 143)*

"Thuaj: "Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje…". *(Jusuf: 108)*

Bazuar në këto mësime hyjnore, myslimanët filluan të përhapin shpalljen Islame në gjithë botën dhe duke mos iu frikësuar askujt përveç All-llahut. Moto e tyre ishte, *"All-llahu na ka krijuar që të nxjerrim njerëzit nga adhurimi i njerëzve në adhurimin e All-llahut, nga bota e ngushtë në atë të gjerë dhe nga padrejtësitë e feve tjera në drejtësinë e Islamit".*

Dëshmitë e profetësisë

Prej shenjave më të njohura që kanë të bëjnë me lirinë e besimit është ajo që ardhja e Muhamedit a.s. është paralajmëruar në shkrimet e shenjta të mëparshme. Dijetarët e feve tjera i pranuan këto shenja. Kjo mund të shpjegohet ashtu siç vijon:

a. Kur'ani i shenjtë hapur paralajmëron ardhjen e Muhamedit a.s.

All-llahu xh.sh. thotë:

"Dhe, kur Isai, bir i Merjemes tha: "O beni israilë, unë jam i dërguar i All-llahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!" E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: "Kjo është magji e hapët". *(es-Saf: 6)*

Emri "Ahmed" i përmendur në ajet është një prej emrave të të Dërguarit a.s. Buhariu transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Kam pesë emra: Quhem Muhamed dhe Ahmed; el-Mahi përmes të cilit All-llahu do ta eliminojë ateizmin; el-Hashir pasi do të jem i pari që do të ringjallet, ndërsa pastaj do të ringjallen njerëzit tjerë, dhe gjithashtu quhem el-Akib (që ka kuptimin se nuk do të ketë profet pas tij).*

Kur'ani deklaron:

"Atyre që u kemi dhënë librin, ata e njohin atë *(Muhamedin)* ***siç i njohin bijtë e vet, e një grup prej tyre edhe pse e dinë këtë, janë duke fshehur të vërtetën".*** *(el-Bekare: 146)*

Përemri **"atë"** i referohet Muhamedit a.s.

Gjithashtu Kur'ani i Shenjtë deklaron:

"Dhe cakto për ne *(jetë)* ***të mirë në dynja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai*** *(Zoti)* ***tha: "Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë*** *(Mëshirën)* ***do ta caktojë për ata të cilët i ruhen*** *(mëkateve),* ***e japin zekatin dhe për ata që argumentet tona i besojnë. Që pranojnë të dërguarin*** *(Muhamedin),* ***Pejgamberin arab,*** *(që nuk shkruan as nuk lexon),* ***të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil...".*** *(el-A'rafë: 156-157)*

b. Ardhja e Muhamedit a.s. është paralajmëruar qartë në Tevrat dhe Inxhil

Nëse lexojmë Tevratin dhe Ungjijtë ekzistues, pavarësisht shtrembërimeve e ndryshimeve, do të gjejmë që paralajmërimi i Muhamedit a.s. është përmendur qartë në shumë raste.

Në Ungjillin e Barnabës (41: 27) është përmendur qartë:

Sa e lumtur do të jetë koha kur do t'i dërgohet botës. Më beso, e kam parë atë dhe i kam ofruar respekt ashtu siç bënë të gjithë profetët, sepse All-llahu e pajisi me profetësi nga shpirti i Tij. Kur e pashë, ndjeva pikëllim dhe thashë: o Muhamed, All-llahu të ndihmoftë dhe më nderoftë mua duke zgjidhur këpucët tua, sepse po ta bëja këtë, do të jem një profet i rëndësishëm dhe prej më të shenjtëve te All-llahu.

Ungjilli i Xhonit, i cili është njëri prej librave kanonikë, e përdor fjalën "Mbrojtës (paraclete)", që rrjedh nga fjala greke "parakletos" që do të thotë mbështetës, ngushëllues, ndihmëtar dhe kujdestar. Ajo i ngjason fjalës "Paraklutos" që do të thotë Muhamed, Ahmed dhe Mahmud.

Në librin e tij "Demonstrimi i së Vërtetës", Rahmatullah el-Hindi konstaton:

Është e qartë që dallimi mes dy fjalëve është shumë i vogël, dhe shkronjat greke janë shumë të ngjashme. Fjala "Paraklutos", që është shtrembëruar në "Parakletos" nga shkruesit në disa botime është shumë e afërt me analogji. Por, besimtarët e Trinisë preferojnë këtë botim ndaj botimeve tjera. Besimtarët e Trinisë dëshirojnë të fshehin të vërtetën dhe të shtrembërojnë fjalët me këtë kuptim me qëllim të mohimit të profetësisë së Muhamedit a.s. dhe hedhjen poshtë të shpalljes së tij.

Dr. Hasan Dijaudin Atir konfirmon këtë shtrembërim në librin e tij "Profetësia e Muhamedit a.s. në Kur'an" ashtu siç është transmetuar nga Abdulvehab Nexhar:

Studiuesi dhe orientalisti italian, Kalro Nalino ishte duke ndjekur mësimet e gjuhës arabe në kolegjin Dar el-Ulum, në Universitetin e Kajros, me rekomandim të Qeverisë italiane. Ai kishte doktoruar në literaturën greke. Kur ishte student, rrinte shumë me shejh Nexhar, sa

që u bënë shokë të ngushtë. Njëherë, shejh Nexhari e pyeti, "Çfarë kuptimi ka fjala "Parakletos" (Mbështetës)?" Ai iu përgjigj, "Priftërinjtë thonë që do të thotë mbështetës". Shejh Nexhari iu përgjigj, "Të pyeta si profesor i gjuhës greke, e jo si prift!" Ai tha, "Ka kuptimin e dikujt që është shumë i lavdëruar". E pyeta, "A rrjedh kjo fjalë nga rrënja e foljes 'hamida' apo 'lavdëroj'?" Ai u përgjigj, "Po." I thashë, "Njëri prej emrave të Dërguarit a.s. është Ahmed". Ai u përgjigj, "Vëllai im, t'i dijë shumë fjalë". Pas kësaj, ne shkuam në drejtime të kundërta. Shejh Nexhar thotë, "Prej këtu, kuptova kuptimin e ajetit kur'anor":

"...dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!...". *(es-Saf: 6)*

Prandaj, fjala "mbështetës" apo "Paraclete" (mbrojtës) që janë përmendur në Ungjijt kanonik janë paralajmërim për të dërguarin me emrin Ahmed apo Muhamed, ashtu siç përmendëm më lart.

Ungjijtë ekzistues, pavarësisht mospajtimeve dhe shtrembërimeve të bëra nga priftërinjtë e murgjit, përmbajnë një pjesë të shpalljes hyjnore të saktë. E dimë që All-llahu xh.sh. e ka zbritur Kur'anin si shfuqizues të të gjitha ligjeve të mëparshme, duke konfirmuar mësimet që nuk janë shtrembëruar apo fshirë, dhe duke refuzuar mësimet e rreme e të shtrembëruara. Atë që Kur'ani e refuzon është pa vlerë ligjore, dhe atë që e konfirmon është ligjore e valide. Nga ajo që e ka konfirmuar është paralajmërimi për Muhamedin a.s., të cilin e gjejnë të shkruar në Tevrat dhe Inxhil.

Gjithashtu, misioni i Muhamedit a.s. është përmendur në Tevrat, në kaptinën e dytë të Librit të Hagait:

"Kështu, pasi që Zoti i ushtarëve tha: Në një kohë të shkurtër, do të lëkund qiejt, tokën, detin dhe gjithë kombet. Kur të vijë personi i dëshiruar (Muhamedi) për të gjitha kombet, do të mbushë këtë shtëpi me drejtësi".

Në gjuhën hebraike dhe shënimet anësore, fraza "njeriu i dëshiruar për të gjitha kombet" do të thotë "hamdut", dikush që është i lavdëruar nga të gjitha kombet. Pa dyshim, ky interpretim do të thotë Muhamed, Mahmud apo Ahmed. Duket sikur që Zoti i ushtarëve dëshiron

të thotë, "Do të trondit të gjitha kombet kur të vjen Muhamedi, pastaj do të përhapë drejtësinë në këtë shtëpi, që është Bejt el-Makdis apo Jerusalemi". Kështu, teksti i mëparshëm tregon që Tevrati ka cituar emrin e Muhamedit me fjalën "hamdut" apo "i lavdëruari". Por përkthyesit e shtrembëruan këtë fjalë për të përjashtuar emrin e Muhamedit dhe e zëvendësuan atë me një sinonim "i dëshiruari" në vend të Muhamed, Ahmed apo Mahmud. Ky është një shtrembërim real. All-llahu xh.sh. thotë:

"Për shkak se ata e thyen zotimin e tyre, Ne i mallkuam ata, dhe zemrat e tyre i bëmë të forta *(të shtanguara)*. ***Ata i ndryshojnë fjalët*** *(në Tevrat)* ***nga domethënia e tyre dhe braktisën një pjesë me të cilën ishin urdhëruar. Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese të tyre, përpos një pakice nga ata...".*** *(el-Maide: 13)*

c. Rabinët dhe murgjit pranojnë shenjat e ardhjes së Muhamedit a.s. dhe tregojnë karakteristikat e tij.

1. Në librin **"Biografia e Muhamedit"** është shënuar që Umeje ibn Abi es-Salet et-Thekafiu i ka thënë Ebu Sufjanit: "Në Shkrimet e Shenjta kam lexuar për karakteristikat e të dërguarit që do të paraqitet në vendin tonë. Mendova se unë isha ai profet dhe bisedova me njerëzit për këtë çështje. Pastaj kuptova se ai do të ishte pjesëtar i familjes Abdul Menaf".
2. Në të njëjtin libër, është shënuar që murgu Baka i përshkroi Aban ibn Sa'dit në Siri të dërguarin e pritur. Abani transmeton, "Baka më tregoi përshkrimin e duhur dhe nuk gaboi". Pastaj tha, "Pasha All-llahun, ai është profet i këtij kombi. Pasha All-llahun ai do të paraqitet".
3. Në librin "Dëshmitë e Profetësisë" është përmendur që murgu dhe sunduesi i qytetit Umaravije i tregoi Selman Farisiut r.a., "Koha e të dërguarit ka ardhur. Ai beson në fenë e Abrahamit dhe rrjedh nga arabët. Ai do të emigrojë në një vend mes dy vendeve vullkanike e gurore (kishte për qëllim Medinën). Ai ka disa shenja, pranon dhuratën dhe refuzon lëmoshën, dhe vula e pejgamberisë

gjendet në shpatullën e tij. Nëse ke mundësi të emigrosh në këtë vend, atëherë bëne këtë".

4. I njëjti libër përmend faktin që kur murgu i quajtur Bahira pa Muhamedin a.s., kur ai ishte djalosh me axhën e tij Ebu Talibin në Busra (Siri), e njohu atë dhe e këshilloi axhën e tij që të kthehej së bashku me të, pasi që frikësohej se do t'i ndodhte ndonjë e keqe nga çifutët.
5. Gjithashtu përmend që hebreu i quajtur Zejd ibn Sun'a thotë, "Pranova Islamin vetëm pasi që njoha të gjitha shenjat e profetësisë në Muhamedin a.s. duke veçuar dy: e para ishte që vetëpërmbajtja e tij i paraprinte injorancës. Ndërsa shenja e dytë ishte që injoranca e njerëzve rriti vetëpërmbajtjen e tij".
6. I njëjti libër përmend që hebreu sirian ibn el-Haijabani shkoi në Hixhaz dhe jetoi në mesin e fisit Kurejsh. Vdiq dy vjet para misionit të Muhamedit a.s. Para se të vdiste tha, "Erdha këtu që të prisja një profet, koha e të cilit ka ardhur dhe i cili do të emigrojë në këtë vend. Shpresoja ta takoja dhe ta pasoja atë kur do të dërgohej".

Dëshmi tjetër për profetësinë e Muhamedit a.s. është që mbreti i Abisinisë, Nexhashiu dhe rabini çifut Abdullah ibn Salam pranuan Islamin. Tregimi i tyre se si pranuan Islamin është përmendur në histori, është shënuar në librat autentikë dhe është e njohur për çdo mysliman dhe çdo njeri të arsyeshëm e të drejtë.

Përmbledhje: ardhja e Muhamedit a.s. është deklaruar qartë në Kur'an.

Dhe është paralajmëruar qartë në Tevratin dhe Inxhilin ekzistues pavarësisht shtrembërimeve që u janë bërë atyre. Gjithashtu ky fakt është deklaruar dhe pranuar nga murgj, priftërinj e rabinë të arsyeshëm e të drejtë. Kjo tregon që Muhamedi a.s. është i Dërguar, të cilën e ka dërguar All-llahu xh.sh. me udhëzim dhe me fe të vërtetë që ta bëjë atë fitues mbi të gjitha fetë tjera megjithëse jobesimtarët e urrejnë këtë.

Njerëzit e periudhës paraislamike para dhe pas misionit të tij, e kanë pranuar që Muhamedi a.s. ishte i sinqertë dhe i besueshëm.

Mrekullia e Kur'anit, me stilin e tij të paimitueshëm e madhështor që i ka habitur studiuesit, është një dëshmi tjetër për profetësinë e tij. Pavarësisht kundërshtimeve të tyre të vazhdueshme ndaj Kur'anit, ata kanë dështuar të vinë qoftë edhe me një kaptinë (sure) të vetme si ajo.

"E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme si ai *(Kur'ani)* ***dhe thirrni*** *(për ndihmë)* ***dëshmitarët tuaj*** *(zotërat)* ***pos All-llahut, nëse jeni të sinqertë*** *(në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit).* ***E mos e paçit bërë*** *(deri më tash),* ***e as që do ta bëni kurrë (edhe në të ardhmen), atëherë ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët".*** *(el-Bekare: 23-24)*

Njerëzimi do të vazhdojë dështimin që të japë një kaptinë (sure) të ngjashme me të derisa të përfundojë jeta në këtë botë. Kjo do të thotë që Kur'ani është fjalë e All-llahut dhe se Muhamedi a.s. është i Dërguari i Tij. Jeta çdo ditë zbulon një aspekt të ri të paimitueshmërisë së Kur'anit, qoftë letrare, legjislative apo shkencore. Besimtarët çdo ditë e shtojnë imanin dhe besimin që Kur'ani është fjalë e All-llahut xh.sh. dhe Muhamedi a.s. është i Dërguari i Tij, i cili është dërguar si mëshirë për njerëzimin. All-llahu xh.sh. thotë:

"Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai *(Kur'ani)* ***është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?"*** *(Fussilet: 53)*

Kështu, pas përfundimit të shpalljes, universalitetit të thirrjes në Islam dhe dëshmive për profecinë, a e din se kush është Muhamedi a.s.? Karakteristikat e shpalljes dhe vlerat e thirrjes së tij? Dhe detyrën me të cilën All-llahu xh.sh. i ka ngarkuar umetin islam në çdo kohë e vend?

Prandaj, do ta dish se çfarë qëndrimi duhet të kenë myslimanët ndaj jomyslimanëve dhe nëse Islami e detyron dikë të pranon Islamin.

Do t'i përgjigjemi këtyre pyetjeve detajisht në rreshtat vijues.

Kush është Muhamedi?

Pa dyshim, ai është i Dërguari të cilin All-llahu xh.sh. e dërgoi për njerëzimin si këshillues dhe paralajmërues i lajmeve të gëzuara, ftues për në rrugën e All-llahut me lejen e Tij dhe si fener që shpërndan dritë. All-llahu xh.sh. e dërgoi si profetin e fundit dhe shpallja e tij ishte shpallja e fundit, pasi që nuk ka shpallje apo ligj pas tij. Thënë më mirë, shpallja e tij i shfuqizon të gjitha ligjet dhe legjislacionet e mëparshme.

Karakteristikat e Shpalljes së Muhamedit a.s.

Më lart kemi përmendur që Shpallja Islame përfshin mësimet e të dërguarve dhe profetëve të mëparshëm, të cilat janë dalluar duke qenë hyjnore e universale, dhe janë karakterizuar duke qenë të përjetshme. Ato gjithashtu janë karakterizuar duke qenë gjithëpërfshirëse dhe që do të zgjasin derisa të përfundojë jeta në këtë botë. All-llahu xh.sh. thotë:

"O ithtarë të librit, juve ju erdhi i dërguari Jonë që ju sqaron shumë nga ajo që fshihnit prej librit, e për shumë nuk ju jep sqarime. Juve ju erdhi nga All-llahu dritë, dhe libër i qartë. All-llahu e vë me atë *(me Kur'anin)* ***në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësinë e Tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë".*** *(el-Maide: 15-16)*

"...Ne ty të shpallëm librin sqarim për çdo send, udhëzim e mëshirë dhe myzhde për myslimanët". *(en-Nahl: 89)*

Detyra me të cilën janë të ngarkuar myslimanët

All-llahu xh.sh. i ka ngarkuar myslimanët që në çdo kohë e vend të thirrin të tjerët për në rrugën e All-llahut me mençuri e bindje dhe me xhihad për hir të All-llahut, që Islami të arrijë në çdo vend. Pas paraqitjes së dëshmive, je i lirë që të zgjedhësh që të pranosh Islamin apo jo. Nuk ka dhunë në fe.

Ne më lart përmendëm ajetin kur'anor:

"Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për të mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni All-llahun…". *(Ali Imran: 110)*

"Dhe ashtu *(sikur u udhëzuam në fenë islame)* ***Ne u bëmë juve një popull të drejtë*** *(një mes të zgjedhur)* ***për të qenë ju dëshmitarë*** *(në ditën e gjykimit)* ***ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush…".*** *(el-Bekare: 143)*

Këto dy ajete kur'anore dhe të tjerat konfirmojnë që umeti islam duhet fuqishëm, me vendosmëri dhe me guxim të përhapë mesazhin Islam në çdo vend, të udhëzojë njerëzim, t'i ruajë ata dhe t'i lirojë nga adhurimi i gjërave tjera.

Qëndrimi i Islamit ndaj jomyslimanëve

Do ta shqyrtojmë këtë temë në detaje dhe do të largojmë çdo dykuptimësi për këtë qëndrim në rreshtat vijues.

Problemi i detyrimit

Çdo mysliman lexon ajetin kur'anor:

"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota...". *(el-Bekare: 256)*

Gjithashtu ka edhe shumë ajete tjera që përmbajnë të njëjtin kuptim dhe konfirmojnë që nuk ka dhunë në fe. All-llahu xh.sh. thotë:

"...A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?" *(Junus: 99)*

"E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues. Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!" *(el-Gashije: 21-22)*

"...I dërguari ka obligim vetëm komunikimin e qartë". *(en-Nurë: 54)*

Pse Islami nuk e detyron askënd të pranojë atë me anë të shpatës?

1. Sepse detyrimi e poshtëron dhe e nënshtron vetë njeriun.
2. Detyrimi e shkatërron personalitetin njerëzor.
3. Detyrimi mbjell mëri dhe zemërim në zemrat e njerëzve.

4. Ai shpie në ngurrim dhe zemërim që mund të shpërthejë më vonë.
5. Ai e turpëron Thirrjen Islame brenda dhe jashtë botës islame.
6. Ai besimin e detyruar e bën të papranueshëm, sepse All-llahu xh.sh. pranon vetëm veprat që bëhen për hir të Tij. Prandaj, i detyruari nuk e adhuron All-llahun me çiltërsi apo me sinqeritet.

Para All-llahut xh.sh., ky lloj adhurimi është i papranueshëm. Për këto arsye, Islami i thërret njerëzit të pranojnë atë nga besimi, kënaqësia dhe zgjedhja. Ai gjithashtu deklaron, "Në fe nuk ka dhunë".

Qëndrimi i Islamit ndaj jomyslimanëve

Së pari duhet të përmendim llojet e jomyslimanëve. Sipas këndvështrimit tim janë katër lloje:

1. Ithtarët e Librit (hebrenjtë dhe të krishterët)
2. Pabesimtarët dhe femohuesit
3. Idhujtarët dhe politeistët
4. Hipokritët (mynafikët)

Lexuesi do të njihet detajisht me qëndrimin e Islamit për çdo grup.

Qëndrimi i Islamit ndaj "Ithtarëve të Librit"

Kush janë "Ithtarët e Librit"?

"Ithtarët e Librit" janë ata të cilët besojnë në një libër hyjnor dhe ndjekin një profet. Në kohën tonë, janë dy grupe: çifutët dhe të krishterët.

Çifutët janë të gjithë ata që i përmbahen Ligjit të Musait a.s., të cilit i është zbritur Tevrati (Tora).

Të krishterët janë ata të cilët i përmbahen Ligjit të Jezusit (Isait a.s.), të cilit i është zbritur Inxhili (Ungjilli).

Këto grupe që pasuan profetin e tyre, qoftë Musain apo Isain dhe vdiqën para misionit të Muhamedit a.s. konsiderohen besimtarë. Por,

ata që pasuan profetin e tyre dhe refuzuan fenë e Muhamedit a.s. konsiderohen si pabesimtarë. Shtrohet pyetja:

Pse "Ithtarët e Librit", të cilët ishin prezentë gjatë apo pas jetës së Muhamedit a.s. dhe refuzuan thirrjen e tij konsiderohen si jobesimtarë? A nuk janë ata pasues të një profeti? A nuk besojnë në një fe hyjnore?

Është pyetje me vend, dhe do t'i përgjigjemi në detaje.

Më herët përmendëm se Mesazhi Islam është shpallja e fundit dhe ai mbizotëron mbi të gjitha Ligjet (fetare) e mëparshme dhe i shfuqizon ato. Ai është gjithashtu hyjnor, universal, i përhershëm, i përtërirë e gjithëpërfshirës deri në Ditën e Gjykimit.

Gjithashtu kemi përmendur se Mesazhi Islam i është dërguar njerëzimit pa diskriminim mes racave, ngjyrave apo gjuhëve.

Gjithashtu kemi përmendur se ardhja e Muhamedit a.s. është paralajmëruar nga murgjit dhe rabinët. Emri i tij dhe domosdoshmëria për ta besuar atë janë përmendur në Tevrat dhe Inxhil.

Gjithashtu kemi cekur se librat hyjnorë të mëparshëm që i kanë çifutët dhe të krishterët janë të ndryshme e të shumta, ashtu siç janë edhe të shtrembëruara.

Veç kësaj, Ligjet hyjnore të mëparshme nuk mund t'i plotësojnë nevojat e sotme dhe nuk mund të shkojnë me civilizimin modern dhe jetën bashkëkohore. Pse? All-llahu xh.sh. e ka ditur se këto Ligje do të mbesin të pandryshueshme, ashtu siç deklaron Kur'ani:

"Ne e kemi zbritur Kur'anin dhe ne do ta ruajmë atë". *(el-Hixhr: 9)*

Prandaj, nuk mund të gjesh asnjë të metë apo defekt. All-llahu xh.sh. thotë:

"...Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca...". *(el-En'amë: 38)*

Nuk ekziston ligj apo sistem i ngjashëm. All-llahu xh.sh. thotë:

"...po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i All-llahut?" *(el-Maide: 50)*

Prandaj, është detyrë e çifutëve dhe e krishterëve, të cilët janë thirrur në Islam, të besojnë Muhamedin a.s., emri i të cilit është paralaj-

mëruar në Tevrat e Inxhil. Gjithashtu, ata duhet të besojnë Kur'anin dhe Ligjin, i cili u është zbritur. Nëse nuk e besojnë atë, atëherë nuk i binden Tevratit e Inxhilit, dhe kushdo që e mohon të vërtetën dhe largohet nga udhëzimi është jobesimtar.

Ekziston edhe një fakt tjetër që çdokush duhet ta dijë. Që kush beson në disa libra hyjnorë e jo të tjerat, apo kush beson disa të dërguar e jo të tjerët konsiderohet jobesimtar. Kjo, sepse besimi i plotë është besimi në të gjitha librat hyjnorë dhe të dërguarit. All-llahu xh.sh. thotë:

"...A e besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni. Ç'mund të jetë ndëshkimi ndaj atij që punon ashtu prej jush, pos poshtërim në jetën e kësaj bote, e në ditën e gjykimit ata hidhen në dënimin më të ashpër...". *(el-Bekare: 85)*

"S'ka dyshim se ata që nuk besojnë All-llahun dhe të dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes All-llahut dhe të dërguarve të Tij e thonë: "Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë" e mes këtij duan të marrin një rrugë. Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë, e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët". *(en-Nisa: 150-151)*

Sipas mësimeve islame, nëse një mysliman nuk beson në një të dërguar apo në një libër hyjnor apo ligj të një profeti, ai konsiderohet si i devijuar nga e vërteta, jashtë fesë apo si renegat.

All-llahu xh.sh. thotë:

"O ju që besuat, besoni vazhdimisht All-llahu, të dërguarit të Tij, librit që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e pati zbritur më parë. Kush nuk i beson All-llahut, engjëjve të Tij, librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg". *(en-Nisa: 136)*

Kështu, Ligji Islam i lejon myslimanit të martohet me të krishtere apo çifute, ngase myslimani beson në të dërguarit dhe librat e mëparshëm. Në të njëjtën kohë, e ndalon myslimanen të martohet me të krishterë apo çifut, sepse këta të fundit nuk e besojnë Muhamedin a.s. apo Kur'anin apo Islamin si fe të fundit.

Nëse jomyslimani i beson të gjitha këto, atëherë do të bëhet besimtar i vërtetë.

Të përmbledhim, i krishteri apo çifuti, i cili nuk beson në Ligjin Islam apo Muhamedin a.s. konsiderohet si jobesimtar i vërtetë. Veç kësaj, argumentet dëshmojnë kundër tij që Muhamedi a.s. është i dërguar, se Kur'ani është Libër i All-llahut dhe se Mesazhi i Muhamedit a.s. është universal, ngase murgjit, rabinët e shumë të tjerë, të cilët pranuan Islamin e njohën në Tevrat e Inxhil. All-llahu xh.sh. thotë:

"E, kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrsesi nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit". *(Ali Imran: 85)*

Shtrohet një pyetje tjetër: Nëse Islami nuk e detyron askënd të pranojë atë, atëherë pse është e lejuar lufta? Cili është qëllimi i një lufte të tillë? Përgjigjja është që Islami synon qëllime që burojnë nga realiteti, universaliteti i thirrjes së tij dhe sistemi i luftës.

Do t'i përmbledhim këto synime në pikat vijuese:

1. Zmbrapsja e padrejtësisë dhe agresionit nga vendet islame

All-llahu xh.sh. thotë:

"Dhe luftoni në rrugën e All-llahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë *(e fillojnë luftën)".* *(el-Bekare: 190)*

"Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje që të luftojnë, për shkak se u është bërë padrejtë, e All-llahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre *(myslimanëve). (U lejuan të luftojnë)* ***Ata, të cilët vetëm pse thanë: "All-llahu është Zoti ynë!" u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur All-llahu të mos i zmbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut. E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues".*** *(el-Haxh: 39-40)*

2. Mbrojtja e marrëveshjeve dhe traktateve

Nëse ekzistojnë marrëveshje apo traktate mes myslimanëve e jo-myslimanëve, por kur këta të fundit i prishin marrëveshjet apo traktatet, myslimanët kanë të drejtë të luftojnë kundër tyre. All-llahu xh.sh. thotë:

"E nëse ata thyejnë zotimet e tyre pas marrëveshjes, ofendojnë fenë tuaj, atëherë luftoni krerët e mohuesve. Ata vërtet nuk kanë besë, luftoni që të frenohen *(nga krimi e fyerja)****".*** *(et-Tevbe: 12)*

3. Largimi i pengesave që pengojnë Thirrjen Islame

Më herët cekëm se Thirrja Islame është universale dhe se Mesazhi i Muhamedit a.s. i është dërguar tërë njerëzimit. Kjo do të thotë që Mesazhi Islam duhet të arrijë në çdo vend dhe te çdokush. Udhëheqësit despotikë e tiranë, të cilët pengojnë thirrjen Islame duhet të luftohen e të largohen, në mënyrë që thirrja Islame të arrijë te çdokush qartë e haptazi. Njerëzit kanë të drejtë të pranojnë Islamin vullnetarisht apo të mbesin në fenë e tyre. Nëse refuzojnë Islamin, duhet të paguajnë një taksë (të quajtur xhizje) shtetit islam që t'i mbrojë nga armiqtë e tyre.

Dialogu vijues mes Ubejd ibn Samitit, udhëheqësit të delegacionit mysliman dhe Mukavkisit, sunduesit egjiptian, konfirmon lirinë për pranimin e Islamit dhe ligjshmërinë për të luftuar kundër atyre që pengojnë thirrjen islame.

Mukavkisi thotë, "O njeri i mirë, kam dëgjuar bisedat tuaja për veten dhe shokët tuaj. Betohem se keni fituar ndaj armiqve tuaj, ngase ata e donin jetën. Ushtarët bizantinë janë të përgatitur që t'ju luftojnë ju. Ata janë të fuqishëm e të guximshëm dhe nuk brengosen se kë e vrasin. Ju nuk mund të luftoni kundër tyre, pasi që ju jeni të dobët, të pakët në numër dhe keni mjete luftarake të pakta. Prandaj, jemi të kënaqur nëse bëni pajtim me ne, dhe ne do t'i japim çdo ushtari nga dy dinarë, njëqind dinarë për udhëheqësin tuaj dhe një mijë dinarë për halifen tuaj. Përndryshe, do të mundeni ashpër".

Ubejde iu përgjigj, "Mos u mashtroni, ti dhe ushtarët tuaj. Pasha All-llahun, nuk kemi frikë nga ju apo ushtarët bizantinë, apo nga numri i tyre, ngase ne jemi të dobët. Ne i presim një nga dy gjërat më të mira: fitoren ndaj jush dhe fitimin e plaçkës së luftës apo rënien martir për hir të All-llahut në rast se mundemi nga ju. All-llahu xh.sh. thotë:

"...Sa e sa grupe të vogla me dëshirën e All-llahut kanë triumfuar ndaj grupeve të mëdha! All-llahu është me durimtarët". *(el-Bekare: 249)*

"Çdokush nga ne shpreson të bjerë martir, duke lënë vendin e familjen e tij, dhe duke u thënë lamtumirë. Brenga jonë e vetme është të luftojmë për hir të All-llahut dhe ta bëjmë Fjalën e Tij më të lartën. Ti the që jemi në rrethana të këqija, përkundrazi ne jemi të pasur dhe të begatë. Ne do t'ju lëmë, ashtu siç më ka urdhëruar komandanti im, vetëm nëse zgjidhni një prej tri gjërave:

"Të pranoni Islamin, që është feja e vetme që e pranon All-llahu dhe që është fe e të dërguarve e profetëve të Tij. Kushdo që pranon Islamin i gëzon të njëjtat të drejta e detyra si ne dhe do të jetë vëlla ynë në Islam. Nëse ti dhe ushtarët tuaj pranoni Islamin, do të arrini kënaqësinë në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe do të përmbahemi nga lufta, lëndimi apo konfrontimi kundër jush.

Nëse refuzoni Islamin, do të na paguani xhizjen me bindje të vullnetshme dhe duke e ndier veten të nënshtruar. Çdonjërin do ta trajtojmë sipas një marrëveshje vjetore dhe do t'i luftojmë ata që ju sulmojnë ju, nderin, tokën, shtëpitë apo pasurinë tuaj, dhe do t'ju mbrojmë ju nëse i bashkoheni marrëveshjes sonë.

Nëse refuzoni këto, do t'ju luftojmë derisa t'ju mundim apo na mundni. Këto janë mësimet e fesë sonë. Nuk lejohet pranimi i fesë tjetër, prandaj, zgjidhni një prej këtyre tri zgjedhjeve".

Të përmbledhim: Islami nuk e detyron askënd të pranojë atë, e as të përhapet me shpatë, ashtu siç pretendojnë armiqtë e Islamit. Islami ka urdhëruar luftën, ashtu siç pamë me rastin e Ubejdes, për t'u liruar nga tiranët, të cilët pengojnë përhapjen e Thirrjes Islame te popujt dhe njerëzit tjerë në gjithë botën.

Dialogu mes Rib'i ibn Amir dhe Rrustumit, komandantit të ushtrisë persiane, është një konfirmim tjetër, se qëllimi i luftës është largimi i tiranëve e pengesave. Rib'i sfidoi Rrustumin duke i thënë, "All-llahu na ka dërguar që t'i nxjerrim njerëzit nga adhurimi i idhujve në adhurimin e All-llahut, nga bota e ngushtë në botën e gjerë, nga fetë e padrejta në Islamin e drejtë".

Veç kësaj, po të ishte përhapur Islami me forcë apo luftë, i Dërguari a.s. nuk do ta pranonte xhizjen nga udhëheqësi i Ajalahës apo nga banorët të Xherbas apo Adhras, kur fitoi kundër ushtrisë bizantine në Luftën e Tebukut. Fitorja shpesh e shtyn fituesin të arrijë më shumë fitore, por ai a.s. refuzoi të vazhdojë luftën kundër banorëve të Ajalahës, Xherbas dhe Adhras, sepse ata anuan nga paqja. All-llahu xh.sh. thotë:

"Në qoftë se ata, anojnë kah paqja, ano edhe ti kah ajo, e mbështetu në All-llahun. Ai është që dëgjon dhe di". *(el-Enfal: 61)*

Xhizja, të cilën e paguan nuk ishte pagesë që të jenë të lirë të mbesin në fenë e tyre, por ishte kompensim ndaj myslimanëve, të cilët bënë përpjekje për mbrojtjen e tyre.

Zgjidhja për të pranuar islamin apo pagimi i xhizjes është dëshmi e qartë që Islami nuk e detyron askënd të pranojë atë. All-llahu xh.sh. thotë:

"Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota...". *(el-Bekare: 256)*

Dëshmi tjetër që konfirmon lirinë e besimit për ithtarët e Librit është kjo: Kur rumunët, bullgarët dhe armenët u shtuan shumë në mbretërinë e tij dhe bënë intriga e parregullsi, sulltani Osman vendosi t'i detyrojë ata të pranojnë islamin apo t'i dëbojë. Por, shejh ul-Islami Zenbil Ali Efendi e kundërshtoi dhe e qortoi ashpër, "Nuk ke të drejtë t'i detyrosh çifutët apo të krishterët të konvertohen në Islam apo t'i dëbosh. E drejtë e jote është marrja e xhizjes". Sulltani ndryshoi vendimin e tij në përputhje me mësimet islame. Islami i konsideron ata që i paguajnë xhizje shtetit islam si njerëzit e marrëveshjes (dhim-mes) dhe ata i kanë të njëjta të drejta e privilegje si myslimanët. Të drejtat e

cekura më poshtë janë të drejtat më të rëndësishme që Islami i jep dhimimiut (të mbrojturit), që jeton nën qeverisjen islame:

1. Myslimanët duhet të përmbahen nga lufta kundër tyre nëse ata anojnë nga paqja dhe paguajnë xhizjen. All-llahu xh.sh. thotë:
   "...derisa ta japin xhizjen në dorë e duke qenë të mposhtur". *(et-Tevbe: 29)*
   Muhamedi a.s. ka thënë, *"Kërkoni nga ata (jomyslimanët) të paguajnë xhizjen. Nëse pranojnë, mos i luftoni".*
2. Myslimanët duhet të mbrojnë pasurinë, jetën dhe nderin e tyre. Libri "Lartësimi i Flamurit" i shkruar nga ez-Zaili përmend se Aliu r.a. ka thënë, "Dhimmitë (të mbrojturit) paguajnë xhizje për t'u mbrojtur pasuria dhe jeta e tyre". Buhariu transmeton nga Abdullah ibn Amr r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë, *"Kushdo që e vranë një dhimmi(të mbrojtur) padrejtësisht nuk do të nuhat erën e xhenetit. Vërtetë, era e xhenetit mund të nuhatet në një distancë (udhëtimi) prej dyzet vjetëve".*
3. E gëzojnë të drejtën e kryerjes së ritualeve dhe riteve në kisha e sinagoga dhe në çështjet personale të tyre. Marrëveshja e bërë nga Omeri r.a. me palestinezët shkruan, "Omeri, udhëheqësi i myslimanëve siguron banorët e Ilijës (Jerusalemit) dhe mbron veten, pasurinë, kishat dhe kryqet e tyre. Askush nuk mund t'i detyrojë ata të braktisin fenë e tyre apo t'i lëndojë".
4. Duhet t'i gëzojnë të gjitha të drejtat si myslimanët. Muhamedi a.s. ka theksuar të drejtat e dhimmiut (të mbrojturit) kur i ka dërguar një shkresë banorëve të Nexhranit, ashtu siç përmendet në librat "Futuh el-Buldan" (Çlirimi i vendeve) dhe el-Haraxh (Taksa e tokës):
   Banorët e Nexhranit dhe fshatrave përreth i kanë të njëjtat të drejta, mbrojtjen e All-llahut dhe marrëveshjen e Muhamedit a.s. mbi pasurinë, jetën, tokën, fenë, shërbëtorët, familjen, kishat e tyre dhe mbi të gjitha pasuritë tjera qofshin të vogla apo të mëdha. Nuk kemi të drejtë të ndërrojmë peshkopët apo murgjit e tyre me të tjerë. Nuk do të kërkohet nga ta haraxhi (taksa e tokës) apo të luftohen.

Nëse ngrinin padi kundër një myslimani, atëherë duhet të gjykohen me drejtësi.

5. Duhet të mbrohen nga çdo sulm i jashtëm, padrejtësia të largohet nga ta dhe jeta e pasuria e tyre të mbrohet.

Buhariu transmeton se Omer ibn Hatabi r.a. i këshilloi sahabët para vdekjes së tij, "E këshilloj pasardhësin tim të përmbushë marrëveshjen e Muhamedit a.s. kundrejt tyre "dhimmive" (të mbrojturve), të luftojë armiqtë e tyre dhe të mos i ngarkojë mbi mundësinë e tyre".

Ebu Davudi transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë, "Kushdo që është i padrejtë ndaj një jomyslimani apo e lëndon atë apo e ngarkon mbi mundësinë e tij apo i merr diçka me forcë, do të jem kundërshtar i tij në Ditën e Gjykimit".

Veç kësaj, Muhamedi a.s. ishte i butë në marrjen e xhizjes.

Sipas Ligjit Islam, xhizja vjetore e marrë nga "dhimmiu" (i mbrojtur) është 12 dërhemë për klasën e varfër, 24 dërhemë për klasën e mesme dhe 48 për të pasurit. Xhizja nuk merret nga i verbëri, i sëmuri, i gjymtuari, i moshuari si dhe as nga gruaja, fëmija, robërit, i çmenduri dhe murgjit.

Duhet të cekim, që sasia e xhizjes është shumë e vogël krahasuar me atë që paguajnë myslimanët për zekat e lëmoshë, dhe atë që shpenzojnë në luftë e xhihad.

Gjithashtu duhet të cekim, që xhizja i hiqet dhimmiut, që pranon Islamin. Imam Ahmedi dhe Ebu Davudi transmetojnë, "Nuk ka xhizje për njeriun që pranon Islamin". Të gjithë juristët islamë pajtohen me këtë.

Historia tregon se një vali (guvernator) i dërgoi letër halifit të myslimanëve, Omer ibn Abdulazizit: "Pagimi i xhizjes është pakësuar, sepse shumë njerëz kanë pranuar Islamin. Prandaj, duhet ta mbledhësh edhe nga ata që pranojnë Islamin". Pas kësaj, Omeri iu përgjigj, "Çfarë mendimi të keq që mban! All-llahu xh.sh. nuk e dërgoi Muhamedin a.s. si mbledhës të fondeve, por si udhëzues për njerëzimin. Kur të arrijë letra ime, largoje xhizjen nga "dhim-mitë" (të mbrojturit), që kanë pranuar Islamin".

Të drejtat që i cekëm më lart janë të drejtat më të rëndësishme, që u janë dhënë "Ithtarëve të Librit", çifutëve dhe të krishterëve. Ato janë të drejta të mrekullueshme dhe nuk mund të gjenden në asnjë fe tjetër hyjnore, sistem të kësaj bote apo ligj ndërkombëtar.

Studiuesit e drejtë jomyslimanë kanë pranuar që Islami i jep rëndësi lirisë së besimit dhe trajtimit të mirë të "dhim-mive") të mbrojturve). Profesori, Sir Tomas Arnold në librin e tij, "Thirrja në Islam" (fq. 66-67, 88) thotë:

Kur myslimanët arritën në Luginën e Jordanit dhe Ubejda ngriti kampin në një vend të quajtur Fehl, të krishterët e këtyre qyteteve i shkruan arabëve myslimanë: "O myslimanë, ju jeni më të dashur te ne se bizantinët, megjithëse bizantinët i takojnë fesë sonë, sepse ju jeni të sinqertë, të drejtë dhe të mëshirshëm. Ju jeni më të mirët për të na qeverisur ne, pasi që ata na luftuan dhe na morën shtëpitë tona".

Në Hims, qytetarët e penguan ushtrinë e Heraklit, që të hyjë në qytet. Ata i treguan myslimanëve se qeverisja e tyre dhe drejtësia janë më të dashura për ta se qeverisja greke.

Ideja që shpata ishte arsyeja kryesore në konvertimin e myslimanëve është e pavërtetë, pasi që thirrja e bindja ishin dy veçoritë kryesore në bindjen e njerëzve për Islam, e jo forca apo dhuna.

Gustav Luboni thotë, "Arabët ishin pushtuesit më të drejtë dhe më të mëshirshëm në histori".

Gjithashtu historia tregon se kur tatarët pushtuan shtetet islame, robëruan njerëzit, qofshin ata myslimanë apo të krishterë. Myslimanët më vonë fituan mbi ta dhe mbretërit e tyre pranuan Islamin. Shejh el-Islam iu drejtua udhëheqësit të tatarëve që të lirojë robërit. Ai i liroi vetëm robërit myslimanë dhe jo dhim-mitë (të mbrojturit të krishterë), Shejhu-l-Islam i tha, "Duhet të lirosh gjithashtu edhe robërit çifut e të krishterë, pasi që ata kanë mbrojtjen tonë".

Më lart përmendëm qëndrimin e guximshëm të marrë nga Shejhu-l-Islami, Zanbili Ali Efendi, i cili kundërshtoi Sulltan Selimin, kur ky i fundit provoi të detyrojë rumunët, bullgarët dhe armenët të pranojnë Islamin.

Omer ibn Hatabi r.a. i shkroi valiut (guvernatorit) të Egjiptit, Amr ibn Asit r.a.: "Ti i qeveris "Ithtarët e Librit" (dhim-mitë), prandaj kujdesu për ta, ashtu siç na ka këshilluar Muhamedi a.s. për ta, "Kujdesuni për koptët (të krishterët e Egjiptit), pasi që janë "Ithtarë të Librit" (dhim-mi)".

Ebu Jusufi , në librin e tij "el-Haraxh", përmend se Omer ibn Hatabi r.a. kaloi pranë një dhim-miu të moshuar, i cili kërkonte lëmoshë para një xhamie për të plotësuar xhizjen dhe nevojat e tij. Omeri i tha, "Ne ishim të padrejtë ndaj teje, ngase morëm xhizjen nga ti kur ishe i ri dhe të neglizhuam tani kur je i moshuar". Ai pastaj hoqi xhizjen dhe taksat nga ai dhe i dha para nga thesari i shtetit.

Gjithashtu është transmetuar se Omer ibn Hatabi r.a. ka ndëshkuar djalin e Amr ibn Asit, guvernatorin (valiun) e Egjiptit, pasi që ai padrejtësisht e goditi një kopt (të krishterë) egjiptian. Pastaj tha, "Amr, kur i ke robëruar njerëzit, kur nënat e tyre i kanë lindur ata të lirë"?!

Ekzistojnë shembuj edhe dëshmi të panumërta që konfirmojnë, se Islami i trajton "Ithtarët e Librit" me mirësi, drejtësi dhe mëshirë.

Kjo është një përgjigje bindëse për ata që pyesin se si çifutët dhe të krishterët trajtohen nën qeverisjen islame.

Ata do të trajtohen ashtu siç urdhërojnë mësimet islame dhe ashtu siç vepruan stërgjyshërit tanë, me mirësi e mëshirë, ashtu siç pranojnë edhe jomyslimanët tjerë të drejtë: "Arabët ishin pushtuesit më të drejtë dhe më të mëshirshëm në histori".

Krahasim

Tani duhet të krahasojmë trajtimin tonë të mirë ndaj tyre dhe trajtimin e keq të tyre ndaj nesh. Këtë do ta bëjmë për të kuptuar faktin real duke krahasuar mes drejtësisë së Islamit dhe padrejtësisë së njerëzve tjerë të ulët.

Historianët pajtohen, që kryqtarët kanë vrarë 70. 000 myslimanë në një ditë në Kryqëzatën e Parë. Gjithashtu përmendet, që gjaku kishte arritur deri në xhaminë el-Aksa dhe rrugët e Jerusalemit. Sa u përket myslimanëve, kryqtarët nuk i respektuan lidhjet, qofshin ato fa-

miljare apo të marrëveshjes dhe nuk kishin aspak mëshirë për të rinjtë apo të moshuarit, gratë apo fëmijët, madje nuk i respektuan as njerëzit e fesë. Megjithëkëtë, Salahudini i trajtoi kryqtarët njerëzisht dhe me respekt kur çliroi Jerusalemin. Nuk derdhi gjak, nuk përdhosi vendet e shenjta, nuk theu marrëveshjet. Nuk përdhosi kishat apo sinagogat dhe ato u ruajtën për një kohë të gjatë deri në kohën kur aleatët hyn në Jerusalem gjatë Luftës së Parë Botërore. Pastaj komandanti britanik Allenbi tha, "Tani kanë përfunduar kryqëzatat".

Dr. El-Amiri në librin e tij "el-Alakat es-Sijasije ed-Devlije" (Marrëdhëniet Politike Ndërkombëtare) thotë:

"Myslimanët u torturuan në Andaluzi, u krishterizuan padrejtësisht nga Gjykatat e Inkuizicionit, të cilat urdhëruan që myslimanët të digjen nëse nuk konvertohen në Krishterizëm. Kardinali i Toledos, i cili ishte udhëheqësi i Gjykatave të Inkuizicionit gjykoi që kokat e arabëve qofshin meshkuj apo femra, të moshuar apo të rinj, duhet të prehen nëse nuk konvertohen në Krishterizëm. Kardinali me këtë dëshironte të zhdukte rrënjët e Islamit për të ruajtur dinjitetin e Kishës dhe të shkatërrojë Andaluzinë (Spanjën Islame) që ta mbajë të pushtuar, triumfuese dhe të ruajë dinjitetin e Kishës.

Myslimanët e Granadës bënë marrëveshje paqësore me dy mbretërit katolikë, Ferdinandin dhe Izabelën, por këta të fundit prishën marrëveshjen, duke i rrethuar tre milionë myslimanë, të cilët pastaj i vranë.

Dr. Hamid Sulltan në librin e tij "E Drejta Ndërkombëtare e Përgjithshme" (el-Kanun ed-Devlij el-Am) shkruan:

Në vitin 1454, papa nxori vendim me të cilin i dha të drejtë lundërtarit portugez të quajtur Henri të lundrojë nëpër vendet myslimane dhe t'i pushtojë ato me qëllim të zhdukjes së Islamit. Vendimi i papës thoshte: "Jemi të gëzuar, ngase djali ynë i dashur, princi portugez Henri ka ndjekur rrugën e babait të tij mbretit Xhon, i cili ishte ushtar i ushtrisë së Jezusit. Detyra e ushtrisë është që të çlirohet nga armiku i Jezusit, nga myslimanët e pafe".

Një këngë e njohur italiane thotë:

"Oj nëna ime, lutu për ne. Mos qaj, por qesh e reflekto. A nuk e di se Italia më thërret të luftoj? Po shkoj në Tripoli dhe jam shumë i gëzuar që të sakrifikoj gjakun tim për të zhdukur atë komb të mallkuar, të luftoj kundër fesë Islame dhe të asgjësoj Kur'anin. Nëse pyetesh se pse nuk po vajton, tregoju se kam shkuar të luftoj Islamin".

Veprimet e Kryqëzatave në të kaluarën në Palestinë, Spanjë dhe Libi dhe veprimet në Filipine, Etiopi, Qipro, Eritre, Zanzibar, Keni, Afrikën e Jugut tani janë dëshmi e qartë e armiqësisë dhe urrejtjes.

Sa u përket çifutëve

Ata janë më keqdashësit dhe më dinakët ndaj Islamit e myslimanëve. Kur të trajtojmë hipokrizinë e çifutëve në kapitullin tjetër, do të shohim që intrigat e tyre dhe marrëveshjet e prishura me Muhamedin a.s. ishin të panumërta. Gjithashtu, intrigat e tyre kundër sistemit islam gjatë gjithë historisë ishin të shumta për t'i shqyrtuar nga afër.

Kjo duke mos përmendur okupimin dhe sulmin e tyre të fundit kundër Jerusalemit e Palestinës dhe planet e tyre për të themeluar shtetin e Izraelit.

Kur'ani i Shenjtë e bën të qartë natyrën e çifutëve e të krishterëve dhe urrejtjen e vazhdueshme të tyre ndaj Islamit e myslimanëve.

"...Ata do t'ju luftojnë juve vazhdimisht për t'ju zmbrapsur, nëse munden nga feja juaj...". *(el-Bekare: 217)*

"Shumë Ithtarë të Librit *(çifutë, krishterë),* ***edhe pasi që iu është bërë e qartë e vërteta, nga vetë zilia e tyre personale dëshiruan që pas besimit tuaj t'iu kthejnë në mosbesimtarë...".*** *(el-Bekare: 109)*

"As çifutët, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri që të pasosh fenë e tyre…". *(el-Bekare: 120)*

Pas këtij krahasimi, çdokush, që kupton do të njohë dallimin mes drejtësisë sonë dhe padrejtësisë së tyre, zemërgjerësisë sonë dhe urrejtjes së tyre.

All-llahu xh.sh. e mëshiroftë poetin që ka thënë:

Kur e qeverisëm Jerusalemin, përhapëm drejtësi.
Kur e qeverisët ju, përhapët gjakderdhje.

Ju lejuat vrasjen e robërve
Derisa ne i falëm dhe i favorizuam.
Ky dallim mes nesh është i mjaftueshëm.

Jo të gjithë jomyslimanët janë të padrejtë. Janë shumë jomyslimanë të drejtë, të cilët vullnetarisht kanë pranuar Islamin, duke treguar dhembshuri dhe paqe ndaj myslimanëve dhe duke lavdëruar Ligjin Islam.

All-llahu xh.sh. thotë:

"Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë dhe ata, që i përshkruan Zotit shok *(idhujtarë)* ***janë njerëzit me armiqësi më të fortë kundër besimtarëve*** *(kundër myslimanëve).* ***Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: "Ne jem nesara - të krishterë". Këtë, ngase prej tyre*** *(të krishterëve)* ***ka dijetarë*** *(ulema)* ***dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryelartë. Kur e dëgjojnë atë që i është zbritur të dërguarit*** *(Kur'anin),* ***prej syve të tyre rrjedhin lot, ngase e kanë kuptuar të vërtetën, e thonë: "Zoti ynë, ne kemi besuar, pra na regjistro ndër ata që dëshmojnë*** *(ndër umetin e Muhamedit)".* *(el-Maide: 82-83)*

Këto që cekëm më lart janë gjërat më të rëndësishme, që duhet t'i kuptojmë për lirinë fetare të "Ithtarëve të Librit" nën qeverisjen islame.

Mendoj, që Islami kujdeset për "Ithtarët e Librit", i trajton me mirësi dhe i lartëson nivelin e tyre psikologjik e shoqëror. Gjithashtu u jep të drejtë të jetojnë me myslimanët në paqe, stabilitet dhe me nder.

- vijon -

Abdullah Nasih Ulvan

FREEDOM OF BELIEF IN ISLAMIC LAW

(Summary)

Before we deal with the topic of freedom of belief in Islamic Law we must briefly present three fundamental components that are closely related to it:

1. The Sealing of Prophethood (revelation)
2. The universality of the call in Islam
3. Proof of the prophecy

All men of honor accept the fact that Mohammed was the Seal of the Prophets and that the Quran is the final revealed message of God. This is confirmed in the Holy Quran:

Muhammad is not the father of any of your men, but (he is) the Messenger of Allah, and the Seal of the Prophets: and Allah has full knowledge of all things (Al-Ahzab: 40).

"My similitude in comparison with the other prophets before me, is that of a man who has built a house nicely and beautifully, except for a place of one brick in a corner. The people go about it and wonder at its beauty, but say: 'Would that this brick be put in its place!' So I am that brick, and I am the last of the Apostles.

The Quran confirms the fact that Mohammed delivered the last revelation:

To thee We sent the Scripture in truth, confirming the scripture that came before it, and guarding it in safety (Al-Ma'idah: 48).

It is He Who has sent His Messenger with Guidance and the Religion of Truth, to proclaim it over all religion: and enough is Allah for a Witness (Al-Fath: 28).

If anyone desires a religion other than Islam (submission to Allah), never will it be accepted of him; and in the Hereafter He will be in the ranks of those who have lost (All spiritual good) (Al-Imran: 85).

عبدالله ناصح علوان

حرية الدين في الاسلام

(خلاصة البحث)

قبل ان نتناول موضوع حرية الدين في الشريعة الاسلامية يجب علينا أن نذكر باختصار ثلاث حقائق لها صلة بالموضوع:

1- الرسالة الخاتمة

2- عالمية الدعوة الاسلامية

3- دلائل النبوة

الرسالة الخاتمة

كل انسان منصف يعترف بالحقيقة ان محمدا (صلعم) كان خاتم الرسل و الانبياء و ان الرسالة التي جاء بها هي خاتمة الرسالات. هذا الذي يؤكد القرآن الكريم: "مَا كَانَ مُحَمَّدٌ أَبَا أَحَدٍ مِنْ رِجَالِكُمْ وَلَكِنْ رَسُولَ اللَّهِ وَخَاتَمَ النَّبِيِّينَ وَكَانَ اللَّهُ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمًا" (سورة الاحزاب، 40)

و يؤكد هذا الامر السنة النبوية الشريفة في احاديث كثيرة. و القرآن الكريم يؤكد بان النبى صلعم جاء بخاتم الرسالات، اذ يقول "وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنْ الْكِتَابِ وَمُهَيْمِنًا عَلَيْهِ..." (سورة المائدة، 48).

"وَمَنْ يَبْتَغِ غَيْرَ الإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الآخِرَةِ مِنْ الْخَاسِرِينَ" (سورة آل عمران، 85).

JURISPRUDENCË

Ajni Sinani

TË DREJTAT E NJERIUT SIPAS BOTËKUPTIMIT ISLAM DHE ATIJ PERËNDIMOR
(Një qasje krahasuese)

Parathënie

Përzgjedhja e kësaj teme[1] për trajtim studimor nuk është bërë rastësisht. Duke qenë se jemi një shoqëri post komuniste, e cila qe bombarduar nga një propagandë e pamëshirshme ndaj religjionit në tërësi, e ndaj Islamit në veçanti, duke qenë se gjendemi në vendet e islamit periferik, duke parë shkrimet sipërfaqësore si rezultat shpeshherë i mosnjohjes së të drejtës islame dhe herë-herë edhe me qëllime tendencioze, e pashë të arsyeshme që të bëja një përpjekje në këtë drejtim. Në vendimin tim për t'iu qasur kësaj tematike, kanë ndikuar edhe disa faktorë, prej të cilëve më të rëndësishëm janë:

1. Jo rrallë herë, bota islame akuzohet, vend e pavend, për shkeljen dhe mosrespektimin e të drejtave të njeriut.
2. Dëshira për të hulumtuar dhe theksuar aspektet e përbashkëta dhe pikat ndarëse ndërmjet botëkuptimit islam dhe atij perëndimor për

[1] Ky studim seminarik për shkallën e tretë është mbrojtur pranë Fakultetit Juridik, drejtimi juridiko-ndërkombëtar, të Universitetit të Prishtinës.

të kuptuarit e të drejtave të njeriut, në veçanti dhe të drejtës në përgjithësi.
3. Mungesa e të qenit një temë e elaboruar në gjuhën shqipe, madje as që është shkruar ndonjë shkrim me tematikë të këtillë në gjuhën shqipe.
4. Rëndësia shkencore që ka një qasje e këtillë, dhe fakti se disa segmente të së drejtës së sheriatit janë zbatuar për shekuj edhe në trojet tona gjatë sundimit osman.
5. Kam bindjen se jo vetëm në të shkuarën, por edhe sot e në të ardhmen, ligji islamik është jetik për të gjithë popujt myslimanë. Edhe populli ynë nuk duhet të bëjë përjashtim në këtë drejtim. Është me rëndësi të kemi një shtet me rend juridiko-moral, e jo shtet të forcës dhe dhunës, instrument të dhunës. Shteti duhet të jetë bashkësi e vlerave, ku kultivohen vlerat e vazhdueshme objektive sikurse janë Drejtësia, e Vërteta, Mirësia, e Bukura, e Shenjta etj. Shekullarizmi nuk është dhe nuk mund të jetë bërthama morale e shtetit. Drejtësia është bërthama morale e shtetit. Porosia kur'anore është: ***"Jini të drejtë, ajo është më afër devotshmërisë."*** *(Kur'ani: El Maide, 8).*

Që njerëzit të jenë të drejtë vetëdija e tyre duhet të jetë e frymëzuar me përmbajtje të pasur të vlerave hyjnore, e jo me përmbajtjen e varfër të shekullarizmit. Edhe të drejtat e njeriut janë njëkohësisht ide morale edhe koncept politik. Ky punim është bërë në frymën e këtij botëkuptimi.

I vetëdijshëm se të marrit me këtë temë nuk do të jetë punë e lehtë, për vetë mprehtësinë e saj dhe për mungesë të literaturës adekuate, nga këndvështrimi i elaborimit tim, madje edhe për shkak të shumë paragjykimeve të ndërsjella nga të dy palët, jam munduar që t'i nxjerr dhe t'i avancoj ato mendime, që çojnë në përfundimin se nuk ka dallime shumë të mëdha ndërmjet legjislacionit perëndimor dhe atij islam. Moskuptimi ndërmjet këtyre dy botëve dhe hendeku i krijuar ndërmjet tyre është, sipas mendimit tim, më shumë rezultat i interesave të ndryshme ekonomike dhe politike.

Jam munduar që të jem objektiv dhe t'u përmbahem kritereve shkencore, mirëpo më është dashur që gjitha ato çështje, të cilat shihen me rezervë nga botëkuptimi perëndimor, t'i arsyetoj dhe t'i mbroj, nga pikëpamja islame dhe logjika e shëndoshë. Gjatë leximit të këtij punimi bie në sy fakti se autori është i mishëruar me pikëpamjen islame. Ndryshe edhe s'do të mund të veproja, sepse bindja fetare s'mund të hiqet, ashtu sikurse do të hiqej palltoja në gardërobë. Gjatë kësaj pune modeste kam kuptuar se kërkohet një punë edhe më angazhuese. Ky mbetet pikësynimi im. I vetëdijshëm për lëshime, të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet janë të mirëpritura.

Formulimi i të drejtave të njeriut në qarkun kulturor perëndimor

Shumë myslimanë janë skeptikë ndaj nocionit - jo ndaj përmbajtjes obliguese - të të drejtave universale valide të njeriut. Ky skepticizëm e ka prejardhjen nga përvoja politike (kolonializmi) dhe nga bindjet religjioze.

Në fakt, formulimi i të drejtave të njeriut, në qarkun kulturor perëndimor, rrënjët e veta i ka në një kryengritje kundër një kishe të gjithëfuqishme dhe kundër tiranëve sundues autokratë.

Lufta për të drejtat e njeriut dhe formimi i demokracisë perëndimore, para 200 vjetëve, si pikë fillestare nuk kishte kryengritjen-rebelimin kundër Zotit, një opinion i formuar gabimisht te shumë myslimanë, por, përkundrazi, nëpërmjet thirrjeve për Zotin, është vërtetuar barazia e të gjithë njerëzve para Zotit.[2]

Deklarata Amerikane për Pavarësi (1776) thotë: "Ne i mbulojmë këto të vërteta, që të bëjnë të vetëkuptueshme se, të gjithë njerëzit janë të krijuar të barabartë, se ata janë të dhuruar nga Krijuesi i tyre me disa të drejta të patjetërsueshme…"[3] Për përpiluesit e Deklaratës Amerikane për Pavarësi vërtetohen të vërtetat apo të drejtat, pas të cilave qartë qëndron Zoti.

[2] Kristian Hoffmann, I Shtrirë nga të gjitha anët, (botues ASR) Tetovë, 2003, f. 40.

[3] Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, botuar nga Gudmundur Alfredssson & Asbjorn Eide, Prishtinë, (pa vit botimi) f. 68.

Ndërkaq, jakobinët francezë, të drejtat e njeriut i kanë kuptuar vetëm në gjërat e të drejtave natyrore (droits naturels).

Respektimi ndërkombëtar i të drejtave të njeriut

Interesimi në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut daton që nga periudha e themelimit të Kombeve të Bashkuara dhe u paraqit si një reagim ndaj mizorive të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse në periudhat paraprake janë bërë disa përpjekje dhe janë regjistruar rezultate në këtë fushë, ato kanë qenë të kufizuara. Që nga Lufta e Dytë Botërore e këtej, ne jemi ballafaquar me një prirje kah përcaktimi i kuptueshëm i standardeve, mbi të drejtat e njeriut në të drejtën ndërkombëtare.[4]

Gjatë hartimit të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, u debatua rreth burimit të të drejtave të njeriut. Me qëllim që, kjo deklaratë të miratohej nga shtete që u përkisnin kulturave dhe ideologjive të ndryshme, si kompromis u mënjanua fjala Zot, Natyrë dhe Natyrë Njerëzore. Çdo lidhje e të drejtave të njeriut me metafizikën, u kundërshtua nga delegatët e vendeve socialiste. Disa delegatë, sikurse ishte ai i Ekuadorit dhe Uruguait, argumentuan se "asnjë referencë në Hyjni, nuk duhet bërë në dokumentet e Kombeve të Bashkuara, për shkak të filozofisë universale mbi të cilën Kombet e Bashkuara janë të bazuara." Kështu u veprua duke iu shmangur çdo gjëje metafizike, në mënyrë që të miratohej nga besimtarët dhe jobesimtarët. Sipas delegacionit të Arabisë Saudite, deklarata ishte e bazuar gjerësisht në modelin perëndimor të kulturës. Mirëpo, nuk kishin mendim të njëjtë vendet tjera islamike, veçanërisht Pakistani, Siria dhe Egjipti.[5]

[4] Shih Krzystof Drzewicki, Ndërkombëtarizmi i të Drejtave të Njeriut dhe Legalizimi i tyre, në: Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, botuar nga Raija Hanski & Markku Suksi, Prishtinë, 2001, f. 40.

[5] Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, botuar nga Gudmundur Alfredssson & Asbjorn Eide, Prishtinë, (pa vit botimi), f. 55-61.

Me rastin e shpalljes së Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, më 10 dhjetor 1948, ajo u miratua njëzëri, sepse për të votuan 48 shtete, ndërkaq 8 shtete abstenuan. Ndër shtetet që abstenuan ishte edhe Arabia Saudite.[6] Është me rëndësi të theksohet se, vendet e tjera islame kanë votuar pro Deklaratës. Arsyet kryesore të abstenimit, nga ana e Arabisë Saudite, ishin dy:

a. Mbrojta e dinjitetit të njeriut në Islam, pavarësisht nga dallimet mes njerëzve, rrjedh nga legjislacioni hyjnor, e jo nga ligjet sekulariste, sepse ligji hyjnor ka ndikim më të fortë se cilido ligj tjetër;

b. Delegacioni saudit shprehu rezerva në adresë të disa pikave të Deklaratës së Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë rezultat i asaj se, Islami ka logjikë të veçantë në rrafshin e mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe lirisë dhe ruajtjes së paqes, mes gjithë njerëzve.[7]

Karta e OKB-së nuk i përkufizon të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, as që ka ndonjë dispozitë që do të obligonte respektimin e tyre. Ajo nuk ka paraparë që të ngrihet një mekanizëm me sanksione adekuate për implementimin e të drejtave në praktikë. Kjo edhe mund të kuptohet kur dihet se përpilimi i Kartës u bë duke iu shmangur çështjeve kontraverse.

Si pasqyrim i kompromisit të arritur në Konferencën e San Franciskos më 1945, klauzolat për të drejtat e njeriut në Kartë, tregojnë shenja të ambivalencës dhe paqartësive.[8]

Megjithatë, rëndësia e kësaj karte qëndron në atë se, ajo ofron një koncept të përgjithshëm për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kërkon bashkëpunim ndërkombëtar për respektimin e tyre. Neni 55 (c), nënvizon detyrën e KB-së, që të angazhohet për respektimin e plotë dhe efektiv të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore,

[6] Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, (botues Universiteti i Prishtinës) Prishtinë 2002, f. 35.

[7] Dijalog Islamskih i Evropskih Ucenjaka, Sarajevë, 1979, f. 36.

[8] Krzystof Drzewicki, në: Ndërkombëtarizmi i të Drejtave të Njeriut dhe Legalizimi i tyre, op. cit., f. 83.

si mjet për të krijuar kushtet, që do të siguronin stabilitet dhe mirëqenie, si parakushte të domosdoshme për marrëdhënie paqësore dhe miqësore midis popujve.[9]

Konventa Evropiane, ka rëndësi shumë të madhe, ngase është dokumenti i parë, që rregullat deklarative, krejt ndryshe nga Karta e OKB-së, i ka shndërruar në rregulla kontraktuese (u ka dhënë karakter të detyrueshëm); ka paraparë një mekanizëm, i cili do të siguronte zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut[10], ndërmjet shumë subjekteve të një regjioni dhe në fund se hyrja në Këshillin e Evropës kushtëzohet me respektimin e të drejtave të njeriut. Shkalla e demokracisë në ndonjë vend, matet qartë me qëndrimin e pushtetit ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.[11] Edhe në Konventën Evropiane është shmangur të referuarit në Hyjni ose çfarëdo gjëje metafizike.

Arsyeshmëria e të drejtave sipas këndvështrimit islam

Për të kuptuar largpamësinë e të drejtave në Islam, është e nevojshme të theksojmë se të drejtat e njeriut në Islam, janë pjesë përbërëse e vizionit integral që myslimani ka ndaj Zotit, universit dhe njeriut. Kjo do të na ndihmojë që të përcaktojmë dimensionet e këtyre të drejtave, specifikën dhe ndikimin e tyre në jetën e njeriut.[12]

[9] Zejnulla Gruda, op. cit., f. 365

[10] Ai mekanizëm fillimisht përbëhej nga dy organe: Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndërkaq që nga viti 1998, bëhet anulimi i Komisionit dhe Gjykatës për të Drejtat e Njeriut dhe krijohet një Gjykatë e vetme permanente Evropiane për të drejtat e Njeriut, me gjyqtarë të angazhuar me orar të plotë pune, e cila do të veprojë si një hallkë e vetme në Strasburg, shih Zejnullah Gruda, Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, op. cit., f. 69, & Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike, Tiranë, 2002, f. 224-226

[11] Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, është miratuar më 4 nëntor 1950. Ajo ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953, pasi që e kanë ratifikuar 10 shtete anëtare të Këshillit Evropian., shih: Zejnullah Gruda, op. cit., f. 53.

[12] Dijalog Islamskih i Evropskih Ucenjaka, op. cit., f. 77.

Të drejtat e njeriut në Islam janë të rrënjosura thellë në të kuptuarit se Zoti, dhe vetëm Zoti, është autor i Ligjit dhe se Ai është burim i të gjitha të drejtave njerëzore.

Njeriu, që nga lindja, është i lirë dhe i barabartë me të tjerët. Të gjithë njerëzit janë lindur nga i njëjti paraardhës dhe kanë të njëjtën natyrë.

Nuk mund të mohohet se njerëzimi, përgjithësisht, dallon në bazë të gjuhës dhe ngjyrës, mirëpo ky ndryshim nuk ndikon në barabarësinë e tyre dhe qenësinë e njëmendët njerëzore.[13]

Shkolla e së drejtës natyrore

Qenia njerëzore është vlerë në vetvete dhe çdo qenie njerëzore meriton dinjitet që rrjedh nga e drejta natyrore. Tradita e konceptit të së drejtës natyrore daton nga kohërat antike dhe gjendet në filozofinë e stoikëve dhe Aristotelit. Ajo u vazhdua më tutje në kohërat e Mesjetës nga Toma Akuini. Ajo është pasuar nga përpjekje për t'u pajtuar me natyrën racionale të qenieve njerëzore si burime të së drejtës natyrore dhe rrjedhimisht me të drejtat e njeriut.[14] Ajo ka përkrahës edhe midis juristëve të sotëm. Natyralistët e kanë mohuar ekzistimin e çfarëdo të drejte pozitive të popujve, madje edhe si pasojë e zakoneve ose traktateve.

Për natyralistët, e tërë e drejta e popujve është pjesë e së drejtës natyrore, rregullat e së cilës janë të lidhura me arsyen e njeriut, duke i kuptuar në mënyrë idealiste, të përjetshme, të pandryshueshme dhe të njëjta për të gjithë popujt.[15] Nën ndikimin e shkollës së të drejtës natyrore, të drejtat e njeriut trajtohen si të drejta të përcaktuara me 'ligj hyjnor' ose me 'ligj të Zotit', i cili është i rrënjosur në zemrën e çdo

[13] Muhammed El Gazali, Hukukul Insani, bejne talimil islami ve ilanil umemil mutehideh, Kairo, 1422/2002, f. 13.

[14] Shih Jarzy Zajadlo, Dinjiteti Njerëzor dhe të Drejtat e Njeriut, në: Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, op. cit., f. 23.

[15] Përfaqësuesit më të fortë të kësaj shkolle kanë qenë filozofi anglez Thomas Hobbes (1588-1679), gjermani Samuel Pufendorf (1632-1649) dhe zvicerani Jean Barbeyrac (1674-1744), shih: Zejnullah Gruda, op. cit., f. 39.

njeriu dhe i cili detyron të bëjë krejt çka i përgjigjet natyrës racionale të njeriut, dhe të rezervohet nga ajo që e dëmton, (Thomasius, Institutiones iurisprudentiae divinae). Në këtë grup bëjnë pjesë e drejta e jetës, e lirisë, e sigurisë dhe e barazisë. Më vonë u është shtuar e drejta që t'u rezistojnë shtypësve dhe të kërkojnë lumturinë[16]

Shkolla e së drejtës pozitiviste

Pozitivistët, jo vetëm që e mbrojnë ekzistimin e së drejtës pozitiviste të popujve, si pasojë e zakoneve dhe e traktateve ndërkombëtare, por e konsiderojnë edhe si më të rëndësishme se të drejtën natyrore të popujve, të cilën disa madje e mohojnë. Disa nga pozitivistët e njohin ekzistimin e së drejtës natyrore, por përpiqen t'ia zvogëlojnë vlerën, duke e konsideruar ndonjëherë pak a shumë moral.[17]

Shkolla marksiste

Marksistët thonë: E drejta është vullnet i klasës sunduese, i shndërruar në ligj. "E drejta është tërësia e rregullave të sjelljes, që shprehin vullnetin e klasës sunduese… Zbatimin e atyre rregullave e bën pushteti i dhunshëm shtetëror me qëllim sigurie, përforcimi e zhvillimi të marrëdhënieve shoqërore dhe gjendjeve që i konvenojnë dhe i përshtaten klasës sunduese."[18]

Pavlovi, përfaqësuesi sovjetik në OKB, mendonte se teoria se të gjithë njerëzit kanë lindur të lirë dhe të barabartë është disi e paqëndrueshme. Sipas tij, barabarësia e të drejtave para ligjit është e "determinuar jo me faktin e lindjes, por me strukturën shoqërore të shtetit. Prandaj, ishte e qartë se në kohën e feudalizmit njerëzit nuk janë lindur të lirë dhe të barabartë." Mirëpo, mendimi i tij u kundërshtua me

[16] ibid, f. 363.

[17] Përfaqësuesit më të rëndësishëm të shkollës pozitiviste janë anglezi Richard Zouche (1590-1660), holandezi Cornelius van Bynkershoeck (1673-1743), gjermani Johan Jakob Moser (1701-1785), ibid, f. 40.

[18] A. Vishinski, Detyrat kryesore të shkencës për të drejtën socialiste sovjetike, 1983, shih: Alija Izetbegoviç, Islami Ndërmjet Lindjes e Perëndimit, Logos-A, Shkup, 2000/1421, f. 264.

mendimin se "njerëzit janë të lindur të lirë, ata janë qenie njerëzore të lira dhe të barabarta, e drejtë e cila është e tyre që nga lindja, edhe pse ata këto atribute mund t'i humbin më vonë".[19]

Dhe vërtet, komunistëve dhe socialistëve iu dha rasti që ta tregojnë në praktikë se ku shpie një e kuptuar e tillë e së drejtës.

Sipas këtij definimi, që i bëjnë marksistët, këtu s'ka të drejta e të padrejta, drejtësi e padrejtësi, moral dhe imoral. Është fjala vetëm për interesin, që në këtë rivalitet forcash u tregua më i fuqishëm. Nëse është e drejta vullnet i klasës sunduese, atëherë ç'parime shkelën ardhacakët e bardhë në Amerikë kur indogjenëve ua pushtuan hapësirën e i zhdukën? Nëse është e drejta vullnet i klasës sunduese, ç'parime shkelën kapitalistët, në kohën të cilën Marksi e përshkruan si periudhë fillestare e akumulimit të kapitalit, meqë ata ishin klasë sunduese dhe meqë shfrytëzimi i klasës punëtore ishte vullnet i tyre, do të thotë ata s'bënin dhunë, por kishin të drejtë! Do të dilte se punëtorët që kundërshtonin eksploatimin nga klasa kapitaliste s'kishin të drejtë, sepse vepronin kundër atij të famshmit "vullnet të klasës sunduese".[20]

Klasikët e marksizmit dhe të proletariatit, të drejtave të njeriut ua kanë shtuar dimensionin social, duke pretenduar të likuidojnë pabarazinë shoqërore, ngase pa këtë, shumë nga të drejtat e shpallura, kanë më tepër karakter formal sesa karakter qenësor.[21]

E Drejta Hyjnore Islame

Në përputhje me Islamin, të drejtat themelore dhe liritë publike, janë pjesë integrale të besimit dhe fesë islame. Askush nuk ka të drejtë, t'i ndalojë ato plotësisht apo pjesërisht, t'i shkelë, apo t'i injorojë ato. Të drejtat themelore janë Hyjnore dhe Qiellore dhe ato janë përcjellë prej pejgamberëve të Zotit në të gjitha Librat e Shenjta. Në të vërtetë, Allahu i Madhëruar e autorizoi Muhammedin a.s, Pejgamberin e Tij të fundit, dërguar mbarë njerëzimit, i cili përmbylli misionet

[19] Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut, op. cit., f. 59.
[20] Alija Izetbegoviç, op. cit., f. 265.
[21] Zejnulla Gruda, op. cit., f. 363

dhe mesazhin e të gjithë pejgamberëve dhe të dërguarve të mëparshëm, me këto të drejta themelore.[22]

Për myslimanët e drejta islame burimin e saj e ka te Shpallja Hyjnore reveluar Pejgamberit Muhammed a.s. sipas së cilës duhet të veprojë individi dhe gjithë njerëzimi. Sheriati përfshin porosi të shpallura nga Zoti, që kanë të bëjnë edhe me sferën shpirtërore edhe me sferën profane (shekullare) të jetës. Sheriati ndahet në dy pjesë. Njëra qeveris me zemrën dhe shpirtin (dogma dhe moraliteti individual), kurse pjesa tjetër përshkruan raportin e njeriut ndaj Zotit, ndaj vetvetes dhe të tjerëve. Pjesa e dytë është e njohur si fikh që do të thotë, se jurisprudenca islame rregullon veprat publike të individëve ndaj Zotit, vetë atyre dhe ndaj personave të tjerë.[23]

Ekzistojnë tre sisteme më të rëndësishme juridike: e drejta romake, anglosaksone dhe islame. Në proceset e sistemit juridik romak dhe atij islam, ka ekzistuar "e drejta e profesorit", kurse në rastin e ligjit anglikan "e drejta e gjykatësit."[24]

Nga ajo që është thënë deri më tani, mund të konstatojmë se kemi dy lloj të së drejtës:

1. E drejta e përcaktuar nga Zoti, e drejta e shpallur; dhe
2. E drejta e zhvillimit perëndimor, e drejta ligjore e miratuar nga parlamenti.

E Drejta Islame, sikurse kemi përmendur është "e drejta e profesorit", do të thotë, e drejtë të cilën teologët dhe juristët islamë e kanë zhvilluar nga dispozitat e Kur'anit. Ajo i flak 'ligjet', normat e përgjithshme, si burim i së drejtës, të sjella nga Pushteti apo ndonjë parlament.[25]

Megjithatë, pushteti islam nuk është as tirani, as pushtet absolutist, por është pushtet kushtetues i bazuar në mendimin e shumicës, në

[22] Shih Deklaratën mbi të Drejta e Njeriut në Islam, të aprovuar nga Konferenca Islamike e XIX e Ministrave të Punëve të Jashtme e mbajtur në Kajro, nga 31 korrik deri më 5 gusht 1990, (14 Muharrem 1411 hixhri), në adresën: http://www1.umn.ed/humanrts/NSTREE/AIRODECLARACION.html.&
[23] Sayed Hassan Amin, Pavni Sistemi Srednjeg Istoka, Sarajevë, 1988, f. 33.
[24] Murad Hofmann, Islami si Alternativë, Furkan ISM, Shkup, 1421/2000, f. 151.
[25] Christian H. Hoffmann, op. cit., f. 193.

përputhshmëri të plotë me parimet kur'anore dhe me traditën e Muhammedit a.s. Prandaj, lufta e gjatë e Kishës dhe shtetit, që u zhvillua në Perëndim, është tërësisht e huaj për mendimin islam.

Raporti ndaj të drejtave të njeriut qëndron apo bie me besimin në Zot. "Ligji Islam veten e konsideron ligj të shpallur në kuptimin më të ngushtë të fjalës, gjegjësisht ligj autentik Hyjnor.[26]

Jam plotësisht kundër pretendimit të dr. Bassam Tibit, prof. i së Drejtës Ndërkombëtare, në Universitetin e Gotingenit në Gjermani, i cili thotë se Deklarata Islame për të drejtat e njeriut e vitit 1981, ka për qëllim krijimin e të drejtave specifike islame të njeriut dhe kështu, në mënyrë implicite, të ndajë civilizimin islam nga pjesa tjetër e njerëzimit.[27]

Të drejtat, sipas Islamit, njeriu i gëzon me të lindur. Ato janë të pacenueshme, të patjetërsueshme dhe të paparashkrueshme, sepse janë të dhëna nga Krijuesi.

Në Islam, vullneti individual i nënshtrohet vullnetit Hyjnor dhe ka supremaci të interesave të përgjithshme kundruall interesave personale.

Sipas së drejtës islame, individi ka "detyra ndaj familjes së tij, shoqërisë, shtetit, komuniteteve tjera të njohura ligjërisht, ndaj komunitetit ndërkombëtar dhe ndaj Krijuesit."

Islami dhe demokracia

Prej Kur'anit mund të nxirren tre elementë, sa i përket organizimit të shtetit:

1. Parimi presedencial, kryetari i shtetit (halifi, ose emiri), e jo komiteti apo politbyroja duhet të qëndrojë në krye të shtetit. Ai funksionon si trashëgimtar i Pejgamberit a.s., e jo si 'përfaqësues i Zotit' sipas kuptimit papnor.[28]

[26] Ibid, f. 151, 152.
[27] Shih dr. Bassam Tibi, Ljudska Prava u Islamskoj Civilizaciji i na Zapadu, në: Ekmeleddin Ihsanoglu (dhe një grup ligjëruesish), Zapad i Islam Ka Dijalogu, el Bejan, Sarajevë, 2001, f. 63 e tutje.
[28] Dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 120

2. Parimi i këshillimit, në pajtim me të cilin pushteti ekzekutiv dhe ligjvënës, duhet zbatuar në bazë të marrëveshjes dhe këshillimit (shura-s).
   Sipas legjislacionit islam, pushteti i kreut të shtetit është i kufizuar dhe pushteti i tij buron nga 'mubajja'-miratimi i popullit, i cili në kushtet e sotme do të mund të realizohej me plot sukses përmes referendumit, e jo nga pohimi se ai është trashëgimtar i Zotit në Tokë.[29]
3. Parimi i Islamit si fe shtetërore: ***"O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit tuaj. Por, nëse nuk pajtoheni në ndonjë çështje, atëherë drejtohuni All-llahut*** *(Librit të Tij)* ***dhe të Dërguarit, nëse i besoni All-llahut dhe Ditës së fundit. Ajo është më mirë dhe më i bukuri shpjegim."*** *(Kur'ani: En Nisa, 59)*

Në Islam, pushteti ligjdhënës i takon vetëm All-llahut dhe vetëm Atij i takon të sjellë ligjin. Askush nuk ka të drejtë të sjellë ligje, përveç Ligjdhënësit Hyjnor. Kurse sa i përket atij, që është në krye të shtetit, kërkohet që ai të jetë mysliman dhe që ligjvënia e tërësishme të jetë e bazuar në Kur'an, si ligji më i lartë i tokës apo 'kushtetutës' së tij, njëherësh duke mbajtur llogari për pakicat jomyslimane.[30]

Muhamed Asadi sqaron se shteti ideal islam, është shtet ku sundon ligji, republika parlamentare me rregullim, që do të mund të korrespondonte me rregullimet perëndimore në nivelet themelore (të drejtat e njeriut, pluralizmi partiak, mbrojtja e pakicave) përderisa mbetet e sigurt se kryetari i shtetit do të jetë mysliman, Islami të jetë fe shtetërore dhe Kur'ani norma më e lartë kushtetuese.[31]

Krishterimi, duke u kënaqur vetëm me përfaqësimin moral, duke iu këshilluar ithtarëve të vet që mbretit t'ia japin të tijën, e ka kufizuar thirrjen e vet universale në sferën shpirtërore. Ndërkaq, Islami duke

[29] Dr. Vehbe Ez Zuhejli, Hakul Hurrijeti fil Alem, Damask, 2000, f. 172.
[30] Dr Murad Hofmann, op. cit., f. 121.
[31] Muhamed Asad, Parimet e shtetit dhe qeverisë në Islam, cituar nga Murad Hofmann, op. cit., f. 122.

përmbushur atë që nuk arriti Krishterimi, ka nxjerrë para botës vizionin e organizimit politik, në të cilin vetëdija për Zotin ka qenë burimi kryesor i mirësjelljes praktike të njeriut dhe themeli i vetëm i të gjitha institucioneve shoqërore. Qëllimi ka qenë konstituimi i teokracisë në raport me Zotin dhe demokracisë ndërmjet njeriut dhe njeriut.[32]

Tërthorazi, nga këto tre parime, mund të nxjerrim edhe të katërtin, parimin e demokracisë. Nga ana tjetër, demokracia islame nuk nënkupton sovranitetin e pakufizuar të njerëzve. Sikurse çdo parlament tjetër, edhe parlamenti islam duhet të ketë parasysh rregullimin, gjegjësisht normat kur'anore, sheriatin në kuptimin më të ngushtë. Ndërkaq, do të ishte i lirë organizimi i shtetit, sistemi ekonomik, sistemi i kodit penal etj., pasi që Kur'ani lejon fleksibilitet maksimal në këto gjëra.[33]

Dallimi ndërmjet demokracisë perëndimore, dhe Islamit, qëndron në atë se:

Sovraniteti, në demokracinë perëndimore, u takon njerëzve, ndërkaq, në Islam, sovraniteti i atribuohet Zotit (el hakimijetu lil-lah) dhe njerëzit janë mëkëmbës (halif) të Tij në tokë.

Në të parën, njerëzit janë ata që i bëjnë ligjet e veta, ndërkaq, në të dytën njerëzit janë të detyruar që t'i ndjekin dhe t'u binden ligjeve të dhëna nga Zoti, dhe të përcjella nëpërmjet të Dërguarit të Tij, Muhammedit a.s.

Në të parën, pushteti është absolut dhe vepron për ta kënaqur vullnetin e njerëzve. Ndërsa në Islam pushteti është relativ dhe njerëzit duhet të zbatojnë vullnetin e Zotit.[34]

Pavarësisht nga rezervat, që tregojnë shumë dijetarë myslimanë kundrejt termit demokraci, duhet të theksojmë, sikurse thekson edhe M. Hofmann se, demokracitë janë më të afta për zgjidhjen e problemit

[32] Muhammed Asad, Rruga për në Mekë, Logos A, Shkup, 2003, f. 406.
[33] Dr Murad Hofmann, op. cit., f. 121.
[34] Shih: Ebul Ala El Mevdudi, Të Drejtat e Njeriut në Islam, Shkup 1413/ 1992, f. 11. & Abdul Hasan Beni Sadr, Kur'ani dhe të Drejtat e Njeriut. Boton Atik, Gjilan 1994, & dr. Vehbe Zuhejl, op. cit., f. 172.

themelor të çdo shteti: quis custodiet (kush do të kontrollojë kontrolluesit?) meqë procesi demokratik është procesi i vërtetuar si më i përshtatshëm në pengimin e keqpërdorimit të autorizimeve. Shoqëria islame duhet të ballafaqohet me problemin e kontrollit, sepse mbretëria ideale e vlerave të aplikuara kur'anore, me të vërtetë, nuk mund të gjallërojë pa institucione shtetërore.[35]

Historiku i të drejtave në Islam

Islami na mëson se çdo njeri, pavarësisht nga vendi, feja, ngjyra, gjinia, shtresa shoqërore, thjesht për faktin se ai është qenie njerëzore, i gëzon të drejtat e tij të patjetërsueshme. Qëllimi i këtyre të drejtave është të treguarit e nderit dhe dinjitetit mbarë njerëzimit, anulimi i eksploatimit, shtypjes dhe padrejtësisë.

Islami, të drejtat e njeriut i ka sanksionuar me ligj, dhe ka siguruar mbrojtjen e tyre duke proklamuar se, njeriu gëzon të drejta të patjetërsueshme dhe detyra të obligueshme, pa marrë parasysh gjendjen dhe pozitën e tij, për vetë faktin e të qenit njeri.[36]

Ligjet, të cilat i vendos një pushtet, mund t'i anulojë vetëm ai pushtet, ose një pushtet më i lartë, e assesi më i ulët: Shpalljen e All-llahut mund ta anulojë vetëm një shpallje tjetër e Tij, Shpallje e re. Gjithashtu një udhëzim të Pejgamberit a.s. mund ta ndërrojë vetëm ai ose All-llahu xh.sh. dhe askush tjetër. Mirëpo, kjo teori, në shikim të parë e ashpër, në Islam bëhet mjaft elastike, duke i lënë mjaft hapësirë njerëzve që t'u përshtaten kërkesave në çdo situatë.[37]

Legjislacioni hyjnor islam, është i pandryshueshëm dhe i gjithmonshëm, sepse Ai, që e dhuroi atë, është i Pavdekshëm dhe i Përjetshëm. Ai është Krijuesi, që krijoi njerëzit dhe caktoi për ata atë, që do t'u përgjigjej nevojave të tyre deri në fund të kohës.

"A nuk di Ai që ka krijuar dhe që njeh çdo send në hollësi"
(Kur'ani: El Mulk, 14)

[35] Dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 123.
[36] Ebul Ala El Mevdudi, op. cit., f. 13.
[37] Shih Dr. Muhammed Hamidullah, Hyrje në Islam, Tiranë, 1993, f. 143.

Historiku i të drejtave të njeriut në botën perëndimore

Bota perëndimore mburret me historinë e të drejtave të njeriut. Ajo zëshëm pohon, se koncepti i parë i të drejtave elementare të njeriut, rrjedh nga Magna Carta e Britanisë. Shkurtimisht, historiku i të drejtave të njeriut është:

1. Karta e Madhe e Lirive (Magna Charta Libertatum), viti 1215.
2. Ligji për të Drejtat (Bill of Rights), viti 1689;
3. Deklarata Amerikane e Pavarësisë, viti 1776, dhe
4. Deklarata Franceze për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarëve, viti 1789.[38]

Në Perëndim, Magna Charta, prej vitit 1215, kremtohet si dokument i madh, i cili, me shkrim, vërteton sigurinë juridike të të gjithë (atëbotë) "të lirëve" dhe, po ashtu, e obligon edhe mbretin, që t'u përmbahet ligjeve valide.

Ndërkaq, Kur'ani të cilin myslimanët e pranojnë si një bazë juridike, i obligoi të gjithë njerëzit, pa përjashtim, t'u përmbahen dispozitave të dhëna prej tij dhe atë, rreth 600 vjet para Magna Chartas.

Ndërkaq, njerëzit në Perëndim, këto të drejta, i kanë përmbledhur prej njerëzve të tjerë dhe për këtë gjë u deshën 1776 vjet.[39]

Islami me urtinë e tij, tolerancën, fleksibilitetin dhe aspektet e tij thellësisht humane është gjithnjë vital dhe mund t'i përcjellë të gjitha periudhat e zhvillimeve të dobishme.

Koncepti islam mund të interpretohet, si arritje e paqes, duke iu dorëzuar vullnetit të Zotit, dhe duke iu përmbajtur Ligjit të Shenjtë e udhëzimeve të tij. Ky punim ka për qëllim të provojë se ligji islamik posedon tërësinë e duhur të parimeve, që janë të domosdoshme për transformim dhe zhvillim të shoqërisë. Në bazë të Kur'anit janë të garantuara të drejtat në vijim: jeta, integriteti personal, liria, trajtimi i barabartë-mosdiskriminimi, liria e ndërgjegjes, martesa, të hetuarit legal,

[38] Zejnullah Gruda, op. cit., f. 8.
[39] Christian H. Hoffmann, op. cit., f. 41.

Supozimi i pafajësisë, mosdënimi pa ligj (nulla poena sine lege), mbrojtja nga mundimi, e drejta e azilit etj.[40]

Sipas Islamit liritë dhe të drejtat duhet t'u njihen të gjithëve, pa dallim në bazë të fesë, bindjes politike, gjuhës, racës, seksit, ngjyrës, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë etj.[41]

Deklarata Islame Universale (e Parisit)[42] dhe Deklarata Islame (e Kajros)[43] për të Drejtat e Njeriut për mentalitetin perëndimor duket paksa e pazakontë shkaku i njohjes së detyrave të individit krahas me atë të të drejtave. Ndërkaq, Konventa Amerikane dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk shënon detyrat e individit.

Dallimet ndërmjet të Drejtës islame dhe të Drejtës Evropiane janë:

1. Ndalimi i martesës së myslimanes me jomyslimanin; 2. Ndalimi i braktisjes së fesë islame (apostazia- irtidad ose ridde); 3. Qytetarët jomyslimanë në vendet islame nuk mund të ushtrojnë funksionin e kryetarit të shtetit; dhe 4. Dënimi me vdekje.

[40] Shih dr. Murad Hofmann, op. cit., f. 165 & Krahaso me Tekstin e Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut, në: Mark W. Janis, Richard S. Kay dhe Anthony W. Bradley, E Drejta Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Prishtinë, 2002, nga f. 586 deri në faqen 590.
[41] Shih Dr. Vehbe Ez Zuhejli, op. cit., f. 34-35. & Revista, Rabitatul Alemil Islami, Hukukul Insani fil Islam, Mekë, 1979, f. 102-103.
[42] Kuvendi Islamik për Evropë në Paris më datë 21 Dhul Ka'de 1401/19 shtator 1981 ka shpallur Deklaratën Islame Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila bazohet në Kur'an dhe Sunet dhe është përpiluar prej studiuesve eminent musliman, juristëve dhe përfaqësuesve të lëvizjeve dhe mendimit Islamik. Shih http://www. alhewar.com/ISLAMDECL .html.
[43] Shih Deklaratën (e Kajros) mbi të Drejtat e Njeriut në Islam, http://www1.umn.ed/humanrts/INSTREE/AIRODECLARACION.html & Ajni Sinani, Të Drejtat e Njeriut në Islam, Takvimi, 1425/26, Kalendar, (botues: B.I.K.) Prishtinë 2005.

1. Ndalimi i martesës së myslimanes me jomyslimanin

Sipas Konventës Evropiane mashkulli dhe femra janë të barabartë, sidomos para ligjit dhe në bashkëshortësi. Vendet myslimane këto formulime mund t'i ratifikojnë me rezervë.

E drejta islame nuk diskriminon femrën në krahasim me mashkullin. Por mendon se e ndryshmja duhet trajtuar ndryshe, e ajo që është njëjtë duhet trajtuar njësoj. Teoritë perëndimore mohojnë dallimet ndërmjet meshkujve dhe femrave.

Sipas Islamit gruaja është biologjikisht, pra edhe fizikisht dhe psikikisht më ndryshe nga burri. Gruaja dhe burri kanë pozitë të njëjtë, por detyra të ndryshme: ata kanë vlerë të njëjtë, por aftësi të ndryshme: të barabartë para Zotit, por kanë role të ndryshme në jetë.[44]

Burrat dhe gratë duhet të jenë plotësues të njëri-tjetrit, në një organizim multi-funksional, më mirë sesa të konkurrojnë me njëri-tjetrin, në një shoqëri uni-funksionale.

Feminizmi, siç paraqitet në shoqërinë perëndimore, përgjithësisht e ka mohuar çfarëdo diferencimi të tillë dhe ka kërkuar një lëvizje drejt një shoqërie uniseksuale, me qëllim që të arrihen të drejta të barabarta për gratë. Me "shoqëri uniseksuale", duam të themi një shoqëri, në të cilën parapëlqehet dhe respektohet një formë e vetme e roleve dhe e punëve, prej të dy gjinive dhe (ajo formë) synohet prej të gjithë anëtarëve të shoqërisë, pavarësisht prej dallimeve të moshës dhe të gjinisë.[45]

Islami i ngriti gratë prej pozitës indiferente dhe përçmuese në atë të partnereve të barabartë në martesë me mashkullin. Prej një pozite të një mosqenieje ligjore, ajo u bë një personalitet ligjor në kuptimin e plotë të fjalës e aftë për të mbajtur pronën, me pasjen e së drejtës për të pasur pjesë të drejtë të pasurisë trashëguese të familjes dhe burrit të saj. Gruaja, sipas Islamit, mund të ketë një rol të barabartë me atë të një burri, aq sa e lejojnë karakteristikat e saj të veçanta fizike.

[44] Murad Hofmann, op. cit., f. 182.
[45] Lois Lamya al Faruqi, Women Muslim Society and Islam, Indianapolis, 1991, f. f.25

Në fenë islame nuk ekziston koncepti i fajësisë së mëkatit fillestar mbi gratë. Larg prej idesë, se djalli e tundoi Evën, në rolin e saj si gruaja e parë, Kur'ani e vendos fajësinë për mosbindje në Parajsë si mbi Ademin ashtu edhe mbi gruan e tij.[46] Ata të dy (Ademi dhe z. Hava) u penduan dhe kërkuan falje. Zoti i fali ata dy: (Kur'ani: El Araf, 20-25; Ta Ha, 121). Gjithashtu, gruaja është nëna e të gjithë burrave dhe roli i saj nuk përmban konotacione përbuzëse.[47]

Juristët perëndimorë kanë rezerva ndaj ndalesës së martesës së myslimanes me jomyslimanin, që bie ndesh me nenin 16- të, të "Deklaratës mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave".[48]

Sipas kësaj Deklarate, çdo mashkulli dhe femre, kur ata arrijnë moshën madhore, u njihet e drejta e martesës dhe fejesës, pa marrë parasysh fenë. Ndërkaq, duhet të theksojmë se logjika islame nuk niset nga pikëpamja e kufizimit të lirisë në të drejtën martesore, por nga obligimi i ruajtjes së familjes nga shkatërrimi, gjë që do të shkaktohej për shkak të mosrespektimit nga bashkëshorti jomysliman të dispozitave fetare të bashkëshortes myslimane.[49]

Nga kjo rrjedhin tre situata vijuese:

a. Islami e ndalon martesën e myslimanit me idhujtare, ose pabesimtare. Kjo është për arsye se, myslimani nuk mund të respektojë bindjet dhe traditat e bashkëshortes së tij idhujtare ose pabesimtare, gjë që do të çonte në prishjen e familjes dhe së fundi në divorcim. Islami, shkurorëzimin e sheh si gjënë e lejuar më të urryer nga Zoti, prandaj edhe nuk e stimulon atë. Prandaj, sipas Islamit, është e ndaluar një martesë e tillë.

[46] Dr. Beqir Topallogllu, Gruaja në Islam, Stamboll, 2000, f. 13, 14.
[47] Madje i Dërguari i Zotit, Muhammedi a.s.thotë: "Xhenneti është nën këmbët e nënës."
[48] Në nenin 16 thuhet: "Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në të gjitha çështjet që rrjedhin nga martesa dhe në marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë ata i sigurojnë gruas, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas: a) Të njëjtën të drejtë për të lidhur martesë; b) Të njëjtën të drejtë të zgjedhë lirisht bashkëshortin dhe të lidhë martesë vetëm me pëlqimin e vet të lirë dhe të plotë…" shih Deklarata mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave, Tiranë, 1994, neni 16, f. 20.
[49] Dijalog Islamskih i Evropskih Ucenjaka, op. cit., f. 40.

b. Islami e ka lejuar martesën e myslimanit me femrën e krishterë ose çifute, sepse Islami e respekton Isain a.s. (Jezusin), si të dërguar të Zotit, i cili ka lindur në mënyrë të jashtëzakonshme, dhe respekton edhe nënën e tij, Merjemen (Marinë) dhe e mbron atë nga shpifjet e ndryshme. Islami respekton edhe Musain a.s. (Mojsiun) dhe e konsideron atë të dërguar të Zotit, për popullin çifut. Prandaj, bashkëshortja e krishterë, apo ajo çifute, të cilat respektojnë fenë e tyre dhe dëshirojnë që edhe më tej (pas martese) të mbesin në fenë e tyre mund ta bëjnë një gjë të tillë dhe nuk do të gjenin asgjë, nga bashkëshorti ose nga familja e tij, që do ta largonte atë nga feja e saj e mëparshme dhe nuk do t'u nënshtrohej pakënaqësive, grindjeve apo asaj më të keqes, ndarjes.

c. Islami e ka ndaluar martesën e jomyslimanit, të krishterit ose çifutit, me femrën myslimane, sepse bashkëshorti jomysliman, i krishterë, ose çifut, nuk e beson Muhammedin a.s. si të dërguar të Zotit. Ata kanë paragjykime për Islamin dhe të dërguarin e tij.

Prandaj, duke u nisur nga një qëndrim me platformë të pastër humane, është logjike që në Islam të jetë e ndaluar lidhja e martesave me karakter të tillë, sepse është e sigurt se në një atmosferë të tillë nuk do të ketë respektim të vlerave islame, gjë që pashmangshëm do të sjellë mospajtim, kontradikta dhe në fund ndarje. Islami dëshiron familje të fortë, prandaj llogarit që, në bazat e tij, të mos ketë marrëdhënie jostabile bashkëshortore.[50]

[50] Ibid, f.41.

2. Ndalimi i braktisjes së fesë islame

Në pajtim me ligjin islam, për myslimanët nuk ekziston e drejta për ndërrimin e fesë. Sipas interpretimit klasik të Sheriatit, për lënien e fesë, apostazinë (irtidad ose ridde), myslimani dënohet me vdekje, gjë që nga shumë perëndimorë është komentuar si mungesë e lirisë së ndërgjegjes në Islam, dhe që bie ndesh me nenin 18, të "Paktit ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike"* që ia njeh secilit njeri të drejtën e ndërrimit të fesë.[51]

Për ta sqaruar këtë problem, të themi, para së gjithash, disa fjalë mbi konvertimin. Kur'ani thotë: ***"Në fe nuk ka dhunë"*** *(Kur'ani: El Bekaretu, 256)*. Në shumicën e periudhave të historisë islame nuk ka pasur konvertim të dhunshëm të "Popujve të Librit*" në Islam. Konvertimi i dhunshëm është ofendim për Zotin dhe nëpërkëmbje e dinjitetit dhe ndërgjegjes së njeriut, që Zoti ia ka dhuruar atij. Arabia në kohën e shpalljes së Kur'anit përbënte përjashtim. Arabëve paganë të atëhershëm, të cilët me të madhe predikonin një formë të vrazhdë të politeizmit, u ishte dhënë zgjedhja: ose të bëheshin myslimanë ose do të përballeshin me luftë. Ishte kjo një zgjedhje shumë e ngjashme me atë, që të krishterët qenë ofruar 'paganëve' evropianë në kohën kur Krishterimi kishte fuqinë mbi atë kontinent. Ndërkaq, ata që ishin ithtarë të librit, të krishterët dhe hebrenjtë, nuk qenë detyruar të bëheshin myslimanë, por mund ta praktikonin fenë e tyre.[52]

* Delegacioni saudit pati shprehur rezerva, me rastin e votimit të 'Paktit ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike' e cila është miratuar nga Asambleja e përgjithshme më 16 dhjetor 1966, kurse ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976.

[51] "Çdo njeri ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij…", shih: Pakti ndërkombëtar lidhur me të drejtat civile dhe politike, Tiranë, 1994, neni 18, f. 13.

* Kur'ani të krishterët dhe çifutët i quan "Ithtarë, popuj të Librit", kjo do të thotë se Islami këto fe jo vetëm që i ka toleruar por edhe ka pranuar se në fillim këto fe kanë patur librat e tyre qiellor, Tevratin dhe Ungjillin, pavarësisht se më vonë ato kanë pësuar ndryshime dhe shtrembërime duke zëvendësuar fjalët e Zotit me fjalët e njeriut.

[52] Sejjid Husejn Nasr, Srce Islama, op cit., f. 73.

Gjithashtu, duhet të kujtojmë se logjika islame nuk niset nga pikëpamja se kjo është kufizim i lirisë së 'të drejtës të njeriut që të ndërrojë fenë', por niset nga pikëvështrimi historik i disa veprimeve dashakeqe, që kanë ndodhur në fillim të paraqitjes së Islamit. Arabët e Medinës, në tërësi, kishin pranuar Islamin. Ata ishin bashkuar pas një periudhe të gjatë luftërash mes tyre. Disa emigrantë, me qëllime keqbërëse, u munduan të realizojnë një mashtrim të tillë: që gjoja disa prej tyre të bënin sikur e "pranonin" Islamin, e më pas ta braktisnin atë, me qëllim që të shkaktonin përçarje dhe të mbillnin dyshim, ndërmjet myslimanëve për fenë e tyre. Kështu, ata mendonin se do t'ia dilnin që t'i largonin njerëzit nga Islami. Nga një komplot i tillë, i përgatitur kundër Islamit, rezultoi qëndrimi i prerë se të pranuarit një herë të Islamit, nuk mund të braktiset. Në këtë mënyrë, nën kërcënimin e dënimit, i është ndërprerë rruga spekuluesve të ndryshëm, që të pranojnë Islamin publikisht, në mënyrë hipokrite dhe më pas të manipulojnë dhe të bëhen shkaktues të komploteve dhe të ngatërresave në tokë.[53]

Dispozita e Sheriatit mbi apostazinë, mund të duket e çuditshme në dritën e qëndrimit tolerant islam ndaj religjioneve të tjera. Arsyeja për një dispozitë të tillë, duhet të kërkohet në faktin se zbatimi i Islamit, në kohën para moderne, kishte të bënte me individin, i cili ishte njëkohësisht anëtar i shtetit islam dhe i bashkësisë, prandaj apostazia e tij konsiderohej jo vetëm si konvertim, por edhe si tradhti dhe komplot kundër shtetit dhe bashkësisë.[54]

Në një thënie të tij Muhammedi a.s. ka thënë: *"Nuk lejohet derdhja e gjakut të myslimanit veçse në tri raste... dhe ai që e braktis fenë e vet duke u ndarë prej komunitetit"*. Disa dijetarë islamë, duke e lexuar këtë hadith tekstualisht, kanë thënë se secili që e braktis Islamin duhet të mbytet. Ndërkaq, një pjesë tjetër e dijetarëve islamë kanë thënë se, ai që duhet të vritet duhet të jetë personi që braktis Islamin dhe lufton kundër tij. Në kohën e Muhammedit a.s., të gjithë ata që braktisnin Islamin, ndonëse numri i tyre ishte i papërfillshëm, dilnin në anën e

[53] Dijalog Islamskih i Evropskih Ucenjaka, op. cit., f. 42.
[54] Sejjid Husejn Nasr, Srce Islama, op. cit., f. 43.

kundërt dhe i bashkëngjiteshin ushtrisë armike, duke luftuar kundër myslimanëve, prandaj, konsideroheshin luftëtarë kundër Islamit. Ndërkaq, sot kur shteti bashkëkohor nuk është në kuptimin tradicional, në shumë vende myslimane, kemi dijetarë që mendojnë se veprimi i apostazisë, nuk duhet dënuar me vdekje, një konvertues i tillë nuk duhet të vritet, por atij duhet t'i shtyhet afati, duke i ofruar argumente rreth Islamit, jo vetëm tre ditë, sikurse mendon shumica e dijetarëve myslimanë, por vazhdimisht derisa të pendohet. Sipas një mendimi të shkollës hanefite, dënimet me vdekje për atë që e braktis fenë islame, janë sikurse dënimet 'tazir', ku imami mund të falë për të, e jo sikurse te dënimet 'hudud', ku nuk është e drejtë e gjykatësit që të falë.[55]

Nga kjo, shihet se Islami nuk niset nga pikëpamja e 'kufizimit të lirisë', por nga pikëpamja e 'pengimit të intrigave spekuluese nga ana e intriguesve, të cilët do të tentonin të luftonin dhe të lëndonin ndjenjat e besimtarëve, duke përhapur publikisht mosbesim dhe lajthitje me qëllim të mbrapshtë, për të shkaktuar ngatërresa në tokë'. Pra, Islami kërkon që askush, që nuk e beson Islamin përnjëmend dhe me bindje, të mos shtiret se e ka pranuar atë. Këtu qëndron shenjtëria e skajshme e besimit, i cili, sikurse kërkon Islami, duhet të jetë i sinqertë dhe me bindje të plotë, e jo sipërfaqësor dhe me qëllim dashakeqës dhe mashtrues.[56]

[55] Dr. Vehbe Ez Zuhejli, op. cit., f. 152.
[56] Dijalog Islamski i Evropskih Ucenjaka, op. cit., f. 42.

3. Qytetarët jomyslimanë në vendet islame nuk mund të ushtrojnë funksionin e kryetarit të shtetit

Qytetarët jomyslimanë në vendet islame mund të ushtrojnë funksione të ndryshme politike, por jo edhe funksionin e kryetarit të shtetit. Në këtë kontekst, jomyslimani nuk qëndron më poshtë se qytetari amerikan, i lindur jashtë SHBA-së, në aspekt të zgjedhjeve presidenciale. Ndërkaq, sa i përket lirisë së bindjes fetare, ithtarët e feve të tjera në një shtet mysliman mund të ushtrojnë lirisht besimin dhe fenë e tyre.

Islami deklaron se nuk duhet të ketë absolutisht asnjë shtrëngim në çështjet që kanë lidhje me fenë. Ky ishte shkaku që kur dikush e përqafonte Islamin, ai duhej të deklaronte hapur se ai e pranon Islamin me vullnetin e vet të lirë. Kjo kishte bërë që Shteti Islam, gjatë jetës së Pejgamberit a.s. të zgjerohej mesatarisht 800 kilometra në ditë. Kur Pejgamberi a.s u nda nga kjo botë një sipërfaqe që i tejkalonte 2.5 milionë kilometër katrorë kishte hyrë nën qeverisjen e Islamit. Gjatë pejgamberisë së Muhammedit a.s. në periudhën 23-vjeçare vdiqën pothuaj 150 burra nga ana e armikut. Numri i myslimanëve të martirizuar llogaritet rreth 120 veta. Historia botërore nuk mund të paraqesë shembullin e një revolucioni të tillë.[57]

Përkundër shpifjeve dhe gënjeshtrave, se Islami është përhapur me shpatë, myslimanët gjithnjë janë treguar konsekuentë ndaj mësimeve të Kur'anit, ndaj ithtarëve të feve tjera:

"Ju keni fenë tuaj, kurse unë kamë fenë time." *(Kur'ani: El Kafirun, 5)*

Historia dhe shumë dijetarë objektivë perëndimorë vërtetojnë, se myslimanët kanë vepruar sipas parimit të përmendur në Kuranin e shenjtë:

"Në fe nuk ka dhunë *(imponim),* ***është sqaruar e vërteta nga e kota…"*** *(Kur'ani: El Bekaretu, 256)*

[57] Sulltan Ahmed Kureshi, Letrat e Muhammedit a.s., Logos –A, Shkup, f. 20.

Historia dëshmon se Islami ka bashkëjetuar me kultura dhe civilizime të ndryshme. Bota islame nuk ka qenë e mbyllur për praninë e religjioneve të tjera dhe tempujve të tyre fetarë. Kishat edhe sot plotësojnë panoramën e Kajros, Bejrutit, Damaskut dhe shumë qyteteve të tjera. Edhe sinagoga ka kudo që jetojnë çifutët, që prej Teheranit deri në Fes. Në Perandorinë Osmane në shumë vende në Ballkan, ku jetonin së bashku çifutë, të krishterë dhe myslimanë, sinagogat, kishat dhe xhamitë ishin ndërtuar njëra pranë tjetrës. Edhe sot e kësaj dite, prania harmonike e tempujve të ndryshëm fetarë është evidente në Stamboll.[58] E njëjta gjë, mund të thuhet edhe për panoramën e Kosovës, ku hasim kisha dhe xhami të ndërtuara pranë njëra-tjetrës. E gjithë kjo, dëshmon për tolerancën islame dhe për faktin se Islami, në trojet tona, është pranuar vullnetarisht.

Pra, brenda kufijve të qytetërimit islam, kanë jetuar popuj të besimeve të ndryshme. Domosdoshmëria e koekzistencës, i hapi rrugë lindjes së një atmosfere tolerance. Si ata që e kishin pranuar Islamin, ashtu edhe grupet e besimeve të tjera, e ruajtën kontinuitetin e qenies së vet. Pushteti nuk ndërhynte asnjëherë në ritualet fetare të qytetarëve jomyslimanë.

Në këtë periudhë, në prani të halifit Me'mun, zhvilloheshin debate fetare dhe filozofike, ku merrnin pjesë katolikët, adhuruesit e zjarrit, sabinjtë dhe apologjetët islamë.[59]

Sigrid Hunke thotë se arabët nuk kishin për qëllim që t'i konvertojnë njerëzit, por që të zgjerojnë rajonin e sundimit të Zotit – strategji e cila, e lidhur me tolerancën islame, rezultoi me pasoja krejt tjera për sundimin e Afrikës Veriore dhe Spanjës nga myslimanët, krahasuar me nënshtrimin e vendasve të Amerikës Latine dhe Veriore nga disidentët krishterë evropianë.[60]

[58] Sejid Husein Nasr, Srce Islama, op. cit., f. 78.
[59] A. Davutogllu, Vetëperceptimet e Qytetërimeve, Logos, Prishtinë, 2002, f. 45.
[60] Cituar nga Christian H. Hoffman, op. cit., f. 61.

4. Dënimi me vdekje

Shumë vende dëshirojnë të heqin dënimin me vdekje. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, është miratuar më 4 nëntor 1950. Ajo ka hyrë në fuqi më 3 shtator 1953, pasi që e kanë ratifikuar 10 shtete anëtare të Këshillit Evropian. Ajo që është me rëndësi të përmendim, në këtë rast, dhe që bie ndesh me dënimin islam, është Protokolli Nr. 6, ndër më të fundit që i është shtuar Konventës, i cili është nënshkruar më 28 prill 1983 dhe ka hyrë në fuqi prej 1 marsit 1985. Ai ka sjellë një inovacion në legjislacionin penal: duke anuluar dënimin me vdekje, ndonëse kjo ishte objekt i një diskutimi të gjatë.[61]

Disa shkojnë deri aty sa të konsiderojnë se dënimi me vdekje është shkelje e të drejtave të njeriut, cenim i dinjitetit njerëzor dhe si i tillë ai është jonjerëzor[62].

Sipas Islamit, vetëm Zoti e jep jetën, dhe meqenëse njeriu nuk mund t'i japë një njeriu tjetër jetën, ai nuk ka të drejtë as t'ia marrë atij jetën. Në pajtim me këtë ai, i cili zgjat dorën që t'i marrë jetën një njeriu tjetër padrejtësisht, bën mëkat, i cili është i dënueshëm në këtë botë dhe në botën tjetër.

Masa e vuajtjes së dënimit në atë botë është kushtëzuar me përmasën dhe llojin e veprës penale të kryer në këtë botë. Islami e shenjtëron jetën njerëzore, e mbron shenjtërinë e shpirtrave dhe sulmin kundër jetës e konsideron si krimin më të madh te Zoti, pas mosbesimit. All-llahu në Kur'anin e shenjtë thotë:

"Nëse dikush mbyt dikë, i cili nuk ka mbytur askënd, ose nuk ka bërë në tokë turbullira, sikur ka mbytur tërë njerëzinë…" *(Kur'ani: El Maidetu, 32).*

[61] Arben Puto, op. cit., f. 228.

[62] Manfred Nowak në: Jurisprudenca e Ligjit të të drejtave të Njeriut, Një Qasje Krahasimore në Interpretim, Edituar nga Theodore S. Orlin, Allan Rosas dhe Martin Scheinin, Prishtinë, 2002, f. 29.

Jeta është dhuratë e All-llahut dhe si e tillë është e shenjtë, madje Islami tërë gjininë njerëzore e trajton si një familje, e cila duhet të çmojë jetën në mënyrë të merituar.[63]

Kur'ani bën klasifikimin e vrasjes në: vrasje me paramendim, vrasje pa dashje dhe vrasje e ngjashme me vrasje pa dashje. Vetëm për vrasjen me paramendim-qëllim, ndëshkimi është dënimi me vdekje.

Të gjitha shkollat juridike janë të mendimit se dënimi mbi vrasësin mund të kryhet, vetëm pas një gjykimi të vlefshëm nga ana e gjyqit, e nëse dikush e vret vrasësin pa vendimin e gjykatës, do të trajtohet si vrasës dhe do t'i nënshtrohet kisasit.[64]

Kisas në të drejtën islame interpretohet si kundërshpërblim i dënimit në masë të njëjtë, atij i cili në çfarëdo mënyre ka atakuar trupin ose jetën e dikujt. Te juristët islamë ai do të thotë: të veprohet me delinkuentin sipas veprës që ka bërë.[65]

Një pjesë e teoricienëve jomyslimanë të së drejtës, janë për atë, që vrasësi të mos ndëshkohet me dënimin kapital. Ka shumë ajete kur'anore dhe hadithe, që kanë shpallur shenjtërinë e jetës së çdo individi, dhe që urdhërojnë dënimin kapital për atë njeri, që pa të drejtë ia merr tjetrit jetën.

Islami ka paraparë dënimin me vdekje, shpagimin shpirt për shpirt, për secilin që argumentohet se është autor i vrasjes, dhe dënim me ndëshkim të rëndë për vepra të këqija, për atë që vërtetohet se është shkaktar i këtij dëmi.

All-llahu i madhëruar thotë:

"Kjo masë e dënimit është jetë për ju." *(el Bekaretu, 179).*

Disa juristë jomyslimanë mendojnë se ky dënim është i ashpër. Ndërkaq, juristët myslimanë mbajnë qëndrimin se ky dënim nuk është i egër dhe i vrazhdë, por është në nivel të aktit, që bën krimineli.

[63] Dr. Jusuf Kardavi, Hallalli dhe harami, Shkup, 1418/1998, f. 322.

[64] Familja e të vrarit, të afërmit e tij për nga gjaku, babai, biri, vëllai, xhaxhai etj., kanë të drejtë të kërkojnë hakmarrje, ose t'ia falin dorasit, duke kërkuar shpagimin e gjakut të të vrarit nga ana e dorasit, ose nga ana e familjes e tij shih: Zbornik Radova 2, Sarajevë, 1987, f. 123.

[65] Dr. Muhammed Beker Ismail, El Fikhul Vadih vëll. 2, Darul Menar, Kajro,1410/1990, f. 300.

Nuk ka egërsi dhe vrazhdësi në këtë dënim. Ndërkaq, i egër është veprimi i personit, që vret të tjerët pa të drejtë.

Juristët myslimanë shtrojnë pyetjen: Pse duhet të kemi mëshirë ndaj vrasësit, kriminelit, e të mos të tregohemi të drejtë ndaj të vrarit dhe familjes së tij?!

S'ka dyshim se ashpërsia e dënimit është ajo që e ruan dorën e vrasësit dhe e mbron jetën e të pafajshmit dhe i garanton të gjithëve siguri dhe qetësi.

Në fakt, zbatimi i këtij dënimi, në vendet islame është shumë i rrallë, madje vite me radhë nuk ndodh një gjë e tillë, dhe kjo ndodh për shkak të vrasjeve të rralla që ndodhin në ato vende, ku zbatohet e drejta islame. Madje, mund të themi se, gati nga ky dënim, nuk ka mbetur, veçse ashpërsia e tij, e cila të gjithë i ka bërë të jenë të sigurt dhe të kenë qetësi. Ai i ka ruajtur edhe duart e atyre, të cilët do të ishin të gatshëm për vrasje, sepse vetë ashpërsia e dënimit, ua bën gati të pamundshme kryerjen e një veprimi të tillë.

Ndonëse sot vëmendja e perëndimorëve më shumë është e përqendruar te karakteri i ashpër i ndëshkimeve që zbatohen në vendet myslimane, të cilat shpesh janë në shënjestër të kritikave të tyre, ata pak, ose aspak, nuk e theksojnë faktin se dënimet e tilla, vërtet, zbatohen shumë rrallë në botën islame, përgjithësisht, për shkak të vrasjeve shumë të rralla në ato vende. Ndërkaq, ajo që duhet të theksohet, për sa u përket ndëshkimeve që zbatohen në vendet myslimane, është se duhet të tregohet pak dëshirë që të vërehet fakti se numri i njerëzve, të cilët vdesin, ose janë lënduar seriozisht në deliktet që janë rezultat i sulmeve, plaçkitjeve dhe vjedhjeve dhe dhunës seksuale në SHBA, është shumë më i madh, sesa numri i njerëzve të dënuar për vrasje, vjedhje dhe prostitucion, sikurse është Arabia Saudite, të cilës gjithnjë i adresohen kritikat.[66]

Ligjet Islame të Sheriatit nuk parashohin që të çrrënjosin në tërësi imoralitetin dhe mëkatet e tjera të mëdha. Asnjë bashkësi njerëzore nuk mund të jetë e mbrojtur nga sjelljet e tilla të gabuara dhe të këqi-

[66] Sejid Husein Nasr, Srce islama, op. cit., f. 197.

ja. Qëllimi kryesor i së drejtës islame është që të pengojë veprimin publik të veprave të turpshme dhe sjelljen mashtruese që shpie deri tek ato, që t'i reduktojë në një pakicë të parëndësishme, e cila do të bënte veprime të tilla në fshehtësi dhe nën frikën e errësirës.[67]

Shumë kundërshtarë të Islamit, kanë shkruar se, dispozitat e Sheriatit janë tejet të ashpra. Madje ka edhe të atillë, sa që shkojnë aq larg, sa që pohojnë se, ligjet islame janë 'të ashpra' sepse origjinën e kanë prej arabëve, prandaj në 'ashpërsinë' e ligjit islam reflektohet 'ashpërsia' e vetë arabëve. Mirëpo, shumë njerëz nuk janë të vetëdijshëm se, këto masa ndëshkimore, kanë për qëllim mbrojtjen e shoqërisë nga shkatërrimi dhe zvetënimi i saj. Lirisht mund të themi se, masat ndëshkimore në Islam, kanë pasur ndikim në çrrënjosjen e veprave penale me vetë normimin e dënimeve dhe sanksionimin e ndëshkimeve. Mund të konkludojmë se, dënimet e parapara kanë arritur të kenë sukses, më shumë me normimin e tyre, sesa me aplikim praktik. Ato, më shumë, kanë ndikuar përmes aspektit teorik, sesa atij praktik. Këto dënime të rrepta, para së gjithash, kanë pasur për qëllim shërimin psikologjik të të sëmurëve nga këto sëmundje shoqërore, sesa që kanë rekomanduar (kanë pasur për qëllim) dënimin trupor. Në këtë mënyrë, e drejta islame, me mbështetje të fortë në bazat e fesë dhe të moralit islam, arrin të çrrënjosë dukuritë negative dhe e pastron shoqërinë nga e gjithë ajo, që anon nga negativitetet, në raport me sigurinë e shoqërisë, qetësisë familjare dhe dinjitetin e femrës.[68]

Masat ndëshkimore luajnë rol edukues, sepse të gjitha ndëshkimet trupore kryhen publikisht. Muhammedi a.s ka thënë: *"Mos zbatoni ndëshkimet me dëshmi të dyshimtë"*. Dijetarët islamë kanë konkluduar në bazë të kësaj thënie të Muhammedit a.s., se është më mirë të mos aplikohet ndëshkimi ndaj një delikti, sesa të zbatohet në bazë të dëshmive të dyshimta.

Padyshim se, njeriu, nën hijen e së drejtës islame, ndihet jo i frikësuar, por i sigurt dhe i qetë, për jetën dhe pasurinë e tij. Këtë e di se-

[67] Malik Badri, AIDS/SIDA i Kriza Modernog Svijeta u Svijetlu Islama, Sarajevo , 2002, fq. 270

[68] Dijalog Islamskih i Evropskih, op. cit., f. 127.

cili, që ka pasur rastin të jetojë në këto vende, qoftë edhe për një kohë të caktuar. Këtë e kam ndier edhe unë gjatë viteve që i kam kaluar atje. Ndërkaq, njeriu nuk mund të jetë edhe aq i sigurt në asnjë vend, ku aplikohen ligjet sekulariste.

Dënimi me vdekje në Islam parashihet për tri kundërvajtje: 1. për tradhti, 2. vrasje dhe 3. grabitje. Ndonëse zbatimi i këtyre dispozitave është shumë i rrallë, shlyerja e përgjithshme e dënimeve me vdekje, meqë ato janë përmendur në librin e shenjtë, Kur'anin famëlartë, dhe pezullimi i këtyre dispozitave nuk mund të bëhet në vendet myslimane. Të kujtojmë se dënimi me vdekje zbatohet edhe në shumë shtete të SHBA-së dhe në disa religjione të tjera.[69]

Ekskluziviteti i të drejtave në Islam qëndron në atë se ato janë të lidhura ngushtë me besimin dhe devotshmërinë ndaj All-llahut të madhëruar:

1. Lidhja e këtyre të drejtave, me besim dhe devocion ndaj Zotit, paraqet burimin e fuqisë së këtyre të drejtave në Islam.
2. Sipas botëkuptimit islam është rrezik i madh të dobësohet kjo lidhje, sepse efekti i besimit në Zot është më i fortë se efekti i cilitdo ligj njerëzor. Kjo dëshmohet me faktin se trazirat dhe ekstravaganca, në jetën e të rinjve në vendet e zhvilluara, është kryesisht rezultat i humbjes së besimit në Zotin, dhe dhënies pas jetës materiale.[70]

Shumë dëshmi të dijetarëve objektivë perëndimorë dhe të konferencave dhe simpoziumeve botërore, janë dëshmi të mjaftueshme për ata që mendojnë drejtë dhe në mënyrë objektive rreth të drejtës islame. Pjesëmarrësit në simpoziumin e organizuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Parisit, në vitin 1950, hartuan njëzëri dokumentin,

[69] Dënimet e rënda në Ligjin Islamik, janë më pak të ashpra se sa tek Ligji Hebraik. Sipas Ligjit Hebraik 36 vepra kriminale, sikurse janë: kurorshkelja, sodomia, idhujtaria, magjia dhe vrasja, ndëshkohen me varje deri në vdekje, këputje koke, djegie ose mbytje (zënie fryme), e megjithatë kritikat vazhdimisht janë të drejtuara vetëm në adresë të Islamit, shih: Sejid Husein Nasr, Srce Islama, op. cit., f. 195.

[70] Dijalog Islamskih i Evropskih, op. cit., f. 150.

ku thuhet: "Duke u bazuar në efektet e pakontestueshme, që u zhvilluan gjatë javës së jurisprudencës islame, konstatohet qartë:

1. Parimet e të drejtës Islame kanë vlerë të padyshimtë dhe të pakontestueshme juridiko-legjislative, dhe
2. Divergjencat e shkollave juridike Islame (medhhebeve), përfshijnë një pasuri të madhe konceptesh, njohurish e faktesh, të cilat janë mahnitëse dhe me ndihmën e tyre, e drejta Islame, është në gjendje t'u përgjigjet kërkesave të jetës bashkëkohore dhe t'i plotësojë nevojat e saj."

Prandaj mund të përfundojmë se nuk ekziston kontradiktë esenciale ndërmjet mësimit islam dhe perëndimor për të drejtat e njeriut. Përkundrazi, Islami është sistem (komplementar) i të drejtave të njeriut.[71]

Përfundim

Me këtë krahasim të thukët të të drejtave të njeriut në Islam dhe në botën perëndimore, nuk dua të arrij deri aty, sa të pretendoj se, në Kur'anin fisnik, ndërtohen dhe gjenden idetë dhe nocionet perëndimore, dhe të vërtetoj kështu se Islami është 'përparimtar', njësoj sikurse teoritë e shoqërisë perëndimore! Pajtohem me mendimin e K. Hoffmann se, asnjë mysliman, nuk duhet të arrijë deri aty dhe të pretendojë se porosia e All-llahut duhet matur sipas kutit të nocioneve të filozofisë dhe sociologjisë perëndimore! Kjo do të ishte shumë naive.[72]

Romakët shumë herët e kanë ndarë jus-in dhe fas-in; Izraelitët kanë respektuar njëkohësisht mbretin dhe profetin; Isait (Krishtit) i përshkruhen këto fjalë: Mbretit jepjani mbretëroren, kurse Zotit hyjnoren". Budistët dhe brahmanët konsideronin se ideal i njeriut të devotshëm është heqja dorë nga bota. Por, janë të rrallë ata që e kanë zbatuar këtë ideal në praktikë; nëse ky ideal nuk është imponuar nën kërcënimin e dënimit, por vetëm është porositur, nuk është edhe aq e

[71] Murad Hofmann, op. cit., f. 167.

[72] Christian H. Hoffmann, op. cit., f. 172.

sigurt se morali i njeriut të thjeshtë do të jetë në nivel. Njeriu mesatar nuk mund të jetojë drejt pa sanksione.[73]

Në marrëdhëniet ndërmjet Islamit dhe Perëndimit hasim dy koncepte të ndryshme, që qëndrojnë në kundërshtim të papajtueshëm.

Nga njëra anë kemi shekullarizmin si model profan, me ndarjen gati totale të shtetit dhe fesë. Kjo me më përpikëri është zbatuar në Francë, kurse në SHBA, Britani, Gjermani, feja dhe shteti, mbesin të bashkuara në nivel të caktuar (në edukimin fetar, lutjet shkollore, taksën kishtare, pushimet, kremtimi i së dielës). Ndarja e fesë dhe shtetit, në Perëndim, është kuptuar si "conditio sine qua non", si kusht themelor për demokracinë e vërtetë, bazuar në sundimin e ligjit dhe pluralizmit politik.

Ndërkaq, në Islam hasim integrimin islam, konceptin e integrimit të shtetit dhe fesë, madje edhe në shtetin demokratik.

Në anën perëndimore, dëgjojmë recitimin entuziast të pasazhit biblik: "Mbretit mbretëroren, e Zotit hyjnoren."

Ndërkaq, Islami përgjigjet me parullën "Din ve devle" (Islami "fe dhe shtet").

Ndonëse kjo formulë nuk haset në Kur'an, e gjithë shpallja kur'anore është "integraliste". Islami, njeriun, e posedon me tërësinë e tij.[74]

Kur'ani shumë herët ka potencuar nocionin e shtetit mbinacional, duke mos u mjaftuar me konceptin "popuj" (ummet) etnikë ose gjeografikë. Nocioni "popuj" në Kur'an nuk bazohet në ngjyrë, gjuhë të njëjtë ose vendlindje, por në mendimin e njëjtë. Me fjalë të tjera, për krijimin e bashkësisë nuk është vendimtare lindja, e cila është e rastësishme, por përzgjedhja personale. Kur'ani dërgon porosinë vijuese: barazi për të gjithë njerëzit me superioritetin e të devotshmëve.[75]

Në literaturën islame, intelektualët myslimanë shpesh klasifikohen si: tradicionalistë, myslimanë modernistë (modernistë fetarë) dhe revivalistë (fundamentalistë). Për këtë ndarje i jam referuar shkrimit të bërë nga Fikret Karçiq.

[73] Muhammed Hamidullah, Muhammed a.s. vëll. 2, Zagreb , 1983, f. 159.
[74] Murad Hofmann, op. cit., f 117.
[75] Muhammed Hamidulla, Muhammedi a.s. vëll. 2, op. cit., f. 162.

Tradicionalizmi paraqet orientimin sipas të cilit, Islami definohet si "besim dhe e drejtë", por pranohen ndryshimet historike të funksioneve shoqërore. Për shumicën e ulemasë, në vendet myslimane Sunnite, manifestimi i mjaftueshëm i Islamit në jetën publike, nënkupton të fituarit e tij të statusit të fesë shtetërore, respektimin e simboleve fetare dhe njohjen e vlefshmërisë së Sheriatit në çështjet statusore të myslimanëve.

Modernistët pranojnë burimin hyjnor të Sheriatit, por theksojnë se qëllimi i tij është mirëqenia e njeriut, dhe se me rastin e interpretimit dhe zbatimit të Sheriatit, ky qëllim duhet të kihet në konsideratë. Ata e ridefinojnë Sheriatin me konceptet dhe terminologjinë e mendimit juridik dhe politik perëndimor (demokracia, liria, barazia, toleranca, drejtësia shoqërore, mirëqenia, etj). Vetë pushteti shtetëror e nxjerr legjitimitetin nga parimi i sovranitetit të popullit **de facto**, për dallim nga sovraniteti Hyjnor **de juro**.

Për modernistët myslimanë, Sheriati, është një ndër sistemet e mëdha juridike të botës, i cili rrjedh nga burimet kryesore të mësimit islam, fetarisht relevant për myslimanët, i përshtatshëm për nevojat e jetës bashkëkohore, për shkak se posedon të gjitha predispozitat e nevojshme. Parimet e sheriatit, duhet të afirmohen si një nga burimet e së drejtës ndërkombëtare.

Revivalizmi, islamizmi radikal ose "fundamentalizmi", paraqet atë orientim ideologjik, në botën bashkëkohore islame, i cili përpiqet që ta zbatojë Sheriatin si tërësi, të bazuar në burimet kryesore të mësimit islam dhe të historisë së hershme islame. Insistohet në atë që Islami të përfshijë të gjitha aspektet e jetës, dhe shpesh definohet si "sistem jetësor", ndërkaq akcentohet autenticiteti i normave dhe dallimi i institucioneve islame. Për këtë arsye, e jo për shkak të fleksibilitetit, sikurse veprojnë modernistët, revivalistët kërkojnë mënjanimin e shtesave nga të komentuarit dhe praktika islame. Përvojës së bashkësisë së hershme në Medine, i japin karakter normativ dhe e konsiderojnë si model, e jo si shembull historik, të realizimit të Islamit.

Islamin e definojnë si "fe dhe shtet". Përpjekjet e tyre i orientojnë kryesisht kah vendosja e supozimit për një rregullim të tillë.

Prandaj, varësisht nga ajo se, cili drejtim ideologjik do të dominojë, besimi islam ose mund të jetë në funksion të modernizmit shoqëror, demokratizimit të sistemit politik dhe juridik dhe hapjes ndaj kulturave të tjera, ose do të jetë i shfrytëzuar për inkurajimin e proceseve retrograde, dogmatizmit, totalitarizmit politik dhe vetëmjaftueshmërisë kulturore.[76]

Kufizimet, që imponon e drejta islame, nuk janë kufizime të lirisë së individit, por ndihmë e domosdoshme, që bën të mundshme arritjen e lirisë së vërtetë. Koncepti, i lirisë së vërtetë është ai që i bën njeriut të mundur të arrijë atë përsosje, që i lejon atij të afrohet dhe të ngrihet kah Zoti, që është njëkohësisht domosdoshmëri absolute dhe liri absolute, koncept ky, tepër i largët me nocionin e lirisë në Perëndim.

[76] Fikret Karcic, Razumijevanje Islamskog Vjerozakona (Sheriata) u Savremenom Muslimanskom Svijetu, në: Islamski fundamentalizam, sta je to, përgatiti, Nusret Cancar & Enes Karic, Sarajevë, 1990, f. 40.

Ajni Sinani

HUMAN RIGHTS – ISLAMIC AND WESTERN VIEWPOINTS

(Comparative approach)

(Summary)

The reason why I chose this topic (to analyze it in greater detail) was not a mere coincidence. Bearing in mind the fact that we live in a post-communist society, in which we were bombarded by a merciless propaganda against religion in general, and Islam in particular, as well as the fact that I have come across many superficial pieces of writing, which reflected a lack of understanding towards Islam I decided to make an effort in this direction. The most important factors that made me choose this topic are:

1. Very often the Islamic world is accused of violating or failing to respect human rights (justly and unjustly);
2. I wanted to study the things which are in common in the Islamic and Western viewpoints regarding human rights;
3. Such a topic has never been elaborated in the Albanian language;
4. Certain segments of the Sharia Law have been applied in these territories as well (during the Ottoman rule);
5. I believe that in the future Islamic Law will be essential for all Muslim peoples. We, the Albanians, should not be an exception in this. It is important that we have a state, which is based on moral values and not a state, which is based on force or its instruments of force. The state must be a combination of values, in which objective values are cultivated (as are Justice, Truth, Righteousness, Holiness, etc.). Secularism is not and cannot be the moral foundation of the state. Justice is the moral foundation of the state. The Quran says: Be just: that is next to piety (Quran: Al-Maide, 8).

عيني سنان

مفهوم حقوق الانسان في الاسلام و القوانين الغربية

(دراسة مقارنة)

(خلاصة البحث)

مقدمة

اختيار هذا الموضوع للدراسة لم يكن مصادفة بل لاسباب موضوعية بما أننا مجتمع خرج بتوه من الحكم الشيوعى و الذي شن على الدين حربا شعواء عامة وضد الاسلام بصفة خاصة و بما أننا نعيش في اطراف العالم الاسلامى و كذلك لعدم معرفة الناس بحقيقة الاسلام و الشريعة الاسلامية و نظرا لنشر بعض الكتابات السطحية عن الاسلام أو بصورة متعمدة قررت ان اخوض في هذا الموضوع. و الدوافع التي جعلتنى اتناول هذا الموضوع اذكر منها.

1- اتهام العالم الاسلامي بحق أو بدونه أنه لا يحترم حقوق الانسان

2- محاولة البحث الايجاد جوانب مشتركة و جوانب مختلفة بين المفهوم الاسلامي و المفهوم الغربى في فهم حقوق الانسان بصفة خاصة و الحقوق عامة.

3- غياب مثل هذه المواضيع في اللغة الالبانية.

4- الاهمية العلمية لهذا الموضوع لان جوانب من الشريعة الاسلامية قد تم تطبيقها عندنا إثناء الحكم العثمانى لهذه المنطقة.

5- انا اعتقد اعتقادا جازما بان الشريعة الاسلامية حيوية و مهمة جدا للمجتمع الاسلامى في المستقبل بما في ذلك المجتمع الالباني.

TRASHËGIMI

Hasan Kaleshi – Ismail Eren

MAHMUD PASHË RROTLLA NGA PRIZRENI - PËRSHPIRTËNIMET DHE VAKËFNAMEJA E TIJ

Lufta turko-austriake e viteve 1683-1690 kishte lënë pas vete shumë pasoja në Kosovë, dhe sidomos në Prizren dhe rrethinën e tij.[1] Në të vërtetë, më 3 nëntor 1689, Pikëlomini qe nisur nga Prishtina për në Prizren, ku kishte arritur më 6 nëntor 1689. Së bashku me të, kishte arritur edhe peshkopi Pjetër Bogdani, i cili i qe bashkëngjitur në Shkup.[2] Me ata dy, kishin arritur edhe disa mijëra vullnetarë shqiptarë dhe serbë të fesë katolike. Se kanë qenë 20.000, siç thuhet në disa dokumente, kjo duhet marrë me shumë rezervë, sepse aq katolikë nuk kishte në këto troje. Sidoqoftë, të krishterët e armatosur në rrethinën e Prizrenit dhe Shqipërinë e Epërme asokohe ishin futur nëpër vendbanimet myslimane dhe ua kishin plaçkitur pasurinë.[3] Autori i një kro-

[1] Në këtë punim nuk do të lëshohemi në shkaqet e luftës, operacionet e luftës, pasojat dhe çështje të tjera, sepse për këto ekziston literaturë e bollshme dhe sepse kjo i kalon kornizat e këtij punimi. Ne do të ndalemi vetëm në ato çështje që kanë lidhje të ngushtë me temën tonë. Megjithëkëtë, Kosova gjatë kësaj lufte të ashpër, pastaj pasojat e rënda ekonomike, politike, kulturore, konfesionale dhe pikëpamjet etnike, meritojnë hulumtime të veçanta.

[2] J. Radonic, *Rimska kurija i juznoslovenske zemlje*, Beograd, 1950, f. 402.

[3] J. Tomic, *Deset godina iz istorije serpskog naroda i cerkve nad Turcima (1683-1693),* Beograd, 1902, f. 44.

nike arabe, *Tahir Efendiu,* thotë se pabesimtarët gjatë asaj kohe vranë shumicën e banorëve të Prizrenit dhe rrënuan shumë xhami, sa që në Prizren nuk mbetën më shumë se dhjetë shtëpi myslimane, kurse shumë nga ata u sëmurën nga murtaja dhe vdiqën. Nga 20.000 shtëpi myslimane, sa kishte Prizreni, thotë Tahir efendiu, mbetën gjashtëmbëdhjetë.[4] Edhe pse në këto pohime të Tahir Efendiut ka mjaft teprime, tipike për shkrimet e asaj kohe,[5] megjithatë, rrënimet, shkatërrimet, asgjësimet dhe vrasjet e myslimanëve padyshim kanë qenë të mëdha. E dhëna se shumë njerëz kishin vdekur nga murtaja, gjithsesi është e vërtetë, sepse murtaja pikërisht në atë kohë kishte bërë kërdi në këto troje. Nga murtaja kishin vdekur edhe Pikëlomini edhe Bogdani. Sipas një burimi tjetër, me rastin e hyrjes së austriakëve dhe vullnetarëve të krishterë në qytetet e Rumelisë, vetëm një e treta e banorëve myslimanë kishte arritur të shpëtonte.[6]

Mirëpo, kur më 9 nëntor 1689 në Prizren vdiq Pikëlomini, komandën mbi ushtrinë dhe vullnetarët e kishte marrë Hercegu nga Holshtajni, i cili, me sjelljen e tij të vrazhdë, shumë shpejt kishte shkaktuar zemërim tek aleatët e vet, dhe sidomos te shqiptarët. Për këtë arsye, shumë liderë shqiptarë qenë larguar nga princi i Holshtajnit dhe kishin filluar bisedat me Mahmud Pashë Begollin, i cili, së bashku me bashibozukët e tij, qe nisur për në Prizren. Që t'i ndëshkonte banorët shqiptarë dhe liderët e tyre, princi nga Holshtajni, më 2 dhjetor (1689 – shën. ynë) qe nisur me një ushtri prej 3.000 luftëtarësh kundër Lumës, por atje nuk gjeti askënd, sepse popullata pati lëshuar shtëpitë e tyre dhe qe fshehur në male. I zemëruar nga kjo, ai ua dogji shtëpitë dhe me këtë akt edhe më shumë u nda nga aleatët e tij. Duke mos pasur

[4] Tahir efendiu në vitin 1874 ishte myfti i Prizrenit dhe myderriz në medresenë "Mehmed Pasha". Ai ka shkrua një kronikë në gjuhën arabe për përmendoret osmane në Prizren me titullin *"Menakib" (Biografi),* autografi i së cilës gjendet në zyrën e Vakëfit në Prizren, kurse një përshkrim i saj gjendet në duart tona. "*Kronikën"* së shpejti do ta botojmë, sepse është shumë interesante për historinë e përmendoreve islame në Prizren.

[5] Një teprim të njëjtë e gjejmë edhe tek konsulli rus në Prizren, I. Jastrebov, i cili thotë: "Në Prizren kanë mbetur gjithsej shtatë familje serbe". Si do që të jetë, edhe njëri burim edhe burimi tjetër flasin për një katastrofë të madhe që kishte goditur Prizrenin gjatë kohë së këtyre luftërave.

[6] Sulejman Kylçe, *Osmanli Tarihinde Arnavutluk,* Izmir, 1944, f. 103.

kah t'ia mbante, ai me të shpejtë qe larguar nga aty drejt Prishtinës që t'i rregullonte (konsolidonte) radhët, duke lënë në Prizren forca të pakta ushtarake dhe vullnetarësh. Ushtria osmane, tatarët dhe bashibozukët e Mahmud Pashë Begollit kishin filluar ofensivën e përgjithshme, kishin marrë Rozhajën dhe i qenë afruar Pejës. Së shpejti ushtria austriake qe larguar nga këto treva dhe, derisa forcat ushtarake osmane riktheheshin në Prizren, Gjakovë, Pejë dhe në qytetet e tjera, banorët e krishterë i qenë nënshtruar të njëjtit terror, sikur që kishin përjetuar banorët myslimanë gjatë kohës së okupimit austriak. Tomiq, ka të drejtë kur thotë se në dekadën e parafundit të shek. XVII, në qytetet e viseve jugperëndimore - Prizren, Gjakovë dhe Pejë - banorët myslimanë ishin shumicë.[7] Që nga kjo kohë filloi qeverisja e *Mahmudbegollve nga Peja* - në disa burime bile edhe Breniviçët dhe Brankoviçët, - të cilët, gjatë gjithë periudhës osmane, do të luajnë një rol të rëndësishëm në historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë Veriore.

Në të njëjtën mënyrë, në luftërat që u zhvilluan në gjysmën e parë të shek. XVIII, në Prizren u ngrit një familje tjetër - *Rrotllajt.* Themeluesi i saj, *Salihu nga Nenkovci*, qe dalluar në këto luftëra dhe kur lufta kishte përfunduar, ai kishte arritur gradën e pashait, kurse më 1747 qe bërë sanxhakbej i Prizrenit. Asokohe titujt pasha fitoheshin shumë lehtë, sepse Perandoria Osmane edhe pse i kishte forcuar kufijtë e saj në lumenjtë Sava dhe Danub, qe detyruar që përfundimisht të largohej nga politika pushtuese dhe nuk kishte mundur që të vendoste pushtetin qendror të mirëfilltë nëpër provincat që ishin tronditur nga lufta austro –turke. Për këtë arsye, ajo me zemërgjerësi mbante raporte të buta ndaj titullarëve të ndryshëm dhe pashallarëve të emëruar, të cilët uzurponin pushtetin dhe fillonin të qeverisnin në mënyrë të pavarur, duke njohur vetëm formalisht pushtetin qendror. Kështu, *Sali Pasha* jo vetëm se kishte arritur të fitonte titullin pasha, por ai kishte arritur që pozitën e vet ta forconte aq shumë sa që pozitën *sanxhakbej* t'ua siguronte edhe trashëgimtarëve e tij.

[7] Më gjerësisht: J. Tomic, vep. cit. f. 40, 151-152.

Për personalitetin e Salih Pashës kemi fare pak të dhëna. Sipas "*Kronikës"* së sipërpërmendur të Tahir Efendiut, thuhet se Salih pasha qe martuar me njërën nga stërmbesat e *Gazi Mehmed Pashës*. Autori i "*Kronikës",* Tahir Efendiu, e lavdëron Salih Pashën, sepse kishte riparuar shumë xhami të rrënuara gjatë luftës, se kishte ngritur shkolla dhe medrese, se në Prizren kishte sjellë myderrizin në zë dhe nxënësin e shkencëtarit, shkrimtarit dhe mistikut të njohur persian Kirmani, - *Ahmed Efendiun*.

Mirëpo, është vështirë të përcillet gjenealogjia e Salih Pashës, më vonë të mbiquajtur Rrotulla apo Rrotlla (në burimet turke: Rrotulu). Sipas gjenealogjisë - të cilën jemi përpjekur ta hartojmë mbi bazë të burimeve turke - Salih Pasha kishte dy djem: *Emrullah Pashën* dhe *Ismail Pashën*. Emrullah Pasha me siguri ka qenë sanxhakbej i Prizrenit në vitet 1772- 1773, kurse vëllai i tij Ismail Pasha, ka qenë sanxhakbej në vitet 1785- 1786. Në verën e vitit 1792, *Mahmud Pashë Bushatliu (Karamahmud Pasha)* me një ushtri të madhe kishte pushtuar tërë Kosovën, duke përfshirë edhe Shkupin dhe Ohrin. Ka shumë të ngjarë që Mahmud Pashë Bushatliu pikërisht atëherë t'i kishte përzënë Rrotllajt nga Prizreni dhe për pasha të Prizrenit të ketë emëruar të birin, *Mehmed Pashën*. Mirëpo, në maj 1795, *Tahir Pashë Rrotlla*, biri i Emrullah Pashës të sipërpërmendur, së bashku me shtatë pashallarë të Kosovës, e kishin përzënë Mehmed Pashën dhe me Prizrenin kishte sunduar vetë. Kara Mahmud Pasha që ta kthente të vëllanë (apo nipin), kishte mësyrë Prizrenin. Pas një beteje të ashpër, Kara Mahmud Pasha e kishte mundur Tahir Pashën dhe aleatët e tij, më pastaj kishte hyrë në Prizren, e kishte plaçkitur atë, dhe e kishte kthyer në pushtet të vëllanë.[8] Sipas disa burimeve të tjera, Mahmud Pashë Bushatliu, në luftën afër Prizrenit kishte humbur 1.500 ushtarë, dhe meqë nuk kishte mundur të vazhdonte rrugën për në Pejë, që kishte qenë qëllimi i tij kryesor, kishte plaçkitur Prizrenin dhe Vushtrrinë dhe qe kthyer prapa.[9] Ka shumë të ngjarë që Rrotllajt të kenë ikur për në

[8] Stavri N. Naqi, *Pashallëku i Shkodrës,* Tiranë,1964, f. 237.
[9] Hatt-I Hymajun III,1309/A; L. Stojanovic, *Stari srpski zapisi i natpisi,* lib. II, nr. 3703.

Sofje dhe pas vdekjes së Mahmud Pashë Bushatliut, bënë lutje që t'u ndahej Sanxhaku i Prizrenit. Kështu, Tahir Pasha sundoi në Prizren deri më 1800, deri atëherë kur *mytesarif* u emërua vëllai i tij, *Rrustem Pasha*.[10] Tahir Pasha i sipërpërmendur dhe Rrustem Pasha, sikur edhe *Abaz Beu*, për të cilin nuk dimë asgjë, janë bijtë e Emrullah Pashës. Rrustem Pashën nga viti 1805 si mytesarif të Prizrenit e trashëgoi *Sait Pasha*, i biri i Tahir Pashës. Krahas Sait Pashës, Tahir Pasha ka pasur edhe bijtë: *Mahmud Pashën* dhe *Emin Pashën*, për të cilët do të bëjmë fjalë më gjatë në punimin tonë. Përveç këtyre, Tahir pasha ka pasur edhe djalin *Jusuf Beun* dhe dy vajzat - *Zehren* dhe *Shehzaden*, të cilat përmenden në Vakëfname [11]

Edhe për Sait Pashën po ashtu dimë shumë pak. Mund të pohohet gati me siguri se gjatë kohës së rebelimit serb e deri më 1909, ai ishte pasha i pavarur i Prizrenit, të cilin në këtë pozitë e trashëgoi Mahmud Pasha. P. Kostiç, thotë se ky Sait Pasha ka qenë xhaxhai i Mahmud Pashë Rrotllës,[12] sa kohë që në Vakëfnamenë e Mahmud Pashës, të cilën po e botojmë në vazhdim të këtij punimi, e gjejmë se ka qenë vëllai i Mahmud Pashës. Për këtë arsye, jemi të prirë të besojmë në variantin e dytë. P. Kostiç tregon për një rast lidhur me këtë Sait Pasha. Popi i atëhershëm i Prizrenit, Dima Parla, që t'i hynte në hatër Sait Pashës, i pati intriguar disa serbë të pasur kinse ata kishin marrë pjesë në luftëra në anën e kryengritësve serbë kundër turqve. Sait Pasha i kishte dhënë popit dy sejmenë, kurse popi kishte grumbulluar 5.000 groshë, të cilat ia kishte dorëzuar Sait Pashës. Mirëpo, mjeku i Sait Pashës, Haxhi Jovani, e kishte akuzuar popin te Pashai se ai (po-

[10] Hasan Kaleshi-Hans-Jyrgen Kornrumf, *Das Wilajet Prizren.Beitrag zur Geschichte der tykischen Staatsreform auf dem Balkan im 19 Jahrhundert*. Sydost-Forschungen, Band XXVI, Mynchen, 1967, f. 193.

[11] Edhe këtu ndeshemi me vështirësitë me rastin e tentimit që të konstruktohet një trung gjenealogjik i Rrotllajve, sepse në Vakënamenë e Mahmud pashës, të cilën po e botojmë në vazhdim, përmendet gjyshi i Mahmud pashës, Selman aga dhe vëllai i tij Muhamed (Mehmed) aga. Mirëpo, për ta s'kemi kurrfarë të dhënash, dhe fakti se ata nuk mbajnë tituj pashallarësh, na shtynë të mendojmë se mbase nuk kemi të bëjmë me paraardhës të mëhershëm.

[12] Petar Kostic, *Crkveni zivot pravoslavnih Srba u Prizrenu i njegovoj okolini u XIX veku,* Beograd, 1928, f. 26.

pi) kishte grumbulluar më shumë para sesa që i qenë dorëzuar pashait, prandaj Sait Pasha kishte urdhëruar që popit "t'ia lidhnin zinxhirin për qafe dhe ta lidhnin pranë derës së çarshisë, dhe aty në kashtë popi kishte kaluar shtatë ditë dhe shtatë net".[13] Pikërisht ky është ai Sait Pasha, i cili, në luftën e Deligradit, gabimisht përmendet me emrin Saip Pasha, të cilit Ibrahim Pashë Bushatliu i pati dërguar letër që të përgatitej për luftë kundër rebelëve serbë:

Librin e shtatë, veziri kishte hartuar
Në Prizren qytetin e bardhë,
Në atë Saip Pashën e ri:
Dëgjo dhëndër, pashë Saip:
Zgjidhe ushtrinë, sa më shumë të mundesh,
Dhe ma ndërto konakun në Prizren.

E më pastaj*:*

Saip Pasha u ndal për ta zgjedhur ushtrinë,
Ai grumbulloi Prizrenin e bardhë
Dhe gjithë rrafshin e Podrimës,
Gjithë Gorën e Siriniqin
Lumën e Tropojën dhe
U ndal ta priste vezir Bushatlinë.[14]

Sipas një burimi tjetër, në luftërat e pashallarëve osmanë kundër rebelëve serbë nën komandën e Ibrahim Pashë Bushatliut (i cili qe emëruar komandant suprem i forcave osmane kundër kryengritësve), - i qenë kërcënuar Karagjorgjit dhe kishin kërkuar nga ai që të dorëzohej, sepse Ibrahim Pashë Bushatliu kishte në dispozicion 10.000 ushtarë dhe se do të grumbullonte edhe 90.000 të tjerë. Ibrahim Pasha komandonte 6.000 ushtarë, Reshid Pasha nga Leskoci 5.000, Mahmud Pasha nga Nishi 1.800, Maliq Pasha nga Prishtina 1.600, Sait Pasha nga Gjakova 1.400 dhe Dervish Pasha nga Prizreni 1.600 ushtarë.[15]

[13] Petar Kostic, vep. cit., f. 26.

[14] Vuk Stef. Karaxhiq, *Serpske narodne pesme,* lib. IV, Beograd, 1896, f. 199.

[15] Dr. Aleksa Ivic, *Spisi beckih arhiva o prvom srpskom ustanku,* lib.VI-1, Beograd, 1965, f. 220.

Mirëpo, në hulumtimet tona të deritashme, nuk kemi hasur në ndonjë Dervish Pashë nga Prizreni. Sipas të gjitha gjasave, kemi të bëjmë me ndonjë gabim, sepse do të duhej të qëndronte Sait Pasha nga Prizreni (dhe jo nga Gjakova) dhe Mustafë Pasha nga Gjakova, për të cilin kemi të dhëna të sigurta se ka qenë shumë i angazhuar në luftërat kundër rebelëve serbë.

Ekziston një shkrim nga viti 1829, në të cilin bëhet fjalë për njëfarë igumeni Dionis, i cili paskësh nxjerrë lejen nga Mahmud Pasha dhe vëllai i tij Sinan Pasha, që të meremetonte manastirin "Tre të Shenjtit" në fshatin Mushtisht, që i takon rrethit të Prizrenit.[16] Është e sigurt se nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë Sinan Pashë, por vetëm për Sait Pashën, e kjo do të thotë se në atë kohë ai akoma ishte gjallë. Por kjo duhet të vërtetohet.

Sait Pashën në pozitën e mytesarifit të Prizrenit nga viti 1809 e trashëgoi Mahmud Pasha, i cili ishte një nga anëtarët më në zë të familjes Rrotllaj, i cili këtë pozitë e mbajti deri më 1836, – një rast fare i rrallë në administratën e Perandorisë Osmane. Autori i "*Kronikës"* së sipërpërmendur, Tahir Efendiu, i cili kishte qenë mirë i informuar, thekson se Mahmud Pasha ka qenë edhe vali i Nishit dhe Sofjes, por të dhëna më të afërta për këtë nuk kemi gjetur. Ka shumë të ngjarë që Mahmud Pasha ishte angazhuar në luftërat kundër rebelëve serbë nga viti 1809 deri në përfundim të shuarjes së rebelimit. Ai së bashku me Mustafë Pashën nga Gjakova, Shahin Pashën nga Leskoci, Ali Gushanin, Karafejzen dhe Maliq Pashë Gjinollin kishte marrë pjesë në betejën që qe zhvilluar në Kamenicë, më 19 maj 1809, në të cilën kryengritësit kishin përjetuar humbjen më të rëndë.[17] Në këtë betejë më së shumti qe dalluar *Maliq Pashë Gjinolli*,[18] i cili kishte kontribuu-

[16] Ljub. Stojanovic, *Zapisi i natpisi II,* nr. 4067.

[17] Milenko Vukiqevic, *Kamenicka pogibija 19 maja 1809 godne i njeni uzroci,* "Ratnik", sveska za juli 1909 godine, f. 979; J. Mishkovic, *Iz ratova srba sTurcima,* "Ratnik", 1882, sveska za decembar, f. 462-3. Sipas burimeve serbe, numri i ushtarëve turq që kishin marrë pjesë në këtë betejë, arrinë nga 30 mijë deri në 70 mijë, që është absurde.

[18] Edhe pse aty këtu ka të dhëna për Maliq pashën dhe djalin e vëllait të tij Jashar pashën, të cilët me vite kishin qeverisur Prishtinën dhe qytetet përreth, dhe ndonëse ata, duke uzurpuar pushtetin në kohën e anarkisë më të madhe feudale në Kosovë kishin arritur

ar më së shumti për humbjen e rebelëve. Për pjesëmarrjen e mëtutjeshme të Mahmud Pashës në luftërat kundër rebelëve serbë, nuk kemi të dhëna, por mund të thuhet me siguri se Mahmud Pasha kishte marrë pjesë në ripushtimin e Beogradit. Pas pushtimit të Beogradit, Mahmud Pasha kishte hyrë edhe në Smederevë, i kishte shkoqur tri kambana nga kishat e atjeshme, i kishte sjellë në Prizren dhe i kishte vendosur në *sahat-kullat* që i kishte ndërtuar vetë ai: një në Prizren, një në fshatin Mamushë afër Prizrenit dhe një në Rahovec. Ai kishte kërkuar

pasuri kolosale dhe kishin luajtur rol shumë të rëndësishëm në ngjarjet e viteve 1800 e deri me 1836, megjithëkëtë, për ta nuk është shkruar asnjë artikull. Sipas traditës, Gjinollajt kanë prejardhje nga Novobërda. Ata themeluan Gjilanin dhe së pari kishin pushtetin në ato anë. I pari nga kjo familje që u shpërngul në Prishtinë ishte Maliq pasha, i cili së shpejti vendosi pushtetin në gjithë Kosovën. Ai mori pjesë në betejën tek Deligradi në vitin 1806 dhe për të u këndua në këngën popullore serbe "Boj na Deligradu" (Vuk Stef. Karaxhiq, *Srpske narodne pesme*, lib.IV, Prosveta, Beograd, 1969, f.155, 157)

Në këngë, thuhet:

Librin e tetë veziri përgatit
Në Kosovë në qytetin Prishtinë
Për atë Maliq pashën e ri
"Maliq pashë krah krahine
Zgjidhe ushtrinë, sa më shumë të mundesh
Dhe ndërtoma konakun në Kosovë
Në Lipjan që të takohemi
Sepse gjaurri është ngritur me armë
Kosovës sa më afër me i ardhë…"
Kënga vazhdon:
Maliq pasha nisi të zgjedh ushtrinë
Ai grumbulloi gjithë rrafshin e Prishtinës
Dhe e grumbulloi Novobërdon të tërën
Janjevën me rrafsh
Dhe Vushtrrinë e bardhë
Mitrovicën me gjithë rrafsh
Banska Pallankën të tërën
Dhe gjithë Shalën mbi Mitrovicë
Dhe Drenicën nën Qyqavicë
Për të pritur vezirin Bushatli.

Për të ekzistojnë edhe këngë popullore shqiptare. Mirëpo, pas tri vjetëve, më 19 maj 1809, Maliq pasha i qe hakmarrë rebelëve serb tek Kamenica. Në atë kohë, Maliq pasha dhe pashai i Nishit, ngritën *Qelekullën*. Si duket, rreth vitit 1912, Maliq pasha vdes, dhe pasi nuk kishte lënë fëmijë meshkuj, pushtetin e trashëgoi djali i vëllait, Jashar Pasha, njëri nga pashallarët më të papërshtatshëm në Kosovë.

që në muret e Kalasë së Prizrenit të ndërtohej një Sahat-kullë dhe në të të vendosej mbishkrimi në gjuhën osmane, nga i cili qartë shihet pjesëmarrja e Mahmud Pashës në luftërat rreth pushtimit të Beogradit dhe Smederevës. Mbishkrimi sot nuk ekziston dhe ne e kemi marrë nga Jastrebovi, i cili atë mbishkrim e kishte ofruar të transkriptuar në cirilikë. [19]

زهي لطف اسي مولا كيم ايد ورمؤمنلره اكرام
مجاهدينه نصرتلربهر ساعت قيلوب انعام
بلغراد و سيندره هم مضافاتي نيجه قلع
اولوب فتحينه مأمور امريله چوق عسكر اسلام
لواء پرزرين واليس محمود پاشا ذيشان
مراد پادشاه اوزره جكوب صرب اوستونه اعلام
نيجه كفار صربك اوردیلر اعناقنه شمشير
عياللرى اسير اولوب دخى ماللر اعتنام
بعونيله ميسر اولدى چون فتح بلغرادك
مجرد نيتى خيريله پاشا ذو الاحسام
سمندره ده غنيمت الديغى ناقوس اعلابى
حصين بورجنده ساعت وضع ايدوب وقتى قيله اعلام
شكر بر اشرف ساعت كلوب نورىديدىتاريخ
بولند صدا جديد ساعت ايدر ايصال فراح پيام

Përkthimi i mbishkrimit, thotë:
Ja sa e bukur është mirësia e Allahut që i shpërblen besimtarët
1b Për çdo çast luftëtarëve për fe u bën mirësi
2a Beogradin dhe Smederevën me rrethinat e tyre dhe me shumë kësh-tjella

[19] I. Jastrebov, *Podaci za istoriju srpske crkve,* Beograd, 1875, f. 62-63. Ky mbishkrim është botuar edhe në turqishte me shkrim latin në punimin e përbashkët të Dr. Kemal Ozergin - Dr. Hasan Kaleshit dhe Ismail Erenit: *Prizren Kitabeleri,* Vakiflar Dergisi VII, Ankare, 1968, f.84.

2b Ushtria shumë e madhe myslimane ka marrë urdhrin t'i pushtojë
3a Po ashtu edhe valiu i Prizrenit Mahmud Pasha
3b Sipas dëshirës së Padishahut qe nisur dhe kishte valuar flamurin kundër serbëve
4a Shumë pabesimtarë serbë u therën me shpata
4b Familjet ua robëruan dhe pasuritë ua plaçkitën
5a Me ndihmën (e Allahut) u pushtua Beogradi
5b Pashai madhështor me një dëshirë që të bëjë vepër të mirë
6a Plaçkiti nga Smedereva kambanën e njohur
6b Dhe e vendosi si orë në kalanë e fortë që ta llogaritë kohën
7a Faleminderit (Allahut) që Nuri gjeti rastin e përshtatshëm ta tregojë kohën
7b Ora e re me tonin e saj kumbues lajmëron lajmin e gëzuar

Në të njëjtën kohë, saktësisht në vitin 1815, Mahmud Pasha kishte urdhëruar të ndërtohej Sahat-kulla edhe në fshatin Mamushë, jo fortë larg Prizrenit. Sahat-kulla gjendet në oborrin e xhamisë "Kamber-beu". Mbishkrimi gjendet në hyrje të Sahat-kullës, i gdhendur në një pllakë mermeri me shkrimin *thuluth*. Edhe vetë mbishkrimi flet se kambana është hequr nga një kishë në Smederevë dhe është sjellë në Mamushë. Teksti i mbishkrimit, thotë:

الله تعالى ايتدى هدايت — قلدى مظفر اولدى سعادت
سمندره نك ناقوس كفرين — محمود پاشا هم الدى غنيمت
خير نيتله ياپدرمسنه — ماموشه ايچون ايلدى همت
اقبال عمرى اولسون زياده — اتدقده افلاك دوره عزيمت
بر حوشچه چقدى نظميله تاريخ — اعلام اوقات اوله بو ساعت

Përkthimi:
1a Allahu i Madhëruar e udhëzoi në rrugën e drejtë
1b E bëri fitimtar, e kishte harruar fati
2a Kambanën e pabesimtarëve të Smederevës
2b Mahmud Pasha e fitoi si plaçkë
3a Me qëllim të mirë urdhëroi të ndërtohet

3b Bëri vepër të mirë për Mamushën
4a Fati i tij jetësor le të rritet
4b Kur të ndërron jetë
5a Ka lindur kronogrami i bukur në strofë
5b Lë të jetë kjo orë lajmëruese për kohët e namazeve
Në muajin ramazan 1230.



Mbishkrimi në Sahatkullë në Mamushë

E përmendëm se Mahmud Pasha kishte ndërtuar edhe një Sahat-kullë (të tretën) në Rahovec, e cila edhe sot e kësaj dite ekziston dhe tërësisht është e njëjtë me atë të Mamushës, por në këtë Sahat-kullë nuk ka mbishkrim. Në Rahovec ende mund të dëgjosh nga njerëzit e moshuar se kambana e Sahat-kullës është sjellë nga Serbia gjatë kohës së Kryengritjes së parë serbe.

Ndonëse një nga detyrat e pashallarëve shqiptarë ndaj Portës kishte qenë që kryesisht të merrnin pjesë në luftërat kufitare të Arnautllëkut, megjithëkëtë, pas kryengritjeve greke, pashallarët shqiptarë kishin marrë për detyrë që të merrnin pjesë edhe në shuarjen e atyre kryengritjeve. Ka të ngjarë që Mahmud Pashë Rrotlla, po edhe pashallarët e tjerë, që në Shëngjergj 1821, të qenë nisur për More,[20] kurse Vasa Popoviq, më 29 qershor 1824, e njoftonte Milloshin nga Karanovci se Pashai i Shkodrës, Numan Pasha i Pejës dhe Mahmud Pashë Rrotlla kanë pasur humbje të mëdha në More tek Misolungi.[21] Nga ky fakt mund të nxjerrim konstatimin se nga viti 1822 deri më 1824, Mahmud Pasha kishte qenë i angazhuar në luftërat për shuarjen e kryengritjes greke.

Periudha tjetër e Mahmud Pashës në pozitën sanxhakbeut, është koha kur Porta tentonte të bënte reforma të ndërmarra nga sulltan Selimi III dhe të vazhduara nga Mahmudi II, në mënyrë që sërish të vendoste pushtetin e vet në provincat, në të cilat qenë forcuar lloj-lloj pashallarësh që sundonin gati të pavarur dhe duke luftuar në mes vete rreth zgjerimit të territoreve nën pushtetin e tyre. Një nga këto konflikte me përmasa më të mëdha, ndodhi në vitin 1827 midis Mustafë Pashë Bushatliut dhe Numan Pashës nga Peja. Shkas për këtë konflikt qe dëshira e pashait të Shkodrës për t'i përfshirë nën pushtetin e vet territoret e sanxhakut të Pejës. Në mars 1827, Mustafë Pasha me ushtri i qe drejtuar Pejës, por nuk arriti të realizonte qëllimin. Ky konflikt u zgjerua edhe më shumë vitin që pasoi, atëherë kur në këtë konflikt qenë përzier edhe pashallarët e tjerë - disa në anën e Mustafë Pashë Bushatliut, kurse disa në anën e pashait të Pejës. Zotëruesi i Prizrenit, Mahmud Pashë Rrotlla, me disa liderë të tjerë (Hysen Hoti nga Peshteri, Sylejman aga nga Bijello-Polja) qenë rreshtuar në anën e Mustafë Pashë Bushatliut, kurse Jashar Pasha nga Prishtina dhe Gjylbegu nga Gucia qenë rreshtuar në anën e Numan Pashës nga Peja. Edhe pse këto turbullira reciproke qenë ndërprenë përkohësisht gjatë luftës rusoturke, megjithatë, ato vazhduan edhe më vonë[22] dhe zgjatën deri në shkatërrimin e lëvizjes për pushtet të shqiptarëve. Në qoftë se i besohet të dyshimtit Panti Sreçkoviq, një luftë e këtillë qe zhvilluar mes sanxhakbeut të Shkupit - Hamza Pashës dhe Mahmud Pashë Rrotllës.

[20] Danilo Vulovic, *Nahija Pozheshka (1815-1839),* Beograd, 1893, f. 138.
[21] Danilo Vulovic, vep, cit. f.138.
[22] Më gjerësisht, Vladimir Stojancevic, *Jugoslovenski narodi u Osmanskom carstvu od Jedrenskog mira 1829 do pariskog kongresa 1856 godine,* Beograd, 1871, f. 46.

Pashait të Shkupit i kishte shkuar përdore që nga Mahmud Pasha të grabiste Dukagjinin dhe ta mbante nën pushtetin e vet rreth dy vjet. Në atë luftë në Brod të Gorës ishin vrarë rreth 600 prizrenas.[23]

Në lëvizjen e madhe shqiptare kundër reformave të Sulltan Mahmudit II, në krye të secilës qe vënë Mustafë Pashë Bushatliu, - në burimet serbe i mbiquajtur Pashai i Shkodrës, - Mahmud Pashë Rrotlla ishte pjesëmarrës aktiv. Mustafë Pasha më 19 mars 1831 kishte arritur në Prizren me ushtarët e vet dhe më 27 mars, së bashku me ushtritë e pashallarëve të tjerë, kishte hyrë në Shkup. Mahmud Pasha haptazi qe rreshtuar në anën e Mustafë Pashës dhe në operacionet e mëvonshme ishte nënkomandant.[24] Mirëpo, me këtë sjellje ata dhe aleatët e tyre shkaktuan shqetësim të hapur te sulltani, andaj Shejhul-islami, *Jazinxhi-zade Abdylvehab Efendiu*, kishte lëshuar fetvanë me të cilën Mustafë Pasha dhe aleatët e tij qenë shpallur tradhtarë.[25] Pasi në Shkup kryengritësit kishin hartuan planin e luftës, ata i qenë drejtuar vezirit të madh Mehmed Reshid Pashës, i cili më herët qe dërguar që me forcë t'i zbatonte reformat dhe t'i qetësonte shqiptarët. Për ta ndalur përparimin e vezirit, i cili pa ndonjë rezistencë të fortë kishte marrë Dibrën, Elbasanin, Tiranën dhe Kavajën, Mustafë Pasha me aleatët e tij qe nisur për Veles dhe Manastir. Mirëpo, në vend se me forcat e veta të sulmonte forcat e Reshid Pashës, ai e kishte ndarë ushtrinë në dy pjesë: një pjesë nën komandën e Ali Beg Karafejzit, e kishte drejtuar për në Sofje, ku pas rrethimit katërdhjetëditor, më 23 prill 1821, kishte arritur ta pushtonte,[26] kurse vetë me pjesën më të madhe të ushtrisë dhe me disa pashallarë të tjerë, ia kishte mësyrë Velesit. Duke ditur për planet e Mustafë Pashës, Veziri i Madh me ushtrinë më të madhe e më mirë të përgatitur dhe me rreth 1.500 toskë të paguar[27]

[23] P. Sreckovic, *Sinan pasha,* Beograd, 1865 ff.102.

[24] P. Vukanovic, *Arbanashki ustanci 1826-1832,* Vranski glasnik, lib.V Vranje, 1969, f.46.

[25] Lutfi, *Tarih,* III, f.186 dhe më tej.

[26] Islam Ansiklopedi, *Mustafë pasha Ishkodrali-Bushatli-Sherifi.*

[27] Edhe pse rëndom konsiderohet se shqiptarët e Shqipërisë Veriore dhe të Kosovës ishin mercenarët më të besueshëm të turqve, ky mendim është i gabuar, sepse nga shek. XVII e tutje kemi një varg të dhënash që flasin për toskët, duke i përfshirë edhe ata ortodoks, si mercenarët më të mirë të turqve. Mbase edhe në shuarjen e lëvizjes shqiptare të viteve 1910-1912, toskët luajtën rol shumë të rëndësishëm si mercenarë turq.

nga Janina, ishin nisur drejt Manastirit. Mirëpo, në të tri këto beteja, aleatët e Mustafë Pashës përjetuan humbje, kurse në betejën vendimtare që u zhvillua afër Babun-Hanit, në një ngushticë midis Velesit dhe Prilepit, Mustafë Pasha kishte pësuar humbje të rëndë, në të cilën qenë vrarë e lënduar rreth 2.000 ushtarë dhe disa mijëra të tjerë qenë zënë robër.[28] Me rreth 100-150 ushtarë, Mustafë Pasha, përmes Luginës së Preshevës, Karadakut, Grykës së Kaçanikut nëpër Zhup, kishte arritur në Prizren[29] dhe qe përpjekur që përmes aleatit të tij, Mahmud Pashës, të grumbullonte ushtarë të rinj. Edhe pse kishte ofruar rrogë të mirë, atij nuk i kishte shkuar përdore një gjë e tillë, sepse popullatën e kishte përfshirë frika nga ardhja e Vezirit të Madh me ushtrinë e tij. I dëshpëruar, Mustafë Pasha qe tërhequr në Shkodër[30] dhe qe mbyllur në Kështjellën e Rozafës gati gjashtë muaj (nga maji deri në tetor 1831), dhe ishte i rrethuar nga 15.000 ushtarë të Perandorisë Osmane nën komandën Giridi-zade Mehmed Pasha. Mirëpo, kur kishte parë se ushtria nuk kishte ndër mend për t'u larguar dhe pasi më 20 shtator 1831 kishte gjuajtur rrufeja në depon e armëve, e cila kishte eksploduar dhe kishte mbytur 40 njerëz dhe dy gratë e tij, si dhe qe rrëzuar muri i kështjellës në anën e liqenit,[31] Mustafë Pasha e kishte njoftuar Vezirin e Madh se do të dorëzohej nëse do të falej, madje e kishte dërguar edhe njeriun e besueshëm te Meterniku që të ndërmjetësonte tek Porta për ta falur. Para se të arrinte fermani për falje, ai më 9 tetor

[28] Të dhënat se Mustafë pasha ka pasur 40.000 - 60.000 ushtarë, se janë robëruar 10.000 bashibozuk të tij (në disa burime bile thuhet 14.000), shihet qartë se këto të dhëna janë të tepruara. Burimet turke theksojnë se në betejën tek Babunhani kishin marrë pjesë gjithsej 10.000 shqiptarë.

[29] Më gjerësisht, T. P. Vukanoviq, vep. e cit., f. 48.

[30] Është interesante letra e princ Milloshit dërguar Mustafë pashë Shkodrës, ku e qorton këtë të fundit për shpirtvogëlsi pse e kishte lëshuar Prizrenin dhe qe mbyllur në Kalanë e Shkodrës, duke i thënë: "Unë kurrë as në ëndërr s'kisha mundur të ëndërroja se vepra juaj do të kalojë kështu siç kaloi… Sikur unë të kisha vepruar ashtu dhe menjëherë të përulesha, nga unë s'do të kishte asgjë". (Më gjerësisht Mih. Gavrilloviq, Milosh Obrenoviq III, Beograd 1912, f.394; T. P.Vukanoviq, vep, cit.,f.54).

[31] Artikulli i përmendur në *Islam Ansiklopedisi.* Gjithë kjo lëvizje më së miri është paraqitur në librin e Drag. M. Pavloviqit, *Pokret u Bosnji i Albaniji protiv reformama Mahmuda II,* Beograd, 193 ?

1831 i qe dorëzuar Vezirit të Madh, dhe, në përcjellje të Ahmed Fevzi Pashës, qe dërguar në Stamboll.[32]

Në kohën kur Mustafë Pashë Shkodra kishte pësuar humbje pas humbjeje dhe pasi qe përballë me vështirësi të mëdha, kryengritësit boshnjakë në komandën e Hysejn Gradashqeviçit ngadalë qenë drejtuar kah jugu. Në pranverë 1831, ushtria boshnjake përmes Prijepoljës, Sjenicës dhe Pazarit të Ri i qe drejtuar Kosovës që t'i mbronte kufijtë e Pashallëkut të Bosnjës kundër depërtimit të ushtrisë osmane nën komandën e Vezirit të Madh. Në Kaçanik më 16 korrik 1831, qe zhvilluar një betejë midis ushtrisë boshnjake dhe pararojës ushtarake të Vezirit të Madh, e pak më vonë, te Lipjani, plotësisht qe mundur ushtria turke, qenë vrarë dhe plagosur disa pashallarë, qe plagosur madje edhe vetë Veziri i Madh, kurse në duar të kryengritësve kishin rënë rreth 2.000 ushtarë dhe gati gjithë artileria. Si duket, kësaj fitoreje të boshnjakëve më së shumti i kishte kontribuar Mahmud Pashë Rrotlla, i cili më herët me ushtrinë e vet i qe dorëzua Vezirit të Madh dhe qe bashkuar me të, por në momentin vendimtar ai kishte kaluar në anën e boshnjakëve. Madje edhe vetë Veziri i Madh, *Reshid Pasha*, e kishte akuzuar Mahmud Pashën për tradhti,[33] dhe për humbjen e pësuar, dhe kjo më vonë do t'i kushtonte me kokë (Mahmud Pashë Rrotullës- vër. përk.). Mirëpo, Gradashqeviç dhe aleatët e tij nuk ditën ta shfrytëzonin fitoren dhe në vend që të vazhdonin me sulme, qenë mashtruar nga dredhia e Vezirit të Madh, i cili i kishte premtuar Gradashqeviçit se do të përpiqej te sulltani të nxirrte një ferman, me të cilin Gradashqeviçin do ta emëronte beglerbeg të Bosnjës.[34] Pasi boshnjakët qenë kthyer nga Kosova, Hysen Gradashqeviçit i kishin shkuar natën në këshillim Jashar Pasha nga Prishtina dhe Mahmud Pashë Rrotlla.[35] Mi-

[32] Duke arritur në Stamboll, Mustafë pasha së pari u vendos në një konak afër xhamisë *Sylejmanije*, më pastaj i qe kthyer pasuria, i qe dhënë titulli *mirmiran*, i qe vesh uniforma e nizamit dhe qe ftuar në saraj. Nga janari i vitit 1845 deri në vdekje të tij, Mustafë pasha kreu detyrën e valiut në Bol, Kastamuni, Adanë, Marash, Hercegovinë, Konjë, në Arkipelagun e Egjeut, Halep dhe në Izmir. Në vitin 1860 qe marrë edhe me shkrime dhe me poezi. Djali i tij Hasan Haki pasha ka qenë vali i Halepit dhe konsiderohej si shkrimtar dhe shkencëtar i aftë (Më gjerësisht në *Islam Ansiklopedisi,* artikulli i theksuar).

[33] Vladimir Stojanqeviq, vep, cit. f. 60; Danilo Vuloviq, vep, e cit. f. 340.

[34] Më gjerësisht në punimet e Drag. Pavloviçit dhe të T. P. Vukanoviçit.

[35] Danilo Vuloviq vep. e cit., f. 354.

rëpo në bazë të zhvillimeve të mëvonshme, mund të përfundohet se bisedimet e tyre nuk dhanë ndonjë rezultat, sepse, menjëherë pas tërheqjes së ushtrisë boshnjake, në mesin e pashallarëve shqiptarë kishte mbretëruar anarkia, sepse ata kishin vërejtur se ushtria osmane po përmbyste çdo rebelim, çdo rezistencë. Kështu që të gjithë pashallarët shqiptarë do të kalonin, njëri pas tjetrit, në anën e Vezirit të Madh. Gjatë tetorit 1831, Kersta Jovanoviq, spiun i Millosheviqit, me urdhër të këtij të fundit kishte shkuar në Prizren dhe Gjakovë dhe, personalisht nga Mahmud Pasha, kishte dëgjuar se Pashain e Shkodrës e kishin lënë vetëm, përveç të afërmëve, dhe se ushtria e Mahmud Pashës kishte marrë pjesë në shuarjen e kryengritjes në Shqipërinë Jugore.[36] Petar Lazareviq, në bazë të informatave që kishte marrë në Kosovë me shaka e njoftonte Milloshin nga Karanovci se Mahmud Pasha dhe vëllai tij Emin Pasha nuk e dinë "të kujt janë dhe si janë".[37] Duke menduar se do të ishin të pastër para administratës osmane, në fillim të muajit maj 1832, Mahmud Pashë Rrotlla, Jashar Pasha nga Prishtina,[38] dhe Ismail Pasha nga Leskoci do të kontribuojnë për humbjen e ushtrisë boshnjake te Prijepolja.[39]

[36] Danilo Vuloviq vep. e cit. f. 311. Miloshi gjithnjë ka qenë i informuar mirë për ato që po ngjanin në Kosovë dhe Shqipërinë Veriore. Njerëzit e tij, të dhëna më të shumta merrnin nga Gjakova, kurse njëfarë Hasani nga Gjakova dhe biri i tij Hamzai, i kishin sjellë Vasa Popoviqit në Cacak tri barrë armesh dhe i kishin dhënë informacione për konfliktin midis Jashar pashës nga Prishtina dhe Llaojanëve.

[37] Danilo Vulovic, vep, e cit. f. 336.

[38] Jashar pasha e trashëgoi xhaxhain e tij, Maliq pashën, që ishte pushtetmbajtës i Prishtinës dhe i një pjese të madhe të Kosovës. Ai së bashku me pashallarët e tjerë të Kosovës, i bëri rezistencë të madhe reformave të sulltan Mahmudit II; ai mori pjesë në luftërat kundër vezirit të madh, Mehmed Reshid pashës në anën e Mustafë pashë Bushatliut, pastaj mori pjesë në luftërat në mes të Gradashqeviqit dhe ushtrisë nizame turke; ai, përveç kësaj, radhitej herë në një anë e herë në anën tjetër, duke u përpjekur t'i ikte fatit të pashallarëve të tjerë. Atij deri diku i shkoi përdore të ikte nga hakmarrja e sulltanit në fazën e parë dhe të nxjerrë gradën mytesarif i Shkupit. Në Shkup i vdiq djali më i vjetër, Bahtiar Pasha, kurse për shpirt të tij, Jashar Pasha, në Prishtinë ndërtoi xhaminë, e cila edhe sot ekziston dhe nga mbishkrimi origjinal i xhamisë shihet se është ndërtuar në vitin 1250/1834-5. Në Shkup qëndroi plotë dhjetë vjet si mytesarif, e më pastaj, meqë ishin burgosur, likuiduar dhe internuar pashallarët kosovarë, të cilët kishin bërë rezistencën më të madhe kundër reformave, në Stamboll qe ftuar edhe ky (Jashar Pasha) dhe në vitin 1840 qe likuiduar. Është varrosur në Stamboll në kuartin Shehzade-bashi.
Jashar Pasha pas vdekjes ka lënë djalin Abdurrahman pashën, për të cilin dihet fare pak. Ky i fundit pas veti ka lënë katër djem: Zija begun, Ibrahim begun, Ali Danish begun

Nga viti 1832 deri më 1835 në Shqipëri dhe në Kosovë kishte vazhduar lufta kundër reformave, edhe pse ajo kishte rënë nga intensiteti. Përmasa më të mëdha kryengritja kishte marrë në vitin 1835, në të cilën kryengritje morën pjesë shumë pashallarë kosovarë. Por, pas humbjes së Mustafë Pashë Shkodrës dhe Gradashqeviqit, Veziri i Madh i kishte duart e lira që t'i nënshtronte pashallarët kosovarë. Çfarë aksione politike kishte ndërmarrë Mahmud Pasha që ta shpëtonte lëkurën e vet, këtë ne nuk e dimë.

Në fund të tetorit 1835, Veziri i Madh kishte dhënë urdhër që të burgoseshin Haki Pasha nga Dibra, Islam Pasha nga Peja dhe Sejfedin Pasha nga Gjakova si dhe disa kadilerë dhe myftinj, të cilët ishin deklaruar kundër reformave, duke i konsideruar ato akte kundër Sheriatit.[40]

Në fund të gushtit 1836, valiu i Rumelisë, së bashku me Fejzi Pashën e Shkupit dhe me një ushtri prej 40.000 ushtarësh, kishte hyrë në Prizren. Mahmud Pasha nuk kishte pasur guximin që ta priste atë, por kishte ikur në Lumë, në vendlindjen e të parëve të tij. Vëllai i tij, Emin Pasha, qe dorëzuar, kurse valiu kishte dhënë urdhër që ky të vihej në pranga së bashku me 24 bashkëpunëtorët më të ngushtë të Mahmud Pashës. Që ta kapte Mahmud Pashën, valiu Tangroglli i kishte dhënë besën se do ta falte dhe se do t'ia lironte edhe të vëllanë. Mirëpo, kur Mahmud Pasha qe dorëzuar, në fshatin Akt (?), valiu kishte shkelur fjalën e dhënë dhe më 29 gusht 1836 e kishte dërguar Mahmud Pashën në Stamboll, e nga këtu e kishin dërguar në Boll të Anadollisë ku e kishin mbytur.[41] Asokohe në Anadoll qenë internuar edhe Arsllan Pasha i Pejës dhe shumë të tjerë. Në këtë mënyrë qe likuiduar numri më i madh i pashallarëve dhe bejlerëve më të mëdhenj, dhe kështu iu dha fund shtëpive trashëguese, sikur që ishin Rrotllajt në Prizdhe Fuad Pashën. Këta dy të fundit kanë luajtur rol të rëndësishëm në lëvizjet shqiptare pas revolucionit xhonturk, ndërsa Ali Danish begu ka qenë edhe ambasador i Turqisë në Moskë, ministër dhe shkrimtar.

[39] Vladimir Stojanqeviq, vep. e cit. f. 68.

[40] Vladimir Stojanqevic, vep. e cit. f. 220.

[41] Danilo Vulovic, vep, e cit. f. 477.

ren, Gjinajt në Prishtinë; iu mohuan të gjitha të drejtat Mahmudbegollajve të Pejës, pastaj pashallarëve nga Tetova, Shkupi, Vrana, Leskoci, Dibra etj.[42]

Ndryshe, Mahmud Pashë Rrotlla i takon asaj plejade të pashallarëve të shkolluar të kohës. Që të riparonte ose të ndërtonte shumë institucione fetare e kulturore dhe të meremetonte Kalanë e Prizrenit, ai kishte ndihmuar për vendosjen e muratorëve vlleh, të cilëve u kishte dhënë tokë për të ndërtuar shtëpitë e tyre.[43] Me kalimin e kohës qe formuar një koloni e fortë vllahe në Prizren, e cila kishte grabitur kishën e "Shën Shpëtimit" dhe e kishte mbajtur deri më 1912.[44] Nga Prizreni, vllahet qenë larguar në Ferizaj, ku në vitet e tetëdhjeta në duart e tyre mbanin pjesën më të rëndësishme të tregtisë. Mahmud Pasha dhe vëllai i tij Emin Pasha, mund të konsiderohen nismëtarë të modernizmit urban të Prizrenit. Ai mbante lidhje me princin Millosh dhe ishte mbrojtës i Patrikanës së Pejës dhe Manastirit të Deçanit.[45] Ai është meritor si edhe Kurt Pasha nga Gjakova që për mitropolit të Prizrenit të zgjidhej Haxhi Zahariu e jo greku. Padyshim, meritë e tij është që gjatë kohës së tij kanë vepruar dy shkolla serbe private.[46] Nga ana tjetër, si sundues të pavarur, Rrotllajt kishin uzurpuar shumë hase perandorake, vakëfe dhe pasuri të tjera dhe kështu kishin arritur të ishin pronarë të shumë pasurive, të cilat i kishte trashëguar vajza e Emin Pashës, *Umu Kulthum*, e më pastaj, e gjithë kjo, kishte shkuar në moskthim.

[42] Vladimir Stojanqevic, vep. e cit. f. 220

[43] Petar Kostic, vep. e cit. f. 80

[44] Petar Kostic, vep. e cit. f. 80. Pikërisht përmes këtyre vllaheve më vonë qeveria greke ka tentuar që në Kosovë të hapte shkolla greke.

[45] Vladimir Stojanqeviq, *Problemi saradnje balkanskih naraoda u narodnooslobodilackim pokretima u Turskoj u prvoj polovini XIX veka*, JIQ 4|1964,f.58.

[46] Petar Kostiq, vep. e cit. f. 114. Nga ana tjetër, I Jastrebov, (Stara Srbija i Albanija, Beograd, 1904, f. 80-81), për të cilin nuk mund të thuhet se ka qenë i informuar, por as të këtë qenë objektiv, thotë se me islamizmin e pashallëkut të Prizrenit dhe të Prishtinës janë ndryshuar jo vetëm konfesionet, por me kalimin e kohës edhe gjuha. Kjo dukuri, e cila kishte filluar nga fundi i shek. XVIII, u forcua gjatë kohës së Mahmud Pashë Rrotllës.

Pas intervenimit të Mahmud Pashës, në pozitën e mytesarifit të Prizrenit, erdhi Emin Pasha, të cilin pushtetarët osmanë e kishin falur. Edhe për Emin Pashën nuk kemi mjaft të dhëna, por dimë për përshpirtnimet (vakëfnimet) e tij. Sipas sallnamesë së Vilajetit të Prizrenit për vitet 1873-1874, Emin Pasha ishte sanxhakbej i Prizrenit gjatë viteve 1842-1843. Ai në Prizren kishte ndërtuar një xhami dhe një medrese. Xhamia është ruajtur deri në ditët e sotme, dhe, sipas *"Kronikës"* së Tahir Efendiut, është ndërtuar sipas modelit të xhamisë "Sinan Pasha", por është shumë më e vogël. Në hyrje të xhamisë, në anën e jashtme, mbi dyer, gjendet një pllakë e mermertë me dimensione 42x51 cm, në të cilën, me shkrimin *thuluth*, është gdhendur ky mbishkrim:

Mbishkrimi në xhaminë Emin Pasha në Prizren

صاحب الخيرات و الحسنات پرزرينى طاهر پاشازاده محمد امين پاشا يسرالله تعالى كل ما فى الدارين ما يشاء فى سنة سبع و اربعين و ماء تين و الف

سنه ١٢٤٧

"Bamirësi është nga Prizreni, Tahir pashazade Muhamed Emin Pasha, - le t'ia lehtësojë Allahu (që të arrijë) gjithçka që dëshiron në të dy botët. Viti njëmijë e dyqind e dyzet e shtatë. Viti 1247.[47]

Në oborrin e xhamisë gjendej medreseja e tij. Në të ka ligjëruar autori i *"Kronikës",* Mehmed Tahir efendiu. Objekti i medresesë është ruajtur deri tani. Në murin e medresesë gjendet pllaka e mermertë me dimensione 67x55 cm në të cilën, me shkrimin *thuluth*, në dy kolona është gdhendur mbishkrimi që flet për meremetimin e medresesë, të cilën e ka ndërtuar Emin Pasha. Mbishkrimi thotë:

الحمد لله كه معمار مروت ايلدى آبار دل عاشق كبى نالان ايكن بو موضوع پور نور

يكيدن قلديلر اشبوا محل درس آبادا الهى پرزرين اهلك بو سعيك ايلكل مشكور

اوله هر بر شجر حار مغيلان چشم اعدايه خدا آبار ايده دائم بد انديشى اوله مقهور

انى اعمار ايدنلر نائل اولمزمى مثوباته اولور احياسنه سعى ايلينلر خيرايله مأجور

جهانده كرچه دل شار اولدى جمله مؤمنين اما الور عقباده هم روح امين پاشا دخى مسرور

كتاب جفر عقليده بو وجه اوزره محررد خلوص اوزره بنا اولدى اولور خيرابد موفور

...دستيله مشغول نحيف طاهر ديدى تاريخ موفق اوله ياديان اوله علم عمل منشور



Mbishkrimi në murin e ish-medresesë Emin Pasha

[47] Viti 1247 fillon më 12 VI 1831. Mbishkrimi është botuar me turqishte latine në artikullin e përmendur të Ozrenit, Kaleshit dhe Erenit në "Vakiflar Dergisi" në Ankara.

1a Faleminderit Zotit Që e ka përjetësuar ndërtuesin e veprave të mira.
1b Ky vend i ndritur, me dritën e Zotit, sikur zemra e të dashuruarit kur gufon.
2a E bënë këtë medrese përsëri të ndritur.
2b O Zot, prano falënderimin për përpjekjen e banorëve të Prizrenit
3a Lë të jetë secili dru zjarr që djeg në sytë e armiqve.
3b Lë ta bëjë gjithmonë Zoti të lulëzuar, lë të jetë i shkatërruar ai që mendon keq.
4a Ata që e kanë ndërtuar, vallë, a nuk janë të denjë për sevap?!
4b Ata që përpiqen për meremetimin e saj shpërblehen me shpërblim.
5a Vërtet në këtë botë zemra e besimtarit është e mbushur me lumturi, por
5b Në këtë botë shpirti i Emin Pashës po ashtu do të jetë i lumtur
6a Në këtë mënyra në librin e fatit ka qenë e shkruar.
6b Është ndërtuar në themelet e sinqeritetit, ajo do të jetë bamirësi e plotë e përhershme.
7a Me dorën e vlefshme Tahiri i dobët e tha kronikën:
7b O Ti që shpërblen, bëre që të këtë sukses zgjerimi i diturisë dhe i lutjeve.

Në bazë të këtij mbishkrimi mund të përfundohet se Emin Pasha këtë medrese e kishte rindërtuar dhe nuk e kishte ndërtuar nga themeli.

Emin Pasha kishte ndërtuar edhe një çezme në fshatin Mamushë, e që gjendej para xhamisë. Çezma sot nuk ekziston, por ka mbetur pllaka e mermertë, e cila ruhet në oborrin e xhamisë, në të cilën është gdhendur ky mbishkrim:

حاصل عمر اولدی خیر و حسنات ای مهلقا سعی ایدوب ایله جهانده نام نیکو ابتغا
میر میران کرامدن منبع جود و همم اعنی طاهر پاشا زاده پاك دل امین پاشا
خیرواثر عمر ثانی اولدیغن فهم ایلیوب فی سبیل الله قلدی نیجه چشمه ابتغا
آب خوشکواره تشنئة لب ماموشه ده دشت ولهسرادن اقیدوب ماءحیات جان فزا
چقدی اوچلر نوریادی تاریخن هم دیدیلر چشمه سندن ایج صوین پاشایه ایلسن دعا

1a Rrjedha e jetës është bërë vepër e mirë, oj bukuroshe!
1b Është përpjekur duke dëshiruar që në këtë botë të arrijë autoritet,
2a Fisniku paqedashës, burim i bamirësisë dhe i së mirës
2b Ky është Tahir Pasha biri i Emin Pashës, zemra e të cilit është e pastër.
3a E ka kuptuar se vepra e mirë është si jetë e dytë.
3b U ka vendosur themelet shumë krojeve për hir të Zoti
4a Uji i këndshëm për shpirtrat e etshëm në Mamushë
4b Përmes rrafshinës dhe...ka rrjedhur ujë nga i cili zemra rritet
5a Paraqitet treshja - Nuri thuaje strofën kronistit - dhe ata thanë:
5b Pi ujë nga kroi, lë të lutën për pashanë.

Nga "Kronika" del viti 1232 sipas Hixhrit, i cili i përgjigjet vitit 1816.

Në oborrin e ndërtesës, në të cilin sot gjendet zyra e Lidhjes Socialiste(?!), e ku më herët ka qene mejtepi, gjenden varrezat, ku është edhe varri i Emin Pashës. Në gurin e varrit të Emin Pashës është gdhendur ky mbishkrim:

Guri mbivarror i Emin Pashës në oborrin e xhamisë

الحكم لله

جهانك مالنه اقبالنه اولمه صقين مغرور

كلن كيتمكده در ايله نظر همواره دنيايه

غريق مند رحمت صچه امين پاشا بن طاهر پاشا

جهان اقليمى ترك ايليوب عزم ايتدى عقبايه

ندايه ربى ارجعى صماخ جانى اولدقده

فداى جسم ايدوب جان ايتدى جناب رب عليايه

الهى ايلمه محزون يارين روز قيامتده

او مرحومى دخى شايسته قل غفران عظمايه

سنه ١٢٥٩

Mos u bën krenar kurrsesi për pasuri dhe lumturi të kësaj bote
Shih në këtë botë të rrafsh - ata që vijnë dhe shkojnë
Emin Pasha, biri Tahir Pashës, lë të jetë i përfshirë nga mëshira e Zotit.
Duke u larguar nga kjo botë, është shpërngulur në amshim
Kur shpirti tij nga Zoti kishte dëgjuar thirrjen "Mu kthe"
Ai duke e flijuar trupin me dëshirë të madhe kishte dashur të shkonte tek Ai,
O Zot, mos e dëshpëro nesër në botën tjetër
Atë të ndjerë bëre të jetë i denjë për falje mëkatesh
Viti 1259.[48]

Si duket, nga Emin Pasha ka ngelur vetëm një vajzë, Umu Kulthum, e cila në vitin 1327 (1909) kishte kërkuar që *Vakëfnameja* e saj të hartohej në Yskidar afër Stambollit, me të cilën kishte lënë vakëf dy lokalet e saj në Prizren për mbajtjen e mejtepit të saj, të cilin ajo e kishte ndërtuar në Prizren.[49] Për këtë mejtep nuk kemi kurrfarë të dhënash. Të dhëna të tjera për Emin Pashën ne nuk kemi, përveç vitit

[48] Viti 1259 sipas Hixhrit fillon më 1.II.1834. Mbishkrimi është botuar me turqishte latine në artikullin e sipërpërmendur të Ozrenit, Kaleshit dhe Erenit.

[49] Një përshkrim i kësaj Vakëfnameje gjendet në Zyrën e Vakëfit në Prizren (sot Këshilli i Bashkësisë Islame. – vër. përkth).

të vdekjes së tij (1843), i cili shihet në mbishkrimin e gurit të varrit, të cilin e përmendëm më lart.

***

Tani të kthehemi te përmendoret e Mahmud Pashës dhe Vakëfnameja e tij. Mahmud Pasha në Kalanë e Prizrenit ndërtoi xhaminë, e cila më herët ka ekzistuar dhe padyshim është ndërtuar me rastin e riparimit të kalasë nga pushteti osman, sepse ka qenë traditë që në kala, për shkak të rrethimeve, të ndërtoheshin xhami. Mirëpo, ajo xhami qe rrënuar deri në themel, me siguri gjatë kohës së invadimit austriak në Prizren, kur pësuan të gjitha objektet e kulturës islame. Këtë xhami të rrënuar, Mahmud Pasha e kishte ndërtuar nga themeli. Kah fundi i sundimit të pushtetit osman ajo sërish qe rrënuar dhe më nuk u rindërtua. Ekziston një fotografi e vjetër e Kalasë së Prizrenit nga periudha osmane, në të cilën kjo xhami shihet mirë, por me këtë rast nuk kemi mundur të arrijmë te fotografia. Mahmud Pasha po ashtu kishte ndërtuar xhami dhe medrese afër sarajeve të tij. Xhamia nuk është ruajtur, por ka mbetur mbishkrimi, i cili tani gjendet në ndërtesën e Zyrës së Vakëfit në Prizren. Mbishkrimi është skalitur në një pllakë të mermertë, me dimensione 67,5x53,5 cm. Rreshtat janë të kornizuar, kurse shkrimi, me të cilin mbishkrimi është shkruar, është thuluth. Mbishkrimin e ka hartuar poeti, mësuesi dhe sekretari i Mahmud Pashës, - Nuri. Teksti i mbishkrimit, thotë:

حالكده وسعت اولنجه (؟) خيراتدن اولمه بر لحظه مبعود

عقباده صاحب خيره ويريلور آل مراتب اولمش چو موعود

دنياده داخى خيرايله آدى مذكور اولوبدر خلقك دلنده

هم جامع ابنا ايدن كشيلر حقنده مژده معلوم و مشهود

حين فتحده قلعه ايچنده انشا اولمش جامع و معبد

چوق وقت وازمان كچمكله اولدى خاكيله يكسان ويران و نابود

پاشاى محمود والئ ولايت خيراته مائل صاحب ديانت

بر طرز رعنا قلعه ده جامع ایلدی ابنا اول ذات مسعود

بر کلمکیله خوش تکمیل اولمش کورنجه نوری سویلدی تاریخ

بو جامع دلزیب ایچنه کیر قیل اولسون نمازك مقبول معبود

سنه م ؟ = محرم /۱۲۴۴



Mbishkrimi në xhaminë "Mahmut pasha" në Prizren

Ja O shpirt, kur është gjendja jote plot, mos u largo për asnjë çast nga bamirësia
1b Në Ditën e Gjykimit mirëbërësit i ndahet shkallë e lartë, siç është thënë
2a Edhe në këtë botë po ashtu populli ia përmend emrin për të mirë
2b Për ata që ndërtojnë xhami shpërblimi është i njohur dhe i dëshmuar
3a Gjatë kohës së pushtimit në kala ka qenë e ndërtuar xhamia-faltorja
3b Me kalimin e kohës është rrënuar rrafsh me tokë dhe është zhdukur
4a Valiu i devotshëm Mahmud Pasha që ka prirje për bamirësi
4b Ai personalitet i lumtur ka ndërmarrë që në kala me pamje të bukur të ndërtohet një xhami
5a Kur erdhi Nuri dhe pa se është e bukur, shkroi një vjershë
5b Hyn në këtë xhami të stolisur, falu që lutja të të pranohet tek Allahu
Në vitin 1244.[50]

[50] Viti 1244 sipas Hixhrit fillon më 14.VII.1828. Mbishkrimi është botuar me turqishte latine në artikullin e sipërpërmendur të Ozrenit, Kaleshit dhe Erenit në "Vakiflar Dergisi" në Ankara.

Në lagjen Haxhi Kasëm, në rrugën Mustafë Bakia, nr. 19, gjendet xhamia "*Haxhi Kasëm"*, të cilën po ashtu e quajnë edhe *"Toska xhamisi"*. Kjo xhami është ndërtuar para viti 1526, sepse ajo si *mesxhid* figuron në *Vakëfnamenë e Kukli-beut*.[51] Kjo xhami është rinovuar dhe meremetuar shumë herë. Dihet se atë xhami në gjysmën e shekullit XVI e ka restauruar Maksud Pasha nga Prizreni. Për një riparim tjetër ekziston edhe sot një mbishkrim, i cili me vështirësi lexohet. Mirëpo, nga mbishkrimi mund të shihet se këtë xhami në vitin 1247/1831-32, për shpirt të nënës së tij, Hatmane hanmit, e kishte rinovuar Mahmud Pasha.

Njëri nga hamamet më të bukur në vendin tonë dhe një nga përmendoret më të bukura në arkitekturën islame padyshim është *Hamami* i *Mehmed Pashës në Prizren*. Këtë hamam e ka ndërtuar Mehmed Pasha, ndërtuesi i xhamisë *"Mehmed Pasha"* në Prizren, e cila po ashtu quhet edhe *"Bajrakli Xhamia",* sepse në të, me rastin e festave, valonte flamuri, kurse gjatë kohës së Ramazanit në këtë xhami së pari kalleshin dritat, të cilat tregonin për përfundimin e agjërimit. Në Vakëfnamenë e Mahmud Pashës caktohej paga për personin që e ngrinte flamurin (*alemdar*) në këtë xhami. Hamami, sipas një legjende, është ndërtuar para se të ndërtohej xhamia. Këtë hamam po ashtu e kanë rindërtuar Mahmud Pasha dhe vëllai i tij, Emin Pasha, për se dëshmon edhe mbishkrimi me dimensione 40x35 cm, i skalitur në një pllakë të mermertë dhe i shkruar me shkrimin thuluth. Mbishkrimi, thotë:

قد عمر هذه الخیرات مدینه پرزرین سنجاغی متصرفی محمود پاشا و برادری امین پاشا بن

طاهر پاشا ۱ محرم ۱۲۴۱

"E ka rinovuar këtë përshpirtnim (hajrat) mytesarifi i sanxhakut të Prizrenit, Mahmud Pasha dhe vëllai i tij, Emin Pasha, bijtë e Tahir Pashës. 1 Muharrem 1249"[52]

[51] Hasan Kaleshi-Ismail Rexhep, *Prizrenac Kukli beg i njegove zaduzbine,* Prilozi za orijentalnu filologiju VIII-IX, Sarajevë, 1960.

[52] Më 21 maj të vitit 1833. Mbishkrimi është botuar me turqishte latine në artikullin e cekur të Ozrenit, Kaleshit dhe Erenit në: *"Vakiflar Dergisi",* Ankara.

***

Nga ekspozimi i deritanishëm mund të vërehet se sa i madh është numri i institucioneve fetare-arsimore dhe atyre publike, të cilat i kanë ndërtuar nga themelet ose i kanë rinovuar Mahmud Pasha dhe vëllai i tij, Emin Pasha. Kjo vërteton njëkohësisht edhe një tezë tonën të paraqitur më parë: Gjatë kohës së luftërave osmane-austriake të viteve 1683 - 1689 janë rrënuar sistematikisht të gjitha përmendoret islame, disave u ka humbur çdo gjurmë, kurse disa të tjera janë rindërtuar më vonë. Në mesin e përmendoreve që kanë rinovuar Mahmud Pasha dhe Emin Pasha, si dhe paraardhësit e tyre, të cilët edhe për këtë arsye përmenden, shumica, sipas mendimit tonë, janë rrënuar pikërisht gjatë këtyre luftërave.

Për mirëmbajtjen e këtyre përmendoreve, Mahmud Pasha kishte lënë vakëf dhe kishte përshpirtënuar një punëtori mekaniku dhe 15.000 groshë, më hollësisht mund të shihet nga Vakëfnameja, të cilën këtu e ofrojmë në tërësi në gjuhën osmane dhe në përkthimin shqip.

Vakëfnameja origjinale e Mahmud Pashës për vakëfnimet e tij është ruajtur në Prizren dhe gjendet në Zyrën e Vakëfit. Ajo është në formë rolne me gjatësi 3.5 m, kurse vetë teksti përfshin 2.56 m. Rolna e Vakëfnamesë është nga lëkura. Vakëfnameja ka mbetur e pa njohur, madje edhe nuk është përmendur. Tekstin e Vakëfnamesë origjinale e kemi krahasuar me një përshkrim të së njëjtës, i cili përshkrim gjendet në një *Sixhil të Prizrenit* në arkivin e ASHAS në Beograd. Mirëpo, për shkaqe teknike si dhe për faktin se kemi të bëjmë me një dokument të shekullit XIX, i cili, meqë nuk ka vlera të mëdha filologjike, nuk i kemi theksuar gabimet dhe dallimet, por në vetë tekstin i kemi përmirësuar. Që të shihet se si e kemi deshifruar, kemi dhënë edhe faksimilen e fillimit dhe përfundimit të Vakëfnamesë.

***

Teksti i vakëfnamesë së Mahmud Pashës



Fillimi dhe fundi i vakëfnamesë së Mahmud Pashës

Përkthimi për vërtetësinë e Vakëfnamesë, thotë:

Gjithë atë që përmban (dokumenti) nga vakëfnimet dhe nga testamenti, me vendimin dhe regjistrimin gjyqësor, është bërë i parevokueshëm. Kam gjykuar për rregullsinë dhe parevokueshmërinë e tij në të gjitha imtësitë dhe rregullat e përgjithshme, duke ditur për dallimet që ekzistojnë midis imamëve të respektuar.

Unë, Osmani i biri i Sylejmanit, përfaqësues gjyqësor në qytetin e Prizrenit dhe Suharekës.

Lë të jenë të falur!

Përkthimi i vetë dokumentit është ky:

Atë që Allahu dëshiron!

O Zot, prano këto përshpirtnime! O Muhammed!

Ai është Që di të gjitha sekretet dhe Që di të gjitha mendimet më të fshehura.

Falënderimi, adhurimi dhe madhërimi, - të kënduar me gjuhën e bilbilit të murrmë dhe me melodinë e papagallit të vendit të sheqerit (shekeristan), - i takojnë vetëm Allahut xh.sh. Që di të gjitha fshehtësitë dhe ngjarjet në botë.

Përshëndetjet dhe shpëtimi i takojnë po ashtu të dashurit (të Zotit), vulës së pejgamberëve, të zgjedhurit - Muhammedit, familjes së tij dhe shokëve të tij të respektuar (ashabëve).

Më pastaj: Shkak për hartimin e dokumentit të rregullt dhe shkas për shkrimin e fjalëve të respektuara, është:

Qytetari i ndershëm i Terzi Memi Mëhallës, (e cila gjendet në qytetin e Prizrenit në vilajetin e Rumelisë), shembull i bamirësisë dhe më i miri në mesin e bamirësve, mytesarifi i sotëm i sanxhakut të Prizrenit, i respektuari mirmiran, i shkëlqyeshmi Mahmud Pasha, biri i të ndjerit Tahir Pasha - ia lehtësoftë Allahu për të arritur atë që e do! - për t'i përcaktuar harxhimet dhe për t'i sqaruar e shprehur kushtet e përshpirtënimit që do të përshkruhen si më poshtë dhe në testamentin që do ta sqarojë bamirësi, - pasi sipas Sheriatit pasuria e bazuar dhe dhurimi janë të përligjura,- iu drejtua Shtëpisë së të drejtës duke sqaruar dhe arsyetuar dhurimin e tij vullnetar dhe të pastër, - ka deklaruar dhe ka pranuar kështu:

Njeri është ai, i cili, kur nga kjo botë tërheq këmbën (vdes), në mesin e njerëzve lë emrin e mirë në mënyrë që ta përmendin për të mirë, sepse kjo botë fiktive është e pabesë dhe e kalueshme.

Meqë duhet përpjekur për të bërë vepra të mira, të cilat do të bëhen shkak që secilin besimtar ta përmendin për të mirë, nga pasuria ime kam ndarë mullirin me pesë gurë, të cilin, më herët, e kam ndërtuar nga themeli nga pasuria ime më e pastër dhe nga fitimi më i mirë, e të cilët (gurë) gjenden në jazin që gjatë verës rrjedhë mespërmes arave të Vlashnjës dhe del nga mulliri i Ali Dedesë;

Edhe një furrë buke,[53] që gjendet në mëhallën e Levishës, deri te kopshti Kullo, e cila në katër anët është e kufizuar me lokalin e Ahmet Topallit dhe bijve të tij, me kopshtin Kullo dhe me tyrben e Kashi Ali Efendiut,[54] dhe pranë saj me mishtoren,[55] pranë saj nallbanhanhanja,[56] pranë kësaj lokali mekanik,[57] do të thotë gjithsej katër lokale dhe një mishtore - i kam ndarë nga pasuria ime e përgjithshme.

Po ashtu, (kam përshpirtënuar dhe bërë testament) nga pasuria ime më e pastër dhe nga fitimi më i bukur gjithsej 15.000 akçe të reja, të cilat i kam ndarë.

Duke u bazuar në fjalët e respektuara të Pejgamberit: "Kush ndërton një xhami për hir të Allahut, Ai do ta shpërblejë me Xhennet", për kënaqësinë e Allahut xh.sh. dhe duke kërkuar kënaqësinë e Fisnikut, xhaminë time të ndershme, të cilën më herët kam arritur ta ndërtoj me ndihmën e Zotit xh.sh. në afërsi të konakut tonë në Terzi Mem Mëhallë, dhe pranë xhamisë mejtepin, pastaj po ashtu pranë xhamisë edhe gjashtë dhoma për medrese, të cilat gjenden në vend të shtëpive, posedues i të cilave jam bërë duke i blerë me pasurinë time më të pastër, dhe një klasë (mësonjëtore), të cilën nga themeli e kam ndërtuar dhe ngritur, të sipërpërmendurit pesë gurë mulliri, furrën, lokalin mekanik dhe 15.000 groshë në para - (të gjitha këto) i kam përshpirtënuar dhe testamentuar dhe në këtë mënyrë kam përcaktuar dhe vendosur kushtet:

[53] Në tekst: ekmekci dykani
[54] Nuk kemi njohuri se ku gjendej tyrbja e Kashikqi Ali efendisë.
[55] Në tekst: kasap odasi.
[56] Në tekst: nalban dykani.
[57] Në tekst: Qilinger dykani.

Të ardhurat vjetore të mullirit të theksuar, qiraja e furrës,qiraja e mishtores, qiraja e nallbanhanës dhe e lokalit mekanik, si dhe interesi prej dymijedyqindenjëzet groshëve në kapitalin prej 15.000 groshëve, që do t'u jepet të tjerëve me interes, duke llogaritur për dhjetë, njëmbëdhjetë dhe nga të ardhurat dhe qiraja e mullirit dhe lokaleve dhe nga interesi i shumës së caktuar, pasi të grumbullohet për çdo vit - të të paguhen shërbimi i hatibit[58] dhe imamit[59] të xhamisë së respektuar dhe shërbimi ligjërues në shkollën të cilën unë e kam themeluar dhe të të mbahen efendilerët, të cilët i mësojnë talebët në mejtep si dhe zotëri myderrizi në medresenë e theksuar dhe me seriozitet të interesohen për vakëfin. Nxënësit që banojnë në dhomat e medresesë të lexojnë për çdo vjet gjatë muajit Ramazan nga një hatme,[60] do të thotë në të tetë dhomat të lexohen tetë hatme. Në këtë mënyrë le të lexohen pesëmbëdhjetë hatme për të ndjerët nga familja jonë, e, sa të jemi gjallë, për shëndetin tonë. Me detyrën e përmendur kam obliguar dhe si kusht ia kam vënë imamit dhe mësuesit të mejtepit, Halid efendiut. Ai këtë e ka pranuar dhe me të është obliguar. Po ashtu, pesë namazet e detyrueshme ditore të falen me xhemat. Në namaz të mos mungojnë. Lë të veprojnë sipas rregullave dhe kushteve të theksuara. Tani, pasi është obliguar se si do të duhej t'i kryente detyrat e kushtëzuara, imami i caktuar dhe i përmendur, dhe këtë detyrën e imamit dhe vaizit,[61] në xhaminë e respektuar, t'i mësojë fëmijët dhe t'i lexojë pesëmbëdhjetë hatme për të ndjerët tanë, njëjtë po ashtu kushdo qoftë prej njerëzve që i pranon këto detyra dhe i meriton, le të obligohet me këto rregulla dhe kushte! Kur myteveliu[62] të grumbullojë të ardhurat e mullirit, - të cilat qartë u theksuan më lart, - qiranë e katër lokaleve dhe të ardhurat nga interesi i parave,

[58] Hatibi është shërbyesi fetar, i cili ditën e xhuma dhe gjatë bajrameve mban hytbën, d.m.th. këshillën, ligjëratën.
[59] Imami është shërbyesi fetar i cili udhëheq namazin në xhami. Rëndom ai kryen edhe shërbimet e tjera fetare.
[60] Hatmja është leximi i tërë Kuranit. Sipas parimeve islame, një gjë e tillë konsiderohet sevap i madh.
[61] Vaizi është shërbyesi që mban ligjërata (vaz) në xhami. Në xhamitë e vogla, detyrën e imamit, hatibit dhe vaizit rëndom e mban një person, kurse në xhamitë më të mëdha për secilin shërbim caktohet nga një person.
[62] Myteveliu është drejtues i vakëfit i caktuar nga mirëbërësi.

për çdo vjet në muajin Ramazan t'ia dorëzojë në tërësi myderriz[63] *efendiut dhe shërbyesve të tjerë. Dhe ata të na përkujtojnë me dua të mira. Para së gjithash, lë t'i jepen 33 groshë të nderuarit Ramazan efendiut, hatibit të xhamisë: imamit të nderuar Halil Efendiut 60 groshë: për shërbimin e predikimit 17 groshë: për shërbimin e mësimit të fëmijëve në mejtep 140 groshë: për leximin e 15 hatmeve, për secilën nga dhjetë groshë, që gjithsej bëjnë 150 groshë: Myezinit të parë, mulla Sylejmanit, 25 groshë: Myezinit të dytë 25 groshë: Shërbyesit të xhamisë 35 groshë: Myderrizit të medresesë së përmendur, të nderuarit Haxhi Ali Efendiut, 1.200 groshë: Për furnizimin e talebëve, të cilët banojnë në tetë dhoma të medresesë së përmendur, për ndjekjen e rregullt të mësimeve dhe për leximin e tetë hatmeve me të cilat janë obliguar nxënësit, i është caktuar secilës dhomë nga njëqind groshë, që gjithsej bëjnë 800 groshë. Portierit të dyerve të medresesë, 40 groshë: myezinit*[64] *të xhamisë në Kala, Hafizit të verbët 60 groshë: shërbyesit të xhamisë në Kala 40 groshë: orëtarit të orës së Kalasë gjatë vitit 60 groshë: imamit të xhamisë Begzade 20 groshë, sepse shërbimi i tij është i vogël. Imamit të dytë të xhamisë Levisha, Omer efendiut 30 groshë: alemdarit, që vendos flamurin në minare të xhamisë Mehmed Pasha, 60 groshë. Mulliri i theksuar, furra, lokalet e farkëtarisë dhe nallbanhanës, si dhe muret e ndërtesave të përshpirtnuara, t'i ruajnë dhe të kujdesën e të meremetohen, kur për këtë paraqitet nevoja. Nga kapitali dhe nga sasia e tepruar, myteveliu të mos mbajë asnjë akçe në duart e veta. Lë të jepen me interes 10 groshë për njëmbëdhjetë e gjysmë. Ai myteveli që përpiqet me gjithë shpirt, le të kënaqet me yshyrin e të ardhurave vjetore dhe me 200 groshë para. Lë të punojë pandërprerë në detyrat e marra mbi vete. Për brendinë e xhamisë së respektuar, për dhomat e medresesë, për mejtepin, sipas nevojës, në haremin e xhamisë së kalasë, lë t'i shtrijë shtrojat. Për ndriçimin e haremit, minares, medresesë, mejtepit, xhamisë në kala, lë të vendosë gazin në kandila, e në dritare letër. Pasi mulliri i theksuar gjendet në vendin e*

[63] Myderrizi është profesor i medresesë. Që ta kryente këtë detyrë, ai patjetër duhej të kishte diplomën.

[64] Myezini është shërbyes fetar që thërret ezanin në minare, duke i ftuar besimtarët në namaz.

vakëfit të Kukli Begut, lë t'i jepen një herë në vit 12 groshë mytevelisë së vakëfit të Kukli Begut.[65]

Pasi të jenë paguar, - ashtu si dëshiron Allahu xh.sh., - në fund të çdo viti nga të ardhurat e mullirit, qirave të furrës, mishtores, nallbanhanës dhe lokalit mekanik dhe nga shuma e interesit nga shuma e parave, lë t'u jepen pagat secilit shërbëtor, sipas kushteve të qartësuara më lart. Pastaj lë të merren me dijeninë e Gjyqit të Sheriatit dhe në prani të xhematlinjve myslimanë të ardhurat nga vakëfet dhe lë të kontrollohen faturat e të dalave të shërbyesve, për kandila, hasra, letra dhe për ato gjëra që kanë kërkuar riparim dhe meremetim. Ajo që tepron nga të ardhurat e vakëfeve të sipërcituara, lë të përcillet në kapitalin themelor.

Myderrizit të nderuar, të medresesë së sipërcituar, që është i caktuar për mbikëqyrje (nazirit)[66]*, ndaj myteveliut të vakëfit të theksuar, e pas tij kushdo qoftë myderriz për t'i kontrolluar faturat e myteveliut të përmendur, sipas kushteve të përshpirtënimit dhe mënyrës së paraparë, lë t'i jepen 80 groshë. Naibi aktiv i gjyqit që të mund të kujdeset me rastin e kontrollimit të faturave të mytevelisë së vakëfit të cekur, lë t'i jepen 20 groshë.*

Nga tetë hatmet, për leximin e të cilave, në muajin Ramazan për çdo vit,, nxënësit e obliguar me qëndrim në tetë dhomat e medresesë, lë t'i lexojnë për sevap të: së pari një hatme për shpirtin e ndritshëm të Zotërisë sonë madhështor, i cili është gëzimi pejgamberëve dhe i zgjedhuri i fundit nga Allahu xh.sh.; një hatme për shpirtrat e pastër të pejgamberëve të tjerë; një hatme shpirtrave të pastër të katër halifëve,[67] *dhe shpirtrave të Hasanit dhe Hysejnit;*[68] *një hatme shpirtrave të lumtur të të gjithë njerëzve të ndershëm të Zotit xh.sh.; një hatme për shpirtrat e të parëve tanë dhe të afërmeve; një hatme për shpirt të babait tonë të ndjerë dhe nënës së ndjerë; një hatme për shëndet të motrës sonë, Shehzadesë, sa të jetë gjallë, e pas vdekjes, për shpirt të saj; një hatme*

[65] Për Kukli-begun, për vakëfet e tij dhe vakëfnamenë, shih: Hasan Kaleshi-Ismail Rexhepi, Prizrenac Kukli-beg i njegove zadužbine, Prilozi za orijentalnu filologiju, VIII-IX, Sarajevë,1960.

[66] Nadhiri është person i caktuar nga mirëbërësi si mbikëqyrës që kontrollonte punën e myteveliut dhe shërbyesve të tjerë të vakëfit.

[67] Katër halifët e parë janë: Ebu Bekri, Ymeri, Osmani dhe Aliu r.a..

[68] Mendoj në bijtë e halifit të katërt, Aliut r.a. dhe bijën e Muhamedit a.s., Fatimen.

për mua, sa të jem gjallë, për shëndetin tim, e pas vdekjes sime, për shpirtin tim. Sevapin e tyre lë t'ua falin shpirtrave të tyre dhe mua.

Sikur që u shkrua më lart, imami i përmendur, lë t'i lexojë nga pesë hatme në vit. Siç u sqarua, lë të jetë shpërblimi për lexim nga dhjetë grosh dhe sevapi i tyre t'u dedikohet: së pari, nga një hatme babait tim të ndjerë Tahir Pashës; nga një hatme xhaxhait tim të ndjerë, Rrustem Pashës; nga një hatme xhaxhait tim të ndjerë, Abaz Begut; nga një hatme nënës sime, Humës; nga një hatme vëllait tim, Jusuf Begut; nga një hatme vëllait tim, Seit Pashës dhe bijve të tij Tahir Pashës dhe Rrustem Pashës;[69] *nga një hatme motrës sime, Zehrës; nga një hatme të parëve të mi, Selman Agës dhe Mehmed Agës,*[70] *dhe bijve të tyre; nga një hatme nënës së babait tim, gjyshes sime, Arife hanmit; nga një hatme babait të saj, Kurt Begut dhe xhaxhait të tij, Zekerija Begut; nga një hatme tezeve të mia, Azize hanmit dhe Gylsym hanmit; nga një hatme njerkës sime, Zehra hanmit; nga një hatme vëllait tim, Emin Pashës; për mua po ashtu lë të lexohet nga një hatme, derisa të jemi gjallë për shëndetin tonë, e pas vdekjes, për shpirtrat tanë. Shërbimet që u cekën lart dhe u kushtëzuan, me përgjegjësi të plotë të realizohen dhe assesi të mos neglizhohen.*

Gjatë netëve të Ramazanit, bajrameve, mevludeve, Regaibeve dhe Beratit[71] *të vendosen në harem të xhamisë dymbëdhjetë kandila, në pjesën e jashtme një kandil, në minaret dymbëdhjetë kandila, në medrese një kandil, në mejtep një kandil dhe në haremin e xhamisë në kala shtatë kandila, kështu që gjithsej gjatë netëve të dalluara të ndezën gjithsej 47 kandila, e për secilin kandil, respektivisht për vajgur lë të jepen nga 360 dërhem që gjithsej bëjnë 47 okë. Kur xhamia, dhomat e medresesë dhe mejtepi dhe xhamia në kala kanë nevojë për hasra, myteveliu t'i ofrojë për shtruarje. Lë të jepen kandila edhe për dritare si dhe për letër.*

[69] Ne në punim kemi folur për vëllain e Mahmud Pashës, Tahir Pashën, kurse për bijtë e Said Pashës dhe bijtë e vëllezërve të Tahir Pashës, si dhe për Rrustem begun, nuk kemi kurrfarë të dhënash. Si do qoftë, këtij dokumenti duhet patjetër t'i besojmë.

[70] Në tekst është përdorë shprehja *ced,* që do të thotë gjysh dhe paraardhës. Mirëpo, mund të jetë gjysh edhe nga ana e nënës.

[71] Këto janë netët që kanë të bëjnë me ngjarjet nga jeta e Muhamedit a.s., p.sh. nata e shtatzënisë, nata e vdekjes etj.

Kur nga të ardhurat e mullirit të lartpërmendur, mishtores, nallbanhanës dhe lokalit mekanik dhe nga të ardhurat nga interesi i parave të vakëfnuara, - siç u sqarua më lart dhe kushteve të parapara pas plotësimit të pagave të shërbyesve, vajgurit për kandila, dhe sipas nevojës harxhimeve për hasra, kandila dhe letra, - atëherë gjithçka që tepron nga të ardhurat e vakëfeve të cekura, myteveliu të mos i mbajë në duar të veta, por lë t'ua jep të tjerëve me interes.

Me kalimin e kohës, gjatë muajve dhe vitit, kur paraqitet nevoja për meremetimin e xhamisë dhe dhomave të mejtepit dhe medresesë, të xhamisë në kala dhe gjërave të përshpirtënuara, si mulliri, furra, mishtorja, lokali mekanik, nallbanhaneja, myteveliu i cekur të jep mjete për meremetimin e tyre. Vetëm nëse është e madhe kërkesa, atëherë myteveliu duhet të gjejë forma për t'i meremetuar. Për ujitjen e arave që kanë nevojë gjatë stinës së verës një gur mulliri të ndalohet, e uji i tij të përdoret për ujitjen e arave.

Derisa të dëshirojë Allahu xh.sh., ata që do të jenë më të vjetrit trashëgimtarë në familjen tonë, gjeneratë pas gjenerate, lë të përpiqen për mbikëqyrjen e vakëfeve tona.

Vakëfnuesi i cekur duke i plotësuar kushtet e vakëfnimit dhe duke plotësuar tërësisht klauzolat e vakëfit, sipas Sheriatit, që t'i protokollojë dhe ta përmbarojë këtë që u cek më lart, përshpirtënuesi i cekur - lë ta ruajë Allahu xh.sh. nga të këqijat e kohës - duke përcaktuar si myteveli të banorëve të Terzi Memi Mëhallës personin me emrin mulla Selman, i cili është i pranishëm në këtë tubim, ia dorëzoi vakëfin. Kur ky e ka marrë, me të cilën u njoftua vakëfnuesi dhe ky i fundit u njoftua se sipas shkollës së Sheriatit, vakëfnuesi nuk ka të drejtë në revokim të gjërave të përshpirtënuara, sepse përshpirtënimet që bëhen për hir të Allahut xh.sh. tërheqja nga ky vendim nuk është i lejueshëm. Gjithë këto përshpirtënime, zotëri gjykatësi menjëherë ka protokolluar vakëfin si të drejtë dhe të parevokueshëm. Edhe kush përpiqet të asgjësojë ndonjë përcaktim ose ta ndryshojë, ose ta shtrembërojë ndonjë prej kushteve, lë të jetë mbi të mallkimi i atyre që mallkojnë dhe i melaqeve dhe gjithë njerëzve. Kurse Allahu xh.sh. lë ta shpërblejë bamirësin.

Kjo u bë dhe u shkrua më njëmbëdhjetë rebiul ahir të vitit 1247.[72]

[72] Fillon më 12 VI 1831.

Dëshmitarët e mëhershëm:	***Këtë herë dëshmitarë:***[73]
Myderrizi i njohur Sylejman efendiu	*Myderriz Ebu Beqir efendiu*
Bibliotekisti Ebu Beker efendiu	*Myderriz Haxhi efendiu*
Ali efendiu	
Myftiu Ramadan efendiu	*Myftiu Ramadan*
Shejh Abdylfetah efendiu	*Ymer efendiu*
Shejh Ibrahim efendiu	*Haxhi Abdullahu*
Shejh Ahmed efendiu	*Imam Terzi Mehmed efendiu*
Shejh Ejub efendiu	*Imam Hali efendiu*
Nuri efendiu	*Mustafë efendiu*
Adullah efendiu	*Zulfi efendiu*
Halid efendiu	*Hali efendiu*
Murteza begu	
Abdulfetah begu	
Haznadar Ilaz aga	
Abdyl aga	
Abas Spasiu	
Muhtar aga	
Selimdar Dervish aga	
Ali aga…	
Ibrahim aga Kurd	
Jusuf efendiu	
Sherif efendi pejani	
Procesmbajtësi: Mehmed Ibrahimi	

Marrë nga:
Hasan Kaleši – Ismail Eren, Prizrenac Mahmud-paša Rotul, njegove zadužbine i vakufnama, "Starine Kosova – Antikitete të Kosovës", br. VI – VII, Prishtinë, 1972-1973, str. 24 – 60.

Përgatiti:
Ismail Rexhepi
Sadik Mehmeti

[73] Kjo na shtynë të mendojmë se këtu kemi të bëjmë me përshkrimin e vërtetuar të vakëfnamesë, prandaj janë futur dëshmitarët me rastin e hartimit të vakëfnamesë, e më pastaj edhe me rastin e këtij përshkrimi. Mirëpo, nga vet dokumenti, nga forma e tij dhe nga disa elemente të tjera mund të konstatohet se kemi të bëjmë me origjinalin. Dëshmitarët e parë me siguri janë cekur atëherë kur bamirësi ka vendosur të themelonte vakëfin ose ka hartuar ndonjë dokument të përkohshëm, e herën tjetër, dëshmitarët e cekur para kadiut me rastin e regjistrimit të vakëfit dhe futjen në protokoll. Disa nga dëshmitarët përmenden në të dy rastet, gjë që dëshmon se nuk ka kaluar shumë kohë në mes të dy rasteve.

Hasan Kaleshi – Ismail Eren

MAHMUD PASHË RROTLLA FROM PRIZREN - HIS WAQF ENDOWMENT

The war between the Ottoman Empire and Austria (between 1683 and 1690) had grave consequences in Kosova, especially in the town of Prizren and its surroundings. On November 3, 1689, Pikëlomin left the town of Prishtina and headed for Prizren (he arrived there on November 6, 1689). He was accompanied by Pjetër Bogdani, a priest, who had joined him in Shkup. The two were accompanied by thousands of Albanian volunteers and Catholic Serbs. The claims that the above-mentioned numbered almost 20.000 (as is said in a number of documents) must be viewed with caution, as the number of Catholics in that area was not that high. Armed Christians had raided the Muslim settlements in the vicinity of Prizren as well as in Albania. Tahir Efendiu, the author of an Arab chronicle, claimed that the infidels killed most of the inhabitants of Prizren and destroyed many mosques. Consequently, no more than 10 Muslim households were left in this town (eventually, many of them were struck by the plague and died). Out of a total of some 20.000 Muslim households in Prizren only 16 were left. Despite the fact that there are many exaggerations in these writings, as was typical in that time, there is no doubt that the level of devastation and as well as the number of killed was very high. The claim that many people were struck by the plague and died of it is true. Among others, Pikëlomin and Bogdani died of the plague, too. According to another source, only 1/3 of the Muslim population managed to survive the occupation of the towns in Rumelia by the Austrians and Christian volunteers.

حسن كلشي – إسماعيل أرن

محمود باشا رتولا من بريزرن و وقفه

(خلاصة البحث)

ان الحرب التي دارت بين الدولة العثمانية و الامبراطورية النمساوية خلال السنوات (1690-1683) تركت مضعافات كثيرة في كوسوفا و بصفة خاصة بمدينة بريزرن و ضواحيها.

يقال ان قائد الجيش النمساوى بيكولوميني تحرك بتاريخ 3 نوفمبر 1689 من برشتينا و وصل إلى بريزرن بتاريخ 6 نوفمبر 1689. و كان بصحبته القيسن بيتر بوغدانى الذي انضم إليه بمدينة شكوبى. و كان في صحبتهما آلاف من المتطوعين الالبان و الصرب من الكاثوليك. الاخصات التي تقول بان عددهم كان عشرون الفا يجب اخذها بالتأنى لان ذلك العد لم يكن في كل الاراضى الالبانية.

لقد اقتحم المسلحون المسحيون من ضواحى بريزرن و البانيا العليا بيوت المسلمين و سلبوا أموالهم و حسب ما يقول المؤرخ طاهر افندى فان الكفار خلال تلك الفترة قتلوا معظم سكان مدينة بريزرن و دمروا معظم المساجد الامر الذي أدى أن بالمدينة لم يبق أكثر من عشر بيوت للمسلمين و اغلبهم ماتوا نتيجة لنشر وباء كوليرا، و من عشرين ألف بيت كان عدد المسلمين بالمدينة بقى ستة عشرة بيتا فقط حسب ما يقول المؤرخ طاهر أفندى في كتابه.

TRASHËGIMI

Mirije Xhezairi

XHAMITË MONUMENTALE NË PRIZREN*

Hyrje

Gjatë periudhës Osmane krahas shtëpive të banimit, dyqaneve, punishteve dhe ndërtesave të tjera publike, një vend të rëndësishëm në arkitekturën e qyteteve zinin edhe objektet fetare.

Në kuadër të këtyre ndërtimeve bëjnë pjesë edhe disa xhami klasike monumentale. Objekte të tilla kemi mjaft në Kosovë si: Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Xhamia e Sinan Pashës, Xhamia e Suzi Efendiut etj., në Prizren. Në Prishtinë kemi Xhaminë e Jashar Pashës, Xhaminë Sulltan Fatih, pastaj Xhamia e Hadumit në Gjakovë, Xhamia e Gazi Ali Beut në Vushtrri etj.

Këto vepra të mëdha monumentale që sot stolisin këtë nënqiell janë vepra madhështore ndaj të cilave duhet të kemi një kujdes të veçantë, sepse këto janë dëshmia më e madhe e autoktonisë sonë shqiptare në këto troje.

Prizreni si qytet i lashtë dhe me traditë të ruajtjes së monumenteve dhe objekteve fetare ka nxitur shumë studiues që studimet e tyre t'i orientojnë kah ky qytet. Pra ajo që të magjeps në këtë qytet e që edhe

* Temë diplome e mbrojtur në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

mua më ka nxitur kureshtjen të filloj me hulumtim me përvojën time fillestare në këtë drejtim janë objektet e trashëgimisë islame dhe historia e tyre si dhe interesimi për të kaluarën e qytetit dhe ruajtja sa më e mirë e kësaj kulture, e cila është formuar me shekuj të tërë.

Në pamundësi që në një punim si ky të përmblidhen të gjitha objektet e kulturës islame të Prizrenit, jam fokusuar vetëm në xhamitë, të cilat janë nën përkujdesjen e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prizren

XHAMIA E GAZI MEHMET PASHËS (BAJRAKLI) (1573-74)

Prej monumenteve të lashta dhe mahnitëse Osmane është edhe Xhamia e Gazi Mehmet Pashës. Kjo xhami jo vetëm në Prizren, por edhe në Kosovë e Ballkan njihet ndër xhamitë më të bukura. Xhamia e Gazi Mehmed Pashait, e cila njihet edhe si xhamia e Bajraklisë numërohet njëra prej më të mëdhave, kurse për shkak të pozitës së saj njihet edhe si njëra ndër objektet më me vlerë.[1]

Ndërtues i kësaj xhamie ka qenë Gazi Mehmet Pasha, i cili në historinë Osmane njihet si komandant ushtarak. Ka marrë pjesë në shumë luftëra, pas luftës së Mohaçës në vitin 1526, bëhet sanxhakbej i Smederevës dhe Pozhegës. Pas zgjerimit të Perandorisë Osmane, matanë Savës dhe Danubit, Mehmet Pasha rimëkëmbës dhe beglerbej i Budapestit zgjeroi pushtetin edhe në dymbëdhjetë sanxhaqe të Hungarisë. Përveç se ka qenë i guximshëm ishte i njohur edhe për

[1] Raif Virmiça: "Kosova'da osmanli mìmarì eserlerì", fq. 35.

ngritjen e xhamive, medreseve, hamameve dhe objekteve të tjera. Janë të njohura edhe ndërtimet e tij në Prizren, ku ka ndërtuar një xhami, medresenë dhe hamamin.[2]

Gazi Mehmet Pasha ndërtoi në Prizren njërën ndër xhamitë më të bukura të kohës. Xhamia e tij si më madhështorja që ishte, u privilegjua që gjatë festave shtetërore dhe gjatë muajit të Ramazanit në te të valonte flamuri. Për këtë qëllim, në pjesën më të lartë të minares, është vendosur një shufër metalike dhe në të një litar që lëshohej deri në vendin ku myezini thërriste ezanin, nëpërmjet të cilit është ngritur gjegjësisht është ulur flamuri. Pikërisht për këtë nga populli u quajt Xhamia e Flamurit-Bajrakut (në popull xhamia e Bajraklisë)[3].

Kjo xhami gjendet në anën e djathtë të Lumëbardhit, është njëra ndër më të mëdhatë dhe ka një hapësirë të konsiderueshme. Dallohet nga xhamitë tjera ngase gjendet në një kompleks të bukur oriental.[4]

Oborri është i shtruar me kalldrëm dhe në hapësirën e tij gjendet Medreseja e Mehmet Pashës, në afërsi të medresesë ai ka ndërtuar edhe tyrben për ta varrosur në të, mirëpo, si duket është vrarë në ndonjë betejë dhe nuk është i varrosur aty,[5] gjithashtu, në oborr gjenden varreza, në anën perëndimore të oborrit të xhamisë janë të vendosura tetë çezme, e pak më tutje banjat, ndërkaq, para hyrjes kryesore, në anën e djathtë dhe të majtë gjenden dy gurë të musal-las.

Si ndërtesë ka themelin katërkëndësh dhe disa pjesë të ndërtuara prej mermeri. Mbi derën hyrëse (portikun) gjendet epitafi i mermertë me dimensione 40x40 cm., është i shkruar me shkrim thuluth me ngjyrë të kuqe nga poeti Ali Mehmet Tahir efendiu nga Bursa.[6]

Edhe njëherë Gazi Mehmet Pasha
dhuroi-ndërtoi një xhami të shenjtë
Nuk e bëri këtë për lavdërim
veçse për hir të Zotit
Kjo xhami në qytetin e Prizrenit

[2] Maliq Osi: "Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor", fq. 82.
[3] Ibid, fq. 93.
[4] Maliq Osi: "Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturorë", fq. 86.
[5] Grup autorësh: "Kosova dikur e sot", fq. 470-71.
[6] Raif Virmiça: "Kosova'da osmanli mìmarì eserlerì", fq. 35.

e bëri këtë qytet vendparajsë
Shejh Ali ka kënduar në vargje fillimin e xhamisë
Zoti e ripërtëriu Qabenë e fukarave.[7]
Viti – (Sene) 981

Nga mbishkrimi konstatohet se Gazi Mehmet Pasha xhaminë e ka ndërtuar në vitin 981/1573.[8] Hyrja përbrenda xhamisë është mahnitëse për secilin vizitor, ngase ka vizatime dekoruese dhe kolorit në gjithë hapësirën e saj.

Duke hyrë brenda në xhami është e ndërtuar edhe pjesa e fundit për vendfalje e cila është e ndarë me dritare ku është e rrethuar me hekur dhe kjo pjesë ka edhe mihrabin. Mihrabi i xhamisë është prej mermeri[9]. Specifikë e kësaj xhamie është se në të ekzistojnë pesë vende të imamit (mimbere), një në brendi, dy në çardakë dhe dy në korridore. Këto elemente nuk i kanë xhamitë e tjera në Prizrenin e lashtë dhe as në hapësirën më të gjerë.[10]

Në anën e brendshme të kupolës janë të vendosur një numër i qypeve të zbrazët, roli i të cilëve është që të kondensojnë lagështinë e ajrit e që mos të dëmtohet suvatimi dhe ornamentet nën kupolë. Avulli i kondensuar në qypa, pikon në formë të ujit. Xhaminë e karakterizon edhe një akustikë e jashtëzakonshme.

Në çdo mur janë të vendosura nga dy dritare lart dhe poshtë, po ashtu në qoftë se ia shtojmë edhe nga një dritare gjysmëharkore, atëherë xhamia ka 27 dritare. Minarja është me gjatësi 40m, mbulesa e minares është e ndërtuar prej llamarine zinku.[11]

Xhamia është restauruar në vitin 1993-94 janë investuar punime me vlera të mëdha, kështu që në enterier, plasaritjet vertikale në kupolën kryesore (11.00x0,15 x 0.03m), u bë rikonstruksioni i pikturave

[7] Po aty, fq. 40.
[8] Lidhur me datën e ndërtimit të xhamisë hasim disa versione: disa thonë se xhamia është ndërtuar në vitin 1549 e në disa burime të tjera hasim vitin 1561, ndërkaq në mbishkrimin përmbi deren e xhamisë tregohet viti 981 sipas hixhretit, që korrespondon me vitin 1573-74. Unë kujtoj se kjo është më e sakt.
[9] Raif Virmça: "Kosova'da osmanli mìmarì eserlerì", fq. 37.
[10] Muhamed Shukriu: "Prizreni i lashtë…", fq. 269.
[11] Raif Virmiça: "Kosova'da Osmanli mìmarì eserlerì", fq. 38.

murale, i fragmenteve të arabeskave në kupolë e mbi dritare, u bë rillaqosja e minares, meremetimi i shtresës së plumbit në minare e kupolë, llamarina në pullaz është lyer me ngjyra e kemikalie mbrojtëse dhe është ngjyros e gjithë hapësira brenda dhe jashtë xhamisë. Me rastin e investimeve të fundit në xhami është instaluar edhe një luster elektrik dimensionesh të mëdha (2x3m) dhe katër më të vegjël[12].

Investimet për restaurimin e xhamisë janë bërë nga Këshilli i Bashkësisë Islame dhe ndihmat e popullit si dhe me punë vullnetare, pas restaurimit kjo xhami edhe pse ka pësuar ndryshime, megjithatë nuk e ka humbur origjinalitetin e saj burimor. Xhamia zë një sipërfaqe prej 1.907m² (vetëm xhamia 771m² ndërsa oborri 1.136m²)[13].

Në fund të përshkrimit të kësaj xhamie monumentale, do të theksoja se pikërisht në këtë xhami është mbajtur edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, e të cilën, fatkeqësisht, historianët tanë nuk e thonë troç, jo për tjetër por vetëm sa për hir të së vërtetës.

[12] Muhamd Shukriu: "Prizreni i lashtë", fq. 258.
[13] Raif Virmiça: "Kosova'da Osmanli mimarì eserleri", fq. 37.

XHAMIA E MYDERRIZIT (ALI MYDERRIZIT) (1581)

Edhe zotëri myderrizi që i thoshin Ali Hoxha, ka ndërtuar gjithashtu një xhami në mes të qytetit tonë.
Është transmetuar se ai ka komentuar Bejdaviun,varri i tij është te xhamia e tij në mes nesh.[14]

*Nga **Kronika e Tahir ef.***

Xhamia gjendet në Afërsi të Katedrales "Zonja ndihmëtare" në hapësirën trekëndëshe të formuar nga tri rrugë. U shpall përmendore kulturore me aktvendimin nr.411/1989 të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Prizren.[15]

Xhaminë e ndërtoi Ali Hoxha, një personalitet me zë ku njëherësh ishte myezin në xhaminë e Mehmet Pashës, pranë Medresesë së Prizrenit. Përkundër asaj që libri i xhamisë nuk u ruajt deri në ditët e sotme, të dhënat e saj janë të pakta, por sipas studiuesit Jastrebov, kjo xhami është ndërtuar më 1581.

Sipas disa të dhënave xhamia në fillimet e saj ka qenë mesxhid, ndërkaq, më vonë (nuk dihet viti) e kanë ngritur minaren dhe e kanë shndërruar në Xhami.[16]

[14] Nehat Krasniqi: "Kronika e Tahir Efendiut burim i rëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës turko-osmane", "Edukata Islame", nr.57, fq. 84.
[15] Muhamed Shukriu: "Prizreni i lashtë…", fq. 333.
[16] Raif Virmiça: "Kosova'da Osmanli mimarì eserleri", fq. 81.

Ali Myderizi ndërtoi xhaminë në mes të qytetit, në oborr gjendet varri dhe tyrbja e tij, pasi që ishte myderriz pranë xhamisë kishte edhe Medresenë. Pas njëqind e tetë vjetësh për të parën herë pësoi një shkatërrim nga lufta austro-turke në vitin 1689. Fatkeqësisht kjo xhami edhe njëherë pësoi nga zjarri në vitin 1979, më pas bëhet renovimi dhe meremetimi në ato pjesë ku u dëmtua më së shumti.[17]

Kupolat dhe korridoret e mbuluara me rrasa guri janë karakteristikat arkitektonike të xhamisë, si dhe muret rrethuese të vendosura në trajtë trekëndëshi të mbuluara me rrasa guri, kurse tyrbja e mbuluar me tjegulla turke. Në brendi gjendet një mahfil dhe një mimber, ndërsa mimberi tjetër gjendet në korridor. Tyrbja, ku është i varrosur ndërtuesi i xhamisë Ali efendiu, e kishte hyrjen nga oborri i xhamisë, ndërsa e vetmja dritare e vogël gjendej kah rruga, në mes të murit jugor, 50cm mbi nivel të rrugës. Në pjesën e majtë të hyrjes është një kthinë, që duket se shërbente për punë administrative, ndërsa në anën e djathtë shtrihet korridori që ndahet në dy pjesë.

Objekti humbi nga origjinaliteti për shkak të intervenimeve intensive të pavolitshme. Pas Luftës së Dytë Botërore, një kohë të gjatë, shërbeu si depo e Kryqit të Kuq, kështu që brendia u dëmtua mjaft. Pas zjarrit që e kaploi në vitin 1963, kur u dogj minarja dhe pullazi, në vend të rrasave u vendosën tjegulla, të cilat më vonë u zëvendësuan me ato mediterane, mbulimi i pullazit me silonit të fallcuar, vendosja e llamperive që dëmtoi konstruksionin akustik, veprime këto jashtë rregullave të mbrojtjes së një objekti të tillë të vlefshëm. Me riparimin e shtesës së suvasë në minare, në vitin 1994, dukja iu afrua asaj të kohës së ndërtimit.[18]

Xhamia ka një sipërfaqe prej 877m², brendësia e xhamisë 258m², oborri 621m².[19]

[17] Dr. Maliq Osi: "Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor", fq.65.
[18] Muhamed Shukriu: "Prizreni i lashtë", fq.333-34.
[19] Raif Virmiça: "Kosova'da Osmanli Mimarì Esrlerì", fq. 82.

XHAMIA E ARASTËS (EVRENOS BEGUT) - (1594)

Edhe Jakup Beu ka ndërtuar një faltore për tregun e tij për t'u falur e lutur njerëzit që ia mësyjnë tregut.[20]

Nga ***Kronika e Tahir ef.***

Xhamia e Arastës, dikur e kompletuar, është ndërtuar nga Jakupi, nipi i Gazi Evrenosit. Quhej Xhamia e Arastës se në atë kohë në afërsi kishte një çarshi të njohur. Arasta në persisht do të thotë e mbyllur, e mbuluar. Kjo çarshi e mbuluar e kishte nismën nga kjo xhami dhe kalonte nëpër urën po ashtu të mbuluar.

Xhamia e Evrenosit është ndërtuar para vitit 1526, mirëpo së pari shërbente si mesxhid, më vonë iu bënë disa restaurime, e më pastaj u shndërrua në xhami. Gjatë ndërtimit të xhamisë popullata filloi t'i afrohej kompleksit, kështu që dita ditës banorët ndërtonin objekte banimi dhe punëtori të ndryshme, fatkeqësisht edhe kjo xhami pësoi nga djegia më 25 qershor 1853.[21]

Vetë xhamia nuk ka pasur ndonjë arkitekturë me vlerë të posaçme, nuk kishte mihrab e mahfil, i mungonte kupola në brendi. Pullazi ishte i mbuluar me tjegulla turke, të cilat u zëvendësuan me ato të Shkupit në vitin 1932. Pasi që ishte e vendosur në kat, besimtarët ngjiteshin përmes

[20] "Pjesë nga kronika e Tahir efendiut", Edukata Islame, nr.57.
[21] Dr. Maliq Osi: "Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor", fq. 92-93.

shkallëve të gurit. Në përdhese ndodheshin depot e dyqaneve përreth, ndërsa në pjesën jugore gjendej "Mirihani" Hani i Arasta çarshisë, në vitin 1946 u shndërrua në treg.

Sipas planit të përgjithshëm urbanistik, të aprovuar pjesërisht në vitet 1960-61 u rrënuan të gjitha dyqanet, tregu dhe Xhamia e Arastës, të cilës iu la vetëm minarja. Kjo minare u cilësua përmendore kulturore me aktvendimin nr.1300/1970 të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës Prizren dhe në të u bë restaurimi dhe konservimi. Koncepti i hartuar synonte që në nivelin e hyrjes së minares të ndërtohet një plato me rrethojë dhe shkallë të hekurit, ku do të pushonin vizitorët dhe do të ngjiteshin nëpër shkallët e brendshme deri në sherefe të minares, prej nga do të shijohej ambienti i kësaj pjese të qendrës urbane të qytetit. Realizimi i këtyre dy tentimeve u pengua qëllimisht nga politikanët udhëheqës me botëkuptime shoviniste.

Për ta mbrojtur minaren e vetmuar Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës Prizren u konfrontua me kryetarin e KK të Prizrenit dhe organet e tij.[22]

[22] Muhamed Shukriu, "Prizreni i lashtë…", fq.330-31.

XHAMIA E SOFI SINAN PASHËS (1615)

I thonë Sinan Pasha e prejardhjen e ka nga Villa,është bërë zëvendës i sadriazemit të mbretit.
Ka ndërtuar një xhami; me të s'ka në trojet tona pseudonimi i tij ishte Sofi; me të përmendet biografia e tij[23]

Nga ***Kronika e Tahir ef.***

Është ndër objektet më të rëndësishme që meriton trajtim të veçantë, për shkak të madhështisë së saj imponuese, historisë dhe rrjedhave për mbrojtjen dhe prezantimin e saj.



Në Kosovë gjenden dy xhami të cilat e mbajnë emrin e Sinan Pashës, njëra në Prizren, më e madhe dhe më e njohur, kurse tjetra në Kaçanik.

Ndërtuesit e këtyre dy objekteve kanë qenë personalitete shumë të njohura dhe kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë turke. Ndërtues i xhamisë së Kaçanikut ka qenë Koxha Sinan Pasha, vezir i madh, kurse i asaj të Prizrenit Sofi Sinan Pasha beglerbej i Budinës. Për këto dy personalitete në historiografi, mbase edhe në shtypin tonë është shkruar mjaft, megjithatë rreth këtyre dy personaliteteve aq shumë janë përzier faktet historike dhe legjendat sa që

[23] "Edukata Islame", nr 57, fq. 84.

nuk dihet cili është cili, bile shkohet deri atje sa që ndërtimi i njërës xhami i përshkruhet tjetrit ose që të dy shihen si i njëjti personalitet. Në fakt vetëm vakëfnamet deri më tash të panjohura dhe të pa shpalosura meritojnë të studiohen për shkak të dhënave të rëndësishme që ofrojnë.[24]

Rrallë për ndonjë xhami dhe ndërtuesin e saj janë thurur aq shumë legjenda dhe tregime sa për xhaminë e Sinan Pashës në Prizren. Kronistë, diplomatë, historianë, studiues të kulturës kishtare si dhe gazetarë, shkruajnë për Sinan Pashën dhe pronat e tij në Prizren, por megjithatë deri më sot akoma nuk është qartësuar personaliteti i tij.

Kush ishte Sinan Pasha rreth të cilit janë krijuar aq shumë legjenda dhe si erdhi deri te këto paqartësi?!.

Studiuesi Hasan Kaleshi thotë: "Sipas mendimit tim, shkakun kryesisht duhet kërkuar në faktin se në Lumë të Shqipërisë në të njëjtën kohë kanë jetuar dy Sinan Pasha, Koxha Sinan Pasha që ka qenë pesë herë vezir dhe pesë herë Serdar (komandant suprem i ushtrisë), i cili ia ul shkëlqimin e lavdisë së Sinan Pashës ndërtuesit të xhamisë së Prizrenit".[25]

Sofi Sinan Pasha u lind në fshatin Vilë të Lumës së Shqipërisë në familjen e Rrotllave. Titullin "Sofi" e mori se ishte njeri i dijes. Si ushtarak pushtoi Jemenin, pesë herë mori pozitë të kajmekamit të Sadriazemit (kryeministrit), më pas u bë vezir i madh dhe dy herë ishte në postin e valiut të Budapeshtit. Mungojnë të dhënat se si ai mbërriti në Stamboll. Vdiq dhe u varros në Galipol të Turqisë.[26]

Pasi natyra e temës është e tillë që të mos zgjerohem edhe aq shumë në personalitetin e ndërtuesit të xhamisë, të shohim cilat janë arsyet që në mënyrë kategorike na shtyjnë të dëshmojmë se xhaminë e Sinan Pashës në Prizren e ka ndërtuar Sofi Sinan Pasha e jo Koxha Sinan Pasha.

[24] Hasan Kaleši, "Najstraji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na Arapskom jeziku", botoi: Zajednica Naucnih Ustanovo Kosova-Prishtinë 1972, fq. 257.
[25] Po aty, fq. 258.
[26] Muhamed Shukriut, "Prizreni i lashtë-Morfologjia e ecurive për mbrojtjen e kulturës materiale", fq. 296.

Para së gjithash Xhaminë në Prizren nuk ka mundur ta ndërtojë Koxha Sinan Pasha, sepse ajo është ndërtuar më 1024/1615, kurse Koxha Sinan Pasha ka vdekur njëzet vjet më herët. Përveç tjerash, Tahir efendiu në kronikën e tij në mënyrë të prerë thekson se xhaminë në Prizren e ka ndërtuar Sofi Sinan Pasha, ngase duke përshkruar një biografi të Koxha Sinan Pashës thekson se ai ka lënë vakëfe në Prizren, por jo edhe ndonjë objekt jetëgjatë në qytetin tonë. Dhe në fund, në dokumentet zyrtare turke ky objekt njihet vetëm si Xhamia e Sofi Sinan Pashës.[27]

Xhamia e Sinan Pashës në Prizren është një ndër xhamitë më të bukura të qytetit dhe gjendet në qendër të Prizrenit-Shatërvan, kjo është ndërtuar 2,5m prej lartësisë së nivelit të rrugës. Xhamia ka vlerën e vet kulturore, sepse gjendet nën Kalanë e vjetër të Prizrenit.[28]

Objekti më madhështor me kupolë në Prizren është kjo xhami e ndërtuar në vitin 1615, është e tipit sulltanor, e ndërtuar me gurë të gdhendur, me hajat të mbështetur mbi shtylla guri para korpusit kryesor të faljeve, kishte kupolën me diametër 14.5m, që përbënte pjesën më me vlerë të kësaj xhamie.[29]

Statusi i përmendores kulturore me interes të veçantë shoqëror i është dhënë me aktvendimin nr.1599 të vitit 1979 të Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Në vitin 1979 po ashtu i është dhënë statusi i kl.-I-Pasuri kulturore me vlerë të jashtëzakonshme, ndërsa në vitin 1994 në të është vënë flamuri i UNESCO-s. Objekti është i regjistruar në raportin teknik të UNESCO-s të vitit 1975-76/3.411.6 faqe 13.

Mund të konstatohet se arkitektura e kësaj xhamie është origjinale dhe se i është përshtatur kushteve të nënqiellit të Prizrenit të lashtë, si në horizontale ashtu edhe në vertikale.[30]

[27] Hasan Kaleši, "Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arabskom jeziku", fq. 261.
[28] Raif Virmiça: "Kosova'da Osmanli Mimarî", fq. 28.
[29] Zija Shkodra, "Qytetet shqiptare gjatë rilindjes kombëtare", botoi: Akademia e shkencave e RSP të Shqipërisë, Instituti i historisë, Tiranë 1984, fq. 408.
[30] Muhamed Shukriu, "Prizreni i lashtë…", fq. 296.

Rëndësia e Xhamisë së Sinan Pashës është brendësia e saj, dekorimet i kanë riparuar piktorët më të shquar të shtetit jugosllav. Stili i figurave pothuajse është i njëjtë me ato të përparshmet të cilat paraqesin një figurë gjeometrike me dekorime shumë të bukura.[31]

Për sa i takon minares, është për t'u theksuar se minarja e kësaj xhamie është shumë më e hollë se minaret tjera dhe është ndër minaret më të gjata në Kosovë, ku lartësia e saj arrin 42m. Mbulesa e minares është prej plumbi, hyrja në të është nga pjesa e jashtme pasi që është prishur çardaku, minarja është e tillë prej momentit të ndërtimit.[32]

Për shkak të dekorimeve të shumta që i janë bërë mihrabit ai e humbi origjinalitetin, mbi të ka qenë edhe një mbishkrim tjetër përveç mbishkrimit që është në hyrje të xhamisë, mirëpo si dukët për shkak të dekorimeve ka ardhur deri te fshirja e këtij mbishkrimi, vetëm se në këto shkrime vërehet një llojshmëri ngjyrash.

Mimberi është ndërtuar prej mermeri të kualitetit të lartë dhe në të janë pikturuar shumë trëndafila, dritarja përmbi mimber është imitim i një dritareje, ndërsa pjesët tjera janë të ndërtuara nga guri.

Edhe mahfili i xhamisë është i ndërtuar nga mermeri. Kjo xhami në katër muret e saja ka gjithsej 42 dritare, dritaret e pjesës së poshtme janë 125x190cm ndërsa trashësia e murit është 200cm, në pjesën e jashtme të dritareve janë të vendosur gurë të quajtur "Kesmetash" (gurë katër këndesh shumë të qëndrueshëm). Në mesin e këtyre dritareve në afërsi të mihrabit edhe sot ekziston "Vula e Sulejmanit a.s.".[33]

Dekorimi i enterierit është stil barok me motive spirale dhe florare. Kjo përzierje e stilit turk dhe barok është më e pazakonta dhe përveç kësaj xhamie, gjendet vetëm në xhaminë e Emin Pashës (1831) në Prizren.[34]

Pas ndërtimit, objekti përjetoi dëmtime të mëdha, supozohet të janë bërë nga tërmeti, dhe më pas janë bërë meremetime të brendshme

[31] Raif Virmiça: "Kosova'da osmanli mìmarì eserleri", fq. 29.
[32] Po aty, fq. 28.
[33] Po aty, fq. 29.
[34] "Sanat dünjamiz", Yil 4. Sayi 1977. Eylül 1977, botoi: Tifdruk Matbaacilik Sanayii A.S- Istambul, fq. 22.

dhe ripikturimi i plotë me seko- teknikë, në stilin barok (mesi i shek.XIX).

Çardaku i xhamisë ishte i mbuluar me tri kupola, të mbështetura në shtylla guri. Shtyllat kishin fondament katrorë dhe me përforcime prej shufrash hekuri, të vendosura horizontalisht. Të gjitha kupolat ishin të mbuluara me plumb. Xhamia ka dhe çezmen e vet të vendosur në nivel të rrugës.

Ky objekt shërbeu për kryerjen e obligimeve fetare deri në vitin 1912, kur nisën luftërat ballkanike dhe më pas Lufta e Parë Botërore. Gjatë okupimit trevjeçar bullgar (1915-18), në këtë objekt ishte e vendosur depoja e municioneve.[35]

Në vitin 1919 pushteti serb vendosi ta rrënojë objektin në tërësi, kështu që më 18 maj nisi rrënimi i çardakëve me qëllim të rindërtimit të Manastirit të Kryeungjillit të "Shenjtë" (Sveti Arhangjell) në Grykën e Lumëbardhit. Me atë rast u rrënuan tri kupolat e çardakëve së bashku me shtyllat e gurit, ndërsa ngelën vetëm katër transversale të hekurit, që horizontalisht mbështeteshin në shtylla (0.20x0.25x8m). Transversalja e fundit në verilindje është shtrembëruar aq shumë nga tentimet për ta shkulur nga muri sa që vetë murit i shkaktohen dëmtime tejet serioze.

Pas këtyre dëmtimeve që iu bënë xhamisë, për incizimin dhe për mbrojtjen e saj, Shoqata për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturo-Historike Gjithëshqiptare, në bashkëpunim me Këshillin e Bashkësisë Islame në Prizren, veproi në fund të vitit 1995 në disa drejtime. Ky aksion kishte për qëllim parandalimin e rrezikut që vjen nga koncepti i hartuar serb për rikonstruksionin total të manastirit të përmendur, në të cilin parashihet edhe marrja e kapitoleve nga mahfili dhe vendosja e kopjeve në vend të tyre.[36]

Madhësia e xhamisë në përgjithësi është 3.150m², vetëm xhamia 671m, ndërsa oborri 2.497m².[37]

[35] Muhamed Shukriu: "Prizreni i lashtë…", fq. 297.
[36] Po aty, fq 299.
[37] Raìf Virmìça: "Kosova'da Osmanli Mìmarì Eserleri", fq.30.

XHAMIA E MAKSUT PASHËS (NË KOMPLEKSIN MARASH), (SHEK.XVII)

Ka ndërtuar një xhami tek ne, të këndshme, të zbukuruar dhe e ka gjallëruar me shumë vakëfe në qytetin tonë.
Ndërtuesi kishte urdhëruar që ajo xhami të bëhej si e Sinan Pashës, por kur ai erdhi vali në qytetin tonë, ajo që më par ka qenë xhami pa mimber.[38]

Nga Kronika e Tahir ef.

Maksut Pasha në Perandorinë Osmane luajti rol me rëndësi dhe kreu funksione të shumta. Ai kishte kontakte me njohës të mirë të Kur'anit dhe këmbenin mendime rreth kulturës islame. Me këtë kuptojmë se lagjja Marash ishte një fole në të cilën bëhej përhapja dhe ndriçimi i kulturës islame.

Ky njeri në këtë lagje ndërtoi një xhami të bukur, i frymëzuar nga xhamia e Sinan Pashës urdhëroi që edhe xhamia e tij të jetë identike si ajo.[39]

Pas ndërtimit të kësaj xhamie fillon edhe ndërtimi i shtëpive përreth. Por për shkak të konfiguracionit të terrenit, ajo lagje mbetet më e vogla e këtij qyteti.[40]

[38] "Edukata Islame", nr.57. fq. 88-89.
[39] Dr.Maliq Osi: "Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor", fq.42.
[40] Salajdin Krasniqi: "Prizreni udhëtim nëpër kohë", Prizren, 2002. fq. 38.

Xhamia e Maksut Pashës është një xhami me kube të mesme, e vogël por shumë simpatike. Dorëshkrimet e librit të xhamisë sot nuk ekzistojnë, për këtë arsye edhe nuk dihet saktë viti i ndërtimit, mirëpo sipas dokumenteve që i posedojmë, kjo xhami është ndërtuar në shek. XVII. Ndërsa sipas Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në bazë të një shënimi na njofton se xhamia është ndërtuar në vitin 1641.

Edhe pse Maksut Pasha ka urdhëruar që kjo xhami të ndërtohet si Xhamia e Sofi Sinan Pashës, megjithatë përafërsisht i përngjan xhamisë së Kukli Begut.[41]

Në vitin 1894 kjo xhami rreth e përqark ka pasur 19 shtëpi dhe ka qenë në një pjesë shumë të bukur ku edhe sot e kësaj dite njihet si pjesa më e bukur e qytetit, ku bukurinë e saj ia shton edhe xhamia.

Xhamia e Maksut Pashës dallohet nga xhamitë tjera për nga ndërtimi i saj. Nëse ia hedhim një shikim nga brenda, të gjitha stolitë dhe dekorimet që i ka pasur qysh prej ndërtimit të saj janë mbuluar prej meremetimeve dhe fare nuk ekzistojnë.

Madhësia e xhamisë është 10.20x10.20m, dhe është e ndërtuar prej gurëve "kesmetash". Muret e xhamisë janë të ndërtuara nga gurët molozë dhe kanë pasur dimensione 90cm. Kubeja e xhamisë nuk është aq e lartë dhe është e mbuluar me plumb. Minarja ka 14 kënde dhe është e ndërtuar prej guri, brenda në xhami është edhe mihrabi i cili është i rindërtuar në vitin 1981. Dera është prej druri dhe rrethi i derës është i punuar me gurë "kesmetash", mbi derë të xhamisë, përmbi gurë është punuar Hëna dhe Ylli. Xhamia ka shtatë dritare në pjesën e sipërme dhe katër në pjesën e poshtme ku pjesa e poshtme e dritareve është mermer. Mahfili është i ndërtuar prej druri me një gjerësi prej 2m. Në hyrje është dera për t'u ngjitur në minare. Edhe pse në fillim xhamia ka pasur një sipërfaqe më të madhe, sot posedon vetëm 544m², xhamia 162m², kurse oborri 382m².

Oborri i xhamisë është ndërtuar me gurë mollozë dhe ka kangjele të hekurt, në oborr kanë qenë varret, ndërsa sot nuk ekzistojnë ato fare.[42]

[41] Raif Virmiça: "Kosova'da Osmanli Mimarì Eserlerì", fq.79.
[42] Po aty, fq. 80.

XHAMIA E EMIN PASHËS (1831)

Ai (Muhamed Pasha) kishte një vëlla që i thoshin Emin Pasha, pastë dobi e mirësi përgjithmonë.
Kishte tubuar më të mirin kapital
dhe kishte blerë shtëpi në zemër të lagjes sonë
Ai ka ndërtuar një xhami që i shëmbëllente asaj të Sinan Pashës.
Ajo ka qenë xhamia e tretë në qytetin tonë[43].

Një xhami e bukur me kupolë në Prizren është ajo e Emin Pashës, në hyrje të tregut, e ndërtuar sipas modelit të Sulejmanies së Stambollit[44]

Objekti i ndërtuar në vitin 1831 e fitoi cilësinë e përmendores së kulturës me aktvendimin nr.371/1987 të Institutit për Mbrojtjen e Mo-

[43] "Edukata Islame", nr.57, fq.109-110.
[44] Zija Shkodra: "Qytetet shqiptare gjatë rilindjes kombëtare", Tiranë 1984, fq. 407.

numenteve të Kulturës, ndërsa nishani mbi varrin e Emin Pashës me aktvendimin nr.638/1955 të po këtij Instituti. Ky monument, me arkitekturën dhe arabeskat, prezanton për nga monumentaliteti kulturë materiale me vlerë të qytetit pas xhamisë së vëllait të tij Mehmetit dhe asaj të Sinan Pashës.[45]

Para se të hyhet në xhami, në anën e jashtme gjendet një pllakë mermeri me dimensione 41x51 cm, me mbishkrim të shkruar në stilin thuluth.

"Mirëbërësi paqësor prizrenas
Mehmet Emin Pasha, i biri i Tahir Pashës
në emër të Zotit le t'i mbërrijë
në të dy botët të gjitha që i dëshiron
Viti njëmijë e dyqind e katërdhjetë e shtatë"
1247/H. 1831

Xhamia e Emin Pashës është e pasur me shumë ornamente, vizatimet në të janë të ngjashme me vizatimet e xhamisë së Sinan Pashës, nëse këto vizatime vështrohen mirë na duket se i kanë punuar mjeshtrit e njëjtë të artit. Këtë e dëshmon edhe vizatimi i xhamisë së Sinan Pashës që gjendët mbi mihrab. Kupola e xhamisë është aq e madhe, ku përfshin tërë hapësirën e lartë të pjesës së brendshme. Në pjesën e poshtme të kupolës gjenden tetë dritare të madhësive të njëjta, dritaret janë njëpjesëshe dhe radhiten njëra pas tjetrës. Në mes të kupolës dominon ngjyra vjollce, në të është i vizatuar gjethi i stilizuar me ngjyrë oker.[46]

Edhe hapësira e brendshme është e stilizuar dhe ka dekorime të stilit oriental në pjesën e brendshme të mahfilit që ka mbështetje në katër shtylla, pjesës së brendshme ia jep bukurinë edhe mihrabi i zbukuruar, mimberi i tij është punuar e dekoruar me një stil shumë të bukur. Në përgjithësi arkitektura dhe dekorimet janë të stilit barok.[47]

[45] Muhamed Shukriu: "Prizreni i lashtë…", fq. 327.
[46] Dr. Maliq Osi. "Prizreni i lashtë- muze me thesar të pasur kulturorë", fq. 95.
[47] Po aty, fq. 94.

Në oborrin e xhamisë edhe sot e kësaj dite gjenden varrezat ku janë të varrosur edhe pjesëtarë të familjes së Emin Pashës, ndërsa varri i tij gjendet po ashtu në oborr para Medresesë se tij.[48]

Në vitin 1974 u bënë intervenime intensive në Xhaminë e Emin Pashës nga Bashkësia e Fesë Islame në Prizren, me ç'rast është lyer minarja e saj me një ngjyrë të mbyllët dhe të papërshtatshme, kështu që në vitin 1985 u bë korrigjimi i ngjyrës dhe u vu në maje të minares një shtresë e re e plumbit. Në vitin 1995 në çardakët e xhamisë u rregulluan kornizat me qelq, veprim ky që është në kundërshtim me vlerat arkitektonike të objektit. Në të vërtet, ky ishte një akt që bie në kundërshtim me normat shkencore të restaurimit dhe të konservimit të objekteve të kulturës materiale.[49]

Sipërfaqja e xhamisë është 1.400m², vetëm xhamia 397m², ndërsa oborri 1.003m².[50]

Përfundimi

Të hulumtosh dhe të shkruash për objektet islame të një qyteti të lashtë siç është Prizreni, ishte punë e mirë dhe e dobishme nga njëra anë po gjithsesi edhe me përgjegjësi të madhe nga ana tjetër. Për shkak të natyrës së punimit, jam përqendruar vetëm për xhamitë, të cilat janë nën përkujdesjen e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës Prizren, sepse ka edhe objekte tjera të cilat e gëzojnë këtë status siç janë Hamami i Gazi Mehmet Pashait, Ura e Gurit, Lisi i Marashit dhe disa objekte tjera. Jam munduar që në këtë punim të përfshij vetëm tiparet dhe karakteristikat kryesore të objekteve më të rëndësishme, më markante të këtij qyteti historik, qytetit të Lidhjes Shqiptare (1878), qytetit të cilit mu këto objekte të përmendura në këtë punim dhe po ashtu edhe shumë të tjerë që ngelin jashtë këtij punimi, janë ato të cilat i japin frymën Prizrenit.

[48] Raif Virmiça, "Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri", fq. 42.
[49] Muhamed Shukriu: "Prizreni i lashtë…", fq. 328.
[50] Raif Virmiça: "Kosova'da Osmanli Mimari Eserleri", fq.43.

Nuk them se kam bërë atë që nuk mund ta bënte dikush tjetër, pos që kam sjell ndonjë risi të vogël në këtë drejtim, sepse atë që kam shkruar jam kujdesur ta verifikoj tek objektet.

Prizreni është i njohur në tërë Kosovën dhe më gjerë si qyteti më i bukur, e mban "namin" e qytetit muze, dhe shumë favore tjera që e ngrinin famën e tij në këtë aspekt.

Mirëpo, a do të ishte dhe çka do të ishte Prizreni pa Xhaminë e Bajraklisë, Xhaminë e Sinan Pashës, pa Hamamin e Mehmet Pashës, Urën e Gurit, pa Kalanë e pa më shumë se 30 minare….?! Me siguri që do të ishte një qytet, por jo ky Prizren.

Me shumë respekt dhe konsideratë kam përmendur të dhëna të dokumentuara për ndërtuesit e kësaj trashëgimie fetare islame dhe kulturore, edhe pse shkurtimisht për faktin se nuk kanë qenë objekt i punimit tim, e të cilët i falënderoj në këtë punim dhe sa herë që i shikoj objektet e përmendura, shpresoj se shpërblimin adekuat do ta kenë vetëm nga Allahu xh.sh., për hir të të cilit edhe i kanë ndërtuar.

E falënderoj edhe mentorin tim prof. Resul Rexhepi që më ka sugjeruar dhe ndihmuar rreth këtij punimi sikundër i falënderoj të gjithë ata që në një mënyrë ose tjetër më kanë ndihmuar gjatë përgatitjes së këtij punimi.

Gjatë përgatitjes së kësaj teme jam munduar të përdor literaturë profesionale të botuar deri më tash dhe me besnikëri t'i citoj me fusnota. Gjithashtu, këtë punim e kam ilustruar edhe me fotografi për të cilat shpresoj se janë në të mirë dhe funksion të temës.

Përshtypje të veçantë më ka lënë kronika e Tahir ef., i cili aq bukur i ka përshkruar objektet në fjalë e që për mua ka qenë një burim i dorës së parë.

Ajo që mund të them me këtë rast është se trashëgimia islame në tërësinë e saj meriton vëmendje dhe kujdes më të madh e në veçanti nga institucionet kompetente, në rastin tim sidomos nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Pa një përkujdesje meritore dhe profesionale, kam frikë se këto shtëpi të Allahut dita ditës edhe më shumë do të pësojnë, sepse dhëmbi i kohës është i pamëshirshëm.

Dija absolute për çdo gjë i takon Allahut, Atij i qofshim falë për gjithçka. Lutja jonë e parë dhe e fundit: Lavdi i qoftë Allahut, Krijuesit të botëve!

Burimet dhe literatura

1. Sherif Ahmeti, "KUR'ANI" - përkthyer me komentim në gjuhën shqipe, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame Prishtinë,1988.
2. Muhamed Shukriu, "PRIZRENI I LASHTË - Morfologjia e ecurive për ruajtjen e kulturës materiale", Prizren 2001
3. Dr Maliq Osi, "Prizreni qytet i lashtë, muze me thesar të pasur kulturor", botoi: Shoqata Numizmatike Shqiptare "Demastion" Prizren 2001.
4. Salajdin Krasniqi, "Prizreni udhëtim nëpër kohë", Prizren 2002.
5. Prof.dr. Esat Haskuka, "Analiza e funksioneve të Prizrenit gjatë shekujve", Prizren 2003.
6. Abib Ahmeti, "Theranda - Prizreni ndër shekuj", Prizren 1996.
7. Nexhat Ibrahimi, "Islami dhe myslimanët në tokat shqiptare dhe në Ballkanin mesjetar /shekujt IX-XIV/", botoi: Logos-A, Shkup, Tiranë, Prishtinë 2003.
8. Si ta njohim artin islam, përktheu nga boshnjakishta Nexhat Ibrahimi, Prishtinë 2000, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë.
9. Grup autorësh, "Kosova dikur e sot", botoi: Ekonomska Politika, Beograd 1973.
10. Zija Shkodra, "Qytetet shqiptare gjatë rilindjes kombëtare", botoi Akademia e shkencave e RSP të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1984
11. "Feja kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët" - Simpozium ndërkombëtar, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 1995.
12. Raif Vërmiça, "KOSOVA'DA OSMANLI MÌMARÌ ESERLERÌ-I", 1999, botoi: T.C Kultur Bakanligi Osmanli Eserleri, Ankara 1999.
13. Prof. dr. Hakki Acun, Y.Doç.dr. Mehmet Ibrahimgil, "Gërmimet dhe restaurimet e Namazxhahut (Xhamia e thyer) Kosova-Prizren Fatih Sultan Mehmet dhe parku i dëshmorit Hysen Kutlu", botoi: Türk Tarih Kurumu Basilevi, Ankara 2002.
14. Hasan Kaleshi, "Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda", botoi: Albanoloska i Strazivanja Knjige –Prishtinë 1962.
15. Hasan Kaleshi, "Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arabskom jeziku", botoi: Zajednica Naucnih Ustanovo Kosova, Prishtinë 1957.
16. "Sanat Dünjyamiz",Yil.4, Sayi.11, Eylül, 1997, botoi: Tifdruk Matbacilik Sanayii, A.S- Istambul 1997.

17. "Dituria Islame", Revistë fetare kulturore e shkencore, nr. 98, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 1997.
18. "Edukata Islame", Revistë fetare, kulturore e shkencore, nr. 57, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 1995.
19. "Edukata Islame", Revistë fetare, kulturore e shkencore, nr. 75, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 2004.
20. "http:iiu.edu/deed/quran/Albanian/kultura.html."

Mirije Xhezairi

MONUMENTAL MOSQUES IN PRIZREN

(Summary)

During the Ottoman period religious objects had a very important place in urban architecture (alongside houses, shops, workshops and other public buildings).

A number of mosques fall within this category. There are many such objects in Kosova: the Gazi Mehmet Pasha Mosque, the Sinan Pasha Mosque, and the Suzi Efendi Mosque in Prizren, the Jadar Pasha Mosque and the Sultan Fatih Mosque in Prishtina, the Hadumi Mosque in Gjakova, the Gazi Ali Beu Mosque in Vushtrri, etc.

Special attention must be paid to these magnificent buildings as they are the greatest testimony of the autochthony of the Albanians in these territories.

ميرية جزائرى

الجوامع الاثرية بمدينة بريزرن

(خلاصة البحث)

مقدمة

خلال فترة الحكم العثمانى إلى جانب البيوت و الدكاكين و المبانى العامة كانت المساجد و الجوامع تحتل مكانا خاصا في فن معمار المدن المختلفة.

في إطار هذه المبانى يمكن أن نذكر بعض الجوامع القديمة و الاثرية في كوسوفا مثل: جامع غارى محمد باشا و جامع سنان باشا و جامع سوزى افندى الخ بمدينة بريزرن. اما بمدينة بريشتينا أشهر الجوامع هي: جامع ياشار باشا و جامع السلطان فاتح و جامع الخادم بمديمنة جاكوفا و جامع على بك بمدينة فوشترى إلخ.

هذه الجوامع الاثرية التي توجد بمدن كوسوفا المختلفة يجب علينا الاهتمام بها لانها تمثل ثروة فنية و معمارية كبيرة بالنسبة لنا و تشهد على هويتنا و وجودنا المستمر في هذه البقعة من العالم.

KULTURË

Rozhe Garodi

KONTRIBUTI I KULTURËS ISLAME CIVILIZIMIT BOTËROR

Në njërën nga faqet e veprës së jashtëzakonshme të Anatole Fransës "Në gurin e bardhë' njëri nga historianët e pyet madam Dovazien "Cila është dita më fatkeqe për historinë e Francës? Nuk është përgjigjur. As nuk ka ditur cila është ajo ditë. Atëherë asaj ai i ka thënë: Ajo ka qenë në vitin 732 – në të cilin ka ndodhur lufta në Poatjea, viti kur kultura arabe u tërhoq para barbarizmit francez".

Këto fjalë nxisin në mua kujtim shumë të mirë, i kam përmendur edhe në Tunis në vitin 1945 me rastin e ligjërimit tim mbi Ibni Haldunin. Pas asaj gjenerali francez, përndryshe gjenerali rezident i Tunisit rekomandoi dëbimin tim me akuzën se po përhapi propagandë kundër Francës. Kjo ngjarje ka pasur rëndësinë e vet të madhe, sepse nga pikëpamjet kolonialiste edhe vetëm të përmendurit e popujve të kolonizuar dhe të përkujtuarit të kaluarës dhe kulturës së tyre, janë konsideruar si urrejtje ndaj kolonializmit dhe rrezik i cili i kërcënon.

Kur në Algjer kam dashur të njoh traditën e lavdishme të kulturës dhe civilizimit arab, jam përballuar me krimin e vërtetë, të cilin kolonializmi e ka bërë kundër mendjes njerëzore. Pra, komploti i heshtjes kundër kulturës islame ka qenë skajshmërisht i organizuar. Në vitin

1945, i kam vizituar gati të gjitha bibliotekat e Algjerisë. Kjo ka qenë e mjaftueshme për të ardhur deri te konkluzioni, që ka dëshmuar se një numër shumë i vogël i veprave të shkencës arabe është përkthyer në gjuhën franceze.

Përkundër kësaj, në çdo bibliotekë të Algjerisë kam hasur në nga disa ekzemplarë të veprës: "Vështrim i shkurtër i politikës Islame", e cila fliste mbi ideologjinë e vërtetë kolonialiste. Në të gjendet definicioni i shkencës arabe, si vijon: "Kultura arabe, e cila ka shkuar në pakthim, në realitet përfaqëson vetëm ekstraktet e mendimtarëve grekë, të cilat i kanë përkthyer çifutët në kohën e mesjetës".

Mirëpo, me një angazhim të madh dhe me ndihmën e miqve nga Algjeria, të cilët m'i përkthyen apo rezymuan citatet e zgjedhura themelore, kam arritur për të tubuar materialet kryesore për ligjëratat e mia. Që në vitin 1945 kam kuptuar se çdo ligjëratë mbi "kontributin historik të kulturës arabe", përmban në vete reagim në politikën koloniale të arsimit, e cila ka për qëllim t'i mohojë popullit krenarinë në të kaluarën e tij, duke arsyetuar me atë se është i nënshtruar dhe i privuar nga pavarësia.

Për këtë shkak kam konsideruar se publikimi i ligjëratës së atëhershme në gjuhën franceze në Algjeri, e pastaj përkthimin e saj arabisht në Kairo, nga ana e luftëtarëve nacionalist, të cilët në të kishin gjetur armën ideologjike të luftës së tyre, nuk paraqet vetëm nder të madh, por edhe shpërblimin më të madh që mund t'i jepet njeriut. Mirëpo, sot situata është ndryshe dhe është e mundur të shtrohen në përmasa të mëdha kompleksiteti i problemeve dhe i pyetjeve: Çka i ka dhënë kultura islame njerëzimit të kohës tonë, ose çka i ka dhënë jo vetëm në pikëpamje të revolucionit kundër mohimit të kaluarës së lavdishme, por edhe në pikëpamje të kontributit njerëzimit të periudhës sonë, mendoj pjesës socialiste të tij.

I. Shkaqet dhe pasojat e ekspansionit arab

Ekspansioni arab, para lulëzimit të civilizimit të tij krijoi kushte të nevojshme për përtëritjen e kulturës botërore dhe hodhi entuziazëm të ri në mbarë botën. Ai ka prodhuar kushte ekonomike e sociale për një progres të ri duke shkatërruar anarkinë e feudalizmit dhe zhvillimin parazit të tij. Është me rëndësi të përmendet se ky ekspansion edhe pse ka qenë shumë i shpejtë, në asnjë moment nuk ka marrë karakter shkatërrues siç ka qenë rasti me invadimin e tatarëve ose të mongolëve. Çetat numerikisht të vogla arabe depërtuan në krahina të gjera dhe në shumicën e rasteve ka ndodhur që të kenë fituar përkrahjen e drejtpërdrejtë dhe absolute. Në këtë mënyrë ushtria pushtuese në Spanjë për shembull ka numëruar më pak se 40000 luftëtarë[1]. Do të thotë duhet kërkuar tjera shkaqe për të kuptuar ekspansionin aq të shpejtë arab dhe gjithanshmërinë e tij e jo forcën ushtarake.

Faktori vendimtar i fitores ka qenë se pushtuesit arabë botës skllavopronare të shkatërruar dhe feudale të përçarë e të rraskapitur, i sollën me vete formën më të lartë të jetës ekonomike e sociale, me të cilën i obligonin masat e gjera dhe përputheshin me kërkesat dhe nevojat e tyre. Për shembull shoqatat profesionale, të cilat Evropa i ka njohur pas disa shekujve, te arabët janë shfaqur në shekullin e nëntë. Ato kanë qenë shoqatat e esnafëve në kohën e Karamitëve. Sistemi "Komunë", i cili në Evropë u shfaq pas luftërave të kryqëzatave dhe kontakteve me Islamin, në botën arabe ka ekzistuar shumë më herët me të gjitha cilësitë dhe karakteristikat e tij. Në qendrat tregtare e gjejmë institucionin e muhtesibit, inspektorit të vërtetë të veprimtarisë tregtare, i cili kontrollonte çdo aktivitet të ekonomisë dhe siguronte jetë normale morale.

Në Spanjë ku ndikimi arab ka qenë më i madhi, ka ekzistuar një lloj i këshillave të qytetit me buxhetet e veta të pavarura dhe me gjyqësi të zgjedhur. Njëkohësisht ka ardhur deri te lulëzimi shkencor i

[1] Sipas Filip Hitit, ushtria në fjalë numëruar 12.000 veta (vër. e përkth.)

bujqësisë, industrisë së pëlhurave të metalit, lëkurës dhe i detarisë më të mirë në Evropë, detari e cila do të zbulonte Amerikën.

Në këtë mënyrë pushtuesit arabë me rrënimin e ekonomisë së copëtuar, me krijimin e territoreve më të gjera se sa që kishte Imperia Romake për qarkullimin e të mirave, dhe ideve, me ndërtimin e shtetit të njësuar centralist të bazuar në ligj të shkruar dhe me organizimin e administratës gjyqësore, e shkundën pluhurin nga gjërat, njerëzit dhe idetë, dhe krijuan kushte të nevojshme për ndërmarrje të madhe krijuese në historinë e njerëzimit. Kultura e lashtë, në të cilën mbretëronte stagnimi dhe venitja në Bizant, përsëri u ngjall nga ana e pushtuesve të rinj.

Ekspansioni arab e eliminoi ndikimin e borgjezisë tregtare në qytete, i cila ka qenë mbështetur në rregullimin e atëhershëm shoqëror, sistemin social të bazuar në skllevër dhe të trupëzuar në shtangim e ngrirje, të cilat ua kishte imponuar sundimi romak dhe bizantin. Në këtë pikëpamje Zhan Bereni thotë: Ekspansioni arab i ka shkaktuar ringjallje të vërtetë ekonomisë botërore". Kjo madje ka ndodhur krahas ndikimit dhe fuqisë së elementeve feudale në vitet e para të pushtimit.

Rëndësisë së marrëdhënieve sociale dhe ekonomike për kulturën tregtare në ballafaqim me shoqëritë skllavopronare dhe feudale, ajo i ka dhënë edhe poentën etike, e cila është bazuar në tolerancë pastaj elementin racional, i cili është bazuar në frymën kritike dhe në rezistencën e shovinizmit tiranik dhe dogmatik. Për atë shkak Engelsi, bashkëpunëtori i Marksit, vërteton se mendimtarët arabë ia kanë tejkaluar enciklopedistëve francezë të shekullit të tetëmbëdhjetë. Në veprën e tij "Dialektika" duke folur për Renesancën përmend: "Popujt romanë kanë idenë e pastër dhe të lirë të marrë nga arabët, dhe të frymëzuar nga filozofia greke. Pastaj ajo gjithnjë e më tepër është forcuar duke përgatitur në këtë mënyrë lindjen e materializmit të shekullit tetëmbëdhjetë".

Nga kjo mund të konkludohet se ekspansioni arab nuk ka qenë as ekspansion ushtarak as kolonialist, por ka qenë, për çdo vend, rast i jashtëzakonshëm për krijimin e kulturës, e cila ka rezultuar me Islamin dhe tiparet e tij lokal pa marrë parasysh se i cilit lloj ka qenë:

uzbekë, persianë, sirianë, egjiptianë, marokenë, andulizianë etj. Madje edhe përkundër përzierjes së atyre kulturave dhe gërshetimeve të fuqishme të tyre, ato e kanë ruajtur origjinalitetin e vet, i cili ka shërbyer si bazë për artin dhe kulturën e ardhshme nacionale. Këtë na e vërteton edhe shkrimtari i njohur spanjoll Blasko Ibanez në veprën e tij të shquar: "Në hijen e katedrales", kur flet për vendin e vet ai thotë:

"Në Spanjë renesanca nuk ka ardhur nga veriu, me pushtimet barbare, por nga jugu, me pushtuesit arabë... Ekspansioni i tyre më tepër ka qenë i natyrës kulturore sesa ushtarake. Nga andej na ka ardhur kjo kulturë e re e fuqishme, e cila ka pasur zhvillim të shpejtë fenomenal, kulturë e cila posa të ketë lindur, menjëherë i tejkaloi të gjitha të tjerat, kulturë të cilën e krijoi entuziazmi fetar i profetit të Zotit dhe e cila në vete ka mbajtur tërë atë që ka qenë më e mira në mësimin çifut dhe bizantin. Dhe jo vetëm atë, por ajo me vete barti edhe elemente të traditës hinduse dhe persiane dhe shumëçka të përvetësuar nga Kina e panjohur. Lindja, ç'është e vërteta, ka qenë ajo e cila ka depërtuar në Evropë. Ajo nuk ka qenë rast që ka ndodhur në sundimin e Darisë dhe perandorëve tjerë persianë që Lindja ka depërtuar përmes Greqisë, e cila i ka penguar në rrugë të mbrojtjes së lirisë së vet. Jo, kësaj here e tëra ka ndodhur nga ana tjetër, nga Spanja e civilizuar, e cila para asaj ka qenë në prangat e sunduesëve kishtarë dhe të klerit luftënxitës, vendi i cili pushtuesit e rinj i ka pritur krah hapur.

Nuk kaluan as dy vjet, e ata i vuan duart e tyre në atë, për të cilën do të jetë e nevojshme të deponohet më tepër se shtatë shekuj për kthimin e saj. Nuk ka qenë ajo luftë e imponuar me fuqinë e armës, por ka qenë përhapje e shoqërisë së re në të gjitha anët e botës, shoqëri rrënjët e së cilës kanë qenë shumë të forta. Principi i vetëdijes së lirë që përbën gurthemelin në të cilin qëndron madhështia e vërtetë e çdo kombi, te ata ka qenë tepër i respektuar, gati i shenjtë. Në qytetet në të cilat kanë sunduar nuk i kanë prekur kishat krishtere as tempujt e hebrenjve. Nga shekulli VIII e deri në shekullin XV u krijua kultura më e bukur të cilën Evropa e ka parë në mesjetë. Derisa në veri popujt bredhshin dhe shkatërroheshin në luftërat fetare dhe vepronin sikur të ishin fise të egra, ndërsa populli i Spanjës kishte arritur gjendjen efektive në tridhjetë milionë. Në këtë masë të madhe të njerëzve kanë qenë të përzier të gjitha nacionalitetet dhe ideologjitë me të gjitha ndryshimet dhe specifikat e tyre. Ato përbënin një kompaktësi dhe një tërësi. Rezultati i saj ka qenë fuqia evidente e shoqërisë dhe përparimi i saj shpirtëror dhe shkencor. Në këtë përzierje të frytshme të popujve dhe të nacionaliteteve, në paqe kanë koekzistuar të gjitha ideologjitë dhe traditat. Produkt i saj kanë qenë të gjitha zbulimet, të cilat u shfaqën deri më atëherë në botë, të gjitha llojet e artit, shkencës, industrisë, i arritjeve krijuese dhe sistemeve të vjetra. Nga kontaktet e këtyre elementeve të shumëllojshme lindën zbulime të reja dhe fuqi të reja krijuese. Me këta të huaj nga Lindja kanë ardhur mëndafshi, pambuku, limani, kafeja, portokalli, shega, tepihët, pëlhurat, xehet etj. Falë atyre janë njohur numrat, algjebra, kimia, medicina, astronomia dhe poezia metrike.

Filozofët grekë pas harresës së gjatë përsëri u ngjallën. Ata e kthyen vendin e tyre, atëherë kur filluan të përcjellin arabët me rastin e pushtimeve të tyre. Vetëm pas asaj Aristoteli triumfoi në universitetin e njohur të Kordovës..."

II. Civilizimi arab

Ekspansioni arab krijoi kushte frymëzuar për renesancën. Ajo ka qenë e cila, para të gjithëve krijoi mundësi të ringjalljes së kulturës së vjetër, posaçërisht asaj Helene. Periudha e parë e Islamit, periudha e sundimit të Emevijve në Damask, ka qenë shekull i ekspansionit. Periudha e dytë Islame ka qenë periudha e Abasinjve në Bagdad. Ajo ka qenë periudhë e formimit të perandorisë, e cila filloi nga viti 750 e vazhdoi deri në vitin 900. Ajo paraqet periudhën e përvetësimit, përkatësisht të përkthimit.

1. Ngjallja e kulturës së harruar

Para përfundimit të shekullit të tetë kanë qenë të përkthyera në gjuhën arabe gati të gjitha veprat e Aristotelit, Galileut, Platonit, Ptolemeut, Euklidit, Arhimedit si dhe mekanika e Heronit.

Nga viti 813-833, në periudhën kur Evropa nuk ka pasur mësuar të lexojë, halifi Mëmun, me ndihmën e një grupi përkthyesish, formoi akademinë në Bagdad, të cilën e quajti "Bejt al-Hikmet", e cila e bëri të lehtë njohjen e kulturës greke për të gjithë lexuesit e Kur'anit. Ibni Halduni mendon se kjo akademi paraqet fillimin e lulëzimit revolucionar të kulturës arabe. Periudhën më të zhvilluar të përvetësimit ai paraqet Al-Kindin, i lindur në vitin 850, i cili e transmetoi teorinë kosmologjike të Aristotelit dhe e shkroi enciklopedinë më të madhe, të cilën e ka njohur bota, para "Përmbledhjes teologjike" të Toma Akuinit, e cila lindi plot tre shekuj më vonë. Atë e ka përkthyer në latinisht Xherard Kremoni dhe ka paraqitur gjatë shumë shekujve arsimimin e vërtetë në Perëndimin.

Në këtë mënyrë kultura arabe paraqet bazën themelore të periudhës së renesancës, anën e saj humane do të thotë ringjalljen e së kaluarës. Uniteti arab në atë periudhë paraqet lidhje të fortë, e cila e ka lidhur kulturën e vjetër me të renë. Kështu që gjatë pesëqind vjetëve prej vitit 700-1200, Islami do të sundonte si me fuqinë e shkencën ashtu edhe me kulturën superiore.

Në kohën kur në Marok halifi Ibni Nasir diskutonte me Ibni Rushdin (Averosin) mbi Aristotelin dhe Platonin, princat e Perëndimit krenoheshin që nuk dinin as të lexonin. Derisa Franca jetonte nën udhëheqjen e "mbretërve dembelë" në atë kohë në Kairo, Karavijun dhe Fes, familjet mbretërore jepnin përkrahje të pakufizuar, letërsisë, shkencës dhe artit. Rreth vitit 900 Hugo Kabia ia ka besuar për edukim djalin e tij klerikut Xherberit, i cili kishte studiuar shkencat matematikore në Universitetin arab në Kordovë. Në atë kohë në Kordovë ka qenë në pushtet El-Hakem, dijetar, biblioteka e të cilit ka numëruar

më tepër se 100000 vepra[2], kurse pas plot katër shekujve mbreti i Francës Sharli V, i quajtur i urti, nuk do të mund të tubonte as 1000 vepra.

Ekspansioni arab e ka ringjallur Perëndimin në atë moment kur ia ktheu atij shkencën Helene, të cilën Evropa tërësisht e kishte harruar dhe nuk kishte mundësi vetë që përsëri ta ringjallte. Kur viteve të njëmita Perëndimi vuante nga terrori dhe me shqetësimin mistik e priste "Fundin e botës" në të njëjtën kohë popujt arabë nuk mjaftonin vetëm me ringjalljen e kulturës së vjetër, por me punë shumë të madhe e me elanin e tyre krijues në të gjitha lëmenjtë, i kanë kontribuar kulturës botërore. Ja këtë kontribut krijues të arabëve kësaj here dëshiroj ta shqyrtojë.

2. Kontributi i arabëve shkencave natyrore

Zbulimet më të rëndësishme shkencore dhe artistike të periudhës Helene në shekullin e tretë dhe të dytë para e.r., për shkak të kushteve ekonomike dhe shoqërore, nuk kanë mundur ta ndryshojnë botën. Përhapja e skllavopronarizmit ka qenë pengesa më e madhe e të arriturave tekniko-shkencore të asaj periudhe, si dhe të realizimit të ndryshimeve rrënjësore të jetës ekonomike, për shkak se eksploatimi i skllavëve, deri te i cili vinte me çmime shumë të ulëta, kishte më tepër përparësi sesa përdorimi i veglave dhe pajisjeve teknike për punë. Në atë mënyrë ka dështuar përpjekja e mendimit helenist për sendërtimin e kulturës së re dhe ndryshimin e shoqërisë.

Kur ky popull udhëtues e pushtues, themelues i perandorisë tregtare shkatërroi sistemin feudal bujqësor, për shkencën realizoi progres të paçmuar, i cili u manifestua në qëllimet e dobishme shkencore, të cilat ia kanë ofruar shkencat. Zbulimet praktike dhe teorike të periudhës helene gjetën truall pjellor për ekzistimin personal në kulturën e re tregtare. Gjeografia ka qenë nevojë dhe domosdoshmëri jetësore, posaçërisht për ata që i kalonin shkretëtirat dhe detet. Ata kanë qenë

[2] Për këtë bibliotekë, veprat tjera pohojnë se ka pasur rreth 600.000 volume.

të parët në botë të cilët themeluan opservatori: në Semerkand, Bagdad, Damask, Kairo, Kordovë etj.

Al-Fazari qysh në vitin 770 përsëri e vuri në përdorim astrolabin të cilin Ptolemeu e kishte zbuluar. Në shekujt vijues në të janë bërë ndryshime të rëndësishme dhe përmirësime. Këtë vegël marinarët e kanë përdorur deri në shekullin e tetëmbëdhjetë. Kur Havarizmi e përktheu Ptolemeun rreth vitit 844, krijoi kuptim të ri harmonizimi të paraleleve dhe meridianeve.

Gjeografët dhe astronomët arabë duke shkuar në vizitë vendeve të pushtuara me qëllim të mësimit dhe të organizimit të perandorisë dhe administratës së saj, me admirim pranuan se toka ka formën e topit. Teologët dhe dijetarët krishterë e mohonin këtë të vërtetë shkencore. Kjo shpjegon ndikimin e madh të astronomëve arabë në renesancën dhe periudhën e saj. Qysh në vitin 860 Ahmed El-Fargani ka shkruar veprën e tij të njohur mbi astronominë, e cila do t'i paraqesë Evropës burimin themelor të shkencës në shtatë shekujt e ardhshëm. Mësuesi i Evropës në gjeografi ka qenë Idrisi, i lindur në vitin 1100, mësoi në Kordovë dhe jetoi në oborrin e mbretit të Sicilisë Rogjerit në gjysmën e shekullit dymbëdhjetë. Shkrimet e tij vërtetojnë formën e topit të tokës. Kam pasur fat ta vizitoj Semerkandin dhe ta shoh opservatorin, të cilin e ka ngritur astronomi dhe matematikani i madh Uluk beg. Kjo opservatori në Uzbekistan, ndërtimi i së cilës është përtërirë në kohën tonë, shërben si argumenti më i mirë i kulturës madhështore arabe. Ky progres shkencor, i cili sipas të gjitha gjasave ka qenë i lidhur ngushtë me përparimin teknik, për të cilin Mefer Novajt dhe Lorasier nuk kanë treguar në historitë e tyre detare, ia mundësoi arabëve superioritetin absolut në det. Ibni Halduni pohon se të krishterët nuk kanë qenë në gjendje pas kësaj të lëshojnë as dërrasën e thjeshtë në Detin Mesdhe.

Në vitin 851 ka dalë vepra e shkrimtarit të panjohur, i cili e përshkruan udhëtimin në Kinë. Thotë se ka arritur deri të Kantona, ndoshta deri te Koreja ose Japonia. Kjo ka qenë 425 vjet para rrugës zbuluese të Marko Polos. Kur ka arritur Vasko de Gama deri te Melanda në bregdetin lindor të Afrikës, pas pesëqind vjetëve më 1498, marinari arab Ahmed Maxhizi, ia ka treguar rrugën deri në Indi. Ky

marinar arab e ka shkruar studimin mbi udhëtimin detar në Oqeanin Indian, Detin e Kuq, Gjirin Persik dhe Detin Kinez, të cilën portugezët e morën si bazë në studimin e tyre të detarisë në kohën e detarit të shquar Henriut. Një halif ka qenë i pari që ka menduar për hapjen e kanalit të Suezit. Vetëm shkaqet strategjike e shtyn të heqë dorë nga ideja e madhe e tij.

Është e njohur se shkencat astronomike arritën përparimin e madh të tyre tek arabët, sa që kleriku Xherber, i cili është bërë prapë në vitin 999 i njohur si Silvestëri II, ka thënë se është takuar me djallin kur u kthye në botën krishtere, pas studimeve të tij në Universitetin Islam – në Kordovë.

Nevojat tregtare dhe matematikore kanë bërë që arabët të kryejnë revolucion të vërtetë në matematikë, sikur që bënë Fenikasit më herët. Me zbulimin e numrave arabë dhe zeros, në të cilën bazohej sistemi dekadës çoi deri te revolucioni i dytë në shkencat matematikore pas Fenikasve. Evropa ka ardhur deri te këto zbulime shkencore vetëm përmes arabëve dhe atë vetëm në shekullin e dymbëdhjetë, përkatësisht plot dyqind e pesëdhjetë vjet pas zbulimit të tyre.

Në algjebër mes vitit 835 dhe 844, Havarizmi përsëri erdhi deri te metodat e rregullit të ekuacionit të shkallës së dytë, të cilën grekët më herët e kanë njohur. Në shekullin e njëmbëdhjetë Ahmed Musa ka gjetur mënyrën gjeometrike dhe analitike të rregullimit të këtij llojit të ekuacionit. Këtë vepër të tij e ka përkthyer Xherard Kremoni në shekullin e dymbëdhjetë. Universitetet evropiane e kanë përdorur si vepër themelore e burimore vazhdimisht deri në shekullin e gjashtëmbëdhjetë.

Në vitin 1229, Hasan Marakeshi ka përpiluar tabelat e para të llogaritjes dhe tabelat e harqeve të tangentës. Matematikani dhe poeti Omer Hajjam, që ka vdekur më 1125, arriti të zgjidhë problemin e ekuacionit të shkallës së tretë në të njëjtën mënyrë, të cilën arriti Dekarti pas plot pesë shekujsh. Në këtë mënyrë Hajjami vendosi themelet e gjeometrisë analitike. Kjo vepër e rëndësishme nga algjebra është përkthyer në frëngjisht në vitin 1857.

Në gjeometri Sabit Kurra ia ka shkuar problemeve të Euklidit, dhe në gjeometri nuk ishte Koperniku nuk ishte zbulues i Sekanteve por Ebu Vefa. Farabiu ka zbuluar llogaritmet në rastin e studimit të tij të notave muzikore. Ibni Sinaja, prapë i ka kushtuar kujdes të veçantë llogaritjes së ekuacionit të pafund.

Një numër i madh i shprehjeve në kimi, si: alkaloid, alkool, alimpik, alik, sir etj., neve na e përkujton atë që arabët i dhanë Perëndimit. Përveç kësaj atyre iu takon merita e zbulimeve:

a) Mënyra e destilimit, sublimimit, kristalizimit dhe koagulizimit;

b) Prodhimet e reja siç janë putazimni, nishadra, thartësira azotike, dallimet mes thartirës dhe alkoolit etj. Nga koha e Harun Rashidit që vdiq më 808, arabët kanë prodhuar letrën, me të cilën i ofruan botës një ndër mjetet më të fuqishme për përhapjen e shkencës dhe kulturës.

Arabët kanë zënë vendin e parë në mjekësi më tepër se pesëqind vjet, prej vitit 700-1200. Ibni Razi ka shkruar enciklopedinë e njohur të mjekësisë, të cilën e ka përkthyer Faragoti me urdhrin e Sharl Dangës I mbretit të Sicilisë. Ajo vetëm në Angli në mes vitit 1458-1866, ka përjetuar më tepër se dyzet botime. Në flakën dhe jehonën e renesancës është shtypur në Vjenë më 1520 dhe në Frankfurt më 1588.

Në mesin e të arriturave të mëdha medicinale, për shkak të cilave Perëndimi edhe sot i ka borxh mjekësisë arabe është vaksinimi kundër variolës, të cilën e kanë njohur mjekët persianë, e të cilën arabët më tutje e zhvilluan dhe e përsosën. Kryenin shpimin e lëkurës, e pastaj bënin masazhe me virusin e variolës në vend të inkrustacionit të mukozës. Kështu që të parët e trasuan rrugën e vaksinimeve të ndryshme, të cilat i ka zbuluar Goneri në vitin 1797.

Në farmaci, arabët kanë njohur një numër të madh të bimëve mjekësore. Me rëndësi është të përmendet se ata përdornin penecilinën dhe kërpudhat si melhem për shërimin e plagëve të gjalla. Kështu që kanë njohur përdorimin kundër efektit në mënyrë eksperimentale. Sa i përket okulistikës, ajo është vepër origjinale e arabëve. Njohuria e gjerë e natyralistëve në lëmin e optikës iu ka ndihmuar shumë okulistëve (mjekëve të syve) arabë. Mënyrat e tyre teknike kanë mbetur në përdorim deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë.

Akademitë arabe me bibliotekat e tyre, fakultetet, planet arsimore, sistemet dhe shkallët shkencore, studentëve të huaj të tubuar në shoqatat e tyre nacionale, iu kanë dhënë sisteme shembullore të arsimit, të cilat kishin kaluar në Evropën Islame, në San Remo, në Sicili, Kordovë në Spanjë, e pastaj në Evropën e krishterë, e cila i ka imituar dhe në mënyrë të ngjashme ka themeluar universitetet e saj të mëdha në Bolonjë, Paris, Monblej, Oxford etj.

3. Kontributi i arabëve artit

Arti, gjithashtu ka përjetuar periudhën e tij të artë dhe lulëzim të madh, i cili për asgjë nuk mbeti prapa lulëzimit të shkencës. Megjithatë, u krijua tregimi naiv dhe kuptimi, i cili artin islam e kufizoi në vetëm art dekorativ, punë dore dhe zejtari. Koha është për të argumentuar se ky art kryesisht ka diçka tjetër. Ai është paraqitja mbi botën, dhe atë i përcakton qëllimet e saj, gjuhën dhe stilet.

Përkundër ndryshueshmërisë së të shprehurit në këtë art, në përputhje me secilin vend që ai është paraqitur dhe formave të caktuara specifike të çdo treve, dallimeve të dukshme mes artit irakian e maroken, për shembull, megjithatë uniteti i thellë i frymëzimit qysh në vështrimin e parë tërheq vëmendjen e shikuesit. Ai paraqet shprehjen Islame të jetës dhe atë jo në aspektin negative, i cili ndalon fotografimin e njerëzve dhe gjallesave, por në aspektin e kundërt. Kurani në këtë pikëpamje skajshmërisht është i qartë dhe dominant. Në të qëndron: "O besimtar: alkooli, lojërat e fatit, idhujt dhe falli janë veprat e djallit, largohuni atyre nëse doni të shpëtoni". Ky tekst kuranor nuk ndalon bartjen e fotografive me skulpturë ose pikturë, por ndalon marrjen për idhuj dhe shndërrimin e tyre në qenie të vërtetë me qëllim të konkurrimit Zotit dhe krijimit të Tij. Disa vende siç është Irani edhe sot e ruajnë traditën e tyre në pikturë. Gjithashtu është e njohur se në disa vende në kohën e Hulefai Rashidinëve janë krijuar vepra jashtëzakonisht të rëndësishme të pikturës dhe artit, të cilat paraqesin njeriun ose shtazën. Për këtë shkak ndalimi i pikturimit nuk mund të paraqesë veçoritë themelore të artit Islam.

Inspirimi i këtij arti bën paraqitjen e botës jo si paraqitje reale e qenieve dhe gjërave, por edhe atëherë kur artisti e trajton njeriun ose shtazën ai nuk i trajton në individualitetin e tij subjektiv, vetëm si fotografi përkatësisht kopje. Në atë mënyrë arti arab dallon me dy karakteristika kryesore: 1) Islami nuk është kundër fotografive, por kundër idoleve; 2) Islami më tepër e cakton stilin e artit sesa objektin e tij.

Pranimi i patundshëm Islam i monoteizmit kategorikisht mohon çdo ndërmjetësim mes njeriut dhe Zotit. Madje edhe vetë i Dërguari i Zotit konsiderohet njeri sikur njerëzit tjerë, të cilëve ju ka ardhur me rregulla të caktuara të sjelljes dhe të rregullimit të jetës, duke i përgatitur për ditën e gjyqit të përgjithshëm. Për këtë arsye atij nuk i duhen pikturat sipas modelit të jetës së krishtit ose jetës së të shenjtëve sikur që është rasti me botën krishtere. Përkundër asaj çdo pikturë e botës mund të shmangë besimtarin nga lutja e sinqertë dhe kuptimi i vërtetë i njëshmërisë së Zotit, duke hedhur atë në rrjetin e idhujtarisë.

Synimi për çlirimin nga fenomeni i botës materiale dhe orientimi i mendjes në njëshmërinë e pastër, kërkon nga njeriu të mos vështrojë tjetër përveç formës, e cila sajohet në mendje. Kjo në realitet është korniza matematiko-racionaliste, e cila është skajshmërisht harmonike e përputhshme dhe muzikale. Ky kuptim i ndarjes së hyjnores shpien deri te abstraksioni, i cili paraqet dallimin themelor të artit islam. Xhamia, ndërtesa e gurit, paraqet qendrën ku takohen të gjitha llojet e artit Islam. Për këtë arsye edhe konsiderohet se i tërë arti shpie në xhami e ajo shpie në lutjen (namaz). Dallimi i parë i artit Islam është funksionaliteti. Xhamia sipas konstruksionit të saj i përgjigjet funksionit të destinuar. Ajo dallon nga kisha krishtere dhe tempulli grek. Nuk shërben për strehimore të fotografive të Zotit, as dekorim të ceremonive fetare, sepse Islami ndalon edhe fotografitë edhe ceremonitë. Xhamia është sallë për adhurim dhe lutje. Për këtë arsye nuk ka formë të tempullit të caktuar për vendosjen e statujës së Zotit as formën e gjatë të kishës, por në përgjithësi anon kah gjerësia për të pasur sa më tepër vende për besimtarët të cilët radhiten pranë njëri-tjetrit në tepihun e

adhurimit. Xhamia nuk është gjë tjetër përpos vend që cakton kahen në drejtim të Mekës dhe ka minaren për thirrje në adhurim.

S'ka dyshim se xhamia, duke u nisur nga roli funksional themelor i saj, përbën pikën fillestare të artit islam, kështu që në vete përmban elemente të shumta lokale, si p.sh. xhamia iraniane është e zbukuruar me plot kube të fryra dhe me dekorime të pasura të punuara nga argjila. Xhamia turke, prapë mbërthen artin e arkitekturës bizantine në tendencën islame të adhurimit të Zotit, kurse xhamitë në Egjipt dallojnë me kube të larta dhe minare me sherefe. Mirëpo fryma e njëjtë, faktikisht në të gjitha është përfaqësuar. Ajo, në realitet qeveris me këtë ndryshueshmëri të pasur ngase njëshmëria e funksionit fetar dhe lidhja e ndërtesës me këtë funksion është tërësisht e qartë.

Dallimi i dytë i artit islam është abstraksioni. Ky dallim është përcaktuar përmes botëkuptimit islam të botës, njeriut dhe Zotit. Për këtë arsye detyra e artit në Islam nuk është bartja e të dukshmes, por tregimi i të padukshmes ose i shpjegimit të vështirë të sistemit hyjnor të kozmosit, shoqërisë dhe të ligjeve të rrepta, të cilat mbretërojnë në të gjitha këto. Gjuha më e afërt e këtij lloji të shprehurit janë ligjet matematikore të gjeometrisë, dhe rregullat muzikore të melodisë dhe ritmit.

Nisur nga ky aspekt arti i ndërtimtarisë zë vendin e parë në artin Islam, jo për atë se ai është më i afërti i lutjes duke pasur parasysh qëllimin, por pikërisht për shkak se ai sipas natyrës së tij dhe muzikalitetit nuk është drejtpërsëdrejti pikturë. Në të gjitha periudhat e lulëzimit të këtij arti, prej Emevijve në Damask deri me sundimin e osmanlinjve, madhërimi i Allahut e gjeti jehonën e vet në mermer, në tjegulla etj… me përdorimin e të gjitha elementeve funksionale për qëllime dekorative. Vijat e harqeve bëheshin gjithnjë më të komplikuara, kryhej kalimi nga melodia e thjeshtë, e trajtës së plotë të harkut drejt gjithë simfonitë me studimore, siç është harku i thyer, dhe harku i cili merr formën e majës së shigjetës së zbukuruar, rrjetën e harqeve sinonime dhe të thurura derisa të mos kalojë në lavdërimin mahnitës, të cilin na e vërteton në mënyrë simbolike xhamia Sylejmanie në Istamboll, Tullmish dhe Hamra në Granadë dhe Tulun në Kajro.

Kjo gjithashtu ka të bëjë edhe me elementet tjera të arkitekturës, p.sh., mihrabi nuk është më thjesht i mbuluar. Në xhaminë e njohur të Tumishevës janë zhvilluar vrimat e njohur spanjolle-marokene, të cilat janë përbërë nga rreshtat e plotë të anëve të dekoruara me gurë. Këtë mund të shohim gjithashtu te dekorimi i anëve të dyerve të xhamisë, qemereve, shtyllave mbi të cilat lartësohen kubet dhe qoshet. Këtu shprehet tendenca e vazhdueshme për vërtetimin e formës, hapësirës dhe dekorimit të gdhendur e të shprehur në materialin ndërtimor.

Tendenca kah muzikaliteti potencial në artin arkitektonik, përkatësisht kah muzika e zhvilluar dhe objektivizuar, në të cilën sipas fjalëve të Hegelit në artin Islam nuk mohohet ndjenja e thellë ndaj natyrës, e cila nuk shfaqet vetëm në shikimin e natyrës të paraqitur në pëlhurë siç është rasti në Evropë, por edhe ndërtesa e shpreh dhe paraqet vetvetiu. Kjo arrihet me përputhjen e ndërtimeve në ambientin që i rrethon. Arkitektët e Spanjës dhe të Marokut, posaçërisht kanë arritur për të realizuar harmoninë mes shpateve e kodrave dhe vijave të ndërtimeve, me ndjenjën e tyre delikate të rreptë dhe artistike dhe me përdorimin e blloqeve të mëdha. Në oborre gjenden basenet, kurse qëndisjet e shtojnë pamjen dhe elegancën e vijave, fontanat e ujit dallohen me vijat elegante të shtyllave dhe me harmoninë e harqeve të qemerëve.

***

Dallimi i tretë i artit Islam është uniteti mes elementit fetar dhe të kësaj bote, adekuat ideologjisë, e cila e ka frymëzuar. Prandaj, janë gjetur forma të ndryshme të marrëdhënieve me botën si forma të shprehjes përmes të cilave pasqyrohet përkushtimi i plotë i principeve islame në fushën e artit. Arti i Emevive, në Damask për shembull, shpreh idenë e superioritetit botëror të perandorisë arabe. Mbi shprehjen e kësaj perandorie për të vërtetën hyjnore të manifestuar në këtë botë, më së miri dëshmon mozaiku madhështor i kubës as-sahra në Kuds (Jerusalem), e cila është ndërtuar gjatë kohës së halifit Malik bin Mervan në vitini 691 e.r. Ky halif i Emevive, triumfues dhe trashëgues i dy perandorive e qet në shesh se tërë bota ka hyrë në "shtëpinë

Islame", e cila sistemin sundues e trupëzon në personalitetin e vet. Kjo tërësisht manifestohet përmes paraqitjes së drunjve, frutave, lulishteve dhe fushave të gjelbra, të cilat posaçërisht takohen bashkë me të gjitha simbolet tjera në Iran.

Në Bagdad, në periudhën abasite dialogu i paraqitur më tepër shpreh ligjet e botës dhe ritmet e tyre më të fuqishëm se vet simbolet. Kjo dëshirë realizohet me tregim. Madje edhe atëherë kur paraqiten personalitetet në pikturë, teshat ose lëvizjet e këngëtareve, nuk pretendohet me atë të krijohet qëndrim i ngjashëm me sendet dhe me dukuritë reale, por pretendohet në njësimin e shprehur etnik dhe dekorativ, i cili lëviz para të gjithë kufijve kohor. Përkundër tërë kësaj njëra ndër dallimet themelore të pikturës arabe është pajisja e veprave shkencore me piktura (fotografi) siç dëshmon vepra: "Barishtet dhe bimët", botuar në vitin 1119, në Irak. Rasti i njëjtë është me figurat e shtazëve në veprën: "Teknika e veterinarisë", e botuar në vitin 1210, në Bagdad. Gjithashtu këtë e vërteton dhe studimi mbi: "Yjet e palëvizshëm", i Ibni Sufisë nga viti 1224, i cili i gruponte yjet sipas vijave personale dhe i lidhte me interesimin dhe zbulimin shkencor të rrjedhës së përditshme të jetës. Me një fjalë, ky është art, i cili është karakteristikë për shoqërinë tregtare në shekullin e tetë, që varej nga përparimi i shkencave, të cilat e përcaktonin përparimin e ekonomisë dhe në mënyrë tendencioze e lidhte me jetën e përditshme të njeriut.

Ky art i zhvilluar në të gjithë lëmenjtë e jetës do të mbetet gjithnjë besnik burimit të tij themelor dhe frymëzimit të përhershëm. Ai paraqitet në format e veta më të pastra në dekorimet e ngjyrosura të Kur'anit. Ky burim i frymëzimit paraqitet në elementet e vazhdueshme teknike, të cilat rregullisht e përcjellin artin islam.

Nëse është e vërtetë se ndikimi i artit bizantin dhe sasanadik kanë lënë vulat e tyre në fillimet e para të artit islam, atëherë është gjithashtu aq e vërtetë se ai shumë shpejt është pavarësuar dhe ka gjetur burimin dhe origjinalitetin personal.

Dallimet themelore të këtij arti janë të perfektuara me mënyrën e nënshtrimit të elementeve dekorative kërkesave të skeleteve të arkitekturës, të cilat vendosin për renditjen e tyre sipas vijave, sipërfaqeve,

ose reaksionit të elementeve specifike për arkitekturë… Nga këtu në realitet edhe del domosdoshmëria e ekzistimit të dekorimit për të qenë zbukurimi në përputhje me vijat themelore të ndërtimit, ku në mënyrë fenomenale bëhet shmangia e zbrazëtive, të cilat pakëz mund ta rrënojnë përputhshmërinë dhe ritmin.

Momenti i dytë i rëndësishëm, i cili del nga preokupimi gjeometrik i artit islam është caktimi i formës së begatshme duke mos marrë parasysh se a qëndron apo jo pas drunjve të paraqitura dhe figurave të bimëve të degëzuara. Çka mund të thotë, se preferon mënyrën e introspeksionit të të shprehurit ose unitetit gjeometrik, i cili në këtë mënyrë duket përputhshmërisht: lidhur për dekorimin bimor. Në atë mënyrë fuqia e formësimit abstrakt u bë modeli më i bukur i këtij arti, plotësisht i vërejtur për secilin që përcjell zhvillimin e artit modern dhe format e tij të trajtimit dhe shprehjes. Përbërja teknike e elementeve në artin islam në asnjë mënyrë nuk bën të na mashtrojë në rrugën e shikimit të vlerave reale të tij. Mbështetja vetëm në anën fenomenal të formave tregtare, siç e bëjnë këtë shumëkush, paraqet gabimin e pafalshëm, i cili shpie te devijimi dhe bindja se kemi kontakt të vetëm me tipin dekorativ të artit. Vetëm me numërimin e thjeshtë të temave themelore dekorative, do të na bindë se para së gjithash ka të bëjë me shprehjen e të menduarit ndaj botës dhe kuptimin e saj filozofik. Me lënien pas dore të atij elementi, neve na shpie deri te moskuptimi i lulëzimit të fuqishëm të këtij arti. Në fillim të ekspozesë kam përmendur se arti islam nuk pretendon në bartjen e thjeshtë të fenomeneve të botës, por dëshiron të vërtetojë se natyra e ligjeve matematikore dhe muzikore sundojnë me to…

Dekorimi i bimëve, i cili u paraqit në shekujt e parë të artit islam, mori për dekor kaktusin nga arti grek, fletët e kalaveshit të rrushit, trëndafilat, bredhat, këto bimë ndryshojnë dhe kalojnë në forma të simboleve për përdorimin e ndryshëm estetik. Rast i njëjtë është edhe me palët e fletëve të hurmës. Të gjitha dekorimet i nënshtrohen ritmit të përbashkët ose të gjithmbarshëm, pastaj përdridhen dhe thjeshtësohen ngjashëm me vibracionin e degëve, të cilat i lidhin pjesët dekorative me tërësinë e përgjithshme arkitektonike dhe me funksionin e saj që

prodhon dinamikë dhe lëvizje. Gdhendja arabe është shprehje e drejtë për perceptim të tillë. E. Kuhnel, e definon atë në mënyrë si vijon: "Ajo është formë personale dhe e pastër islame. Shërben për ndryshimin e dekorimeve të bimëve të përbëra nga fletët e ndara, të thurura me lule të cilat janë të lëvizshme në mënyrë ritmike. Gdhendja arabe njëkohësisht shpreh ndjenjën muzikore ndaj natyrës dhe ndjenjën racionale ndaj gjeometrisë.

Ajo është si në abstraksion ashtu në pozicion. Të dy ndjenjat janë painte themelorë të artit islam dhe perceptimit të tij filozofik të sistemit të ndërlikuar kozmik. Cilësitë më të bukura të këtij arti janë krijimi i ekuilibrit mes dekorimit të begatshëm bimor Andulizian dhe varfërisë së vijave të pastër të gjera të artit Muvehhid në kohën e halifit Abdul-Mu'min, kah gjysma e shekullit XII. Arti Islam i kësaj periudhe arriti kulmin e bukurisë estetike dhe vlerës së tij.

Shkrimi arab ofron edhe mundësinë tjetër, bashkimin e tendencave të ndryshme dekorative. Shkrimi kufik, i cili dallon me thjeshtësinë gjeometrike me vizatimet e veta dhe tendencën e drejtë të vijave themelore, jep numër më të madh të përmbajtjeve dekorative, lejon lidhjen e njësive gjeometrike me të bimëve, qoftë me njësimin me shkronja ose shpërndarjen krahas tyre, ose me zbukurimin e vijave me shtojcat e bimëve. Këtu misioni i të dërguarit të Zotit dhe fjala e shkruar e Tij, bëhen dekorimi i drejtpërdrejtë, i cili na e përkujton se është gabim fatal të flitet mbi këtë art si shprehje të vetme të dekorimit duke mos llogaritur mbi qëllimin e tij origjinal dhe frymën burimore.

Nëse kalojmë në artin e praktikuar, dekorimin e mobileve, bakrit, dhe pëlhurave, atëherë këtë dekorim të posaçëm më tepër i përgjigjet që ta lidhim me sendet e thjeshta josakramentale dhe me qëllimin e skajshëm të zbukurimit. Aty shprehet përputhshmëria e plotë me ndërtesën, bllokun e saj dhe mjedisin. Stili dekorativ i gdhendjes së karrigeve paraqet dekorimin e mindereve. Gjithashtu këtë e vërtetojnë edhe skalitja e pjatave të bakrit dhe pëlhurat, të cilat përmbajnë vizatime të ngjyrosura në fletët e Kur'anit dhe në mihrabe. Në këtë mënyrë gjithnjë e më tepër vërtetohet ajo që kemi thënë më parë se ky art shpie në

xhami, e ajo në lutje (namaz). Është shumë me rëndësi të përmendet se kontributi i artit islam artit evropian nuk mund kurrsesi të kufizohet vetëm në ndikimin e tij në trajtë dhe formë. Nëse mjaftojmë vetëm me dy shembuj e ata janë, ndikimi i artit islam në artin romak dhe ndikimin e tij në pikturën bashkëkohore atëherë me siguri do të gabonim, nëse do të mjaftonim vetëm me numërimin e trajtave dhe formave të marra prej tij. Aty është për shembull druri i jetës, si model klasik, në kurorën e shtyllave të manastirit të Mousë, skalitjet në formë të degëve me fletë, në San Remo në Tuluz, skajet e shkrimit të dyshimtë kufik në kornizën e kishës në Notrdam, ose modeli i dekorimit në miniaturë i kishës se Klastenbergut në Austri dhe vizatimi i pikturave, të cilat i zbukurojnë kurorat e shtyllave të kishave romake, të cilat bartin format e pastra të marra nga pëlhurat e lindjes. Megjithatë, tërë kjo nuk paraqet asgjë tjetër pos anën e jashtme të gjërave. Ajo që është e saktë dhe e vërtetë për njësit dekorative, është e saktë dhe e vërtetë edhe për arkitekturën. Mirëpo, ekziston diç që është larg më thellë dhe më origjinale se ajo, ngase derivacionet shpejt përfundojnë, për shkak se disa anë të mungesave të botës janë tejet të dukshme në një nga periudhat e zhvillimit të kulturave dhe civilizimeve.

Këtë e ka konkluduar edhe Emil Mal, qartë në krahasim me periudhën romake duke thënë: "Pjesa e vjetër e historisë klasike reduktohet në një pjesë tërësisht të vogël e të varfër të dekorimit të shtazëve dhe llojeve të egërsirave, të cilat janë të dashura te artistët e shekullit dymbëdhjetë. Lindja iu ka ofruar gati të gjitha... Fundi i botës së vjetër dallon me fitoren e Lindjes. Përsëri u ngjallën arti dekorativ i keltëve, asirianëve, fenikasve dhe persianëve. Këtu mbisundon imagjinata dhe bëhej rekonstruksioni i botës, e cila duhej të jetonte në përputhje me dëshirën e saj. Ky prodhim i ri paralel me natyrën është i madh. Figurat e shtazëve, bartin në vete të gjitha karakteristikat janë prodhim i pastër i Lindjes. Ai ka formuluar qeniet e gjalla në shpirtrat e bukur arabë, që është e mundshme të formulohet dhe orientohet në përputhje me dëshirat tona. Ky art lidh kurorën e shtyllave të shekullit dymbëdhjetë me dekorimin fenomenal arab. Lindja formoi dekoratorët e asaj kohe te ne... Arti lindor është në përputhje të plotë me fillimin e kohës së mesme, kur ëndrrat kanë qenë ende të fuqishme, dhe kur njeriu ende nuk ishte bashkuar me natyrën. Artisti romak nuk ka hasur në kurrfarë pengesash për të përvetësuar këtë lloj arti dhe njëkohësisht për të qenë origjinal në qëndrimet e veta.

Ideja e "prodhimit paralel me natyrën", e cila shërben si frymëzim i çdo artisti bashkëkohor në Evropë, tregon tërheqjen dhe ndikimin të cilin arti islam e ka sot në pikturën tonë. Shembull të madh në këtë pikëpamje jep Matjusi. Ai menjëherë pas udhëtimit në Marok dhe vizitës së ekspozitës së artit islam në Minhen në vitin 1911-1912 ka shkruar: "Gjithmonë frymëzimi më ka ardhur nga Lindja. Në Minhen kam gjetur vërtetimin e ri të hulumtimeve të mia. Figurat e vogla persiane më kanë shpjeguar fuqinë e ndjenjave të mia. Shtojcat e këtij arti tregojnë për hapësirën më të madhe dhe hapësirën e formës së vërtetë. Ajo më ka mundësuar për t'u liruar nga piktura intraspektore. Njeriu shumë më shpejt përparon kur tradita ia vërteton mendimet e tij. Kjo i ndihmon për ta kapërcyer greminën".

Matjusi nuk ka zbuluar në artin islam vetëm stilet teknike, mënyrën e krijimit të hapësirës, pa heq dorë prej saj principin e transmisionit dekorativ, ndarjen e elementeve dekorative në shumë vija të bashkangjitura të luleve dhe trëndafilave, tendenca ndaj formave gjeometrike dhe fasadës, e cila dallon me thurjen e dekorimeve të bimëve etj., por çka është më e rëndësishmja prej të gjithave siç shprehet Emil Mal, është "prodhimi" paralel me natyrën", i cili shpreh natyrën e thellësisë së artit dhe funksionet e tij, të cilat e tejkalojnë bartjen e fenomeneve ose thjesht ekspozimin e kopjimit apo imitimit.

Kjo përvojë artistike e artit islam ka arritur kulminacionin e vet para gjysmë shekullit në pikturën abstrakte. Piktori Paul Keli, i cili nën ndikimin e madh të artit islam, mendon se ka luftuar gjatë në rrugën për ta bërë "të padukshmen të dukshme". Ai nuk shpreh fenomene të realitetit, por ritmin e tij të vërtetë dhe ligjshmërinë. Kemi parë se si disa artistë të cilët madje as që i takojnë Islamit siç ka qenë rasti me skulptorët romakë në shekullin e dymbëdhjetë madje me ata të cilët nuk interesohen për fe, në përgjithësi, kanë zbuluar në artin

Islam, fuqishëm të lidhur me fe, jo vetëm shumëllojshmërinë e stileve të artit, por edhe ekzistimin e "qenësisë humane".

4. Kontributi i arabëve shkencave humane

Kontributi i kulturës arabe shkencave natyrore dhe artit, kërkon që të shikojmë edhe kontributin e tyre në fushën e shkencave humane. Idetë, të cilat u zhvilluan në qendrat tregtare arabe i tejkaluan kornizat feudale dhe u bënë paraprijëse të renesancës dhe të shekullit tetëmbëdhjetë në Francë.

Sa i përket studimit të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, pa dyshim personalitetin më të shquar dhe më progresiv paraqet Ibni Halduni (1332-1406), luftëtar, jurist dhe filozof, i cili me gjenialitetin universal të tij është i barabartë me gjigantët e renesancës. Ibni Halduni ka qenë pronar i madh, diplomat dhe epror ushtarak. Ka qenë dëshmitar i ngjarjeve të rëndësishme politike, në të cilat shpesh edhe vetë ka marrë pjesë në cilësinë e udhëheqësit dhe njeriut me përgjegjësi. Përvoja e tij zbulohet qartë atëherë, kur bënë analizën e mekanizmave të brendshëm të shoqërisë dhe zhvillimit të saj. Ai e admiron luftëtarin më të ashpër Timerlenkun, i cili i lejoi që me shokët e tij ta lëshojë Damaskun në vitin 1400.

Kur njeriu i Perëndimit lexon "Mukaddimen" e Ibni Haldunit, ai para vete sheh qysh në shekullin katërmbëdhjetë Dekartin e Monteskeun, që janë parakaluar plot tre shekuj. E kur imponueshëm shtron problemet shkencore vijuese:

- Si ka filluar shteti
- Çka është baza e dinastive sunduese
- Si krijohen dinastitë sunduese?

Ai ngrihet në nivel të shikimit kuptimor dhe vendosmërisë, të cilën Makijaveli në shekullin e gjashtëmbëdhjetë nuk ka qenë në gjendje ta mposhtë në veprën e tij të njohur "Princi", pastaj kur shtron ligje shkencore të historisë dhe sociologjisë na e përkujton në "Frymën e ligjit" të Monteskeut. Ai për shembull parashtron definicionin e historisë kritike, atëherë kur Evropa ka njohur vetëm regjistruesit e ngjarje-

ve. Ibni Halduni për historinë pohon: "Shkenca e historisë është shumë e rëndësishme, e dobishme dhe e ndershme. Ajo kërkon njohjen e shkencave të shumënumërta dhe të shumëllojshme, largpamësi dhe pavarësi, të cilat atij që i posedon i zbulojnë, të vërtetën dhe e mbrojnë prej gabimeve dhe dështimeve. Mandej vazhdon: "Shkenca e historisë sipas esencës së saj është shikim, studim dhe argumentim të qenieve. Ajo është me principe rigoroze, shkencë, e cila mëson se si kanë ndodhur ngjarjet dhe analizon shkaqet e tyre. Për atë shkak përbën themelin e çdo urtësie dhe aq është e rëndësishme sa që duhet të numërohet ndër shkencat e saj".

Dallimi kryesor "Mukaddimes" na detyron të kujtojmë veprën e Dekartit "Disertacioni mbi metodën" ngase edhe në të vjen principi i sintezës pas kryerjes së analizës historike. Në kohën kur historia në Evropë ka qenë thjesht me karakter tregimor dhe deskriptiv, Ibni Halduni – krijoi historinë, e cila zbulon shkaqet e ngjarjeve. Ai në mënyrë kategorike vërteton: "Unë i marrë shkaqet e përgjithshme për studimin e fakteve një nga një. Vetëm atëherë mund ta kuptojë historinë e shoqërisë njerëzore në kuptimin e drejtë. Unë hulumtoj shkaqet dhe burimet e ndodhive politike" Ai ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se është në rrugën e formimit të shkencës së re. Këtë e vërtetojnë edhe fjalët e tij: "Çështjet të cilat do t'i studiojmë këtu paraqesin shkencë të re, e cila do të dallojë me pikëpamje origjinale dhe dobinë e madhe. Atë e kemi zbuluar falë hulumtimeve tona të gjata dhe të të menduarit të thellë. Studimi i asaj që është relative për një kulturë dhe fillim të qyteteve, kam gjurmuar për atë që çdo shoqëri njerëzore jep në kufijtë e kushteve specifike. Në këtë mënyrë i kam kuptuar shkaqet e ngjarjeve dhe burimin e tyre".

Nëse e krahasojmë metodën historike të Ibni Haldunit me tregimtarinë naive të historisë, ose nëse e krahasojmë Ibni Haldunin me njërin nga bashkëkohësit e tij evropian Afr. Obarin, do të shohim se Ibni Halduni i ka tejkaluar historianët e kohës së tij për më tepër se katër shekuj. Historia, sipas mendimit të tij, nuk është rrëfim i ngjarjeve dhe i sjelljeve të princërve, por analizë e kulturave dhe civilizimeve. Ai këtë e vërteton duke cituar: "Historia është shkencë e pavarur,

objekt i saj është studimi i civilizimit njerëzor dhe marrëdhëniet shoqërore të saj. Objekti real i historisë është të kuptuarit e pozitës shoqërore të njeriut, do të thotë, kulturës dhe nga ajo fenomenet e lidhura natyrisht me qenien e tij, mendoj jetën fillestare, orientimin e sjelljeve të tij, çiftet, familjet, fiset dhe dallimet tjera. Ajo krejtësisht tregon se si një popull i tejkalon tjerët.

Nga ajo del lindja e perandorive, dinastive sunduese, dallimet e thirrjeve dhe profesioneve me të cilat njerëzit merren si zeje e pëlqyeshme dhe profesionet, të cilat merren me shkencë dhe art. Dhe në fund historia është shkencë, e cila i studion ndryshimet që rezultojnë nga natyra e gjërave dhe veçoritë e shoqërisë".

Ibni Haldun është themeluesi i vërtet i mendimit shkencor të historisë dhe sociologjisë. Ai ka qenë i pari që ka zbuluar ligjshmëritë dhe parimet e tyre themelore dhe atë:

1. Se fenomeni shoqëror dhe historia e tij u nënshtrohen ligjeve të caktuara të domosdoshme. Ai do të jetë i pari që sistematikisht në histori përdori parimin e kauzalitetit: "Nëse mendojmë për botën... do të shohim në të rregull të plotë, dhe sistem të përputhshëm raporteve mes shkakut dhe pasojës". Kur flet për operacionet ushtarake dhe analizon shkaqet e fitores thotë: "Fitorja në luftë dhe epërsia e fuqisë janë fati dhe rasti". Atë e shpjegon me këtë se epërsia e forcës në luftë, në shumicën e rasteve është rezultat i shkaqeve të padukshme kurse ndodhia e diçkaje në mënyrë të fshehtë do të thotë fati. Definicionin e fatit e gjejmë tek ai të dhënë para Spinozës plot tre shekuj, dhe idenë e shkaqeve historike, të cilën e ka formuluar Montesku pas katër shekujve, Ibni Halduni thotë: "Kur vjen deri te shkatërrimi i ndonjë perandorie në një luftë, kjo nuk do të thotë asgjë tjetër përveç se ekzistojnë shkaqet e mëdha që lejojnë që ajo të rrënohet gjatë një disfate. Shtojmë se ideja e Ibni Haldunit, na kujton idenë e Marksit dhe Engelsit të rastit, të cilët pohojnë se rastësia është "Forma e ekzistencës së domosdoshmërisë".
2. Për domosdoshmërinë historike të Ibni Haldunit nuk ekziston natyra e determinizmit mekanik përkatësisht fatalizmit. Përkundrazi

ai zbulon kuptimin dialektik të fenomeneve, ngase para së gjithash ai ka parasysh raportet mes fenomeneve historike, shkaqet e tyre dhe pasojat. Ai nuk shikon në botë si në një grumbull gjëra të rastit, por shikon në lidhshmërinë në të cilën fenomenet janë kushte ndaj njëra-tjetrës. Kjo tendencë shpjegon natyrën enciklopedike "Mukaddime", e cila përfshin: astronominë, gjeografinë e botës, politikën, ekonominë, sistematizimin racional të shkencës, pedagogjinë dhe stilistikën. Mund të vazhdohet dhe të shtohet: kiminë, algjebrën, bujqësinë, medicinën, teknikën, urbanizmin, estetikën, teologjinë, shkathtësitë ushtarake etj. Kjo shumëllojshmëri është e lidhur logjikisht në bazë të kuptuarit të sintezës historike, e cila ka për qëllim të vijë deri te shpjegimet politike, ekonomike dhe sociale. Ja, edhe teksti që vërteton kujdesin e Ibni Haldunit për lidhshmërinë e fenomeneve, të cilat historianët një kohë të gjatë i kanë ndarë: "Shumë gjëra janë të lidhura mes vete me marrëdhënie të forta siç është shteti dhe numri i banorëve, madhësia e kryeqytetit, niveli dhe kënaqësia e banorëve. Këto lidhje janë ekzistuese, ngase mbretëria e perandoria janë në lidhje të ngjashme si kombi dhe civilizimi.

Tërë ajo që është e lidhur me shtetin, banorët, dhe qytetet i nënshtrohet fuqisë së saj. Në fe dhe në të drejtën islame duhet shikuar në bazë të asaj, se objekti i tyre është studimi i ekzistimit të kombit dhe shtetit".

3. Ibni Haldun e vëren shumëllojshmërinë e periudhave historike, fatin e shoqërive dhe ligjet e zhvillimit të tyre. Ai nuk i ka studiuar vetëm anët e një civilizimi, por i ka hulumtuar marrëdhëniet mes civilizimeve, ka analizuar lëvizjen e pandërprerë të tyre dhe ligjet e ndryshimeve. Kjo i ka mundësuar për të krijuar teorinë mbi zhvillimin e shtetit, shkaqet e lindjes së tij, të zhvillimit, dhe të humbjes. Ai ndriçon rolin shkencor të shkencës së historisë, se ajo është dituri e cila mundëson parashikimin dhe aksionin: "Nuk kam lënë asgjë nga gjeneratat e hershme të njerëzve dhe shteteve ose aktualitetet e popujve, shkaqet e sjelljeve dhe të fuqisë e shekujve të kaluar dhe tërë asaj që është paraqitur në civilizimin e shteteve,

kombeve, situatave të ndryshme, të beduinëve dhe banorëve të qyteteve, realitetit dhe të pritshmes, e që nuk i kam përfshirë dhe shpjeguar shkaqet dhe pasojat. Kështu që libri paraqet njëshmëri sipas asaj që ka përfshirë nga shkencat dhe artet... Te punimi i këtij libri dhe sistematizimin e tij jam shërbyer me metodën e çuditshme, kam zgjedhur drejtim të çuditshëm, metodën e re dhe stilin duke shpjeguar gjendjen e kulturave dhe civilizimeve dhe tërë asaj që është paraqitur në civilizimin e shteteve, kombeve, qyteteve, fuqisë dhe rënies, shumësisë dhe mangësisë, të shkencës dhe zejeve, fitimit dhe humbjes, ndryshimit të situatave, të beduinit dhe banorëve të qyteteve, e që nuk kam përfshirë dhe shpjeguar shkaqet dhe pasojat. Për përgatitjen e këtij libri dhe sistematizimin e tij jam shërbyer me një metodë të çuditshme, kam zgjedhur drejtim të çuditshëm, metodë të re dhe stil duke shpjeguar gjendjen e kulturave dhe civilizimeve dhe çdo gjëje që është paraqitur në shoqërinë njerëzore, duke filluar nga dukuritë personale, analiza e qenieve dhe shkaqet e tyre, duke kuptuar se si banorët e shteteve kanë hyrë në dyert e tyre. Në këtë mënyrë mund të ndahet nga imitimi, të shikohet gjendja para vete, koha dhe gjeneratat pas vete".

4. Lirisht mund të thuhet se Ibni Halduni është njëri nga paralajmëruesit e historisë së materializmit. Në studimet e tij të dialektikës së brendshme të zhvillimit të shoqërisë ai i jep rëndësi të madhe ndarjes së punës. Ai ndan popujt dhe format shoqërore, duke pasur parasysh mënyrën e prodhimit ekonomik.

Në realitet ai bën burimin e parë të principit të materializmit historik: "Ndryshimet, të cilat njeriu i vëren në zakonet dhe ritualet e popujve të ndryshëm varen nga mënyra në të cilën secili prej tyre arrin te ushqimi". Pastaj e zgjeron këtë parim për t'i përfshirë moralin dhe llojet tjera të mbindërtimit: "Personaliteti i njeriut varet nga edukimi dhe tradita e jo nga natyra dhe klima". Ai bën krahasime mes shoqërive, të cilat ndryshojnë për nga feja, raca, koha dhe shteti, por të cilat janë të ngjashme për nga prodhimi që lind të të gjithë ata përbërje dhe

zhvillim të ngjashëm. Gjykuar në përgjithësi duket se në analizën e tij" Beduirizmi (fshatarësia dhe "qytetaria" ka treguar kundërshtinë klasore ndërmjet feudalëve dhe tregtarëve, gjegjësisht borgjezisë së qytetit.

Në bazë të këtyre parimeve, në fushën e ekonomisë Ibni Halduni ka ardhur deri te teoria e vlerave, e cila bazohet në punë, shumë më herët sesa që kanë arritur ekonomistët evropianë të shekullit tetëmbëdhjetë. Ai mendon se ari e argjendi nuk janë burim i pasurisë, por mjete për ndërrim: "Metalet e çmueshme nuk janë asgjë tjetër përveç mjete me ndihmën e të cilave njeriu vjen deri te ajo që i nevojitet, ato krijojnë bollëk dhe mungesa".

Rezultatet etike dhe politike të materializmit historik të Ibni Haldunit tepër janë të rëndësishme. Ai nuk mundohet për të vendosur barabarësi mes njerëzve në baza metafizike. Edhe më herët kemi parë se si ai pohon se njerëzit nuk dallojnë për nga natyra dhe klima, por edukimi dhe jeta shoqërore shpien deri te dallimet mes tyre.

Duke u nisur nga ky qëndrim ai formulon parim të rëndësishëm: "Askush nuk ka të drejtë ta nënshtrojë tjetrin".

Dhe në fund racionalizmi i thellë, i cili ka frymëzuar kuptimin e Ibni Haldunit dhe i ka mundësuar ta perceptojë punën si burim të jetës shoqërore, ndjenja e lirisë, refuzimi i nënshtrimit, shikuar nga aspekti politik, e ka çuar deri te hedhja e ideve e të drejtës hyjnore" e cila ka mbretëruar në Evropë deri në shekullin njëzet. Vendosja e halifit, sipas mendimit të tij, është "marrëveshje" e heshtur, e cila na përkujton në "Marrëveshjen shoqërore" të Rusos. Ai në Mukadime thotë: "Imameti nuk është princip fetar, por pozitë e cila është krijuar me qëllim të interesit të përgjithshëm dhe është bërë nën kontrollin e popullit".

Shumë lehtë mund të vërehet se Ibni Halduni ka edhe kundërshti, të cilat janë specifike për kohën dhe personalitetin e tij. Njeriu, i cili ka kuptuar shumicën e synimeve progresive historike të kohës së tij, edhe vetë ka qenë pronar i madh dhe nuk ka mundur të ngrihet mbi kërkesat e klasës së vet. Ndërkaq, ajo që na ka mbetur, ajo është vepra e tij, e cila paraqet kontribut të madh në formimin e diturive humaniste, të cilat dallojnë me racionalizëm çka e bëjnë paraprijës të Dekartit

dhe Monteskies dhe tregon në historinë dhe sociologjinë shkencore. Për këtë shkak nuk mund të mos e vërtetojmë mendimin e Hitit, të cilin e shprehu në veprën e tij të njohur "Shqyrtimi i historisë arabe", ku pohon: "Ibni Halduni ka qenë më i madhi filozof dhe historian që e ka dhënë Islami dhe njëri ndër mendimtarët gjigantë të të gjitha kohërave".

Kjo kulturë e madhe nuk mohon që myslimani i arsimuar mund të gjejë thesar të madh shkencor te Dekarti apo Hegeli, te Rikardi ose Sharl Furija, njësoj sikur edhe njeriu i arsimuar i Evropës nuk mund të mohojë se nuk gjen thesar të madh shkencor te Ibni Sinaja, Ibni Rushdi, Ibni Halduni etj.

Me qëllim kemi shkuar kah ajo, për ta vërtetuar të tashmen revolucionare dhe trashëgiminë e madhe kulturore, për të përkujtuar me këtë kundërshtimin e perceptimeve kolonialiste, të cilat kanë mohuar dhe falsifikuar gjatë shumë viteve burimin themelore të kulturës arabe, madhështinë dhe rëndësinë e saj.

Mirëpo, kjo e kaluar fiton kuptimin e vërtetë të saj vetëm me atë që po zbulohet dhe që po përgatitet lindje e re e kulturës arabe, e cila ka filluar të formohet me fillimin e shekullit njëzet dhe të cilës pavarësia i siguron lulëzim të ri dhe renesancë të re.

Përktheu:
Hajrullah Hoxha

Marrë nga: Takvimi 1975, Sarajevë

P.S.
Shënim për autorin: Rozhe Garodi është mendimtar i shquar francez, i cili është i njohur ndër qarqet intelektuale botërore. Ai ka botuar më tepër se njëzet vepra nga lëmi të ndryshme: të historisë, filozofisë, sociologjisë, psikologjisë, artit, religjionit etj. Qysh nga mesi i shekullit të kaluar, ai është marrë me hulumtimin dhe studimin e historisë kulturës e trashëgimisë Islame dhe ka kaluar në fenë islame. Teksti i lartpërmendur përbëhet nga dy ligjërata, të cilat i ka mbajtur më 1969 në Kajro dhe janë botuar në gazetën e njohur "El-Ahram". Ato janë përkthyer nga Ahmed Smajloviq dhe botuar në Takvimin e vitit 1975 në Sarajevë, nga i cili janë përkthyer në gjuhën shqipe. (Përkthyesi).

Rozhe Garod

THE CONTRIBUTION OF ISLAMIC CULTURE TO CIVILIZATION

(Summary)

In one of the pages of the "White Stone" (which was written by Anatole France) a historian asks madam Dovazien: "Which was the most unfortunate day in the history of France?" She did not reply as she did not know the answer. Then, he told her. "It was 732, the year in which the battle of Poitiers took place, the year when Arab culture withdrew in front of French barbarism."

These words make me recall an incident, which occurred in Tunis in 1945 (as I was giving a lecture on Ibn Haldun). On that occasion, a French general, recommended that I be expelled from Tunis under the charges that I was spreading propaganda against France. This event was very significant due to the fact that the mere mentioning of colonized peoples, their culture and their past, was viewed as a threat by the colonial powers.

روجه غارودي

مساهمة الثقافة الاسلامية في الحضارة العالمية

(خلاصة البحث)

في أحدى صفحات الكتاب المشهور لآناتوله فراسيس بعنوان "في الحجر الابيض" سأل أحد المورخين السيدة دوفازين: "هل تعلمين ما هو أسوأ يوم في تاريخ فرنسا؟ هي لم تعرف الاجابة و لم تعرف أي يوم هو. عندئذ تولى الاجابة بفسه و قال: أسوأ يوم في تاريخ فرنسا كان في السنة 732، السنة التي وقعت معركة بواتية العام الذي اضطرت فيه الثقافة العربية أن تنسحب امام البربرية الفرنسية".

هذه الكلمات هي التي تذكرنى بما قلته في تونس سنة 1945 عندما القيت هناك محاضرة عن ابن خلدون. و بعد المحاضرة طالب منى الجنرال الفرنسى المقيم أن اغادر تونس متهما أياى بانني أقوم بنشر الدعاية ضد فرنسا. و كان لهذا الحث صدى كبير في نفسي لان مجرد ذكر الشعوب المستعمرَة بما ضيهم و ثقافتهم كان يعتبر خطرا للشعوب المستعمِرة.

SEKTE

Nexhat Ibrahimi

KADIJANISTËT DHE AHMEDISTËT [1]

Në fillim të shekullit XIX, si përgjigje kundrejt dominimit të fuqive kolonialiste në vendet myslimane, u paraqitën një varg lëvizjesh 'mehdiste', sikur në Afrikën Perëndimore, në Sudan, modernizmi i Sejjid Amir Aliut në Indi etj. Megjithëkëtë, këto lëvizje mehdiste nuk sollën paraqitjen e sekteve.[2] Disa nga këto lëvizje kishin synime të shpëtimit të popullit dhe vendit të tyre, kurse disa lëvizje kishin synime të kundërta: shërbimi kolonialistëve për leverdi personale apo për leverdi të grupit të ngushtë.[3] Lëvizjet me karakteristika tipike sektesh u paraqitën me babizmin dhe behaizmin në Iran dhe sekti sinkretist, kadianizmi- ahmedizmi, i cili u shfaq në Indi.[4] Analistët pohojnë se kjo lëvizje është sekti i fundit i madh mysliman, i shfaqur në hapësirat e nënkontinentit indus, në kohën e shpartallimit të pushtetit mysliman dhe ardhjes së okupimit kolonial britanik.

[1] Shkëputje nga një studim më i gjatë. N.I.
[2] S. H. Nasr, Srce islama, op. cit., fq. 111.
[3] Kasim Dobrača, Kadijanizam i Ahmedizam, Leiçester, Angli, 1994/1415 h., fq. 9.
[4] K. Dobrača, op. cit., fq. 9-10.
Ebul A'la El-Mevdudi, Kadiyanilik Nedir?, Istanbul, 1975.

Formimi dhe prejardhja e sektit ahmedist

Ky sekt emrin ia ka borxh Mirza Gulam Ahmedit, për ç'arsye edhe u quajt *ahmedizëm* (el-ahmedijjeh). Mirza Gulam Ahmedi (1839-1908) u lind në qytezën Kadijan në Penxhab, rreth 70 milja larg Lahores.[5] Është karakteristike se derisa babizmi dhe behaizmi kishin si burim shi'izmin, kadijanizmi dhe ahmedizmi, sipas mendimit të S. H. Nasrit, kishte si burim sunizmin[6], kurse për vendlindje Indinë, vend me shumicë budiste dhe brahmaniste, kurse me ndikim islam dhe hinduist.[7] Husein Gjozo, teolog i madh boshnjak i shekullit XX, duke analizuar zhvillimet e tefsirit në shekullin XIX, pohon se lëvizja e Ahmed Kanit në Indi ishte properëndimore dhe në një mënyrë ishte hyrje, parapërgatitje për paraqitjen e kadijanizmit - ahmedizmit, për në shërbimin e plotë të Perëndimit.[8] M. Ikballi, njohës i shkëlqyeshëm i rrethanave politike dhe fetare në këtë nënqiell, "shkroi disa artikuj kundër kadijanistëve, shpjegoi në të gënjeshtrat dhe lajthitjet e tyre"[9], kurse me një rast tjetër këtë sekt e përkufizoi si "sekt të ri, të organizuar në doktrinën e liderit të tij, i cili pohoi se është i dërguar i Zotit dhe se pejgamberia e tij e ka tejkaluar pejgamberinë e Muhammedit a.s."[10] Fillimisht ky sekt ishte si reaksion kundrejt aktivitetit misio-

[5] H. Laoust, op. cit., fq. 322. J. -R. Milot, op. cit., fq. 127.
[6] S. H. Nasr, Srce islama, op. cit., fq. 112. Kasim Dobraca, op. cit., fq. 10.
[7] M. Ebu Zehreh, Tarih'ul-medhahib'il-islamijjeti op. cit., fq. 220.
[8] Husein Djozo, Potreba i pokusaji savremene interpretacije i egzegeze kur'anske misli, Zbornik Radova Islamskog Teološkog Fakulteta u Sarajevu, nr. 1/1982, Sarajevë, fq. 16-20. Këtë mendim e shpreh edhe: El-Mewsuat ..., I, op. cit., fq. 421.
[9] Ihsan Ilahij Dhahir, El-Kadijanijjetu – Dirasatun ve tahlilun, Rijad, 1404 h./1984, fq. 5. Është interesant të theksohet se kundër M. Ikballit u ngrit edhe Xhavahir Leal Nehru, një prej liderëve të Indisë, më vonë kryeministër i Indisë, duke shkruar disa artikuj kundër M. Ikballit e në mbrojtje të kadijanistëve. Ky fakt provon se kadijanistët- ahmedistët ishin monstrum i përbashkët anglezo-indian kundër musliman. Këta artikuj madje u lexuan edhe në hutbetë e xhumasë te kadijanistët dhe u botuan në revistën kadijanistëve El-Fadl, e dt. 18. qershor 1936. Sipas: I. I. Dhahir, op. cit., fq. 5.
[10] Esh-shejh Abdulkadir Shejbe El-Hamd, El-Kadijanije, Mexhel-let'ul-xhami'at'il-islamijjeh, Medinë, 1974, VI, 3, 19, sipas: M. Omerdic, Kadijanije i Ahmedije, Glasnik VIS-a SFRJ, Sarajevë, nr. 6/1986, fq. 616-617.

narist anglez në Indi.[11] Të parët e Mirza Gulam Ahmedit ishin nga Samerkandi, të cilët në Indi erdhën rreth vitit 1530. Prindërit e tij ishin shumë të pasur, të cilat i realizonin kryesisht për shkak të bashkëpunimit me anglezët. Thuhet se më 1858 babai i Mirza Gulam Ahmedit e ndihmoi ushtrinë angleze kundër myslimanëve me 50 ushtarë dhe me 50 kuaj. Sikur edhe shumica e fëmijëve të pasur, edhe Mirza Gulami u shkollua në shtëpi. Ka mësuar Kur'an, gjuhën arabe dhe gjuhën persishte. Në dituritë islame nuk kishte mësues të veçantë, andaj arriti një formim të lirë. Siç e përshkruajnë disa biografë të tij, ishte personalitet i luhatshëm, konfuz, enigmatik, poltron dhe shumë herët filloi të përdorë opiumin, siç e pohon këtë edhe djali i tij: "Babai im me bollëk e përdorte opiumin, duke e përdorur si ilaç." Kurse vetë Mirza Gulam Ahmedi pohon: "Në opium është gjysmë ilaçi, është i lejuar dhe në të nuk ka dëm. Ky është ilaç hyjnor në tokë. Po ashtu, opiumin e ka përdorur edhe trashëgimtari i tij i parë Nurudini." Ai e përdorte edhe alkoolin, ndaj pohonte: "Brendi dhe rrumi janë dy lloje alkoolesh në lejuara në sëmundje, sikur edhe disa lloje tjera nëse janë më efikase...". Por, meqë Mirza Gulami gjithnjë diç ankonte, kishte cirkulim të dobët, dizenteri kronike etj., arsyetohej se duhej të pijë alkool." [12]

Meqë konsideronte se kishte një arsimim solid hyri në punë te anglezët në qytetin Shejlekut te viceguvernatori i Indisë. Aty lidhi lidhjet me anglezët, i simpatizoi dhe bëri çmos që t'i ndihmojë ata. Pas katër vjetësh, me kërkesë të babait të tij, më 1876, kthehet në shtëpi dhe vazhdon studimin e islamit dhe feve tjera. Dhe kështu, më 1880 paraqitet vepra e tij e parë *El-Berahin'ul-ahmedijjeh,* për të vazhduar për katër vjet edhe me tri vepra të tjera. Në veprën e parë dhe të dytë ai përpiqet të sqarojë pikëpamjet e lëvizjes së tij, kurse në pjesën e tretë të librit, të vitit 1882 ai kërkon që të njihet si *muxheddid* (rilindës) i shekullit XIV hixhrij. Më 1884 doli edhe pjesa e katërt e veprës, në të cilën ai shpalli se i është shpallur shpallje nga Zoti. Më vonë botoi edhe pjesën e pestë të librit, në të cilën ka lajthitur nga nevojat e kohës.[13]

[11] K. Dobrača, op. cit., fq. 10.

[12] Er-Reddu'l-hasim ale'l-kadijanijjeti ve ala kul-li men teshebbehe bi inhirafiha, El- Belag, Kuvajt, 24. 03. 1985, 785, 34, sipas: M. Omerdic, Kadijanije ..., 6/1986, op. cit., fq. 35.

Në vitin 1905 themeloi shkollën fetare arabe, për të përgatitur misionarë për vendet islame. Po ashtu, këtë vit udhëtoi në Nju- Delhi që t'ua mbajë disa ligjërata myslimanëve të atjeshëm, por meqë masa myslimane shumë rreptë kundërshtoi dhe e refuzoi ardhjen e tij, atij nuk i mbeti tjetër pos të takohet me pasuesit e tij në banesën e vet.[14]

Në maj të vitit 1908 qëndroi në Lahore, ku edhe vdiq saktë më 26 maj 1908, por pasuesit e tij vendosën ta varrosin në vendlindjen e tij, në Kadijan. Në varrin e tij shënon: Mirza Gulam Ahmed Mew`ud, do të thotë,. Mehdi Muntedhiri, i premtuar për ringjalljen e sheriatit etj.[15]

Mirza Mahmud Ahmed (vdiq më 1954), i cili mori udhëheqjen e ahmeditëve nga Kadijani – të Kadianizmit, e shtroi mësimin e sektës së tyre në vepra të shumta në shkruara në gjuhën angleze. Edhe anëtarët tjerë të sektit kanë shkruar vepra të rëndësishme dhe të ndryshme. Sekti botonte edhe disa revista, jo vetëm në Indi dhe Pakistan, por edhe në Evropë dhe SHBA. Kjo literaturë meriton të studiohet dhe vlerësohet.[16]

Sunizmi ishte kategorik kundrejt mësimeve të kadijanistëve duke i konsideruar mësimet e tyre si joislame. Ahmedistët dhe kadijanistët konsideroheshin barabartë të rrezikshëm sikur edhe babistët dhe behaistët.[17]

[13] Sipas: K. Dobrača, op. cit., fq. 10.

[14] K. Dobrača, op. cit., fq. 10.

[15] M. Ebu Zehreh, Tarih'ul-medhahib'il-islamijjeti ..., op. cit., fq. 221. I. Dzananovic, Ekstremne sekte..., op. cit., fq. 84-85.

[16] H. Laoust, op. cit., fq. 323.

[17] Nur'ul-islam, III, 447-463 dhe IV, 5-17 dhe 110-119, sipas: H. Laoust, op. cit., fq. 323.

Doktrina ahmediste

Janë të pakta ato sekte myslimane për doktrinën e të cilëve dijetarët myslimanë janë unik se nuk janë myslimanë, madje edhe ata më tolerantë. Prezantuesit e këtij sekti përdorin dy metoda: një për myslimanët - duke iu shmangur çështjeve diskutabile, dhe tjetër për jomyslimanët dhe pasuesit e sektit të tyre – duke i shprehur haptazi synimet e tyre. Për të përfunduar lidhur me doktrinën e tyre shumë dijetarë myslimanë i analizuan veprat e tyre dhe shprehën mendimin.[18]

Ndonëse Mirza Gulam Ahmedi përpiqej ta tregonte si islame doktrinën e tij[19], kjo në të vërtetë nuk mund të thuhet. Sidomos, pas vitit 1876 e pas, kur ai pas vdekjes së babait të tij, haptazi pohon se është për të dërguar të Zotit. Me një rast pohoi: "... Atij (Muhammedit a.s., vër. NI) iu errësua Hëna, kurse mua edhe Hëna edhe Dielli, vallë do ta mohosh."[20] Në vitin 1889 Mirza Gulam Ahmedi publikisht shpalli se ka marrë leje prej Zotit që të kërkojë që nxënësit e tij t'i japin atij zotimin për besnikëri. Kurse më 1891 solemnisht ka shpallur se duhet të konsiderohet *mehdi* i myslimanëve dhe *mesi* i të krishterëve.[21] Ai veten e mendonte të privilegjuar të shpalljes së drejtpërdrejtë të Allahut, nëse jo edhe vetë providenca, misioni i drejtpërdrejtë pejgamberik dhe paraqitej si mrekullibërës, kurse simpatizuesit e tij e mendonin atë për profet.[22]

Ata respektonin kultin e Jezusit dhe mendonin se ai nuk është kryquar, por është tërhequr të vdesë në Srinagarë në Indi.[23] Mirëpo, doktrina e tyre në disa vepra pohon se, gjoja, Zoti e ka këshilluar Mirza Gulam Ahmedin: "Unë të kam krijuar ty nga esenca e Isait, dhe vërtet edhe ti edhe Isa jeni nga një esencë si një gjë e vetme", për të

[18] El-Xhuhenij, El-Mewsuat ..., I, op. cit., fq. 420 e tutje.
[19] Tendencë e tyre është që doktrina kadijaniste – ahmediste të tregohet e bazuar në Kur'an. Shih veprën origjinale të një lideri të tyre: Mirza Beshiruddin Mahmud Ahmed, Da'vet'ul-ahmedijjeti ve garduha, botimi II, Lahore, Pakistan, pa vit botimi, fq. 2-3.
[20] I. Dzananovic, Ekstremne sekte..., op. cit., fq. 86.
[21] H. Laoust, op. cit., fq. 322. Lidhur me vdekjen e Isait dhe vendosjen e tij në Kashmir
[22] J. -R. Milot, op. cit., fq. 127. S. H. Nasr, Srce islama, op. cit., fq. 112.
[23] J. -R. Milot, op. cit., fq. 128.

vazhduar në një burim tjetër se Mirza është më i mirë se Isai: "Braktisni përmendjen e të birit të Merjemes, se pa dyshim Gulam Ahmedi është më i mirë se ai."[24]

Doktrina e tij karakterizohet me ndikime hinduizmi të sufizmit të vonshëm dhe ndikim të Perëndimit modern.[25] Po ashtu, sekti i tij karakterizohet edhe me faktin se Mirza Gulam Ahmedi i pari e futi aktivitetin misionarist sipas shembullit të versionit misionarist të krishterimit.[26]

Idetë e tij i ka shtruar në vepra të shumta në persishte, arabishte dhe urdu.[27]

Mësimet e tij karakterizohen me huazime nga sufizmi dhe frymëzimi modern perëndimor. Është mjaft ekletik, herë-herë mësimi i tij është konfuz, por i përshkuar me spiritualizëm dhe idealizëm, që i kontribuuan të ketë sukses në shumë mjedise.[28]

Pas vdekjes së Mirza Ahmedit më 1908, lider i ahmeditëve u bë Mewlewi Nuruddin, me titullin halif i parë i sektit ahmeditë, pushteti i të cilit nuk qe kontestuar në fillim, por me vdekjen e tij më 1914, pasoi një rrëmujë dhe përçarje në këtë sekt.

Mevlevi Nurudini, i njohur edhe si Hakim Nurudin Bejrevi, ishmjek në pallatin e Kashmirit, është devijant i njohur në islam, e disa ia atribuojnë se ky është ai që lëvizjes kadijaniste i dha ngjyrë të një sekti antiislam.[29] U lind më 1841 në Penxhab, në Pakistan. Njihte persishten, gjuhën arabe dhe kaligrafinë. Nën ndikimin e tij, Mirza Gulam Ahmedi filloi të propagandojë se është reformator islam dhe se është njeriu për të cilin Pejgamberi a.s. ka folur në një hadith se do të vijë një ditë.[30] Mirza Gulam Ahmedi për Hakim Nurudinin thotë në veprën

[24] Muhammed El-Hidr El-Husejn, El-Kadijanijjetu ve'l-behaijjetu, tuboi dhe redaktoi Alij Rida Et-Tunisij, (Kairo), 1395 h./1975, fq. 21 dhe 22.
[25] J. R. Milot, op. cit., fq. 128.
[26] S. H. Nasr, Srce islama, op. cit., fq. 112.
[27] H. Laoust, op. cit., fq. 322.
[28] H. Laoust, op. cit., fq. 322.
[29] Hajrudin Muja, Kadijanizmi dhe sekti ahmedijë, në: http://www.horizonti.com/muslimani/tema/ahmedijet.html.
[30] H. Muja, Kadijanizmi... , op. cit.

e tij *Siret'ul-Mehdi*: "E kam takuar fisnikun shejh Nurudinin të preokupuar me idetë e materializmit, por pas takimit tonë, ky ves më nuk ishte i pranishëm tek ai." Përndryshe, këta te dytë për mrekulli plotësoheshin.[31] Kurse ky me rastin e marrjes së rolit udhëheqës deklaroi: "Betohem në Zotin se ai (Gulami) më ka emëruar për halif të vetin: kush e dëshiron këtë flamur ta marrë prej meje dhe me të të mbështillet, le ta bëjë këtë, por providenca dhe vullneti i Zotit është që unë të jam udhëheqësi dhe halifi juaj. Flisni ç'të dëshironi, por dijeni, të gjithë ata që do të më fajësojnë dhe sulmojnë këtë nuk do ta drejtojnë mbi mua por mbi Zotin, sepse Ai mua më ka inauguruar për halif."[32]

Deri sa *ahmeditët nga Kadijani* edhe më tej e konsideronin Mirza Ahmedin për të dërguar të vërtetë të Zotit, *ahmeditët nga Lahoreja*, që ishin pakicë, në Mirza Gulam Ahmedin shihnin vetëm një reformatorë, e jo për të dërguar të Zotit. Kjo ndarje sipas të gjitha gjasave karakterizohej edhe me shkaqe të natyrës politike, sepse ahmeditët e Kadijanit (kadijanitët) më lehtë i përshtateshin dominimit britanik se sa ahmeditët e Lalores, të cilët ishin diç më nacionalist në apelin e nacionalizmit indus.[33] Ata e quajtën veten *Lëvizja Ahmedite në Islam* ose *Shoqëria ahmedite në përhapjen e Islamit*. Shkak tjetër për ndarjen e sektit ahmedit, mbase edhe më i madh, është edhe synimi që pas vdekjes së Mirza Gulam Ahmedit, rolin e liderit ta marrë Hoxha Kemaluddin, pasues i tij. Kur këtë nuk e arriti, atëherë pasoi ndarja.[34] Ata që nuk shkuan në Lahore, mbeten aty dhe vazhduan ta quajnë veten kadijanit. Ata u tubuan rreth djalit të Mirza Gulamit, Mirza Mahmudit, kurse disa të tjerë thonë se djali i Gulam Ahmedit quhej

[31] Ehsan Elahi Zaherr, Qadiyaniat an analytical survey, Lahore, 1978, 2-4, sipas: M. Omerdic, Kadijanije ..., 6/1986, op. cit., fq. 721.

[32] Review of Religions, Fletë kadijaniste, vol. 14, nr. 6, p. 234, sipas: M. Omerdic, Kadijanije ..., 6/1986, op. cit., fq. 721.

[33] H. Laoust, op. cit., fq. 322.

[34] I. Dzananovic, Ekstremne sekte..., op. cit., fq. 89.
Hoxha Kemaluddin, bashkëpunëtori më i afërt i Muhammed Aliut. Pasi nuk arriti ta merrë rolin e liderit, shkoi në Evropë, Angli, ku ka punuar në përhapjen e sektit, duke shpenzuar para të shumta të sektit për lukse personale. Jetonte jetë joislame, konsumonte mishin e derrit dhe e lejonte ate. Sipas: Ehsan Elahi Zaherr, Qadiyaniat..., op. cit., fq.293-294.

Beshiruddin Mahmud, i cili këtë detyrë e kreu deri në luftën e Dytë Botërore.[35] E zëvendësoi Hakim Nurudinin. U shpall halif i të gjithë njerëzve, e jo vetëm i kadijanistëve.[36]

Ahmedizmi nga Lahoreja – Ahmedizmi

Ahmedistët janë degë e ahmedizmit zanafillor, respektivisht të kadijanizmit dhe që të dy krahët e pranojnë Mirza Gulam Ahmedin për themelues të lëvizjes. Për shkak se një kohë vepruan nën një ombrellë dhe për shkak të ngjashmërive ndërmjet tyre, është vështirë të bëhet dallimi i saktë mes tyre. Kjo është edhe për shkak se literatura në shumë raste nuk bën dallimin e saktë ndërmjet njërit dhe sektit tjetër. Megjithatë, do të përpiqemi t'i shtrojmë disa karakteristika më të theksuara të ahmedizmit.

Ahmeditët lahorianë, pas mospranimit të Hakim Nurudinit për pasardhës të Mirza Gulamit, e zgjodhën Muhammed Aliun për lider të tyre. Ky ishte i arsimuar, me diplomë magjistri, nëpunës perspektiv i administratës koloniale. Ishte redaktor i Fletës së sektit *Review of Religions*. Me perfiditet mbillte ide të sektit të tyre, duke abuzuar me emrin islam.[37] Ky sekt pohon se nuk ka asgjë të përbashkët me kadijanistët, duke i kritikuar rreptë kadijanitë dhe duke e konsideruar veten si mysliman të vetëm të drejtë. Mirëpo, pohimi i tyre se Mirza Gulam Ahmedi ka pranuar shpallje, nuk jep shenjë se kemi të bëjmë me myslimanë të drejtë, e as me myslimanë mëkatarë, por kemi të bëjmë me një sekt joislam.[38]

Po ashtu, ata pohojnë se synimi i tyre parësor dhe përfundimtar është Kur'ani, mirëpo interpretimet e tyre janë tejet perfide dhe

[35] Mirza Beshiruddin Mahmud Ahmed u lind më 1889 dhe vdiq më 1965. Ai i dha një forcë ahmedizmit në botë rreth 50 vjet. Gjerësisht: Haxhi Mirza Beshiruddin Mahmud Ahmed r.a., Da`vet'ul-ahmedijjeti ve garduha, Botimi II, Lahore, Pakistan, pa vit botimi, fq. + 1 (kopertina e brendshme në fillim, libër i botuar nga ahmeditët). Krhs.: K. Dobrača, op. cit., fq. 10.

[36] Ehsan Elahi Zaherr, Qadiyaniat ..., op. cit., fq.286-287.

[37] Ehsan Elahi Zaherr, op. cit., fq. 621-622.

[38] K. Dobrača, op. cit., fq. 43.

mashtruese. Ndaj, nuk duhet të mashtrohemi në pohimet e tyre verbale, por edhe në disa shkrime të tyre, sepse ata, për ta vënë në mashtrim masën myslimane herë-herë shkruajnë në mënyrë korrekte.[39]

Ahmeditët e Lahores nuk pajtohen me kadijanitët dhe mendojnë se duhet heshtur disa qëndrime të udhëheqësit të tyre, në të cilat ai ka gabuar, sidomos ato qëndrime që bien ndesh me mësimet islame. Por, ndonëse ata heqin dorë nga kadijanizmi, ata nuk e braktisin Mirza Gulam Ahmedin.

Sipas ahmeditëve lahorianë dy janë dallimet parësore ndërmjet tyre dhe kadijanistëve:

1. Kadijanistët mendojnë se Mirza Gulam Ahmedi është i dërguar i Zotit dhe;
2. Të gjithë ata që nuk besojnë në pejgamberinë e Mirza Gulam Ahmedit janë jobesimtarë.

Këta mendojnë se këtë mashtrim e bëri Mahmudi, i biri i Mirza Gulam Ahmedit, porse harrojnë se vetë themeluesi Mirza Gulam Ahmedi ka pohuar një gjë të tillë.[40]

Për Mirza Gulam Ahmedin pohojnë: "Mendojmë se Mirza Gulam Ahmedi nga Kadijani është rimëkëmbës i shekullit XIV, kurse nuk besojmë se është pejgamber as që ai ka pohuar pejgamberinë", dhe me këtë përpiqen ta mashtrojnë opinionin, duke pohuar se ai nuk është pejgamber, por është muxheddid (rimëkëmbës), pozitë e lartë në fenë islame.

Mirëpo, pohimi vijues tregon se edhe vetë ahmeditët besojnë në njëfarë shpalljeje: "Besojmë se Zoti i frymëzon miqtë e tij (evlijatë) dhe se këta në sheriat quhen rimëkëmbës."[41]

Qëndrimi islam ndaj evlijave është tjetërfare.[42]

Edhe pse ahmeditët lahorianë pohojnë: 'Kush beson se Zoti është vetëm një dhe se Muhammedi është i Dërguar i Zotit ne e mendojmë mysliman" ata me pohimin vijues se "ne respektojmë të gjithë të Dër-

[39] K. Dobrača, op. cit., fq. 44-45.
[40] K. Dobrača, op. cit., fq. 45.
[41] K. Dobrača, op. cit., fq. 45 dhe 46.
[42] Kur'ani, sureja X, ajeti 62-63.

guarit e Zotit dhe të gjithë myslimanët e mëdhenj. Ne largohemi nga ata që e përçmojnë një as`hab, imam, muhadith apo një muxheddid" me pretendimin e tyre se Mirza Gulam Ahmedi është *muxheddid* përpiqen atij t'i japin shenjtëri, dhe pacenueshmëri, që nuk pajtohet me mësimet islame.[43]

Thënia vijuese e vetë Mirza Gulam Ahmedit vetë flet dhe provon pohimet tona se ai është jashtë islamit: "Kam parë se kam qenë Zot...".[44]

Në pamundësi që t'i cekim të gjitha dallimet, sepse ato edhe janë vetëm dytësore, në tabelën vijuese do t'i paraqesim disa dallime më thelbësore ndërmjet *kadijanizmit* dhe *ahmedizmit*[45]

	Kadijanizmi		**Ahmedizmi**
1.	Mirza Gulam Ahmedi është i dërguar i Zotit, që pranoi shpallje.	1.	Mirza Gulam Ahmedi është reformator i dërguar nga Zoti, që pranoi shpallje.
2.	Kush nuk beson ose dyshon në pejgamberinë e Mirzës nuk është mysliman dhe pas tij nuk duhet falur namaz.	2.	Kush nuk e beson dhe kush e nënçmon Gulam Ahmedin ose e shpall jomysliman, ne e braktisim dhe pas tij nuk do të falemi.
3.	Gulam Ahmedi është Mesiu i premtuar.	3.	Gulam Ahmedi është Mesiu i premtuar.
4.	Zoti i ka dërguar këtij populli Mesi më të përsosur se Mesitë e mëhershëm dhe e ka quajtur Gulam Ahmed.	4.	Mirza Gulam Ahmedi ka arritur më shumë se sa ai për të cilin pohohet se është i ngjashëm sipas shpirtit dhe forcës (e ai është Isa a.a.).
5.	Zoti e ka ngritur Mirzën mbi çdo gjë tjetër. Ka zbritur froni nga qielli, kurse froni i tij është mbi çdo fron tjetër.	5.	Mirza Gulam Ahmedi është në shkallën më të lartë të moralit dhe njeri unik.
6.	Mirza Gulam Ahmedi ka çudi dhe mrekulli të shumta (mu'xhize).	6.	Njerëzit e domenit (të Mirzës) shpallin mrekulli etj.

[43] K. Dobrača, op. cit., fq. 48.
[44] K. Dobrača, op. cit., fq. 49.
[45] K. Dobrača, op. cit., fq. 51.

Edhe disa karakteristika të ahmedistëve lahorianë

Ahmeditët mendojnë se duhet t'i kenë xhamitë dhe imamët e tyre.

Ata mendojnë se nëse një ahmedit fal namazin pas një myslimani tjetër, ai këtë namaz duhet ta përsërisë. Po ashtu, pasi që bota myslimane i ka braktisur këta, edhe këta duhet ta braktisin botën myslimane. Sipas tyre mysliman quhet ai njeri që "beson se Zoti është një, se Muhammedi a.s. është i dërguar i Zotit dhe ai që beson në tërë atë që ka thënë Mirza Gulam Ahmedi."[46]

Ahmeditët e Lahores, me numër më të vogël, po ashtu shkruan shumë vepra. Lideri i tyre Mewlana Muhammed Ali (vdiq më 1951) ishte autor i frytshëm. Ky përktheu edhe Kur'anin në gjuhën angleze. Shkroi disa vepra në anglishte dhe urdu mbi pejgamberin dhe mësimet islame.[47]

Ahmedistët janë shumë aktivë dhe mund të gjenden kudo nëpër botë. Janë më pakë se kadijanistët.

Sunizmi ishte tejet rigoroz kundrejt ahmedistëve. Ata ishin përjashtuar nga bashkësia e gjerë myslimane për shkak të doktrinës së tyre mbi profetologjinë dhe kristologjinë. Ata u akuzuan për shkak të mësimeve ekstreme dhe për shkak të kolaboracionizmit me britanikët.[48]

Krahas dy sekteve më të njohura, kadijanive dhe ahmedive, ekziston edhe një sekt tjetër me emrin *Xhemati kadijanit*, sekt ky i cili secilin lider e shpall për të dërguar të Zotit, sepse besojnë se cikli pejgamberik nuk bën të ndërpritet deri në Ditën e Kijametit. Sipas tyre, kadijanitë dher ahmeditë janë mosbesimtarë. Këta janë të shtrirë në bashkësi të vogla nëpër vende të ndryshme të botës.[49]

[46] Kadijanistët nuk pranojnë të falen pas jokadijanistit, madje Mirza Gulami, nuk fali namazin e xhenazes së djalit të tij, sepse ai vdiq si musliman. Sipas: I. I. Dhahir, op. cit., fq. 36 e tutje.
I. Dzananovic, Ekstremne sekte..., op. cit., fq. 89.
[47] H. Laoust, op. cit., fq. 323. E. E. Zaherr, op. cit., fq. 622.
[48] H. Laoust, op. cit., fq. 323.
[49] E. E. Zaherr, Qadiyaniat..., op. cit., fq. 300.

Ahmedistët mbi krishterimin dhe politikën angleze

Ndonëse propaganda ahmediste pohon se luftojnë kundër okupatorëve dhe për çlirimin e vendeve myslimane, në praktikë, ata u shërbejnë krishterimit dhe anglezëve. Edhe kur kritikojnë ndonjë dogmë të krishterë, atë e bëjnë vetëm në ato pjesë kur nevojitet për ta përforcuar mesianizmin e Mirza Gulam Ahmedit. Të njëjtën e bëjnë edhe kur kemi të bëjmë me mësimet islame.

Qëndrimi ahmedist ndaj anglezëve është pozitiv. Vetë Mirza Gulam Ahmedi në vitin 1897 u drejtoi një letër dijetarëve myslimanë të Indisë, me titull "Paqja është më e mirë", në të cilën iu apelon atyre që ta braktisin kritikën ndaj punës së tij vetëm për 10 vjet."

Kur në vitin 1907 ndodhi një kryengritje e popullit kundër anglezëve, ai dha proklamatën që pasuesit e tij të qëndrojnë larg rrëmujës dhe t'i ndihmojnë pushtetit anglez në thyerjen e lëvizjes, që këta edhe vepruan ashtu.

Mirza Gulam Ahmedi thuajse në çdo vepër të tij, sikur edhe në *Nur'ul-hakk:* "Kjo perandori e bekuar (angleze) nuk e ka të njohur se unë prej moti jam një prej shërbëtorëve të tij dhe prej atyre që ia dëshirojnë të mirën. Ne gjithnjë i afrohemi me zemër të përkushtuar... Kjo perandori hyjnore-qiellore më ka pasuruar, ka rehabilituar varfërinë time, më ka freskuar, e ka ndriçuar natën time dhe më bëri ndër të zgjedhurit. Për këtë arsye kam vendosur t'i ndihmojë Perandorisë...".[50]

Hoxha Kemaludin, në librin e tij *Pozita e Indisë* pohon: "Mësimi i qartë i Kur'anit dhe hadithet e të dërguarit kanë mbjellë në zemra përkushtimin dhe sinqeritetin ndaj pushtetit britanik. ... Unë kam mbajtur disa ligjërata për t'i përudhur myslimanët t'i nënshtrohen pushtetit anglez...".[51]

Liderët kadijanistë – ahmedistë shtrembërojnë shpjegimet e ajeteve kur'anore, duke i komentuar ato në shërbim të dëgjueshmërisë ndaj anglezëve. Këtë e shprehin haptazi: "... vallë jeni mëkatarë dhe rebelë,

[50] Nur'ul-jekin, pjesa I, fq. 26 e tutje, sipas: K. Dobraca, op. cit., fq. 33-35 dhe 35-40.
[51] K. Dobraca, op. cit., fq. 53.

të cilët jeni ngritur kundër sunduesve? A mos keni harruar atë që rekomandohet nga minberi çdo të premte? Ju jeni myslimanë, kurse është e pamundur që myslimanët ta zhgënjejnë pushtetin anglez. Ju jeni besimtarë, kurse është e pamundur që besimtari t'i dëmtojë pushtetit legjitim. Ju jeni pasues të Kur'anit, kurse Kur'ani urdhëron dëgjueshmëri ndaj sunduesve."[52]

Qëndrimi i myslimanëve kundrejt Kadijanistëve – Ahmedistëve

Ndonëse fillimisht bota sunite islame e nderoi paraqitjen e kadijanizmit - ahmedizmit, madje edhe organizoi pritje madhështore për Hoxha Kemaluddinin në vitin 1922 kur ky kaloi nëpër Egjipt[53], ndonëse e toleroi paraqitjen dhe propagandën e tyre, megjithatë, pas zbulimit të fytyrës së vërtetë të tyre dhe pas ashpërsimit dhe radikalizimit të qëndrimeve të kadijanistëve - ahmedistëve, qeveritë myslimane filluan ta sanksionojnë veprimtarinë e kadijanizmit - ahmedizmit,[54] por, duhet pranuar, jo në mënyrë sistematike dhe shkencore.

Është për t'u theksuar se është mendim unanim (ixhma`) i të gjithë dijetarëve islamë në të gjitha kohët se është mosbesimtar secili mysliman që mendon dhe flet se pas Muhammedit a.s. mund të vijë ndonjë Pejgamber i ri i Zotit.[55]

Për këtë shkak, respektivisht për shkak se secili lider i tyre pretendon në pejgamberi dhe shpallje, por edhe për shkak të raporteve të ngushta dhe miqësore të kadijanistëve - ahmedistëve me botën okupatore, me anglezët dhe të tjerët, bota myslimane (më tepër paria fetare dhe masa e gjerë se vetë institucionet politike) haptazi iu kundërvu atyre, sidomos pas lejimit të haremeve dhe ndalimit të hallalleve, shpalljes për pejgamber, shtrembërimit të Kur'anit etj. Dijetari i madh

[52] Hoxha Kemaludin dhe liderë të tjerë me ngulm kërkojnë nga masat muslimane t'u nënshtrohen anglezëve, madje duke ua komentuar ajetet në mënyrë të rrejshme. Shih: K. Dobrača, op. cit., fq. 52-54.

[53] K. Dobrača, op. cit., fq. 55.

[54] S. H. Nasr, Srce islama, op. cit., fq. 112-113.

[55] Ibn Hazm, Kitab'ul-fisal, fq. 255 dhe 256, sipas: K. Dobrača, op. cit., fq. 41.

mysliman, Muhammed Reshid Rida, tërhoqi vërejtjen kundrejt mësimit kadijanist – ahmedist.[56]

Edhe Ebu'l-hasan En-Nedevi, dijetar i madh mysliman, u mor me këtë temë dhe me një varg shkrimesh gjykoi këtë sekt si joislam.

Me qëllim të propagandimit të ideve të tyre dhe depërtimit sa më të suksesshëm në mesin e sunizmit, në vitin 1939-1940 ahmeditët i regjistruan dy studentë, sipas të gjitha gjasave me prejardhje nga Shqipëria, në El-Ez`her. Ata filluan të shpërndajnë libra si *Ta'lim'ul-ahmedijjeh* dhe *El-Ahmedijjeh kema arefnaha*. Pas zbulimit të këtyre librave, zyrtarët e El-Ez`herit shpallën se ahmeditët nuk janë myslimanë dhe këtë lajm e dërguan nëpër të gjitha gazetat myslimane në botë.[57]

Vetëm në gjysmën e shekullit XX, më 26 shkurt 1971, Liga Islame në Mekë filloi t'u kushtojë rëndësi mësimeve dhe veprimtarisë së tyre dhe të ofrojë shpjegime konkrete, por edhe të ndalojë hyrjen e tyre për të kryer haxhin.[58]

Ky organ ftoi dijetarët më të njohur të përgjigjen me shkrime shkencore për t'i zbardhur synimet dhe platformën e kadijanistëve - ahmedistëve. Ftesës iu përgjigjen Hasenejn Muhammed Mahluf (ish-mufti i Egjiptit dhe tani anëtar në Institutin për hulumtime islame në Kairo), Ebu'l-Hasan En-Nedevi (dijetar i njohur nga Pakistani), Ebu'-l-A'la El-Mewdudi[59] (dijetar i njohur nga Pakistani) dhe Muhammed El-Hidr Husejn (ish-rektor i El-Ez`herit dhe tani anëtar i Akademisë së gjuhës arabe në Kairo dhe anëtar i Akademisë së Shkencave në Damask).

[56] El-Fet`h, Kairo, VIII, 15 xhumade'l-uhra 1352 h., sipas: M. Omerdic, Kadijanije ..., 1/1987, op. cit., fq. 63.

[57] Ahmed Muhammed Avi, El-Kadijanijjeh, Kairo, 1969, fq. 52, sipas: M. Omerdic, Kadijanije ..., 6/1986, op. cit., fq. 625.

[58] M. Omerdic, Kadijanije ..., 1/1987, op. cit., fq. 64.
Sipas Dr. Xhuheniut, Konferenca e Rabitës në Meke u mbajtë në prill të vitit 1974 / Rebiulevvel 1394 që mori vendime rigoroze kundër kadijanistëve – ahmedistëve. Shih: El-Xhuhenij, El-Mewsuat ..., I, op. cit., fq. 421.

[59] Për ata që njohin turqishten shih një studim konstruktiv: Ebul A'la El-Mewdudi, Kadiyanilik nedir?.. (arabcadan Çeviren: Ahsen Batur, Istanbul, 1975, fq. + 231.

Nuk kemi mundësi hapësinore t'i prezantojmë të gjitha mendimet e tyre, pos të konstatojmë mendimin e tyre të përmbledhur se ky sekt në pikëpamje fetare është tërësisht jashtislame dhe kundërislame, kurse në pikëpamje politike është një bastard, një virus me pasoja të rënda për unitetin mysliman.[60]

Edhe Qeveria pakistaneze në vitin 1974 ndaloi veprimtarinë e tyre, pasi që sekti kadijanit sulmoi trenin me student myslimanë të mjekësisë në qytetin Rebvi. Sipas shembullit të tyre vepruan edhe Emiratet, India, ndërsa paralajmëruan masa edhe Egjipti etj.[61] Megjithëkëtë, masat që ndërmorën vendet arabo-islame ishin të pjesërishme, jostudioze dhe sipas bindjes sonë, të kushtëzuara nga raportet politike në botë.

Edhe Bashkësia Islame e Jugosllavisë, pjesë e së cilës atëherë ishte edhe Kosova, në vitet e 70-ta e pas, nga njerëzit zyrtarë dhe në gazetat zyrtare të saj, si në Preporod, Takvim e Glasnik, disa herë dha shenjë lidhur me këtë sekt, duke e cilësuar jo vetëm sekt jomysliman, por edhe sekt *kundër*mysliman. Kështu, Husein Gjozo, intelektuali numër një i asaj kohe, në fetvanë e tij për kadijanitë dhe ahmeditë pohon se janë ekstremë dhe shtrembërim dhe sekt jomysliman.[62]

Mënyrat e veprimit të kadijanistëve - ahmedistëve në tokat shqiptare

Mënyrat e veprimit të ahmeditëve janë të ndryshme. Ata nuk zgjedhin mjete për të vepruar. Ata nuk i lanë të qeta as tokat shqiptare me një shumicë mbi 90 % myslimane.

Gjurmët e para të kadijanive – ahmedive në tokat shqiptare i kemi në vitin 1937, në Vushtrri, kur dr. Muhammed Din, misionar ahmedit, mbajti disa ligjërata. Mirëpo, masat myslimane sunnite reaguan ash-

[60] Posedojmë librin e Muhammed El-Hidr El-Husejn me titull El-Kadijanijjetu ve'l-behaijjetu, tuboi dhe redaktoi Alij Rida Et-Tunisij, (Kairo), 1395 h./1975, fq. + 84, në të cilin trajtohen, pak a shumë, problemet që i kemi trajtuar në këtë shkrim.

[61] El-Xhuhenij, El-Mewsuat ..., I, op. cit., fq. 421. I. Dzananovic, Ekstremne sekte..., op. cit., fq. 88.

[62] Husein Djozo, Fetve – Pitanja i odgovori, Novi Pazar, 1996, fq. 376-378.

për, kurse Bashkësia Islame ndërmori të gjithë hapat që ky rast mos të përsëritet.[63]

Në vitet e tetëdhjeta në Kosovë studioi Muhammed Zekerija Kan, i cili pas qëndrimit disavjeçar, u kthye në Pakistan dhe në vitin 1990 botoi në Islamabad përkthimin e Kur'anit në gjuhën shqipe. Këtë përkthim ua dedikoi shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri dhe diasporë.[64] Viteve të fundit ata përkthyen edhe pamflete, broshura të tjera në gjuhën shqipe, me shpresë që t'i përfitojnë zemrat e njerëzve fetarisht, moralisht, politikisht, ekonomikisht dhe kulturalisht të humbur, respektivisht të hamendur pas dhunës gjysmëshekullore të komunizmit kundër fesë.[65]

Disa punime të publikuara për kadijanitë - ahmeditë deri tash në gjuhën shqipe janë kontribut i mirë, por jo i mjaftueshëm. Lëvizja e tyre duhet të prezantohet shkencërisht, pa emocione dhe më gjithanshëm, si në tokat shqiptare ashtu edhe në diasporë, sepse rreziku më i madh kanoset pikërisht te punëtorët tanë në botën e jashtme. Ata, të shtrënguar nga gjendja ekonomike-sociale nuk kanë kohë të mjaftueshme të arsimohen sa duhet me mësimet islame dhe për këtë arsye mund të bien pre, viktimë e propagandës së tyre. Këtë drojë e rritë fakti se aktivistët kadijanistë - ahmedistë janë aktivë në tokat shqipfolëse dhe në diasporë, kurse Bashkësitë Islame, në këtë aspekt, fare pak kujdesen si në vend ashtu edhe në diasporë.

[63] Propaganda ahmedija u nasoj drzavi, El-Hidaje, 1938, II, 2-3, 48; Dopis od Pravog naiba za Vrhovno vjersko starjesinstvo, El-Hidaje, 1938, II, 5, 80 sipas: M. Omerdic, Kadijanije ..., 1/1987, op. cit., fq. 65.

[64] Kurani i shenjtë arabisht – shqip, përktheu dhe komentoi Muhammad Zakarija Khani, IIP Ltd. Islamabad, Sheephatch Lane, Tilford, surrey. G.U. 10/2 A.Q. – U.K., 1990. Shih edhe libërthin e vlefshëm: B. Ahmeti, Kadijanitë (Ahmeditë) Prishtinë, 1997, fq. 83-89. N. Tërnava, Fraksionet në Islam, Prishtinë, 1997, fq. 157—165.

[65] Po e cekim me këtë rast broshurën e Mirza Beshiruddin Mahmud Ahmedit në gjuhën shqipe (që e cekëm në arabishte) me titull Mesazhi i Ahmedijatit, të shtypur në Angli, ndërsa të përkthyer prej Muhamed Zekerija Kan, përkthyesi ahmedit, tashmë i njohur, i Kur'anit në gjuhën shqipe.

Nexhat Ibrahimi

QADIYANISTS AND AHMADEYISTS

(Summary)

In the beginning of the XIX century, in response to the rule of the colonial powers over Muslim countries, a number of Mahdi movements emerged in West Africa, Sudan, the modernism of Sayyid Amir Ali in India, etc.

Nonetheless, these Mahdi movements did not lead to the creation of sects. Some of these movements aimed at liberating their peoples and countries, while others aimed the opposite (to serve the colonial powers – be it for their personal interests or those of small groups). The movements, which had the typical characteristics of sects emerged with Babism and Bahaism in Iran and the syncretist sect. Analysts claim that this movement was the last major Muslim sect, which emerged in the Indian sub-continent, at a time when Muslim rule was fading and British colonial rule was gaining ground.

نجاد إبراهيم

قاديانيون و أحمديون

(خلاصة البحث)

ان في بداية القرن التاسع عشرة ردا على الهيمنة الاستعمارية على الدول الاسلامية ظهر عدد من الحركات "المهدية" مثل في أفريقيا الغربية و السودان و اعتدال سيد عامر على في الهند الخ، و لكن على الرغم من ذلك فان هذه الحركات المهدية لم تأت بفرق.

كان غرض بعض هذه الحركات انقاذ شعوبهم و بلدانهم و كان غرض عدد أخر من الحركات عكس ذلك: خدمة المستعمرين للصلحة الخاصة أو

للمصلحة الضيقة لمجموعة صغيرة أن الحركات التي كانت تتصف. بهذه الصفات يمكن ان يقال عن الفرقة البابية أو البهائية في إيران و الفرقة القاديانية و الاحمدية في الهند. و فقا لراى عدد كبير من المحللين بان هذه الحركة تعد أخر أكبر فرقة من المسلمين التي ظهرت بشبه القارة الهندية في فترة انهيار الحكم الاسلامي و مجئ الاستعمار البريطانى.

PËRVJETOR

Me rastin e 94-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë

TË DHËNA PËR SHQIPËRINË NË PRAG TË PAVARËSISË NË REVISTËN "EL-HILAL" TË KAJROS*

(Disa të dhëna interesante për gjendjen në Shqipëri, në një artikull të botuar në revistën "el-Hilal" të Kajros më 1 maj të vitit 1911, (2 xhumade-l-evvel 1329h), para pavarësisë së Shqipërisë, ku bëhet fjalë për gjeografinë, historinë dhe gjendjen e saj të përgjithshme)

Për shkak të trazirave të fundit që ndodhën në Shqipëri dhe ngritjes së popullatës së vilajetit të Shkodrës në kryengritje, pamë të arsyeshme të japim një pasqyrë të shkurtër për gjeografinë, historinë dhe gjendjen e saj të përgjithshme që të interesuarit të jenë në gjendje të përcjellin në mënyrë më të afërt zhvillimet politike në atë vend.

* Revista "El-Hilal" e cila botohet edhe sot e kësaj dite në Kajro, është revistë për shkencë, kulturë dhe letërsi. Numri i parë i saj ka dalë më 1892. Ky artikull i kushtohet Shqipërisë dhe ngjarjeve në të. Edhepse me disa mangësi, për kohën e botimit të tij ka vlerën e tij në veçanti për disa të dhëna statistikore, të cilat përmban. (Vër. e përkth.).

1. Aspekti gjeografik: Kufijtë dhe ndarja administrative

Shqipëria njihet te ne më shumë si vendi i Arnautëve. Ajo kufizohet me Malin e Zi dhe Bosnjën në veri, me Greqinë në jug, me Maqedoninë dhe Serbinë në lindje dhe me detin Adriatik në perëndim. Ajo ndahet në tri pjesë, secila pjesë quhet vilajet.

1. Vilajeti i Shkodrës në veri me qendër qytetin e Shkodrës.
2. Vilajeti i Janinës në jug me qendër Janinën, Epiri është pjesë përbërëse e tij.
3. Vilajeti i Manastirit në mes dhe lindje me qendër Manastirin.
4. Vilajeti i Kosovës me qendër në Shkup.[1]



Harta e trojeve etnike shqiptare

[1] Nuk jep të dhëna për Vilajetin e Kosovës.

Shqiptarët ndahen në dy fise:

1. Gegë, të cilët banojnë në pjesën veriore të Shqipërisë, në Shkodër dhe pjesë të tjera.
2. Toskë, të cilët banojnë në jug dhe në pjesën qendrore të Shqipërisë, si Berat, Elbasan dhe në perëndim të Manastirit.

Po japim disa të dhëna për secilin vilajet:

Vilajeti i Shkodrës

Shtrihet në pjesën veriore të Shqipërisë dhe njihet me emrin Shqipëria Veriore. Konsiderohet vilajeti më jo stabil i Shqipërisë për shkak se është në fqinjësi me Malin e Zi. Ky vilajet ndahet në dy sanxhaqe nën secilin sanxhak janë nga tetë kaza, në secilin sanxhak ose kaza ka nahi si dhe fshatra. Kjo është përbërja e tyre:

Emri i kazasë	**numri i nahive**	**numri fshatrave**
Sanxhaku i Shkodrës	5	88
Kazaja e Lezhës	2	39
Kazaja e Krujës	1	49
Kazaja e Tuzit	-	24
Kazaja e Pukës	-	46
Kazaja e Mirditës	-	5
Sanxhaku i Durrësit	-	5
Kazaja e Tiranës	-	101
Kazaja e Kavajës	-	57
Kazaja e Shijakut	2	56
Gjithsej:	10	470

Qyteti më i njohur i këtij vilajeti është qyteti i Shkodrës. Ai në të njëjtën kohë është edhe selia e vilajetit. Gjendet në pjesën jugore të Liqenit të Shkodrës. Numri i banorëve të këtij vilajeti është 30.000. Pjesa dërrmuese e popullatës janë të besimit islam. Shkodra është e pasur me tregje, të cilat janë të vjetra e rrugët janë të ngushta. Qyteti është i ndërtuar në një rrafshinë, në të cilën takohen dy lumenjtë Buna dhe Drini i Bardhë. Në Shkodër gjendet një numër i konsideruar i

xhamive dhe kishave. Konsiderohet qendër tregtare me rëndësi, për shkak të lidhjeve të saj me detin Adriatik, me lumin Buna dhe Drinin e Bardhë. Anijet bartin nga deti Adriatik prodhime të ndryshme nëpër rrjedhën e lumit Drin, të cilat ua shesin banorëve të malësisë, ndërsa prej tyre blejnë lesh, drunjtë dhe gjëra tjera. Në Shkodër gjenden disa fabrika për prodhimin e armëve dhe përpunimin e pambukut.

Shqiptarë me veshje kombëtare

Shkodra është qytet shumë i vjetër. Në gjuhën sllave ajo quhet "Skadar". Gjini mbreti i parë i ilirëve e kishte marrë për kryeqendër të mbretërisë së tij në mesin e shekullit të dytë para erës së re. Atë e

kishin rrethuar romakët, të cilët pasi kishin korrë fitore ndaj ushtrisë së tij e kishin dërguar në Romë në vitin 168 para erës së re. Më vonë nën sundimin e Venedikut dhe pastaj nën sundimin e Perandorisë Osmane në vitin 1479 deri më sot.

Vilajeti i Janinës

Gjendet në jug të Shqipërisë, ndahet në 4 sanxhaqe dhe në 15 kaza. Në të gjenden 12 nahije dhe 1606 fshatra.

Emri i kazasë apo sanxhakut	Numri i nahive	Numri i fshatrave
Sanxhaku i Janinës	4	229
Kazaja e Leskovikut	-	49
Kazaja e Konicës	-	36
Kazaja e Ajdonatit	-	61
Kazaja e Filatit	-	68
Kazaja e Meçoves	-	3
Sanxhaku i Angerit	-	64
Kazaja e Delvinës	1	92
Kazaja e Paramithies	1	99
Kazaja e Pogonjan	-	38
Kazaja e Tepelenës	-	63
Kazaja e Kurveleshit	1	22
Sanxhaku i Prevezës	-	38
Kazaja e Lorosit	1	68
Kazaja e Margëlliqit	2	73
Sanxhaku i Beratit	1	218
Kazaja e Vlorës	-	71
Kazaja e Lushnjës	1	215
Kazaja e Guseinices	-	101
Gjithsej:	12	1606

Ushtarë shqiptarë me uniformën e gardës së Sulltan Abdul Hamitit

Prej qyteteve më të njohura të këtij vilajeti është qyteti i Janinës, i cili është edhe kasaba e këtij vilajeti. Pamja e tij është shumë e bukur, sepse ai shtrihet në fund të malit **Mitzikali**, lartësia e të cilit është 1500 metra mbi sipërfaqen e detit.

Ky qytet u bë i njohur në fillim të shekullit të kaluar me paraqitjen në skenë të Ali Pashë Tepelenës, për të cilin do të flasim më vonë e që u bë njëra ndër figurat më të njohura në historinë e Shqipërisë. Ali Pasha këtë qytetet e zgjodhi seli të pushtetit të tij. Numri banorëve të saj arrin në 50.000, shumica e të cilëve janë të krishterë, në atë qytet është një kështjellë e njohur që quhet "Demir-kulla" apo “Kalaja e hekurt”, e cila gjendet mbi një kodër që ishte lënë pas dore. Në Janinë gjenden disa dhjetëra xhami, shtatë kisha, dy sinagoga, një shkollë, një fakultet grek, një bibliotekë dhe një spital. Ka dy limane, të cilët përdoren për zbarkimin dhe ngarkimin e mallrave për tregti. Aty krijohet një lëvizje e madhe e tregtisë me limanet tjera si atë Korfuzit dhe Artës në jug. Kjo lëvizje e madhe tregtare, pjesa më e madhe e së

cilës është në duar të grekëve, ata janë të njohur me qëndisjen e arit dhe të argjendit. Më gjatë rreth kësaj do të flasim, kur do të bëjmë fjalë për Ali Pashë Tepelenën.

Vilajeti i Manastirit

Ai është vilajeti më afër Selanikut dhe Maqedonisë. Ky vilajet formohet prej 5 sanxhaqeve, 20 kazave, 24 nahijeve dhe prej 1903 fshatrave. Ja kjo është përbërja:

Emri i Sanxhakut apo kazasë	Nahijet	Fshatrat
Sanxhaku i Manastirit	4	241
Kazaja e Prilepit	1	131
Kazaja e Florines	2	76
Kazaja e Kërçovës	-	113
Kazaja e Ohrit	2	103
Sanxhaku i Serfixhes	1	29
Kazaja e Koçanës	1	81
Kazaja e Kalparit	2	54
Kazaja e Taslixhes	2	93
Kazaja e Kidines	-	78
Kazaja e Ulusines	3	73
Sanxhaku i Dibrës	-	111
Kazaja e Matit	-	32
Kazaja e Prespës	-	37
Kazaja e Rekë e Lirë	-	44
Sanxhaku i Elbasanit	-	155
Kazaja e Grafecit	-	66
Kazaja e Peklinit	-	53
Sanxhaku i Korices	2	160
Kazaja e Kesres	3	120
Kazaja e Kostories	1	100
Kazaja e Kolonjës	-	54

Kasaba e këtij vilajeti është Manastiri. Ai gjendet në një lartësi prej 1880 m. mbi sipërfaqen e detit. Është i rrethuar me fusha të pasura në një sipërfaqe prej dhjetëra milash në një gjerësi prej 40 mila. Ky qytet ka një pozitë strategjike ushtarake, për arsye se gjendet në pikën ku takohen rrugët për Selanik, Durrës, Shkup dhe Edrene. Për këtë arsye osmanlinjtë në vitin 1830 e bënë qendër ushtarake dhe prej asaj kohe u shtua rëndësia e tij. Numri i banorëve të tij është 50.000. Është quajtur me këtë emër sipas një manastiri që gjendej aty. Nga qyteti i Resnes në vilajetin e Selanikut është Nijazi begu, autori i kushtetutës më të re të shtetit osman.

Prej qyteteve më të njohura të Shqipërisë është Prizreni, i cili gjendet në veri-lindje të Shqipërisë. Është i njohur me prodhimin e armëve sidomos të pushkëve. Numri i banorëve të tij arrin në 30.000. Prej qyteteve tjera po përmendim Tiranën, Ohrin, Elbasanin, Delvinën, Mitrovicën etj. Kurse prej limaneve po përmendim Ulqinin, Durrësin, Parken, Prevezën Artën etj.

Banorët

Banorët e Shqipërisë njihen me emrin "Arnaut". Ata janë të njohur me trupa të zhvilluar dhe janë shembull për fuqinë e tyre. Megjithatë, ata nuk mundën të themelojnë shtetin e tyre për shkak të përçarjes dhe mosunitetit të tyre. Kështu që vendi i tyre gjatë tërë historisë ishte cak i pushtuesve të huaj. Edhe pse ky vend që nga kohët më të lashta ishte vendi nga i cili lindën njerëzit dhe trimat më të mëdhenj, të cilët i njohu historia, duke filluar prej Lekes së Madh (Aleksandërit të Madh), Skënderbeut, Ali Pashë Tepelenës, të cilën do ta përmendim më vonë, pastaj Mehmed Ali Pashën, themelues i dinastisë së Hidejvit (Mbretërisë së Egjiptit), si dhe një numër të madh të burrave që u dalluan kohëve të fundit si mbrojtës të kushtetutës osmane. Gjatë historisë me shqiptarët u bashkuan popuj dhe kombe të ndryshëm si grekët, turqit dhe shumë popuj tjerë. Numri i shqiptarëve tash llogaritet në 1.500.000 deri në 2.000.000 banorë. Më shumë se gjysma i përkasin

besimit islam, kurse pjesa tjetër dy të treta janë të krishterë të ritit ortodoks, kurse një e treta të ritit katolik.

Shqiptarët dallohen me trupat e tyre të gjatë dhe të plotë. Janë kryelartë, të buzëqeshur dhe vazhdimisht kanë besim të madh në vetvete. Zakonet e tyre ua imponojnë që ata vazhdimisht të mbajnë armë pranë vetes si thika apo karabinierë. Veshjet e tyre u përngjajnë veshjeve të grekëve, por ata dallohen me fustanellat e tyre apo fustanella të shkurta deri në gjunjë të ngjashme me ato të skotlandezve edhe pse ato dallohen në ngjyra. Në vendet e banimit të tyre shqiptarët shoqërohen me armë si pushkë, jataganë dhe thika. Pjesë e veshjes së tyre është edhe mbulimi i kokës me një kapuç të bardh (plis) si dhe bartjen e shallit të gjatë. Por, një pjesë e inteligjencës shqiptare të këtij brezi veshin rroba moderne evropiane, ashtu siç bëjnë të rinjtë e Egjiptit dhe të Shamit.

Për shkak se shqiptarët, gjatë historisë u dalluan për fuqi, trimëri dhe përdorimin e armëve, shteti osman i përdori ata si ushtarë. I fundit që bëri këtë është sulltan Abdylhamiti, garda mbretërore e të cilit ishte kryesisht e formuar prej shqiptarëve .

2. Historia

Më lart përmendëm ndjenjën e përçarjes në mesin e shqiptarëve, andaj kjo dobësi e tyre, e cila i ka shoqërua ata gjatë historisë, ka qenë shkak që ata të jetojnë të nënshtruar nga shtetet tjera dhe shumë rrallë ndodhi që ata të kenë shtetin e tyre të pavarur. Edhe pse ata në luftëra tregoheshin të suksesshëm dhe me tërë qenien e tyre mbronin atdheun e tyre, por përçarjet e brendshme dhe lufta për pushtet ishin ato që i bënin ata të dështonin. Andaj edhe nënshtrimi i tyre mund të bëhej vetëm pas një mundi të madh. Prej mbretërve të tyre më të vjetër dhe më të njohur po përmendim Pirron, mbretin e Epirit (296-272) para epokës së re, i cili hyn në radhën e mbretërve më të mëdhenj të botës. Pirro ishte ai që i bashkoi të parët e shqiptarëve dhe themeloi shtetin e tyre. Mirëpo, pas vdekjes së tij, pasardhësit e tij u përçanë dhe nuk mundën t'u bëjnë ballë sulmeve nga jashtë. Andaj, vendi i tyre ra nën

ndikimin e maqedonasve. Kështu mbeten deri në vitin 167 p.e.re kur ata ranë nën ndikimin e romakëve. Pas dobësimit të shtetit romak dhe forcimit të shtetit bullgar, një pjesë e tokave shqiptare ra nën ndikimin e tyre, por ata nuk mundën ta nënshtrojnë tërë Shqipërinë.

Skënderbeu (1405-1468)

Kur osmanlinjtë shtrinë ndikimin e tyre në Ballkan, deshën ta pushtojnë edhe Shqipërinë, por shqiptarët u bënë një rezistencë të madhe, nën komandën e heroit të tyre Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, të birit të Gjon Kastriotit, njërit prej princave të Shqipërisë. Gjergj Kastrioti i lind në vitin 1404 dhe si fëmijë ishte dërguar në pallatin e sulltanit osman, ku u edukua dhe përqafoi fenë Islame. Pasi mbaroi shkollimin e duhur hyri në shërbimin e ushtrisë osmane dhe u bë njëri prej komandantëve të saj dhe u quajt me emrin Skënderbe.



Skënderbeu

Me trimërinë dhe zgjuarsinë e tij u bë i njohur në kohën e sulltan Muratit të dytë. Në vitin 1443, sulltani e dërgoi Skënderbeun në krye të një ekspeditë ushtarake në Hungari. Derisa ai ishte në rrugë e sipër dëgjoi për vdekjen e babit të tij, andaj, dëshira e tij për liri dhe pavarësi bëri që ai ta braktisë ushtrinë e sulltanit. Gjon Huniadi, komandanti i ushtrisë hungareze kishte fituar betejën kundër ushtrisë osmane në Nish, gjë që kishte bërë që ushtria osmane ta humbë luftën. Skënderbeu kishte shfrytëzua këtë rast, duke kërkua prej bashkatibit të sulltanit, që ishte në shoqërinë e tij t'i japë një ferman në emër të sulltanit që ai është emëruar vali i Krujës,

vendlindjen e tij. Kështu ai braktisi ushtrinë osmane, tradhtoi fenë islame dhe së bashku me afër 300 kalorës shqiptarë shkoi në Krujë, ku shpalli pavarësinë e Shqipërisë. Shqiptarët pranuan udhëheqjen e tij dhe u bashkuan nën flamurin e tij. Posa arriti lajmi te sulltani, ai dha urdhër për dërgimin e një ekspedite ushtarake për nënshtrimin e tij, por kjo përpjekje nuk pati sukses. Më në fund vetë sulltan Murati, personalisht u nis në krye të ushtrisë osmane në vitin 1450, mirëpo edhe kjo përpjekje e tij nuk pati sukses. Pas tij në fronin e Perandorisë erdhi Sulltan Mehmet i dytë i njohur me nofkën "el-Fatihu", (çliruesi i Konstantinopojës në vitin 1453), i cili në vitin 1461 nënshkroi një marrëveshje paqe me Skënderbeun.

Mirëpo, Skënderbeu më vonë, nën ndikimin e Papës Piut të dytë dhe Republikës së Venedikut shkeli marrëveshjen me Osmanlinjtë dhe u shpalli luftë atyre në vitin 1464. Skënderbeu vdiq në vitin 1467, pas vetes la një djalë me emrin Gjon. Pas vdekjes së tij ushtria osmane përsëri e nënshtroi Shqipërinë në vitin 1479 pas rrethimit të Shkodrës. Megjithatë, nënshtrimi i plotë i Shqipërisë pothuajse nuk ishte i plotë asnjëherë për shkak të ndjenjës së shqiptarëve që të jenë të pavarur si dhe për shkak të kryengritjeve të tyre të shumta. Me dobësimin e Perandorisë Osmane në gjeneratat e fundit, ndjenja e shqiptarëve për pavarësi u forcua edhe më shumë, të cilën e arritën në fillim të shekullit nëntëmbëdhjetë nën udhëheqjen e Ali Pashë Tepelenës, heroi dhe trim i njohur shqiptar i Janinës.

Ali Pashë Tepelena (1740-1822):

U lind në Tepelenë në vilajetin e Manastirit. Rrjedh prej një familjeje nga Toskëria. Të parët e tij ishin një familje e njohur aristokrate dhe quheshin paria e Tepelenës. Kur venedikasit e rrethuan ishullin e Korfuzit në vitin 1716, gjyshi i Ali Pashës ishte në mesin e atyre që po e mbronin atë. Ai vdiq në luftë dhe atë e trashëgoi i biri i tij do të thotë babai i Ali Pashës. Por, ai ishte i dobët, për ç'gjë fqinjët e tij ia plaçkiten tërë pasurinë e tij. I biri i tij Aliu u edukua në duart e nënës së vet. Ajo vazhdimisht i fliste të birit të saj për fqinjët, të cilët ia

kishin plaçkitur pasurinë e babait të tij. Kjo sjellje e nënës së tij kishte ndikuar që, ai të edukohej me një edukatë të vrazhdë dhe dëshirës për hakmarrje. Aliu kaloi rininë e vet me një grup shokësh nëpër male, duke plaçkitur, sulmuar njerëzit, në veçanti armiqtë e babait të tij. Gjatë këtyre aksioneve ai kishte rikthyer një pjesë të pasurisë së babait të tij në Tepelenë. Kronikat e ndryshme flasin se Ali Pasha ka vrarë vëllain, ka burgosur nënën e vet, e cila kishte jetuar vetëm pak ditë pas burgosjes.

Ali Pashë Tepelena

Posa riktheu disa nga pasuritë e babait të vet dhe u bë beg, shfaqi lakminë e tij për ta zgjeruar pushtetin e vet. Në atë kohë valiu i Shkodrës ishte çua në kryengritje kundër Portës së Lartë dhe Aliu shprehu gatishmërinë e tij për ta rikthyer rendin dhe shuajt kryengritjen. Porta e Lartë i lejoi një veprim të këtillë, Ali Pasha shoi kryengritjen duke mbytur valin kryengritës. Për këtë veprim Porta e lartë e shpërbleu, që ai të ketë të drejtë t'i gëzojë të gjitha pronat e tij si dhe e caktoi ndihmës të Drevendes së Pashës së Rumelisë, që ishte përgjegjës për ruajtjen e rrugëve të maleve nga plaçkitësit e shumtë që ishin shfaqur nëpër rrugët malore.

Mirëpo, lakmia e tij për pasuri, kishte bërë që ai t'u shmangej obligimeve të tij. Ai, në vend se të mbante rregullin, bashkëpunonte me plaçkitësit duke marrë pjesë me ta në ndarjen e plaçkës. Qeveria kuptoi këtë dhe e akuzoi kryetarin e tij për një akt të këtillë, duke e pa-

ditur në gjyq. Kryetari u dënua me vdekje, kurse Aliu shpëtoi nga ky proces, pasi që dikush kishte ndërmjetësuar.

Më vonë filloi lufta e vitit 1787, në mes Perandorisë Osmane dhe Perandorisë Ruse. Ali Pasha, ishte në mesin e komandantëve që mori pjesë aktive në këtë luftë, ku tregoi trimëri dhe shkathtësi të rrallë me ç'rast u shpërblua nga sulltani me emërimin e tij vali i Trekalles në Thesali, kur ajo ende nuk ishte pavarësuar, si dhe derven i Rumelisë në të njëjtën kohë me llagapin Pasha. Nuk kaloi vetëm pak kohë dhe ai pastroi vendin nga plaçkitësit, duke i joshur ata të inkuadrohen në radhët e ushtrisë dhe policisë osmane. Me këtë ai formoi një brigadë të posaçme. Në atë kohë në Janinë u paraqiten disa grupe kryengritësish, të cilët i nënshtroi me forcat e tij në vitin 1787 dhe e përmirësoi gjendjen e sigurisë. Kur qeveria osmane pa këto rezultate e caktoi në krye të këtij vilajeti dhe prej atëherë u quajt "Vali i Janinës", me të cilin llagap ai njihet edhe sot në histori.

Kur, Ali Pasha e pa veten në pushtet dhe pothuajse pa konkurrent, sepse këtë ai e kishte arritur me zotësinë dhe shkathtësinë e vet dhe njerëzve të tij, atëherë mendoi ta zgjerojë pushtetin e vet. Për këtë, ai shpikte lloj-lloj shkaqesh për t'i sulmuar fqinjët dhe për ta zgjeruar pushtetin e vet ashtu siç vepronte edhe Mehmet Ali Pasha në Egjipt. Lexuesi mund të vërejë një lloj ngjashmërie në mes biografisë së këtyre dy burrave në shumë aspekte.

Kështu shohim se Ali Pasha zgjeron kufijtë e tij në drejtim të Greqisë, duke pushtuar pjesën perëndimore dhe veriore të saj, krahinën që quhej me emrin Livadija. Ai lakmoi t'i shtijë nën sundimin e tij edhe malet e Suljotëve në jugperëndim të Epirit, luftoi me ta deri në vitin 1803, të cilët më në fund pranuan t'i lëshojnë malet e tyre dhe të vendosen në ishullin e Korfuzit. Ai u siguroi atyre një shpërngulje të sigurt, por posa i lëshuan malet e tyre, njerëzit e tij i zunë dhe prenë në mënyrë tradhtie.

Ali Pasha ishte i vetëdijshëm se lakmitë e tij nuk do të kalojnë pa u ndëshkuar nga ana e Portës së Lartë, për këtë ai ndërmori masat e duhura për ndërtimin e kalave në vend. Në vitin 1797, francezët kishin pushtuar Venedikun, ai kishte dëgjuar për trimëritë e francezëve

dhe përparimin e tyre në ndërtimin e kështjellave. Andaj, ai dëshiroi të shkojë hapave të tyre për çka ra në kontakt me Napolonin dhe kërkoi prej tij t'i dërgojë disa inxhinierë për planifikimin dhe ndërtimin e disa kështjellave në vilajetin e Janinës. Inxhinierët erdhën dhe ndërtuan disa kështjella në Janinë, të cilat ekzistojnë edhe sot. Këtu vlen të shtojmë se vetë natyra e Janinës dhe malet e saj ishin mbrojtëse të natyrshme të këtij qyteti. Numri i banorëve të Janinës ishte 35.000 myslimanë, të krishterë dhe bohimianë.

Nuk kaloi shumë kohë dhe ekspedita e Napolonit në Egjipt kishte dështuar, Ali Pasha shfrytëzoi këtë rast dhe i dëboi francezët nga Preveza në gjirin e Artës, pastaj mori bekimin e sulltanit për territoret që ai kishte pushtuar. Kështu që pushteti i tij pothuajse shtrihej në pjesën më të madhe të Shqipërisë, duke filluar prej Malit të Zi e deri në Epir. Nuk shkoi shumë kohë dhe në vitin 1817 ia bashkoi shtetit të tij Epirin, një pjesë të Thesalisë dhe pjesën perëndimore të veriut të Greqisë. Njërin prej bijve të tij e kishte vendosur në krye të qeverisë së Morës, kështu që pushteti i tij ishte zgjeruar shumë.

Kjo sjellje e tij nuk ishte parë me sy të mirë nga ana e Portës së Lartë në Stamboll, andaj ajo ishte e interesuar për likuidimin e tij, por mungonte ideja se si të realizohej kjo. Ali Pasha në atë kohë ishte në moshën 80-vjeçare. Nuk deshi fati që shteti i tij të mbijetojë ashtu siç mbijetoi shteti i Mehmet Ali Pashës në luginën e lumit Nil. Një oficer i ushtrisë së tij i ishte bashkangjitur ushtrisë osmane në Stamboll. Ky akt e kishte hidhëruar pa masë Ali Pashën, derisa ai kishte dërguar dikë që ta vriste atë në vitin 1820. Kjo sjellje e Ali Pashës po ashtu kishte shqetësuar shumë Portën e Lartë. Andaj, në shenjë hakmarrjeje Porta e Lartë kishte kërkuar nga të gjithë valinjtë e Perandorisë në pjesën e Evropës që të bëjnë përgatitjet e duhura për ta mposhtur Ali Pashën. Kjo ekspeditë e Portës së Lartë nuk pati sukses për shkak të pozitës së Janinës dhe kështjellave të saja të shumta. Më në fund, Porta e Lartë e pa të domosdoshme ta ndryshojë politikën e saj dhe për këtë qëllim dërgoi Hurshid Pashën në fillim të vitit 1822, kinse për t'i dërguar Ali Pashës fermanin e faljes së tij nga ana e Sulltanit. Ali Pasha, meqenëse ishte në moshë të shtyrë dhe nuk dëshironte të hyjë në

luftëra të reja me Portën e Lartë pranoi një kompromis të këtillë. Kështu më 5 shkurt 1822, Hurshid Pasha e ftoi Ali Pashën t'ia dorëzojë "hatisherifin" e sulltanit, që kishte të bënte me faljen e tij. Ali Pasha, duke mos ditur se çka fshihej pas këtij shkoi te Hurshid Pasha, u ul pranë tij dhe filluan të bisedojnë. Ndërkohë, Hurshid Pasha e nxori fermanin, që kishte të bënte me vrasjen e tij, për t'ia dorëzuar Ali Pashës. Ali Pasha, posa e pa i habitur nga ky gjest iu kundërvu me tërë fuqinë që kishte, mirëpo meqenëse kundërshtarët e tij ishin më të shumtë në numër e mundën dhe e vranë. Kokën e tij e dërguan në Stamboll. Kështu pra përfundoi edhe shteti i tij, pasi që kishte vazhduar më shumë se tridhjetë vjet.

Historia më e re e Shqipërisë

Shqipëria përsëri u kthye në gjirin e Perandorisë Osmane, por në të njëjtën kohë u filluan edhe kryengritjet e shumta, me anë të cilave populli kërkonte pavarësinë e shtetit shqiptar. Në tërë Shqipërinë mbretëronte një urrejtje ndaj nëpunësve të pushtetit osman. Prej këtyre kryengritjeve më e madhja ishte ajo që kishte ndodhur pas kongresit të Berlinit, sepse në bazë të marrëveshjes së tij territore të mëdha të tokave shqiptare, iu ishin dhënë Malit të Zi në veri dhe Greqisë në jug.

Në veri fuqitë e mëdha në Kongresin e Berlinit kishin vendosur që Plava, Gucia, Shpuzi dhe Podgorica prej tokave shqiptare t'i jepen Principatës së Malit të Zi. Shqiptarët shfrytëzuan tërheqjen e ushtrisë osmane prej këtyre trojeve në vitin 1879 i zunë pozitat e tyre dhe nuk pranonin t'ia dorëzojnë Malit të Zi. Fuqitë e mëdha në shenjë kompromisi në vend të tyre t'ia japin kazanë e Tuzit, por shqiptarët refuzuan. Fuqitë e mëdha propozuan që në vend të tyre t'ia japin limanin e Ulqinit, në detin Adriatik, por këtë nuk e pranoi vet Sulltani. Shqiptarët menjëherë e morën Ulqinin dhe përsëri filluan bisedimet rreth gjetjes së një kompromisi. Më në fund Anglia kërcënoi Portën e Lartë, se nëse ajo nuk ndërmerr masat e duhura për t'i bindur shqiptarët, që ata ta dorëzojnë Ulqinin, ajo do ta okupojë Izmirin. Nën këtë presion dhe

kërcënim të Fuqive të mëdha, Portës së Lartë nuk i mbet asgjë tjetër vetëm të ndërmarrë masat për dorëzimin e Ulqinit. Ulqini iu dorëzua Principatës së Malit të Zi më 27 nëntor 1879, nga i cili u shpërngulën të gjithë shqiptarët.

Akti i dhunshëm i dorëzimit të Ulqinit ishte shkak për mobilizimin e popullit shqiptar dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare në Shqipërinë e veriut. Kështu, sipas shkrimeve të asaj kohe shohim se janë bashkuar mirditasit, të cilët janë katolikë, me myslimanët për t'iu kundërvënë qeverisë së Portës së Lartë në rast se ajo dëshiron t'i detyrojë ata që të dorëzojnë ndonjë pjesë të tokës së tyre sllavëve, të cilët i përkasin Kishës ortodokse. Kështu një numër i madh i përfaqësuesve të tyre u tubuan në Shkodër më 19 prill 1880, nën udhëheqjen e një prifti katolik dhe biseduan për çështjen e bashkimit të tyre, për ruajtjen e tërësisë tokësore. Në mënyrë të veçantë u bisedua rreth Tuzit, i cili gjendet në kufi midis Shqipërisë dhe Malit të Zi. Për këtë qëllim, ata kishin formuar një Këshill të Përgjithshëm me seli në Prizren, në kompetencë të cilit është tubimi i taksave si dhe organizimi administrativ dhe legjislativ i vendit. Më 18 maj 1880 ata dërguan një protestë Fuqive të mëdha kundër dorëzimit të Tuzit, Mali të Zi dhe aty kishin shprehur se askush prej shqiptarëve nuk pranon të jetojë nën pushtetin e sllavëve. Porta e Lartë tregoi kujdes dhe e shoi këtë kryengritje të shqiptarëve. Ajo arrestoi disa prej krerëve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të cilët i dërgoi në Stamboll, në muajin dhjetor 1880. Në mesin e tyre ishte dhe Prenë Bibë Doda, prijësi i katolikëve të Mirditës.

Megjithatë, Lidhja Shqiptare vazhdoi aktivitetin e saj dhe ajo priste fillimin e luftës mes Greqisë dhe Portës së Lartë për të shpallur pavarësinë e Shqipërisë. Ky komision për këtë qëllim u tubua në Shkodër me pëlqimin e Portës së Lartë, anëtarët e të cilit ishin nga myslimanë dhe katolikë, mirëpo, ai nuk arriti në ndonjë vendim meritor, për shkak siç përmendëm më parë të natyrës së shqiptarëve, të cilët nuk mund të gjejnë një fjalë të përbashkët. Kështu, Porta e Lartë dërgoi një ekspeditë ushtarake nën komandën e Dervish Pashës, i cili i shoi të gjitha shpresat e shqiptarëve për pavarësi. Ai dhe ushtria e tij u ballafaqua me rezistencën e forcave të Lidhjes Shqiptare në Ferizaj.

Pastaj e rrethoi Prizrenin, selinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të cilin e mori me forcë duke e shuar Lidhjen e Prizrenit. Në këtë kohë shqiptarët e Lindjes ishin bashkuar rreth Ali Pashë Gucisë, të cilin donin ta kurorëzonin mbret të tyre. Mirëpo, Porta e Lartë i kundërshtoi përpjekjet e tyre dhe bëri që ajo të dështojë, ashtu siç dështoi përpjekja e tyre në Shqipërinë e Veriut.

Kurse, sa i përket jugut, marrëveshja e Kongresit të Berlinit kërkonte që krahina të tëra shqiptare si Janina, Larisa, Preveza dhe Arta t'i jepeshin Greqisë. Shqiptarët nuk kishin asgjë që Thesalia të mbetet nën Greqinë, por ata ishin me këmbëngulje kundër asaj që krahinat shqiptare t'i jepeshin Greqisë siç ishin krahinat e vilajetit të Janinës. Lidhja Shqiptare me këtë rast kishte përkrahjen e plotë të Portës së Lartë. Kështu u organizua një kongres kombëtar gjithë shqiptar në Janinë, ku u morën vesh që Janina t'u mbetet shqiptarëve.

Përfundimi i tërë kësaj është, se marrëveshja e Kongresit të Berlinit kishte zvogëluar sipërfaqen e Shqipërisë për 967 mila katrorë në jug dhe për 265 mila katrorë në veri. Shqiptarët prej asaj kohe janë të mllefosur për këto padrejtësi të mëdha që u janë bërë. Andaj, këto pakënaqësi ata po i shprehin prej kohës në kohë, siç ishin rebelimet e tyre të fundit në Tuzi dhe në Shkodër, përfundon revista "el-Hilal" e Kajros artikullin e saj, para më shumë se nëntëdhjetë e pesë vjetëve.

Përktheu dhe përshtati:
Q. Morina

Marrë nga revista "El-Hilal", vëllimi i tetë,
viti i nëntëmbëdhjetë,
1 maj 1911 (2 xhumadu-l-evvel, 1329)

On the 94-th anniversary of the independence of Albania

Qemajl Morina

FACTS ABOUT ALBANIA – PUBLISHED IN THE "EL-HILAL" MAGAZINE IN CAIRO

(Summary)

A number of interesting facts about the situation in Albania as well as its history and geography, which were published in an article of the "El-Hilal" Magazine in Cairo on May 1, 1911 (a few months prior to the declaration of the independence of Albania).

Due to the recent disturbances in Albania and the uprising of the population in the vilayet of Shkodra, we decided to make a brief presentation about the general situation in Albania as well as its history and geography in order to give those interested the possibility to follow more closely the political developments in that country.

معلومات عن البانيا قبل استقلالها بمجلة إلهلال القاهرية

(خلاصة البحث)

نذكر هنا بعض المعلومات عن الحلة في ألبانيا بمقال تم نشره بمجلة الهلال القاهرية في أول مايو 1911م الموافق الثانى من الجمادى الاول 1329ه، حيث يتناول المقال الجغرافيا و التاريخ و الحالة العامة في البانيا قبل استقلالها.
نظرا للحوادث الاخيرة في ألبانيا و ثورة الشعب بولاية شكودرا ضد الحكومة رأينا من المناسب أن نعطى نبذة مختصرة عن الجفرافيا و التاريخ و الاوضاع العامة بهذا البلد حتى يسهل متابعة التطورات السياسية فيه.

ESE

Avni Aliu

KUPTIMI SHUMËDIMENSIONAL I NAMAZIT
(Ndarja nga bota e njollave dhe takimi me botën e bukurisë)

Në ndërtimin dhe formimin e personalitetit të njeriut, në kujdesin e shpirtit, trupit dhe mendjes, për të qëndruar në rrugën e artë mesatare, me një model mesatar, të balancuar, me një sistem të ekuilibrit, larg teprimit dhe neglizhencës, rol të rëndësishëm zë institucioni i namazit. Namazi është shumë frytdhënës dhe moment i pasur, në të cilin besimtari përtërin lidhjen me burimin e fshehur nga e cila e nxjerr ekzistimin e tij. "Ndarja me botën e njollave, përcjell takimin me botën e bukurisë. Lutja islame (në gjuhën arabe "salat", do të mbetet një "thesar i fshehur, përmbajtjen e së cilës nuk e di askush, përveç atij që e kryen me prezencë të plotë të shpirtit. Allahu na thotë "kryeni lutjen", e nuk thotë "lutuni"…, sepse, namazi i vërtetë është ai, i cili kryhet me pjesëmarrjen e të gjitha organeve pranë zemrës, mendjes dhe shpirtit…", konstaton Dr. Mustafa Mahmud. Nga gjërat që ia rritin vlerën shumëdimensionale namazit është edhe kjo se namazi është i vetmi ibadet adhurimi, i cili nuk është obliguar në tokë, por në qiell, direkt nga Zoti dhe pa ndërmjetësimin e Xhibrilit. Ndodhi kjo me rastin e Miraxhit, do të thotë, ngritjes së Muhammedit a.s., në qiell, në

prani të Allahut në Sidretul Munteha, ku Zoti i flet të Dërguarit direkt dhe pa ndërmjetës.

Prandaj, nëse e synon piedestalin më të lartë të ngritjes, ke për obligim namazin dhe fillo me namaz. Fillo me namaz dhe mos hezito, aq më parë, kur tashmë e ke gjetur adresën e shpirtit tënd, dhe adresën e shpirtit tënd e ke gjetur në momentin kur ke thënë fjalën: "***La ilahe il-lall-llah***". E ke gjetur vendin tënd mbi bazën e vlerave të Imanit, Islamit dhe Ihsanit. Je vendosur në binarë të sigurt. Atëherë fillo me namaz. Përpiqu ta ruash pastërtinë e jetës, dhe pastërtinë e jetës duhet ta ruash si pastërtinë e zemrës. Kur ia mbyll derën djallit, ai përpiqet të krijojë dritare nga ndonjë veprim yti i pakujdesshëm, në mënyrë që, kështu, të depërtojë në brendësinë tënde. Prandaj kujdes! Ndjellakeqit të mos i lësh as vrimë të hapur. Se po e bëre një hap në jetë që s'përkon me kodin e moralit të shëndoshë islam, ia ke vënë një njollë të zezë zemrës. E kjo është e rrezikshme. Sa ka mundësi që njeriu dalëngadalë të adaptohet në një ambient ku mëkati është evident, dhe kështu zemrën e vet tërësisht ta bëjë të zezë. Dhe kur zemra bëhet tërësisht e zezë nga njollat e zeza, atëherë ajo shndërrohet në gjenerator, i cili prodhon të këqija dhe mbështet ato në njërën anë, dhe nuk lejon realizimin e të mirave në anën tjetër. Këtij njeriu mëkatmadh ndryshe i thuhet njeri-zemërzi. Sa zemërzi që ishte – thonë për dikë që është i tillë. Thuhet kur bie mjegulla s'shihet dielli. Dua të të përkujtoj se mëkatet janë një lloj tymnaje që të pengojnë të shohësh dritën e Zotit. Dhe jo vetëm që pengojnë të shohësh, por ato pengojnë që drita e Zotit të të hyjë në zemër. Prandaj, Muhammedi a.s., na tërheq vërejtjen me një hadith, të cilin e transmeton Muslimi dhe En-Nevevija. Dhe, si thash, pasi je vendosur në binarë të shëndoshë, tash të ka mbetur rruga deri te caku. Prandaj, fillo me namaz. Hapi parë yt le të jetë namazi. Namazi të ndihmon të ruhesh nga mëkatet. Namazi është ilaç kundër dukurive johumane dhe jocivilizuese. Kur'ani shprehet kështu: "*Vërtet namazi të largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat*".[1] Namazi nuk lejon të të mbulojë mjegulla dhe retë e zeza plot stuhi të sisteme-

[1] Kur'ani, sura El Ankebut, ajeti 45.

ve të pasioneve. Ashtu si rrezet e diellit që më në fund me vazhdimësinë e tyre e zhdavaritin mjegullën, ashtu edhe namazi dhe këmbëngulësia jote në namaz më në fund të ruan për të mos rënë në pushtimin e asaj që e quajmë pasion. Prandaj, qëllimi dhe dëshira jote e vetme, por edhe e të tjerëve le të jetë të falurit e namazit. Sepse, ndërmjet njeriut që fal namazin dhe atij që nuk falet, apo ndërmjet një populli që e fal namazin dhe atij që nuk e fal ekziston një dallim shumë i madh, sikur ndërmjet të zgjuarve dhe atyre të rënë në gjumë. Të sjellim një krahasim paksa më ndryshe: dallimi i njeriut që falet dhe i atij që nuk falet është sikurse në një shtet, të cilin, një pjesë e popullit e respekton, kurse pjesa tjetër jo. Me siguri unë, ti, ne të gjithë nuk duam që të jemi të tillë, si të vdekur - jo, por duam të jemi të gjallë e me ndjenja të zgjuara. Duam që ne të gjithë ta respektojmë Allahun. Ky duhet të jetë qëllimi i të gjithëve që i thonë vetes myslimman. "*Vërtet, namazi është obligim për besimtarët në kohë të caktuar*".[2] Ky është obligimi më i madh i njerëzve ndaj Allahut dhe e drejta e myslimanëve. Dhe nëse çdo njeri fillon të falë namazin, e dini se ç'fitojmë? Do të fitojmë edhe këtë botë edhe Ahiretin. Fitimi i Ahiretit është i qartë: Xhenneti."Çelësi i Xhennetit është namazi".[3] Pastaj mbetet që ta fitojmë jetën e kësaj bote-dynjanë, dhe kjo ndahet në dy drejtime: 1) Ato që i ka ndaluar Allahu, me të cilat shpirti ynë nuk kënaqet, pra, paturpësitë, të këqijat, të ligat, të irrituarat, të pamoralshmet të flaken, dhe 2) Ato që ka urdhëruar Allahu dhe që i përshtaten moralit të njeriut, pra, ato punë të mira, të bukura, të moralshme, të mbahen dhe të përparohen.

Dhe, për të ngritur një shtet, a nuk mjaftojnë këto?! Do të thotë, ato të moralshmet të pranohen, kurse të pamoralshmet të çrrënjosen, të zhduken tërësisht. E, namazi këtë do ta argumentojë. Namazi e lidh njeriun me Zotin, dhe ai këtë lidhje çdo ditë e përtërinë, e freskon, e forcon duke e mbajtur kontinuitetin e tij. Njeriu që falet pesë herë në ditë e ushqen shpirtin e tij, e ndriçon me nurin e Allahut, rrezet e të

[2] Kur'ani, sura En-Nisa, ajeti 193.
[3] Hadith. Transmeton Tirmidhiu.

cilit depërtojnë në skutat më të thella e më të fshehura të shpirtit. Myslimani pesë herë në ditë qëndron para Allahut, merr forcë dhe ushqehet nga burimi i pashtershëm i fisnikërisë dhe bukurisë, por e jep edhe provimin e vet. Në një atmosferë të tillë të ndriçuar me afërsinë hyjnore, ku shpirti lirohet dhe hapet plotësisht, ku gjithçka bëhet e qartë, e pranishme, e dukshme, e afërt, e sheshtë, njeriu ushtron ndjenjën e vetëkontrollit dhe vetëkritikës. Aty kurrgjë nuk mund të fshihet. Gjithçka i nënshtrohet dijes së Zotit. Për këtë arsye namazi i vërtetë, i falur me një kujdes të veçantë, është kulminacioni i sinqeritetit. Një njeri a një popull që e fal namazin, nuk do të lejojë të bjerë nën ndikimin e amoralizmit, nihilizmit, hedonizmit, korrupsionit, kontrabandizmit, trafikimit të qenieve njerëzore, alkoolizmit, prostitucionit, homoseksualizmit, shkatërrimit familjar, e sa e sa të zeza tjera që e torturojnë njerëzimin. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të familjes, 15 Maj 2006, jepen edhe këto shënime rrëqethëse, ku ndër të tjera thuhet: "Sot miliona fëmijë janë bonjakë, sepse nënat e tyre vdesin nga komplikimet e shtatzënësisë dhe lindjes, ose nga SIDA. Me siguri se mundemi të bëjmë më mirë dhe më shumë…, thërret UNFPA komunitetet dhe popujt. Shumë jetë mund të shpëtohen, dhe familjet të forcohen… Gjithashtu të rëndësishme janë edhe politikat mike familjare që ndihmojnë prindërit që t'i balancojnë përgjegjësitë e punës dhe shtëpisë dhe marrëdhënie të barabarta brenda familjes…", konstaton Thoraya Ahmed Obaid, drejtoreshë ekzekutive e UNFPA-së.[4] Të dhënat e Eurostatit që kanë të bëjnë me martesat, ndarjet, lidhshmërinë si dhe me shpenzimet japin këto shënime: "Në çdo 2 martesa, njëra përfundon me ndarje, një e treta e fëmijëve lindin jashtë martese, dy të tretat e çiftëve nuk bëjnë më fëmijë dhe, së fundi, më shumë se një e pesta e shpenzimeve të familjes përdoren për të blerë shtëpi… Të dhënat tregojnë se martesa po e humb gjithnjë e më shumë forcën e dikurshme dhe po zëvendësohet me forma të reja marrëdhëniesh, si bashkëjetesa, raportet e përkohshme, çiftet homoseksuale etj. Kjo ka sjellë, për pasojë, uljen graduale të lindshmërisë dhe plakjen e popullsisë në Evro-

[4] Gazeta "Zëri", dt. 15 Maj, 2006, f. 10.

që si dhe ndryshimin e raporteve mes fëmijëve e prindërve, gjyshërve etj. Ka intelektualë perëndimorë që, pasi kanë njohur jetën dhe zakonet e shqiptarëve, disa gjëra që ruhen ende, si dashuria për fëmijët e familjen, për prindërit e gjyshërit, marrëdhëniet midis brezave, respektimi i të moshuarve, i njerëzve të vdekur, ndihma ndaj fqinjit apo mikut në ditë të vështira etj. Na këshillojnë me sinqeritet: "Kujdes! Mos ndiqni modelin tonë të zhvillimit!" Sepse ata shohin te ne disa shprehi të një mënyre jetese që, ose nuk ka ekzistuar kurrë tek ata, ose ka qenë dikur dhe qytetërimi modern e ka zhdukur pa lënë gjurmë… Drama që ndodhi verën e vitit 2003 në Francë, kur nga vapa vdiqën, mbi 15 mijë të moshuar, vetëm se s'kishte kush t'u jepte një gotë ujë, ilaçe apo t'u kryente një shërbim sado të vogël, e shpjegon më së miri fenomenin e braktisjes së prindërve e të gjyshërve në shoqërinë perëndimore. Meqë kur flasim për familjet perëndimore (përfshirë edhe atë amerikane), nuk mund të mos vihet re goditja që ajo ka marrë nga liberalizmi seksual i filluar që nga vitet '70. Aq sa tani studimet tregojnë se 30-40 për qind të fëmijëve rriten në familje me një prind dhe sidomos pa baballarë, gjë që po sjell probleme në rritjen dhe edukimin e tyre. Imagjinoni që pas disa vitesh do të ketë shumë më tepër fëmijë që do të adaptohen nga familjet homoseksuale. Ose, fjala vjen, largimi i nipërve e i mbesave nga shtëpitë e gjyshërve dhe zëvendësimi i tyre prej qenve e maceve, ose dërgimi i të moshuarve nëpër azile dhe mosinteresimi për ta është rezultat i një procesi të gjatë e të ndërlikuar, të cilin në Perëndim e solli jeta moderne dhe individualizmi", thotë Gjovalin Kola, Bruksel, kur shkruan për temën "Familja shqiptare dhe modeli perëndimor".[5] E pra, duhet të jemi të vetëdijshëm se ç'duhet të marrim dhe prej kujt duhet të marrim; çka duhet të pranojmë dhe çka jo nga "jeta moderne" perëndimore. "Ai që nuk është i vetëdijshëm se ç'duhet marrë prej Perëndimit, i ngjan njeriut që qëndron para një dollapi përplot ilaçe dhe merr vetëm ato që i pëlqejnë nga ngjyra", thotë prof. dr. Abdulhamid Ebu Sulejman, ish-rektor i Universitetit Islam Ndërkombëtar në Malajzi. Nga të dhënat e mësipërme na bëhet edhe

[5] Gazeta "Zëri", dt. 15 maj, 2006, f. 6.

më e qartë në peshë rëndësia e edukatës fetare islame në familjet tona dhe roli i namazit në ngritjen e saj. Afër mendsh, në familjet ku falet namazi zotëron harmoni e plotë familjare, bashkëshortët nuk tradhtojnë njëri-tjetrin, familjet nuk shpërbëhen, fëmijët nuk do të mbeten jetimë pa nënë e pa babë, dhe ata fëmijë të mbështjellë e të panjohur nuk do të lihen në oborret e xhamive e nëpër deponitë e bërllokut. Thjesht, nëse të gjithë banorët e një vendi e falin namazin, aty në atë vend nuk mund të ekzistojë e keqja dhe e liga. Sepse namazi nuk ia jep të drejtën. Namazi, vërtet, shëron virusin e çdo dukurie johumane, jocivilizuese dhe patologjike. Shiko se ç'na mëson Krijuesi ynë: ***"Ti lexo atë që po të shpallet nga libri*** *(Kur'ani),* ***fale namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat-Allahu e di se ç'punoni ju***".[6]

Shiko veten: si je krijuar, si je rritur, si ka filluar planeti në të cilin ti jeton, lexo bukuritë e universit. Përherë vlen të përmendet tregimi i njeriut dhe profetit të parë, Ademit a.s., andaj të mësosh që ta kuptosh më mirë këtë çështje, e të thuash në vetvete: "*O Allahu im, Ty të takojnë të gjitha falënderimet… Sikur të mos ishe Ti, o Zot i Madh, unë nuk do të isha*". Shiko përreth vetes, ke të gjithë mirësitë e Allahut. Ato janë të panumërta dhe të pallogaritshme. Po, me që ekziston Zoti i cili na ka ushqyer e rritur me gjithë këto të mira, ekziston edhe adhurimi ndaj Tij. Është Zoti që i jep trajtë këtij mendimi për adhurim që ekziston potencialisht në ndërgjegjen e njeriut: "*Do ta vë fytyrën për tokë e nuk do ta ngre kokën deri në kiamet… Përballë madhështisë Tënde do të qëndroj i përthyer më dysh…*" Dhe fjalët e Lutësit të Madh: *"Gjunjët ku i ke, o Zoti im, kokën të vë!..."* E dikujt tjetër: *"Ku është ajo dora jote e bekuar që e ndiej mbi kokën time!..."* Në çastet kur njeriu, me një ashk hyjnor të tillë, me emocione hyjnore, as vetë nuk e di se ç'thotë, revelacioni qiellor, duke zbritur mbi ne me anë të idesë së vërtetë të adhurimit, me anë të trajtës e të kuptimit të adhurimit, pa u dhënë mundësi shmangies e çalimit të mendimeve, do t'i

[6] Kur'ani, sura El Ankebut, ajeti 45.

përçojë ashkun dhe emocionet tona sipas urdhrave të Krijuesit. Me fjalë të tjera, sikur Zoti i thotë njeriut:

"Unë jam Zoti yt dhe ti je robi im. Më njohe mua me anë të të mirave që të kam dhuruar. Edhe unë kam për të të mësuar ty edukatën e adhurimit. Në audiencën time vihet në këtë mënyrë: Në fillim merret abdest, pastaj, kur hyhet brenda, thuhet "I madh Ti je, Allahu im, çdo gjë tjetër është e vogël dhe e pavlerë" që do të thotë ta mbytësh në vetvete egon tënde, qëndrohet me duar të lidhura, drejt, plotësisht i vetëdijshëm për qenien tënde rob i Zotit dhe kjo vetëdije e ky qëndrim thellohen sa të jetë e mundur. Atëherë, nën hijen e miraxhit, sipas nivelit të secilit, zgjohet dëshira për t'u ngjitur në ato lartësi ku qe ngjitur Pejgamberi ynë, Muhammedi a.s., dhe duke u ngjitur, shkohet në ruku me ndjenjën e falënderimit, sikur që thoshte Pejgamberi ynë a.s., 'O Zot! Ty të jam përulur dhe Ty të besova. Ty të jam nënshtruar; Ty të është përulur me frikë dëgjimi im, shikimi im, truri im, ashti im, nervi im- dhe gjithë ato që mbajnë këmbët e mia - Ty të nënshtrohen', në përuljen e plotë të rukusë arrihet në një dimension të ri dhe bihet në sexhde, ku arrihet një thellësi tjetër sipas përmasave të thjeshtësisë dhe përulësisë së robit. Pastaj ngrihet, merret frymë dhe, në kërkim të një thellimi tjetër, bihet në sexhden e dytë. Në sexhdet ndihet në ndërgjegje urdhri: "Çasti kur robi gjendet më afër me Zotin e vet, është çasti i sexhdes. Kur të bini në sexhde, bëjini Zotit shumë lutje. Muhammedi a.s., kështu lutej: 'O Zot, Ty të kam bërë sexhde, Ty të besova, Ty të jam nënshtruar, fytyra ime i bën sexhde Atij i cili e ka krijuar dhe e ka zbukuruar dhe që ia ka krijuar veshët dhe sytë, i Madhërishëm qoftë Allahu, Krijuesi më i mirë'!. Dhe me anë të fshehtës "Ve tekallu-beke fissaxhidin", "Dhe të sheh mes atyre që bëjnë sexhde…"[7] mes namazit të vërtetë, mes rënieve në sexhde sipas kapacitetit të secilit, arrihet në miraxh që konsiderohet esencialja e namazit".[8] Oh! Sikur të jemi të shkrirë në besimin e vërtetë pranë e pranë në të njëjtin saf, etër, nëna, vëllezër, motra, burra, gra, vajza… Mjerë ato qenie

[7] Kur'ani, sura Esh-Shuara, ajeti 219.

[8] Fethullah Gylen, Lëkundjet që solli shekulli, 2, f.47-48, krahaso Said Ali Kahtani, Mburoja e myslimanit, f. 52-57.

njerëzore që nuk e kanë shijuar ëmbëlsinë e jetës. Nuk e ka shijuar ëmbëlsinë e kësaj bote ai i cili ka qenë i privuar nga të falurit e namazit. Ibni Tejmije ka thënë: "Të varfër janë ata banorë të tokës, që kanë dalë prej kësaj bote pa e shijuar ëmbëlsinë e saj" Në pyetjen se ç'është ëmbëlsia e kësaj bote - është përgjigjur: "Dashuria e Allahut".

Besimtarët e periudhës së Muhammedit a.s., gjithnjë ishin të interesuar vetëm për të mësuar e për të forcuar ndershmërinë dhe karakterin e tyre.

- Hoxhë, a nuk është kjo paksa e përgjithësuar? Më konkrete diçka, mund të sillni ndonjë shembull?- pyeti një djalë i ri, plot vullnet që rrinte ulur në një qoshe të konakut, të cilin nuk e kisha vërejtur deri atë çast.

- Posi jo? - thash, dhe më theri një fije e hollë mendimi se m'u duk u nguta kur i thash "posi jo". Për t'u arsyetuar disi e për ta zbutur një çikëz shprehjen time, para se t'i përgjigjesha në pyetjen, fillova të flas paksa për veten, për të mos thënë, për një defekt që, zakonisht, vihet në dukje te shumë kolegë të mi. Ndaj, thash: Edhe ne hoxhallarët, jemi njerëz e kemi një shpirt të brishtë si çdo qenie njerëzore dhe, duke dashur që gjithnjë të ecim drejt gjatë shtigjeve të arsyes hyjnore, që në fillim të fjalëve tona për ndonjë çështje apo për diçka që duam të flasim - ia shprehim falënderimet Allahut. Mirëpo, ndodh shpesh që pas kësaj të vazhdojmë diskutimin, pa e paralajmëruar xhematin e xhamisë apo të konakut se për ç'temë e kemi fjalën apo ç'duam të flasim. Pastaj, shpeshherë themi se një sehab, shokë i Muhammedit a.s., ishte kështu apo ashtu, bëri këtë apo atë pa e përmendur me emër e mbiemër, ose flasim në shumës për shokët e tij kur duam t'i marrin shembull, etj., etj. E ky është një defekt yni me siguri, që, duhet ndrequr. Mbase na mungon, jo të gjithëve, metodika e punës në kryerjen e detyrës.

Shëmbëlltyra e karakterit të namazliut

Ishte ky Urvetu Ibn Zubejri, Zoti e bekoftë, djali i zonjës Esma, motrës së Aishes, njëri ndër shokët e Muhammedit a.s., ëmbëlsinë e të cilit nuk mund ta kuptojë askush që, në afërsi të Allahut, nuk i ka përjetuar rekatet e namazit me ashk paqeje të thellë shpirtërore. Njërën këmbë të tij e kishte goditur gangrena dhe mjekët e këshillojnë se këmba duhej prerë, përndryshe gangrena do të përhapej në pjesën tjetër të trupit dhe do ta vriste. Kur mjekët u përgatitën për t'ia prerë këmbën, e patën pyetur nëse ai donte të merrte anestezion për të lehtësuar dhembjen. Të marrë anestezion, pyeti me habi Zubejri!? Jo,jo! Allahu po më sprovon mua që të shoh se deri ku shkon durimi im. Si mund të shkoj kundër urdhrave të Tij?!. Të largoj zemrën dhe gjuhën nga të përmendurit e Allahut?! Jo, jo! Jo pasha Allahun, kurrë jo! Punë që s'bëhet!" Nuk dua të prehet asnjë pjesë e trupit tim e unë të ndodhem në pozitën e të vdekurit!. Kurrë jo!" Atëherë mjekët i propozuan: -" Pra, lejon të kapin shokët që të të mbajnë?" - "Të më mbajnë?"- pyeti Zubejri, dhe shtoi: - " Mos u merakosni, unë ju ndihmoj juve për shpirtin tim". Mjekët, duke insistuar i thanë: - "Nuk ke mundësi, nuk mundesh!". Ndërsa ky, krejtësisht i qartë për qëndrimin e vet të palëkundur, me atë pamjen serioze, të dëlirë e të çelur, ua ktheu prerë: -"Më lejoni të falem dhe, kur të më gjeni të palëvizshëm, veç më kanë pushuar pjesët e trupit tim dhe janë përforcuar, atëherë ju preni derisa të bie në sexhde. E kur të bie në sexhde, unë më nuk jam në këtë botë, atëherë bëni me mua ç'të doni!". Kështu, Zubejri nisi faljen e namazit, ndërsa mjeku që ishte në pritje me shokët e tij, mori prerësen dhe kur ai kishte rënë në sexhde dhe ishte shkrirë në dashurinë e Allahut, duke thënë pranë Tij "La ilahe il-lall-llah", jam i kënaqur me Allahun - Zot, Islamin – Fe dhe Muhammedin – Pejgamber", këmbën ia kishin prerë. Sa gjë e madhe është të jesh i dashuruar në Allahun. Çfarë force! Çfarë guximi dhe durimi! Zemra bëhet heroike, kur je në namaz. Ajo përbëhet nga dëlirësia. Ajo s'mbështetet mbi asgjë tjetër veçse në Allahun. Është aq e fisme sa në rrafshin e saj nuk

mund të lëshojë rrënjë e padenja, "ashtu siç nuk mund të lëshojë rrënjë një hithër mbi një akullnajë". Kishte besim dhe ky i mjaftonte për të qenë i lumtur. Imani që i mbushte shpirtin ia shtonte durimin dhe pastërtinë e pakrahasueshme të qenies së tij të dëlirë dhe të guximshëm. Ishte i qetë dhe i lutej Zotit. Dhe kur t'i falesh Zotit e t'i lutesh, puna pastaj shkon gjithmonë shumë mirë, sepse Zoti të del në ndihmë. Kur e përfundoi namazin, ia paraqitën këmbën. Ishte këmba e Zubejrit me të cilën kurrë nuk kishte shkelur në të ndaluarat e Allahut. Shputa dhe gishtërinjtë e saj kurrë s'ishin përlye në haram. Zubejri po e shikonte këmbën e vet dhe thoshte: -" Betohem në Allahun, në Atë që më ka vënë mbi ty për të ecur, unë kurrë nuk të përdora ty në ndonjë vend të veprës së keqe, as në ndonjë vend ku Allahu nuk do të donte që unë të isha. Sa e sa kohë të gjatë, oj këmba ime, ke qëndruar e palodhur në namaze nate. Sa e sa herë je ngritur. Me ty, oj këmba ime, këtë e kam bërë vetëm për Allahun". Pastaj ai porositi që këmba duhet të lahej, parfumosej, të mbështillet me një fashë (qefin) dhe të varrosej në varrezat e myslimanëve. Atëherë, njëri nga shokët e tij i quajtur Isa ibn Talha e ngushëlloi me këto fjalë: -"Allahu ka shpëtuar shumicën tënde: mendjen tënde, gjuhën tënde, shikimin tënd, dy duart e tua dhe një prej dy këmbëve të tua. "Gëzohu, o Urve, gëzohu, që një pjesë nga trupi yt të ka paraprirë në Xhennet". -"Pasha Allahun, askush nuk më ka ngushëlluar, nuk më ka këshilluar dhe nuk më ka thënë fjalë më të mira se ti",- u përgjigj Zubejri.[9]

Dhjetë treguesit e sigurt

-Hoxhë, ne kemi parë e kemi dëgjuar se edhe nga namazlitë ka që gabojnë?,-ishte kjo pyetja e një të riu, për të cilin më vonë mora vesh se ishte një student i zgjuar.

- Dëgjo këtu, o dashamiri im-le të përpiqemi të bëjmë dallimin e t'i sqarojmë gjërat më mirë mes njerëzve që falin namazin dhe atyre që duken sikur falen, sepse ekziston ndryshimi mes tyre. Për grupin

[9] Ibn Kajjim el Xhevzi, Durimi dhe përmbajtja, f. 90-91, krahaso Amër Halid, Adhurimet e besimtarit, f. 93.

që duken sikur falen, nuk do të flasim tani. Këtë po e lëmë pak më vonë.

Por, ja që edhe unë po e filloj me një lloj pyetje: A ke menduar, ti, ndonjëherë, se ç'do të thotë "Namaz"?! Thjesht, ky është takim me Allahun e Lartësuar. Bisedë me Allahun e Lartësuar sikur je duke e parë, sepse njeriu, vërtet, në namaz bisedon me Zotin e vet. A ke menduar ndonjëherë për këtë domethënie dhe, a të ka shkuar mendja se kur të thuash "Allahu Ekber", vërtet, Allahu këtë e pranon prej teje dhe shikon në ty, në zemrën tënde?! Muhammedi a.s. në një hadithi kudsijj tregon t'i ketë thënë Allahu xh.sh.: "E kam ndarë namazin mes Meje dhe mes robit tim në dy pjesë dhe për robin tim është ajo që ka kërkuar". Në namaz ndien shijen e ëmbëlsirës vetëm ai që e do Allahun xh.sh. Njëri ndër ata që vërtet e ka dashur Allahun xh.sh., me sinqeritet të plotë ka thënë: "Në zemër ka një plasaritje, nuk e shëron kush pos kthimit te Allahu; në zemër ka egërsi, nuk e zhduk kush, veçse lidhja me të Gjithëmëshirshmin; në zemër ka frikë, s'e eviton kush, veçse kthimi dhe strehimi tek Allahu. A e ke menduar ndonjëherë këtë kuptim shumë domethënës të namazit?! A ke ndjerë ndonjëherë në zemër se ti dëshiron t'i kthehesh Allahut dhe të pohosh me gjuhën tënde: "Unë kam nevojë për fenë Tënde, o Zot. Kam nevojë të të afrohem Ty, o Allah!" ke ndjerë ndonjëherë në zemrën tënde këtë mallëngjim që s'mund ta shuajë askush veçse kënaqësia e Allahut me ty?! Dijetari, Ibn Kajjimi ka thënë: "Nëse njerëzit furnizohen nga kjo botë, ti furnizohu nga Allahu, e nëse njerëzit i gëzohen kësaj bote, ti gëzoju Allahut; nëse njerëzit afrohen te të dashurit e tyre, ti afrohu tek Allahu; e nëse njerëzit shkojnë te sunduesi i tyre dhe te të mëdhenjtë e tyre dhe i lusin që t'i furnizojnë dhe të dashamirësohen me ta, ti dashamirësohu me Allahun dhe lute Atë". A e ndjen ti në zemër se e do Allahun, pyete veten, çfarë dëshiron? Çfarë do nga kjo botë? E do Xhennetin? Pse jeton? Veçoje qëllimin tënd. Ji i vetëdijshëm se përse ekziston. Kjo do të të ndihmojë në çdo hap të jetës sate.

Vullnetmirët e namazit këtë e kanë kuptuar, dhe ata mund të dallohen nga dhjetë tregues të sigurt. Së pari, janë ata që ruajnë kohën e namazit dhe bëjnë përgatitjen e plotë që manifestohet në këtë mënyrë:

falin namazin në kohë të caktuar. Marrin abdest sipas rregullit dhe sipas mënyrës si e ka bërë Muhammedi a.s. Përsëritin fjalët e myezinit çka thotë kur thërret ezanin, dhe pas ezanit bëjnë dua. Vishen me rroba të pastëra dhe të bukura. Krejt këtë bazuar në fjalët e Allahut: "*O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz...*"[10]; së dyti, ata që gjatë faljes së namazit janë të qetë, nuk nxitojnë, por plotësojnë pjesët e namazit si ka hije një nga një, plotësojnë mirë ruqunë dhe sexhden; së treti, ata që kur falen, falen në atë mënyrë sikur janë duke u ndarë nga kjo botë. Prandaj, është e domosdoshme përulësia në çdo namaz, sepse mundet që pikërisht ai namaz të jetë i fundit; së katërti, ata që mendojnë dhe meditojnë rreth ajeteve kur'anore dhe lutjeve të cilat thuhen gjatë faljes së namazit. Për të menduar rreth kuptimeve të ajeteve kur'anore duhet që më parë të posedojmë dituri, kështu që, të kuptojmë drejtë, mirë, saktë domethënien e atyre ajeteve që lexohen gjatë namazit. Kjo është e domosdoshme, nëse duam të ndien shpirti veprimin tonë gjatë namazit; së pesti, ata që ajetet e Kur'anit në namaz i lexojnë një nga një, në përkim me praktikën e Muhammedit a.s.; së gjashti, ata që ajetet e Kur'anit në namaz i lexojnë ngadalë dhe me një ritëm të caktuar, por edhe me zë të bukur, kur falen në namazet në të cilat Kur'ani lexohet me zë. Lidhur me zërin e bukur mendohet në zërin e personit që është më i devotshmi. Muhammedi a.s., ka thënë: "Gjatë leximit të Kur'anit zërin më të këndshëm mes jush e ka ai, për të cilin mendoni se është më i devotshmi, kur dëgjoni se si i lexon ajetet kur'anore"; së shtati, janë ata që i shoqëron bindja e thellë dhe e patundur se Allahu, i Lartësuar u përgjigjet kërkesave të tyre; së teti, ata që e falin namazin me përulësi që buron nga zemra, e kjo nënkupton qetësi dhe përqendrim, të jesh prezent me zemër, pra, të mos shëtisësh me zemrën djathtas e majtas, përulja në namaz është më e rëndësishmja e namazit dhe është truri i tij; së nënti, ata që e falin namazin me frikë e respekt duke qenë të vetëdijshëm se janë para të Lartësuarit dhe Fuqiplotit. Këta mund t'i kuptosh nga sytë dhe nga shprehja e fytyrës së tyre. Ali Ibn Talibi kur ka hyrë në namaz, është

[10] Kur'ani, sura El A'raf, ajeti 31.

dridhur i tëri dhe është zbehur. Kur e kanë pyetur shokët si kështu, ka thënë: "A e dini se kush është në atë moment para meje dhe para kujt po qëndroj?". Shenja e dhjetë është, së fundi, fakti se ata e falin namazin me devotshmëri të plotë, me thjeshtësi dhe modesti, duke mos larguar sytë nga vendi i sexhdes ku do të lëshojnë fytyrën dhe ballin. Kur Muhammedi a.s., ka hyrë në Qabe, sytë e tij kanë qenë të fiksuar në vendin e sexhdes derisa është larguar nga namazi.

Logjika e pagabuar ndërsa natyra e njeriut është e "mangët"

- Megjithatë, nuk janë të pagabuar apo jo?

- Unë nuk thash se këta janë njerëz të pagabuar. Jo. Unë tregova se ç'i karakterizon vullnetmirët e namazit. Përpikëria dhe kujdesi i tyre ndaj namazit është adhurim, kështu që logjika e gabuar është jashtë çdo mundësie, ndërsa gabimi njerëzor është diçka e paevitueshme, sepse natyra njerëzore është e "mangët". Muhammedi a.s., ka thënë: "Çdo bir i Ademit a.s., do të thotë, çdo njeri gabon, mirëpo më i miri prej tyre është ai i cili e kupton gabimin e vet dhe i drejtohet Allahut me pendim (tevbe)". Tregohet se një shok i Muhammedit a.s., i quajtur me emrin Ebu Talha El-Ensari, një ditë derisa po falej në kopshtin e tij, sheh një shpend duke lëvizur mes drunjve gjë që e bën t'i drejtojë sytë kah shpendi, sa që harron se sa rekate nga namazi i ka falur. Pas kësaj ndodhie shkon te i Dërguari a.s., i dëshpëruar e duke qarë dhe e pyet: -"O i Dërguari i Allahut! Derisa isha duke u falur në kopshtin tim, sytë më shkuan kah një shpend që po lëvizte mes degëve të një druri dhe sakaq, harrova sa rekate i kam falur. Meqë më ndodhi ky gabim, kam vendosur që kopshtin tim ta jap lëmoshë në rrugën e Allahut, ndoshta Allahu ka për të më falë"! Pse ky sehab e bëri këtë? Pse u dëshpërua aq sa i rridhnin lotët? Sepse tek ai nuk kishte pos ndonjë mëkati të vogël. Ai s'ishte mësuar të bëjë mëkate. Prandaj, edhe lëvizja e syrit për të u bë gjë e madhe. Kështu besimtari, vullnetmirë i namazit i sheh mëkatet e tij si të mëdha edhe nëse ato janë fare të vogla". Pra, të tillë janë njerëzit vullnetmirë të namazit, që edhe kur

të rrëzohen dinë të ngrihen dhe të vazhdojnë udhën, edhe kur është errësirë, këta e gjejnë dritën.

Veprat vlerësohen sipas nijetit

- Po si qëndron me ata njerëz që duken sikur falen?

- Këtu, në konsideratë duhet marrë nijeti dhe qëllimi i pastër. Muhammedi a.s., ka thënë: "Veprat vlerësohen sipas nijetit dhe çdokujt i takon ajo për çfarë e ka pasur nijetin…" Këtu është shënuar vetëm pjesa e parë e hadithit.[11] Nijeti i njeriut qëndron në zemër. Ne nuk e dimë se ç'ka zemra. Atë mund ta dijë vetëm Allahu, sepse vetëm "syri" i Tij depërton në zemër të njeriut. Allahu vlerëson dhe shpërblen veprat sipas qëllimit – nijetit. Ky dimension i përket vetëm Atij. I vetmi Allahu është që vlerëson dhe di qëllimet intime të njeriut. Dimensioni metafizik i veprës së mirë qëndron në motivin (nijetin), mjetin dhe në punën që bëhet në emër të Allahut. Punës dhe veprës së cilës i mungon kjo anë e dimensionit metafizik nuk mund të kualifikohet si e mirë. Por, ne mund të japim vlerësimin nga pamja e jashtme e një veprimi. Mund të themi se ky apo ai ka vepruar mirë, atëherë kur vepra e tij është në pajtueshmëri të plotë me kodin e rregullave që e kërkojnë dhe e lejojnë kryerjen e atij veprimi. Umer Ibnul Hatabi, më një rast duke e parë një njeri se si po lozte në namaz me mjekrën e vet, kishte thënë: "Sikur t'iu kishte frikësuar zemra, do t'iu kishin frikësuar edhe pjesët e trupit". S'do mend, e ka thënë të vërtetën, sepse "pjesët e trupit janë pasqyrë e zemrës, ndërsa çdo enë e derdhë atë që e posedon". Nëse e shohim një njeri se si nxiton në namaz, pa i kushtuar rëndësinë dhe vëmendjen e duhur, është i pakujdesshëm, ruqunë dhe sexhden e bën me shpejtësi të çuditshme, se si bën lëvizje të ndryshme si të ishte ndonjë vegël e vogël mekanike, pa e përfunduar leximin e sures pas Fatihas mësyn ruqunë, pa u drejtuar mirë mësyn sexhden, se si e shikon orën e dorës gjatë qëndrimit në këmbë në namaz apo gjatë ndejës në teshehud, se si duke u falur në shtëpi i pikasin sytë në ndonjë parregullsi në mur të dhomës a gjetiu dhe, shpejt e

[11] Hadithi është më i gjatë, shih Sahihun e Buhariut, pjesën "El - Iman".

shpejt e kryen namazin për ta ndrequr atë parregullsi, ndërkaq, kur e shohim njeriun se si, duke u falur ngre kokën lart shikon kupolën e xhamisë, apo në fushë qiellin, lumin, kodrën para tij me kilometra larg, etj. Këto janë shenja që japin të kuptosh se më të diçka nuk është në rregull, duket sikur falet. Madje, nëse vjen e manifestohet përulësia e rrejshme gjatë të falurit, për të cilën Hudhejfe ka këshilluar: "Ruajuni përulësisë së rrejshme në namaz" E kanë pyetur:" Ç'është përulësi e rrejshme në namaz?"- Është përgjigjur: - "Kur trupi shfaq përulësi që nuk buron nga zemra". Fudajl ibn Ijad ka thënë: "Sa gjë e shëmtuar është të shohësh njeriun që shfaq përulësi, të cilën nuk e posedon zemra". "Dhe përulësia është në zemër dhe jo në rrudhjen e supeve". Kryelartësia, lavdërimi dhe hipokrizia e tepruar në përulësi janë sjelljet e njeriut i cili do të tregohet para të tjerëve si i mirë, ndërsa shpirti në brendi është përplot pasion dhe lakmi. Besimi jo i sinqertë shfaqet me kryelartësi dhe dyfytyrësi, pa pjesëmarrje të zemrës. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Vjedhësi më i madh është ai që vjedh nga namazi i vet". Dikush nga shokët e pyeti: "O i Dërguari i Allahut, si është e mundur që dikush të vjedhë nga namazi i tij?" "Duke mos i plotësuar mirë ruqunë dhe sexhden",-u përgjigj Muhammedi a.s.[12]

Megjithatë, derisa kjo kategori e njerëzve të shoqërohet në xhami me xhematë, me vullnetmirët dhe me të kujdesshmit e namazit, ka shans që të përmirësohet një ditë. Muhammedi a.s., thotë: "Ka dy kategori njerëzish: Të dijshmit dhe ata që mësojnë, nga të tjerët s'ka dobi".[13] Këshilla e një dijetari është kjo: "Mos u mërzit duke qëndruar para derës së Zotit tënd edhe nëse refuzohesh!!". E kjo do të thotë, nëse nuk realizohet devotshmëria në kërkim të saj, mos u tërhiq, mos u dorëzo, por vazhdo, vazhdo të qëndrosh në përpjekje deri në realizimin e saj, këmbëngulë duke trokitur në derën e Allahut Mëshirëplotë, e s'ka dyshim se Ai, Atij i qofshim falë, ka për të ta hapur derën. Nëse gjenden njerëz që falin namaz, falu edhe ti me ta dhe rri me njerëz të mirë. Shembulli i kësaj është sikurse shembulli i bartësit të parfumit,

[12] Ebu Davudi 1/536, nr. 858.
[13] Hadith. Transmeton Taberaniu.

ose ka për ta dhuruar ty, ose ti e blen nga ai, ose do të ndjesh aromën e tij të mirë". Dhe nëse hapen dyert e Mëshiruesit në kohën para mëngjesit - dhe ajo është koha e përgjigjes së lutjes, siç është sexhdeja - përkulja, shpejto aty - shtrij duart para Madhëruesit dhe thuaji: "Unë, o Zot, jam i varfër, por kërkoj lëmoshë prej teje"…, atëherë do ta ndjesh ëmbëlsinë e shpëtimit dhe ëmbëlsinë e shoqërimit me Mëshiruesin e Lartësuar. Ngase, ca gjëra njeriu i ndien me zemër. Lëre të flasë zemra, e nëse prapë nuk ke sukses, atëherë, ja një këshillë të Imam Gazaliut: "Kërko zemrën tënde në tri vende: 1) kur të lexosh Kur'anin, 2) kur je në namaz dhe 3) kur ta përmendësh Allahun. E nëse nuk e gjen në këto tri vende - lute Allahun të të dhurojë një zemër, përndryshe ti nuk e posedon atë".[14]

Pjesëmarrja e zemrës në namaz

Mund të shtrohet pyetja: Cila është shenja e pjesëmarrjes së zemrës në namaz?

Përgjigja: Shenja specifike është se ajo pranon dritën nga namazi. Pejgamberi Muhammed a.s., ka thënë: "Namazi është dritë" dhe me këtë dritë të namazit duhet të ndriçohet tërë qenia e besimtarit, e cila, së pari shkëlqen në zemrën e tij, ndriçon shpirtin e tij, përhapet dhe pastron ambientin e tij, shkëlqimi i plotë i dritës së namazit ia zbulon të vërtetat e gjërave, të vërtetat e vlerave dhe botëkuptimeve, ashtu që zemra e besimtarit i shikon krejtësisht, në tërësinë e tyre të plotë, pa kurrfarë mbulese, me asgjë të mjegulluara, gjithçka për të është e qartë, e pozicionuar, e vendosur në vendin e vet, merr nga ato çka është në pajtim më urdhrat e Allahut, është e patundur, e qetë, dhe e vendosur në kërkim të afrimit kah i Gjithëmëshirshmi. Të kesh zemër të pastër do të thotë të jetosh cilësitë dhe vetitë e kërkuara në Kur'an për besimtarin. "Me këtë "zemër" nuk nënkuptojmë atë çikë tul e dell të vendosur në anën e majtë përbrenda kraharorit, por nënkuptojmë atë zemër që përdor të gjitha shqisat e tjera si vegla dhe shërbëtore të saj. Kjo zemër për të cilën po bëjmë fjalë, s'është e kësaj bote, por e botës

[14] Amër Halid, Adhurimet e besimtarit, f.28-29 dhe 44.

së padukshme, e ardhur në sferën tonë, të themi, si një tregtar për arsye tregtie dhe, mbase është duke kaluar për në atdheun e vet". Të pesë shqisat e njeriut janë si pesë dyer të hapura në botën e jashtme, por më e çuditshme nga këto është "Zemra", e cila ka një dritare të hapur në botën e padukshme…", thotë Ebu Hamid El Gazaliu, në veprën e vet "*Ballsami i lumturisë"*.

Nëse nuk e kemi thënë në tërësinë e vet, tash po e themi se "shpirti i namazit është nijeti, sinqeriteti, frika dhe përqendrimi, pasi namazi përfshin përmendje të Allahut të Lartësuar, lutje dhe veprime, dhe mospasja e mendjes nuk e realizon qëllimin e lutjeve dhe përmendjes së Allahut, pasi nëse fjalët nuk shprehin atë që është në zemër dhe në mendje. Po kështu nuk arrihet qëllimi i veprimeve, pasi qëndrimi në këmbë nënkupton shërbim dhe gatishmëri, rukuja dhe sexhdeja nënkuptojnë madhërim dhe përgjërim, dhe nëse zemra dhe mendja nuk janë aty, atëherë nuk realizohet domethënia e tyre.

Pa dyshim kur veprimi kryhet i pakuptimtë dhe jodomethënës, mbetet si një pamje pa kuptim që s'tregon asgjë.

Allahu i Madhëruar thotë:

"Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja juaj".[15]

Dhe synimi i tyre është se ajo që arrin tek Allahu xh.sh., është gjendja që mbizotëroi zemrën, aq sa e detyroi atë të bindej e të kryente urdhrat e kërkuara. Kjo është shenja e dytë që tregon ndodhjen e zemrës në namaz.

Pra është domosdoshmëri pjesëmarrja e zemrës dhe vëmendja në namaz, dhe Allahu i cili është Ligjvënës, e fal ndonjë harresë dhe mospërqendrim që ndodh, pasi vëmendja në fillim të tij i jep vlerën edhe pjesës tjetër të tij.

Ka mundësi të arrihet kjo?

Pa dyshim.

Së pari përpiqu të respektosh nocionet dhe dimensionet që plotësojnë gjallërinë dhe i japin jetë namazit, e ato janë:

[15] Kur'ani, sura El Haxh, ajeti 37.

1. Vëmendja. Të kesh vëmendjen në namaz, kjo do të thotë të zbrazësh zemrën nga çdo gjë që të tërheq vëmendjen, shkak i të cilave janë shqetësimet dhe ambiciet. Sa herë të shqetëson një çështje, përpiqu ta largosh atë shqetësim. Nuk ka ilaç për përqëndrimin e vëmendjes veçse të konsiderosh namazin si shqetësim të vetëm.
   Largimi prej brengave, halleve dhe shqetësimeve, forcohet në varësi të forcës së besimit në Ditën e Gjykimit…Kështu sa herë të shohësh mendjen dhe zemrën tënde të mos përqendrohet në namaz, dije se shkaku është dobësimi i besimit, ndaj puno për forcimin e tij.
2. Pjesëmarrja e zemrës në namaz ka shumë rëndësi. Njerëzit mund të bëjnë shumë të mira, mund të tregohen trima e bujarë, por më parë duhet ta shpëtojnë zemrën nga mohimi, politeizmi dhe perversiteti. Në këtë kuptim zemrën duhet rregulluar me Islamin dhe të pajiset me moralin dhe edukatën e Kur'anit. Po që se zemra nuk është e pajisur dhe rregulluar me moralin e përkufizuar e të propozuar nga Kur'ani, nuk është e pastër. Besimtarët që falin namazin përpiqen që në adhurimin e tyre t'i kenë të përqendruara zemrat dhe përmes adhurimit t'i rregullojnë zemrat e tyre. Në këtë kuptim është me rëndësi të kuptohet domethënia e fjalëve, pasi zemra mund të jetë me ty në namaz me fjalët dhe jo me kuptimin e tyre. Prandaj, është e nevojshme të mblidhet mendja për të kuptuar domethënien, duke larguar mendimet që të mundojnë, dhe duke i prerë rrugën burimeve të tyre, se nëse nuk i pritet rruga burimit të mendimeve, ato nuk largohen nga mendja. Burimet, siç thotë Ibn Kudama el Mekdesi, në librin e tij, *Rruga e lumturisë së përjetshme*, mund të jenë të dukshme, siç janë ato që shqetësojnë vështrimin dhe dëgjimin, dhe të brendshme, të cilat janë më të forta dhe më të rrezikshme, si atij që i degëzohen mendimet dhe preokupimet në luginat e dynjasë.

Ilaçi i mendimeve që të mundojnë, nëse është prej burimeve të dukshme dhe të jashtme është largimi i çdo gjëje që preokupon vësh-

trimin që është para teje, si copat e qëndisura etj., dhe të ngulitet vështrimi te vendi i sexhdes.

Nuk duhet lënë përpara gjëra që e shqetësojnë dhe e tërheqin vëmendjen e shqisave të namazliut, pasi Pejgamberi Muhammed a.s., kur u fal në një copë me figura e hoqi dhe tha: "Ajo më largoi vëmendjen nga namazi im i parë".[16]

Dhe nëse shqetësimet vijnë prej burimeve të brendshme, mënyra e shërimit është të kthesh vëmendjen forcërisht tek ajo që lexon në namaz dhe të preokupohet me të. Duhet të përgatitësh para se të fillosh namazin, duke i kryer të gjitha detyrat që të preokupojnë, dhe të përpiqesh shumë për të zbrazur mendjen dhe zemrën nga energjitë negative dhe nga shqetësimet. Duhet të ripërtërish në shpirt kujtimin e ahiretit dhe rëndësinë e qëndrimit para Allahut të Madhëruar. Dhe nëse nuk gjejnë prehje mendimet në këto, përpiqu t'i shkëpusësh lidhjet me ato qejfe që më së shumti anojnë mendimet.

Sëmundja kur arrin të mbizotërojë zemrën, nuk i bën dobi veçse një ilaç i fortë. Dhe kur sëmundja forcohet dhe e tërheq atë që falet, edhe ky e tërheq atë derisa të mbarojë namazin kështu.

Kjo është e ngjashme me shembullin e një njeriu që nën një pemë, që dëshiron të kthjellojë mendjen e tij, dhe zërat e zogjve e shqetësojnë dhe e ngacmojnë atë, ndërsa ai mbante një shkop në dorë për t'i larguar ato. Sapo u kthjellonte e u qetësonte mendja e tij, zogjtë ktheheshin dhe ai merrej me to. Atëherë atij i thanë: Kjo gjë nuk ndërpritet, prandaj nëse dëshiron të shpëtosh, prite pemën.

Kështu është pema e epshit, kur prek zemrën dhe shumohen degët e saj, tërheq mendimet siç tërhiqen zogjtë nga pemët, dhe mizat nga kalbësirat. Dhe shkon jeta e çmuar në largimin e asaj që nuk largohet. Arsyeja dhe shkaku i këtij epshi që sjell gjithë këto mendime është dashuria për dynjanë dhe kënaqësitë e përkohshme në këtë botë duke lënë pas dore ato të ahiretit.

Mirësitë e kësaj jete duhet kërkuar ashtu si duhet kërkuar edhe mirësitë e jetës së ahiretit. Dhe i pari që na mësoi të lutemi për mirë-

[16] Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

sitë e kësaj bote dhe për mirësitë e ahiretit (në jetën e pasme) është Pejgamberi Muhammed a.s., me anë të ajetit të Kur'anit: "O Zoti ynë! Na jep të mira në këtë jetë dhe të mira në jetën tjetër, dhe na ruaj prej dënimit të zjarrit!" Mirëpo, dashuria për mirësitë e dynjasë nuk mund të jetë arsye për humbjen e mirësive të ahiretit.

3. Mundësia e njohjes së Zotit është vetëm me një jetë ndiesore. E vërteta dhe enigma e materies del në pah në raport me nivelin e ndjesive. "E vërteta absolute mund të arrihet vetëm me anë të zemrës. Sepse, diapazoni i mendjes dhe i pesë shqisave është i kufizuar. Ashtu si largësia e pamjes së syrit dhe mundësia e dëgjimit të veshit, edhe kufiri i mendjes është i caktuar. Udhëtimi hyjnor, siç ka vënë re Osman Nuri Topbash, vazhdon pas atij kufiri, me anë të zemrës".[17] Ndaj, ç'i mbetet njeriut? Detyra më e rëndësishme në jetë dhe një preokupim serioz është përgatitja për përtejvdekjen, perspektivën e pafundme. Dhe kjo bëhet vetëm me njohjen e të vërtetës së zemrës, me mbrojtjen e saj prej të këqijave. Sëmundja dhe dobësia e zemrës vjen si rrjedhojë e dy gjërave: e dijes së mbrapshtë dhe nijetit të keq. Në këto dy gjëra ndërlidhen edhe dy sëmundje vdekjeprurëse: devijimi dhe urrejtja. Devijimi është pasojë e dijes së mbrapshtë, kurse urrejtja është pasojë e nijetit të keq. Udhëzimi në rrugën e drejtë përmban ilaçin kundër devijimit. Për këtë arsye lutja për udhëzim në rrugën e drejtë i urdhërohet çdo robi të Zotit që të jetë i udhëzuar dhe i orientuar kah morali i bukur çdo ditë e çdo natë dhe në çdo namaz. Sepse, ekuilibri dhe lumturia në këtë botë dhe shpërblimi në ahiret janë të lidhura me zotërimin e një zemre të shëndosh që është në gjendje çdo çast t'i ruajë vetitë e mira e thelbësore. Siç e sqaruam edhe më parë, me zemër nënkuptojmë ndjenjat, botën ndiesore të njeriut. Gjatë një jete të tërë, zemrat lëkunden mes ndërhyrjeve shpirtërore, do të thotë engjëllore dhe ndërhyrjeve egoistike ose djallëzore. Namazliu duhet të ketë kujdes që zemra e tij të jetë e përqendruar në çdo pjesë të namazit. Sepse, ajo e do ushqimin e vet. "Zemrat mund të qetësohen vetëm duke për-

[17] Osman Nuri Topbash, Vargu u profetëve nën dritën e Kur'anit, pjesa e I-rë, f. 44.

mendur Allahun!" "O ju që besuat! Përmendni shumë Allahun!…"[18] Që të jetë zemra gjithmonë nën ndikimin e klimës pozitive duhet pasur parasysh dy elemente kryesore: a) Njohja e Allahut xh.sh., dhe e Madhështisë së Tij dhe, b) Njohja e egos duke e kuptuar se ajo është skllave. Nga këto dy njohje lind frika dhe përulësia. Prej tyre është edhe shpresa, e cila është shtesë përmbi frikën.

Sa njerëz i nderojnë mbretërit sepse i frikësohen pushtetit të tyre, sikurse edhe shpresojnë mirësitë e tyre. Edhe ai që falet, duhet të shpresojë në shpërblimin e Allahut, sikurse edhe të frikësohet nga moskryerja mirë e tij prej dënimit.

Zemra që është duke përmendur Allahun, merret nën mbrojtjen e Tij. Dhe sa herë që të përmendim emrin e Zotit në këtë botë, aq herë do të bëhemi të denjë nesër për bashkimin me Të. Prandaj, jemi të detyruar që çdo çast të përkujtojmë Allahun. Nëse dëgjojmë thirrjen e myezinit, le të përfytyrojmë thirrjen për ringjallje, dhe le të përgatitemi për t'u përgjigjur; secili prej nesh le të shohë se ç'përgjigje do të japë dhe në cilin grup ringjallet. Ai që falet, kur të mbulojë pjesët e turpshme të trupit të tij nga njerëzit, le të kujtojë të fshehtat e brendshme të tij dhe sekretet e turpshme të tij që nuk i din askush veç Krijuesit, dhe që nuk mund t'i mbulojë dot prej Tij. Ato i shlyen pendimi, turpi dhe frika. Ai që falet, kur drejtohet nga Kibla, ka kthyer fytyrën e tij në drejtim të shtëpisë së Allaht xh.sh., dhe drejtimi i zemrës së tij nga Allahu është më primare dhe më e rëndësishme. Sikurse ai që nuk mund të drejtohet në drejtim të shtëpisë së Allahut (Qabes), përveçse duke lënë drejtimet e tjera, po ashtu edhe zemra nuk i dedikohet Allahut të Madhëruar veçse duke u larguar nga gjithçka tjetër veç Tij.

Ti o njeri që falesh!

Kur të përmendësh emrin e Zotit sa është i pranishëm prestigji i Tij në zemrën tënde? Emri i lartë i Allahut është fjala në gojë të robërve të zgjedhur. Sa kohë që të jenë në këmbë këta robër të zgjedhur, kiameti nuk do të shpërthejë. Me ata e ruan Zoti jetën fetare, Islamin dhe vendi ku ndodhen ata, është i ruajtur.

[18] Kur'ani, sura Er-Ra'd, ajeti 28 dhe sura El Ahzab, ajeti 41.

Kur të thuash "*Allahu Ekber*", ki kujdes se mos e përgënjeshtron zemra gjuhën tënde, pasi nëse në zemrën tënde ka gjë më të madhe se Allahu i Madhëruar ti ke gënjyer. Ruaju të mos jetë epshi yt më i madh për ty. Provë për këtë është prirja jote për ndjekjen e epshit ndaj bindjes së Allahut.

Kur të thuash "*Eudhu bil-lahi minesh-shejtanir-rraxhim*", dije se ajo është kërkim mbrojtje tek Allahu xh.sh., nga djalli i mallkuar, e nëse nuk e ke kërkuar atë me zemër, fjala jote është e kotë.

Përpiqu të kuptosh edhe domethënien e asaj që lexon në namaz. Kujtoji me zemrën tënde fjalët *"Elhamdu lil-lahi rabbil alemiin*" Falënderimi është vetëm për Allahun, Krijuesin e të gjitha botëve, sill ndër mendje dhe kujto se po e falënderon Allahun për mirësitë që të ka dhuruar qysh në barkun e nënës, qysh kur të ka nxjerrë në dritë e deri në vdekje. Sepse është Ai që i krijon të gjitha të mirat dhe jo dikush tjetër. Pra edhe të gjitha falënderimet i bëhen vetëm Atij e jo dikujt tjetër. Meqenëse Krijuesi i gjithkujt dhe i gjithçkaje është vetëm Allahu prandaj u tha "*Elhamdu Lil-lah…*" që tregon se Zoti ynë, para të Cilit qëndrojmë në namaz,- është i gjallë, i ditur, i fuqishëm dhe veprues me dijen e vet. Dhe secili le të mendohet se çdo grimcë e të gjithë botëve, ka nevojë për edukimin e Zotit, prandaj le t'ia bëjnë falënderimet vetëm Madhërisë së Tij. Mendo: Allahu është i vetmi Krijues. Ai rrit dhe e plotëson çdo krijesë. Ai i mban dhe i rregullon të gjithë botët. Kurse për të treguar se mëshira e Tij përfshin të gjitha krijesat, kujto kur thua: "*Err-rrahmanirr-rrahiim*"-Mëshiruesi, Mëshirëbërësi. Ai është shumë i Mëshirshëm, është shumë Falës e shumë Dhurues. Gjithkujt në këtë jetë i dhuron të mirat dhe mbas vdekjes; në jetën e pasosur u jep pa masë të gjithë atyre që besojnë në të vërtetën.

Dhe kur thua "*Maliki jeumiddiin*", Zotëruesi e Sunduesi i ditës së Gjykimit, shijo Madhështinë e Allahut, në dorën e të Cilit është i gjithë sundimi. "Shpikësi e mbajtësi i gjithësisë, dhuruesi i çdo të mire, Allahu me madhërinë e vet, është Zoti i ditës së gjykimit e Zoti i botës së ahiretit. Në ahiret zotëruesi e përdoruesi i çdo sendi është vetëm

Allahu, me madhërinë e vet. Në atë ditë, përveç Tij, nuk ka pronar tjetër".

Dhe kur të thuash "*Ijjake na'budu ve ijjake nesteiin*", - "O, Zot! Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë", përjeto afërsinë që ke arritur pranë Allahut dhe dëgjo zemrën tënde a është zbrazur nga sendet e tjera. Tani je shumë më afër Zotit, sikur ta kesh Atë para syve. H. Hafiz Ibrahim Dalliu këtë ajet, në tefsirin e tij "Ajka e kuptimeve të Kur'ani Kerimit", e komenton kështu: "Deri tani kënduesi i Fatihasë i ka sjellë fjalët në trajtën e vetes së tretë dhe tha: Lavdërimi është vetëm për Allahun, Zotin e të gjithë botëve. Ai është mëshiruesi i madh. Ai është Zoti e sunduesi i ditës së gjykimit. Tani fjala është sjellë në veten e dytë dhe i drejtohet Zotit sikur ta kesh Atë para syve dhe tha: O Zot! Vetëm Ty të adhurojmë! Kënduesi tha ashtu për të treguar se Zoti, me madhërinë e vet, pasi u cilësua me vetitë e larta, u shqua krejt në sytë e tij. Dhe në këtë mënyrë ligjërata do të thotë: "O Zot! Më parë të njihja Ty me mend e me arsye, por tani, njohja ime ka arritur në atë shkallë, sa më duket sikur të shikoj me sy. Nëse kënduesi do të thotë "Vetëm Atë adhurojmë", thënia do të ishte e pasaktë. "Vetëm Ty të adhurojmë",- fjala ka ardhur në trajtën e shumësit, për të treguar se jo vetëm ai, por edhe bashkëfalësit, Zotin adhurojnë. Kënduesi e solli fjalën në këtë trajtë, sepse ai i shoqëron vetes edhe vëllezërit e motrat e fesë në faljet e në lutjet e tij dhe, meqenëse ndër ta gjenden edhe engjëjt e njerëzit e shenjtë, ai ka shpresë të madhe që i pranohet falja e lutja nga Zoti… Fjala ka ardhur në trajtën e shumësit për të theksuar se vepra e mirë që bëhet me shumë shokë është më e vlerësuar e më e pëlqyer te Zoti, sesa ajo që bëhet vetëm".[19] I Dërguari Muhammed a.s., ka thënë: "Namazi në xhematë është më i vlefshëm se namazi individual njëzeteshtatë herë (gradë)".[20] Ndërsa kur thua *"Ve ijjake nesteiin*", - "Dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë", përkujto se vetëm Zoti është i fuqishëm t'i japë njeriut atë që do t'i kërkojë. "Në të dyja pjesët e ajetit me parafjalën "Ijjake", Zoti thekson se ashtu siç nuk vlen t'i bëhet adhurim dikujt tjetër e daçkaje tjetër përveç Zotit, ashtu nuk vlen edhe të kërkohet ndihmë prej të tjerëve. Në punët e dynjasë lejohet të merren mjetet e duhura dhe të kërkohet ndihmë prej disa njerëzve; por kërkuesi duhet të dijë se ajo është ndihmë e sipërfaqshme, sepse ndihmëtari i vërtetë është Allahu me madhërinë e vet dhe është Ai që krijon përshtypjen si në mjetet ashtu edhe në njerëzit. Allahu i ka thënë Davudit a.s.:

[19] Hafiz Ibrahim Dalliu, Ajka e kuptimeve të Kur'ani Kerimit, f. 23.
[20] Transmeton Buhariu.

"O Davud! Për madhërinë Time! Nëse vjen të kërkosh ndonjë send vetëm në derën Time, nuk lë pa ta mbaruar, sikur të kesh armik botën mbarë. Por, për madhërinë Time! Në qoftë se ti shkon nëpër dyer të tjera, dije se nuk të kryhet as edhe një punë, sikur gjithë botën ta kesh mik"

Prej kësaj fjale të shenjtë kuptohet: Kushdo që është i detyruar të kërkojë ndihmë prej dikujt, duhet të dijë me zemër se në dashtë Zoti, nevoja e tij do të plotësohet dhe jo ndryshe".[21] Dhe kështu përpiqu të kuptosh domethënien e të gjithë asaj që e lexon gjatë të falurit e namazit.

Ndërkaq, në ruku përjeto modestinë dhe përuljen, ndërsa në sexhden tënde rritjen e nënshtrimit pasi ti e kë vënë veten në pozicionin e përulësisë dhe je kthyer në origjinë duke bërë sexhde në tokë nga e cila u krijove.

Namazi është burim i pafund i ushqimit që rrjedh pa u ndalur, burim i cili vazhdimisht përtërinë me energji pozitive zemrën e njeriut nëse ajo është e pranishme, aktive e gjallë në kryerjen e të falurit, zgjatë litarin e durimit dhe nuk lejon që ai të këputet. Atëherë krahas durimit zemra përmbushet edhe me ndjenjën e kënaqësisë, disponimit, qetësimit, besimit dhe bindjes.

Njeriu herë-herë tregohet shumë i dobët dhe ka mundësi të kufizuara, prandaj, ka nevojë të mbajë lidhjen me fuqinë e Allahut, prej nga e merr ndihmën e vazhdueshme. Këtu vjen në konsiderim vlera e namazit që është lidhje direkte mes njeriut të vogël dhe fuqisë së Am-

[21] Hafiz Ibrahim Dalliu, vep. e cit., f. 24-25.

shueshme. Namazi është çelësi i thesarit që begaton, jep në pronësi dhe tejkalon. Kjo është kërcim nga suazat e realitetit të vogël tokësor në hapësirën e madhe të realitetit kosmik. Namazi është shpirt, përgjigje dhe mbështetje në vend të huaj; është prehje e zemrës së kapitur dhe të magjepsur. Për këtë arsye Pejgamberi, Muhammed a.s., thërriste myezinin, Bilalin dhe i thoshte: "O Bilal, lehtësona shpirtin me namaz", duke ftuar në këtë mënyrë Bilalin që t'i thërrasë njerëzit në namaz përmes ezanit. Ai falej gjatë në mënyrë që sa më shumë të qëndrojë në kontakt dhe në lidhje të drejtpërdrejtë me Allahun.

Ky program islam është program i ibadetit plot fshehtësi. Njëra nga ato fshehtësi është edhe ajo që namazi të shoqëron në rrugë, është ndihmë për shpirtin dhe dëfrim për zemrën. Dhe sa herë të shfaqet ndonjë vështirësi, ky ibadet të jep çelësin për t'i tejkaluar vështirësitë me kënaqësi, guxim, disponim dhe lehtësi. Thjesht, namazi është qendra e gëzimit, çlodhë zemrën, forcon lidhjen, lehtëson problemin, rrezaton dritën, ofron ngushëllimin dhe qetësimin; është mburojë nga errësira e shkarjes dhe pasionit, nga errësira e persekutimit dhe të rënies poshtë, nga errësira e snobizmit dhe mendjelehtësisë, nga errësira e dhunës dhe tiranisë, nga errësira e dobësisë dhe poshtërsisë, nga errësira e hipokrizisë dhe munafikërisë, nga errësira e makutërisë dhe tërbimit, nga errësira e dyshimit, shqetësimit dhe hutisë.

Kryerja e namazit me këto kushte të brendshme të zemrës që u thanë më sipër, është shkak për pastrimin e saj nga ndryshku, dhe për ndezjen e dritave në të, me të cilat vezullon Madhështia e të Adhuruarit, vëren Ibn Kudama. Dhe nga ky qëndrim që ke me pjesëmarrjen e zemrës në namaz, mund të shkrepë shkëndija, që do të vinte për së mbari jetën tënde. Atëherë do të ishte një botë më e mirë.

Avni Aliu

THE MULTIDIMENSIONAL MEANING OF NAMAZ

(Summary)

A very important role in building the human personality has the institution of namaz. The purpose of the namaz is to act as an individual's communion with God. According to Mustafa Mahmud "the ritual prayer (salat) is a hidden treasure, whose content is not known to anyone, apart from those who do their prayers with the full presence of their souls". One of the things that increase the multidimensional value of namaz is the fact that namaz is the only ibadet, which was ordered directly by God, without the mediation of Gabriel. The latter happened during the holy night of Miraj, i.e., the ascension of Mohammed to the sky (when they arrived in Sidrat al Munteha God spoke directly to him).

عون علي

المعاني المتعددة للصلاة

(الانفصال عن عالم التلوث و الاتصال بعالم الجمال)

(خلاصة البحث)

ان في بناء شخصية الانسان و المحافظة على الروح و العقل و لكى نسير على الطريق الوسط و نكون معتدلين في كل تصرفاتنا يجب أن نعلم بان الصلاة تلعب دورا مهما فيه. ان فوائد الصلاة كثيرة و متعددة لان الانسان في الصلاة يعيش اثمن و أحسن لحظاته الروحية. أن العبادة في الاسلام التي تسمى بالعربية "صلاة" هو كنـــز مخفى و لا يعرف قيمتها و فضلها الا الشخص الذي يؤديها بكل وقار و خشوع و خضوع و بجسمه و روحه.

إن الله سبحانه و تعالى في القرآن الكريم يقول: "أقيموا الصلاة" و لا يقول "أدعوا" لان الصلاة الحقيقة هي التي تودى بكل جوارحها الجسدية و النفسية حسبما يقول د. مصطفى محمود.

BOTA ISLAME

ISLAMI NË AUSTRALI DHE NË ZELANDEN E RE

AUSTRALIA

Emri zyrtar: Australia e Komonuelthit

Kryeqyteti: Kanbera

Sipërfaqja: 7.686.850 km2

Numri i banorëve (2003): 19.731.984, prej tyre 84% jetojnë në vendet urbanistike.

Religjioni: myslimanë 1,4%; budistë 0,8%; çifutë 0,4% dhe të krishterë 74%, nga të cilët 27% katolikë, 23% anglikanë, 8,2% kisha e bashkuar, 4,3% presbiterianë, 2,8% ortodoks, 1,7% baptistë, 1,5% luterianë dhe 0,5% jezuitë.

Popullata myslimane

Harta demografike. Shtatëdhjetë e katër për qind të banorëve të Australisë identifikohen me ndonjërën prej grupeve të krishtere. Ndërsa njëzetegjashtëpërqindëshi tjetër ndahet në pakica të tjera fetare në mesin e të cilëve myslimanët përbëjnë shumicën.

Numri dhe shtimi i popullatës myslimane. Sipas regjistrimit të banorëve, për vitin 2001, numri i myslimanëve në Australi arrinte shifrën në 281.578, që përbën 1,4% të popullatës së përgjithshme. Ndërkaq që, shënimet jozyrtare tregojnë për një numër shumë më të lart, i

cili tejkalon shifrën 350.000, apo më tepër se 2% të popullatës së përgjithshme.

Regjistrimi i vitit 1971, ishte regjistrimi i parë në të cilën numri i myslimanëve ishte i mjaftueshëm, që në përgjithësi të mund të përmenden ndaras. Sipas këtij regjistrimi, numri i myslimanëve në Australi ishte 22.311, që përbënte 0,2% të popullatës së përgjithshme. Nuk ka asnjë dyshim se numri i vërtetë i myslimanëve ka qenë dukshëm më i madh nga ajo që ka dalë nga ky regjistrim. Popullata myslimane në mënyrë konstante rritej. Shkaku themelor i kësaj rritjeje ishte emigrimi. Faktori i dytë që kontribuonte në rritjen e popullatës myslimane të Australisë relativisht ishte shkalla e lartë e lidhjeve martesore dhe shtimi natyror. Shumica e femrave myslimane martesat i bënin më së voni deri në vitet e para të njëzetave dhe lindnin shumë fëmijë. Shtimi i popullatës myslimane nga shkaqet e kalimit në islam prej grupeve tjera fetare relativisht ishte i vogël.

Përhapja gjeografike. Myslimanët në Australi kryesisht janë vendosur në Sidnei (50%) dhe Melburn (32%). Pjesa tjetër e popullatës myslimane janë të vendosur nëpër qytete më të mëdha si; Wolgong dhe Newcastle, Geelong, Brisban dhe Gold Cast/Tweed, Adellaide, Perth, Hobard, Darwin dhe në Cambera Queanbeyan. Jashtë qyteteve të mëdha të Australisë jetojnë vetëm 4,3% e myslimanëve të këtij vendi.

Struktura në vjetërsi dhe gjini. Pjesa dërrmuese e shumicës së myslimanëve në Australi (54%) janë të moshës më pak se 25 vjet. Afër 53% janë meshkuj, që janë në shumicë nga femrat të çfarëdo qoftë moshe. Proporcioni i meshkujve kundruall femrave është 1,12, derisa ky proporcion për popullatën australiane është 0,985. Shumë shpesh, sqarimi për këtë fakt qëndron mu aty se meshkujt janë iniciatorët më të shpeshtë të emigrimit sesa femrat. Gjithashtu, meshkujt më përpara sesa femrat e marrin vizën për vendqëndrim, dhe përgjithësisht meshkujt janë ata që më parë emigrojnë, e pastaj e tërheqin edhe pjesën tjetër të familjes.

Prejardhja dhe gjuha

Regjistrimi i vitit 1996, tregon për më tepër se një të tretën e myslimanëve australianë të kenë lindur në Australi, që për shembull është më i madh se rasti me hindusë dhe budistë, ndërsa më i vogël nga ai çifut, katolik dhe të pjesëtarëve nga kisha e bashkuar. Numri më i madh i myslimanëve australianë vjen nga Turqia, Libani, nga hapësirat e ish-Jugosllavisë (kryesisht, pas shkatërrimit të saj-nga Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia dhe Kosova), si dhe nga Qiproja. Vendet tjera të prejardhjes së myslimanëve australianë, me më shumë se 1% dhe më pak se 5% të popullatës së përgjithshme myslimane në Australi, janë Malajzia, Indonezia, Egjipti dhe Fidxhi. Nga regjistrimi i vitit 2001, myslimanët e Australisë bëjnë të njohur për më tepër se shtatëdhjetë shtete të ndryshme si vende të prejardhjes së tyre, që i bën ata të jenë grupi më i madh etnik i besimtarëve në Australi.

Myslimanët e Australisë, në shtëpitë e tyre përveç gjuhës angleze, flasin së paku edhe në tridhjetë gjuhë tjera, nga të cilët më të pranishme janë gjuha arabe, turqishte, boshnjake etj.

Struktura arsimore dhe socialo-ekonomike

Arsimimi. Vlerësimet tregojnë se më tepër ka myslimanë me arsimim të lartë (shkalla e dytë dhe e tretë)-sesa popullata e përgjithshme e Australisë. Meshkujt myslimanë 3,09% dhe femrat 1,02%, kurse ndër australianë ky vlerësim është-meshkuj 1,43%, ndërsa femrat 0,54%. Ndër ata, mjerisht është edhe përqindja më e madhe e atyre që janë të pakualifikuar. Në të gjitha kategoritë tjera të arsimimit dhe të përgatitjes profesionale, për dallim nga popullata e përgjithshme, vlerësohet se myslimanët janë në një pozitë varëse. Vërehet edhe një gjë, se në të gjitha kategoritë e profesioneve themelore dhe të mesme si dhe në ato të pakualifikuara, meshkuj ka më shumë sesa femra.

Ndonëse shumica e myslimanëve në Australi e zotërojnë mirë gjuhën angleze, shembujt e hulumtimeve nëpër disa lokalitete kanë treguar se një e treta e myslimanëve të Sidneit, dhe një e katërta e

myslimanëve të Melburnit, janë deklaruar se nuk janë në gjendje të aftë që të shërbehen me gjuhën angleze.

Punësimi. Norma e të zënit me punë është 37,5% (47% meshkuj dhe 25% femra), që përafërsisht është nën nivelin e përqindjes nacionale. Rezultatet e të papunësuarve prej 22% për meshkuj dhe 14% për femra tregojnë se përafërsisht janë nën nivelin e përqindjes nacionale. Nga ana tjetër, vlerësimi prej 41% për ata që nuk i takojnë fuqisë punëtore është diçka pak nën nivelin e përqindjes nacionale, e që në shumicë këta janë nga struktura e të rinjve të popullatës myslimane.

Profesioni. Profesionet më të shpeshta të myslimanëve, sipas prioritetit të vlerësimeve të paraqitura**,** janë punët e rënda fizike dhe punë të tjera të ngjashme (21,08% meshkuj të punësuar dhe 20,51% femra, në krahasim me 13,1% nga popullata e përgjithshme), pastaj punët nëpër plantacione, të drejtuarit me makina të ndryshme dhe punët e vozitësit (18,79% meshkuj të punësuar dhe 11,78% femra në krahasim me 12,7% nga popullata e përgjithshme), tregti (8,31% meshkuj të punësuar dhe 17,03% femra në krahasim me 7% nga popullata e përgjithshme) dhe punët komerciale, derisa nëpër shërbimet shtetërore, me punët gjysmëprofesionale dhe profesionale, si dhe me punët e menaxhmentit dhe të administratës, myslimanët shumë pak prezantohen. Myslimanët janë të pranishëm edhe në prodhimtarinë industriale, por kryesisht si fuqi punëtore.

Të ardhurat. Sikurse që është rasti edhe me të gjitha bashkësitë tjera të emigrantëve, po ashtu edhe myslimanëve u duhet një kohë për ndërtimin e profilit personal kur është në pyetje shpërndarja vjetore e të ardhurave për familje. Sipas regjistrimit të vitit 1991, profili i bashkësisë myslimane nuk dallon shumë nga modeli nacional i shpërndarjes vjetore në të ardhurat, që do të thotë se përqindja më e madhe është e atyre familjeve, të cilëve të ardhurat vjetore u sillen mes 16.000 dhe 25.000 dollarë australianë, dhe atyre mes 40.000 dhe 80.000 dollarë australianë, ndërsa përqindja më e vogël është e atyre me nën 8000 dhe 80.000 dollarë australianë.

Historia

Edhe pse myslimanët e parë të përhershëm u vendosën në Australi gjatë shekullit XIX, apo më herët, shumica dërrmuese e myslimanëve australianë janë vendosur në shek. XX, kryesisht pas Luftës Dytë Botërore.

Kontaktet e para të myslimanëve me Australinë. Pasi që islami ende gjatë shek. XIV, me të madhe ishte përhapur në Azinë Juglindore, ekzistojnë indikacionet që myslimanët të kenë hulumtuar veriun e Australisë edhe më herët. Megjithatë, ajo që dihet me siguri është se, madje edhe para se të vendosen evropianët në Australi, në shek. XVII dhe XVIII, ekzistonin kontaktet e para të rëndësishme dhe të rregullta mes popullit aborixhan të Australisë dhe myslimanëve të quajtur makasan *(Macassan)* që përbëheshin nga ekuipazhet e peshkatarëve dhe tregtarëve, nga Indonezia, dhe që disa prej tyre për një kohë të caktuar vazhdonin jetën në veriun e largët të vendit-kontinentit. Makasanët, që islamin e kishin përqafuar në fillim të shek. XIX, bënin tregti me aborixhanët, të cilët për afërsisht që nga viti 1650 e deri në fillim të shek. XX, kishin jetuar përgjatë bregdetit verior. Konsiderohet që makasanët me ndikimin e tyre bënë plotësime në gjuhët e aborixhanëve, për çka ekzistojnë dëshmitë të anijeve të vizatuara nëpër shpella, pastaj vokabulari e, posaçërisht me foljet e parregullta që realizoheshin nga gjuha e makasanëve, që u bënë të përvetësuara nëpër vende më të përhapura dhe më të njohura të gjuhës aborixhane të Australisë verilindore në rajonin Arnhem Lland.

Vendosja e parë e përhershme. Vendosjen e përhershme të myslimanëve në Australi mund ta ekzaminojmë në disa faza. Grupi i parë më i rëndësishëm që kanë arritur në Australi në shek. XIX, kanë qenë legjendarët afganë që ishin grahës të deveve. Afro 3000 grahës devesh, më shumë se gjashtëdhjetë vjet bënë sigurimin e transporteve më vitale nëpër pjesët e pa arritshme të Australisë e deri te zbulimet e vendeve të pasura me ari. Afganët e famshëm ishin pjesëmarrës në ekspeditat hulumtuese dhe luajtën një rol të rëndësishëm në disa pro-

jekte të mëdha dhe të vlefshëm, duke u kyçur edhe në vendosjen e lidhjes telegrafike mbitokësore *(Overland Telegraf Line)* 1870-1872. Deri në fund të shek. XIX, u ndërtuan xhamitë e para në qytetet Adelaide, Coolgardie, Maree, Broken Hill dhe Perth. Disa prej tyre edhe sot ekzistojnë.

Diskriminim politik apo "Australia e bardhë". Pas udhëheqësve afganë që prinin me deve, deri në mesin e shek. XX në Australi filluan të vendosen kryesisht studentët, ekspertët e profesioneve të ndryshme, njerëz afaristë dhe zyrtarë shtetërorë, të cilët në Australi vinin për shkaqe karrieriste të tyre. Para së gjithash, shkaku i këtyre ishte ligji i vitit 1901, që përkufizonte emigrimin në Australi *(Imigration Restriction Act)*, i cili edhe zyrtarisht rivendosi parimin për "Australinë e bardhë". Ky ligj në mënyrë eksplicite bënte diskriminim ndaj potencialit të ngjyrës tjetër të emigrantëve e që në mes tjerash, drejtpërsëdrejti vinte në shprehje edhe në zhvillimin e popullatës myslimane në Australi.

Vala e dytë me rëndësi e ardhacakëve. Vetëm pas Luftës Dytë Botërore, veçmas kah fundi i viteve të gjashtëdhjeta të shek. XX, me ndryshimin e politikës australiane për emigracion dhe shpërthimin e luftës qytetare në Liban, filloi një ardhje e dukshme e emigrantëve myslimanë, shkaqet dhe motivet e të cilëve ishin të natyrës ekonomike dhe politike. Grupet më të mëdha të emigrantëve myslimanë që arritën në këtë periodë ishin nga Turqia dhe Libani.

Fillimet e viteve të nëntëdhjeta e deri në fund të shek. XX, për arsye të luftërave në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë si dhe në Kosovë, u regjistrua një numër i konsiderueshëm i myslimanëve të ndjekur, të cilët nga dhuna e shkatërrimeve luftarake, krimeve dhe gjenocidit, u larguan nga vatrat e tyre, duke gjetur strehim në Australinë tejoqeanike. Politika për imigrim e Australisë duke aplikuar kategori të reja dhe të përkohshme për emigrantë, këtyre të pastrehëve ua mundësoi që në këtë kontinent të qëndrojnë përhershëm.

Organizimi fetar

Që nga viti 1957, kur janë shënuar formimet e para të bashkësive islame në Australi, njëra në Viktori dhe tjetra në N. S. W.(New South Wales), myslimanët e Australisë, pak a shumë i tubon dhe i përfaqëson organizata e trefishtë e bashkësisë islame, që në mënyrë të rregullt është e regjistruar në të gjitha organet shtetërore të të gjitha niveleve. Atë, në mënyrë formale dhe juridike e përbëjnë organizatat lokale islame (xhemati), tetë këshilla islame dhe Federata Australiane e këshillave islame. Në organizimin e myslimanëve vend i veçantë u takon xhamive dhe imamëve**.**

Organizatat lokale islame (xhemati). Si njësi themelore organizative e bashkësive myslimane në Australi, janë formuar organizatat lokale islame (*Islamic Societies, Communites, Centers...*) respektivisht xhemati me Këshilla drejtues në krye të cilëve janë imamët. Këto organizata përkujdesen për çështjet dhe punët e bashkësive lokale myslimane, ndërtimin e xhamive, blerjen dhe huazimin e hapësirave tjera të nevojshme, sigurimin dhe mirëmbajtjen e rregullt të tyre.

Organizatat lokale islame, merren edhe me aktivitete tjera, ku mund të kyçen edhe shërbimet humanitare shëndetësore, orët vijuese për gjuhë, aktivitetet e ndryshme sociale, konsultative, këshillëdhënëse dhe kulturore. Organizimet nëpër organizata lokale islame kryesisht bëhen sipas çelësit etnik, që para se gjithash janë të kushtëzuar për shkak dallimeve kulturore dhe gjuhësore te myslimanët e Australisë.

Këshillat islame (IC). Në çdo shtet dhe territor australian, si njësi organizative e bashkësive islame të shkallës dytë në Australi, ekziston nga një këshill islame (*Islamic Council*), të cilët përfaqësohen nga organizatat lokale islame të shteteve apo territoreve përkatëse. Anëtarësimi nëpër këshillat islame bëhet vullnetarisht. Megjithatë është tendenca, që të gjitha organizatat lokale islame të jenë anëtare në ndonjërën nga tetë këshilla, në mënyrë që këshillat, detyrë themelore e të cilave është të koordinuarit e interesave dhe aktiviteteve të organi-

zatave islame brenda një shteti, të jenë sa më efektivë në plotësimin e misionit.

Federata Australiane e Këshillave islame (AFIC). Federata Australiane e Këshillave Islame *(Australian Federation of Islamic Councils)*, të cilën e përbëjnë Këshillat islame e të gjitha shteteve australiane, është një përfaqësi e shkallës tretë dhe trup koordinues në nivelin e gjithë territorit australian. Krahas asaj që bën koordinimin e aktiviteteve të këshillave islame, FAKI prezanton interesat e myslimanëve australianë në planin federal dhe ndërkombëtar, ofron shërbime të shumta arsimore, kulturore dhe fetare, ndihmon në sigurimin e rrogave islame si dhe nxjerr certifikata që në Industrinë e mishit të Australisë të theren bagëtitë sipas dispozitave islame (hallall).

Ndonëse organizimi i myslimanëve australianë në nivel shtetëror heq rrënjët që nga viti 1964, ata organizimin e sotëm të tyre në formën e shkallës së tretë (organizatat lokale, këshillat islame dhe FAKI) e arrin tek në vitin 1974.

Krahas këtyre strukturave organizative të bashkësive islame të theksuara, në Australi ekzistojnë edhe asociacionet e xhematëve të ndryshëm dhe të bashkësive lokale islame me simptome etnike.

Xhamitë. Simboli fizik i pranisë islame dhe të myslimanëve në një bashkësi është xhamia. Për myslimanët e Australisë xhamia para së gjithash është vend për kryerjen e namazeve të rregullta ditore dhe të kohë pas kohe, por edhe shoqërimi dhe ndërrimi i informatave në gjuhën e atyre vendeve nga të cilat kanë ardhur në Australi. Hytbeja e xhumasë, të premteve, si dhe mësimet fetare gjatë vikendit, për ta paraqesin mishërim ndaj mësimeve fetare dhe njohuri e informata më të mira mes xhematit.

Në Australi ekzistojnë afër 100 xhami dhe qendra islame, prej të cilave 35 gjenden në Melburn, kurse 40 në Sidnei. Xhamia e parë në Australi u ndërtua në vitin 1861, në vendin Marree në Australinë Jugore, ndërsa xhaminë e parë më të madhe e ndërtuan grahësit afganë të deveve në vitin 1890, në vendin Adelaide. Kurse xhamitë e para me madhësi më të mëdha u ndërtuan në vitin 1976, në New South Wales dhe Victori. Xhamitë më të mëdha në Australi gjenden në Lakemb

dhe Auburn (N.S.W.), Prinston, Broadmeadows dhe në Deer Park (Victori). Këto si dhe shumica e xhamive tjera financohen nga bashkësitë lokale myslimane, e ndonjëherë edhe prej ndihmave të myslimanëve nga jashtë. Në Australi të gjitha xhamitë nuk janë xhami klasike, me minare dhe kupola. Disa xhami janë, thjesht, vende për kryerjen e namazit (mesxhidet) dhe përbëhen nga një hapësirë, që si zakonisht ato janë të shtruara me tepih, në të cilën si simbol i improvizuar gjendet mihrabi që tregon drejtimin e Qabesë. Xhamitë tjera janë ngushtë të lidhura me shkollat islame (shkollat e vikendit apo mektebet) në të cilat vijohet mësim-besimi, edhe organizohen manifestimet e rëndësishme fetare apo të atyre nga bashkësitë etnike përkatëse.

Në rrethin e çdo shkolle private islame gjendet edhe xhamia apo mesxhidi, që shërben njësoj si për nevoja të nxënësve e po ashtu edhe për popullatën lokale myslimane. Shumica dërrmuese e xhamive dhe mesxhideve janë pronat e vetë myslimanëve australianë, derisa një numër më i vogël i tyre, kryesisht mesxhidet, që janë të vendosura nëpër hapësirat e zbrazëta dhe të huazuara. Gjinden aty këtu (në pakicë) xhamitë e ndërtuara sipas modelit dhe stilit oriental, me minare, kupola, dhe me elemente tjera klasike të arkitekturës islame. Pranë mbishkrimeve në varr, kapistrave dhe dekorimeve të brendshme të mesxhidave si dhe hapësirave tjera myslimane, me të cilat disponon bashkësia islame në Australi, këto xhami paraqesin bukurinë e vetme kulturore të myslimanëve australianë.

Imamët. Në krye të çdo bashkësie lokale islame (xhematit) gjendet autoriteti fetar-imami, i cili, kryesisht dërgohet nga vendi i prejardhjes së anëtarëve të bashkësisë. Kështu ndodh në disa raste, sepse vendi i prejardhjes së xhematit, i ofron bashkësisë ndihma financiare, kurse në rastet tjera bashkësitë thjesht dëshirojnë ta sjellin personin nga mesi i afërt i tyre. Disa imamë paguhen nga organizatat qeveritare dhe joqeveritare, që janë jashtë Australisë, ndërsa të tjerëve rrogat ua sigurojnë vetë bashkësitë lokale islame nga anëtarët e rregullt të bashkësisë dhe nga të ardhura tjera të dedikuara për interesa të bashkësive. Qeveria australiane nuk ofron kurrfarë ndihme ekskluzive për aktivitete fetare e as për financimin e nëpunësve fetarë.

Në Australi ende nuk ekzistojnë kushtet që të interesuarit atje të mësojnë dhe të përgatiten për kryerjen e detyrës së imamit, edhe pse në bashkësinë lokale islame në Lakembi (Sidnej) ka mendime që të formohen institucionet arsimore për nevoja të tilla.

Këshilli i imamëve. Në shumicën e shteteve dhe territoreve australiane ekzistojnë këshillat e imamëve, si një trup konsultativ dhe këshillëdhënës, të cilët automatikisht, përbëhen nga të gjithë imamët zyrtarë, që janë të angazhuar nëpër rajone të caktuara. Këshilli imamëve çdo ditë kryen punët që janë drejtpërdrejt të lidhura me çështjet aktuale fetare, bënë realizimin e bashkëpunimit reciprok mes xhematit, i përputh dhe i përshtat shënimet e datave të rëndësishme të historisë islame dhe të ceremonive islame, ndërmjetëson mes bashkësive lokale eventualisht në rast të ndonjë kontesti etj.

Asociacionet e studentëve. Në shumicën e universiteteve në Australi veprojnë asociacionet e studentëve, të cilat organizojnë dhe tubojnë studentët e popullatës myslimane dhe kujdesen për adaptimin e shpejtë dhe të lehtë të studentëve ndërkombëtarë nga radha e myslimanëve të rinj. Gjithashtu, këto organizata, në kuadër të universitetit sigurojnë ambientin (mesxhidin, ligjëratat islame, tribuna etj.) me çka kontribuojnë që studentët myslimanë, e veçanërisht ata të cilët vijnë nga vendet tjera të ndihen "si në shtëpitë e veta". Këto asociacione iniciojnë dhe mbajnë web-faqet me të cilat sigurohen informata që janë me interes për islamin dhe myslimanët. Njëra nga ato është *Federation of Australian Muslim Stydents and Youth* (Federata e studentëve mysliman dhe të rinjve australian) me qendër në Sidnej.

Përkatësia në medh-hebe. Shumica dërrmuese e myslimanëve të Australisë janë suni, të medh-debit hanefi dhe shafi. Myslimanët me prejardhje turke, libaneze, boshnjake dhe shqiptare kryesisht janë të medh-hebit hanefi, ndërsa ata nga Egjipti dhe Malajzia janë shafi. Në Australi jeton edhe një numër i konsiderueshëm i shiive, maksimalisht 15% nga popullata e përgjithshme myslimane.

Personalitete të shquara

Individë që me prezencën e tyre islame në hapësirat e Australisë kanë lënë gjurmë të përhershëm për të cilët ekzistojnë informata relevante kryesisht janë nga radhët e imamëve profesionistë dhe të aktivistëve fetarë.

Sejjid Xhelal Shah (Sayyed Jalal Shah). I lindur në Karaçi në gjysmën e dytë të shek. XIX. Në atë kohë çmohej si dijetar islam. Në moshën tridhjetëvjeçare ka ardhur në Australi, në mënyrë që të udhëheqë bashkësinë myslimane. Paraqitja e tij e parë publike dhe zyrtare u shënua në vitin 1914 në Perthy, me rastin e ligjëratës së hytbes së Bajramit të ramazanit. Konsiderohet se ai ishte si nga baba e po ashtu edhe nga nëna, pasardhës direkt i të dërguarit të Allahut xh. sh.- Muhamedit a. s.

Isak Imamoviq. U lind në fillim të shek. XX, në Rahiq të Bosnjës. Arsimimin islam, veçanërisht studimet në të drejtën e sheriatit, i kreu në Sarajevë. Për një kohë në Bosnjë kryente detyrën e kadiut, pas kësaj në Vjenë, dhe para shkuarjes në Australi, i vijonte mësimet nga filozofia. Në Australi shkoi në vitin 1949, ku qëndroi deri në përfundimin e jetës. Vdiq në moshën 67 vjeçare. Imamoviqi është autor i veprës përmbajtjësore nga fusha e besimit islam, ibadetit dhe etikës *Vështrim doktrinës islame (Oytlines of Islamic Doctrine)*, që është lekturë unike i këtij lloji dhe vëllimi e shkruar ndonjëherë në vendin e Australisë. Imamoviq botoi shkrime edhe në boshnjakisht, në *Glasnik IVZ* në Sarajevë si dhe në *Bosanskim Pregledima* të Vjenës dhe Cyrihut. Përveç gjuhës amtare ai fliste edhe anglisht, arabisht dhe gjermanisht.

Mahomet Allum. Ishte ndër myslimanët e parë afgan të vendosur në Australi, në vendin Adelaide, ku u bë shumë i njohur si shërues në mjekësinë popullore. Si grahës i deveve, ai në vitin 1903 ishte dëshmitar në inaugurimin e ujësjellësit Coolgardie. Në Australinë raciste të asaj kohe, Allumi, proklamonte haptazi me gojë dhe me shkrim predikimet islame për racizëm. Në kohën e politikës raciste, nuk pati

mundësi me marrë nënshtetësinë australiane, sepse nuk ishte "i ngjyrës së bardhë", ndërsa kur zyrtarisht politika e tillë u largua, Mohamet Allumi nuk e paraqiti më kërkesën për marrjen e nënshtetësisë. Vdiq në vitin 1964, në shtëpinë e vet në Everard Park, në moshën 106 vjeçare.

Ahmed ef. Skaka. U lind në Sarajevë ku në medresenë e Gazi Husrev-begut, e murrë titullin e imamit. Në vitin 1950 emigroi në Australi, ku, përpos punës së rregullt në industrinë-elektronike në Adelaid, angazhohej edhe si imam dhe ofiqar për çështje fetare. Emri i tij, sa i përket myslimanëve të Australisë, ndërlidhet me shumë ngjarje dhe projekte, në mesin e cilëve është edhe formimi i Federatës Australiane i Këshillave Islame. Vdiq në Adelaide në vitin 2001.

Shejh Fehmi Nexhi el-Imam (Sheikh Fehmi Naji al-Imam). U lind në Tripoli (Liban) më 1927. U arsimua në Kolegjin islam në Tripoli të Libanit, pastaj diplomoi studimet e sheriatit. Më 15 maj 1951 vendoset në Australi. Në fillim vepronte vullnetarisht si aktivist në çështjet fetare. Në vitin 1957 në Viktori e themelon bashkësinë e parë islame të pasluftës. Të njëjtin vit e inicioi shkollën e parë të vikendit për fëmijët myslimanë. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e bashkësive tjera islame nga të gjitha vendet e Australisë, Fehmi el-Imami në vitin 1964 themeloi, Federatën e bashkësive islame, që njëherë ishte paraardhëse e Federatës australiane të bashkësive islame të themeluar në vitin 1974. Në vitin 1976 Shejh Fehmiu, pas një pune me honorar për një çerek të shekullit ai, filloi punën e imamit të rregullt pranë Islamic Society of Victoria (Priston).

Bilall Cleland. U lind më 16 shkurt 1942, si pas ardhës direkt i ardhacakëve të flotës britanike në Australi. Në vitin 1977 duke pranuar islamin në Egjipt, zgjidhet sekretar i trupit nacional islam, për këshillat islame të federatës australiane, si dhe në dy drejtime-sekretar i këshillit islam për Viktorin, dhe i organizatës kulmore islame në Viktori. Clelandi është luftëtar i dalluar për të drejtën dhe arsimimin e myslimanëve në Australi dhe në botë. Pranë teksteve, deklaratave dhe intervistave të shumta, është edhe autor i një historie të shkurtër të myslimanëve australianë: *The Myslim in Australia-a Brief History*

(Myslimanët në Australi-histori e shkurt), vepër më parimor dhe më integral i këtij lloji.

Arsimi fetar

Myslimanët e Australisë, përpos asaj çka mësojnë në rrethin e ngushtë të familjes, ata arsimin islam e arrijnë edhe përmes sistemit qofshin ato të mënyrës së rregullt apo edhe jo të rregullta të institucioneve arsimore.

Shkollat islame. Në sferën e arsimit të rregullt myslimanët australianë, në përputhjen e ligjit për arsim, kanë themeluar 10 shkolla fillore dhe 11 të kombinuara, pastaj shkolla fillore dhe të mesme si dhe kolegje islame, në të cilat, paralel planit dhe programit shtetëror mësohen edhe lëndët themelore të islamit (kira'et, studime islame, historia islame etj.). Edhe nëse këto shkolla janë të hapura për të gjithë, pa marrë parasysh fenë, në to zbatohen parimet e edukatës dhe arsimit islam. Shkollat më të njohura të këtij lloji janë *King Khalid Islamic Colege of Viktoria* dhe *The Islamic Schools of Victoria (Weribe College)* në Melbourn, si dhe *Malek Fahd Islamic School* në Greenacreu, në Sidneiij.

Shkolla të vikendit dhe mektebet. Burimet tjera të sistemit islam për arsim janë shkollat e vikendit, të cilat gjithashtu janë të karakterit privat, apo mektebet, e të cilat i organizon dhe udhëheq organizata lokale islame, kryesisht në qarkun e xhamive apo të hapësirave të huazuara për këto qëllime. Mësimdhënësit kryesorë në këto shkolla janë paraardhësit imamë të bashkësive islame që ndihmohen nga vullnetarë të arsimuar.

Shkollat publike australiane nëpër shkollat publike të shtetit nuk e njohin mësim besimin, apo ndonjë lëndë tjetër të ngjashëm.

Rrethanat shoqërore-politike

Prej kohërave politike e njohur me emrin "Australia e bardhë" nga fillimi i shek XX, kur myslimanët, bashkë me popuj tjerë të ngjyrosur, diskriminoheshin për shkak të racës (e kishin të ndaluar të merren me xehetari, u shkurtoheshin të drejtat për të votuar, për pensione, të drejtat për natyralizim etj), statusi i të gjitha racave, me këtë edhe ai i myslimanëve, pësoi shumë ndryshime posaçërisht në shikimet formale-juridike. Sot myslimanët në Australi janë anëtarë të bashkësive multietnike dhe multifetare të Australisë me të drejta të plota qytetare. Nga ana e shtetit lejimi i kurorëzimit me ligjet e sheriatit para ofiqarëve të autorizuar fetar është vetëm një shembull i respektimit të të drejtave fetare myslimane (por edhe të tjerëve) në Australi.

Megjithatë, duke pasur parasysh dominimin çifut-krishterë në shoqërinë australiane, nuk është vështirë që të parashikohet bartja e trandjeve nga pjesa tjetër e botës çifute-krishtere edhe në Australi. Njëra prej tyre është edhe të shfaqurit e kohë pas kohe të islamofobisë. Kjo ndodh, sikurse edhe në pjesë tjera të botës, në ato rrethana politike kur myslimanët dhe të krishterët, në cilëndo qoftë anë të botës, gjenden në konflikt, apo ndoshta janë duke u përgatitur për të. Në atë rast shumë shpesh, me ndihmën e madhe të medieve dhe mjeteve tjera propaganduese, islamofobia trazohet, e kjo rregullisht rezulton me dëmtimin e jetës dhe pronave të myslimanëve. Myslimanët e Australisë janë dëshmitarë të ngjarjeve të tilla që nga Galipolia, në historinë e hershme, përmes krizave të naftës gjatë viteve të shtatëdhjeta të shek. XX, pastaj në kontekst të konfliktit amerikano-iranian dhe luftës së gjirit, e deri te ngjarjet e fundit jo shumë larg në Nju-Jork dhe Uashington, si dhe lufta në Afganistan dhe Irak.

Me siguri, islami, në të ardhmen, në Australi do të luajë një rol të rëndësishëm si faktor kyç në organizimin e jetës së ardhacakëve në këtë vend, dhe mbrojtjen e identitetit fetar dhe etnik të tyre.

ZELANDA E RE

Emri zyrtar: Zelanda e Re

Kryeqyteti: Vellingtoni

Sipërfaqja: 268.680km2

Numri i banorëve (2003) : 3.951.307, prei tyre 80% jetojnë nëpër qytete.

Religjioni: myslimanë 0,5% (rreth 20.000), anglikanë 24%, presbiterianë 18%, rimo-katolikë 15%, metodistë 5%, baptistë 2%, protestantë të tjerë 3%, Kishat Maore dhe të tjerë 1,5%, dhe fetarë të papërcaktuar 31% (1986)

Popullata myslimane

Harta demografike. Meqenëse, krahas përfshirjes nëpër formularë të regjistrimit të popullsisë, çështja e religjionit nuk është obligim, për ç'arsye është vështirë të verifikohet gjendja faktike e grupeve fetare, në Zelandën e Re. Sipas regjistrimit të vitit 1991, në Zelandën e Re jetonin 5.277 myslimanë, apo 0,15% e popullatës së përgjithshme. Sipas vlerësimeve të lira të myslimanëve zelandezë, sot në Zelandën e Re jetojnë rreth 20.000 myslimanë, apo 0,5% e popullatës së përgjithshme. (Disa, burime jozyrtare, flasin për numrin e 40.000 myslimanëve.)

Përhapja gjeografike. Të paktën gjysma nga numri i përgjithshëm i myslimanëve zelandezë jetojnë në Auckland, që është qyteti më i madh i Zelandës Re.

Profesioni dhe të ardhurat. Edhe pse bashkësinë e këtij qyteti në masë të madhe e përbën klasa punëtore, mesatarja e të ardhurave të myslimanëve në Zelandën e Re është krejt afërt me të ardhurat mesatare shtetërore.

Prejardhja

Bashkësinë myslimane të Zelandës së Re e përbëjnë rreth 35% e nacionaliteteve të ndryshëm, ndërsa në mënyrë gjenerale mund të ndahen në tri grupe: ardhacakët e hershëm në Zelandën e Re, që janë natyralizuar, evropianët etnikë, dhe ata që u vendosën më vonë. Në pjesën më të madhe myslimanët e Zelandës Re janë fixhio-indianë dhe me rrënjët tjera të Azisë Jugore, ndonëse një numër i dukshëm i tyre heq rrënjët nga vendet e tjera, duke i ndërlidhur këtu edhe grupin shumë aktiv të konvertuarve nga Perëndimi.

Historia

Kontaktet e para të myslimanëve me Zelandën e Re. Myslimanët e parë në Zelandën e Re janë vendosur në vitin 1868, ndërsa në vitin 1874 për herë të parë paraqiten në regjistrimin e popullsisë së Zelandës së Re. Ata ishin kinezët, që merreshin me xehetari. Kur industria e xehetarisë shënoi rrënje, ata kthehen në Kinë, duke mos lënë pas vetes kurrfarë gjurme islame, as trashëgimi myslimane.

Vendosjet e përhershme. Ndërkaq, rrënjët, e bashkësisë myslimane të sotëm në Zelandën e Re zënë fillin në vitin 1906, kur një grup i vogël i myslimanëve nga Guxhurata arrin në këtë ishull. Megjithatë, tek pas vitit 1950 fillon procesi i shpërnguljeve masive të familjeve myslimane në Zelandën e Re. Vendosje të rëndësishme janë regjistruar gjatë viteve të vonshme të gjashtëdhjetave, që ka rezultuar të dhjetëfishohet numri i myslimanëve në Zelandën e Re, gjatë periudhës kohore mes 1966 dhe 1991. Njëra nga shkaqet e rëndësishme që qe shkak për këtë vërshim të myslimanëve ishte grusht shteti *(Coup D'etat)* në Fixhi në vitin 1987.

Në rritjen e numrit të myslimanëve të Zelandës së Re kontribuuan edhe valët e të dëbuarve nga Bosnjë e Hercegovina dhe Kosova, prej të cilëve një numër i tyre u vendosën në këtë vend të largët ishullor.

Organizimi fetar

Organizatat lokale islame. Meqenëse relativisht janë bashkësi e vogël, myslimanët zelandezë janë mirë të organizuar, si në nivele lokale dhe rajonale, ashtu edhe në ato shtetërore. Asociacionet lokale islame, që në Zelandën e Re ka më tepër se tridhjetë sosh, janë formuar me qëllim të sigurimit të hapësirave dhe mundësive për aktivitetet fetare, arsimore dhe shoqërore të myslimanëve, duke kyçur ushqimin hallall dhe kujdesin për normat publike të myslimanit dhe islamit në shoqërinë dhe opinionin zelandez. Disa nga këto organizata i kanë grupet e posaçme për femra dhe të rinj, si dhe grupe për këshilla familjare (grupet *usra*). Aktivitetet misionare përmes të ashtuquajturit *xhemati* teblig zënë një vend të rëndësishëm në organizimin por, para së gjithash në jetën misionare të myslimanëve zelandezë.

Organizatat rajonale myslimane. Organizata e parë rajonale në Zelandën e Re është formuar në vitin 1950 në Auckland, me emrin Asociacioni Mysliman i Zelandës së Re *(New Zealand Muslim Association-NZMA)*, kurse deri në vitin 1989, janë formuar edhe pesë këso organizatash, në mesin e cilëve edhe Asociacioni Mysliman i Velingtonit *(Welington Muslim Association)*, në vitin 1962, e cila më vonë, për arsye se përbëhej nga shumica e studentëve të vendeve të ndryshme, ndërroi emrin në Asociacioni ndërkombëtar i myslimanëve të Zelandës së Re *(International Muslim Association of New Zeland-IMAN)*. Deri në gjysmën e viteve të pesëdhjeta çdo rajon formonte dhe regjistronte ndonjë organizatë myslimane, ashtu që, pranë atyre dy organizatave rajonale islame që i cekëm më lart, veprojnë edhe Organizata myslimane e Auclandit jugor (*South Auckland Muslim Association-SAMA)*, në Aucland, Organizata myslimane Waikato Bay of Plenty-a *(Waikato Bay of plenty Muslim Association-WBPMA),* në Hamilton, Asociacioni mysliman Manawatua *(Manawatu Muslim Association-MMA)*, në Palmerston Nourth, Asociacioni mysliman Canterburya *(Muslim Association of Canterbury-MAC)*, në Chirstchurch dhe Asociacioni mysliman Otaga *(Otago MuslimAssociation-OMA)*, në Dunedin.

Federata e asociacioneve islame në Zelandën e Re. Në përfundim të viteve të shtatëdhjeta ekzistonte një nevojë e qartë për formimin e një trupi të nivelit shtetëror, i cili do të koordinonte aktivitetin e organizatave lokale dhe rajonale, do të rriste efikasitetin e tyre si dhe do të prezantonte interesat e myslimanëve si një tërësi në planin ndërkombëtar dhe atë shtetëror. Në këtë mënyrë në vitin 1979, u themeluan Federata e asociacioneve islame të Zelandës së Re *(Federation of Islamic Associations of New Zealand)*, organizata kulmore islame në nivelin shtetëror me qendër në Welington. FAIZR-në e përbëjnë shtatë asociacione rajonale myslimane që i cekëm më lart. Krahas këtyre aktiviteteve FAIZR-ja ofron edhe shërbime tjera si bie fjala, në industrinë e mishit në Zelandën e Re bën sigurimin e therjes së mishit sipas dispozitave islame që dedikohen për eksportimin e tregut të botës myslimane. Gjithashtu, kjo federatë, nxjerr gazetën dyjavore për tërë Zelandën e Re.

Në shikimin organizativ, FAIZR-ja vepron sipas principit përfaqësues; çdo asociacion rajonal dërgon përfaqësuesit e vet në Këshillin e FAIZR-ës; pastaj, Këshilli, nga anëtarët e vet zgjedh Këshillin ekzekutiv, i cili përbëhet nga kryetari, nënkryetari, sekretari gjeneral, arkëtari dhe tre anëtarë.

Në vitin 1990, Këshilli themeloi një sipërmarrje me emrin *Amana Corporation Limited*, me qëllim të sigurimit të mjeteve për vetë mbajtjen e FAIZR-së dhe për përkrahjen materiale të bashkësisë myslimane. Ky këshill rregullisht i mban tubimet e veta, duke u takuar të paktën katër herë në vit.

Xhamitë dhe qendrat islame. Në fillim numri i vogël i myslimanëve zelandezë takimet i bënin nëpër shtëpitë private, ku organizonin mësim besimin për fëmijë dhe i festonin festat fetare. Meqë numri i tyre shtohej, atëherë ishte shumë e natyrshme që u rritën edhe kërkesat për vende dhe hapësira më të mëdha, ku mund të tuboheshin, të kryenin namazin, të mbanin ligjërata fetare dhe aktivitete tjera. Si rezultat i kësaj, nëpër gjitha qytete të mëdha anembanë vendit, bliheshin shtëpi të thjeshta dhe shndërroheshin në xhamia dhe qendra islame.

Xhamitë dhe qendrat islame janë vende në të cilat zhvillohen të gjitha aktivitetet (fetare, arsimore, shoqërore, kulturore etj) e mysli-

manëve zelandezë dhe organizatave islame të tyre. Më tepër se tridhjetë qendra të ndryshme islame, xhamia apo mesxhide janë në shërbimin e myslimanëve të Zelandës së Re. Njëra prej xhamive më të njohura në Zelandën e Re, ajo e Chirstchurchit, ndërtimi i së cilës përfundoi në vitin 1985, është xhamia më e largët nga Mekeja, në tërë botën.

Imamët dhe udhëheqësit. Edhe nëse në një numër të caktuar të xhamive imamët shërbejnë në kohën e plotë të punës, qeverisja e organizatave islame dhe kontrollimi i politikës së tyre kryesisht gjendet në duart e laikëve. Sikurse në Australi, po ashtu edhe myslimanëve të Zelandës së Re u nevojitet ndihma nga jashtë, e cila duke arritur kryesisht nga Arabia Saudite, shfrytëzohet si për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e xhamive dhe të qendrave islame, po ashtu edhe për financimin e imamëve.

Përkatësia në medh-hebe. Organizatat islame në Zelandën e Re nuk janë të ndarë sipas përkatësive etnike dhe të medh-hebeve, para së gjithash për shkak se janë në numër të vogël, por edhe duke iu falënderuar angazhimeve të udhëheqësve të tyre që bëjnë në planin e bashkësisë lokale dhe shtetërore.

Arsimi fetar. Në Auckland, qyteti me më së shumti mysliman në Zelandën e Re, dhe në qendra tjera zelandeze veprojnë pesë shkolla islame, në mesin e cilëve janë edhe *Al-Madinah School* dhe *Zayed College for Girls*, në Auckland.

Rrethanat shoqërore-politike. Duke organizuar kënaqësitë e nevojave shpirtërore, myslimanët e Zelandës së Re kanë siguruar nga pushtetarët komunalë parcela të posaçme për varrosjen e myslimanëve të vdekur. Gjithë kjo tregon se edhe përkundër faktit që janë një bashkësi e vogël, gjeografikisht shumë larg nga pjesët tjera të botës myslimane, ata kanë ndërtuar një bashkësi organizative shumë të fortë.

Marrë nga "Atllasi botës islame"
Sarajevë 2004

Përgatiti:
Shevki Sh. Voca

ISLAM IN AUSTRALIA AND NEW ZEALAND

(Summary)

Commonwealth of Australia
Capital: Canberra
Area: 7.686.850 km2
Population (2003): 19.731.984 (84% live in urban areas)

Religion: Muslims (1.4%), Buddhists (0.8%), Jews (0.4%), Christians (74%), Catholics (27%), Anglicans (23%), United Church (8.2%), Presbyterains (4.3%), Orthodox (2.8%), Baptist (1.7%), Lutheran (1.5%) and Jesuits (0.5%)

Muslim population

Demographic map: 74% of the population of Australia identify themselves as Christians. Out of the other religious groups Muslims comprise the majority.

According to the 2001 census, the number of Muslims in Australia is 281.578 (1.4%). Yet, according to certain sources, the number of Muslims in Australia is thought to be much higher (to exceed 350.000).

الاسلام في استراليا و زلنده الجديدة

(خلاصة البحث)

الاسم الرسمي: أوستراليا كومونفلت
العاصمة: كانبرا
المساحة: 7.6886850 كيلو متر مربع
عدد السكان: (2003) 19.731.984 حوالى 84% يعيشون في المدن
الديانة: المسلمون 1.4%، البوذيون 5.8%، اليهود 5.4%، المسيحيون 74% منهم 27% كاثوليك و 23% انجليكان و 2.8% الكنائس الموحدة و بقية الفرق.

المسلمون

طيقا لا حصائية سنة 2001 عدد المسلمين في أوستراليا كان 281-578 و هذا يعتبر 1.4% من تعداد السكان الكلى الا أن الاحصائيان غير الرسمية تقول

بان عدد المسلمين يصل إلى 350.000 ألف و يمثلون 2% من تعداد السكان.

HISTORIOGRAFI

RAPORTET E LUFTËS TË LAV TROCKIT (LUFTËRAT BALLKANIKE 1912-1913[1])

Vërejtja e përkthyesit

Në vjeshtë të vitit 1912 Lav Trocki (1879-1940), teoricien dhe revolucionar rus, ishte dërguar në Ballkan me qëllim të raportimit për gazetën më të popullarizuar të Rusisë Jugore "Kievskaya Mysl". Raportet e tij nga fushëbetejat ballkanike janë botuar në vëllimin VI të Përmbledhjes së veprave (Sochinenia) të botuara në gjuhën ruse, ndërmjet viteve 1923-1927. Raportet për Ballkanin dhe për luftërat ballkanike janë përkthyer në gjuhën angleze në vitin 1980 dhe kanë përjetuar disa botime, posaçërisht gjatë viteve 1991-1999, kur edhe fillojnë luftërat në ish-RSFJ si pasojë e politikës ekspansioniste serbomadhe. Teksti që pason flet në mënyrë të qartë për qëndrimin, trajtimin dhe masat gjenocidiale të shteteve ballkanike ndaj popullatës myslimane, e në veçanti asaj shqiptare gjatë viteve 1912-1913, pasi që kanë të bëjnë me trojet etnike shqiptare të okupuara nga ushtria serbe-jugosllave dhe bullgare. Gjithashtu në këtë tekst bëhet fjalë për komplotin e heshtjes, jo vetëm nga ana e organeve më të larta shtetërore, të deputetëve, të përfaqësuesve diplomatikë, por edhe të shtypit

[1] Burimi: *The War Cerrespondence of Leon Trotsky: Balkan Wars* 1912-1913, tr. By Brian Pearce; ed. By George Weeisman and Dunean William, New York: Pathfinder, 1993, pp. 267-272, 275-277,: 285-287.

rus, i cili veten e konsideronte si shtyp demokratik. Gjithë kjo përkrahje dhe heshtje kanë qenë në pajtim me politikën ruse ndaj Ballkanit, me ndihmën e aleatëve sllavë. Ky shkrim është një tablo e shkëputur nga opusi i gjerë të shkrimeve të Trockit, që ka për qëllim të paraqesë përjetimet e një intelektuali rus, me orientim human, gjatë "çlirimit të tokës së shenjtë të Dushanit" pas shkatërrimit të Perandorisë Osmane.

6. KRIMET E SHOVINIZMIT DHE TË DEMOKRACISË

- Prapa perdes -

Kjo është gati tekstualisht (kam shkruar derisa më është diktuar), rrëfimi i një mikut tim serb. "Kam pasur rastin-fatmirësisht ose fatkeqësisht, vështirë është për të thënë – derisa ende ka zgjatur lufta; të vizitoja Shkupin (Uskup), disa ditë pas luftës në Kumanovë. Qysh prej fillimit, nga pakënaqësia irrituese me të cilën lutja ime për leje qëndrimi dhe lëvizjeje në Beograd dhe të pengesave artificiale, kam filluar të dyshoj se njerëzit që janë duke udhëhequr luftën, nuk kanë veçanërisht të pastër ndërgjegjen dhe se atje poshtë, janë duke e bërë gjërat të cilat shumë pak pajtohen me të vërtetën zyrtare të raporteve për të qeverisur. Kjo përshtypje, më mirë të them parandjenjë, edhe më tepër më është përforcuar kur në Nish rastësisht takova një oficer i cili, sipas urdhëresës së Gjeneralshtabit, kishte qenë në Shkup. Ky oficer ishte një njeri i mirë, njeri i ndershëm, të cilin e kisha njohur një kohë të gjatë. Por, për së shpejti kur e kuptojë se do të shkoja në Shkup dhe se në të vërtetë, kisha fituar lejen për të shkuar atje, ai më tha me një armiqësi të papërmbajtur; se nuk ke kurrfarë arsye për të shkuar në Shkup, në rast se nuk ke ndonjë punë me rëndësi atje; dhe se pushtetarët në Beograd nuk e dinë çka janë duke bërë, kur u lejojnë të 'huajve' që të shkojnë në Shkup etj. Në Vrajë, në kufirin e vjetër serb, pasi që e kuptoi se s'e kam ndërmend të ndryshoj qëllimin tim, oficeri e ndryshoi tonin dhe filloi, në mënyrë të tërthortë, të më përgatit për pamjet,

të cilat do të shoh kur të arrijë në Shkup. "Këto janë gjërat jashtëzakonisht të pakëndshme, por me keqardhje, ato janë të paevitueshme". Vërejtjet e mikut tim, kanë përfshirë natyrisht theksimin e interesave dhe të nevojave shtetërore. Të gjitha, duhet të pranoj, më bindnin që edhe më tepër të bëhem dyshimtar. Kjo ka një domethënie, mendoja, lajmet mbi krimet, të cilat kishin arritur deri në Beograd, nuk ishin të rastit, nuk ishin individuale dhe nuk ishin rastet e veçuara, pasi që një oficer me autoritet i arsyetonte ato si rezultat i "nevojave shtetërore". Dikush patjetër duhet të kishte shënimet për të gjitha këto. Kush? Pushteti ushtarak? Ose edhe qeveria gjithashtu? Përgjigjen në këtë pyetje e mësova fill pas arritjes në Shkup.

Tmerret filluan menjëherë kur e kaluam kufirin e vjetër. Në orën pesë pas dite iu afruam Kumanovës. Dielli kishte filluar të perëndojë dhe kishte filluar të bjerë terri. Sa më tepër qielli që bëhej më i errët, aq më trishtuese shkëlqenin shtyllat e zjarrit, të cilat ngjiteshin lart në qiell. Rreth nesh gjithçka digjej. Të gjitha fshatrat shqiptare ishin në flakë, ishin të shndërruara në shtylla të zjarrit – të afërta dhe të largëta, deri në binarët e hekurudhës. Kjo ishte shembull i parë, i vërtetë dhe real i asgjësimit mizor reciprok ndërmjet njerëzve, të cilën e pashë në këtë zonë luftarake. Vendbanimet, pasuria e fituar nga ana e etërve, gjyshërve dhe stërgjyshërve janë zhdukur tërësisht nga zjarri. Tërësia e pamjes monotone të këtij zjarri na ka përcjellë gjatë tërë rrugës deri në Shkup. Atje kemi arritur në orën dhjetë të mbrëmjes. Zbrita nga vagoni për bagëti, në të cilin udhëtova gjatë tërë kohës. Tërë qyteti ishte në qetësi-nëpër rrugë s'kishte njeri të gjallë. Vetëm aty para stacionit të hekurudhës jehonte zëri i të dehurve. Të gjithë që kishin udhëtuar me tren shkuan në rrugën e vet, duke më lënë mua të vetmuar në stacion. Shkova deri te grupi i ushtarëve. Katër ushtarë ishin duke mbajtur bajonetat në gatishmëri, kurse në mesin e grupit qëndronin dy shqiptarë shumë të rinj me plisat e bardhë në krye. Një ushtar i dehur, jo i rregullt komitxhi (çetnik) ishte duke mbajtur në një dorë kamën (thikën), kurse në dorën tjetër shishen e rakisë. Komita jepte urdhra. "Poshtë". Shqiptarët gjysmë të vdekur nga frika ranë në dy gjunjë. "Lart"! U ngritën. Kjo vazhdoi disa herë. Pastaj, komita duke

u kërcënuar dhe duke sharë, drejtoi majën e thikës në fyt dhe në gjoksin e viktimave; kurse më vonë të gjithë i detyroi të pinin raki, më vonë krejt i dehur ...i përqafoi (puthi). I dehur nga pushteti, rakia dhe gjaku, dëfrehej duke lozur me ta, si mace e egër mizore me minjtë. Truqet ishin të njëjta, psikologjia e njëjtë. Ngelën tre ushtarë, të cilët nuk ishin të dehur, rrinin gatitu duke vështruar shqiptarët të mos iknin ose mos të tentonin të bëjnë rezistencë, ashtu që komita të mund të kënaqet në tërësi me argëtimin e vet. "Ata janë arnautë", më tha një ushtar në besim. "Tash do t'i therin në copa".

Me frikë në shpejtësi u largova nga ky grup. Nuk kishte kuptim të tentoj për të shpëtuar shqiptarët. Ata kanë mundur të shpëtohen nga këta ushtarë dhe komita, vetëm me anë të forcës së armatosur. Të gjitha këto ndodhnin në stacionin hekurudhor, ku sa kishte ardhur treni. Ua mbatha këmbëve, supozoj, për të mos i dëgjuar klithmat e dhimbshme dhe lutjet për ndihmë...

Në qytet, ose thënë më saktë, në rrugët e qytetit mbretëronte asi lloj qetësie, sikurse qyteti t'i ishte boshatisur, braktisur në tërësi. Të gjitha dyert dhe portat e shtëpizave ishin të mbyllura qysh nga ora gjashtë pasdite. Me ardhjen e natës komitat fillonin punën e tyre, shkallmonin shtëpitë e shqiptarëve dhe turqve dhe çdoherë kryenin detyrën e njëjtë, plaçkitjet dhe vrasjet. Shkupi kishte 60 mijë banorë, prej të cilëve gjysmën e përbënin shqiptarët dhe turqit. Disa prej tyre sigurisht kishin ikur, por pjesa dërrmuese e tyre kishin mbetur. Dhe tani, natën kundër tyre bëhej hakmarrja.

Dy ditë para ardhjes sime në Shkup, gjënë e parë të cilin banorët në mëngjes kishin parë, kur ishin çuar nga gjymi, ishte grumbulli i kufomave të shqiptarëve me kokat e prera, nën urën e Vardarit, mu në qendër të qytetit. Disa thoshin se ata ishin kufomat e shqiptarëve lokalë, të cilët i kishin mbytur komitat, kurse të tjerët thoshin se ato kufoma i kishte pru Vardari deri në urë. Në çdo rast ishte e qartë se ata njerëz me koka të këputura nuk ishin vrarë në luftë...

Shkupi, thjesht ishte shndërruar në një kamp ushtarak. Banorët, posaçërisht myslimanët fshiheshin, ndërkaq nëpër rrugë mund të shiheshin vetëm ushtarakët. Në mesin e turmës së ushtarëve mund të shih-

eshin fshatarët serbë, të cilët kishin ardhur të kërkojnë (gjejnë) djemtë dhe vëllezërit e tyre, ata kalojnë Fushë-Kosovën dhe fillojnë plaçkitjen. Bisedova me tre nga këta torbarë. Ata kishin ardhur nga Shumadija, qendra e Serbisë, në këmbë nëpërmjet të Fushë-Kosovës. Më i riu në mesin e tyre, një njeri trupshkurtër, "sojit të të patremburve", mburrej se në fushë kishte vrarë dy arnautë me pushkën e vet automatike. "Ishin katër veta, por dy veta arritën të ikin". Bashkudhëtarët e tij, fshatarë të moshuar, e vërtetuan rrëfimin. "Një gjë s'është mirë", ankohen "nuk kemi të holla të mjaftueshme me vete. Këtu mund të merren kije dhe kuaj me bollëk. Rroga ushtarake është 2 dinarë (75 kopejka). Ushtari shkon në fshatin e parë shqiptar në të cilin ndesh rrugës dhe menjëherë ta bien kalin e mirë. Me ndihmën e ushtarit mund të fitosh një palë kije të mirë, për njëzet dinarë. Nga lokalitetet rreth Vrajës, banorët masivisht janë vënë në lëvizje në drejtim të fshatrave shqiptare, për të plaçkitur të gjitha ato që mund të gjenden atje. Gratë fshatare kanë mbajtur në shpinë edhe dyert e dritaret nga shtëpitë shqiptare.

Dy ushtarë erdhën deri tek unë. Ata i takojnë njësisë, e cila i çarmatoste shqiptarët nëpër fshatra. Një ushtar më pyeti se ku mund të këmbejë një lirë. Kërkova të më tregojë lirën, pasi që kur nuk kisha parë atë monedhë turke. Ushtari shikoi me kujdes përreth, pastaj nxori nga portofoli lirën, duke bërë me shenjë se ende ka kësi lira në portofol, vetëm nuk dëshiron që askush të dijë për këtë. Një turke, siç edhe e dini vlen 23 franga.

Tre ushtarë kaluan pranë meje. Dëgjova bisedën e tyre. "Kam vrarë as vetë nuk e di sa shqiptarë", tha njëri, por te asnjëri prej tyre nuk gjeta asgjë të vlershme. Por, atëherë kur e preva një bullë (femra e re myslimane), vetëm te ajo gjeta dhjetë lira të arit".

Ata për këto gjëra këtu flasin bukur haptas, në mënyrë të qetë dhe të painteresuar. Kjo është diç e zakonshme. Njerëzit nuk janë duke kuptuar se çfarë ndryshime të mëdha të brendshme kanë sjellë këto disa ditë të luftës. Mund të shihet se në çfarë mase njeriu, varet nga rrethanat. Në kushtet e organizuara të brutalitetit të luftës njerëzit shpejt bëhen të brutalizuar, e aspak nuk janë të vetëdijshëm për këtë fakt.

Një tog i ushtarëve marshoi nëpër rrugën kryesore të Shkupit. Një turk i dehur me të gjitha shenjat e gjysmëçmendurisë diçka mallkoi. Ushtarët e ndalën, e mbështetën turkun për murrin e shtëpisë më të afërt dhe në vend e pushkatuan. Togu vazhdoi edhe më tutje rrugën si edhe masa përcjellëse. Gjithçka kishte marrë fund.

Atë natë, në një kafene takova një toger, të cilin e njihja edhe më herët. Njësia e tij ishte i stacionuar në Ferizoviq (Ferizaj), qendër e shqiptarëve në Serbinë e Vjetër. Togeri, me njerëzit e vet, e tërhoqi topin rrethues, gjatë defilimit prej Koçanës deri në Shkup, prej ku do t'i dërgohet ushtrisë në Edirne, të cilën e kishte rrethuar ushtria.

"E çka bëni tani në Ferizoviq, në mes të shqiptarëve?", e pyeta oficerin.

"Pjekim zogj dhe i vrasim arnautët. Por, jemi të lodhur nga kjo", shtoi duke hapur gojën nga mërzia dhe lodhja. "Ka shumë njerëz të pasur në mesin e tyre. Afër Ferizoviqit hymë në një fshat të pasur, me shtëpi sikur kulla. Hymë në një shtëpi. I zoti i shtëpisë, një burrë në moshë të shtyrë, i cili kishte tre djem, do të thotë, ishin katër burra dhe shumë femra. Të gjithë i nxorëm jashtë shtëpisë, gratë i renditëm me një anë dhe meshkujt i premë para syve të tyre. Gratë nuk vajtonin; sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Vetëm na u lutën që t'i lejojmë që të largohen nga shtëpia dhe të marrin gjësendet e tyre. I lejuam të largohen. Të gjithë neve na dhanë dhurata të bukura. E pastaj e dogjëm tërë fshatin".

"Po, si mundeni kaq brutalisht të silleni ?", e pyeta i shokuar nga tregimi i tij.

"Nuk e di as vetë – adaptohesh në të gjitha. Në ndonjë kohë të tjetër, sinqerisht nuk do kisha qenë në gjendje, për shembull, të vras njeriun plak, ose fëmijën e pafajshëm. Në kohën e luftës, siç edhe e dini, komandimi ju jep urdhra dhe ju duhet t'i zbatoni. Shumë gjëra, siç ishte edhe ky rast kanë ndodhur shumë herë edhe tani shpejt. Derisa e tërhiqnin atë top prej Shkupit, në rrugë kemi rastisur në një qerre të kuajve të mbuluar, ku ishin shtrirë katër burra të mbuluar deri në bel. Menjëherë hetova aromën e jodit. U mendova, mos kishte diçka atje brenda dyshimtë. E ndala qerren, i pyeta kush janë dhe kah

shkojnë. Heshtnin, duke u bërë se nuk kuptonin serbisht. Me ta ishte vetëm një karrocier maxhup dhe ai më sqaroi se ishin katër shqiptarë, të cilit kishin marrë pjesë në luftimet në Merdar; dhe se ishin plagosur në këmbë dhe tani janë në rrugë për në shtëpi. Do të thotë çdo gjë ishte e qartë.

"Zbritni", i thashë, kuptuan çfarë domethënie kishte ajo, por ata kundërshtuan, nuk donin të zbritnin nga qerrja. Çka të bëhet tjetër? E vendosa bajonetën në pushkë dhe e kreva me të gjithë të katërtit që ishin në qerre..."

Unë e njihja këtë njeri. Ishte kamerier në Kragujevc. Djalosh pa ndonjë kualitet të veçantë. Për nga natyra joluftarak. Kamerier si edhe shumë kamerierë në vendet tjera. Një kohë ishte edhe anëtar i sindikatave të kamerierëve. Ishte edhe sekretar një kohë të shkurtër, e pastaj i braktisi të gjitha ato...E tani, shikoni mirë në çka e kanë shndërruar dy apo tri javë të luftës.

Pse silleni sikur banditët! Jeni duke vrarë dhe plaçkitur pa kurrfarë dallimi!; bërtita me zë të lartë, duke u prapsur me gërditje më të madhe fizike nga njeriu me të cilin bisedoja.

Togeri e ndiente veten të bezdisur. Pa mëdyshje, diçka i kishte rënë ndërmend, mendohej dhe krahasonte. Kurse më vonë, për të arsyetuar veten, foli i bindur dhe me plot seriozitet, frazën e cila edhe më tepër hodhi dritë në errësirën që e shihja dhe që e dëgjoja.

"Jo, nuk është ashtu. Ne, ushtria e rregullt, në mënyrë të përpiktë u përmbahemi kufijve të përcaktuar dhe asnjëherë nuk i vrasim personat nën moshën 12-vjeçare. Për komitat asgjë nuk mund të them me siguri të plotë. Ata janë çështje e veçantë. Por, mund t'ju garantoj për ushtrinë."

Togeri nuk ka dashur të garantojë për komitat. Dhe me të vërtetë, ata nuk kanë respektuar asgjë, nuk dinin për asnjë kufi. Të rekrutuar kryesisht nga djerrakohësit, papunëtorët, të pa aftët, të gjithë këta elementë keqbërës ishin nga fundërrina e shoqërisë – ata vrasjet, plaçkitjet dhe dhunën e kishin shndërruar në argëtim të egër. Veprat e tyre flasin tepër bindshëm kundër tyre- edhe pushteti ushtarak kanë pasur ndjenjën e pakëndshme për shkak të bakanaleve të përgjakshme, me

të cilat lufta kryengritëse ishte degjeneruar dhe për këtë arsye kishin ndërmarrë masat vendimtare; duke mos pritur që lufta të mos përfundojë, kanë çarmatosur komitat dhe i kanë dërguar në shtëpi.

Nuk isha më në gjendje të duroj këtë atmosferë, nuk kam pasur lukthin aq të fortë për këto gjëra. Interesi politik dhe kërshëria e madhe morale e entuziazmi të gjitha këto u zhdukën. Të gjithë ajo çka më ngeli ishte një dëshirë e vetme, të largohem sa më shpejt nga ky vend. Sërish u gjeta në vagonin për transportimin e bagëtisë. Shikoja fushat e gjëra rreth Shkupit; çfarë bukurie, çfarë gjerësie, njerëzit kishin mundur të jetojnë mirë; por edhe përkundër kësaj...mirë çfarë dobie të flitet, ju e dini këto ide; vetëm ato më vërshonin në atë vend me fuqinë dhjetëfish të shtuar. Pesëmbëdhjetë minuta pasi që treni e braktisi stacionin, shikova jashtë dhe pashë dyqind jardë nga hekurudha kufomën të shtrirë për toke me fesë në krye, me fytyrën e kthyer kah toka, me krahët e hapur. Rreth pesëdhjetë jardë në drejtim të hekurudhës, qëndronin dy roje serbe, pjesë e forcave që ruanin hekurudhën; ata diç bisedonin dhe qeshnin, njëri prej tyre tregonte kufomën. Pa kurrfarë mëdyshje kjo ishte vepra e tyre. Sa më larg, sa më larg, vetëm sa më parë të largohem nga ky vend!

Jo fortë larg Kumanovës, në një livadh afër hekurudhës, ushtarët ishin duke hapur një gropë të madhe. I pyeta, se për çka është fjala. Më thanë se gropa do të shërbejë për mishin e kalbur, i cili gjendej në pesëmbëdhjetë ose njëzet kamionë, të cilët ishin parkuar anash. Ushtarët, siç u konstatua, nuk donin të merrnin racionin e tyre të mishit. Të gjitha ato për çka kishin nevojë, por edhe më tepër i merrnin drejtpërdrejt nga shtëpitë e shqiptarëve: tamblin, djathin, mjaltin etj. "Në atë kohë kam ngrënë më shumë mjaltë në llogari të shqiptarëve sesa në tërë jetën time deri atëherë", më tregoi një ushtar të cilin e njihja. Çdo ditë ushtarët thernin lopë, dhenë, derra, pula dhe i hanin, duke gjuajtur ushqimin e mbetur. "Neve nuk na duhet mishi", më tha një oficer intedanti. "Neve na mungon buka. Kemi shkruar njëqind herë në Beograd, që të mos na dërgojnë mish, por ata vazhdojnë të veprojnë në pajtim me një procedurë rutinë".

Kështu qëndrojnë gjërat ku t'i vështron nga afër. Mishi kalbet, si mishi i njeriut po ashtu edhe mishi i kafshëve, fshatrat janë shndërruar në shtylla të zjarrit; njerëzit shfarosin 'personat mbi moshën 12-vjeçare', çdokush është i brutalizuar, duke humbur pamjen e vet njerëzore. Lufta shpaloset si një gjë primare dhe kryesore, një e keqe, vetëm kur e ngrini një anë të perdes, e cila mbulon veprat e trimërisë ushtarake..."

Kievskaya Mysl No. 355

23 dhjetor, 1912.

- Në provincat e reja -

Lajmet e këqija vijnë nga provincat e pushtuara. Së pari na flitnin vetëm për klithmat e entuziazmuara të banorëve të çliruar, për fjalimet patriotike, për administratorët të porsaemëruar. Por, klithmat dhe fjalimet patriotike kanë pushuar, kurse kaosi dhe çrregullimet kanë mbetur. Por, edhe para luftës në Maqedoni ka pasur elemente të mjaftueshme për dezintegrimin shoqëror dhe anarkinë politike. Lufta kryengritëse dhe sulmet me dinamit kanë dhënë oreolin ushtarak këtyre elementeve dhe e kanë ngritur bindjen se atyre gjithçka u është lejuar, gjithçka mund të bëjnë. Përkohësisht, të gjitha këto lufta i ka thithur. Por tani, sërish kanë dalë në sipërfaqe, thellësisht të prishur me përvojën e luftës.

Më ra në dorë kopja e letrës, të cilën e kishte shkruar një nëpunës i dërguar në Shtip, me detyrë që aty të organizojë filialin e bankës kombëtare. Letra është shumë domethënëse, ashtu që këtu do të paraqes në tërësi.

"Arrita para katër ditëve dhe menjëherë u pendova që erdha këtu. Këtu pashë gjëra trishtuese. Nuk kam besuar se këto gjëra mund të ndodhin, që janë të mundura. Në orën gjatë të mbrëmjes tërë qyteti ishte i vdekur. Shtëpitë e turqve dhe të hebrenjve, të cilët në këtë qytet përbënin gjysmën e popullatës së qytetit, në tërësi janë të boshatisura. Të gjitha shitoret dhe shtëpitë në atë pjesë të qytetit, ku jetonin këta, në tërësi janë të plaçkitura ose të shkatërruara. Plaçkitjet dhe vrasjet ndodhin përherë. Para syve të mijë, më dy nëntor në mesditë, rreth 20 ose 25 çetnikë dhe vagabondë (endacakë të natës) sulmuan një hebre,

të moshës 60 ose 70-vjeçare dhe ia thyhen kokën. Unë ndërhyra dhe fillova të thërras policinë. "Kapni, edhe ai është hebre"!, filluan të bërtasin. Filluan të më ndjekin, kështu që u detyrova të ik. U mbylla në dhomën time, në katin e parë, e nxora revolen, gjë që e bëri edhe pronari i shtëpisë, ku isha duke banuar. Hajdutët filluan të shqelmonin derën, por dera ishte shumë e fortë. Shoqja ime, e cila kishte mbetur përjashta, u mundua të fshihet në bodrum. Kur ndjekësit kuptuan se nuk gjendem aty, pushuan të më kërkonin. Pas një rrethimi të shkurtër, hajdutët u tërhoqën. Dërgova një njëri deri te prefekti, te kryeshefi i administratës së qarkut, te shefi i policisë dhe te komandanti i kryengritësve. Në afat prej një, ndërmjet dymbëdhjetë dhe pesëmbëdhjetë anëtarë "udhëheqës" u tubuan në dhomën time. Pa kurrfarë mundi u konstatua se kush e kishte vrarë plakun: disa kryengritës të përmendur, bashkë me disa hajdutë në petkun e anëtarëve të rinj të pranuar në njësitë kryengritëse. Asnjëri prej tyre nuk u dënua. Këtu nuk ka ushtri, kurse këta "kryengritës" janë zotët e situatës. Disa udhëheqës të kryengritësve gjatë kësaj periudhe kanë grabitur pasuri dhe të holla në vlerë prej tre deri në katërmijë lira (një lirë vlen 23 franga). Në Radovishtë dyshohet se shefi lokal i policisë, në mënyrë të fshehtë bashkëpunon me këto banda.

Kjo është situatë tmerruese. Dikur, kur shihni si fshatarët paqedashës turq janë therur pa kurrfarë arsyeje, e tërë pasuria e tyre është marrë, kurse gratë dhe fëmijët e tyre janë lënë të vdesin nga uria, zemra më copëtohet nga dhembja. Ndërmjet Radovishtës dhe Shtipit afro 2000 refugjatë turq, kryesisht gra dhe fëmijë, kanë vdekur nga uria – tekstualisht nga uria...".

Plaku shtatëdhjetëvjeçar me kokën e çarë, mijëra gra dhe fëmijë të vdekur nga uria, kryengritësit revolucionarë të degjeneruar në hordhitë banditeske, shefi i policisë së rrethit si mbrojtës i plaçkitësve – kjo është pamja e jetës në këtë provincë të çliruar. Kur në këtë atmosferë, administratorët e rijnë në mënyrë, secili gjithmonë manifeston heroizmin e Katos. Kufizimet e arbitraritetit keq janë të definuar, kurse mundësitë për pasurimin e shpejtë janë tepër provokuese. "Thuaj N.N.", shkruan një nëpunës tjetrit, "se këtu toka mund të blihet shumë lirë, e

posaçërisht në Ovçje Pole". Turqit ikën, kanë braktisur pasuritë e veta dhe grabitja e tokës së turqve është në hovin më të madh. Njerëzit largpamës veç kanë gjetur rrugën e vet në provincat e reja, vështrojnë dhe kontrollojnë përreth dhe masin mundësitë e reja. Shumë ushtarë bullgarë kanë menduar, jo pa inkurajimin e organeve të larta, se tokat e braktisura do t'u jepen atyre. Kur kishin ditën e lirë, ata vështronin ndonjë pjesë të bukur dhe vendosnin gurët kufitarë...Këta djelmosha gabonin. Ata familjeve dhe në shtëpitë të veta, nga ekspedita ushtarake do t'u sjellin disa gjëra të pavlefshme turke, krahun e plagosur, reumatizmin e dhimbshëm, i cili do t'i përcjellë derisa të jenë gjallë. Toka do t'u takojë çorbaxhijnve, politikanëve të pasur dhe largpamës. Sot, të drejtat e reja pronësore janë të përcaktuara dhe "kufijtë" e vendosur të pronësisë janë të pacenueshëm.

Për një kohë të shkurtër, lufta e rreptë qytetare do të fillojë, luftë qytetare në të cilin kryengritësit duhet të thonë fjalën e tyre të fundit. Por mbi të gjitha, vendosja e rendit në "provincat e pushtuara" do të bjerë në barrë popullit punues të Bullgarisë.

- Një pyetje jashtëparlamentare zotëri N. Miljukovit[2]

Zotëri deputet,

Ju jeni njëri prej iniciatorëve dhe inspiratorëve të asaj që njihet si "lëvizja neosllave", e cila paraqitet në emër të asgjë më pak, se në emër të parimeve të përgjithshme të civilizimit, humanizmit dhe të lirisë kombëtare.

Ju shpeshherë, si në faqet e gazetave, ashtu edhe nga foltorja e Dumës, keni bindur aleatët ballkanikë – përkatësisht dinastitë dhe klikat dinastike të sundojnë me Ballkanin – me simpatitë e pandryshuara të të ashtuquajturës të shoqërisë ruse në fushatën e "çlirimit". Kjo nuk ka qenë fortë larg.

[2] Pavel Nikolaeviq Miljukov (1859-1943), historian dhe politikan rus; themelues dhe udhëheqës i partisë liberale ruse – Partisë Demokratike Kushtetuese (Kadetëve). Ka qenë redaktor i organit jozyrtar partiak *Rec* (Fjala) dhe udhëheqësi i grupit të deputetëve të kadetëve në Dumën e Katërtë (prej vitit 1912), kur edhe Trocki i shkroi këtë letër. I njohur me orientimin e vet sllavofil (M.B)

Pak kohë më herët, gjatë ndërprerjes së zjarrit, ju keni pasur një udhëtim politik në Ballkan; keni vizituar disa qendra dhe çka është posaçërisht me rëndësi, keni vizituar edhe provincat të cilat, kohë më parë janë pushtuar nga ana e aleatëve.

A nuk keni dëgjuar gjatë udhëtimeve tuaja - duhet patjetër të supozojmë se për ju kishte me qenë shumë interesante – për aktet monstruoze të brutalitetit, të cilat i kanë kryer ushtarët fitimtarë të aleatëve gjatë tërë rrugës së vet të luftës, jo vetëm kundër ushtarëve të paarmatosur turq, të plagosurve dhe ndaj robërve të luftës, por edhe kundër banorëve pandashëm myslimanë, ndaj pleqve dhe plakave, si dhe ndaj fëmijëve të paaftë dhe të pambrojtur?

Në rast se keni qenë të informuar – e nuk keni mundur mos me qenë të informuar!- atëherë pse heshtni.

Pse hesht e juaja, plot elokuencë "Rec"?[3]

A nuk ju kanë detyruar faktet e pakontestuara dhe të pamohueshme, të konkludoni se bullgarët në Maqedoni dhe serbët në Serbinë e Vjetër[4], që në vrullin e vet nacional të ndryshojnë të dhënat etnografike statistikore, të cilat nuk janë në favorin e tyre, thjesht janë të angazhuar në shfarosjen sistematike të banorëve në fshatra, në qytete dhe në rrethe?

Çka keni për të thënë në pikëpamje të këtyre metodave me qëllim të sigurimit të fitores të elementit sllav? A nuk pajtoheni se komploti i heshtjes nga ana e të gjitha gazetave "kryesore" - "Rossiya-s" qeveritare, gazetës gjarpërore patriotike "Russkoye slovo" dhe "Rec" e cila gjithmonë pretendon të ketë renomenë superiore - kjo marrëveshje reciproke për heshtje, u bën të gjithë juve bashkëfajtorë dhe bashkëpjesëmarrës në këto akte shtazarake, të cilat do të lënë gjurma të pashlyeshme dhe të pandershme në tërë epokën tonë?

A nuk janë, në këto rrethana, protestat tuaja kundër veprave të liga të turqve, të cilat unë assesi nuk dua t'i mohoj - ngjashëm me sjelljet e farijsejëve; burimi i të cilave, patjetër kështu duhet supozuar, nuk janë

[3] Lojë fjalësh për revistën "Rec" e cila ka qenë në zë për artikujt plotë elokuencë dhe qëndrim sllavofile. (M.B)

[4] Emërtimi i Kosovës në fjalorin e nacionalistëve dhe pushtuesve serbë. (M.B.).

nga parimet e përgjithshme të kulturës dhe të humanizmit, por nga kalkulimet e zhveshura e të pangopura imperialiste? A nuk e keni qartë se miratimi i heshtur, nga ana e "partive kryesore e udhëheqëse ruse" ndaj krimeve të bullgarëve dhe të serbëve, tani - kur aleatët ballkanikë kanë ripërtëritur operacionet luftarake - ua lehtëson këtyre të fundit, që të angazhohen në veprën e tyre të Kainit, me masakrat vazhduese ndaj popujve të Gjysmëhënës, në interes të "kulturës" të Kryqit? A mund të përgjigjeni në këto pyetje të thjeshta dhe të qarta, zotëri deputet?

Ose ju përfundimisht jeni të mësuar t'i mblidhni dy plus dy, dhe të gjeni vendosmëri të mjaftueshme të konkludoni se udhëheqësi i opozitës së "përgjegjshme" pasi është dakorduar të jetë ndërmjetës mes diplomacisë petrogradase dhe të dinastive ballkanike, në këtë mënyrë ka pranuar një pjesë të përgjegjësisë para opinionit publik të vendit të vet, për stomakët e shqyer të fëmijëve turq dhe të kokave të prera të pleqve myslimanë.

Në rast se është ashtu, juve asgjë tjetër nuk ju ngel vetëm të heshtni. Por në atë rast, heshtja e juaj ka me pasur fuqinë e gjykimit e të mospajtimit, të cilin fjalimet tuaja asnjëherë nuk kanë poseduar.

Luc No. 34 (110)
30 janar, 1913.

"Znakovi Vremena"
Përktheu nga boshnjakishtja:
Menduh Bamja

Naucno-istrayivacki institut
"IBN SINA", Sarajevo, 2001, Vol. 4, nr. 11, fq. 65-175

Menduh Bamja

THE WAR CORRESPONDENCE OF LEON TROTSKY: BALKAN WARS 1912-1913

(Summary)

In the autumn of 1912, Leon Trotsky (1879-1940), a Russian revolutionary, was sent to the Balkans as a correspondent of the "Kievskaya Mysl" newspaper. His reports from the battlefields were published in the 6th volume of the Sochinenia, which were published in Russian between 1923 and 1927. The reports on the Balkans and the Balkan Wars were translated in English in 1980. These reports were re-published on a number of occasions, especially between 1991 and 1999, a period which coincides with the outbreak of wars in the former SFRY as a consequence of the expansionist policy of Serbia.

تقارير لاف تروسكى
(الحروب البلقانية 1912–1913)

(خلاصة البحث)

في خريف سنة 1912و لاف تروسكى (1879–1940) ثائر روسى تم إرساله إلى البلقان كمراسل لجريدة "كيفسكايا موسل" و قد تم نشر تقاريره عن المعارك في البلقان في المجلد السادس في مجموعة أعمال "سوشنينا" باللغة الروسية خلال الفترة من (1923–1927) و قد تم ترجمة هذه التقارير إلى اللغة الانجليزية سنة 1981م و تم اعادة نشرها عدة مرات و خاصة خلال السنوات (1991–99) عندما بدأت الحروب في يوغسلافيا السابقة. النص الذي ينشر يتحدث على المجازر التي أرتكبت من قبل الدول البلقانية في حق المسلمين.

NJË RECENSION I VONUAR

Dr. Feti Mehdiu

Dr. Hasan Kaleshi, NAJSTARIJI VAKUFSKI DOKUMENTI U JUGOSLAVIJI NA ARAPSKOM JEZIKU[1], Prishtina, 1972, fq. 356 (Dokumentet më të vjetra të vakëfit në gjuhën arabe në Jugosllavi)

Kjo vepër e dr. Hasan Kaleshit është mbrojtur tezë doktorate në Universitetin e Beogradit dhe është botuar në gjuhën serbokroate në vitin 1972, në Prishtinë në serinë e botimeve të Bashkësisë së Institucioneve Shkencore të Kosovës, me numrin 23.

Recensentët e këtij botimi janë: akademik dr. Mehmed Begoviq dhe dr. Hazim Shabanoviq.

Në kohën kur është botuar ky tekst ka zgjuar interesim të madh në qarqet shkencore të orientalistikës në shumë qendra shkencore, sidomos ato evropiane. Qenë botuar disa recensione në revistat më eminente të kohës që trajtojnë problemet historike, filologjike etj., që janë të lidhura me studimin e dokumenteve të vakëfit në gjuhën arabe.

Në revistën më të vjetër për çështje të orientalistikës *Journal Asiatique* të Parizit, në revistën për islamologji të Hamburgut *Der Islam,*

[1] Botohet në shenj kujtimi të profesor dr. Hasan Kaleshit(1922-1976), themeluesit të orientalistikës shqiptare, në tridhjetëvjetorin e vdekjes: 1976-2006. Botohet për herë të parë në gjuhën shqipe.

në *Etudes balcaniques* të Sofjes. Është prezantuar edhe në disa revista të hapësirës në ish-Jugosllavi, si në: *Jugoslovenski istorijski casopis*, Beograd, në *Glasnik na Institut za Nacionalna Istorija*, Skopje, madje edhe në gjuhën arabe.[2]

Meqë vepra në fjalë ka rëndësi të veçantë për historinë tonë të kulturës në përgjithësi, duke përfshirë këtu edhe lëmin e Kur`anit,[3] na duket me arsye që ta njoftojmë edhe opinionin shkencor e kulturor shqiptar me çështjet e shtruara dhe të trajtuara në këtë vepër.

Libri ndahet në tetë kaptina.

Hapet me parathënien. Vijon pasqyra e transkribimit të alfabetit të gjuhës arabe dhe një tekst hyrës.

Në kaptinën e parë(21-49) autori jep një studim shterues përkitazi me hyrjen dhe përhapjen e gjuhës arabe në rajone të caktuara. Bën fjalë për ndikimin e kulturës dhe civilizimit islam, në këto anë dhe mishërimin e njerëzve tonë me shkrimin dhe kulturën orientale në tërësi. Për herë të parë këtu flet veç e veç për disa lloje dokumentesh siç janë, kurorëzimi, shkurorëzimi, caktimi i alimentacionit, lirimi nga robëria, për certifikata dhe diploma të ndryshme, të cilat janë shkruar në gjuhën arabe dhe jo në osmanishte, përkundra faktit se i përkasin periudhës së administratës osmane.

Për të gjitha këto autori jep edhe tekstin origjinal, në gjuhën arabe, i cili për shkak të mungesës së mjeteve teknike ka dalë me disa të meta. Për shembull mungojnë pikat diakritike, mungesa e të cilave e vështirëson leximin e tekstit. Sikur të kishte faksimile të ndonjërit nga këto dokumente, sa për ilustrim, do ta bënte më të fuqishme këtë kaptinë. Me interes të veçantë nga këto dokumente janë Ixhazetnamet, nga të cilat mund të nxirren informata për një varg profesorësh dhe

[2] *Al-Ma arifa*, nr. 193-194, 1978, Damask, pp. 311-315.

[3] Nga këta dokumente të vakëfit shihet se sa rëndësi i jepnin vakëfet mësimit të Kur'anit si edhe disiplinave tjera islame siç janë tefsiri, fiku-l-ibadati, texhvidi etj. Në disa vakëfname është precizuar se cilën sure të Kur`anit duhet të këndojë hafizi pas namazit të jacisë e cilën pjesë pas namazit të sabahut duke caktuar edhe shpërblimin e veçantë, p.sh. nga dy akçe në ditë, për suren **Jasin**, pas namazit të sabahut; një akçe në ditë për të kënduar suren **Mulk**, pas namazit të drekës, etj. Shih më gjerësisht kapitulli V. Vakëfnameja e dytë e Is` hak Çelebiut nga Manastiri e vitit 1508.

shkencëtarësh të disiplinave të ndryshme që përcillnin dituritë brez pas brezi.

Në këtë kaptinë mësojmë se edhe të krishterët kurorëzoheshin dhe shkurorëzoheshin para kadiut mysliman. Kjo ka rëndësi për studime sociologjike dhe çështjen e shtrirjes së ndikimit të qytetërimit islam.

Kaptina e dytë(49-63) u kushtohet vakëfnameve dhe botimeve të tyre. Këtu autori bën ndarjen në tri grupe: Mbishkrimet e vakëfit, përshkrimet e vakëfnameve, të cilat paraqesin rezymenë e origjinalit të ndonjë vakëfnameje të humbur dhe vakëfnamet ose vakëfijet. Këto të fundit paraqesin burime të dorës së parë për studimin e vakëfeve si në pikëpamje historike, juridike, filologjike etj. Po në këtë kaptinë bëhet edhe përpunimi diplomatik i vakëfnameve, elementet diplomatike të tyre siç janë: Ekspozicioni, dispozicioni, kushtëzimi, legalizimi, sanksioni, datimi etj. Është theksuar edhe në recensionet e deritanishme se tani kemi për herë të parë përpunim diplomatik të vakëfnameve, gjë që nuk e gjejmë në veprat e diplomacisë turko-osmane të autorëve L.Fekete, Guboglu, etj.

Kaptinat : III. IV, V, VI, VII dhe VIII(fq. 65-308) përfshinë nëntë vakëfnamet më të vjetra në gjuhën arabe në Jugosllavi, që u përkasin viteve 1435 e këndej, të cilat radhiten si vijon:

I - Vakëfnameja e Sunkur Çaush beut nga Manastiri, e cila mban datën 9-19 prill 1435(f.721-88). Autori pohon se ky është dokumenti më i vjetër i këtij lloji, që është zbuluar deri tani në vendin tonë.[4]

II - Vakëfnameja e Is-hak beut nga Shkupi, 9-18 shkurt 1445

III - Vakëfnameja e Sinanuddin Çelebiut nga Ohri, 1491

IV - Vakëfnameja e Is-hak Çelebiut nga Manastiri e datës 22-30 qershor 1506

V - Vakëfnameja e Is-hak Çelebiut nga Manastiri, 10-19 korrik 1508.[5]

[4] Në kohën kur dr. Hasan Kaleshi ka hulumtuar për këtë temë dhe kur e ka mbrojtur tezën e doktoratës – kjo i referohet periudhës deri në vitin 1960 - me shprehjen "në vendin tonë" ka përfshirë ato vende që ishin pjesë e Jugosllavisë së atëhershme.

[5] Disa nga kushtet që parashtronte vakëfi ishin edhe këto:

VI - Vakëfnameja e Is-hak Çelebiut nga Manastiri e datës 18-27 qershor 1511, dhe

VII - Vakëfnameja e Is-hak Çelebiut nga Manastiri e datës 24 shtator 3 tetor 1511

Nga këto katër vakëfname të Is-hak Çelebiut nga Manastiri, dy të parat janë legalizuar në Manastir kurse dy të fundit në Selanik.

VIII - Vakëfnameja e Muslihuddin al- Madinit, ndërtuesit të Kurshumli hanit në Shkup dhe që mban datën 21 dhjetor 1549, 2 janar 1550, është njëra nga dokumentet që e entuziazmoi autorin me shkrim shumë të bukur dhe stil fantastik, dhe

IX - Vakëfnameja e Koxha Sinan Pashës, 23 korrik 1556.(fq. 278-308).

Dokumentet jepen në gjuhën arabe, e disa sish, pjesërisht janë prezantuar edhe me faksimile, për të pasur mundësi shkencëtari t'i krahasojë me origjinalin dhe ta kontrollojë deshifrimin. Secilit nga këto dokumente i prin studimi i posaçëm mbi themelimin e vakëfit. Për shembull këtu kemi studimin më të hollësishëm për Vezirin e Madh, Koxha Sinan Pashën, për të cilin dr. Hasan Kaleshi ka dëshmuar me fakte se ky është me origjinë shqiptare nga fshati Topojan i Lumës. Autori hedh dritë edhe mbi një varg personalitetesh tjera me origjinë shqiptare. Pastaj në vija të përgjithshme i bën vështrim kritik vakëfnames që vijon, në pikëpamje historike dhe filologjike.

Pason teksti origjinal dhe përkthimi me shumë kujdes. Faksimili është vënë në fund të përkthimit, gjë që do të ishte më praktike sikur të ndodhej kundruall tekstit të deshifruar.

"I ka kushtëzuar që të mësojë fëmijët bonjakë të lexojnë Kur`an dhe prej asnjërit të mos kërkojë kurrfarë pagese. Në të kundërtën do të largohet nga puna."

"... që pesë recitues të mirë të Kur`anit të lexojnë pesë xhuz`a nga Kur` ani, në xhaminë e përmendur për shpirt të Pejgamberit a.s., dhe këtë duhet bërë pasi ta ketë falë xhemati namazin e drekës. Secilit kurr-rra t`i paguhet nga një dërhem në ditë."

"Udhëheqësit të hafizëve i ka caktuar nga dy dërhem në ditë, kurse tre hafizëve, përveç udhëheqësit të tyre, nga tre dirhem në ditë me kusht që secili prej tyre të këndojë ditën e xhuma në mafil nga një ashere nga Kur`ani... me një melodi të këndshme, jo këndim pa shije."(198-199), etj.

Gjatë punës së tij autori nuk kënaqet vetëm me përkthimin, por ia del të sqarojë edhe shumë çështje tjera. Shkoqit emërtime të ndryshme, krahason qëndrimin e shkencëtarëve të tjerë përkitazi me ndonjë problem historik, na jep informata për titujt e plotë të veprave të ndryshme, të cilat i janë vënë në dispozicion ndonjë vakëfi,[6] na afron të dhëna shumë të vlershme biografike dhe me rëndësi historike lidhur me autorët e atyre veprave dhe vetë veprat. Njëkohësisht bën edhe korrigjimin e ca autorëve, të cilët e kanë cekur këtë problem, me qëllim që ta sqarojnë, por, pa ndonjë studim serioz. Dr. Hasan Kaleshi arrin ta vërë problemin përkatës në binarë shkencorë. Gjithashtu me sukses ndërhyn edhe në përmirësimin e tekstit në dokument, pas të cilit përmirësim dokumenti merr kuptimin e plotë (fq. 124, 125, 160, 161, etj)

Përkthimi korrekt dhe plotësimet me sqarime gjegjëse janë një dëshmi se kemi të bëjmë me një njohës të dalluar të arabishtes siç ishte dr. Hasan Kaleshi, i cili gjatë punës në këtë vepër është shërbyer edhe me literaturë në gjuhën turke, gjermane dhe gjuhë të tjera, në të cilat janë bërë studime nga kjo fushë.

Në fund (fq. 309-313) vjen përfundimi, pas të cilit vijon lista e burimeve dhe literaturës(315-320), prej nga shihet se autori i ka kushtuar kohë të gjatë këtij punimi. Ka bërë kërkime shkencore në arkivat dhe bibliotekat e Ankarasë, Stambollit, Bosnjës, Maqedonisë dhe Kosovës. Njëherësh ka përdor literaturë të pasur në gjuhë të huaja dhe të vendit.

Rezymenë e veprës (321-341) dr. Hasan Kaleshi e jep vetëm në gjuhën shqipe dhe gjermanishte.

Nuk do të ishte e tepërt, përkundrazi do ta bënte më të afërt veprën, sikur rezymeja të bëhej edhe në gjuhën arabe, ngase vepra në fjalë ka një rëndësi të veçantë për kulturën arabe dhe ndikimin e saj në Ballkan, pikërisht falë institucionit të vakëfit dhe zbatimit me konsekuencë të atyre normave nga administrata osmane.

[6] Për shembull, në vitin 1511, Isa hak Çelebiu kishte lënë vakaf librat: Al-Hidaje, Sadrush-sheria, Hashija as-sajjidush-sherif, Sharh Fanari, Shar Sajjid li-l-Fanari, Tefsir Kadi Bejdavi, Sherh akaid, etj.

Në fund libri ka listën e emërtimeve gjeografike dhe topografike (343-346) dhe regjistrin e emrave të përveçëm (347-356) me ç'rast përmbushen të gjitha kriteret për një vepër shkencore.

Përkundër ndonjë gabimi të vogël, që nuk çon shumë peshë, ky libër i dr.Hasan Kaleshit i vetmi në listën e studimeve shkencore të këtij lloji, është një kontribut i çmuar për shkencën dhe kulturën shqiptare e më gjerë. Vlera e tij nuk është e kufizuar vetëm në historinë tonë të kulturës, por është me interes të posaçëm edhe për historinë politike dhe legjislaturën. Këtu mund të kërkohen edhe arsyet e dominimit osman si dhe zbatimin e këtyre normave nga osmanlinjtë në vendet e posazotëruara.

Në bazë të dokumenteve të botuara, në këtë libër dalin në dritë shumë themelues të vakëfeve, që kanë një rëndësi të veçantë për ndërtimin e një vargu objektesh kulturore, higjienike, islame, sociale, historike, artistike etj.

Në bazë të këtyre dokumenteve, dr. Hasan Kaleshi ka ndriçuar një varg çështjesh të koklavitura. Ka hedhur poshtë tezën se hanin e vjetër të Shkupit, Kurshumli – han, e ka ndërtuar Justiniani ose Car Dushani dhe ka provuar se atë e ndërtoi Al-Madini, i cili ndërtoi edhe një han e një xhami në Trepçë dhe në Novi Pazar. Gjithashtu ndriçon problemin rreth xhamisë së Sinan Pashës në Prizren dhe Kaçanik.

Nuk ka dyshim se për një vepër të këtillë kërkohen njohuri të hollësishme të epigrafisë arabe dhe turke, njohuri për karakterin e objekteve të ndryshme, disiplinat islame, etj., me të cilat ka qenë i pajisur mirës, tani më i ndjeri, dr. Hasan Kaleshi.

RECENSIONE

Hysen Ibra

LIBËR ME QASJE REALE NDAJ ZHVARRIMEVE TË VARREZAVE NË JUG TË SHQIPËRISË NGA ANA E KISHËS DHE POLITIKËS GREKE

Në qershor të këtij viti (2006) pa dritën edhe një libër përmbajtësor me një mesazh të drejtë që i dedikohet objektivitetit nacional-shovinizmit dhe ekspansionizmit grek ndaj hapësirës shqiptare edhe në fillim të shekullit XXI, por edhe nonsholoncës, papërgjegjësisë dhe mosinteresimit të politikanëve shqiptarë dhe mostrajtimit të barabartë të shteteve, përkatësisht të popullit pa dallim të faktorit ndërkombëtar, veçmas ndaj këtij akti vandal dhe të egër të shovinistëve grekë! Libri i autorit të nderuar z.Nuri Dragoj, "Eshtra që akuzojnë...",[1] e trajton objektivisht e me një përkushtim këtë harbutëri të kishës dhe të politikës së Greqisë.

[1] Tiranë qershor 2006 faqe 203

Autoktonia e shqiptarëve të Çamërisë dhe trojeve tjera etnike nën Greqinë - historia dhe civilizimi

Me qëllim që lexuesi të ketë një pasqyrë më të qartë për lashtësinë, shtrirjen, kulturën e begatë dhe historinë e bujshme dhe krenare të shqiptarëve të Jugut të Shqipërisë dhe me aspiratat perfide e të egra të Greqisë ndaj shqiptarëve në vazhdimësi, si dhe librit në fjalë t'i bëjë një prezantim sa më cilësor, lexuesin e njoftoj: "Epiri përbën një krahinë dhe njërin nga ish-shtetet e Ilirisë së Jugut. Ai shtrihej në malet e Vetëtimës (Akrokeraunet antike) dhe në rrjedhën e mesme të Vjosës, deri në gjirin e Ambrakisë në jug dhe nga malet e Pindit në lindje deri në brigjet e detit Jon, në perëndim. Si emër i përveçëm gjeografik ai fillon të njihet nga fundi i shek. VI p.e.r., derisa në shek. IV p.e.r. mori edhe kuptimin e përcaktuar politik. Fiset (iliro-shqiptare-H.I.) që banonin në këtë trevë ishin Tesparotët, Kaonët dhe Molosët. Ato fise dolën në histori si forma politike në vete në Luftën e Peleponezit (432-404 p.e.r.).[2] Pastaj ky autor i mirënjohur vazhdon: "Asambleja Kombëtare e Greqisë, më 1844, përmes gojës së kryeministrit, Jane Koleti shpalli "Megali Idenë" (Idenë e Madhe) si themel të ekzistencës së Greqisë. Synimi ka qenë krijimi i një shteti të madh grek, në kufijtë e Perandorisë Bizantine, ku do të përfshiheshin edhe popullsi të tjera ballkanike (si shqiptarë, bullgarë, maqedonas etj). Në të njëjtën kohë (1844) veproi edhe shovinisti serb ish-kryeministri i Serbisë, Ilia Garashanini. Ndër të tjera, objekt i kësaj platforme ishte përfshirja në shtetin grek të një pjese të tokave shqiptare, më specifikisht edhe krahinat e Korçës dhe Gjirokastrës (mundësisht edhe më shumë), që Fuqitë e Mëdha Evropiane i njohën si pjesë të shtetit shqiptar, pasi i dhuruan Greqisë rajonet më jugore shqiptare në Epir, si Çamërinë dhe krahina të tjera, si Janinën dhe Kusturin".[3]

Shovinizmi dhe ekspansionizmi përkatësisht ksenofobia dhe gllabërimi grotesk grekomadh është shprehur edhe ndaj popujve të tjerë.

[2] Robert D. Kaplan, Greqia-dashnorja e Perëndimit, gruaja e Lindjes, Tiranë 2002 fq. 17.
[3] Po aty fq. 18.

"Më 1916, trupat greke pushtuan Selanikun. Më 1917 ra një zjarr i madh, i cili e rrafshoi krejt rajonin çifut (jahudi, përkatësisht izraelit-H.I.) të qytetit, përfshirë edhe 34 sinogoga. Numri i të pastrehëve arriti në 73.448, prej të cilëve 53.737 ishin çifutë".[4]

Përdorimi i eshtrave, për ta gllabëruar dhe helenizuar Jugun e Shqipërisë

Siç shihet nga titulli dhe përmbajtja e librit në fjalë, për objekt trajtimi ka zhvarrimet antiligjore dhe antinjerëzore të politikës greke të bërë me anën e kishës dhe të Konsullatës greke të instaluar në Gjirokastër. Ky veprim anticivilizues meriton një vëmendje të madhe, është një diskreditim publik kombëtar (shqiptar) e ndërkombëtar dhe nënçmim tejet i ulët, po ashtu kombëtar (shqiptar) dhe ndërkombëtar. Ngase të bëhen zhvarrime ditën nga institucionet shtetërore e fetare të një shteti tjetër, pa lejen e pushtetit (institucioneve) të shtetit tjetër, me ditë të tëra të lihen varret e hapura dhe eshtrat në lëndinë pa i izoluar, vërtet është një krim. Ndërkaq, institucionet lokale dhe qendrore të shtetit shqiptar të sillen me papërgjegjësi dhe gjakftohtë, duke mos reaguar në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe rregullativën juridike kombëtare, sikur të mos kishte ndodhur asgjë, është e paprecedent. Po kështu është vepruar edhe në hapjen e shkollave greke dhe uzurpimi i ndërtesës së Shtëpisë së Kulturës, po ashtu në Jug të Shqipërisë. Pastaj ngritja e kishave tjera greke dhe varrezave monumentale e çka jo greke në Jug të Shqipërisë, veçanërisht përgjatë kufirit administrativo-politik shqiptaro-grek, si në Korçë, Himar, Gjirokastër, Përmet, Këlcyrë etj., për të prezantuar si tokë greke, e pastaj aneksuar. Për klasën udhëheqëse dhe intelektuale shqiptare dhe greke më njerëzore, civilizuese dhe demokratike ka qenë, është, sidomos do të jetë, sikur të kishin ngritur monumente, lapidare, emërtuar institucione e sheshe me heronjtë shqiptarë-arvanitas të Vilajetit të Janinës, dhe revolucionarë të Revolucionit greko-shqiptar të 1821 dhe për patriotët shqiptarë që ranë dëshmorë apo u likuiduan nga politika e Athinës, që nga Kongresi i Berlinit (1878) e deri sot, sesa për monumentet dhe varrezat e ushtrisë vrastare grekomadhe!

[4] Po aty fq. 25.

Shkaku i një katrahure të tillë kombëtare shqiptare (në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi) që na ka përcjellë gjatë historisë, veçmas prej Kongresit të Berlinit, është harbutëria shoviniste e ekspansioniste e shteteve fqinje, veçanërisht e serbo-grekëve dhe fanatizmi e fundamentalizmi i disa shteteve proruse-sllavo-helene, si dhe siç thotë edhe autori z. Nuri Dragoj: "Shqiptarët e gjorë duket se kanë fatin më të keq në botë, për shkak se në krye nxjerrin përherë njerëzit më të papërshtatshëm" (fq. 13). Janë këta disa nga kryesuesit e anëtarët e kryesive të partive politike e të institucioneve shtetërore e publike. Janë këta disa udhëheqës, zyrtarë të lartë dhe biznesmenë shqiptarë, të cilët nuk kanë dhe nuk po kursejnë as shtetin, mirëqenien e popullsisë dhe moralin familjar, duke kolaboruar me armikun e popullit dhe ishbashkëpunëtorët e tij (të brendshëm e të jashtëm) " duke e gënjyer edhe mashtruar, vjedhur, plaçkitur popullin, dhe uzurpuar pasurinë kombëtare, duke mos kursyes asgjë që të vijnë apo të mbesin në pushtet dhe vende udhëheqëse, si dhe të pasurohen brenda nate. Pastaj, kur të vijnë në pushtet, nuk shikojnë që së pari të udhëheqin politikë të drejtë kombëtare, që edhe populli shqiptar më i lashti dhe më i shtriri në Gadishullin Ilirik (Ballkan) më në fund të jetë i bashkuar dhe i zhvilluar, përkatësisht i barabartë me popujt e tjerë. Të zhvillojnë ekonomi dhe planifikim hapësinor e urbanistik të qëndrueshëm e për popull, e jo për një shtresë të korruptuar, mafioze dhe keqpërdoruese të ligjit dhe detyrës zyrtare. Pastaj mosngritja në një nivel më të mirë të arsimit, shëndetësisë, ekologjisë, urbanistikës, bujqësisë dhe kulturës. Por, krijuan biznese, karrierë, aventurë për vete, familje të afërm e grupe në dëm flagrant të popullit dhe atdheut. Me ç'rast u përshkallëzua varfëria, shtimi i dallimit mes shtresave (të pasur e të varfër), emigracion të madh, sidomos të rinisë, papunësi enorme, shtim të kriminalitetit e të korrupsionit etj., veçmas i zgjuan apetitet e shteteve fqinje për rianeksime. Duke e detyruar popullin që për kafshatën e bukës t'i zhvarrosin edhe eshtrat e të parëve të tyre që t'ia shesin armikut shekullor që të mbijetojnë; të emigrojnë për të fituar kafshatën e

gojës te armiqtë. Me ç'rast popullin po e zhveshin nga tradita e denjë dhe po ia zymtësojnë ardhmërinë. Me të drejtë edhe publicisti Koço Danaj i quan "Tragjikët e Evropës" atë kategori të klasës udhëheqëse e intelektuale shqiptare, të cilët nuk çajnë kokën për popull.

Vepra "Eshtrat që akuzojnë..." i autorit N. Dragoj shquhet me një gjuhë të pastër, realizëm prezantues të qëllimit dhe të zhvillimit të aksionit të zhvarrimit të eshtrave, me një përshkrim të drejtë e në mënyrë kronologjike e me faktografi, duke e dokumentuar dhe bërë një komparacion të së tashmes me të kaluarën, si mes Shqipërisë e Greqisë dhe Italisë e Shqipërisë me dëshmi analitike, se çdo armik që i ka mësy ta okupojë Shqipërinë, ka gjetur vdekjen nga populli liridashës shqiptar.

Ndarja e librit

Përmbajtja e librit ndahet në tri pjesë kryesore: Pjesa e parë fillon me hyrje e në vazhdim pason një shkrim analitik me titull: "Shqiptarët e duan miqësinë me fqinjët", dëshirë e cila me çdoherë është keqpërdorur dhe manipuluar nga fqinjët, veçmas nga Greqia dhe ish-Jugosllavia, përkatësisht Serbia e madhe. Autori z.Dragoj, në kaptinën "Pak histori" në mënyrë kronologjike prezanton dhe shpjegon një historik të shkurtër të aspiratave, represionit dhe makinacionet e shteteve fqinje, por edhe të atyre me interes në Shqipëri që nga viti 1940 e deri te Deklarata e përbashkët e 44 Shoqatave Atdhetare e Kulturore të Shqipërisë drejtuar presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Alfred Moisiu, kryetares së Parlamentit znj. Jozefina Topalli dhe kryeministrit të Shqipërisë, z. Sali Berisha, të parashtruar më 12 qershor 2006, të titulluar "Interesi kombëtar mbi të gjitha", në të cilën kërkohet që problemet e ndodhura, veçmas ato në Kutal e Kosinë, por edhe kudo të trajtohen dhe analizohen me përgjegjësi deri në fund.

Pjesën e dytë, autori e fillon me një letër të Komunitetit Mysliman të Përmetit që i drejtohet po ashtu: kryetarit të Republikës, kryetarit të Parlamentit, kryeministrit të Qeverisë së Shqipërisë, ministrit të Drejtësisë së kësaj qeverie dhe institucioneve të tjera, që mban datën 10

prill 2006, në të cilën thuhet se "nuk po zbatohen ligjet, shtëpia e kulturës "Sami Frashëri" në Përmet e uzurpuar prej kishës ortodokse nuk po i kthehet popullit siç duhet t'i kthehet edhe pallati i sportit, sportistëve nga kisha etj.

Teqeja, kisha dhe xhamia duhet t'i përmbahen dhe të respektojnë kushtetutën dhe ligjet e shtetit. Ndërkaq, shteti dhe faktori ndërkombëtar t'i trajtojnë njëjtë pa dallim institucionet konfesionale". Autori pastaj vazhdon me pyetjet se "ç'po ndodh në Përmet"! dhe kujt i shërbejnë kishat greke që ndërtohen në Jug të Shqipërisë, "A po i mbrojnë interesat kombëtare institucionet shtetërore"? " pse nuk hiqet Ligji i luftës nga Greqia me Shqipërinë"? Z.N.Dragoj në librin në fjalë, lexuesit i ofron edhe faktografi e dëshmi nga e kaluara kur shkruan: "Në Gjirokastër, nën kryesinë e ministrit të Jashtëm të Greqisë, Jorgji Zagrofi dhe të zëvendësministrit të Jashtëm grek Dhuli, më 8 mars 1914, u organizua Kongresi Epirot, i cili shpalli "Autonominë e Verio-Epirit". Kështu ra dakord në parim që të vazhdonin veprimtarinë antishqiptare për të greqizuar me çdo kusht Jugun e Shqipërisë" (fq. 129). Këtij vendimi antishqiptar dhe antipaqësor në rajon, i parapriu vendimi edhe më i padrejtë e me peshë më të rëndë destabilizuese, vendimi i Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha të Evropës i vitit 1913 për ricopëtimin e trojeve shqiptare në favor të Greqisë, Serbisë dhe Malit të Zi, i cili ishte vendimi i dytë pas vendimit të Kongresit të Berlinit të vitit 1878 për copëtimin e hapësirës shqiptare. Pastaj autori lexuesit i informon se përkundër vështirësive, shqiptarët më 1929 e shpallën Kishën Ortodokse Shqiptare Autoqefale, me në krye kryepeshkopin e nderuar shqiptar, Imzot Visarion Xhuvanin dhe miratuan statutin të KOASH, më 29 qershor 1929, autoqefali të cilën, kjo kishë prestigjioze e humbi me ardhjen e detektivit grek, Anastas Janullatosit në krye të saj me ndihmën e "pushtetit" të Shqipërisë më 1996. Pjesën e tretë të librit, "Eshtra që akuzojnë..." autori e fillon me intervistën e z.prof. dr. Sabri Godos, dhënë gazetës "Standard" të datës 3 qershor 2006, duke vazhduar me intervistën e prof. dr. Beqir Metës, 'Memorial përkujtimor edhe për varret çame dhënë gazetës' "Republika" të datës 6.06.2006, për të vazhduar me kërkesën e aktivistit shqiptaro-ameri-

kan z.Geri Kokollari, se "Janullatos duhet të largohet nga Shqipëria" duke përfunduar me një përmbyllje në formë të rezymesë, në të cilën lëshohet një gabim teknik i përsëritjes së disa faqeve.

Lirisht mund të konkludojmë, se libri trajton një çështje aq me rëndësi - aspiratën e Greqisë për ta gllabëruar dhe asimiluar Jugun e Shqipërisë, me ndihmën edhe të institucionit të vet me vepruesin gjatë historisë kundër shqiptarëve- Kishës ortodokse greke. Libër ky që doemos duhet të lexohet dhe sugjerimet e tij të respektohen dhe zbatohen.

Autorit i dëshiroj shëndet dhe suksese që të na ofrojë libra të tjerë të mirë.

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina
"Gjashtë shtekuj të Islamit ndër shqitparët **5**

Akademik Jashar Rexhepagig
Disa përparësi të arsimit në Kosovën e re, evropiane dhe moderne **11**

Orhan Bislimaj
Nocionet "islam" dhe "iman", entitete të ndara dhe të bashkuara **17**

Ibn Rushd & (Averroes)
Pajtimi ndërmjet sheriatit dhe filozoffisë **45**

Abdullah Nasih Ulvan
Liria e besimit në Ligjin Islam **87**

Ajni Sinani
Të drejtat e njeriut sipas botëkuptimit Islam dhe atij perëndimor **115**

Hasan Kaleshi – Ismail Eren
Mahmud Pashë Rrotlla nga Prizreni – përshpirtënimet dhe vakëfnameja e tij **151**

Mirije Xhezairi
Xhamitë monumentale në Prizren **191**

Rozhe Garodi
Kontributi i kulturës Islame civilizimit botëror **215**

Nexhat Ibrahimi
Kadijanistët dhe Ahmedistët **245**

Të dhëna për Shqipërinë në prag të pavarësisë në revistën "El-Hilal" të Kajros **263**

Avni Aliu
Kuptimi shumëdimensional i namazit **281**

Islami në Australi dhe në Zelandën e Re **307**

Raportet e luftës të Lav Trockit **327**

Dr. Feti Mehdiu
Dr. Hasan Kaleshi, Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku **341**

Hysen Ibra
Libër me qasje reale ndaj zhvarrimeve të varrezave në Jug të Shqipërisë nga ana e kishës dhe politikës greke **347**

Përmbajtja **355**